

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË*

(Ndryshuar me ligjet: nr. 9675, datë 13.1.2007; nr. 9904, datë 21.4.2008; nr. 88/2012, datë 18.9.2012; nr. 137/2015, datë 17.12.2015; nr. 76/2016, datë 22.7.2016; nr. 115/2020, datë 30.7.2020; nr. 16/2022, datë 10.2.2022)

Ne, Populli i Shqipërisë, krenarë dhe të vetëdijshëm për historinë tonë, me përgjegjësi për të ardhmen, me besim te Zoti dhe/ose te vlera të tjera universale, me vendosmërinë për të ndërtuar një shtet të së drejtës, demokratik e social, për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, me frymën e tolerancës dhe të bashkëjetesës fetare, me zotimin për mbrojtjen e dinjitetit dhe të personalitetit njerëzor, si dhe për prosperitetin e të gjithë kombit, për paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror, me aspiratën shekullore të popullit shqiptar për identitetin dhe bashkimin kombëtar, me bindjen e thellë se drejtësia, paqja, harmonia dhe bashkëpunimi ndërmjet kombeve janë ndër vlerat më të larta të njerëzimit,

VENDOSIM KËTË KUSHTETUTË:

PJESA E PARË

PARIME THEMELORE

Neni 1

1. Shqipëria është Republikë parlamentare.
2. Republika e Shqipërisë është shtet unitar dhe i pandashëm.
3. Qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike.

Neni 2

1. Sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i përket popullit.
2. Populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërsë-drejt.
3. Për ruajtjen e paqes dhe të interesave kombëtare, Republika e Shqipërisë mund të marrë pjesë në një sistem sigurimi kolektiv, në bazë të një ligji të miratuar me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Neni 3

Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë.

Neni 4

* Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë është miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998.

1. E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit.
2. Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë.
3. Dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe.

Neni 5

Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të.

Neni 6

Organizimi dhe funksionimi i organeve të parashikuara në këtë Kushtetutë rregullohen me ligjet e tyre përkatëse, përveç rasteve kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe.

Neni 6/1

(Shtuar me ligjin nr. 137/2015, datë 17.12.2015)

Ndalohet zgjedhja, emërimi apo ushtrimi i një funksioni publik në një nga organet e parashikuara në këtë Kushtetutë, ose të krijuara me ligj, pavarësisht përcaktimeve të bëra në dispozitat e tjera të kësaj Kushtetute, nëse verifikohen rrethana që cenojnë integritetin e funksionarit publik, sipas kushteve dhe rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Neni 7

Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor.

Neni 8

1. Republika e Shqipërisë mbron të drejtat kombëtare të popullit shqiptar që jeton jashtë kufijve të saj.
2. Republika e Shqipërisë mbron të drejtat e shtetasve shqiptarë me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të vet.
3. Republika e Shqipërisë u siguron ndihmë shtetasve shqiptarë që jetojnë e punojnë jashtë shtetit për të ruajtur e për të zhvilluar lidhjet me trashëgiminë kulturore kombëtare.

Neni 9

1. Partitë politike krijohen lirisht. Organizimi i tyre duhet të përputhet me parimet demokratike.
2. Partitë politike dhe organizatat e tjera, programet dhe veprimtaria e të cilave mbështeten në metoda totalitariste, që nxitin e përkrahin urrejtjen racore, fetare, krahinore ose etnike, që përdorin dhunën për marrjen e pushtetit ose për të ndikuar në politikën shtetërore, si edhe ato me karakter të fshehtë janë të ndaluara sipas ligjit.
3. Burimet financiare të partive, si dhe shpenzimet e tyre bëhen kurdoherë publike.

Neni 10

1. Në Republikën e Shqipërisë nuk ka fe zyrtare.
2. Shteti është asnjans në çështjet e besimit e të ndërgjegjes dhe garanton lirinë e shprehjes së tyre në jetën publike.
3. Shteti njih barazinë e bashkësive fetare.
4. Shteti dhe bashkësitë fetare respektojnë në mënyrë të ndërsjellë pavarësinë e njëri-tjetrit dhe bashkëpunojnë në të mirë të secilit dhe të të gjithëve.
5. Marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare rregullohen mbi bazën e marrëveshjeve të lidhura ndërmjet përfaqësuesve të tyre dhe Këshillit të Ministrave. Këto marrëveshje ratifikohen në Kuvend.
6. Bashkësitë fetare janë persona juridikë. Ato kanë pavarësi në administrimin e pasurive të tyre sipas parimeve, rregullave dhe kanoneve të tyre, për sa nuk cenohen interesat e të tretëve.

Neni 11

1. Sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike.
2. Prona private dhe publike mbrohen njëjloj me ligj.
3. Kufizime të lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike.

Neni 12

1. Forcat e armatosura sigurojnë pavarësinë e vendit, si dhe mbrojnë tërësinë territoriale dhe rendin e tij kushtetues.
2. Forcat e armatosura ruajnë asnjansinë në çështjet politike dhe i nënshtrohen kontrollit civil.
3. Asnjë forcë e huaj ushtarake nuk mund të vendoset dhe as të kalojë në territorin shqiptar, si dhe asnjë forcë ushtarake shqiptare nuk mund të dërgohet jashtë, përveçse me një ligj të miratuar me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Neni 13

Qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë ngrihet në bazë të parimit të decentralizmit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore.

Neni 14

1. Gjuha zyrtare në Republikën e Shqipërisë është shqipja.
2. Flamuri kombëtar është i kuq me një shqiponjë të zezë dykrenore në mes.
3. Stema e Republikës së Shqipërisë paraqet një shqyt me fushë të kuqe me një shqiponjë të zezë dykrenore në mes. Në krye të shqytit, me ngjyrë të artë, është vendosur përkrenarja e Skënderbeut.
4. Himni kombëtar është “Rreth Flamurit të Përbashkuar”.
5. Festa Kombëtare e Republikës së Shqipërisë është Dita e Flamurit, 28 Nëntori.
6. Kryeqyteti i Republikës së Shqipërisë është Tirana.
7. Forma dhe përmasat e simboleve kombëtare, përmbajtja e tekstit të himnit kombëtar, si dhe përdorimi i tyre rregullohen me ligj.

PJESA E DYTË TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE TË NJERIUT

KREU I
PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 15

1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik.

2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Neni 16

1. Të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejnë njëloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara.

2. Të drejtat dhe liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave, lirive dhe detyrimeve.

Neni 17

1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Neni 18

1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.

2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive.

Neni 19

1. Kushdo që lind duke pasur qoftë edhe njërin prej prindërve me shtetësi shqiptare, e fiton vetiu shtetësinë shqiptare. Shtetësia shqiptare fitohet edhe për shkaqe të tjera të parashikuara me ligj.

2. Shtetasi shqiptar nuk mund ta humbasë shtetësinë, përveçse kur ai heq dorë prej saj.

Neni 20

1. Personat që u përkasin pakicave kombëtare ushtrojnë në barazi të plotë para ligjit të drejtat dhe liritë e tyre.

2. Ata kanë të drejtë të shprehin lirisht, pa u ndaluar as detyruar, përkatësinë e tyre etnike, kulturore, fetare e gjuhësore. Ata kanë të drejtë t'i ruajnë e zhvillojnë ato, të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën e tyre amtare, si dhe të bashkohen në organizata e shoqata për mbrojtjen e

interesave dhe të identitetit të tyre.

KREU II LIRITË DHE TË DREJTAT VETJAKE

Neni 21

Jeta e personit mbrohet me ligj.

Neni 22

1. Liria e shprehjes është e garantuar.
2. Liria e shtypit, e radios dhe e televizionit është e garantuar.
3. Censura paraprake e mjeteve të komunikimit ndalohet.
4. Ligji mund të kërkojë dhënien e autorizimit për funksionimin e stacioneve të radios ose të televizionit.

Neni 23

1. E drejta e informimit është e garantuar.
2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.
3. Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.

Neni 24

1. Liria e ndërgjegjes dhe e fesë është e garantuar.
2. Secili është i lirë të zgjedhë ose të ndryshojë fenë ose bindjet, si dhe t'i shfaqë ato individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së riteve.
3. Askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohet të marrë pjesë në një bashkësi fetare ose në praktikat e saj, si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij.

Neni 25

Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues.

Neni 26

Askujt nuk mund t'i kërkohej të kryejë një punë të detyruar, përveçse në rastet e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor, të kryerjes së shërbimit ushtarak, të një shërbimi që rrjedh nga një gjendje lufte, nga një gjendje e jashtëzakonshme ose nga një fatkeqësi natyrore, që kërcënon jetën ose shëndetin e njerëzve.

Neni 27

1. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj.
2. Liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastet e mëposhtme:
 - a) kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente;

b) për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës ose për moszbatim të ndonjë detyrimi të caktuar me ligj;

c) kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj;

ç) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent;

d) kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paaftë mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë;

dh) për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose të ekstradimit.

3. Askujt nuk mund t'i hiqet liria vetëm për shkak se nuk është në gjendje të përmbushë një detyrim kontraktor.

Neni 28

1. Kushdo, të cilit i hiqet liria, ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet. Personi, të cilit i është hequr liria, duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me avokatin, si dhe t'i jepet mundësia për realizimin e të drejtave të tij.

2. Personi, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, paragrafi 2, nënparagrafi "c", duhet të dërgohet brenda 48 orëve përpara gjyqtarit, i cili vendos paraburgimin ose lirinë e tij jo më vonë se 48 orë nga çasti i marrjes së dokumenteve për shqyrtim.

3. I paraburgosuri ka të drejtë të ankohet kundër vendimit të gjyqtarit. Ai ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të procedohet i lirë përkundërt një garancie pasurore sipas ligjit.

4. Në të gjitha rastet e tjera, personi, të cilit i hiqet liria në rrugë jashtëgjyqësore, mund t'i drejtohet në çdo kohë gjyqtarit, i cili vendos brenda 48 orëve për ligjshmërinë e kësaj mase.

5. Çdo person, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij.

Neni 29

1. Askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një vepër penale, e cila nuk konsiderohet e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj, me përjashtim të veprave, të cilat në kohën e kryerjes së tyre, përbënin krime lufte ose krime kundër njerëzimit sipas së drejtës ndërkombëtare.

2. Nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ka qenë parashikuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës penale.

3. Ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese.

Neni 30

Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Neni 31

Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë:

a) të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet, për të drejtat e tij, si dhe t'i krijohet mundësia për të njoftuar familjen ose të afërmit e tij;

b) të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;

- c) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën shqipe;
- ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme;
- d) t'u bëjë pyetje dëshmitarëve të pranishëm dhe të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.

Neni 32

1. Askush nuk mund të detyrohet të dëshmojë kundër vetvetes ose familjes së vet dhe as të pohojë fajësinë e tij.
2. Askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme.

Neni 33

1. Kushdo ka të drejtë të dëgjohet para se të gjykohet.
2. Nga kjo e drejtë nuk mund të përfitojë personi që i fshihet drejtësisë.

Neni 34

Askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale dhe as të gjykohet sërish, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga një gjykatë më e lartë, sipas mënyrës së parashikuar me ligj.

Neni 35

1. Askush nuk mund të detyrohet, përveçse kur e kërkon ligji, të bëjë publike të dhëna që lidhen me personin e tij.
2. Mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.
3. Kushdo ka të drejtë të njihet me të dhënat e mbledhura rreth tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.
4. Kushdo ka të drejtë të kërkojë ndreqjen ose fshirjen e të dhënave të pavërteta ose të paplota ose të mbledhura në kundërshtim me ligjin.

Neni 36

Liria dhe fshehtësia e korrespondencës ose e çdo mjeti tjetër të komunikimit janë të garantuara.

Neni 37

1. Paprekshmëria e banesës është e garantuar.
2. Kontrollat e banesës, si dhe të mjediseve që njësohen me të, mund të bëhen vetëm në rastet dhe në mënyrat e parashikuara me ligj.
3. Askujt nuk mund t'i bëhet kontroll vetjak jashtë procesit penal, me përjashtim të rasteve të hyrjes në territorin e shtetit dhe të daljes prej tij ose për të mënjanuar një rrezik që i kanoset sigurimit publik.

Neni 38

1. Kushdo ka të drejtë të zgjedhë vendbanimin si dhe të lëvizë lirisht në çdo pjesë të territorit të shtetit.
2. Askush nuk mund të pengohet të dalë lirisht jashtë shtetit.

Neni 39

1. Asnjë shtetas shqiptar nuk mund të dëbohet nga territori i shtetit.
2. Ekstradimi mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, dhe vetëm me vendim gjyqësor.
3. Ndalohet dëbimi kolektiv i të huajve. Dëbimi i individëve të huaj lejohet në kushtet e përcaktuara me ligj.

Neni 40

Të huajt kanë të drejtën e strehimit në Republikën e Shqipërisë sipas ligjit.

Neni 41

1. E drejta e pronës private është e garantuar.
2. Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil.
3. Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publikë.
4. Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundëjt një shpërblimi të drejtë.
5. Për mosmarrëveshjet lidhur me masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë.

Neni 42

1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.
2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

Neni 43

(Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës.

Neni 44

Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore.

KREU III LIRITË DHE TË DREJTAT POLITIKE

Neni 45

(Ndryshuar paragrafi i tretë me ligjin nr. 137/2015, datë 17.12.2015)

1. Çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet.

2. Përrjashtohen nga e drejta e zgjedhjes shtetasit e deklaruar me vendim gjyqësor të formës së prerë si të paaftë mendërisht.

3. Përrjashtohen nga e drejta për t'u zgjedhur shtetasit që janë dënuar me burgim, me vendim përrfundimtar të formës së prerë, për kryerjen e një krimi, sipas rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në raste përrjashtëmore dhe të justifikuara, ligji mund të parashikojë kufizime të së drejtës për të zgjedhur të shtetasve që vuajnë dënimin me heqje lirie, ose të së drejtës për t'u zgjedhur para dhënies së një vendimi përrfundimtar apo kur shtetasit janë dëbuar për një krim ose për cenim shumë të rëndë dhe serioz të sigurisë publike.

4. Vota është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.

Neni 46

1. Kushdo ka të drejtë të organizohet kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm.

2. Regjistrimi në gjykatë i organizatave ose i shoqatave bëhet sipas procedurës së parashikuar me ligj.

3. Organizatat ose shoqatat që ndjekin qëllime antikushtetuese janë të ndaluara sipas ligjit.

Neni 47

1. Liria e tubimeve paqësore dhe pa armë, si dhe e pjesëmarrjes në to është e garantuar.

2. Tubimet paqësore në sheshe dhe në vendet e kalimit publik bëhen sipas procedurave të parashikuara me ligj.

Neni 48

Kushdo, vetë ose së bashku me të tjerë, mund t'u drejtojë kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përrgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj.

KREU IV LIRITË DHE TË DREJTAT EKONOMIKE, SOCIALE DHE KULTURORE

Neni 49

1. Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme, që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional.

2. Të punësuarit kanë të drejtën e mbrojtjes shoqërore të punës.

Neni 50

Të punësuarit kanë të drejtë të bashkohen lirisht në organizata sindikale për mbrojtjen e interesave të tyre të punës.

Neni 51

1. E drejta e të punësuarit për grevë që ka të bëjë me marrëdhëniet e punës, është e garantuar.

2. Kufizime për kategori të veçanta të punësuarish mund të vendosen me ligj për t'i siguruar shoqërisë shërbimet e domosdoshme.

Neni 52

1. Kushdo ka të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri ose kur është i paafte për punë, sipas një sistemi të caktuar me ligj.

2. Kushdo, kur mbetet pa punë për shkaqe të pavarura nga vullneti i tij dhe kur nuk ka mjete të tjera jetese, ka të drejtën e ndihmës në kushtet e parashikuara me ligj.

Neni 53

1. Kushdo ka të drejtë të martohet dhe të ketë familje.

2. Martesa dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit.

3. Lidhja dhe zgjidhja e martesës rregullohen me ligj.

Neni 54

1. Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti.

2. Fëmijët e lindur jashtë martese kanë të drejta të barabarta me të lindurit nga martesa.

3. Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal.

Neni 55

1. Shtetasit gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti.

2. Kushdo ka të drejtë për sigurim shëndetësor sipas procedurës së caktuar me ligj.

Neni 56

Kushdo ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij.

Neni 57

1. Kushdo ka të drejtën për arsimim.

2. Arsimi shkollor i detyrueshëm caktohet me ligj.

3. Arsimi i mesëm i përgjithshëm publik është i hapur për të gjithë.

4. Arsimi i mesëm profesional dhe i lartë mund të kushtëzohet vetëm nga kritere aftësie.

5. Arsimi i detyrueshëm, si dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike është falas.

6. Nxënësit dhe studentët mund të arsimohen edhe në shkolla jopublike të të gjitha niveleve, të cilat krijohen e funksionojnë në bazë të ligjit.

7. Autonomia e institucioneve të arsimit të lartë dhe liria akademike janë të garantuara me ligj.

Neni 58

1. Liria e krijimit artistik dhe e kërkimit shkencor, vënia në përdorim, si dhe përfitimi prej arritjeve të tyre janë të garantuara për të gjithë.
2. E drejta e autorit mbrohet me ligj.

KREU V OBJEKTIVAT SOCIALË

Neni 59

1. Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon:
 - a) punësimin në kushte të përshtatshme të të gjithë personave të aftë për punë;
 - b) plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim;
 - c) standardin më të lartë shëndetësor, fizik e mendor, të mundshëm;
 - ç) arsimimin dhe kualifikimin sipas aftësive të fëmijëve dhe të të rinjve, si dhe të personave të pazënë me punë;
 - d) një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm;
 - dh) shfrytëzimin racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm;
 - e) përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët;
 - ë) zhvillimin e sportit dhe të veprimtarive ripërtëritëse;
 - f) riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paafteve, si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës;
 - g) mbrojtjen e trashëgimisë kombëtare, kulturore dhe kujdesin e veçantë për gjuhën shqipe.
2. Përmbushja e objektivave sociale nuk mund të kërkohet drejtpërdrejt në gjykatë. Ligji përcakton kushtet dhe masën në të cilat mund të kërkohet realizimi i këtyre objektivave.

KREU VI AVOKATI I POPULLIT

Neni 60

1. Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike.
2. Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës së tij.
3. Avokati i Popullit ka buxhet të veçantë, të cilin e administron vetë. Ai e propozon buxhetin sipas ligjit.

Neni 61

1. Avokati i Popullit zgjidhet nga tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për një periudhë prej 5 vjetësh, me të drejtë rizgjedhjeje.
2. Avokati i Popullit mund të jetë çdo shtetas shqiptar, me arsim të lartë, me njohuri dhe veprimtari të njohura në fushën e të drejtave të njeriut dhe të ligjit.
3. Avokati i Popullit gëzon imunitetin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.
4. Avokati i Popullit nuk mund të bëjë pjesë në asnjë parti politike, nuk mund të kryejë veprimtari tjetër politike, shtetërore ose profesionale dhe as të marrë pjesë në organizmat drejtues të organizatave shoqërore, ekonomike dhe tregtare.

Neni 62

1. Avokati i Popullit mund të shkarkohet vetëm me kërkesë të motivuar të jo më pak se një së tretës së deputetëve.
2. Në këtë rast Kuvendi vendos me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të tij.

Neni 63

1. Avokati i Popullit paraqet raport vjetor përpara Kuvendit.
2. Avokati i Popullit raporton përpara Kuvendit kur i kërkohet prej këtij, si dhe mund t'i kërkojë Kuvendit të dëgjohet për çështje që ai i çmon të rëndësishme.
3. Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike.
4. Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij.

PJESA E TRETË KUVENDI

KREU I ZGJEDHJA DHE AFATI

Neni 64

(Ndryshuar me ligjin nr. 9904, datë 21.4.2008, nr. 115/2020, datë 30.7.2020)

1. Kuvendi përbëhet nga 140 deputetë, të zgjedhur sipas një sistemi zgjedhjesh proporcional me konkurrim rajonal dhe prag kombëtar.
2. Në shpërndarjen e mandateve marrin pjesë subjektet zgjedhore që arrijnë pragon kombëtar.
3. Zgjedhësit gëzojnë të drejtën për të dhënë votë parapëlqyese për kandidatët e listave shumemërore. Kriteret dhe rregullat për zbatimin e sistemit zgjedhor, për caktimin e zonave zgjedhore, pragon kombëtar, numrin e mandateve për secilën zonë, shpërndarjen e mandateve dhe masën e shtrirjes së votimit parapëlqyes përcaktohen në ligjin për zgjedhjet. Ligji për zgjedhjet garanton që votimit parapëlqyes t'i nënshtrohen jo më pak se dy të tretat e listës shumemërore dhe të sigurojë përfaqësim gjinor.

Neni 65

(Ndryshuar me ligjin nr. 9904, datë 21.4.2008)

1. Kuvendi zgjidhet çdo 4 vjet. Mandati i Kuvendit fillon me mbledhjen e parë të tij pas zgjedhjeve dhe përfundon në të njëjtën datë të të njëjtut muaj të vitit të katërt nga data e mbledhjes së parë. Në çdo rast, Kuvendi qëndron në detyrë deri në mbledhjen e parë të Kuvendit të ri të zgjedhur.
2. Zgjedhjet për Kuvendin e ri zhvillohen në periudhën zgjedhore më të afërt që i paraprin datës së përfundimit të mandatit të Kuvendit. Periudhat zgjedhore dhe rregullat për thirrjen e zgjedhjeve për Kuvendin përcaktohen në ligjin për zgjedhjet.
3. Në rast shpërndarjeje të Kuvendit para përfundimit të mandatit të plotë, zgjedhjet thirren jo më vonë se 45 ditë pas shpërndarjes së tij.
4. Kuvendi nuk mund të nxjerrë ligje gjatë periudhës 60 ditë para mbarimit të mandatit të tij deri në mbledhjen e parë të Kuvendit të ri, me përjashtim të rasteve të vendosjes së masave të

jashtëzakonshme.

Neni 66

Mandati i Kuvendit zgjatet vetëm në rast lufte dhe për aq kohë sa vazhdon ajo. Kur Kuvendi është i shpërndarë, ai rithirret vetiu.

Neni 67

(Ndryshuar me ligjin nr. 9904, datë 21.4.2008)

1. Presidenti i Republikës e mbledh Kuvendin e porsazgjedhur jo më parë se data e përfundimit të mandatit të Kuvendit paraardhës, por jo më vonë se 10 ditë pas mbarimit të këtij mandati. Kur Kuvendi paraardhës është shpërndarë para mbarimit të mandatit, Presidenti i Republikës e mbledh Kuvendin e ri jo më vonë se 10 ditë pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve.

2. Në rast se Presidenti i Republikës nuk e ushtron këtë kompetencë, Kuvendi vetëmbledhet në ditën e dhjetë të afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

KREU II DEPUTETËT

Neni 68

(Ndryshuar me ligjin nr. 9904, datë 21.4.2008, ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 115/2020, datë 30.7.2020)

1. Kandidatët për deputetë paraqiten në nivel zone zgjedhore nga partitë politike ose nga zgjedhësit. Një kandidat mund të paraqitet vetëm për një nga subjektet propozuese, sipas kësaj pike. Rregullat për regjistrimin e kandidatëve për deputetë përcaktohen në ligjin për zgjedhjet.

2. Në ligjin për zgjedhjet përcaktohen edhe kritere dhe rregulla të tjera të nevojshme për organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve, duke përfshirë ato për regjistrimin e zgjedhësve, zhvillimin e fushatës zgjedhore, administrimin, vlefshmërinë e zgjedhjeve dhe shpalljen e rezultateve të tyre.

Neni 69

1. Nuk mund të kandidojnë e as të zgjidhen deputetë, pa hequr dorë nga detyra:

- a) gjyqtarët, prokurorët;
- b) ushtarakët e shërbimit aktiv;
- c) punonjësit e policisë dhe të sigurimit kombëtar;
- ç) përfaqësuesit diplomatikë;
- d) kryetarët e bashkive dhe të komunave, si dhe prefektët në vendet ku kryejnë detyrat e tyre;
- dh) kryetarët dhe anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve;
- e) Presidenti i Republikës dhe funksionarët e lartë të administratës shtetërore të parashikuar nga ligji.

2. Mandati i fituar në kundërshtim me paragrafin 1 të këtij neni është i pavlefshëm.

Neni 70

1. Deputetët përfaqësojnë popullin dhe nuk lidhen me asnjë mandat detyrues.

2. Deputetët nuk mund të ushtrojnë njëkohësisht asnjë detyrë tjetër shtetërore, përveç asaj të anëtarit të Këshillit të Ministrave. Rastet e tjera të papajtushmërisë caktohen me ligj.

3. Deputetët nuk mund të kryejnë asnjë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të fitojnë pasuri të këtyre.

4. Për çdo shkelje të paragrafit 3 të këtij neni, me mocion të kryetarit të Kuvendit ose të një së dhjetës së anëtarëve të tij, Kuvendi vendos për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, e cila konstaton papajtueshmërinë.

Neni 71

1. Mandati i deputetit fillon ditën që ai shpallet i zgjedhur nga komisioni përkatës i zgjedhjeve.

2. Mandati i deputetit mbaron ose është i pavlefshëm, sipas rastit:

- a) kur ai nuk bën betimin;
- b) kur heq dorë nga mandati;
- c) kur vërtetohet një nga kushtet e pazgjedhshmërisë ose papajtueshmërisë të parashikuara në nenet 69, 70 paragrafët 2 dhe 3;
- ç) kur mbaron mandati i Kuvendit;
- d) kur mungon pa arsye mbi 6 muaj rresht në Kuvend;
- dh) kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

Neni 72

Para fillimit të ushtrimit të mandatit deputetët bëjnë betimin në Kuvend.

Neni 73

(Ndryshuar me ligjin nr. 88/2012, datë 18.9.2012, ndryshuar paragrafi 3, me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

1. Deputeti nuk mban përgjegjësi për mendimet e shprehura në Kuvend dhe votat e dhëna prej tij në ushtrim të funksionit. Kjo dispozitë nuk zbatohet në rastin e shpifjes.

2. Deputeti nuk mund të arrestohet ose t'i hiqet liria në çfarëdo lloj forme apo ndaj tij të ushtrohet kontroll personal ose i banesës, pa autorizimin e Kuvendit.

3. Deputeti mund të ndalohet ose të arrestohet pa autorizim kur kapet në kryerje e sipër ose menjëherë pas kryerjes së një krimi të rëndë. Prokurori i Përgjithshëm ose Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme njofton menjëherë Kuvendin, i cili, kur konstaton se nuk ka vend për procedim, vendos për heqjen e masës.

4. Për çështjet e parashikuara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, Kuvendi mund të diskutojë në seancë me dyer të mbyllura, për arsye të mbrojtjes së të dhënave. Vendimi merret me votim të hapur.

KREU III ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

Neni 74

1. Kuvendi i zhvillon punimet vjetore në dy sesione. Sesioni i parë fillon të hënën e tretë të janarit dhe sesioni i dytë të hënën e parë të shtatorit.

2. Kuvendi mbledhet në sesion të jashtëzakonshëm, kur kërkohet nga Presidenti i Republikës, nga Kryeministri ose nga një e pesta e të gjithë deputetëve.

3. Sesionet e jashtëzakonshme thirren nga Kryetari i Kuvendit në bazë të një rendi dite të përcaktuar.

Neni 75

1. Kuvendi zgjedh dhe shkarkon Kryetarin e vet.
2. Kuvendi organizohet dhe funksionon sipas rregullores së miratuar nga shumica e të gjithë anëtarëve.

Neni 76

1. Kryetari kryeson debatin, drejton punimet, siguron respektimin e të drejtave të Kuvendit dhe të anëtarëve të tij, si dhe përfaqëson Kuvendin në marrëdhëniet me të tjerët.
2. Nëpunësi më i lartë civil i Kuvendit është sekretari i përgjithshëm.
3. Shërbimet e tjera të nevojshme për funksionimin e Kuvendit kryhen nga nëpunës të tjerë, siç përcaktohet në rregulloren e brendshme.

Neni 77

1. Kuvendi zgjedh nga gjiri i tij komisione të përhershme, si dhe mund të caktojë komisione të posaçme.
2. Kuvendi ka të drejtë dhe, me kërkesë të një së katërtës së të gjithë anëtarëve të tij, është i detyruar të caktojë komision hetimi për të shqyrtuar një çështje të veçantë. Përfundimet e tyre nuk janë detyruese për gjykatat, por mund t'i njoftohen prokurorisë, e cila i vlerëson sipas procedurës ligjore.
3. Komisionet e hetimit veprojnë sipas procedurës së parashikuar me ligj.

Neni 78

1. Kuvendi vendos me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon një shumicë të cilësuar.
2. Mbledhjet e deputetëve që mbahen pa u thirrur sipas rregullores, nuk sjellin asnjë pasojë.

Neni 79

1. Mbledhjet e Kuvendit bëhen të hapura.
2. Me kërkesën e Presidentit të Republikës, të Kryeministrit ose të një së pestës së deputetëve mbledhjet e Kuvendit mund të bëhen të mbyllura, kur për këtë kanë votuar shumica e të gjithë anëtarëve të tij.

Neni 80

1. Kryeministri dhe çdo anëtar tjetër i Këshillit të Ministrave është i detyruar t'u përgjigjet interpelancave dhe pyetjeve të deputetëve brenda tri javëve.
2. Anëtari i Këshillit të Ministrave ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Kuvendit ose të komisioneve të tij; atij i jepet fjala sa herë që e kërkon.
3. Drejtuesit e institucioneve shtetërore, me kërkesë të komisioneve parlamentare, japin shpjegime dhe informojnë për çështje të ndryshme të veprimtarisë së tyre për sa e lejon ligji.

KREU IV PROCESI LIGJVËNËS

Neni 81

1. Të drejtën për të propozuar ligje e ka Këshilli i Ministrave, çdo deputet, si dhe 20 mijë zgjedhës.

2. Miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit:

- a) ligjet për organizimin dhe funksionimin e institucioneve, të parashikuara nga Kushtetuta;
- b) ligji për shtetësinë;
- c) ligji për zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore;
- ç) ligji për referendumet;
- d) kodet;
- dh) ligji për gjendjen e jashtëzakonshme;
- e) ligji për statusin e funksionarëve publikë;
- ë) ligji për amnistinë;
- f) ligji për ndarjen administrative të Republikës.

Neni 82

1. Propozimi i ligjeve, kur është rasti, duhet të shoqërohet kurdoherë me raportin që përligj shpenzimet financiare për zbatimin e tij.

2. Asnjë projektligj joqeveritar që bën të nevojshme rritjen e shpenzimeve të buxhetit të shtetit ose që pakëson të ardhurat, nuk mund të miratohet pa marrë mendimin e Këshillit të Ministrave, i cili duhet të shprehet brenda 30 ditëve nga data e marrjes së projektligjit.

3. Në qoftë se Këshilli i Ministrave nuk shprehet brenda afatit të mësipërm, projektligji kalon për shqyrtim sipas procedurës së zakonshme.

Neni 83

1. Projektligji votohet tri herë: në parim, nen për nen dhe në tërësi.

2. Kuvendi, me kërkesë të Këshillit të Ministrave ose të një së pestës së të gjithë deputetëve, mund të shqyrtojë e të miratojë një projektligj me procedurë të përshpejtuar, por jo më parë se një javë nga fillimi i procedurës së shqyrtimit.

3. Procedura e përshpejtuar nuk lejohet për shqyrtimin e projektligjeve të parashikuara në nenin 81 paragrafi 2, me përjashtim të nënparagrafit “dh”.

Neni 84

1. Presidenti i Republikës shpall ligjin e miratuar brenda 20 ditëve nga paraqitja e tij.

2. Ligji quhet i shpallur, në qoftë se Presidenti i Republikës nuk ushtron të drejtat e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni dhe në paragrafin 1 të nenit 85.

3. Ligji hyn në fuqi me kalimin e jo më pak se 15 ditëve nga botimi i tij në Fletoren Zyrtare.

4. Në rastet e masave të jashtëzakonshme, si dhe në rast nevojë e urgjence, kur Kuvendi vendos me shumicën e të gjithë anëtarëve dhe Presidenti i Republikës jep pëlqimin, ligji hyn në fuqi menjëherë, vetëm pasi të jetë njoftuar publikisht. Ligji duhet të botohet në numrin më të parë të Fletores Zyrtare.

Neni 85

1. Presidenti i Republikës ka të drejtë ta kthejë ligjin për rishqyrtim vetëm një herë.

2. Dekreti i Presidentit për rishqyrtimin e një ligji e humbet fuqinë, kur kundër tij votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

PJESA E KATËRT PRESIDENTI I REPUBLIKËS

Neni 86

1. Presidenti i Republikës është Kryetar i Shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit.
2. President mund të zgjidhet vetëm shtetasi shqiptar që nga lindja, me qëndrim jo më pak se 10 vjetët e fundit në Shqipëri dhe që ka mbushur moshën 40 vjeç.

Neni 87

(Ndryshuar me ligjin nr. 9904, datë 21.4.2008)

1. Kandidati për President i propozohet Kuvendit nga një grup prej jo më pak se 20 deputetësh. Një deputet nuk lejohet të propozojë në të njëjtën kohë më shumë se një kandidat.
2. Presidenti i Republikës zgjidhet me votim të fshehtë dhe pa debat nga Kuvendi. Për zgjedhjen e Presidentit, Kuvendi zhvillon deri në pesë votime.
Votimi i parë zhvillohet jo më vonë se shtatë ditë nga fillimi i procedurës për zgjedhjen e Presidentit. Secili nga votimet e tjera zhvillohet jo më vonë se shtatë ditë nga përfundimi pa sukses i votimit pararendës. Votimi quhet i kryer edhe kur në konkurrim nuk paraqitet asnjë kandidat. Në votimin e dytë, të tretë dhe të katërt mund të paraqiten kandidatë të rinj, sipas kushteve të pikës 1 të këtij neni.
3. Presidenti zgjidhet në votimin e parë, të dytë ose të tretë kur një kandidat merr jo më pak se tri të pestat e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në votimin e katërt dhe të pestë zgjidhet President kandidati që siguron më shumë se gjysmën e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit.
4. Votimi i pestë zhvillohet kur në votimin e katërt asnjë kandidat nuk ka siguruar shumicën e kërkuar të votave. Votimi i pestë zhvillohet vetëm midis dy kandidatëve që kanë marrë më shumë vota në votimin e katërt. Në rast se ka më shumë se dy kandidatë me të njëjtin numër votash, kandidati që merr pjesë në votim caktohet me short.
Në rast se pas votimit të katërt nuk ka mbetur asnjë kandidat në konkurrim, për këtë votim mund të paraqiten kandidatë të rinj, sipas kushteve të pikës 1 të këtij neni. Kur paraqiten më shumë se dy kandidatë, votimi zhvillohet midis dy kandidatëve që kanë siguruar numrin më të lartë të deputetëve propozues.
5. Në rast se edhe pas votimit të pestë asnjë kandidat nuk siguron shumicën e kërkuar, ose kur pas votimit të katërt pa sukses nuk paraqitet asnjë kandidaturë e re, Kuvendi shpërndahet. Zgjedhjet e reja zhvillohen brenda 45 ditëve nga shpërndarja e tij.
6. Kuvendi pasardhës e zgjedh Presidentin e Republikës me shumicën e të gjithë anëtarëve të tij.

Neni 88

(Ndryshuar pika 2, shtuar pika 2/1 me ligjin nr. 9904, datë 21.4.2008)

1. Presidenti i Republikës, në çdo rast, zgjidhet për 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.
2. Mandati përfundon në të njëjtën datë të të njëjtit muaj të vitit të pestë nga data e betimit si President i Republikës. Mandati i Presidentit zgjatet vetëm në kohë lufte dhe për aq kohë sa vazhdon ajo.
2/1. Procedura për zgjedhjen e Presidentit fillon jo më vonë se 60 ditë para mbarimit të mandatit presidencial paraardhës. Kur mandati presidencial përfundon në gjashtë muajt që i paraprijnë fundit të mandatit të Kuvendit ekzistues, procedura për zgjedhjen e Presidentit fillon jo më vonë se 60 ditë para mbarimit të mandatit të Kuvendit.
3. Presidenti fillon në detyrë pasi bën betimin para Kuvendit, por jo më parë se të ketë mbaruar mandati i Presidentit që largohet. Presidenti bën këtë betim:
“Beto hem se do t’i bindem Kushtetutës dhe ligjeve të vendit, do të respektoj të drejtat dhe liritë e shtetasve, do të mbroj pavarësinë e Republikës së Shqipërisë dhe do t’i shërbej

interesit të përgjithshëm dhe përparimit të Popullit Shqiptar.” Presidenti mund të shtojë edhe: “Zoti më ndihmoftë!”

4. Presidenti që jep dorëheqjen para mbarimit të mandatit të vet, nuk mund të kandidojë në zgjedhjen presidenciale që bëhet pas dorëheqjes së tij.

Neni 89

Presidenti i Republikës nuk mund të mbajë asnjë detyrë tjetër publike, nuk mund të jetë anëtar partie dhe as të kryejë veprimtari tjetër private.

Neni 90

1. Presidenti i Republikës nuk ka përgjegjësi për aktet e kryera në ushtrim të detyrës së tij.
2. Presidenti i Republikës mund të shkarkohet për shkelje të rëndë të Kushtetutës dhe për kryerjen e një krimi të rëndë. Propozimi për shkarkimin e Presidentit në këto raste mund të bëhet nga jo më pak se një e katërta e anëtarëve të Kuvendit dhe duhet të mbështetet nga jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij.
3. Vendimi i Kuvendit i dërgohet Gjykatës Kushtetuese, e cila, kur vërteton fajësinë e Presidentit të Republikës, deklaron shkarkimin e tij nga detyra.

Neni 91

1. Kur Presidenti i Republikës është në pamundësi të përkohshme për të ushtruar funksionet e tij ose kur vendi i tij mbetet vakant, Kryetari i Kuvendit zë vendin dhe ushtron kompetencat e tij.
2. Në rast se Presidenti nuk mund të ushtrojë detyrën për më shumë se 60 ditë, Kuvendi, me dy të tretat e të gjithë anëtarëve, vendos dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, e cila vërteton përfundimisht faktin e pamundësisë. Në rast të vërtetimit të pamundësisë, vendi i Presidentit mbetet vakant dhe zgjedhja e Presidentit të ri fillon brenda 10 ditëve nga dita e vërtetimit të pamundësisë.

Neni 92

Presidenti ushtron edhe këto kompetenca:

- a) i drejton mesazhe Kuvendit;
- b) ushtron të drejtën e faljes sipas ligjit;
- c) jep shtetësinë shqiptare dhe lejon lënien e saj sipas ligjit;
- ç) jep dekorata e tituj nderi sipas ligjit;
- d) jep gradat më të larta ushtarake sipas ligjit;
- dh) me propozim të Kryeministrit, emëron dhe liron përfaqësuesit e plotfuqishëm të Republikës së Shqipërisë në shtetet e tjera dhe në organizatat ndërkombëtare;
- e) pranon letrat kredenciale dhe tërheqjen e përfaqësuesve diplomatikë të shteteve të tjera dhe të organizatave ndërkombëtare të akredituara në Republikën e Shqipërisë;
- ë) lidh marrëveshje ndërkombëtare sipas ligjit;
- f) me propozim të Kryeministrit, emëron drejtorin e shërbimit informativ të shtetit;
- g) emëron Kryetarin e Akademisë së Shkencave dhe rektorët e universiteteve sipas ligjit;
- gj) cakton datën e zgjedhjeve për Kuvendin, për organet e pushtetit vendor dhe për zhvillimin e referendumeve;
- h) kërkon mendim dhe të dhëna me shkrim nga drejtuesit e institucioneve shtetërore për çështje që kanë të bëjnë me detyrat e tyre.

Neni 93

Presidenti i Republikës, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr dekrete.

Neni 94

Presidenti i Republikës nuk mund të ushtrojë kompetenca të tjera përveç atyre që i njihen shprehimisht me Kushtetutë dhe që i jepen me ligje të nxjerra në pajtim me të.

PJESA E PESTË
KËSHILLI I MINISTRAVE

Neni 95

1. Këshilli i Ministrave përbëhet nga Kryeministri, zëvendëskryeministri dhe ministrat.
2. Këshilli i Ministrave ushtron çdo funksion shtetëror, i cili nuk u është dhënë organeve të pushteteve të tjera shtetërore ose të qeverisjes vendore.

Neni 96

1. Presidenti i Republikës, në fillim të legjislaturës, si dhe kur vendi i Kryeministrit mbetet vakant, emëron Kryeministrin me propozim të partisë ose koalicionit të partive, që ka shumicën e vendeve në Kuvend.
2. Në qoftë se Kryeministri i emëruar nuk miratohet nga Kuvendi, Presidenti emëron një Kryeministër të ri brenda 10 ditëve.
3. Në qoftë se edhe Kryeministri i emëruar rishtas nuk miratohet nga Kuvendi, brenda 10 ditëve Kuvendi zgjedh një Kryeministër tjetër. Në këtë rast Presidenti emëron Kryeministrin e ri.
4. Kur Kuvendi nuk arrin të zgjedhë Kryeministrin e ri, Presidenti i Republikës shpërndan Kuvendin.

Neni 97

Kryeministri i emëruar sipas nenit 96, nenit 104 ose 105, i paraqet për miratim Kuvendit, brenda 10 ditëve, programin politik të Këshillit të Ministrave së bashku me përbërjen e tij.

Neni 98

1. Ministri emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës, me propozim të Kryeministrit, brenda 7 ditëve.
2. Dekreti shqyrtohet brenda 10 ditëve nga Kuvendi.

Neni 99

Para fillimit të detyrës, Kryeministri, zëvendëskryeministri dhe ministrat betohen para Presidentit të Republikës.

Neni 100

1. Këshilli i Ministrave përcakton drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore.

2. Këshilli i Ministrave merr vendime me propozim të Kryeministrit ose të ministrit përkatës.
3. Mbledhjet e Këshillit të Ministrave bëhen të mbyllura.
4. Aktet e Këshillit të Ministrave janë të vlefshme, kur nënshkruhen nga Kryeministri dhe ministri propozues.
5. Këshilli i Ministrave nxjerr vendime dhe udhëzime.

Neni 101

Këshilli i Ministrave, në rast nevoje dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit, për marrjen e masave të përkohshme. Këto akte normative i dërgohen menjëherë Kuvendit, i cili mbledhet brenda 5 ditëve nëse nuk është i mbledhur. Këto akte humbasin fuqinë që nga fillimi, në qoftë se nuk miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve.

Neni 102

1. Kryeministri:
 - a) përfaqëson Këshillin e Ministrave dhe kryeson mbledhjet e tij;
 - b) koncepton dhe paraqet drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe përgjigjet për to;
 - c) siguron zbatimin e legjislacionit dhe të politikave të miratuara nga Këshilli i Ministrave;
 - ç) bashkërendon dhe kontrollon punën e anëtarëve të Këshillit të Ministrave dhe të institucioneve të tjera të administratës qendrore të shtetit;
 - d) kryen detyra të tjera të parashikuara në Kushtetutë e në ligje.
2. Kryeministri zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet ministrave.
3. Kryeministri, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr urdhra.
4. Ministri, brenda drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, drejton nën përgjegjësinë e tij veprimtarinë që ka në kompetencë. Ministri, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr urdhra dhe udhëzime.

Neni 103

1. Ministër mund të caktohet kushdo që ka cilësitë për deputet.
2. Ministri nuk mund të ushtrojë asnjë veprimtari tjetër shtetërore dhe as të jetë drejtues ose anëtar i organeve të shoqërive fitimprurëse.
3. Anëtarët e Këshillit të Ministrave gëzojnë imunitetin e deputetit.

Neni 104

(Ndryshuar me ligjin nr. 9904, datë 21.4.2008)

1. Kryeministri ka të drejtë t'i paraqesë Kuvendit mocion besimi ndaj Këshillit të Ministrave. Në rast se mocioni i besimit votohet nga më pak se gjysma e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, Kryeministri, brenda 48 orëve nga votimi i mocionit, i kërkon Presidentit të Republikës shpërndarjen e Kuvendit.
2. Presidenti shpërndan Kuvendin brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës.
Kërkesa për mocion besimi nuk mund të paraqitet gjatë periudhës së shqyrtimit të mocionit të mosbesimit, sipas nenit 105.
3. Votimi i mocionit nuk mund të bëhet pa kaluar tri ditë nga paraqitja e tij.

Neni 105

(Ndryshuar me ligjin nr. 9904, datë 21.4.2008)

1. Një e pesta e deputetëve ka të drejtë të paraqesë për votim në Kuvend një mocion mosbesimi ndaj Kryeministrit në detyrë, duke propozuar një Kryeministër të ri.

2. Kuvendi mund të votojë një mocion mosbesimi ndaj Kryeministrit vetëm duke zgjedhur me votat e më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij një Kryeministër të ri.

3. Presidenti i Republikës dekreton shkarkimin e Kryeministrit në detyrë dhe emërimin e Kryeministrit të zgjedhur jo më vonë se 10 ditë nga votimi i mocionit në Kuvend.

Neni 106

Kryeministri dhe ministrat janë të detyruar të qëndrojnë në detyrë deri në formimin e Këshillit të Ministrave pasardhës.

Neni 107

1. Nëpunësit publikë zbatojnë ligjin dhe janë në shërbim të popullit.

2. Nëpunësit në administratën publike caktohen me konkurs, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji.

3. Garancitë e qëndrimit në detyrë dhe trajtimi ligjor i nëpunësve publikë rregullohen me ligj.

PJESA E GJASHTË QEVERISJA VENDORE

Neni 108

1. Njësitë e qeverisjes vendore janë komunat ose bashkitë dhe qarqet. Njësi të tjera të qeverisjes vendore rregullohen me ligj.

2. Ndarjet administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore caktohen me ligj mbi bazën e nevojave e të interesave të përbashkët ekonomikë dhe të traditës historike. Kufijtë e tyre nuk mund të ndryshohen pa u marrë më parë mendimi i popullsisë që banon në to.

3. Komuna dhe bashkia janë njësi bazë të qeverisjes vendore. Ato kryejnë të gjitha detyrat vetëqeverisese, me përjashtim të atyre që me ligj u jepen njësive të tjera të qeverisjes vendore.

4. Vetëqeverisja në njësitë vendore ushtrohet nëpërmjet organeve të tyre përfaqësuese dhe referendumeve vendore. Parimet dhe procedurat për zhvillimin e referendumit vendor parashikohen me ligj në përputhje edhe me nenin 151 paragrafi 2.

Neni 109

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 9675, datë 13.1.2007)

1. Organet përfaqësuese të njësive bazë të qeverisjes vendore janë këshillat, të cilat zgjidhen çdo katër vjet me zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë.

2. Organi ekzekutiv i bashkisë ose i komunës është kryetari, i cili zgjidhet drejtpërdrejt nga populli në mënyrën e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Të drejtën e zgjedhjes në këshillat vendorë dhe si kryetar bashkie ose komune e kanë vetëm shtetasit që janë me banim të përhershëm në territorin e njësisë vendore përkatëse.

4. Organet e njësive të qeverisjes vendore kanë të drejtë të formojnë bashkime dhe institucione të përbashkëta me njëri-tjetrin për përfaqësimin e interesave të tyre, të bashkëpunojnë me njësitë vendore të vendeve të tjera, si dhe të përfaqësohen në organizatat ndërkombëtare të pushteteve vendore.

Neni 110

1. Qarku përbëhet nga disa njësi bazë të qeverisjes vendore me lidhje tradicionale, ekonomike e sociale dhe të interesave të përbashkët.

2. Qarku është njësi ku ndërtohen e zbatohen politikat rajonale dhe ku ato harmonizohen me politikën shtetërore.

3. Organi përfaqësues i qarkut është këshilli i qarkut. Bashkitë dhe komunat delegojnë anëtarë në këshillin e qarkut në përpjesëtim me popullsinë e tyre, por për çdo rast të paktën një anëtar. Kryetarët e komunave dhe të bashkive janë kurdoherë anëtarë të këshillit të qarkut. Anëtarët e tjerë të tij zgjidhen me lista përpjesëtimore ndër këshilltarët bashkiakë ose komunalë nga këshillat përkatës.

4. Këshilli i qarkut ka të drejtë të nxjerrë urdhëresa dhe vendime me fuqi detyruese të përgjithshme për qarkun.

Neni 111

1. Njësitë e qeverisjes vendore janë persona juridikë.

2. Njësitë e qeverisjes vendore kanë buxhet të pavarur, i cili krijohet në mënyrën e parashikuar me ligj.

Neni 112

1. Njësitë të qeverisjes vendore mund t'u delegohen me ligj kompetenca të administratës shtetërore. Shpenzimet që kryhen për ushtrimin e delegimit, përballohen nga shteti.

2. Organeve të qeverisjes vendore mund t'u vihen detyrime vetëm në përputhje me ligjin ose sipas marrëveshjeve që ato lidhin. Shpenzimet që lidhen me detyrimet që u vihen me ligj organeve të qeverisjes vendore përballohen nga Buxheti i Shtetit.

Neni 113

1. Këshillat komunalë, bashkiakë dhe të qarkut:

a) rregullojnë dhe administrojnë në mënyrë të pavarur çështjet vendore brenda juridiksionit të tyre;

b) ushtrojnë të drejtat e pronës, administrojnë në mënyrë të pavarur të ardhurat e krijuara, si dhe kanë të drejtë të ushtrojnë veprimtari ekonomike;

c) kanë të drejtë të mbledhin dhe të shpenzojnë të ardhurat që janë të domosdoshme për ushtrimin e funksioneve të tyre;

c) kanë të drejtë të vendosin, në përputhje me ligjin, taksa vendore, si dhe nivelin e tyre;

d) caktojnë rregullat për organizimin dhe funksionimin e tyre në pajtim me ligjin;

dh) krijojnë simbolet e qeverisjes vendore, si dhe titujt vendorë të nderit;

e) ndërmarrin nisma për çështje vendore përpara organeve të caktuara me ligj.

2. Organet e njësitë të qeverisjes vendore nxjerrin urdhëresa, vendime dhe urdhra.

3. Të drejtat për vetëqeverisje të njësitë të qeverisjes vendore mbrohen në gjykatë.

Neni 114

Këshilli i Ministrave cakton prefektin si përfaqësues të tij në çdo qark. Kompetencat e prefektit caktohen me ligj.

Neni 115

1. Organi i zgjedhur drejtpërdrejt i njësisë qeverisëse vendore mund të shpërndahet ose të shkarkohet nga Këshilli i Ministrave për shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve.

2. Organi i shpërndarë ose i shkarkuar mund të ankohet në Gjykatën Kushtetuese brenda 15 ditëve, dhe në këtë rast vendimi i Këshillit të Ministrave pezullohet.

3. Në rastin e mosushtrimit të së drejtës së ankimit brenda 15 ditëve, ose në rastin e lënies në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nga Gjykata Kushtetuese, Presidenti i Republikës cakton datën e zgjedhjeve në njësinë vendore përkatëse.

PJESA E SHTATË AKTET NORMATIVE DHE MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE

KREU I AKTET NORMATIVE

Neni 116

1. Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë:

- a) Kushtetuta;
- b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara;
- c) ligjet;
- ç) aktet normative të Këshillit të Ministrave.

2. Aktet që nxirren nga organet e pushtetit vendor kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial që ushtrojnë këto organe.

3. Aktet normative të ministrave dhe të organeve drejtuese të institucioneve të tjera qendrore kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë brenda sferës së juridiksionit të tyre.

Neni 117

1. Ligjet, aktet normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave, të institucioneve të tjera qendrore marrin fuqi juridike vetëm pasi botohen në Fletoren Zyrtare.

2. Shpallja dhe botimi i akteve të tjera normative bëhet sipas mënyrës së parashikuar me ligj.

3. Marrëveshjet ndërkombëtare që ratifikohen me ligj, shpallen dhe botohen sipas procedurave që parashikohen për ligjet. Shpallja dhe botimi i marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare bëhet sipas ligjit.

Neni 118

1. Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë.

2. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte.

3. Organi i autorizuar me ligj për të nxjerrë akte nënligjore, siç specifikohet në paragrafin 2 të këtij neni, nuk mund t'ia delegojë kompetencën e tij një organi tjetër.

Neni 119

1. Rregulloret e Këshillit të Ministrave, të ministrave e të institucioneve të tjera qendrore, si dhe urdhrat e Kryeministrit, të ministrave e të drejtuesve të institucioneve qendrore kanë karakter të brendshëm dhe janë të detyrueshme vetëm për njësitë administrative që varen prej tyre.

2. Këto akte nxirren në bazë të ligjit dhe nuk mund të shërbejnë si bazë për të marrë vendime në lidhje me individët dhe subjektet e tjera.

3. Rregulloret dhe urdhrat nxirren në bazë dhe për zbatim të akteve që kanë fuqi juridike të përgjithshme.

Neni 120

Parimet dhe procedurat për nxjerrjen e akteve juridike vendore parashikohen me ligj.

KREU II MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE

Neni 121

1. Ratifikimi dhe denoncimi i marrëveshjeve ndërkombëtare nga Republika e Shqipërisë bëhet me ligj në rastet kur ato kanë të bëjnë me:

- a) territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake;
- b) të drejtat dhe liritë e njeriut, si edhe detyrimet e shtetasve, siç parashikohen në Kushtetutë;
- c) anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare;
- ç) marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga Republika e Shqipërisë;
- d) miratimin, ndryshimin, plotësimin ose shfuqizimin e ligjeve.

2. Kuvendi, me shumicën e të gjithë anëtarëve, mund të ratifikojë edhe marrëveshje të tjera ndërkombëtare që nuk parashikohen në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Kryeministri e njofton Kuvendin sa herë që Këshilli i Ministrave nënshkruan një marrëveshje ndërkombëtare që nuk ratifikohet me ligj.

4. Parimet dhe procedurat për ratifikimin dhe denoncimin e marrëveshjeve ndërkombëtare parashikohen me ligj.

Neni 122

1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Ndryshimi, plotësimi dhe shfuqizimi i ligjeve të miratuara me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për efekt të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet me të njëjtën shumicë.

2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.

3. Normat e nxjerra prej një organizate ndërkombëtare kanë epërsi, në rast konflikti, mbi të drejtën e vendit, kur në marrëveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pjesëmarrjen në atë organizatë, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të nxjerra prej asaj.

Neni 123

1. Republika e Shqipërisë, në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare, u delegon organizatave ndërkombëtare kompetenca shtetërore për çështje të caktuara.

2. Ligji me të cilin ratifikohet një marrëveshje ndërkombëtare, siç parashikohet në paragrafin 1 të këtij neni, miratohet me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

3. Kuvendi mund të vendosë që ratifikimi i një marrëveshjeje të tillë të bëhet me referendum.

PJESA E TETË GJYKATA KUSHTETUESE

Neni 124

(Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

1. Gjykata Kushtetuese zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.
2. Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës.
3. Gjykata Kushtetuese ka buxhet të veçantë, të cilin e administron në mënyrë të pavarur.

Neni 125

(Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

1. Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 9 anëtarë. Tre anëtarë emërohen nga Presidenti i Republikës, tre anëtarë zgjidhen nga Kuvendi dhe tre anëtarë zgjidhen nga Gjykata e Lartë. Anëtarët përzgjidhen ndërmjet kandidatëve të renditur në tri vendet e para të listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, sipas ligjit.

2. Kuvendi zgjedh gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese me jo më pak se tri të pestat e të gjithë anëtarëve të tij. Nëse Kuvendi nuk zgjedh gjyqtarin brenda 30 ditëve nga paraqitja e listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, kandidati i renditur i pari në listë shpallet i emëruar.

3. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese qëndrojnë në detyrë për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi.

4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kriteret e tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.

6. Përbërja e Gjykatës Kushtetuese përtërihet çdo 3 vjet me një të tretën e saj, sipas procedurës së përcaktuar me ligj.

7. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese vazhdon në detyrë deri në zgjedhjen e pasardhësit të tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 127, paragrafi 1, nënparagrafët “c”, “ç”, “d” dhe “dh”.

Neni 126

(Ndryshuar me ligjin nr. 88/2012, datë 18.9.2012 dhe me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrim të funksioneve të tij, përveç rasteve kur ai ka vepruar për një interes vetjak ose me keqbesim.

Neni 127

(Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

1. Mandati i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese mbaron kur:
 - a) mbush moshën 70 vjeç;
 - b) përfundon mandatin 9-vjeçar;
 - c) jep dorëheqjen;
 - ç) shkarkohet sipas parashikimeve të nenit 128 të Kushtetutës;
 - d) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;
 - dh) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.
2. Mbarimi i mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese deklarohet me vendim të

Gjykatës Kushtetuese.

3. Në rast se vendi i gjyqtarit mbetet vakant, organi i emërtesës emëron një gjyqtar të ri, i cili qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të gjyqtarit të larguar.

Neni 128

(Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mban përgjegjësi disiplinore sipas ligjit.

2. Procesi disiplinor ndaj gjyqtarit zhvillohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila vendos për shkarkimin e tij kur:

a) konstaton shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të mandatit;

b) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

3. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese pezullohet nga detyra me vendim të Gjykatës Kushtetuese kur:

a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një vepre penale;

b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të kryer me dashje;

c) fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit.

Neni 129

Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese fillon detyrën pasi bën betimin para Presidentit të Republikës.

Neni 130

(Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

Qenia gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër politike, shtetërore, si dhe me veprimtari profesionale që ushtrohen kundrejt pagesës, me përjashtim të atyre të mësimdhënies, akademike dhe shkencore, sipas ligjit.

Neni 131

(Ndryshuar shkronja “e” me ligjin nr. 137/2015, datë 17.12.2015 dhe ndryshuar nënparagrafi “f” dhe shtuar paragrafi 2 me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

Gjykata Kushtetuese vendos për:

a) pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, siç parashikohet në nenin 122;

b) pajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën para ratifikimit të tyre;

c) pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare;

ç) mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve, si dhe ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore;

d) kushtetutshmërinë e partive dhe të organizatave të tjera politike, si dhe të veprimtarisë së tyre, sipas nenit 9 të kësaj Kushtetute;

dh) shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës dhe vërtetimin e pamundësisë së ushtrimit të funksioneve të tij;

e) çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të

Presidentit të Republikës, të deputetëve, të funksionarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë, si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre.

ë) kushtetutshmërinë e referendumit dhe verifikimin e rezultateve të tij;

f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë.

2. Gjykata Kushtetuese, në rastin kur vihet në lëvizje për shqyrtimin e një ligji për rishikimin e Kushtetutës, të miratuar nga Kuvendi sipas nenit 177, kontrollon vetëm respektimin e procedurës së parashikuar nga Kushtetuta.

Neni 132

(Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim.

2. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë në fuqi ditën e publikimit në Fletoren Zyrtare. Gjykata Kushtetuese mund të urdhërojë që vendimi i saj, me të cilin ka shqyrtuar aktin, të fillojë efektet në një datë tjetër.

3. Mendimi i pakicës publikohet bashkë me vendimin përfundimtar.

Neni 133

(Ndryshuar pika 2, me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

1. Pranimi i ankesave për gjykim vendoset nga një numër gjyqtarësh, siç përcaktohet me ligj.

2. Gjykata Kushtetuese merr vendim përfundimtar me shumicën e të gjithë anëtarëve të saj, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj.

Neni 134

(Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

1. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të:

a) Presidentit të Republikës;

b) Kryeministrit;

c) jo më pak se një të pestës së deputetëve;

ç) Avokatit të Popullit;

d) Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit;

dh) çdo gjykatë, sipas nenit 145, pika 2, të kësaj Kushtetute;

e) çdo komisioneri të krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Kushtetuta;

ë) Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë;

f) organeve të qeverisjes vendore;

g) organeve të bashkësive fetare;

gj) partive politike;

h) organizatave;

i) individëve.

2. Subjektet e parashikuara nga nënparagrafët “d”, “dh”, “e”, “ë”, “f”, “g”, “gj”, “h” dhe “i”, të paragrafit 1, të këtij neni, mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre.

PJESA E NËNTË

GJYKATAT

Neni 135

(Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

1. Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj.

2. Gjykatat e posaçme gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, si dhe akuzat kundër ish-funksionarëve të sipërpërmendur.

3. Kuvendi mund të krijojë me ligj gjykata të tjera për fusha të veçanta, por në asnjë rast gjykata të jashtëzakonshme.

4. Gjyqtarët e gjykatave të posaçme që parashikohen në paragrafin 2, të këtij neni, emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas ligjit. Gjyqtarët e gjykatave të posaçme shkarkohen nga detyra me dy të tretat e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kandidatët për gjyqtarë dhe nëpunës civilë gjyqësorë në gjykatat e posaçme, si dhe familjarët e afërm të kandidatëve, para emërimit, i nënshtrohen verifikimit të pasurisë dhe të figurës, si dhe japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit.

Neni 136

(Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga Presidenti i Republikës, me propozim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për një mandat 9-vjeçar, pa të drejtë riemërimi.

2. Presidenti i Republikës, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, emëron gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, me përjashtim të rasteve kur Presidenti konstaton se kandidati nuk plotëson kriteret e kualifikimit ose kushtet e zgjedhshmërisë, sipas ligjit. Dekreti i Presidentit të Republikës për mosemërimin e kandidatit humbet fuqinë kur kundër tij votojnë shumica e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në këtë rast, si dhe kur Presidenti nuk shprehet, kandidati shpallet i emëruar dhe fillon detyrën brenda 15 ditëve nga data e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës. Kandidatët që përzgjidhen nga radhët e juristëve duhet të kenë gradë shkencore në drejtësi.

4. Kandidati jo gjyqtar nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit. Kriteret e tjera dhe procedura e përzgjedhjes së gjyqtarit parashikohen me ligj.

5. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë qëndron në detyrë deri në emërimin e pasardhësit, përveç rasteve të parashikuara në nenin 139, paragrafi 3, nënparagrafët “c”, “ç”, “d” dhe “dh”.

Neni 136/a

(Shtuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

1. Gjyqtarë mund të jenë shtetasit shqiptarë që emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit.

2. Kriteria të tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve parashikohen me ligj.

Neni 137

(Ndryshuar me ligjin nr. 88/2012, datë 18.9.2012 dhe nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

Gjyqtari gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrimin e funksioneve të tij, përveç rasteve të dhënies qëllimisht të një vendimi, si pasojë e një interesi vetjak ose keqbesimi.

Neni 138

(Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

Paga dhe përfitimet e tjera të gjyqtarit nuk mund të ulen, përveç rasteve kur:

- a) nevojitet marrja e masave të përgjithshme ekonomiko-financiare për të shmangur situata të vështira financiare të vendit ose emergjenca të tjera kombëtare;
- b) gjyqtari kthehet në detyrën që mbante para emërimit;
- c) i jepet një masë disiplinore ose vlerësohet i pamjaftueshëm profesionalisht, sipas ligjit.

Neni 139

(Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

1. Mandati i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë mbaron në rastet e mëposhtme:

- a) mbush moshën e pensionit;
- b) përfundon mandatin 9-vjeçar;
- c) jep dorëheqjen;
- ç) shkarkohet sipas parashikimeve të nenit 140 të Kushtetutës;
- d) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;
- dh) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.

2. Mbarimi i mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë deklarohet me vendim të Gjykatës së Lartë.

3. Procedura për emërimin e gjyqtarit në një gjykatë tjetër pas përfundimit të mandatit rregullohet me ligj.

Neni 140

(Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

1. Gjyqtari mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit.

2. Gjyqtari shkarkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor kur:

a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës;

b) është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

3. Gjyqtari pezullohet nga detyra me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor kur:

a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një veprë penale;

b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje;

c) kur fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit.

4. Kundër vendimit të shkarkimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Kushtetuese.

Neni 141

(Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

1. Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar

njësimit ose zhvillimit të praktikës gjyqësore, sipas ligjit.

2. Për ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë tërheq për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore të vendosura nga kolegjet, sipas ligjit.

Neni 142

1. Vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara.
2. Gjykata e Lartë duhet t'i botojë vendimet e saj, si dhe mendimet e pakicës.
3. Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.

Neni 143

(Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

Qenia gjyqtar nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër politike ose shtetërore, si dhe veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik, shkencor, si dhe delegimit pranë institucioneve të sistemit të drejtësisë, sipas ligjit.

Neni 144

(Shfuqizuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

Neni 145

1. Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve.
2. Kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, nuk i zbatojnë ato. Në këtë rast, ata pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për të gjitha gjykatat.
3. Ndërhyrja në veprimtarinë e gjykatave ose të gjyqtarëve passjell përgjegjësi sipas ligjit.

Neni 146

1. Gjykatat i japin vendimet në emër të Republikës.
2. Vendimet gjyqësore shpallen publikisht në çdo rast.

Neni 147

(Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor përbëhet nga 11 anëtarë, gjashtë prej të cilëve zgjidhen nga gjyqtarët e të gjitha niveleve të pushtetit gjyqësor dhe pesë anëtarë i zgjedh Kuvendi, nga radhët e juristëve jogjyqtarë.

3. Anëtarët gjyqtarë përzgjidhen nga radhët e gjyqtarëve me integritet të lartë moral dhe profesional, sipas një procedure transparente dhe publike që siguron një përfaqësim të drejtë të të gjitha niveleve të gjyqësorit. Anëtarët jogjyqtarë përzgjidhen nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional. Ata nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kriteria të tjera dhe procedura për përzgjedhjen e kandidatëve rregullohen me ligj.

4. Dy anëtarë jogjyqtarë zgjidhen nga radhët e avokatëve, dy anëtarë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, si dhe një anëtar nga shoqëria civile. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, bazuar në një procedurë transparente dhe publike, shpall vendet vakante, sipas ligjit.

5. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, jo më vonë se 10 ditë nga paraqitja e kandidaturave, verifikon nëse kandidatët plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji, si dhe vlerëson kriteret profesionale e morale për anëtarin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe përgatit listën. Në rast se kandidatët nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret për t'u zgjedhur, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit nuk i përfshin emrat e tyre në listë.

6. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit pas përfundimit të verifikimeve, i dërgon menjëherë listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret formale nënkomisionit, sipas paragrafit 7 të këtij neni.

7. Komisioni i përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend krijon një nënkomision për vlerësimin e mëtejshëm dhe përzgjedhjen e kandidatëve jo më vonë se 3 ditë nga paraqitja e listës. Nënkomisioni përbëhet nga 5 deputetë, prej të cilëve 3 caktohen nga shumica dhe 2 nga pakica parlamentare. Nënkomisioni, me të paktën katër vota, mund të përfshijë në listën e kandidatëve edhe ata që janë përjashtuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit për mospërbushje të kriterëve formale. Nënkomisioni përzgjedh kandidatët me mbështetjen e të paktën 4 anëtarëve. Nëse nuk arrihet shumica e kërkuar, kandidatët përzgjidhen me short.

8. Emrat e kandidatëve të përzgjedhur nga nënkomisioni përmbledhen në një listë dhe i dërgohen Kryetarit të Kuvendit. Brenda 10 ditëve, Kuvendi miraton listën e kandidatëve me 2/3 e të gjithë anëtarëve. Nëse lista rrëzohet, procedura përsëritet në nënkomision sipas pikës 7 të këtij neni, por jo më shumë se dy herë. Në rast se pas zhvillimit për herë të tretë të procedurës Kuvendi nuk miraton listën e paraqitur, kandidatët e kësaj liste konsiderohen të zgjedhur. Procedura e detajuar rregullohet me ligj.

9. Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor zgjidhet në mbledhjen e parë të Këshillit nga radhët e anëtarëve jogjyqtarë, sipas ligjit.

10. Anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor e ushtrojnë detyrën me kohë të plotë për një periudhë prej pesë vjetësh, pa të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme. Në përfundim të mandatit, anëtarët gjyqtarë kthehen në vendet e mëparshme të punës. Gjyqtarit të Gjykatës së Lartë ose të gjykatës së posaçme i pezullohet mandati si gjyqtar gjatë kohës që ushtron funksionin si anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Anëtarët jogjyqtarë që përpara emërimit punonin me kohë të plotë në sektorin publik, rikthehen në vendet e mëparshme të punës ose në pamundësi, në detyra të barasvlershme me to.

Neni 147/a

(Shtuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron funksionet e mëposhtme:

- a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve;
- b) vendos për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve;
- c) i propozon Presidentit të Republikës kandidatët për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, sipas ligjit;
- ç) miraton rregullat e etikës gjyqësore dhe mbikëqyr respektimin e tyre;
- d) drejton dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave, me përjashtim të mbarëvajtjes së strukturave të teknologjisë së informacionit në gjykata, e cila rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave;
- dh) propozon dhe administron buxhetin e tij dhe të gjykatave;
- e) informon publikun dhe Kuvendin për gjendjen e sistemit gjyqësor;
- ë) ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj.

2. Ligji mund të parashikojë krijimin e komisioneve vendimmarrëse pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Ministri i Drejtësisë mund të marrë pjesë, pa të drejtë vote, në mbledhjet e Këshillit të Lartë Gjyqësor kur diskutohen çështje që lidhen me planifikimin strategjik dhe buxhetin e pushtetit gjyqësor.

Neni 147/b

(Shtuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

1. Mandati i anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor mbaron sipas rasteve të mëposhtme:
 - a) mbush moshën e pensionit;
 - b) përfundon mandatin 5-vjeçar;
 - c) jep dorëheqjen;
 - ç) shkarkohet sipas parashikimeve të nenit 147/c të Kushtetutës;
 - d) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;
 - dh) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.
2. Mbarimi i mandatit të anëtarit deklarohet me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
3. Kur vendi i anëtarit mbetet vakant, organi që ka emëruar anëtarin paraardhës, sipas nenit 147, emëron një anëtar të ri, i cili qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të anëtarit të larguar.
4. Anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor qëndron në detyrë deri në emërimin e pasardhësit, përveç rasteve të parashikuara në nënparagrafët “c”, “ç”, “d” dhe “dh”, të paragrafit 1, të këtij neni.

Neni 147/c

(Shtuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

1. Anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit.
2. Ai shkarkohet nga Gjykata Kushtetuese kur:
 - a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike;
 - b) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.
3. Anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor pezullohet nga detyra me vendim të Gjykatës Kushtetuese kur:
 - a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një vepre penale;
 - b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje;
 - c) fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit.

Neni 147/ç

(Shtuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

Qenia anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër politike ose shtetërore, si dhe veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të veprimtarisë mësimdhënëse, akademike dhe shkencore, sipas ligjit.

Neni 147/d

(Shtuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas procedurës së përcaktuar me ligj.
2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës edhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë.
3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë zgjidhet me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, për një periudhë 9-vjeçare, pa të drejtë rizgjedhjeje, nga radhët e juristëve të spikatur me jo më

pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional. Ai nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit.

4. Inspektori i Lartë i Drejtësisë zgjidhet nga lista e pesë kandidatëve të përzgjedhur dhe renditur mbi bazën e meritave nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, sipas një procedure transparente dhe publike. Në rast se Kuvendi nuk arrin shumicën prej tri të pestave për asnjë prej kandidatëve brenda 30 ditëve nga paraqitja e listës, kandidati i renditur i pari shpallet i emëruar.

5. Inspektori i Lartë i Drejtësisë gëzon statusin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

6. Procedura e vendimmarrjes nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë rregullohet me ligj. Ankimet ndaj vendimeve lidhur me masat disiplinore ndaj inspektorëve të tjerë shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese.

Neni 147/dh

(Shtuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

1. Mandati i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mbaron kur:

a) mbush moshën e pensionit;

b) përfundon mandatin 9-vjeçar;

c) jep dorëheqjen;

ç) shkarkohet sipas parashikimeve të nenit 147/e të Kushtetutës;

d) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;

dh) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.

2. Mbarimi i mandatit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë deklarohet me vendim të mbledhjes së përbashkët të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë qëndron në detyrë deri në emërimin e Inspektorit të ri, me përjashtim të rasteve të parashikuara në paragrafin 1, nënparagrafët “c”, “ç”, “d” dhe “dh”.

4. Pas përfundimit të mandatit, me kërkesë të tij, Inspektori i Lartë i Drejtësisë kthehet në detyrën që mbante para emërimit ose në një detyrë të përafërt me të.

Neni 147/e

(Shtuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit.

2. Ai shkarkohet nga Gjykata Kushtetuese kur:

a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike;

b) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

3. Pretendimet lidhur me shkeljet disiplinore të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë hetohen nga një komision hetimor i Kuvendit, duke respektuar të drejtën e tij për proces të rregullt. Komisioni hetimor, në rast se konstaton shkelje sipas paragrafit, 2 të këtij neni, i propozon Gjykatës Kushtetuese shkarkimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas ligjit.

4. Inspektori i Lartë i Drejtësisë pezullohet nga detyra me vendim të Gjykatës Kushtetuese kur:

a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një veprë penale;

b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje;

c) fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit.

Neni 147/ë

(Shtuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

Qenia Inspektor i Lartë i Drejtësisë nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër politike ose shtetërore, si dhe veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik ose shkencor, sipas ligjit.

PJESA E DHJETË PROKURORIA

Neni 148

(Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

1. Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj.

2. Prokuroria është organ i pavarur që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, sipas ligjit.

3. Prokuroria është organizuar dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor.

4. Prokuroria e Posaçme dhe Njësia e Posaçme Hetimore për ndjekjen penale dhe hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe çështjeve penale sipas nenit 135, paragrafi 2, të Kushtetutës janë të pavarura nga Prokurori i Përgjithshëm. Njësia e Posaçme Hetimore është në varësi të Prokurorisë së Posaçme.

Neni 148/a

(Shtuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

1. Prokurori i Përgjithshëm zgjidhet me tre të pestat e anëtarëve të Kuvendit, mes tre kandidatëve të propozuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, për një mandat 7-vjeçar dhe pa të drejtë riemërimi.

2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në një thirrje publike dhe procedurë transparente, përzgjedh dhe rendit tre kandidatët më të kualifikuar dhe ia përcjell Kuvendit, sipas ligjit.

3. Prokurori i Përgjithshëm zgjidhet nga radhët e juristëve të spikatur, me jo më pak se 15 vjet përvojë pune, me integritet të lartë moral dhe profesional, që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës ose kanë një gradë shkencore në drejtësi. Kandidati nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit.

4. Nëse Kuvendi nuk zgjedh Prokurorin e Përgjithshëm brenda 30 ditëve nga paraqitja e propozimeve, kandidati i renditur i pari nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë shpallet i emëruar.

5. Pas përfundimit të mandatit dhe me kërkesë të tij, Prokurori i Përgjithshëm emërohet në detyrën e mëparshme ose gjyqtar në gjykatën e apelit.

Neni 148/b

(Shtuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

Prokurori i Përgjithshëm ushtron këto kompetenca:

a) përfaqëson akuzën në Gjykatën e Lartë dhe çështjet në Gjykatën Kushtetuese, me përjashtim të rastit kur përfaqësimi bëhet nga Prokuroria e Posaçme;

b) nxjerr udhëzime të përgjithshme me shkrim për prokurorët, me përjashtim të prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme;

c) siguron mbarëvajtjen e punës në administratën e prokurorisë, me përjashtim të administratës së Prokurorisë së Posaçme. Krijimi dhe mbarëvajtja e strukturave të teknologjisë së informacionit në prokurori rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave;

- ç) propozon dhe administron buxhetin e prokurorisë, me përjashtim të buxhetit të Prokurorisë së Posaçme;
- d) raporton në Kuvend për gjendjen e kriminalitetit;
- dh) ushtron kompetenca të tjera të përcaktuara në ligj.

Neni 148/c

(Shtuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

1. Mandati i Prokurorit të Përgjithshëm mbaron kur:
 - a) mbush moshën e pensionit;
 - b) përfundon mandatin 7-vjeçar;
 - c) jep dorëheqjen;
 - ç) shkarkohet sipas nenit 149/c të Kushtetutës,
 - d) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;
 - dh) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.
2. Mbarimi i mandatit deklarohet me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Neni 148/ç

(Shtuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

1. Prokurorë mund të jenë shtetasit shqiptarë, që emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit.
2. Kriteret e tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e prokurorëve parashikohen me ligj.

Neni 148/d

(Shtuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

1. Prokurori mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit.
2. Prokurori shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë kur:
 - a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës;
 - b) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.
3. Kundër vendimit të shkarkimit bëhet ankim në Gjykatën Kushtetuese.
4. Prokurori pezullohet nga detyra me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë kur:
 - a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një veprë penale;
 - b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje;
 - c) fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit.

Neni 148/dh

(Shtuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

1. Prokuroria e Posaçme ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën para gjykatave të posaçme të parashikuara në nenin 135, pika 2, të Kushtetutës, si dhe para Gjykatës së Lartë.
2. Prokuroria e Posaçme përbëhet nga të paktën 10 prokurorë, të cilët emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi. Ligji vendos kritere të tjera për përzgjedhjen si

dhe për procedurën transparente dhe publike të emërimit.

3. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme zgjidhet nga radhët e prokurorëve të kësaj prokurorie me shumicën e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për 3 vjet, pa të drejtë rizgjedhjeje, sipas ligjit.

4. Prokurori i Prokurorisë së Posaçme shkarkohet për kryerjen e një krimi ose për kryerjen e një shkeljeje të rëndë disiplinore me dy të tretat e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

5. Kandidati për prokuror, oficer i hetimit, personel administrativ i Prokurorisë së Posaçme, Njesisë së Posaçme Hetimore, si dhe familjarët e afërm të tij, para emërimit, i nënshtrohen verifikimit të pasurisë dhe të figurës, japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve personale, sipas ligjit.

Neni 149

(Ndryshuar pika 1 dhe 4 me ligjin nr. 9904, datë 21.4.2008 dhe me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve të Republikës së Shqipërisë.

2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë përbëhet nga 11 anëtarë, gjashtë prej të cilëve zgjidhen nga prokurorët e të gjitha niveleve të prokurorisë dhe pesë anëtarë zgjidhen nga Kuvendi, nga radhët e juristëve joprokurorë.

3. Anëtarët prokurorë përzgjidhen nga radhët e prokurorëve me integritet të lartë moral dhe profesional, sipas një procedure transparente dhe publike që siguron një përfaqësim të drejtë të të gjitha niveleve të prokurorisë. Anëtarët joprokurorë përzgjidhen nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional. Ata nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kriteret e tjera dhe procedura për përzgjedhjen e kandidatëve rregullohen me ligj.

4. Dy anëtarë joprokurorë zgjidhen nga radhët e avokatëve, dy anëtarë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, si dhe një anëtar nga shoqëria civile. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, bazuar në një procedurë transparente dhe publike, shpall vendet vakante, sipas ligjit.

5. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, jo më vonë se 10 ditë nga paraqitja e kandidaturave, verifikon nëse kandidatët plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji, si dhe vlerëson kriteret profesionale e morale për anëtarin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe përgatit listën. Në rast se kandidatët nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret për t'u zgjedhur, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit nuk i përfshin emrat e tyre në listë.

6. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit pas përfundimit të verifikimeve, i dërgon menjëherë listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret formale nënkomisionit, sipas paragrafit 7 të këtij neni.

7. Komisioni i përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend krijon një nënkomision për vlerësimin e mëtejshëm dhe përzgjedhjen e kandidatëve jo më vonë se 3 ditë nga paraqitja e listës. Nënkomisioni përbëhet nga 5 deputetë, prej të cilëve 3 caktohen nga shumica dhe 2 nga pakica parlamentare. Nënkomisioni, me të paktën katër vota, mund të përfshijë në listën e kandidatëve edhe ata që janë përjashtuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit për mospërbushje të kriterëve formale. Nënkomisioni përzgjedh kandidatët me mbështetjen e të paktën 4 anëtarëve. Nëse nuk arrihet shumica e kërkuar, kandidatët përzgjidhen me short.

8. Emrat e kandidatëve të përzgjedhur nga nënkomisioni përmbledhen në një listë dhe i dërgohen Kryetarit të Kuvendit. Brenda 10 ditëve, Kuvendi miraton listën e kandidatëve me 2/3 e të gjithë anëtarëve. Nëse lista rrëzohet, procedura përsëritet në nënkomision sipas pikës 7 të këtij neni, por jo më shumë se dy herë. Në rast se pas zhvillimit për herë të tretë të procedurës Kuvendi nuk miraton listën e paraqitur, kandidatët e kësaj liste konsiderohen të zgjedhur. Procedura e detajuar rregullohet me ligj.

9. Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë zgjidhet në mbledhjen e parë të Këshillit nga radhët e anëtarëve joprokurorë, sipas ligjit.

10. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë e ushtrojnë detyrën me kohë të plotë për një periudhë prej pesë vjetësh, pa të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme. Në përfundim të mandatit, anëtarët prokurorë kthehen në vendet e mëparshme të punës. Mandati i prokurorit të posaçëm pezullohet gjatë kohës që ushtron funksionin si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Anëtarët joprokurorë që përpara emërimit punonin me kohë të plotë në sektorin publik, rikthehen në vendet e mëparshme të punës ose në pamundësi, në detyra të barasvlershme me to.

Neni 149/a

(Shtuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ushtron këto përgjegjësi:

- a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon prokurorët e të gjitha niveleve;
- b) vendos për masat disiplinore ndaj prokurorëve të të gjitha niveleve;
- c) i propozon Kuvendit kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm, sipas ligjit;
- ç) miraton rregullat për etikën e prokurorëve dhe mbikëqyr respektimin e tyre;
- d) propozon dhe administron buxhetin e tij;
- dh) informon publikun dhe Kuvendin mbi gjendjen e prokurorisë;
- e) ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj.

2. Ligji mund të parashikojë krijimin e komisioneve vendimmarrëse pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Neni 149/b

(Shtuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

1. Mandati i anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë mbaron kur:

- a) mbush moshën e pensionit;
- b) përfundon mandatin 5-vjeçar;
- c) jep dorëheqjen;
- ç) shkarkohet sipas nenit 149/c të Kushtetutës;
- d) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajftueshmërisë në ushtrimin e funksionit;
- dh) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.

2. Mbarimi i mandatit deklarohet me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

3. Kur vendi i anëtarit mbetet vakant, organi që ka emëruar anëtarin paraardhës, sipas nenit 149, emëron një anëtar të ri, i cili qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të anëtarit të larguar.

4. Anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë qëndron në detyrë deri në emërimin e pasardhësit, përveç rasteve të parashikuara në nënparagrafët “c”, “ç”, “d” dhe “dh”, të paragrafit 1, të këtij neni.

Neni 149/c

(Shtuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

1. Prokurori i Përgjithshëm dhe anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit.

2. Prokurori i Përgjithshëm dhe anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë shkarkohen nga Gjykata Kushtetuese kur:

- a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike;
- b) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

3. Prokurori i Përgjithshëm dhe anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë pezullohet nga

detyra me vendim të Gjykatës Kushtetuese kur:

- a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një vepre penale;
- b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje;
- c) fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit.

Neni 149/ç

(Shtuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

Qenia Prokuror i Përgjithshëm, prokuror ose anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore ose politike, si dhe me veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik ose shkencor.

Neni 149/d

(Shtuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

1. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi kryen verifikimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kriterëve profesionale e morale të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, si dhe të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrton dhe rendit kandidatët sipas meritës profesionale. Renditja e kandidatëve nuk është e detyrueshme, me përjashtim të rastit kur nuk arrihet të emërohet kandidati.

2. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi mbledhet sa herë është e nevojshme.

3. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi përbëhet nga 9 anëtarë të përzgjedhur me short, nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ndaj të cilëve nuk është dhënë masë disiplinore. Ata ushtrojnë detyrën me mandat njëvjeçar, që fillon në datën një janar të çdo viti kalendarik. Presidenti i Republikës përzgjedh me short, midis datave 1 dhe 5 dhjetor të çdo viti kalendarik, dy gjyqtarë nga Gjykata Kushtetuese, një gjyqtar nga Gjykata e Lartë, një prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme, dy gjyqtarë dhe dy prokurorë nga gjykatat e apelit, si dhe një gjyqtar nga gjykatat administrative. Nëse Presidenti i Republikës nuk arrin të zgjedhë anëtarët deri në datën 5 dhjetor, Kryetari i Kuvendit i zgjedh ata me short brenda datës 10 dhjetor të atij viti kalendarik. Avokati i Popullit merr pjesë si vëzhgues në procedurën e hedhjes së shortit si dhe në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

4. Kryetar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi është anëtari i Gjykatës së Lartë. Gjykata e Lartë krijon kushtet e punës për ushtrimin e veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

5. Kriteret e tjera për shkallën e kualifikimit të kandidatëve që marrin pjesë në short parashikohen me ligj. Organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rregullohet me ligj.

PJESA E NJËMBËDHJETË REFERENDUMI

Neni 150

1. Populli, nëpërmjet 50 mijë shtetasve me të drejtë vote, ka të drejtën e referendumit për shfuqizimin e një ligji, si dhe t'i kërkojë Presidentit të Republikës zhvillimin e referendumit për çështje të një rëndësie të veçantë.

2. Kuvendi, me propozimin e jo më pak se një së pestës së deputetëve ose me propozimin e Këshillit të Ministrave, mund të vendosë që një çështje ose një projektligj i një rëndësie të veçantë të shtrohet në referendum.

3. Parimet dhe procedurat për zhvillimin e referendumit, si dhe vlefshmëria e tij parashikohen me ligj.

Neni 151

1. Ligji i miratuar me referendum shpallet nga Presidenti i Republikës.
2. Çështjet që lidhen me tërësinë territoriale të Republikës së Shqipërisë, me kufizimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, me buxhetin, taksat e detyrimet financiare të shtetit, me vendosjen dhe heqjen e gjendjes së jashtëzakonshme, me deklarimin e luftës dhe të paqes dhe me amnistinë nuk mund të shtrohen në asnjë referendum.
3. Referendumi për të njëjtën çështje nuk mund të përsëritet përpara se të kenë kaluar tre vjet nga zhvillimi i tij.

Neni 152

1. Gjykata Kushtetuese shqyrton paraprakisht kushtetutshmërinë e çështjeve të shtruara për referendum sipas nenit 150 paragrafët 1 e 2, nenit 151 paragrafët 2 e 3 edhe sipas nenit 177 paragrafët 4 e 5 brenda 60 ditëve.
2. Rëndësia e çështjeve të veçanta, të parashikuara në nenin 150 paragrafët 1 e 2 nuk është objekt gjykimi në Gjykatën Kushtetuese.
3. Data e referendumit caktohet nga Presidenti i Republikës brenda 45 ditëve pas shpalljes së vendimit pozitiv të Gjykatës Kushtetuese ose pas kalimit të afatit brenda të cilit Gjykata Kushtetuese duhet të shprehej. Gjatë vitit referendumet zhvillohen vetëm në një ditë.

PJESA E DYMBËDHJETË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
(Shfuqizuar me ligjin nr. 9904, datë 21.4.2008)

Neni 153

(Shfuqizuar me ligjin nr. 9904, datë 21.4.2008)

Neni 154

(Shfuqizuar me ligjin nr. 9904, datë 21.4.2008)

PJESA E TREMBËDHJETË
FINANCAT PUBLIKE

Neni 155

Taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të paguesve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre caktohen me ligj. Në këto raste ligjit nuk mund t'i jepet fuqi prapavepruese.

Neni 156

Shteti mund të marrë e të garantojë hua dhe kredi financiare, kur autorizohet me ligj.

Neni 157

1. Sistemi buxhetor përbëhet nga buxheti i shtetit dhe nga buxhetet vendore.
2. Buxheti i Shtetit krijohet nga të ardhurat e mbledhura prej taksave, tatimeve dhe detyrimeve të tjera financiare, si dhe nga të ardhura të tjera të ligjshme. Ai përfshin të gjitha shpenzimet e shtetit.
3. Organet vendore caktojnë dhe mbledhin taksa dhe detyrime të tjera siç përcaktohet me ligj.

4. Organet e pushtetit qendror dhe atij vendor janë të detyruara t'i bëjnë publike të ardhurat dhe shpenzimet.

Neni 158

1. Kryeministri, në emër të Këshillit të Ministrave, i paraqet Kuvendit projektligjin për buxhetin e shtetit gjatë sesionit të vjeshtës, i cili nuk mund të mbyllet pa e miratuar atë.

2. Në qoftë se projektligji nuk arrin të miratohet deri në fillim të vitit të ardhshëm financiar, Këshilli i Ministrave zbaton çdo muaj një të dymbëdhjetën e buxhetit të vitit paraardhës, derisa të miratohet buxheti i ri.

3. Kuvendi miraton buxhetin e ri brenda 3 muajve nga dita e mbarimit të vitit të kaluar financiar, përveçse në rastet e vendosjes së masave të jashtëzakonshme.

4. Këshilli i Ministrave është i detyruar t'i paraqesë raport Kuvendit lidhur me zbatimin e buxhetit dhe me borxhin shtetëror për vitin e kaluar.

5. Kuvendi vendos përfundimisht pasi dëgjon edhe raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Neni 159

Parimet dhe procedurat për hartimin e projektbuxhetit, si dhe për zbatimin e buxhetit përcaktohen me ligj.

Neni 160

1. Gjatë vitit financiar Kuvendi mund të bëjë ndryshime në buxhet.

2. Ndryshimet në buxhet bëhen sipas procedurës së parashikuar për hartimin dhe miratimin e vetë buxhetit.

3. Shpenzimet e parashikuara me ligje të tjera nuk mund të ulen sa kohë që këto ligje janë në fuqi.

Neni 161

1. Banka Qendrore e shtetit është Banka e Shqipërisë. Ajo ka të drejtën ekskluzive të nxjerrjes e të qarkullimit të monedhës shqiptare, të zbatimit të pavarur të politikës monetare dhe të mbajtjes e të administrimit të rezervave valutore të Republikës së Shqipërisë.

2. Banka e Shqipërisë drejtohet nga një këshill, i cili kryesohet nga Guvernatori. Guvernatori zgjidhet nga Kuvendi me propozim të Presidentit të Republikës për 7 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

PJESA E KATËRMBËDHJETË KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Neni 162

1. Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar. Ai u nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjeve.

2. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit zgjidhet dhe shkarkohet nga Kuvendi me propozim të Presidentit të Republikës. Ai qëndron në detyrë për 7 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

Neni 163

Kontrolli i Lartë i Shtetit kontrollon:

- a) veprimtarinë ekonomike të institucioneve shtetërore e të personave të tjerë juridikë shtetërorë;
- b) përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve shtetërore nga organet e pushtetit qendror dhe atij vendor;
- c) veprimtarinë ekonomike të personave juridikë, në të cilët shteti ka më shumë se gjysmën e pjesëve ose të aksioneve, ose kur huat, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti.

Neni 164

1. Kontrolli i Lartë i Shtetit i paraqet Kuvendit:
 - a) raport për zbatimin e buxhetit të shtetit;
 - b) mendim për raportin e Këshillit të Ministrave për shpenzimet e vitit të kaluar financiar para se të miratohet nga Kuvendi;
 - c) informacion për rezultatet e kontrolleve sa herë që kërkohet nga Kuvendi.
2. Kontrolli i Lartë i Shtetit i paraqet Kuvendit raportin vjetor të veprimtarisë së tij.

Neni 165

1. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit mund të ftohet të marrë pjesë dhe të flasë në mbledhjet e Këshillit të Ministrave, kur shqyrtohen çështje që lidhen me funksionet e tij.
2. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit ka imunitetin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

PJESA E PESËMBËDHJETË FORCAT E ARMATOSURA

Neni 166

1. Shtetasit shqiptarë kanë për detyrë të marrin pjesë në mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë, siç parashikohet në ligj.
2. Shtetasi që, për arsye ndërgjegjeje, nuk pranon shërbimin me armë në Forcat e Armatosura, është i detyruar të kryejë një shërbim alternativ, siç parashikohet në ligj.

Neni 167

1. Ushtarakët e shërbimit aktiv nuk mund të zgjidhen ose të emërohen në detyra të tjera shtetërore dhe as të marrin pjesë në parti ose në veprimtari politike.
2. Pjesëtarët e forcave të armatosura ose personat që kryejnë shërbim alternativ, gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë kushtetuese, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

Neni 168

1. Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë përbëhen nga forcat tokësore, detare dhe ajrore.
2. Presidenti i Republikës është Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura.
3. Këshilli i Sigurimit Kombëtar është organ këshillimor i Presidentit të Republikës.

Neni 169

1. Presidenti i Republikës, në kohë paqeje, ushtron drejtimin e Forcave të Armatosura nëpërmjet Kryeministrit dhe Ministrit të Mbrojtjes.
2. Presidenti i Republikës, në kohe lufte, emëron dhe shkarkon Komandantin e Forcave të Armatosura me propozim të Kryeministrit.
3. Presidenti i Republikës, me propozim të Kryeministrit, emëron dhe shkarkon Shefin e

Shtabit të Përgjithshëm, si dhe, me propozim të ministrit të Mbrojtjes, emëron dhe shkarkon komandantët e forcave tokësore, detare dhe ajrore.

4. Kompetencat e Presidentit të Republikës si Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe ato të Komandantit të Forcave të Armatosura dhe varësia e tyre nga organet kushtetuese, caktohen me ligj.

PJESA E GJASHTËMBËDHJETË MASAT E JASHTËZAKONSHME

Neni 170

1. Masat e jashtëzakonshme mund të vendosen për shkak të gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme ose gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe zgjatën për aq kohë sa vazhdojnë këto gjendje.

2. Parimet e veprimtarisë së organeve publike dhe shkalla e kufizimit të të drejtave dhe lirive të njeriut gjatë gjithë periudhës së ekzistencës së gjendjeve që kërkojnë marrjen e masave të jashtëzakonshme, përcaktohen me ligj.

3. Ligji duhet të përcaktojë parimet, fushat dhe mënyrën e kompensimit të humbjeve që vijnë si rezultat i kufizimit të të drejtave dhe lirive gjatë marrjes së masave të jashtëzakonshme.

4. Aktet që ndërmerren si pasojë e marrjes së masave të jashtëzakonshme, duhet të jenë në përpjesëtim me shkallën e rrezikut dhe duhet të synojnë rivendosjen sa më të shpejtë të kushteve për funksionimin normal të shtetit.

5. Gjatë gjendjeve që kërkojnë marrjen e masave të jashtëzakonshme, nuk mund të ndryshohet asnjë prej këtyre akteve: Kushtetuta, ligjet për zgjedhjet për Kuvendin dhe për organet e pushtetit vendor, si dhe ligjet për masat e jashtëzakonshme.

6. Gjatë periudhës së zbatimit të masave të jashtëzakonshme nuk mund të zhvillohen zgjedhje vendore, nuk mund të zhvillohet referendum, si dhe nuk mund të zgjidhet një President i ri i Republikës. Zgjedhjet vendore mund të bëhen vetëm aty ku nuk zbatohen masat e jashtëzakonshme.

Neni 171

1. Në rast agresioni të armatosur kundër Republikës së Shqipërisë, Presidenti i Republikës, me kërkesë të Këshillit të Ministrave, shpall gjendjen e luftës.

2. Në rast kërcënimesh të jashtme ose kur detyrimi për mbrojtje të përbashkët buron nga një marrëveshje ndërkombëtare, Kuvendi, me propozim të Presidentit të Republikës, shpall gjendjen e luftës, vendos gjendjen e mobilizimit dhe të çmobilizimit të përgjithshëm ose të pjesshëm.

Neni 172

1. Në rastin e nenit 171 paragrafi 1, Presidenti i Republikës i paraqet Kuvendit dekretin për vendosjen e gjendjes së luftës brenda 48 orëve nga nënshkrimi i tij, duke specifikuar të drejtat që kufizohen.

2. Kuvendi merr në shqyrtim menjëherë dhe vendos me shumicën e të gjithë anëtarëve për dekretin e Presidentit.

Neni 173

1. Në rast rreziku për rendin kushtetues dhe për sigurinë publike, Kuvendi, me kërkesë të Këshillit të Ministrave, mund të vendosë në një pjesë ose në të gjithë territorin e shtetit gjendjen e jashtëzakonshme, e cila zgjat për aq kohë sa vazhdon rreziku, por jo më shumë se 60 ditë.

2. Me vendosjen e gjendjes së jashtëzakonshme ndërhyrja e Forcave të Armatosura bëhet me vendim të Kuvendit dhe vetëm kur forcat e policisë nuk janë në gjendje të rivendosin rendin.

3. Zgjatja e afatit të gjendjes së jashtëzakonshme mund të bëhet vetëm me pëlqim të Kuvendit çdo 30 ditë, për një periudhë jo më shumë se 90 ditë.

Neni 174

1. Për parandalimin ose mënjanimin e pasojave të një fatkeqësie natyrore ose aksidenti teknologjik, Këshilli i Ministrave mund të vendosë, për një periudhë jo më të gjatë se 30 ditë, gjendjen e fatkeqësisë natyrore në një pjesë ose në të gjithë territorin e shtetit.

2. Zgjatja e gjendjes së fatkeqësisë natyrore mund të bëhet vetëm me pëlqimin e Kuvendit.

Neni 175

1. Gjatë gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme nuk mund të kufizohen të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet: 15, 18, 19, 20, 21, 24, 25, 29, 30, 31, 32, 34, 39 paragrafi 1, 41 paragrafët 1, 2, 3 dhe 5, 42, 43, 48, 54, 55.

2. Gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore mund të kufizohen të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet: 37, 38, 41 paragrafi 4, 49, 51.

3. Aktet për shpalljen e gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme ose të gjendjes së fatkeqësisë natyrore duhet të cilësojnë të drejtat dhe liritë që kufizohen sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 176

Kur Kuvendi nuk mund të mblidhet gjatë gjendjes së luftës, Presidenti i Republikës, me propozim të Këshillit të Ministrave, ka të drejtë të nxjerrë akte që kanë fuqinë e ligjit, të cilat duhet të miratohen nga Kuvendi në mbledhjen e tij më të parë.

PJESA E SHTATËMBËDHJETË RISHIKIMI I KUSHTETUTËS

Neni 177

1. Nisma për rishikimin e Kushtetutës mund të ndërmerret nga jo më pak se një e pesta e anëtarëve të Kuvendit.

2. Asnjë rishikim i Kushtetutës nuk mund të ndërmerret gjatë kohës kur janë vendosur masat e jashtëzakonshme.

3. Projekti miratohet nga jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

4. Kuvendi mund të vendosë, me dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij, që projektamendamentet kushtetuese të votohen me referendum. Projektligji për rishikimin e Kushtetutës hyn në fuqi pas ratifikimit me referendum, i cili bëhet jo më vonë se 60 ditë nga miratimi i tij në Kuvend.

5. Amendamenti kushtetues i miratuar i nënshtrohet referendumit, kur këtë e kërkon një e pesta e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

6. Presidenti i Republikës nuk ka të drejtë ta kthejë për rishqyrtim ligjin e miratuar nga Kuvendi për rishikimin e Kushtetutës.

7. Ligji i miratuar në referendum shpallet nga Presidenti i Republikës dhe hyn në fuqi në datën e parashikuar në këtë ligj.

8. Rishikimi i Kushtetutës për të njëjtën çështje nuk mund të bëhet përpara se të ketë kaluar një vit nga dita e rrëzimit të projektligjit në Kuvend dhe jo më përpara se të kenë kaluar 3 vjet nga

dita e rrëzimit të tij në referendum.

PJESA E TETËMBËDHJETË
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 178

1. Ligjet dhe aktet e tjera normative të miratuara para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute do të zbatohen derisa nuk janë shfuqizuar.

2. Këshilli i Ministrave i paraqet Kuvendit projektligjet e nevojshme për vënien në zbatim të kësaj Kushtetute.

Neni 179

(Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

1. Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese vazhdojnë veprimtarinë e tyre si anëtarë të Gjykatës Kushtetuese sipas mandatit të mëparshëm.

2. Anëtari i parë për t'u zëvendësuar në Gjykatën Kushtetuese emërohet nga Presidenti i Republikës, i dyti zgjidhet nga Kuvendi dhe i treti emërohet nga Gjykata e Lartë. Kjo radhë ndiqet për të gjitha emërimet që do të bëhen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Me qëllim përtëritjen e rregullt të përbërjes së Gjykatës Kushtetuese, gjyqtari që do të zëvendësojë gjyqtarin, të cilit i mbaron mandati në vitin 2017, do të qëndrojë në detyrë deri në vitin 2025 dhe gjyqtari i ri, që do të zëvendësojë gjyqtarin, të cilit i mbaron mandati në vitin 2020, do të qëndrojë në detyrë deri në vitin 2028. Gjyqtarët e tjerë të Gjykatës Kushtetuese emërohen për të gjithë kohëzgjatjen e mandatit, sipas ligjit.

4. Anëtarët e Gjykatës së Lartë vazhdojnë të ushtrojnë detyrën e tyre sipas mandatit të mëparshëm. Anëtarët e rinj që do të zëvendësojnë anëtarët, të cilëve u mbaron mandati, emërohen sipas dispozitave të këtij ligji.

5. Këshilli i Lartë Gjyqësor krijohet brenda tetë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Tre anëtarë gjyqtarë dhe dy anëtarë jogjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohen fillimisht për një mandat trevjeçar, me qëllim përtëritjen e pjesshme të këtij organi. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë e përfundojnë mandatin e tyre pas krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, por jo më vonë se zgjedhja e të gjithë anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas ligjit. Për emërimet e para për anëtarët jogjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor që do të bëhen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, verifikimi i kandidatëve sipas nenit 147, të Kushtetutës, do të kryhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit dhe nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit.

6. Këshilli i Lartë i Prokurorisë krijohet brenda tetë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Tre anëtarë prokurorë dhe dy anëtarë joprokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë emërohen fillimisht për një mandat trevjeçar, me qëllim përtëritjen e pjesshme të këtij organi. Për emërimet e para për anëtarët joprokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, që do të bëhen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, verifikimi i kandidatëve sipas nenit 149, të Kushtetutës, do të kryhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit dhe Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit.

7. Gjatë mandatit të tyre nëntëvjeçar gjyqtarët e Kolegjit të Apelit, sipas nenit 179/b, kanë juridiksion disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kolegji i Apelit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.

8. Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda

do të emërtohen, funksionojnë dhe ushtrojnë kompetencat e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit brenda dy muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas ligjit. Transferimi i çështjeve do të bëhet në përputhje me ligjin. Gjyqtarët në detyrë pranë këtyre gjykatave do të transferohen në gjykata të tjera, në rast se ata ose familjarët e tyre të afërt nuk japin pëlqimin për rishikimin periodik të llogarive të tyre financiare dhe telekomunikimeve vetjake. Prokurorët pranë Prokurorisë së Posaçme do të emërohen brenda dy muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas ligjit. Pas krijimit të Prokurorisë së Posaçme, Prokuroria për Krimet e Rënda do të pushojë së funksionuari. Transferimi i çështjeve në hetim dhe gjykim do të kryhet sipas ligjit.

9. Inspektori i Lartë i Drejtësisë emërohet brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Mënyra e funksionimit të inspektorateve ekzistuese gjatë periudhës kalimtare rregullohet me ligj.

10. Gjyqtarët dhe prokurorët që nuk kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës qëndrojnë në detyrë dhe janë subjekt i procesit të rivlerësimit kalimtar të kualifikimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas nenit 179/b dhe aneksit të këtij ligji.

11. Presidenti i Republikës, brenda pesë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, zgjedh me short anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, sipas nenit 149/d, pika 3, të Kushtetutës. Nëse Presidenti i Republikës nuk i përzgjedh anëtarët brenda pesë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Kryetari i Kuvendit i zgjedh ata me short brenda dhjetë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Të zgjedhurit qëndrojnë në detyrë deri në datën 31 dhjetor të vitit kur hyn në fuqi ky ligj. Avokati i Popullit merr pjesë si vëzhgues në procedurën e shortit, si dhe në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi i nënshtrohen menjëherë procesit të rivlerësimit kalimtar të kualifikimit për gjyqtarë dhe prokurorë sipas nenit 179/b të këtij ligji.

12. Presidenti i Republikës vazhdon të qëndrojë Kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor brenda 8 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Me krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Presidenti emëron gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, sipas nenit 136 të Kushtetutës. Presidenti plotëson vakancën e parë në Gjykatën Kushtetuese sipas paragrafit 2, të këtij neni, dhe nenit 125 të Kushtetutës.

13. Deri në zgjedhjet parlamentare, që do të mbahen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, por jo më vonë se data 1 shtator 2017, zgjedhja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe e Prokurorit të Përgjithshëm do të bëhet me dy të tretat e anëtarëve të Kuvendit. Zgjedhjet e tjera do të bëhen me tri të pestat e anëtarëve të Kuvendit.

Neni 179/1

(Shtuar me ligjin nr. 137/2015, datë 17.12.2015)

1. Mandati i funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar në organet kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj, që është fituar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, mbaron ose është i pavlefshëm kur konstatohet se i zgjedhuri ose i emëruari përfshihet në rrethin e subjekteve që janë të përjashtuara nga e drejta për t'u zgjedhur, sipas neneve 6/1 dhe 45, pika 3, të Kushtetutës.

2. Brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Kuvendi, në përputhje me procedurën e nenit 81, pika 2, të Kushtetutës, miraton ligjin që përcakton kushtet dhe rregullat për garantimin e integritetit të organeve që zgjidhen, emërohen ose mbajnë funksione publike.

Neni 179/b

(Shtuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016; zëvendësuar togfjalësh në fjalinë e parë të pikës 8 me ligjin nr. 16/2022, datë 10.2.2022)

1. Sistemi i rivlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij

sistemi.

2. Rivlerësimi do të kryhet mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të vlerësimit.

3. Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*.

4. Të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme do të rivlerësohen *ex officio*. Procesit të rivlerësimit mund t'i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët, ish-prokurorët, ish-këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet.

5. Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese. Gjatë periudhës kalimtare 9-vjeçare Gjykata Kushtetuese do të funksionojë me dy kolegje.

6. Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë të pavarur dhe të paanshëm.

7. Moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit përbën shkak për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës, krahas shkaqeve të parashikuara në Kushtetutë. Gjyqtarët dhe prokurorët, përfshirë ata që janë deleguar në pozicione të tjera, ish-gjyqtarë ose ish-prokurorë, të cilët kalojnë me sukses rivlerësimin, qëndrojnë në detyrë ose emërohen gjyqtarë e prokurorë. Subjektet e tjera, të cilët kalojnë me sukses rivlerësimin, emërohen gjyqtarë ose prokurorë, sipas ligjit.

8. Mandati i anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisionerit Publik përfundon në datën 31.12.2024, ndërsa mandati i gjyqtarëve të Kolegjit të Apelit është 9 vjet. Pas shpërbërjes së komisionit, çështjet e papërfunduara të rivlerësimit shqyrtohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas ligjit. Çështjet e papërfunduara të rivlerësimit të prokurorëve shqyrtohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, sipas ligjit. Pas shpërbërjes së komisionerëve publikë, kompetencat e tyre ushtrohen nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme. Ankimet ndaj vendimeve të komisionit ende të papërfunduara do të shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese.

9. Kuvendi vendos për shfuqizimin e këtij Aneksi pasi vendimi i fundit të ketë marrë formë të prerë, si dhe mbi bazën e raportit të paraqitur nga Kryetari i Apelit mbi gjendjen e çështjeve të papërfunduara, ose kur përfundon mandati i Kolegjit të Posaçëm të Kualifikimit.

10. Procedurat dhe kriteret e rivlerësimit rregullohen sipas parashikimeve të Aneksit dhe ligjit.

Neni 180

1. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë para hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute konsiderohen të ratifikuara sipas kësaj Kushtetute.

2. Këshilli i Ministrave i paraqet Gjykatës Kushtetuese marrëveshjet ndërkombëtare, të cilat përmbajnë dispozita që vijnë në kundërshtim me këtë Kushtetutë.

Neni 181

1. Kuvendi, brenda dy deri tre vjetëve nga hyrja në fuqi e kësaj Kushtetute, nxjerr ligje për rregullimin e drejtë të çështjeve të ndryshme që lidhen me shpronësimet dhe konfiskimet e kryera para miratimit të kësaj Kushtetute, duke u udhëhequr nga kriteret e nenit 41.

2. Ligjet dhe aktet e tjera normative të miratuara para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute dhe që kanë të bëjnë me shpronësimet dhe konfiskimet, do të zbatohen kur nuk vijnë në kundërshtim me të.

Neni 182

Ligji nr. 7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, si dhe ligjet e tjera kushtetuese shfuqizohen ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute.

Neni 183

Kjo Kushtetutë hyn në fuqi me shpalljen nga Presidenti i Republikës.

Dispozita kalimtare të parashikuara me ligjin nr. 9675, datë 13.1.2007

1. Mandati katërvjeçar, i përcaktuar në nenin 1 të këtij ligji, zbatohet për herë të parë për këshillat dhe kryetarët e bashkive e të komunave që zgjidhen në zgjedhjet e para pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Njëri nga mandatet e dy anëtarëve të KQZ-së, të zgjedhur në bazë të nenit 2 të këtij ligji, mbaron më 31 mars 2010, kurse tjetri më 31 mars 2013. Kuvendi përcakton me short se cili nga mandatet përfundon më 31 mars 2010. Procedurat e shortit përcaktohen nga Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin të Kuvendit të Shqipërisë.

Miratur me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 të Kuvendit Popullor

Miratur me referendum më 22.11.1998

Shpallur me dekretin nr. 2260, datë 28.11.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

ANEKS

Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve

Neni A

Kufizimi i të drejtave të parashikuara nga Kushtetuta

1. Me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit, zbatimi i disa neneve të kësaj Kushtetute, veçanërisht i neneve që lidhen me të drejtën për respektimin e jetës private, si dhe nenet 36 dhe 37, dispozitat që lidhen me barrën e provës, nenet 128, 131, nënparagrafi “P”, 135, 138, 140, 145, paragrafi 1, 147/a, paragrafi 1, nënparagrafi “b”, 149/a, paragrafi 1, nënparagrafi “b”, kufizohen pjesërisht, sipas nenit 17 të Kushtetutës.

2. Subjektet që kalojnë me sukses rivlerësimin, sipas parashikimeve të këtij Aneksi, i nënshtrohen sistemit të përhershëm të llogaridhënies, sipas rregullave të përgjithshme të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligj.

Neni B

Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit

1. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit do të mbështesë procesin e rivlerësimit nëpërmjet monitorimit dhe mbikëqyrjes së gjithë procesit. Ky Operacion përfshin partnerët në kuadër të procesit të integritetit evropian dhe bashkëpunimit euro-atlantik dhe udhëhiqet nga Komisioni Evropian.

2. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit i ushtron detyrat e veta sipas marrëveshjeve ndër-kombëtare. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit emëron vëzhguesit ndër-kombëtarë pas njoftimit të Këshillit të Ministrave. Vëzhguesit emërohen nga radhët e gjyqtarëve ose prokurorëve me jo më pak se 15 vjet eksperiencë në sistemin e drejtësisë së vendeve të tyre përkatëse. Mandati i vëzhguesit ndër-kombëtar ndërpritet nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit për shkelje të

rënda.

3. Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra:

a) i jep rekomandime Kuvendit lidhur me kualifikimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për pozicionin e anëtarit të Komisionit, gjyqtarit të Kolegjit të Apelimit dhe Komisionerit Publik;

b) paraqet gjetje dhe mendime mbi çështje që shqyrtohen nga Komisioni dhe nga Kolegji i Apelimit, si dhe kontribuon për kontrollin e figurës sipas nenit DH. Lidhur me këto gjetje, vëzhguesi ndërkombëtar mund të kërkojë që Komisioni ose Kolegji i Apelimit të marrë në shqyrtim prova ose të paraqesë prova të marra nga organet shtetërore, entitetet e huaja ose personat privatë, sipas ligjit;

c) u jep komisionerëve publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim duke dhënë arsyet e refuzimit;

ç) kanë të drejtën të marrin të gjithë informacionet menjëherë, të dhënat për persona dhe dokumentet e nevojshme, me qëllim monitorimin e procesit të rivlerësimit në të gjitha nivelet dhe fazat.

Neni C

Dispozita të përgjithshme për Komisionin dhe Kolegjin e Apelimit

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit përbëhet nga katër trupa gjykues të përhershëm me tre anëtarë secili.

2. Dy komisionerë publikë përfaqësojnë interesin publik dhe mund të paraqesin ankim kundër vendimit të Komisionit.

3. Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit ushtrojnë përgjegjësitë e tyre bazuar në parimet e llogaridhënies, integritetit dhe transparencës për krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur dhe profesional të çliruar nga korrupsioni. Gjatë ushtrimit të mandatit të tyre, anëtarët e Komisionit dhe komisionerët publikë gëzojnë statusin e anëtarit të Gjykatës së Lartë. Gjyqtarët e Kolegjit të Apelimit gëzojnë statusin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe mandati i tyre nuk kufizohet për shkak të moshës, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj.

4. Anëtarët e Komisionit, gjyqtarët e Kolegjit të Apelimit, komisionerët publikë, si dhe punonjësit e tjerë të këtyre institucioneve nënshkruajnë deklaratë me shkrim, sipas ligjit, për të autorizuar kryerjen e kontrollit vjetor të pasurisë së tyre, monitorimin sistematik të llogarive dhe transaksioneve financiare, si dhe kufizimet e posaçme të së drejtës së fshehtësisë së komunikimeve gjatë gjithë kohëzgjatjes së qëndrimit të tyre në detyrë. Deklaratat e pasurisë së tyre bëhen publike.

5. Anëtarët e Komisionit dhe gjyqtarët e Kolegjit të Apelimit kanë arsim të lartë juridik dhe jo më pak se 15 vjet përvojë si gjyqtar, prokuror, lektor i së drejtës, avokat, noter, jurist i nivelit të lartë në administratën publike, ose në profesione të tjera ligjore që lidhen me sistemin e drejtësisë. Kandidatët për anëtarë të Komisionit dhe gjyqtarë të Kolegjit nuk duhet të kenë qenë gjyqtarë, prokurorë ose këshilltarë ligjorë apo ndihmës ligjorë gjatë dy vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kandidatët nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike dhe funksione drejtuese në partitë politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit.

6. Presidenti i Republikës së Shqipërisë organizon procesin e hapur dhe transparent të aplikimit për pozicionin e anëtarit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, gjyqtarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe të Komisionerit Publik. Kandidatët i paraqesin Presidentit aplikimet dhe të gjitha deklaratat shoqëruese, sipas ligjit. Brenda 7 ditëve nga përfundimi i procesit të aplikimit, Presidenti përpilon një listë me kandidatë, të cilët plotësojnë kriteret formale për secilin pozicion dhe një listë me kandidatë, të cilët nuk i plotësojnë kriteret formale. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit monitoron këtë proces. Nëse Presidenti nuk e përfundon procesin brenda 45 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij Aneksi, kjo kompetencë i kalon Avokatit të Popullit.

7. Një komision i përbërë nga të paktën tre përfaqësues të Operacionit Ndërkombëtar të

Monitorimit vlerëson kandidatët, sipas ligjit. Jo më vonë se katërbëdhjetë ditë nga paraqitja e dy listave nga Presidenti, Komisioni, bazuar në vlerësimet e tij, i dërgon rekomandimet Presidentit, i cili ia përcjell ato Kuvendit. Nëse Presidenti nuk e ushtron këtë kompetencë brenda 5 ditëve, kjo kompetencë i kalon Avokatit të Popullit.

8. Brenda tre ditëve nga marrja e listës së kandidatëve, të cilët i plotësojnë kriteret formale, listës së kandidatëve, të cilët nuk i plotësojnë kriteret formale dhe listës së rekomandimeve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, Kuvendi krijon një komision *ad hoc* me gjashtë anëtarë të ndarë në mënyrë të barabartë midis shumicës dhe pakicës parlamentare. Komisioni, me të paktën katër vota, mund të kalojë një kandidat nga lista e kandidatëve, të cilët nuk i plotësojnë kriteret formale tek lista e kandidatëve, të cilët i plotësojnë kriteret formale. Komisioni, me të paktën pesë vota, mund kalojë një kandidat nga lista e kandidatëve të rekomanduar nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit tek lista e kandidatëve për votim. Brenda dhjetë ditëve nga krijimi i tij, komisioni *ad hoc* i përcjell listën e kandidatëve për votim për secilin pozicion komisioneve *ad hoc* përzgjedhëse. Dy listat e tjera nuk dërgohen për votim.

9. Kuvendi krijon brenda dhjetë ditëve dy komisione *ad hoc* përzgjedhëse të ndarë në mënyrë të barabartë midis shumicës dhe pakicës parlamentare, ku një komision ka 12 anëtarë dhe një ka 6 anëtarë.

10. Brenda 30 ditëve nga konstituimi i komisionit *ad hoc*, secili anëtar i komisionit me 12 anëtarë përzgjedh një kandidat për komisioner nga lista e kandidatëve për votim pa debat përmes një votimi të fshehtë elektronik ku secili anëtar i komisionit voton për një kandidat. Komisioni përzgjedh më pas dy kandidatë nga lista e kandidatëve për votim për komisionerë publikë përmes një votimi ku dy kandidatët me më shumë vota quhen të përzgjedhur. Në rast barazie të votave, fituesit përzgjidhen me short. Dy kandidatë zëvendësues për secilin pozicion përzgjidhen në të njëjtën mënyrë si për Komisionerin Publik.

11. Brenda 30 ditëve nga konstituimi i komisionit *ad hoc*, secili prej 6 anëtarëve të komisionit përzgjedh nga lista e kandidatëve për votim një kandidat për gjyqtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit pa debat përmes një votimi të fshehtë elektronik ku secili anëtar i komisionit voton për një kandidat. Komisioni më pas përzgjedh gjyqtarin e shtatë nga kandidatët e mbetur të listës së kandidatëve për votim përmes një votimi të thjeshtë ku kandidati me më shumë vota quhet i përzgjedhur. Në rast barazie të votave, fituesi përzgjidhet me short. Dy gjyqtarë zëvendësues për secilin pozicion përzgjidhen në të njëjtën mënyrë si për gjyqtarin e shtatë.

12. Emrat e kandidatëve të përzgjedhur nga dy komisionet *ad hoc* përzgjedhëse përmbledhen në një listë të vetme dhe i dërgohen Kryetarit të Kuvendit. Brenda 10 ditëve, Kuvendi miraton listën e kandidatëve në bllok me 3/5 e votave të të gjithë anëtarëve. Në rast se Kuvendi nuk e miraton listën e kandidatëve në bllok, Kryetari i Kuvendit ia kthen atë komisioneve *ad hoc* për përsëritjen e procesit të përzgjedhjes dhe dërgimin e një liste të dytë brenda 10 ditëve. Kuvendi, brenda 10 ditëve, mund ta rrëzojë në bllok listën e kandidatëve me 2/3 e të gjithë anëtarëve. Në rast se lista nuk rrëzohet, kandidatët e përzgjedhur konsiderohen të zgjedhur. Procedura e detajuar rregullohet me ligj.

13. Anëtari i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, gjyqtari i Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe Komisioneri Publik ushtrojnë detyrën me kohë të plotë dhe nuk mund të mbajnë asnjë pozicion apo të ushtrojnë ndonjë detyrë tjetër gjatë kohëzgjatjes së mandatit.

14. Komisioni, Kolegji i Apelit dhe Komisionerët Publikë kanë buxhet, administratë dhe mjedise të mjaftueshme për të kryer funksionet e tyre si dhe për ushtrimin e funksioneve të vëzhguesve ndërkombëtarë, sipas ligjit.

15. Gjuhët zyrtare të Komisionit, të Kolegjit të Apelit dhe komisionerëve publikë janë gjuha shqipe dhe angleze. Të dyja organet punësojnë përkthyes për këtë qëllim.

16. Anëtari i Komisionit, gjyqtari i Kolegjit të Apelit dhe Komisioneri Publik mban përgjegjësi disiplinore. Rastet e shkeljes disiplinore shqyrtohen nga Kolegji i Apelit, sipas ligjit.

17. Anëtarit të Komisionit, gjyqtarit të Kolegjit të Apelit, Komisionerit Publik, vëzhguesit ndërkombëtar, punonjësit të administratës dhe familjarëve të tyre u garantohet mbrojtje e nivelit

më të lartë, sipas ligjit.

Neni Ç **Rivlerësimi**

1. Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij Aneksi dhe ligjit.

2. Komisioni dhe Kolegji i Apelit publikojnë vendimet e tyre si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm të marrë nga publiku. Këto organe marrin në shqyrtim informacione nga publiku duke respektuar parimin e proporcionalitetit midis privatësisë dhe nevojave të hetimit, si dhe duke garantuar të drejtën për një proces të rregullt.

3. Institucionet shtetërore të Republikës së Shqipërisë bashkëpunojnë me Komisionin dhe Kolegjin e Apelit, duke vënë në dispozicion të tyre informacionin e kërkuar, si dhe duke siguruar akses të drejtpërdrejtë në të dhënat. Ata mund të japin mendime ose të bëjnë propozime konkrete, sipas ligjit.

4. Komisioni ose Kolegji i Apelit, sipas rastit, përmes personelit të tyre, Komisionerit Publik ose vëzhguesit ndërkombëtar, shqyrton deklaratat e subjektit të rivlerësimit për të shkuarën e tij, interviston personat e përmendur në deklaratë ose persona të tjerë, si dhe bashkëpunon me institucione të tjera shtetërore ose të huaja për të konfirmuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimeve. Komisioni, Kolegji dhe vëzhguesit ndërkombëtarë kanë akses të drejtpërdrejtë në të gjitha bazat e të dhënave qeveritare, përveç atyre që janë klasifikuar “sekret shtetëror”, duke përfshirë edhe dosjet personale të të rivlerësuarit, të dhënat statistikore, dosje të përzgjedhura për rivlerësim, vetëvlerësimet, mendimet e eprorëve, të dhënat për trajnimet dhe ankimet ndaj të rivlerësuarve, rezultatet e verifikimit të ankesave, vendimet për marrjen e masave disiplinore ndaj të rivlerësuarve, të dhënat për pronat e të rivlerësuarit, llogaritë bankare, të dhënat tatimore, të dhënat për automjetet, të dhënat për hyrje-daljet në kufi, si dhe çdo dokument tjetër të dobishëm. Komisioni ose Kolegji mund të urdhërojë individë dhe shoqëri tregtare të dëshmojnë ose të japin prova në përputhje me ligjin.

5. Barra e provës i kalon subjektit të rivlerësimit vetëm për këtë proces, duke përjashtuar çdo proces tjetër, në veçanti procesin penal.

Neni D **Vlerësimi i pasurive**

1. Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklaramit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

2. Subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave kontrollon deklaratën e pasurisë dhe i dorëzon Komisionit një raport për ligjshmërinë e pasurive, për saktësinë dhe plotësinë e deklaramit, sipas ligjit.

3. Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj.

4. Nëse subjekti i rivlerësimit ka një pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ai prezumohet fajtor për shkeljen disiplinore, përveçse kur ai paraqet prova që vërtetojnë të kundërtën.

5. Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon deklaratën e pasurisë në kohë sipas ligjit, ai shkarkohet nga detyra. Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të

pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

Neni DH **Kontrolli i figurës**

1. Subjektet e rivlerësimit dorëzojnë një deklaratë dhe i nënshtrohen një kontrolli të figurës, me qëllim identifikimin e atyre që kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Kontrolli i figurës për lidhje me personat e përfshirë në krimin e organizuar bazohet në deklaratën për figurën dhe prova të tjera, përfshirë vendimet e gjykatave shqiptare ose të huaja.

2. Subjektet e rivlerësimit plotësojnë dhe i dorëzojnë Komisionit një deklaratë të detajuar për figurën e tyre që mbulon periudhën nga data 1 janar 2012 deri në ditën e deklarimit, sipas ligjit. Deklarata mund të përdoret si provë vetëm në këtë proces dhe në asnjë rast gjatë një procesi penal.

3. Nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

4. Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon në kohë deklaratën për figurën sipas ligjit, ai shkarkohet. Nëse subjekti i rivlerësimit përpiket të bëjë deklarime të pasakta, ose të fshehtë kontaktet me persona të përfshirë në krimin e organizuar, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

Neni E **Vlerësimi i aftësive profesionale**

1. Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen një rivlerësimi të aftësisë profesionale, me qëllim identifikimin e atyre të cilët nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale që mund të korrigjohen përmes edukimit.

2. Vlerësimi i aftësisë zhvillohet me ndihmën e nëpunësve që ushtrojnë detyrën e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve ose prokurorëve në kohën kur kryhet rivlerësimi. Vlerësimi i aftësisë për gjyqtarët, këshilltarët ligjorë ose ndihmësit ligjorë përfshin aftësinë për të gjykuar, aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave gjyqësore, cilësitë personale dhe angazhimin profesional, bazuar në standardet e parashikuara në ligj. Vlerësimi i aftësisë për prokurorët përfshin aftësinë për të hetuar dhe për të ngritur akuzën publike, aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale, si dhe cilësitë personale bazuar në standardet e parashikuara në ligj. Vlerësimi i aftësisë për këshilltarët ose ndihmësit ligjorë përfshin testimin pranë Shkollës së Magjistraturës. Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim.

3. Në rast se rezulton se subjekti i rivlerësimit ka njohuri, aftësi, gjykim ose sjellje të cekëta, ose ka një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij, atëherë kjo konsiderohet mangësi profesionale dhe zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të pezullimit, shoqëruar me detyrimin për të ndjekur programin e edukimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

4. Në rast se rezulton se subjekti i rivlerësimit ka njohuri, aftësi, gjykim ose sjellje të papërshtatshme, ose ka një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij dhe mangësia e vërejtur nuk mund të korrigjohet përmes programit njëvjeçar të edukimit, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

5. Në rast se subjekti i rivlerësimit kryen veprime për të penguar ose vështirësuar vlerësimin e tij, ose rezulton se ka njohuri, aftësi, gjykim, qëndrime, ose një model pune aq të dobët sa që rrezikon ose cenon të drejtat e qytetarëve, ai konsiderohet i papërshtatshëm për të ushtruar funksionin. Në këtë rast zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe

subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

Neni E
Masat disiplinore

1. Komisioni ose Kolegji i Apelit në përfundim të shqyrtimit të çështjes, vendos masat disiplinore, pezullimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra për një vit, të shoqëruar me edukim të detyrueshëm, ose shkarkimin e tij nga detyra. Në çdo rast vendimi jepet i arsyetuar.

2. Vendimi që urdhëron pezullimin nga detyra, shoqëruar me detyrimin për trajnim identifikon mangësitë. Gjatë periudhës së pezullimit, të rivlerësuarit i njihet e drejta e pagës në masën 75 për qind të saj. Subjekti i rivlerësuar urdhërohet të ndjekë një program edukimi njëvjeçar pranë Shkollës së Magjistraturës, i hartuar për të plotësuar mangësitë. Në fund të programit ai testohet për aftësitë e tij. Ky testim mbikëqyret nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit. Subjekti i rivlerësimit që nuk e kalon testimin shkarkohet nga Komisioni.

3. Në çdo rast, shkarkimi i një gjyqtari ose prokurori nuk është shkak për rihapjen e çështjeve të gjykuara ose të hetuara prej tij, përveçse kur ekzistojnë shkaqet, mbi të cilat realizohet kërkesa për rishikim, sipas parashikimeve në ligjet procedurale.

Neni F
Kolegji i Apelit

1. Kolegji i Apelit përbëhet nga shtatë gjyqtarë dhe është organi i vetëm gjyqësor që shqyrtan ankimet kundër vendimeve të Komisionit, sipas këtij Aneksi dhe ligjit. Kolegji vendos në trupa gjyqese me pesë anëtarë secili.

2. Ndaj vendimeve të Komisionit mund të ushtrojnë ankim pranë këtij Kolegji subjekti i rivlerësimit dhe Komisioneri Publik, sipas ligjit, me përjashtim të vendimeve të marra sipas nenit E, paragrafi 2, të Aneksit.

3. Kolegji mund të kërkojë mbledhjen e fakteve ose të provave, si dhe të korrigjojë çdo gabim procedural të kryer nga ana e Komisionit, duke mbajtur parasysh të drejtat themelore të subjektit të rivlerësuar. Kolegji vendos në lidhje me çështjen dhe nuk mund t'ia kthejë atë Komisionit për rishqyrtim. Juridiksioni kushtetues nuk lejon të vihen në diskutim parimet e kushtetutshmërisë, mbi të cilat është bazuar procesi i rivlerësimit dhe si i tillë bazohet tek kriteret e përcaktuara në këtë ligj.

4. Vëzhguesi ndërkombëtar në Kolegjin e Apelit gëzon të njëjtat të drejta si dhe vëzhguesi ndërkombëtar pranë Komisionit.

5. Gjatë periudhës së shqyrtimit të ankimit subjekti i rivlerësimit paguhet në masën 75 për qind të pagës. Nëse Kolegji pranon ankimin duke shfuqizuar vendimin e Komisionit, pjesa prej 25 për qind e pagës i paguhet subjektit për të gjithë periudhën e ndërprerjes. Vendimi përfundimtar që urdhëron shkarkimin nga detyra, hyn në fuqi menjëherë.

6. Kur ushtron ankim kundër masës disiplinore të shkarkimit, subjekti i rivlerësimit pezullohet nga detyra deri në marrjen e vendimit nga Kolegji.

7. Kolegji lë në fuqi, ndryshon ose rrëzon vendimin e Komisionit, duke dhënë vendim me shkrim të arsyetuar. Në rastet e ankimeve nga Komisioneri Publik, Kolegji nuk mund të vendosë një masë disiplinore më të rëndë, pa i dhënë subjektit të rivlerësimit kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur dhe për t'u dëgjuar në seancë.

8. Subjektet që rivlerësohen mund të ushtrojnë ankim në Gjykatën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Neni G
Dorëheqja

1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet.

2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

L I G J
Nr.9154, datë 6.11.2003

PËR ARKIVAT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
OBJEKTI DHE PËRKUFIZIME

Neni 1

Ky ligj përcakton rregullat bazë për organizimin e funksionimin e shërbimit arkivor në Shqipëri, institucionet që kryejnë këtë shërbim, si dhe detyrimet e tyre ligjore për krijimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e pasurisë arkivore, si pjesë e trashëgimisë kombëtare.

Neni 2

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Arkiva” janë institucionet shtetërore ose joshtetërore të specializuara, që mbledhin, përpunojnë, administrojnë, ruajnë dhe shërbejnë pasurinë arkivore, e cila mbrohet dhe sigurohet nga shteti. Arkiva janë edhe njësitë strukturore e nënstrukturore të institucioneve të administratës shtetërore qendrore e vendore, që evidencojnë, ruajnë, përpunojnë dhe vënë në shfrytëzim dokumentet e krijuara prej tyre.

2. “Arkiv” është çdo pasuri dokumentare që ruhet prej institucioneve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, si dhe çdo pasuri dokumentare e krijuar ose e ruajtur prej subjekteve joshtetërore, juridike e fizike private.

3. “Autoritet publik” janë organet përfaqësuese të pushtetit qendror dhe vendor; institucionet e administratës, qendrore dhe vendore të pushteteve kushtetuese; personat juridikë dhe fizikë, në masën që ata përmbushin funksione publike ose ushtrojnë një detyrë administrative, sipas ligjeve në fuqi.

4. “Dokumente me rëndësi historike kombëtare” janë të gjitha aktet që kanë vlerë ruajtjeje të përhershme dhe shpallen si të tilla nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, për shkak të rëndësisë juridiko-administrative, historike, shkencore dhe kulturore për trashëgiminë e popullit shqiptar.

5. “Dokumente” janë të gjitha aktet e krijuara nga autoritetet publike, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre në funksione administrative; aktet e krijuara nga institucionet joshtetërore, si dhe subjektet juridike e fizike private, kur vlerësohen me rëndësi historike kombëtare.

6. “Fondi arkivor kombëtar” është e gjithë pasuria dokumentare, shtetërore e joshtetërore, me vlerë ruajtjeje të përhershme ose të përkohshme, në administrim të arkivave shtetërorë a privatë.

7. “Kërkues” është personi që ka paraqitur një kërkesë me shkrim për shërbim arkivor, e cila i është miratuar, me përjashtim të vetë personelit të brendshëm të arkivave.

8. “Komunikim” është detyrimi ligjor i arkivave shtetërorë për të vënë në dispozicion dhe për t’u shërbyer institucioneve dhe individëve dokumentet që ato ruajnë dhe përmbushja e kësaj përgjegjësie ligjore.

9. “Rrjet arkivor” është tërësia e institucioneve në varësi të drejtpërdrejtë, si dhe e atyre që kanë varësi metodologjike-profesionale nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, përshkruar sipas nenit 9 të këtij ligji.

10. Shfrytëzim i arkivave” është mundësia e përdorimit të dokumenteve arkivore, në funksion të njohjes me veprimtarinë e administratës shtetërore dhe e drejta për shërbim me dokumente për qëllime studimore-shkencore ose për nevoja vetjake.

KREU II FONDI ARKIVOR KOMBËTAR

Neni 3

1. Fondi arkivor kombëtar është tërësia e dokumenteve të krijuara, të dërguara dhe të pranuar, gjatë veprimtarisë së institucioneve shtetërore ose joshtetërore, të personave juridikë e fizikë privatë, pavarësisht nga koha, vendi, pronësia, mënyra e krijimit dhe lloji i tyre, me vlerë historike kombëtare juridike, politike, ekonomike, sociale e kulturore.

2. Emërtimi i dokumenteve, që përbëjnë fondin arkivor kombëtar, shpallet nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe është i njësuar në të gjithë rrejtin arkivor të vendit.

Neni 4

Në fondin arkivor kombëtar bëjnë pjesë edhe dokumentet e krijuara nga institucionet e administratave shtetërore të huaja, që kanë vepruar në hapësirën historike shqiptare para shpalljes së Pavarësisë, si dhe dokumentet e organizatave, shoqërive dhe personaliteteve shqiptare, që e kanë ushtruar veprimtarinë e tyre jashtë shtetit.

Neni 5

1. Fondi arkivor kombëtar dhe arkivat mbrohen dhe sigurohen nga shteti, sipas kërkesave të këtij ligji.

2. Shteti shqiptar njih detyrimet për mbrojtjen e trashëgimisë dokumentare, që rrjedhin nga aktet juridike ndërkombëtare, ku ai është palë nënshkruese.

Neni 6

1. Dokumentet e subjekteve shtetërore e joshtetërore, si dhe të personave juridikë e fizikë privatë, që janë bërë pjesë e fondit arkivor kombëtar para hyrjes në fuqi të ligjit nr.7726, datë 29.6.1993 “Për fondin arkivor dhe për arkivat”, janë të pakthyeshme, pavarësisht nga mënyra e hyrjes në arkivat shtetërorë, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në marrëveshjen e pranimit.

2. Dokumentet që përbëjnë fondin arkivor kombëtar nuk dalin jashtë vendruajtjes së përhershme, përveç rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe. Në ato raste kur dokumenti del jashtë vendruajtjes, shoqërohet nga një punonjës i autorizuar i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Pas përfundimit të veprimeve procedurale të domosdoshme, dokumenti kthehet në vendruajtjen e përhershme dhe nëse është e nevojshme përdoret përsëri sipas së njëjtës procedurë.

Neni 7

1. Përcaktimi i vlerës dhe i afateve të ruajtjes së dokumenteve të arkivave në veprim të institucioneve shtetërore bëhet nga komisionet e ekspertizës, që funksionojnë pranë këtyre institucioneve. Vendimet e tyre miratohen nga komisionet e ekspertizës, që funksionojnë pranë arkivave respektivë të një shkalle më lart, të përshkruar sipas nenit 9 të këtij ligji.

2. Asgjësimi i dokumenteve, që e humbasin vlerën e ruajtjes, bëhet nga institucionet që i kanë ato në administrim, sipas rregullave të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Neni 8

Institucionet shtetërore ose joshtetërore, si dhe personat juridikë e fizikë privatë që kanë

dokumente të shpallura me rëndësi historike kombëtare, janë të detyruara të dërgojnë të dhëna informuese për efekt regjistrimi në arkivat shtetërorë respektivë, të përshkruar në nenin 9 shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “d” të këtij ligji.

KREU III ORGANIZIMI I RRJETIT ARKIVOR

Neni 9

1. Fondi arkivor kombëtar ruhet, përpunohet, administrohet dhe shërbehet nga rrjeti arkivor i Republikës së Shqipërisë.
2. Rrjeti arkivor i Republikës së Shqipërisë përbëhet nga:
 - a) Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave;
 - b) Arkivi Qendror Shtetëror;
 - c) arkivat shtetërorë që ruajnë dokumente të së njëjtës tipologji (Arkivi Qendror i Filmit, Arkivi Qendror Teknik);
 - ç) arkivat shtetërorë të sistemit, që funksionojnë në mënyrë të përhershme pranë institucioneve qendrore fondkrijuese;
 - d) arkivat shtetërorë vendorë;
 - dh) arkivat në veprim të institucioneve shtetërore, qendrore dhe vendorë;
 - e) arkivat privatë.
3. Krijimi i arkivave të rinj shtetërorë, sipas pikës 2 shkronjat “c” dhe “ç” të këtij neni, bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 10

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave është organi më i lartë i rrjetit arkivor kombëtar. Ajo është institucion qendror në varësi të Kryeministrit.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave është person juridik. Ajo ka vulën dhe stemën e vet. Selia e saj ndodhet në Tiranë.
3. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave përfaqësohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili emërohet dhe lirohet nga detyra prej Kryeministrit.

Neni 11

1. Drejtori i Përgjithshëm është titullari i institucionit. Ai kryen këto detyra:
 - a) përgjigjet përpara Këshillit të Ministrave për veprimtarinë e institucionit;
 - b) miraton rregullore, urdhra dhe udhëzime të detyrueshme për zbatim, në mbështetje të legjislacionit arkivor;
 - c) miraton planet vjetore të drejtorive që funksionojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme dhe ato të drejtorive të arkivave shtetërorë vendorë;
 - ç) përfaqëson arkivat shtetërorë të vendit në organizmat dhe institucionet ndërkombëtare ku ato janë anëtarësuar dhe ushtron të drejtën e votës në emër të tyre.
2. Drejtori i Përgjithshëm kryen detyra të tjera të parashikuara nga Rregullorja e Organizimit dhe Funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.

Neni 12

1. Nëpunësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, drejtuesit, specialistët dhe arkivistët, gëzojnë statusin e nëpunësit civil, ndërsa për punonjësit e tjerë zbatohet legjislacioni i Kodit të Punës.
2. Rekrutimi i punonjësve, mënyra e pranimit, lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe largimit bëhet sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.
3. Punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, të cilët, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë në vende pune që konsiderohen pjesë e shërbimit civil, janë nëpunës në periudhë prove për 1 vit.

Neni 13

1. Në varësi të drejtpërdrejtë administrative të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave janë Arkivi Qendror Shtetëror dhe arkivat shtetërorë vendorë.

2. Arkivat e tjerë, që bëjnë pjesë në rrjetin arkivor kombëtar, të përshkruar në nenin 9 shkronjat “c”, “ç”, “dh” dhe “e”, kanë varësi metodologjike-profesionale nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Neni 14

1. Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave funksionojnë: Këshilli i Lartë i Arkivave, Komisioni Qendror i Ekspertizës, Komisioni i Deklasifikimit dhe i Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” dhe Komisioni i Përhershëm i Ekspertëve të Vlerësimit të Dokumenteve me Rëndësi Historike Kombëtare.

2. Këshilli i Lartë i Arkivave harton dhe miraton politikat arkivore dhe strategjinë e zhvillimit të shërbimit arkivor.

3. Komisioni Qendror i Ekspertizës shqyrton dhe miraton listat e dokumenteve për asgjësim, sipas vendimit të propozuar prej komisioneve të ekspertizës, që funksionojnë pranë institucioneve shtetërore, të cilat i dorëzojnë dokumentet e tyre në Arkivin Qendror Shtetëror.

4. Komisioni i Deklasifikimit e i Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” bën deklasifikimin e dokumenteve, që kanë hyrë të klasifikuara në Arkivin Qendror Shtetëror dhe në arkivat shtetërorë vendorë, para hyrjes në fuqi të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””.

5. Statusi, rregullat, përbërja dhe shpërblimi i anëtarëve të Këshillit të Lartë të Arkivave, të Komisionit Qendror të Ekspertizës, të Komisionit të Deklasifikimit e të Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” dhe të Komisionit të Përhershëm të Ekspertëve për Vlerësimin e Dokumenteve me Rëndësi Historike Kombëtare, miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 15

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave harton normën tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor dhe organizon, drejton e kontrollon zbatimin e njësuar të saj në veprimtarinë e të gjithë rrjetit arkivor të vendit.

2. Për krijimin e normës tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave mbështetet në legjislacionin e vendit dhe në aktet e marrëveshjet themelore ndërkombëtare, të pranuar në rang ndërkombëtar, në këtë ligj dhe në Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

3. Rregullat e miratuara prej kësaj drejtorie, në mbështetje dhe në zbatim të këtij ligji, janë të detyrueshme për zbatim në të gjithë rrjetin arkivor të vendit.

Neni 16

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ushtron të drejtën e përfaqësimit dhe të votës, në emër të shtetit shqiptar, në organizatat ndërkombëtare ku është anëtare.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave nënshkruan marrëveshje dy ose shumëpalëshe me institucionet respektive të vendeve të tjera për pasurimin e fondit arkivor kombëtar, për publikimin, shkëmbimin e përvojave, përgatitjen dhe kualifikimin e specialistëve.

Neni 17

Arkivi Qendror Shtetëror ruan, përpunon, administron dhe shërben:

a) dokumentet që janë trashëguar nga shteti shqiptar nga periudha parashtetërore;

b) dokumentet që janë krijuar nga institucionet qendrore e vendore të administratës shtetërore deri në vitin 1944;

c) dokumentet e institucioneve qendrore të administratës shtetërore dhe të organeve udhëheqëse partiake, të krijuara deri në vitin 1991;

ç) dokumentet e institucioneve qendrore të administratës shtetërore pa kufizim kohor, me përjashtim të atyre që ruhen në arkivat e sistemit ose në arkivat që ruajnë akte të së njëjtës tipologji;

d) dokumentet që janë krijuar prej institucioneve të tjera shtetërore joqendrore pas vitit 1944, por janë të vetme në llojin e tyre;

dh) dokumentet që janë krijuar prej subjekteve e personave juridikë dhe fizikë privatë, të kaluara në pronësi të shtetit para hyrjes në fuqi të ligjit nr.7726, datë 29.6.1993 “Për fondin arkivor kombëtar dhe për arkivat”.

Neni 18

Arkivi Qendror Shtetëror ruan, administron dhe shërben trashëgiminë dokumentare joadministrative, të krijuar në hapësirën shqiptare gjatë shekujve, pavarësisht nga fondkrijuesi, gjuha, alfabeti, përmbajtja apo tipologjia e shkrimit.

Neni 19

1. Arkivat shtetërorë, që ruajnë dokumente të së njëjtës tipologji janë Arkivi Qendror i Filmit dhe Arkivi Qendror Teknik.

2. Këta arkiva kontrollojnë zbatimin e këtij ligji dhe japin ndihmë metodologjike e profesionale në arkivat vendorë, ku ruhen dokumentet e së njëjtës tipologji.

Neni 20

1. Arkivat shtetërorë të sistemit funksionojnë pranë këtyre institucioneve: Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Rendit Publik, Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Shërbimit Informativ Shtetëror.

2. Institucioni i Kuvendit të Shqipërisë dhe ai i Presidentit i administrojnë dokumentet respektive në arkiva që funksionojnë në mënyrë të përhershme pranë tyre.

3. Arkivat shtetërorë të sistemit funksionojnë pranë institucioneve shtetërore, të cilat, sipas Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, janë institucione të pavarura.

4. Arkivi shtetëror i sistemit të drejtësisë (gjykatat e prokuroritë) krijohet dhe funksionon pranë Ministrisë së Drejtësisë.

5. Arkivat e sistemit funksionojnë sipas kërkesave të këtij ligji.

Neni 21

1. Arkivat shtetërorë të sistemit administrojnë dhe ruajnë dokumentet e trashëguara, si dhe dokumentet e krijuara gjatë veprimtarisë së institucioneve që, sipas ligjit, e dorëzojnë pasurinë arkivore pranë tyre. Ata kontrollojnë zbatimin e ligjit dhe japin ndihmë metodike në arkivat e institucioneve shtetërore të varësisë së tyre.

2. Arkivat shtetërorë të sistemit janë në varësi administrative të drejtpërdrejtë të drejtuesit të institucionit.

Neni 22

1. Arkivat shtetërorë vendorë administrojnë dhe ruajnë dokumentet e trashëguara, si dhe dokumentet e arkivave të institucioneve shtetërore vendore dhe të organeve të qeverisjes vendore, që veprojnë brenda njësisë administrativo-territoriale përkatëse. Ata kontrollojnë dhe japin ndihmë metodike në arkivat e pushtetit vendor dhe të institucioneve shtetërore vendore, që veprojnë në njësinë administrativo-territoriale përkatëse.

2. Arkivat shtetërorë vendorë janë të detyruar të regjistrojnë çdo pasuri dokumentare joadministrative, që ekziston në territorin e njësisë së tyre administrativo-territoriale.

3. Këto pasuri i bëhen të ditura menjëherë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe ruhen

në Arkivin Qendror Shtetëror.

Neni 23

1. Arkivat e institucioneve shtetërore qendrore dhe vendore janë pjesë organike e tyre dhe varen drejtpërdrejt nga drejtuesi i institucionit.

2. Në varësi të vëllimit të dokumenteve që krijohen, pranë çdo institucioni shtetëror funksionojnë: sekretaria dhe arkivi, sekretari-arkivi ose punonjësi i ngarkuar me shërbimin në sekretari-arkiv.

Neni 24

Arkivat e institucioneve shtetërore qendrore dhe vendore kanë detyrë:

- a) të evidentojnë korrespondencën që dërgohet ose merret nga institucioni;
- b) të bëjnë përpunimin arkivor, të ruajnë dhe të shërbejnë dokumentet që administrojnë;
- c) të dorëzojnë dokumentet në arkivat shtetërorë, sipas afateve ligjore përkatësisht sipas përshkrimit në nenin 9 shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “d” të këtij ligji.

KREU IV ARKIVAT PRIVATË

Neni 25

1. Arkivat privatë e ushtrojnë veprimtarinë e tyre pasi licencohen nga Këshilli i Lartë i Arkivave me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Kriteret për licencim përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

2. Pasuritë, që administrohen në arkivat privatë, gëzojnë të njëjtën mbrojtje nga shteti si ato të arkivave publikë.

Neni 26

1. Pasuri të arkivave privatë, për arsye historike ose me interes publik, mund të shpallen dokumentet me rëndësi historike kombëtare. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, si dhe arkivi privat kanë të drejtën e nismës, ndërsa të drejtën e vendimit të shpalljes e ka Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

2. Shpallja “dokumente me rëndësi historike kombëtare” e pasurive dokumentare, që ruhen në arkivat privatë, nuk cenon, kufizon ose ndryshon marrëdhënien e pronësisë.

3. Përfaqësuesi i arkivit privat ka të drejtë të kërkojë ndryshimin e përcaktimit të dokumenteve në pronësi të tij, të shpallura me rëndësi historike kombëtare. Vendimi për ndryshimin e statusit të dokumenteve të shpallura me rëndësi historike kombëtare merret në të njëjtën formë, me të njëjtën procedurë dhe nga të njëjtat autoritete, si në rastin e shpalljes së tyre si të tilla.

Neni 27

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, kur nis procedurën për shpalljen e dokumenteve në pronësi të arkivave privatë, si dokumente me rëndësi historike kombëtare, njofton menjëherë pronarët ose përfaqësuesit e këtyre të fundit.

2. Efektet ligjore të vendimit hyjnë në fuqi një ditë pas shpalljes.

Neni 28

1. Dokumentet e arkivave privatë, që shpallen me rëndësi historike kombëtare nuk kanë afat të parashkrueshëm. Shpallja e tyre si të tilla nuk është pengesë për transferimin e të drejtës së pronësisë dhe të të drejtave të tjera mbi këto dokumente.

2. Arkivat privatë, që kanë në pronësi dokumente të shpallura me rëndësi historike kombëtare, në rastin e ndryshimit të pronësisë, janë të detyruara t'i bëjnë të njohur paraprakisht blerësit statusin e dokumenteve të tyre.

Neni 29

1. Asgjësimi i dokumenteve të shpallura me rëndësi historike kombëtare, në pronësi të arkivave privatë, është i ndaluar.

2. Asgjësimi i dokumenteve që e kanë plotësuar afatin ligjor të ruajtjes, pronë e arkivave privatë, bëhet me të njëjtat procedura si për arkivat shtetërorë. Ligjshmëria e vendimit për asgjësim miratohet zyrtarisht dhe me shkrim nga autoritetet e arkivave shtetërore përkatës.

Neni 30

Dokumentet e shpallura me rëndësi historike kombëtare, në pronësi të arkivave privatë, nuk mund të shiten dhe të dhurohen jashtë vendit.

Neni 31

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në cilësinë e përfaqësuesit të shtetit shqiptar, gëzon të drejtën e parablerjes së dokumenteve të shpallura me rëndësi historike kombëtare, që ndodhen në pronësi të subjekteve private.

2. Kur subjektet private dëshirojnë të shesin dokumente të shpallura me rëndësi historike kombëtare, ato duhet të paraqesin pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave përshkrimin e tyre, në përputhje me normën e njësuar në fuqi. Subjekti privat që ka në pronësi dokumente të tilla është i detyruar të paraqesë me shkrim të dhënat e kërkuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, pas këshillimit të të dhënave përshkrimore, të vlerësuara nga Komisioni i Përhershëm i Ekspertëve, vendos për dhënien ose jo të lejes për shitjen, si dhe për kushtet e tregtimit të këtyre dokumenteve. Në çdo rast Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave është e detyruar t'i kthejë përgjigje pronarit të dokumenteve brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të të dhënave përshkrimore për to. Kundër vendimit të dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, personi ka të drejtën e ankimit në gjykatë, sipas Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 32

Shteti liron nga detyrimet vjetore fiskale pronarët e arkivave privatë, që u dhurojnë arkivave shtetërore dokumente të shpallura me rëndësi historike kombëtare, në përputhje me ligjin nr.7892, datë 12.12.1994 "Për sponsorizimet".

Neni 33

Arkivat privatë, që administrojnë dokumente të shpallura me rëndësi historike kombëtare janë të detyruar të bëjnë regjistrimin e tyre në evidencën e arkivave shtetërore, qendrorë ose vendorë dhe në përputhje me legjislacionin për trashëgiminë kulturore. Regjistrimi i tyre bëhet jo më vonë se një vit nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Me mbarimin e këtij afati, çdo tjetërsim ose shitblerje e dokumenteve me rëndësi historike kombëtare në pronësi të tyre është i paligjshëm.

Neni 34

1. Pronarët e arkivave privatë, që u dhurojnë ose u shesin arkivave shtetërore dokumente me

rëndësi historike kombëtare, gëzojnë të drejtën e pronësisë intelektuale, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Këto të drejta i gëzon çdo subjekt privat për dokumentet e krijuara jashtë funksioneve shtetërore.

Neni 35

1. Kur subjektet shtetërore privatizohen, dokumentet e tyre mbeten pronë e shtetit. Institucionet e administratës shtetërore, që bëjnë privatizimin, janë të detyruara të dorëzojnë paraprakisht në arkivat shtetërorë përkatës, qendrorë ose vendorë, arkivat e subjekteve shtetërore që privatizohen.

2. Autoritetet e arkivave shtetërorë vendosin për dhënien e pjeshme ose të plotë të kopjeve të dokumenteve, që lidhen me teknikën dhe teknologjinë e prodhimit, pronarit të ri joshtetëror, me kërkesën e këtij të fundit. Shpenzimet e riprodhimit të dokumenteve janë të palës kërkuese.

KREU V ARKIVAT E NUMERIZUAR

Neni 36

1. Dokumentet e numerizuara, pavarësisht nga forma e regjistrimit dhe e qarkullimit, kanë vlerë administrative e juridike vetëm nëse janë hartuar e janë ruajtur sipas standardeve të miratuara.

2. Përshkrimi ligjor i dokumentit të numerizuar bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe institucionet shtetërore të shërbimit informatik. Ato përgatisin rregulla të detyrueshme për hartimin, evidencimin, qarkullimin, përpunimin tekniko-shkencor, ekspertizën e vlerës së ruajtjes e asgjësimit, si dhe për ruajtjen, dublikimin, riprodhimin dhe legalizimin e dokumenteve të numerizuara. Këto rregulla miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 37

Dokumentet e numerizuara janë të vlefshme si pasuri arkivore nëse janë regjistruar në formë të pandryshueshme që në aktin e krijimit.

Neni 38

Kalimi i dokumentit që është krijuar në bartës material (letër, pergamenë) në dokument, në formë të numerizuar, bëhet duke ruajtur njëshmërinë me origjinalin.

Neni 39

Dokumentet e numerizuara ruhen pranë arkivave të institucioneve shtetërore, qendrore dhe vendore. Në mbarim të afatit ligjor të ruajtjes pranë tyre, ato dorëzohen në arkivat shtetërorë respektivë, sipas përshkrimit në nenin 9 të këtij ligji.

Neni 40

Institucionet fondkrijuese të dokumenteve të numerizuara dorëzojnë pranë arkivave përkatës, në të njëjtët bartës që kanë regjistruar dokumentet, edhe mjetet e informimit dhe të kërkimit arkivor.

Neni 41

1. Arkivat e numerizuar janë pjesë e rrjetit arkivor kombëtar. Arkivat e numerizuar i nënshtrohen së njëjtës disiplinë ligjore për ruajtjen, komunikimin dhe shërbimin.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ka të drejtën e përcaktimit të programeve të

numerizimit të dokumenteve në institucionet fondkrijuese.

KREU VI DORËZIMI I DOKUMENTEVE NË ARKIVAT SHETËTORË

Neni 42

1. Dokumentet arkivore, me mbarimin e afatit të shërbimit operativ pranë arkivave të institucioneve fondkrijuese, dorëzohen nga këta të fundit për ruajtje dhe administrim në arkivat shtetërorë, në përputhje me nenin 9 shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “d” të këtij ligji, të sistemuara dhe të inventarizuara, sipas rregullave të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Bashkë me dokumentet dorëzohen:

- a) dy kopje të inventarit;
- b) një kopje inventari në regjistrim të numerizuar, që përputhet me programin e informatizimit të arkivit, ku dorëzohen dokumentet.

Neni 43

Dorëzimi i dokumenteve të institucioneve shtetërore në arkivat përkatës, përshkruar sipas nenit 9 shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “d” të këtij ligji, bëhet sipas këtyre afateve normative:

- a) dokumentet administrative dorëzohen pasi të kenë kaluar 10 vjet nga data e krijimit të tyre. Ky afat është i detyrueshëm edhe për dokumentet në figurë, në zë e në lëvizje, që përbëjnë dokumente administrative;
- b) dokumentet tekniko-shkencore dorëzohen pas mbarimit të nevojave për shërbim operativ, por jo më vonë se 25 vjet nga viti i krijimit të tyre;
- c) dokumentet në figurë, në zë e në lëvizje dorëzohen pasi të kenë kaluar 15 vjet nga data e krijimit të tyre;
- ç) regjistrat e akteve të gjendjes civile dorëzohen pasi të kenë kaluar 75 vjet nga data e krijimit të tyre;
- d) dokumentet e klasifikuara “sekret shtetëror” dorëzohen pas deklasifikimit të tyre. Deklasifikimi bëhet nga autoriteti klasifikues.

Neni 44

Dokumentet e institucioneve qendrore e vendore të administratës shtetërore dorëzohen në rrjetin shtetëror të arkivave drejtpërdrejt nga institucioni që i ka krijuar.

Neni 45

1. Arkivat e institucioneve qendrore e vendore të administratës shtetërore, që e mbyllin veprimtarinë e tyre për çfarëdo lloj shkak, dorëzohen menjëherë pranë arkivave përkatës, sipas nenit 9 shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “d” të këtij ligji.

2. Kur funksionet ose atributet e një institucioni shtetëror barten ligjërisht te një institucion tjetër, ky i fundit mund të administrojë dokumentet e trashëguara deri në mbushjen e afateve të parashikuara në nenin 43 të këtij ligji.

Neni 46

1. Institucionet arkivore shtetërore të përshkruara në nenin 9 shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “d” të këtij ligji kanë të drejtë të tërheqin para afatit normativ dokumentet e krijuara prej institucioneve të administratës shtetërore qendrore e vendore, në rast rreziku të dukshëm dëmtimi a zhdukjeje fizike.

2. Në këtë rast, si dhe kur veprimtaria e një institucioni shuhet, shpenzimet për përpunimin arkivor të dokumenteve përballohen nga institucioni fondkrijues, kur ky ekziston, ose nga institucioni i

burimit të varësisë.

Neni 47

Dokumentet e subjekteve joshtetërore, të personave juridikë e fizikë privatë, si dhe ato të personaliteteve shkencore, politike, kulturore, të krijuara jashtë përgjegjësive të tyre shtetërore, të shpallura me interes historik kombëtar, dorëzohen në arkivat shtetërore me vullnetin e tyre ose të trashëgimtarëve, me marrëveshje.

Neni 48

Arkivat e përshkruar në nenin 9 shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d” dhe “dh” të këtij ligji janë të vetmet institucione shtetërore që kanë të drejtën e blerjes dhe të administrimit të trashëgimisë dokumentare dhe të dorëshkrimeve.

Neni 49

1. Studiuesit dhe punonjësit shkencorë, që bëjnë kërkime për projekte të institucioneve arkivore, kërkimore-shkencore shtetërore në arkiva të vendeve të tjera dhe marrin prej tyre dokumente, janë të detyruar t'i dorëzojnë ato në arkivin e institucionit ku punojnë, si dhe të dërgojnë në arkivat shtetërore përkatës një relacion me përshkrime të hollësishme për sasinë dhe përmbajtjen e tyre.

2. Në këto raste, studiuesit dhe punonjësit shkencorë kanë të drejtën e një kopjeje falas të dokumenteve. Kopja u ofrohet nga arkivi pranues.

Neni 50

Institucionet joshtetërore, personat juridikë e fizikë privatë që dhurojnë, lënë në trashëgim a për ruajtje ose u shesin dokumente arkivave shtetërore, gëzojnë të drejtën për të marrë, sipas marrëveshjes, riprodhime falas të tyre.

Neni 51

Në rast të ndryshimeve në organizimin administrativo-territorial, të riorganizimit të veprimtarisë së organeve shtetërore, njoftohet Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ose arkivat shtetërore, të përshkruar në nenin 9 shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d” dhe “dh” të këtij ligji, për të vendosur për administrimin e mëtejshëm të dokumenteve.

Neni 52

Dokumentet e shpallura me rëndësi historike kombëtare në pronësi a zotërim të subjekteve joshtetërore dhe personave juridikë e fizikë privatë, kur këto e shuajnë veprimtarinë e tyre ose nuk kanë trashëgimtarë të njohur me ligj, depozitohen në arkivat shtetërore.

KREU VII KOMUNIKIMI DHE SHFRYTËZIMI I DOKUMENTEVE TË FONDIT ARKIVOR KOMBËTAR

Neni 53

1. Shërbimi arkivor garanton të drejtën për t'u njohur me dokumentet që dëshmojnë veprimtarinë e administratës shtetërore.

2. Personi dhe institucionet janë të barabartë në të drejtën për shërbim arkivor.

3. Fondkrijuesit gëzojnë të drejtën e shfrytëzimit të dokumenteve në çdo kohë, pavarësisht nga afatet e përcaktuara në nenin 61 të këtij ligji.

4. Fondkrijuesit joshtetërore kanë të drejtën e kufizimit të shërbimit me dokumentet e tyre në afate të ndryshme nga ato të përcaktuara në nenin 61 të këtij ligji.

Neni 54

1. Shërbimi arkivor ofrohet pa autorizim.
2. Shfrytëzimi i arkivave shtetërorë e privatë u ofrohet kërkuesve, pavarësisht nga kombësia, shtetësia, statusi ose funksioni i tyre.
3. Autoriteti arkivor shtetëror, kur është e nevojshme, ofron vetëshërbim.

Neni 55

Kërkuesi i një dokumenti nuk është i detyruar të paraqesë arsye për t'u lejuar që ta shfrytëzojë atë.

Neni 56

Kërkesa për shfrytëzim dokumentesh mund të mos pranohet nëse shërbimi për to është i kufizuar me ligj.

Neni 57

Nëse një arkiv nuk e ka dokumentin e kërkuar, kur është e mundshme, i tregon kërkuesit se në cilin arkiv ose autoritet publik ndodhet.

Neni 58

Punonjësit e rrjetit arkivor kombëtar shërbejnë dokumentet besnikërisht me origjinalin, pa komente ose interpretime.

Neni 59

Mjetet e informacionit dhe të kërkimit arkivor janë të hapura. Shërbimi i tyre nuk mund t'i kufizohet askujt.

Neni 60

Shfrytëzimi i dokumenteve të fondit arkivor kombëtar bëhet sipas kërkesave të këtij ligji, nëpërmjet:

- a) shërbimit të dokumenteve ose riprodhimeve të tyre (mikrofilma, fotokopje) për studim në sallat e leximit të arkivave;
- b) botimit të udhërrëfyesve, katalogëve, inventarëve, si dhe përmbledhjeve me dokumente;
- c) përgatitjes dhe hapjes së ekspozitave dokumentare. Ekspozimi i dokumenteve origjinale lejohet vetëm kur sigurohet ruajtja fizike dhe teknologjike, sipas rregullave në fuqi;
- ç) publikimit në organet e shtypit, radios, medias, multimedias dhe kinematografisë;
- d) dhënies së burimeve institucioneve shtetërore e joshtetërore për problemet që u interesojnë;
- dh) të gjitha formave të promovimit të vlerave kulturore që ruhen në arkiva;
- e) shërbimit të numerizuar në distancë.

Neni 61

1. Dokumentet e publikuara një herë janë lirisht të shfrytëzueshme.
2. Dokumentet që administrohen në institucionet arkivore shtetërore, jepen për shfrytëzim pasi kanë kaluar 25 vjet nga data e krijimit.

Neni 62

Dokumentet që përmbajnë të dhëna të rëndësishme për sigurimin e interesave të lartë të shtetit, që janë pranuar në arkivat shtetërorë para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe nuk janë deklasifikuar ende, jepen për shfrytëzim, sipas kërkesave të ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””.

Neni 63

Arkivat mbrojnë jetën intime të personit. Ndalohet njohja, shfrytëzimi dhe publikimi i dokumenteve që përmbajnë të dhëna me karakter vetjak dhe cenojnë jetën private të personit. Dokumentet që përmbajnë të dhëna me karakter vetjak dhe cenojnë jetën intime të personit, shërbehen vetëm pasi kanë kaluar, sipas rastit, 50 deri në 150 vjet nga data e krijimit të tyre.

Neni 64

Dokumentet e pronësisë u shërbehen trashëgimtarëve të pronës, përfaqësuesve të tyre ligjorë dhe institucioneve shtetërore, që kanë kompetenca vendimmarrëse të njohura me ligj për trashëgimin e pronave.

Neni 65

1. Institucionet publike në veprim, që kanë autoritet klasifikues për arkivat e tyre dhe institucionet arkivore, që kanë trashëguar informacion të klasifikuar, mund të kufizojnë pjesërisht shfrytëzimin e dokumenteve arkivore, në përputhje me ligjin nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””.

2. Kufizime mund të zbatohen edhe në funksion:

- a) të mbrojtjes së sigurisë kombëtare dhe të normalitetit në marrëdhëniet me jashtë;
- b) të interesave të sigurimit publik;
- c) të fshehtësisë për hetimin dhe ndjekjen e veprimtarive kriminale;
- ç) të respektimit të interesave tregtarë dhe të barazisë në konkurrencë;
- d) të moscenimit të barazisë së palëve në një konflikt;
- dh) të mbrojtjes së ekosistemeve natyrore;
- e) të sigurisë së misioneve mbikëqyrëse, si dhe të kushteve për inspektim dhe kontroll nga administrata;
- ë) të mosdëmtimit të politikës financiare, monetare dhe tatimore të shtetit;
- f) të respektimit të mirëbesimit në vendimmarrje brenda ose ndërmjet autoriteteve publike, për përgatitjen e një dosjeje;
- g) të interesave të tjerë të individit, që vlerësohen të ligjshëm nga institucionet e specializuara.

Neni 66

Shfrytëzimi i dokumenteve arkivore mund të lejohet edhe për rastet e parashikuara në nenin 65, nëse një interes publik më i lartë e përlij hapjen.

Neni 67

1. Leje për shfrytëzim të parakohshëm të dokumenteve, që u kufizohet shërbimi në nenet 61, 62 dhe 63 të këtij ligji, jepen përkatësisht:

- a) nga fondkrijuesi;
 - b) nga autoriteti klasifikues, për dokumentet e klasifikuara “sekret shtetëror”;
 - c) nga vetë personi, për dokumentet që përmbajnë të dhëna intime dhe që kanë të bëjnë me dinjitetin personal të tij.
2. Të drejtën e përjashtimit e kanë, gjithashtu:
- a) Drejtori i Përgjithshëm i Arkivave, për dokumentet që ndodhen në Arkivin Qendror

Shtetëror dhe në arkivat shtetërorë të qarqeve, pas marrjes së pëlqimit me shkrim të fondkrijuesit, kur ai ekziston;

b) drejtuesi i institucionit, për dokumentet që ruhen në arkivat e sistemit ose në arkivat që administrojnë dokumente të së njëjtës tipologji;

c) çdo subjekt i autorizuar me ligj.

Neni 68

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, rrjeti arkivor në varësi të saj dhe çdo njësi e shërbimit arkivor pranë institucioneve të administratës shtetërore, qendrore e vendore, nuk kanë autoritet klasifikues mbi dokumentet që ruajnë e administrojnë.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave bën deklasifikimin e dokumenteve të klasifikuara “sekret shtetëror”, që ka trashëguar, sipas përgjegjësisë që i njeht ligji nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 69

Mjetet e informimit dhe të kërkimit arkivor bëjnë të ditur tërësinë e fondeve të dokumenteve të arkivave. Ato njoftojnë edhe për ekzistencën e dokumenteve të klasifikuara “sekret shtetëror”, por pa deklaruar përmbajtjen e të dhënave të mbrojtura nga ligji.

Neni 70

1. Kur shfrytëzimi i një dokumenti arkivor është miratuar, shërbimi arkivor autorizon këshillimin e tij në njërën nga format e ruajtjes (mikrofilm, riprodhim dhe origjinal) ose dhënien e kopjeve të certifikuara të tij. Shërbimi arkivor mban parasysh, brenda mundësive, zgjedhjen e kërkuesit për shërbim.

2. Fotokopje ose riprodhime në forma të tjera jepen për të ilustruar botimet, për përgatitje ekspozitash, si dhe për shërbime të tjera të ligjshme.

Neni 71

1. Kërkuesi ka të drejtë të njihet me një arsye ligjore për mospranimin e shërbimit, duke përfshirë rastin e dokumentacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”.

2. Kërkuesi ka të drejtë të kërkojë autorizim nga autoriteti klasifikues për t’u njohur me informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”.

3. Autoriteti klasifikues mund të lejojë njohjen e pjesshme, si rrjedhim, fshehjen e pjesshme të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”. Kërkuesi vihet në dijeni për këtë.

Neni 72

Kërkuesi, të cilit nuk i pranohet shërbimi për dokumente të klasifikuara “sekret shtetëror”, ka të drejtën e ankimit në gjykatë ose përpara çdo organi tjetër të paanshëm të parashikuar me ligj.

Neni 73

Shërbimi arkivor nuk është i detyruar të japë për shfrytëzim një dokument të botuar ose që është lehtësisht i shfrytëzueshëm në burime të tjera.

Neni 74

1. Shërbimi arkivor dhe autoritetet publike krijuese të dokumenteve janë të detyruara:

a) të vënë në dijeni publikun për të drejtën për të shfrytëzuar dokumentet arkivore dhe për mënyrën e realizimit të kësaj të drejte;

b) të sigurojnë ushtrimin e kësaj të drejte në dobi të interesave të shtetasve;

c) të kualifikojnë nëpunësit e tyre, për të kryer detyrat dhe detyrimet për zbatimin e kësaj të drejte.

2. Shërbimi arkivor dhe autoritetet publike kanë për detyrë:

a) të bëjnë përpunimin tekniko-shkencor të dokumenteve të tyre, duke i bërë lehtësisht të shfrytëzueshme;

b) të zbatojnë procedura të qarta për asgjësimin e dokumenteve pa vlerë ruajtjeje.

Neni 75

Autoritetet publike, me nismën e tyre, bëjnë të njohura burimet që kanë në dispozicion, në funksion të transparencës së veprimtarisë të administratës shtetërore, në shërbim të nxitjes së pjesëmarrjes të publikut në çështje me interes për të dhe në funksion të forcimit të shtetit të së drejtës dhe të mirëqeverisjes.

Neni 76

Institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore bëjnë përpjekje të bashkërenduara, mutatis mutandis, për të lehtësuar kushtet e komunikimit të arkivave privatë me arkivat publikë.

Neni 77

1. Kërkesat e institucioneve shtetërore e joshtetërore, si dhe të personave juridikë e fizikë privatë, për studime joshkencore, të dhëna arkivore, kopje ose ekstrakte dokumentesh, që ruhen në arkivat shtetërorë, plotësohen kundrejt pagesës, sipas tarifave të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

2. Shërbimi me fotokopje, për dokumente në funksion të studimeve shkencore universitare-akademike, bëhet me tarifë të diferencuar favorizuese.

Neni 78

1. Sasia e dokumenteve të riprodhuara, që i shërbehen kërkuarit, në bazë të fletë-porosisë së tij, përcaktohet nga autoriteti arkivor shërbyes, në përputhje me objektin e kërkesës.

2. Kërkuarit që shtrembëron burimin në përdorimin publik të dokumentit, nuk i shërbehen riprodhime.

Neni 79

1. Kur subjektet joshtetërore, personat juridikë e fizikë privatë, pronarë ose zotërues a mbajtës të dokumenteve, nuk respektojnë detyrimet e parashikuara nga ky ligj, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave përcakton një afat kushtëzues, për të verifikuar zbatimin e dispozitave ligjore. Nëse detyrimet nuk plotësohen brenda afatit kushtëzues, dokumentet e tyre merren për ruajtje nga arkivat shtetërorë.

2. Në rast se shërbimi arkivor kombëtar vlerëson se ekziston rreziku i dëmtimit të menjëhershëm, që mund të sjellë zhdukje të dokumenteve, ato merren në administrim pa lënë afat kushtëzues.

3. Në të dyja rastet ruhet e drejta e pronësisë dhe e rikthimit të dokumenteve.

KREU VIII EKSPORTIMI DHE IMPORTIMI I DOKUMENTEVE

Neni 80

1. Dokumentet e fondit arkivor kombëtar, që ruhen në arkivat shtetërorë ose privatë paraqiten në mjedise ndërkombëtare, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për qëllime manifestimi, ekspozimi ose promovimi kulturor, si dhe për qëllime historike e shkencore, vetëm kur garantohet me

marrëveshje ruajtja e integritetit dhe siguria e tyre fizike, në udhëtim dhe në kohën e veprimtarisë.

2. Vlera e sigurimit përcaktohet me marrëveshje, sipas standardeve ndërkombëtare, nga autoritetet e parashikuara në nenet 82 dhe 83 të këtij ligji.

Neni 81

Dokumentet e fondit arkivor kombëtar, që pësojnë dëmtime gjatë transportit ose për shkak të mikromjedisit, ku do të vendosen gjatë ekspozimit, nuk lejohet të paraqiten në mjedise ndërkombëtare.

Neni 82

Leja për paraqitjen e dokumenteve të fondit arkivor kombëtar në mjedise ndërkombëtare jepet:

a) për dokumentet që ruhen në Arkivin Qendror Shtetëror dhe arkivat shtetërore vendorë, nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave;

b) për dokumentet që ruhen në arkivat shtetërore të sistemit dhe arkivat që ruajnë dokumente të së njëjtës tipologji, nga drejtuesit e institucioneve të varësisë përkatëse;

c) për dokumentet që ruhen nga arkivat privatë, nga Këshilli i Lartë i Arkivave.

Neni 83

Dokumentet e fondit arkivor kombëtar, që përbëjnë vlera unike të trashëgimisë kulturore kombëtare, të përcaktuara si të tilla nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, paraqiten jashtë shtetit me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 84

Autoritetet, që kanë të drejtë për dhënie leje për paraqitjen e dokumenteve të fondit arkivor kombëtar në mjedise ndërkombëtare, sipas neneve 82 dhe 83 të këtij ligji, janë të detyruara të përcaktojnë datën e saktë të rikthimit të tyre në vendruajtjen e përhershme. Koha e qëndrimit jashtë shtetit nuk mund të jetë më shumë se një vit nga data e daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë.

Neni 85

Në rastin e lejimit të daljes së përkohshme të dokumenteve të fondit arkivor kombëtar jashtë territorit shtetëror, institucioni miratues është i detyruar t'i shoqërojë ato me lejet përkatëse për autoritetet doganore, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 86

1. Importimi i dokumenteve për pasurimin e arkivave të Shqipërisë bëhet sipas marrëveshjeve të nënshkruara nga palët bashkëpunuese.

2. Pasuritë arkivore, që hyjnë në rrjetin arkivor të Republikës së Shqipërisë përmes importit, shoqërohen me certifikatën që përcakton identitetin dhe prejardhjen e tyre dhe me lejen e autoritetit dërgues.

Neni 87

Shteti shqiptar, sipas legjislacionit në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, ka detyrimin të interesohet e të kërkojë rikthimin në vend të dokumenteve të fondit arkivor kombëtar, që kanë dalë në mënyrë të paligjshme jashtë territorit shtetëror.

Neni 88

1. Kur në territorin e Republikës së Shqipërisë vihet re se ka dokumente të një shteti tjetër, të hyra në rrugë të paligjshme, këto kalojnë në ruajtje të përkohshme pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

2. Nëse brenda pesë vjetëve, pas publikimit të ekzistencës së këtyre dokumenteve, nuk paraqiten kërkesa për rikthimin e tyre në vendin e prejardhjes, ato kalojnë në pronësi të shtetit shqiptar.

KREU IX ARKIVISTI

Neni 89

Punonjësi i rrjetit arkivor kombëtar të Republikës së Shqipërisë respekton Kodin Deontologjik Ndërkombëtar të Arkivistëve.

Neni 90

Arkivistët e rrjetit arkivor shtetëror nuk mund të jenë anëtarë të partive politike. Përgjegjësia e tyre si ruajtës të trashëgimisë dhe të informacionit rrjedh nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe përcaktohet nga ligjet në fuqi.

Neni 91

Arkivistët janë të paanshëm në ofrimin e shërbimit për shfrytëzimin e dokumenteve dhe respektojnë kufizimin ligjor për mbrojtjen e të dhënave të jetës private të individit dhe të interesave të veçantë të shtetit, pavarësisht se mund të njihen me to për shkak të detyrës.

KREU X KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE DHE GJOBAT

Neni 92

1. Autoritetet dhe punonjësit e arkivave shtetërorë mbajnë përgjegjësi ligjore për shkeljen e kërkesave të këtij ligji. Në kuptim të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 1 deri në 5 paga mujore shkeljet e mëposhtme:

a) mungesa e kushteve të nevojshme të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për ruajtjen fizike e teknologjike të dokumenteve;

b) moszbatimi i kërkesave të këtij ligji dhe rregullave të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për evidencimin, sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve;

c) mosdorëzimi në afat dhe sipas kërkesave të këtij ligji i dokumenteve në arkivat shtetërorë;

ç) mosdhënia e të dhënave të nevojshme për regjistrimin dhe evidencimin e veprimtarisë arkivore e të dokumenteve të tyre arkivave shtetërorë, të përcaktuar me ligj;

d) pengimi i punonjësve të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për të kryer përgjegjësitë e tyre sipas këtij ligji.

2. Shkeljet që kanë të bëjnë me tjetërsimin e dokumenteve dhe humbjen e dokumenteve të arkivit nga persona që i kanë në administrim, kur ato nuk janë kopje e vetme, dënohen me gjobë nga 2 deri në 10 paga mujore.

3. Personat fizikë e juridikë privatë i nënshtrohen gjobës nga 100 mijë deri në 300 mijë lekë kur kanë kryer shkeljet e përmendura në shkronjat “a”, “ç”, “d” të pikës 1 dhe pikën 2 të këtij neni.

4. Gjoha vendoset nga punonjësi i autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

5. Për botimin e burimeve arkivore në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, mbajnë përgjegjësi edhe kërkuesit. Kërkuesi që shkel në mënyrë të përsëritur rregulloren e shfrytëzimit të dokumenteve arkivore, ose dëmton vetë dokumentet, mund të përjashtohet për një periudhë deri 1-vjeçare nga e drejta e shërbimit arkivor.

6. Kundër vendimit të dënimit me gjobë ose të përjashtimit, personat që kanë kryer shkeljet mund të bëjnë ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së vendimit.

7. Asgjësimi i dokumenteve, në kundërshtim me kërkesat e këtij ligji, vjedhja, si dhe humbja e dokumenteve të shpallura të një rëndësie të veçantë, kur shkelja përbën vepër penale, dënohet sipas Kodit Penal.

KREU XI DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 93

1. Masat për mbrojtjen e dokumenteve në kohë të veçantë rrjedhin nga ligji nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”.

2. Rregullat e zhvendosjes (evakuimit), të shmangies dhe të risistemimit të dokumenteve në kohë të veçantë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 94

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 9 pika 3, 14 pika 5, 15 pika 2, 25 pika 1, 36 pika 2, 83 dhe 93 pika 2 të këtij ligji.

Neni 95

Ligji nr.7726, datë 29.6.1993 “Për fondin arkivor kombëtar dhe për arkivat”, shfuqizohet.

Neni 96

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.4018, datë 2.12.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

LIGJ
Nr. 139/2015

PËR VETËQEVERISJEN VENDORE

Në mbështetje të neneve 13, 78, 81, pika 2, 83, pika 1, dhe 108 – 115 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i ligjit

Ky ligj rregullon organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre e të organeve përkatëse.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Administrimi” është e drejta për të planifikuar, financuar dhe organizuar ushtrimin e një funksioni.
2. “Autonomi vendore” është e drejta dhe aftësia e njësive të vetëqeverisjes vendore, të krijuara sipas Kushtetutës dhe këtij ligji dhe në kuadër të kufizimeve të tij, që të rregullojnë dhe të administrojnë një pjesë thelbësore të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të bashkësisë.
3. “Funksion” është fusha e veprimtarisë, për të cilën njësia e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse dhe ka kompetencën ligjore për ta ushtruar lirisht, tërësisht apo në një pjesë të tij, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore.
4. “Funksione të deleguara” janë ato funksione të qeverisë qendrore, ushtrimi i të cilave u delegohet njësive të vetëqeverisjes vendore.
5. “Kompetencë” është autoriteti i dhënë me ligj një organi të njësive të vetëqeverisjes vendore për kryerjen e një funksioni apo një pjese të tij.
6. “Konsultimi” është proces institucional këshillimi ndërmjet qeverisjes qendrore dhe vetëqeverisjes vendore, transparent dhe i drejtpërdrejtë, për informimin, këshillimin e shkëmbimin e opinionëve për politikën, legjislacionin e normat që rregullojnë vetëqeverisjen vendore, i cili zhvillohet rregullisht dhe në mënyrë të vazhdueshme, sipas procedurave dhe një strukture të përcaktuar.
7. “Ndërmarrje për shërbime publike” është çdo ndërmarrje e krijuar për të ofruar shërbim /shërbime publik/e që janë kompetencë e bashkisë, për të cilën kapitali, vota ose e drejta për të emëruar organet drejtuese dhe financimi kontrollohen nga bashkia.
8. “Qeverisje qendrore” është Këshilli i Ministrave, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore të shtetit.
9. “Rregullimi” është e drejta për të përcaktuar rregulla të përgjithshme dhe normative sjelljeje, si dhe standarde të detyrueshme në përputhje me ligjin.
10. “Riorganizim administrativo-territorial” është ndryshimi në ndarjen administrativo-territoriale

të njësive të vetëqeverisjes vendore.

11. “Subjekt i kompetencave të përbashkëta” është një komitet, ent, institucion, ndërmarrje ose bord, shoqëri tregtare ose person tjetër juridik, i krijuar nga dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore dhe/ose institucioneve qendrore, me qëllim kryerjen e një shërbimi ose përmbushjen e një detyrimi të përbashkët.

12. “Subsidiaritet” është parimi i kryerjes së funksioneve dhe ushtrimit të kompetencave në një nivel qeverisjeje sa më pranë komunitetit, duke pasur parasysh rëndësinë dhe natyrën e detyrës, si dhe kërkesat e efikasitetit dhe ekonomisë.

13. “Shërbime publike” janë ato shërbime me interes të përgjithshëm publik, të cilat ofrohen për komunitetin nga bashkitë, në mënyrë të vazhdueshme, me çmime të përballueshme, sipas standardeve minimale kombëtare, të përcaktuara me ligj apo me akte të tjera normative.

Neni 3

Misioni i vetëqeverisjes vendore

Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:

- a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë;
- b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;
- c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;
- ç) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;
- d) realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;
- dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithë-përfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;
- e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.

Neni 4

Parimet themelore të vetëqeverisjes vendore

1. Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore veprojnë në bazë të parimit të autonomisë vendore.
2. Në veprimtarinë e tyre organet e njësive të vetëqeverisjes vendore respektojnë dhe zbatojnë Kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore.
3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë persona juridikë publikë.
4. Çdo bashki dhe qark është njësi vetë-qeverisëse me vazhdimësi.

KREU II

NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE DHE ORGANET

Neni 5

Njësitë e vetëqeverisjes vendore

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë bashkitë dhe qarqet, të cilat realizojnë vetëqeverisjen vendore në Republikën e Shqipërisë.

2. Bashkia është njësi bazë e vetëqeverisjes vendore.

3. Bashkia përfaqëson një unitet administrativo-territorial dhe bashkësi banorësh. Bashkitë, shtrirja territoriale, emri dhe qyteti qendër i saj përcaktohen me ligj.

4. Qarku është njësi e nivelit të dytë të vetëqeverisjes vendore.

5. Qarku përfaqëson një unitet administrativo-territorial, të përbërë nga disa bashki me lidhje gjeografike, tradicionale, ekonomike, sociale dhe interesa të përbashkët. Kufijtë e qarkut përrputhen me kufijtë e bashkive që e përbëjnë atë. Qendra e qarkut vendoset në një nga bashkitë që përfshihen në të. Shtrirja territoriale, emri dhe qendra e qarkut përcaktohen me ligj.

Neni 6

Nënndarjet e bashkisë

1. Bashkia përbëhet nga disa njësi administrative, sipas lidhjeve tradicionale, historike, ekonomike dhe sociale. Njësitë administrative në territorin e një bashkie, shtrirja e tyre territoriale dhe emri përcaktohen me ligj.

2. Njësitë administrative përbëhen nga qytetet dhe/ose fshatrat. Shtrirja territoriale, emri i qyteteve dhe fshatrave, pjesë e çdo njësie administrative, përcaktohen me ligj. Shpallja e qyteteve të reja bëhet me ligj.

3. Qytetet mund të ndahen në njësi më të vogla që quhen lagje. Një lagje, si rregull, mund të krijohet vetëm në territore me mbi 20 mijë banorë. Ndarja e qyteteve në lagje dhe shtrirja e tyre territoriale miratohet me vendim të këshillit bashkiak.

Neni 7

Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore

1. Në çdo bashki dhe qark krijohet organi përfaqësues dhe organi ekzekutiv.

2. Organi përfaqësues i bashkisë është këshilli bashkiak. Organi ekzekutiv i bashkisë është kryetari i bashkisë.

3. Organ përfaqësues i qarkut është këshilli i qarkut. Funkcionet ekzekutive në qark kryhen nga kryetari dhe kryesia e këshillit të qarkut.

4. Organet përfaqësuese dhe ekzekutive të bashkisë zgjidhen në përrputhje me Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

5. Organi përfaqësues i qarkut krijohet me përfaqësues nga organet e zgjedhura të bashkive që e përbëjnë atë, sipas mënyrës së përcaktuar në Kushtetutë dhe në kreun XIII të këtij ligji. Kryetari dhe kryesia e këshillit të qarkut zgjidhen nga këshilli i qarkut, sipas mënyrës së përcaktuar në kreun XIII, të këtij ligji.

KREU III

TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E NJËSIVE

TË VETËQEVERISJES VENDORE

Neni 8

Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor

1. Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore mund të ndërmarrin nisma me interes publik vendor në territorin e juridiksionit të tyre për çdo çështje që nuk u ndalohet me ligj ose që nuk i është dhënë ekskluzivisht me ligj një organi tjetër shtetëror.

2. Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore ushtrojnë kompetencat e tyre nëpërmjet

vendimeve, urdhëresave dhe urdhrave.

Neni 9

Të drejtat dhe përgjegjësitë

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:

1.1. Të drejtën dhe përgjegjësinë e vetë-qeverisjes, sipas së cilës:

a) përcaktojnë masa që ato i gjykojnë të nevojshme për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave;

b) bazuar në Kushtetutë, në ligje dhe aktet nënligjore, të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre, për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave, nxjerrin urdhëresa, vendime dhe urdhra;

c) krijojnë struktura administrative për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të tyre, sipas ligjeve në fuqi;

ç) krijojnë njësi ekonomike dhe institucione në varësi të tyre.

d) krijojnë komitete, borde ose komisione për kryerjen e funksioneve të veçanta sa herë që paraqitet nevoja, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore.

1.2. Të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë:

a) njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë. Ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e paluajtshme ose të luajtshme të tyre, si dhe ushtrojnë të drejta të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;

b) e drejta e fitimit të pronës, nëpërmjet shpronësimeve për interes publik, nga ana e njërive të vetëqeverisjes vendore, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;

c) e drejta e pronësisë ushtrohet nga këshilli përkatës, i cili nuk mund t'ia delegojë ushtrimin e kësaj të drejte askujt tjetër.

1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës:

a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;

b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre;

ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.

1.4. Të drejtën dhe përgjegjësinë e kryerjes së veprimtarive ekonomike, sipas së cilës:

a) për përmbushjen e funksioneve publike në interes të komunitetit që përfaqësojnë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ushtrojnë veprimtari ekonomike që nuk bie ndesh me orientimet themelore të politikave ekonomike të shtetit;

b) të ardhurat, që përfitohen nga veprimtaria ekonomike, përdoren në pjesën më të madhe për mbështetjen dhe përmbushjen e funksioneve publike;

c) veprimtaria ekonomike e njërive të vetëqeverisjes vendore rregullohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

1.5. Të drejtën e bashkëpunimit, sipas së cilës:

a) për kryerjen e shërbimeve specifike në emër dhe në dobi të komuniteteve përkatëse, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore mund të ushtrojnë së bashku çdo funksion që u është dhënë atyre me ligj, nëpërmjet zbatimit të marrëveshjeve ose kontratave të përbashkëta, delegimit të kompetencave dhe përgjegjësisë të veçanta njëra-tjetrës ose kontraktimit me një palë të tretë;

- b) bashkëpunojnë me njësi të vetëqeverisjes vendore të vendeve të tjera dhe përfaqësohen në organizata ndërkombëtare të pushteteve vendore, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi;
- c) kanë të drejtë të organizohen në shoqata, në përputhje me legjislacionin përkatës.

1.6. Të drejtën e personit juridik:

Si persona juridikë, njësitë e vetëqeverisjes vendore gëzojnë dhe ushtrojnë të gjitha të drejtat e përcaktuara në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe në legjislacionin në fuqi dhe në mënyrë të veçantë:

- a) të drejtën e lidhjes së kontratës;
- b) të drejtën e krijimit të personave të tjerë juridikë;
- c) të drejtën e ngritjes së padisë civile;
- ç) të drejtën e mbajtjes së llogarive;
- d) të drejta të tjera për ushtrimin e funksioneve në bazë dhe në zbatim të ligjeve dhe akteve nënligjore.

1.7. Të drejta të tjera, sipas të cilave:

- a) japin tituj nderi dhe stimuj;
- b) vendosin emërtimet e territoreve, objekteve dhe institucioneve nën juridiksionin e tyre, sipas kriterëve të përcaktuara me ligj;
- c) njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë vulën dhe simbolet e tyre.

2. Të drejtat dhe përgjegjësitë e sipër-përmendura ushtrohen nga organet e njësisë të vetëqeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj apo ligje të tjera në fuqi.

KREU IV MARRËDHËNIET MIDIS QEVERISJES QENDRORE DHE NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

Neni 10

Marrëdhëniet midis qeverisjes qendrore dhe njësisë të vetëqeverisjes vendore

Marrëdhëniet ndërmjet organeve të njësisë të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve të qeverisjes qendrore bazohen në parimet e subsidiaritetit, të konsultimit dhe të bashkëpunimit për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.

Neni 11

Komunikimi dhe informimi

Organet e njësisë të vetëqeverisjes vendore, për fushën e tyre të përgjegjësisë, informojnë me shkrim organet e qeverisjes qendrore për çdo çështje që u kërkohet informacion. Organet e qeverisjes qendrore, kur kërkohet nga organet e njësisë të vetëqeverisjes vendore, japin informacion, sipas afateve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 12

Konsultimi midis qeverisjes qendrore dhe njësisë të vetëqeverisjes vendore

1. Qeverisja qendrore konsultohet me njësitë e vetëqeverisjes vendore për politikën, legjislacionin dhe normat që rregullojnë dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të këtyre njësisë.

2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore konsultohen, nëpërmjet shoqatave përfaqësuese të vetëqeverisjes vendore dhe grupeve të tjera të interesit, nëpërmjet të cilit u mundësohet prezantimi i opinioneve, komenteve dhe propozimeve të tyre për politikën dhe legjislacionin që ka ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të tyre.

3. Struktura, procedura, forma, mënyra e organizimit dhe funksionimit dhe natyra e çështjeve për konsultim përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 13

Mbikëqyrja dhe kontrolli

1. Për zbatimin e normave e të standardeve kombëtare, të përcaktuara në legjislacionin përkatës, ministrinë, sipas fushave të përgjegjësisë, monitorojnë veprimtarinë e organeve të njësisve të vetëqeverisjes vendore dhe për funksionet e deleguara kanë të drejtë t'i mbikëqyrin ato.

2. Vendimet, urdhrat dhe urdhëresat me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj.

3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen mbikëqyrjes dhe inspektimit financiar për zbatimin e normave e të standardeve kombëtare në fushën e menaxhimit të financave publike, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen kontrollit të jashtëm financiar nga organet e qeverisjes qendrore për përdorimin e fondeve të kushtëzuara dhe/ose të deleguara që financohen nga Buxheti i Shtetit dhe/ose fondet e ndihmës së huaj, të alokuara te njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas marrëveshjeve të nënshkruara nga qeverisja qendrore.

5. Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi.

KREU V

BASHKËPUNIMI MES NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

Neni 14

Bashkëpunimi mes dy apo më shumë njësisve të vetëqeverisjes vendore

1. Për kryerjen e funksioneve dhe ofrimin e shërbimeve specifike në dobinë e përbashkët, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, mund të ushtrojnë së bashku çdo funksion dhe/ose shërbim që u është dhënë atyre me ligj, nëpërmjet lidhjes dhe zbatimit të marrëveshjeve ose kontratave të përbashkëta, delegimit të kompetencave dhe përgjegjësisë të veçanta njëra-tjetres ose kontraktimit me një palë të tretë.

2. Në çdo marrëveshje të bashkëpunimit ndërvendor përcaktohen:

a) qëllimi i marrëveshjes;

b) funksionet që do të ushtrohen nga secila bashki apo në mënyrë të përbashkët;

c) mënyra me anë të së cilës do të plotësohet qëllimi;

ç) shkalla dhe kohëzgjatja e delegimit të kompetencave;

d) mënyra dhe masa e kontributit financiar përkatës dhe e ndarjes së të ardhurave e të përfitimeve të tjera.

3. Marrëveshja e bashkëpunimit ndërvendor miratohet nga këshillat përkatës të secilës prej njësisve të vetëqeverisjes vendore që janë palë në marrëveshje. Detyrimi financiar për secilën prej njësisve të vetëqeverisjes vendore, palë të marrëveshjes, miratohet çdo vit si zë i veçantë në buxhetin vendor.

4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të lidhin marrëveshje bashkëpunimi ndërvendor me njësi të vetëqeverisjes vendore të shteteve huaja. Përpara lidhjes së këtyre marrëveshjeve, njësitë marrin mendimin e Ministrisë Punëve të Jashtme.

5. Dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, si dhe me institucione të qeverisjes qendrore, mund të lidhin marrëveshje të përbashkët për krijimin e një personi juridik të ndarë nga palët, të cilit i japin autoritet dhe kompetenca të caktuara. Në kuptimin e këtij ligji, ky person juridik quhet subjekt i kompetencave të përbashkëta. Për secilën palë përcaktohet ndihmesa financiare, ndihmesa me shërbime, ndihmesa me pajisje dhe me punonjës të kualifikuar ose çdo aset tjetër i nevojshëm për përmbushjen e objektivave.

6. Brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të marrëveshjes, subjekti i kompetencave të

përbashkëta njofton zyrtarisht prefektin.

7. Në njoftimin zyrtar përcaktohen:

- a) emërtimi i njërive të vetëqeverisjes vendore, palë në marrëveshje;
- b) data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes;
- c) qëllimi i marrëveshjes dhe funksioni që do të ushtrohet;
- ç) vendimet e bashkive të përfshira në marrëveshje në lidhje me të;
- d) kontributi i palëve në këtë marrëveshje.

8. Marrëveshja bëhet e zbatueshme pas shprehjes së ligjshmërisë nga prefekti brenda afateve të përcaktuara me ligj.

KREU VI

TRANSPARENCA, KONSULTIMI DHE PJESËMARRJA QYTETARE

Neni 15

Transparenca e veprimtarisë së njësive të vetëqeverisjes vendore

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre.
2. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike.
3. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatorin e transparencës dhe të miratojë programin e transparencës, duke siguruar akces nga të gjithë, veçanërisht nga shtresat më të varfra të komunitetit, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për të drejtën e informimit.

Neni 16

Konsultimi publik në njësitë e vetëqeverisjes vendore

1. Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes.
2. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për njoftimin dhe konsultimin publik.

Neni 17

Mbledhjet e këshillit të bashkisë

1. Mbledhjet e këshillit të bashkisë janë të hapura për publikun. Çdo shtetas lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit.
2. Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara për këtë qëllim brenda territorit të njësisë vendore dhe në media të aksesueshme në njësinë vendore dhe përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.
3. Me kërkesën e kryetarit të bashkisë ose të një të pestës së anëtarëve të këshillit bashkiak, mbledhjet e këshillit bashkiak mund të bëhen të mbyllura, kur për këtë kanë votuar jo më pak se tre të pestat e gjithë anëtarëve të tij.

Neni 18

Seancat e këshillimeve me bashkësinë

1. Këshilli bashkiak ose këshilli i qarkut, përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve, zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë, të cilat janë të detyrueshme për rastet e parashikuara në nenet 54, shkronjat “a”, “dh”, “e”, “f” dhe “k”, dhe 77, shkronjat “a”, “dh”, “e”, “f” dhe “k”, të këtij ligji.
2. Këshillimi me publikun, në çdo rast, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit, duke përdorur një nga format e nevojshme, si takimet e hapura me banorët e grupet e interesit,

takime me specialistë, me institucione të interesuara dhe organizata jofitimprurëse ose nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore.

3. Aktet e këshillit publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe afishohen në vende publike, të caktuara nga këshilli me akses të lirë publik, brenda territorit të njësisë vendore dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo bashki bëhet në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim.

Neni 19

E drejta e kërkesës, ankesës dhe vërejtjes

1. Çdo qytetar apo grupe që përfaqësojnë komunitetet kanë të drejtë t'u drejtojnë kërkesa, ankesa apo vërejtje organeve të vetëqeverisjes vendore për çështje që lidhen me funksione dhe kompetenca në juridiksionin e njësisë së vetë-qeverisjes vendore.

2. Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara t'i marrin në shqyrtim kërkesat, ankesat apo vërejtjet dhe të kthejnë përgjigje brenda afateve të përcaktuara me ligj.

Neni 20

E drejta e iniciativës qytetare

1. Çdo komunitet, nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të tij, ose jo më pak se një për qind e banorëve të bashkisë ka të drejtë të paraqesin për vendimmarrje në këshillin bashkiak iniciativa qytetare për çështje që janë brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Mënyra dhe forma e paraqitjes së këtyre iniciativave, procedura e shqyrtimit dhe miratimit të tyre përcaktohet në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të këshillit bashkiak.

2. Propozimet e ardhura në këshill si iniciativë qytetare, kur kanë ndikim financiar në buxhetin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, shqyrtohen në këshill, sipas rendit të ditës, dhe nuk mund të miratohen pa marrë më parë mendimin e kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

KREU VII

FUNKSIONET DHE KOMPETENCAT E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

Neni 21

Llojet e funksioneve

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë funksione, kompetenca, si dhe funksione të deleguara.

2. Funksionet u njihen njësisë të vetëqeverisjes vendore me këtë ligj. Funksione apo kompetenca të tjera mund t'u njihen një, disa apo të gjitha njësisë të vetëqeverisjes vendore vetëm në bazë të ligjit.

3. Funksionet e deleguara u transferohen njësisë të vetëqeverisjes vendore me ligj ose me marrëveshje. Në çdo rast delegimi i funksioneve shoqërohet nga transferata e mjaftueshme e qeverisjes qendrore për të financuar koston e ushtrimit të këtyre funksioneve.

Neni 22

Parimet për ushtrimin e funksioneve

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore rregullojnë dhe administrojnë ushtrimin e funksioneve të veta në mënyrë të plotë dhe të pavarur, në përputhje me Kushtetutën, Kartën Europiane të Autonomisë Vendore dhe ligjet në fuqi.

2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë funksionet duke respektuar politikat kombëtare dhe rajonale. Për këto funksione, qeverisja qendrore mund të vendosë standarde e norma specifike të

përgjithshme, me qëllim ruajtjen e interesave kombëtarë dhe ofrimin e shërbimeve cilësore.

3. Në rastet kur njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk zotërojnë fondet ose mjetet e mjaftueshme për arritjen e standardeve dhe normave kombëtare, qeverisja qendrore u jep atyre mbështetjen e nevojshme financiare.

4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore admini-strojnë ushtrimin e funksioneve të deleguara, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Kur njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë funksionet e deleguara, qeverisja qendrore siguron mjete dhe burime financiare të mjaftueshme për të ushtruar këto funksione në mënyrën dhe në atë nivel ose standard, i cili është përcaktuar me ligj.

Neni 23

Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike

Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për:

1. Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm.
2. Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.
3. Mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara.
4. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore.
5. Ndriçimin e mjediseve publike.
6. Transportin publik vendor.
7. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike, si dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit.
8. Shërbimin e dekorit publik.
9. Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike.
10. Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.
11. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale.
12. Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.
13. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
14. Planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Neni 24

Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

1. Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
2. Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
3. Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore.
4. Krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social

për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Neni 25

Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

1. Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave e të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.
2. Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar e lokal, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.
3. Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e bibliotekave e të ambienteve për lexim, me qëllim edukimin e përgjithshëm të qytetarëve.
4. Organizimin e aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese, zhvillimin dhe administrimin e institucioneve e të objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

Neni 26

Funksionet e bashkive në fushën e mbrojtjes së mjedisit

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

1. Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja.
2. Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen nga ndotja akustike.
3. Zhvillimin e aktiviteteve edukuese dhe promovuese, në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit.

Neni 27

Funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

1. Administrimin, shfrytëzimin dhe mirë-mbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
2. Administrimin dhe mbrojtjen e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve, si toka të pafrytshme etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
3. Krijimin dhe administrimin e sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural, sipas legjislacionit në fuqi.
4. Krijimin dhe administrimin e skemave vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural, të financuara nga buxheti lokal dhe/ose me bashkëfinancim nga të tretët, duke garantuar akses të balancuar gjinor.
5. Administrimin e fondit pyjor dhe kullor publik, sipas legjislacionit në fuqi.
6. Mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 28

Funksionet e bashkive në fushën e zhvillimit ekonomik vendor

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

1. Hartimin e planeve strategjike të zhvillimit e të programeve për zhvillimin ekonomik vendor.
2. Ngritjen dhe funksionimin e tregjeve publike dhe të rrjetit të tregtisë.
3. Mbështetjen për zhvillimin e biznesit të vogël, nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panairë e reklama në vende publike.

4. Organizimin e shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacioni për bizneset, aktivitetet promovuese, vënia në dispozicion e aseteve publike etj.

5. Publikimin e broshurave informative, krijimin e portaleve me profil ekonomik etj.

6. Dhënien e granteve financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël e të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi, duke garantuar akses të balancuar gjinor.

Neni 29

Funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike

Bashkitë janë përgjegjëse për garantimin e këtyre funksioneve:

1. Mbrojtjen civile, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

2. Garantimin e shërbimit të zjarrfikësve, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

3. Garantimin e mbarëvajtjes së marrëdhënieve në komunitet, parandalimin dhe ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve në komunitet.

4. Parandalimin e kundërvajtjeve admini-strative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të njëjësive të vetë-qeverisjes vendore brenda juridiksionit të tyre vendor dhe në përputhje me përcaktimet ligjore.

Neni 30

Funksionet dhe kompetencat e deleguara

1. Funksionet dhe kompetencat e deleguara janë të detyrueshme ose jo të detyrueshme.

2. Funksione dhe kompetenca të detyrueshme janë ato të përcaktuara me ligj.

3. Institucionet qendrore, kur lejohet me ligj, autorizojnë bashkinë ose qarkun të kryejnë funksione të caktuara, duke përcaktuar, kur është e nevojshme, procedurat e kryerjes e të kontrollit për zbatimin e tyre.

4. Institucionet qendrore mund të autorizojnë bashkinë dhe/ose qarkun të ushtrojnë një kompetencë të vetme për një funksion të caktuar.

5. Bashkisë ose qarkut mund t'u delegohen funksione dhe kompetenca të tjera jo të detyrueshme, mbi bazën e një marrëveshjeje midis njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse dhe institucionit qendror përgjegjës me ligj për këtë funksion ose kompetencë.

6. Në çdo rast qeverisja qendrore u garanton njësisive të vetëqeverisjes vendore mbështetjen e nevojshme financiare për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të deleguara.

7. Bashkia ose qarku, me nismën e tyre, mund të përdorin burimet e veta financiare për ushtrimin e funksioneve e të kompetencave të deleguara, me synim ngritjen në nivel më të lartë të shërbimit në interes të bashkësisë.

Neni 31

Funksionet e qarkut

1. Funksionet e qarkut janë ndërtimi e zbatimi i politikave rajonale, harmonizimi i tyre me politikat shtetërore, në nivel qarku, si dhe çdo funksion tjetër i dhënë me ligj.

2. Qarku ushtron të gjitha funksionet që i delegohen nga një ose më shumë bashki, brenda territorit të qarkut, sipas një marrëveshjeje të lidhur midis palëve.

3. Qarku kryen dhe ushtron kompetencat e deleguara nga pushteti qendror, sipas parimeve të parashikuara në nenin 22 të këtij ligji.

Neni 32

Administrimi i shërbimeve publike

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike, në përputhje me funksionet e caktuara me ligj, duke përdorur instrumente të përshtatshme për të siguruar aksesin, cilësinë, sasinë dhe koston e përbalueshme nga të gjithë.

2. Mënyrat dhe kushtet për ushtrimin e shërbimeve publike, kur nuk janë përcaktuar në mënyrë specifike nga legjislacioni në fuqi, përcaktohen nga vetë njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Neni 33

Instrumentet për administrimin e shërbimeve publike

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore sigurojnë dhënien e shërbimeve publike, nëpërmjet një ose më shumë instrumenteve të mëposhtme:

a) njësive organizative të veta, që janë pjesë e strukturës administrative të njësisë vendore;

b) ndërmarrjeve për shërbimet publike, sipas legjislacionit në fuqi;

c) kontraktimit të dhënies së shërbimeve me palë të treta;

ç) përdorimit të instrumenteve të përshtatshme të partneritetit publik dhe privat, sipas legjislacionit në fuqi;

d) krijimit të shoqërive tregtare në pronësi apo bashkëpronësi të njësisë vendore, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Në çdo rast, pavarësisht nga instrumenti i përzgjedhur, njësia vendore do të jetë përgjegjëse për:

a) hartimin dhe vendosjen e një sistemi administrimi të performancës së shërbimit, bazuar mbi standarde vendore dhe/ose standarde minimale kombëtare;

b) hartimin dhe vendosjen e një sistemi treguesish, përfshirë edhe aspektin gjinor për matjen e performancës;

c) krijimin e një njësie të posaçme në strukturën e njësisë së vetëqeverisjes vendore, e cila do të jetë përgjegjëse për prezantimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e performancës e të shërbimit, përfshirë edhe aspektin gjinor.

3. Njësia e vetëqeverisjes vendore mund të ofrojë mbështetje financiare për ndërmarrjet bashkiake për shërbimet publike dhe/ose për shoqëritë tregtare me kapital të njësisë së vetëqeverisjes vendore, fusha e veprimit të së cilës lidhet me dhënien e një shërbimi publik që është përgjegjësi e kësaj njësie.

KREU VIII

FINANCAT E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

Neni 34

Parimet themelore të financave të vetëqeverisjes vendore

1. Politikat kombëtare financiare garantojnë mjaftueshmërinë financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe bazohen në parimin e shumëllojshmërisë së burimeve të të ardhurave.

2. Funksionet dhe kompetencat që u delegohen njësive të vetëqeverisjes vendore shoqërohen kurdoherë me mjetet e nevojshme financiare për realizimin e tyre.

3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifatat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga qeverisja qendrore dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt atyre nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacione, si dhe burime të tjera, të parashikuara në ligj.

4. Njësitë të vetëqeverisjes vendore u garantoher me ligj e drejta për krijimin e të ardhurave në mënyrë të pavarur.

5. Në rast se ndryshimet në politikën fiskale shoqërohen me ulje të niveleve, normave dhe bazës së taksave vendore apo të pjesës së të ardhurave të njësive të qeverisjes vendore nga taksat e ndara,

Ministria e Financave është e detyruar të marrë masat për kompensimin e uljes, nëpërmjet rritjes së transfertave financiare dhe mundësive për huamarrjen vendore dhe/ose formave të tjera.

6. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore.

Neni 35

Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore

1. Bashkitë krijojnë të ardhura nga:

a) taksat vendore mbi pasuritë e luajtshme e të paluajtshme, si dhe mbi transaksionet e kryera me to;

b) taksat vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël;

c) taksat vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier;

ç) taksat vendore mbi të ardhurat vetjake, të krijuara nga dhuratat, trashëgimitë, testamentet ose lotaritë vendore;

d) të ardhura nga donacionet dhe dhuratat;

dh) taksa vendore të përkohshme, të cilat vendosen sipas mënyrës së parashikuar në ligj;

e) taksa të tjera të përcaktuara me ligj.

2. Bashkitë e ushtrojnë të drejtën e vendosjes së nivelit të taksës, mënyrën e llogaritjes së saj, si dhe mbledhjen e administrimin e tyre brenda kufijve e sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin përkatës.

3. Bashkitë kanë të drejtë të përjashtojnë nga pagimi i taksës kategori të caktuara apo grupe në nevojë, në përputhje me ligjin përkatës.

4. Baza e taksave vendore, si dhe kufijtë maksimalë dhe/ose minimalë të tyre vendosen me ligj të veçantë. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë të drejtë të zbatojnë ose jo një taksë vendore. Kur këto njësi zbatojnë taksën vendore, ato ushtrojnë të drejtën e vendosjes së nivelit të tyre, mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të tyre, sipas kriterëve dhe kufijve të përcaktuar në legjislacionin përkatës.

5. Bashkitë krijojnë të ardhura nga tarifatat vendore për:

a) shërbimet publike që ato ofrojnë;

b) të drejtën e përdorimit të pronave publike vendore;

c) dhënie licencave, të lejeve, autorizimeve dhe për lëshimin e dokumenteve të tjera, për të cilat ato kanë autoritet të plotë, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj;

ç) çdo tarifë tjetër të përkohshme, në përputhje me rrethana të përcaktuara me ligj.

Neni 36

Të ardhurat nga burime të tjera të bashkive

1. Të ardhurat nga burime të tjera të bashkive janë:

a) të ardhurat nga dhënia me qira e asetëve në pronësi të bashkisë;

b) të ardhurat nga investimet mbi kapitalet;

c) të ardhurat nga titujt dhe të drejtat e tjera të blera nga bashkia;

ç) të ardhurat nga fitimi i ndërmarrjeve publike në pronësi;

d) të ardhurat nga partneritetet privat-publik.

2. Bashkitë krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre ekonomike, qiratë dhe shitja e pronave, dhuratat, interesat, gjobat, ndihmat ose donacionet.

3. Bashkitë mund të krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre kulturore, sportive dhe të tjera, të përcaktuara me ligj.

Neni 37

Të ardhurat që rrjedhin nga burimet kombëtare

1. Bashkitë krijojnë të ardhurat nga burimet kombëtare:

a) Taksat dhe tatimet e ndara, në të cilat përfshihen një pjesë e tatimit mbi të ardhurat personale, tatimit mbi fitimin dhe taksave të tjera mbi pasuritë kombëtare. Të ardhurat nga këto taksa e tatime u jepen bashkive rregullisht në jo më pak se katër transfertat në vit. Pjesa e taksës dhe tatimit që shkon në favor të tyre, si dhe mbledhja e administrimi përcaktohen me ligj për çdo taksë ose tatim të ndarë.

b) Transfertat e pakushtëzuara nga qeverisja qendrore të njësitë e vetëqeverisjes vendore për financimin e funksioneve të veta, si dhe për arritjen e barazisë së shpërndarjes së burimeve financiare mes njësitë të vetëqeverisjes vendore. Transfertat e pakushtëzuara caktohet si përqindje fikse kundrejt të ardhurave të qëndrueshme publike, sipas përcaktimit në ligjin që rregullon financat vendore, si dhe shpërndahet sipas formulës së përcaktuar me ligj.

c) Transfertat e kushtëzuara nga qeverisja qendrore do të bazohen në kritere objektive dhe renditjen prioritare të nevojave të njësisë së vetëqeverisjes vendore, kushtet ekonomike, kërkesat e infrastrukturës, si dhe në strategjitë e zhvillimit në nivel kombëtar e rajonal.

2. Qeverisja qendrore, në periudhën e hartimit të projektbuxhetit të shtetit, është e detyruar të konsultohet me njësitë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet instrumenteve të përcaktuara të konsultimit, duke analizuar mjaftueshmërinë dhe stabilitetin e burimeve financiare të njësitë të vetëqeverisjes vendore për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 38

Burimet e financimit të qarkut

1. Qarku krijon të ardhura nga burimet e veta vendore dhe të ardhura që rrjedhin nga burime kombëtare.

2. Të ardhurat nga burimet e veta vendore dhe kombëtare përbëhen nga:

a) transfertat e pakushtëzuara nga Buxheti i Shtetit;

b) transfertat e kushtëzuara për kryerjen e funksioneve e të kompetencave të deleguara përkatëse nga bashkitë përbërëse;

c) taksa të vendosura në nivel qarku, të përcaktuara në përputhje me ligjin;

ç) tarifatat për shërbimet publike të kryera nga qarku.

3. Qarku financohet nga kuotat e anëtarësisë së bashkive përbërëse, të përcaktuara në buxhetin vjetor të bashkive. Kuota e anëtarësisë për financimin e buxhetit të qarkut përcaktohet me vendim të këshillit bashkiak.

4. Kriteret dhe normat për krijimin dhe administrimin e të ardhurave nga burimet e veta vendore janë të ngjashme me ato të përcaktuara për të ardhurat nga burimet vendore të bashkive.

5. Të ardhurat e qarkut nga ndarja e të ardhurave kombëtare krijohen dhe administrohen sipas mënyrës së përcaktuar në këtë ligj dhe në ligje të tjera në fuqi.

Neni 39

Huamarrja vendore

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë të drejtë të marrin hua, në përputhje me legjisllacionin që rregullon menaxhimin e sistemit buxhetor, huamarrjen vendore dhe financat vendore.

2. Në kufirin vjetor të huamarrjes, miratuar me ligjin vjetor të buxhetit, një përqindje e caktuar i rezervohet njësitë të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me politikën dhe disiplinën fiskale të ndjekur nga qeverisja qendrore. Aksesit në tregun e borxhit të jashtëm rregullohet në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe entitete të tjera, të përcaktuara me ligj.

3. Çdo rregullim apo kufizim i vendosur nga qeverisja qendrore në huamarrjen e vetëqeverisjes vendore, që kufizon mundësinë e njërive të vetëqeverisjes vendore për të marrë hua, duhet të jenë të përkohshëm dhe të mos shtrihen përtej vitit fiskal në të cilin janë vendosur, përveç rasteve kur këto masa miratohen nga Kuvendi.

Neni 40 **Shpenzimet**

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kryejnë shpenzime, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në përputhje me parimet e disiplinës fiskale, menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomi të burimeve të tyre financiare. Të ardhurat e veta të njërive të vetëqeverisjes vendore, që nuk janë shpenzuar brenda vitit fiskal, trashëgohen në vitin tjetër fiskal.

2. Në kushtet e mungesës së buxhetit të miratuar nga këshilli, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr përkohësisht kompetencat e këshillit dhe autorizon kryerjen e shpenzimeve mujore deri në 1/12 e shpenzimeve faktike të buxhetit vendor në vitin buxhetor paraardhës.

3. Kryetari i bashkisë ose personat e autorizuar prej tij nuk lejohet të kryejnë shpenzime përtej shumës maksimale të shpenzimeve, të përcaktuar në zërin përkatës në buxhetin vjetor. Nuk lejohen shpenzime të fondeve nëse nuk ka fonde të mjaftueshme në gjendje në bashki për të mbështetur shpenzime të tilla.

4. Pas miratimit zyrtar të buxhetit, kryetari i bashkisë mund të autorizojë ose të kërkojë autorizimin e këshillit për rishpërndarjen e fondeve nga një zë shpenzimesh në një tjetër, brenda dhe midis programeve të ndryshme buxhetore, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë menaxhimin e sistemit buxhetor dhe financat vendore.

5. Pavarësisht nga dispozitat e këtij ligji, asnjë transfertë e kushtëzuar, e dhënë nga qeverisja qendrore, nuk mund të përdoret për qëllime të tjera, përveç atyre të përcaktuara në grantin apo transfertën përkatëse.

6. Buxheti vendor përfshin një fond rezervë dhe një fond kontingjence, të pashpërndarë, i cili miratohet nga këshilli bashkiak në buxhetin vjetor të bashkisë deri në masën 3 për qind të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, përjashtuar transfertat e kushtëzuara.

Neni 41 **Buxheti i njërive të vetëqeverisjes vendore dhe programi buxhetor afatmesëm**

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore hartojnë dhe miratojnë buxhetin vjetor e programin buxhetor afatmesëm, sipas legjislationit në fuqi që rregullon sistemin buxhetor dhe financat vendore.

2. Për qëllime të transparencës e të respektimit të ligjit, buxheti i njërive të vetëqeverisjes vendore duhet të përmbajë:

a) parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimet e propozuara në secilën kategori shpenzimesh, përfshirë shlyerjen e borxhit të njësisë së vetëqeverisjes vendore;

b) të gjitha transfertat e kushtëzuara, të parashikuara për t'u marrë nga qeverisja qendrore dhe të cilat hyjnë në buxhetin e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe që përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë dhënë, në përputhje me rregullat e caktuara nga qeverisja qendrore për përdorimin e tyre;

c) të gjitha fondet e mbartura nga viti i mëparshëm dhe fondet e parashikuara për t'u siguruar në mënyrë të drejtpërdrejtë prej vetë bashkisë nga çfarëdolloj burimi, përfshirë këtu të gjitha taksat, grantet nga qeverisja qendrore, tarifatat, vlerësimet, gjobot, grantet nga burime të niveleve të tjera të

qeverisjes;

ç) parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për dy vitet buxhetore pasardhëse; parashikimin e shpenzimeve për investimet e reja me informacionin e mëposhtëm:

- i) qëllimin e investimit;
 - ii) planin e financimit, përfshirë mënyrat dhe burimet e financimit;
 - iii) shpenzimet vjetore që duhen për shlyerjen e kredisë, nëse përdoret, si dhe një preventiv të shpenzimeve operative që lindin si pasojë e kryerjes së investimit;
- d) objektivat kryesorë të buxhetit për vitin pasardhës dhe rezultatet e pritshme, përfshirë treguesit e performancës dhe informacione të tjera shtesë që kërkohen ose mund të kërkohen nga ligji.

Neni 42

Ruajtja dhe administrimi i dokumenteve financiare

1. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore merr masa dhe është përgjegjëse për arkivimin, ruajtjen e administrimin e dokumenteve financiare dhe për dëmtimin ose humbjen e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore miraton rregulloren e brendshme për zbatimin e legjislacionit për arkivat.

Neni 43

Kontrolli i jashtëm dhe auditimi

1. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore i nënshtrohet kontrollit të jashtëm nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

2. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është subjekt i auditimit të brendshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Çdo raport i kontrollit të jashtëm apo auditimit të brendshëm mbi funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore duhet të vihet në dispozicion të publikut, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Me vendim të veçantë të këshillit bashkiak ose të këshillit të qarkut, organet ekzekutive të njësive të vetëqeverisjes vendore mund t'i nënshtrohen auditimit të kryer nga shoqëri të specializuara në fushën e auditimit.

Neni 44

Raporti vjetor

Kryetari njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport me shkrim të këshilli për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Ky raport i paraqitet këshillit jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës.

KREU IX

PËRBËRJA, KRIJIMI, MËNYRA E ORGANIZIMIT, KOMPETENCAT DHE DETYRAT E KËSHILLIT BASHKIAK

Neni 45

Mënyra e zgjedhjes

Këshilli bashkiak përbëhet nga këshilltarë të zgjedhur, sipas dispozitave të përcaktuara në Kodin

Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 46

Numri i anëtarëve të këshillit bashkiak

1. Numri i anëtarëve të këshillit bashkiak përcaktohet sipas numrit të popullsisë si më poshtë:

- Bashkitë deri në 20 000 banorë 15 anëtarë;
- Bashkitë nga 20 001 deri në 50 000 banorë 21 anëtarë;
- Bashkitë nga 50 001 deri në 100 000 banorë 31 anëtarë;
- Bashkitë nga 100 001 deri në 200 000 banorë 41 anëtarë;
- Bashkitë nga 200 001 deri në 400 000 banorë 51 anëtarë;
- Bashkitë mbi 400 000 banorë 61 anëtarë.

2. Në zbatim të këtij neni, prefekti përcakton numrin e anëtarëve të këshillit për çdo bashki nën juridiksionin e tij, mbi bazën e numrit të banorëve, sipas evidencave të zyrave të gjendjes civile të datës 1 janar të vitit kur zhvillohen zgjedhjet vendore.

Neni 47

Papajtueshmëria e funksionit të këshilltarit

1. Funksioni i këshilltarit është i papajtueshëm me:

- a) funksionin e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të bashkisë;
- b) funksionin e sekretarit të këshillit bashkiak;
- c) funksionin e nëpunësit të administratës së bashkisë përkatëse dhe institucioneve në varësi të saj;

ç) funksionin e deputetit;

d) funksionin e ministrit.

2. Një person nuk mund të zgjidhet në të njëjtën kohë në më shumë se një këshill bashkiak.

3. Nuk mund të jenë anëtarë të të njëjtit këshill personat e lidhur: bashkëshortë, prindër e fëmijë, vëlla e motër, si dhe vjehri e vjehrra me nusen e dhëndrin.

Neni 48

Mbledhja e parë e këshillit bashkiak

1. Këshilli bashkiak zhvillon mbledhjen e tij të parë jo më vonë se 20 ditë nga data e shpalljes së rezultatit nga organi kompetent, i përcaktuar në Kodin Zgjedhor.

2. Mbledhja e parë e këshillit thirret nga sekretari i këshillit bashkiak. Në mungesë të tij, nismën për thirrjen e mbledhjes së parë e merr prefekti.

3. Në rast se asnjë nga subjektet e sipër-përmendura nuk e ushtron këtë të drejtë, brenda afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, atëherë këshilli mblidhet vetë brenda 10 ditëve.

4. Mbledhja e parë e këshillit është e vlefshme kur në të marrin pjesë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të tij, të shpallur nga organi kompetent, i përcaktuar në Kodin Zgjedhor. Nëse nuk mblidhen më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të këshillit, mbledhja nuk zhvillohet dhe ajo thirret çdo tri ditë, por jo më shumë se tri herë. Në rastet kur edhe pas tri herë thirrjeje nuk sigurohet pjesëmarrja e kërkuar, këshilli konsiderohet i shpërndarë.

5. Mbledhja e parë e këshillit, deri në zgjedhjen e kryetarit të tij, drejtohet nga këshilltari më i vjetër në moshë.

6. Në mbledhjen e parë të këshillit bashkiak:

- a) zgjidhet komisioni i mandateve;
- b) miratohen mandatet e anëtarëve të këshillit;
- c) këshilltarët bëjnë betimin;
- ç) zgjidhen kryetari dhe zëvendëskryetarët e këshillit;

d) zgjidhen anëtarët që do të përfaqësojnë këshillin bashkiak në këshillin e qarkut dhe pajisen me mandatin e përfaqësimit.

7. Këshilli konstituohet pas vërtetimit të mandateve të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij.

Neni 49

Mandati i këshilltarit

1. Mandati i jepet këshilltarit me vendim të këshillit bashkiak.
2. Dhënia dhe heqja e mandatit bëhen me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit.
3. Këshilltari nuk voton për mandatin e tij.

4. Mandati i këshilltarit mbaron përpara afatit kur:

- a) ndryshon vendbanimin jashtë territorit të bashkisë ku është zgjedhur;
- b) jep dorëheqjen;
- c) krijohen kushte të papajtueshmërisë, të përcaktuara në nenin 47 të këtij ligji;
- ç) mandati, nga ana e tij, është marrë në mënyrë të kundërligjshme;
- d) humbet zotësinë për të vepruar me vendim gjykate;
- dh) vdes;
- e) nuk merr pjesë në mbledhjet e këshillit për një periudhë 6-mujore;
- ë) dënohet për kryerjen e një vepre penale me vendim gjykate të formës së prerë;
- f) këshilli shpërndahet nga organi kompetent.

5. Mbarimi i mandatit para kohe deklarohet me vendim të këshillit bashkiak, me propozim të komisionit të mandateve.

Neni 50

Betimi

1. Pas verifikimit të mandateve nga komisioni përkatës, këshilltarët bëjnë këtë betim para këshillit:

“Betohe me në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të këshillit bashkiak dhe do t’i bindem Kushtetutës dhe ligjeve. Betohe me se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të bashkisë (*emri i bashkisë përkatëse*) dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre”.

2. Këshilltari që mungon me arsye në bërjen e betimit betohet në mbledhjen më të parë që merr pjesë. Këshilltari, që nuk pranon të bëjë dhe të nënshkruajë betimin, konsiderohet se jep dorë-heqjen dhe atij nuk i jepet mandati.

Neni 51

Të drejtat e këshilltarit

1. Këshilltari kryen funksionin me shpërblim mujor të barabartë me 10 për qind të pagës mujore të kryetarit të bashkisë përkatëse.

2. Punëdhënësi detyrohet të lejojë anëtarin e këshillit bashkiak të shkëputet nga puna për të marrë pjesë në mbledhjet e këshillit bashkiak, komisioneve të tij apo aktivitete të organizuara prej këshillit bashkiak.

3. Me kërkesën e tij, këshilltari informohet dhe i vihet në dispozicion në çdo kohë, nga kryetari i bashkisë përkatëse, çdo dokumentacion i lidhur me bashkinë.

4. Këshilltari ka të drejtën e kualifikimit profesional, sipas programit të miratuar nga këshilli. Financimi për këto raste bëhet sipas rregullave të legjislacionit në fuqi.

Neni 52

Kushtet e pengesës ligjore, vetëdeklarimi dhe përjashtimi

1. Anëtari i këshillit bashkiak nuk përfshihet në një procedurë shqyrtimi dhe vendimmarrëse në rastet kur:

a) ka një interes personal të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen në shqyrtim;

b) bashkëshorti, bashkëjetuesi ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në vendim-marrjen në shqyrtim;

c) ai ose edhe personat e parashikuar në shkronjën “b”, të kësaj pike, kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në një çështje objektivisht të njëjtë dhe me të njëjtat rrethana ligjore me çështjen në shqyrtim;

ç) ai ka marrë pjesë si ekspert, këshilltar, përfaqësues ose avokat privat në çështjen në shqyrtim;

d) personat e përmendur në shkronjën “b”, të kësaj pike, kanë marrë pjesë si ekspertë përfaqësues, këshilltarë apo avokatë në çështjen në shqyrtim;

dh) ai ose personat e përmendur në shkronjën “b”, të kësaj pike, janë debitorë ose kreditorë të palëve të interesuara në çështjen në shqyrtim;

e) ai ose personat e përmendur në shkronjën “b”, të kësaj pike, kanë marrë dhurata nga palët përpara ose pas fillimit të procedurës së shqyrtimit;

ë) ai ose personat e përmendur në shkronjën “b”, të kësaj pike, kanë marrëdhënie të tilla, të cilat vlerësohen, sipas rrethanave konkrete, se do të përbënin arsye serioze për njëanshmëri me palët në procedurën në shqyrtim;

f) në çdo rast parashikohet nga legjislacioni në fuqi;

g) ai ose personat e përmendur në shkronjën “b”, të kësaj pike, janë përfshirë në çdo lloj mënyre në negocime të mundshme për punësim në të ardhmen të tij apo të personave të përmendur në shkronjën “b”, të kësaj pike, gjatë ushtrimit të funksionit apo në negocime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat, pas lënies së detyrës, të kryera nga ai gjatë ushtrimit të detyrës.

2. Nëse anëtari i këshillit bashkiak vëren një nga pengesat e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, ai njofton menjëherë me shkrim kryetarin e këshillit bashkiak.

3. Persona të tretë mund të kërkojnë përjashtimin e pjesëmarrjes së një anëtari të këshillit bashkiak nga një procedurë, deri në kohën e marrjes së vendimit, duke parashtruar arsyet për të cilat kërkohet përjashtimi nga shqyrtimi dhe vendimmarrja. Kërkesa bëhet me shkrim, i drejtohet kryetarit të këshillit bashkiak dhe përmban të gjitha provat e mundshme në të cilat ajo mbështetet.

4. Kryetari i këshillit bashkiak, i njoftuar sipas pikave 2 dhe 3, të këtij neni, i propozon këshillit bashkiak përjashtimin ose konfirmimin e anëtarit të këshillit bashkiak nga/në procedura vendim-marrëse.

Neni 53

Funksionimi i këshillit bashkiak

1. Këshilli bashkiak ushtron funksionet e tij nga data e konstituimit, sipas nenit 48, të këtij ligji, deri në krijimin e këshillit të ri pasardhës.

2. Mbledhjet e radhës së këshillit bashkiak zhvillohen si rregull, sipas përcaktimit që bën vetë këshilli, por jo më pak se një herë në muaj.

3. Këshilli mblidhet në çdo rast:
a) me kërkesën e kryetarit të bashkisë;
b) me kërkesën me shkrim të jo më pak se 1/3 së anëtarëve të tij;
c) me kërkesën e motivuar të prefektit për çështje që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tij.

4. Thirrja për mbledhjen e këshillit bëhet nga kryetari i këshillit dhe njoftimi për mbledhjen bëhet, si rregull, jo më pak se 5 ditë para datës së zhvillimit të saj. Njoftimi përmban datën e mbledhjes, orën, vendin dhe rendin e ditës.

5. Rendi i ditës miratohet nga këshilli.

6. Në periudhën nga data e zgjedhjeve e deri në konstituimin e këshillit të ri, këshilli i mëparshëm bashkiak ushtron kompetenca të kufizuara dhe merr vendime vetëm në raste të situatave emergjente.

7. Mbledhja e këshillit bashkiak quhet e vlefshme kur në të merr pjesë shumica e të gjithë anëtarëve të këshillit, me përjashtim të rasteve kur kërkohet një shumicë tjetër për marrjen e vendimeve, sipas përcaktimeve në nenin 55 të këtij ligji.

8. Mbledhjet e këshillit pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes. Mënyra e mbajtjes së procesverbalit dhe e vërtetimit të tij përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 54

Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak

Këshilli bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca:

- a) zgjedh nga përbërja e vet komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet;
- b) zgjedh, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, kryetarin dhe zëvendëskryetarët e këshillit dhe i shkarkon ata;
- c) emëron dhe shkarkon sekretarin e këshillit bashkiak;
- ç) miraton nivelin e pagave e të shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- d) miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare, si dhe të personave të tjerë juridikë që krijojnë vetë ose me të cilët është bashkëthemelues;
- dh) miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij. Në vendimin për miratimin e buxhetit miraton, gjithashtu, edhe numrin e maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë;
- e) miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve;
- ë) organizon dhe mbikëqyr kontrollin e brendshëm të bashkisë;
- f) vendos për taksat e tarifat vendore, sipas këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi;
- g) vendos për marrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve;
- gj) vendos për krijimin e institucioneve të përbashkëta me njësi të tjera të vetëqeverisjes vendore, përfshirë subjektin e kompetencave të përbashkëta ose me persona të tretë;
- h) vendos për fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së vet;
- i) zgjedh përfaqësuesit e këshillit bashkiak në këshillin e qarkut, të cilët, në jo më pak se 50 për qind të tyre, duhet t'i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar;
- j) vendos për dhënien ose deklarimin e mbarimit të mandatit të këshilltarit, kur ekzistojnë kushtet e parashikuara në nenin 49 të këtij ligji;
- k) miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik;

- l) vendos për simbolet e bashkisë;
- ll) vendos për emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e bashkisë;
- m) jep tituj nderi dhe stimuj;
- n) vendos për rregullat, procedurat dhe mënyrat e realizimit të funksioneve të deleguara, në bazë dhe për zbatim të ligjit, me të cilin bëhet ky delegim te bashkia.

Neni 55

Votimi

1. Votimi në këshill bëhet i hapur ose i fshehtë. Këshilli, me kërkesë të jo më pak se 1/3 të anëtarëve të tij, vendos për rastet kur votimi bëhet i fshehtë. Votimi i buxhetit dhe i akteve të tjera financiare që kanë lidhje me të bëhet kurdoherë i hapur.

2. Vendimet e këshillit merren me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të këshillit, me përjashtim të rastit kur ky ligj parashikon ndryshe.

3. Vendimet merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të këshillit për rastet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “d”, “dh”, “f”, “g”, “gj”, “i” dhe “j”, të nenit 54, të këtij ligji.

4. Vendimet merren me jo më pak se tre të pestat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit për rastin e parashikuar në shkronjën “e”, të nenit 54, të këtij ligji.

5. Në rastet e votimit për kryetarin, zëvendës-kryetarin dhe sekretarin e këshillit, kur nuk sigurohet shumica e kërkuar, votimi ribëhet midis dy kandidatëve që në raundin e parë kanë fituar numrin më të madh të votave. Në këtë rast fitues shpallet kandidati që ka numrin më madh të votave dhe, nëse votat janë të barabarta, fituesi caktohet me short.

6. Aktet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre subjekteve që përfshihen në to.

Neni 56

Kryetari i këshillit bashkiak

1. Kryetari dhe zëvendëskryetarët e këshillit bashkiak zgjidhen nga radhët e anëtarëve të këshillit. Propozimi për shkarkimin e tyre bëhet me shkrim nga të paktën një e treta e anëtarëve të këshillit.

2. Kryetari i këshillit kryen këto detyra:

- a) thërret mbledhjen e këshillit, në përputhje me nenin 53 të këtij ligji;
- b) drejton mbledhjet e këshillit, në përputhje me rregulloren e tij;
- c) nënshkruan aktet që nxjerr këshilli;
- ç) kryen detyra të tjera, të përcaktuara në rregulloren e këshillit.

3. Në mungesë të kryetarit të këshillit, detyrat e tij i kryen zëvendëskryetari, sipas përcaktimit në rregulloren e brendshme të këshillit.

Neni 57

Sekretari i këshillit bashkiak

1. Sekretari i këshillit emërohet dhe shkarkohet nga këshilli bashkiak, në bazë të propozimit të kryetarit të këshillit, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të këshillit. Shkarkimi i sekretarit mund të propozohet edhe nga 1/3 e anëtarëve të këshillit.

2. Sekretari i këshillit bashkiak është përgjegjës për:

- a) mbajtjen e dokumenteve zyrtare të këshillit;
- b) ndjekjen e punës për përgatitjen e materialeve të mbledhjeve, sipas rendit të ditës;
- c) njoftimin për zhvillimin e mbledhjeve të këshillit;
- ç) shpalljen dhe publikimin e njoftimeve e të akteve të nxjerra nga këshilli bashkiak;

- d) përgatitjen e seancave të këshillimit me bashkësinë;
- dh) mbikëqyrjen e respektimit të rregullores së funksionimit të këshillit.

3. Sekretari i këshillit bashkiak kryen çdo funksion tjetër që i caktohet nga vetë këshilli.

Neni 58

Shpërndarja e parakohshme e këshillit bashkiak

1. Kur këshilli bashkiak nuk mblidhet për një periudhë të vazhdueshme tremujore nga mbledhja e fundit e tij, prefekti thërret mbledhjen e tij, jo më vonë se 20 ditë nga ky afat. Nëse edhe pas thirrjes së prefektit këshilli bashkiak nuk mblidhet, atëherë ai shpërndahet para kohe me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Këshilli bashkiak shpërndahet para kohe me vendim të Këshillit të Ministrave edhe kur:

a) nuk miratohet buxheti brenda afatit të përcaktuar në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor. Në këtë rast prefekti i kërkon kryetarit të bashkisë të thërrasë mbledhjen e këshillit bashkiak, e cila duhet të mbahet jo më vonë se 10 ditë nga data e mbarimit të këtij afati. Në rast se edhe në këtë rast këshilli bashkiak nuk arrin të miratojë buxhetin, vendoset shpërndarja e tij para kohe;

b) kryen shkelje të rënda të Kushtetutës ose ligjeve.

3. Këshilli bashkiak shpërndahet edhe kur bëhet riorganizim me ndryshim kufijsh, sipas nenit 93 të këtij ligji.

4. Në rast të lënies në fuqi të vendimit të shpërndarjes nga organi kompetent, në bashkinë përkatëse organizohen zgjedhjet për këshillin, në përputhje me Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

5. Deri në konstituimin e këshillit të ri, funksionet dhe kompetencat e këshillit, për aq sa është e mundur, kryhen nga kryetari i bashkisë.

KREU X

KRYETARI I BASHKISË

Neni 59

Kryetari i bashkisë

1. Çdo bashki ka kryetarin e saj, të zgjedhur sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor.

2. Kryetari i bashkisë mund të zgjidhet dhe të ushtrojë vetëm 3 mandate të njëpasnjëshme në krye të bashkisë, me të drejtë rizgjedhjeje.

3. Kryetari i bashkisë, në kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të tij, ndihmohet nga një ose më shumë zëvendëskryetarë. Numri i zëvendëskryetarëve caktohet nga kryetari i bashkisë, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore. Emërimi dhe shkarkimi i tyre bëhen nga kryetari i bashkisë.

4. Zëvendëskryetari i bashkisë nuk mund të jetë anëtar i këshillit bashkiak.

Neni 60

Mandati i kryetarit të bashkisë

1. Mandati i kryetarit të bashkisë vërtetohet nga gjykata e rrethit gjyqësor, (dhoma civile) në juridiksionin e së cilës përfshihet bashkia përkatëse, brenda 20 ditëve nga data e shpalljes së rezultatit të zgjedhjes së tij.

2. Deklarimi i pavlefshmërisë së mandatit të kryetarit bëhet kur vërehet se nuk plotësohen kushtet, sipas nenit 45 të Kushtetutës dhe dispozitave përkatëse të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

3. Shpallja e vlefshmërisë së mandatit të kryetarit të bashkisë bëhet në mbledhjen më të parë të këshillit bashkiak përkatës, ku kryetari bën betimin, sipas formulës së përcaktuar në nenin 50, të këtij ligji,

dhe e nënshkruan atë.

4. Ushtrimi i mandatit të kryetarit të bashkisë fillon në çastin kur bën betimin dhe përfundon kur bën betimin kryetari pasardhës.

5. Në rast se këshilli bashkiak nuk mbledhet brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, prefekti organizon ceremoninë e betimit të kryetarit të bashkisë në mjedisin e bashkisë dhe në praninë e banorëve të njësisë përkatëse.

Neni 61

Përfundimi para kohe i mandatit të kryetarit të bashkisë

1. Mandati i kryetarit të bashkisë përfundon përpara afatit në rastet kur kryetari:

- a) nuk pranon të bëjë betimin;
- b) jep dorëheqjen;
- c) nuk është më banor i përhershëm i bashkisë ku është zgjedhur;
- ç) shkarkohet, sipas nenit 62 të këtij ligji;
- d) kandidon për deputet;
- dh) humbet zotësinë juridike për të vepruar me vendim gjykate të formës së prerë;
- e) vdes.

2. Kryetari i bashkisë në rastet e dorëheqjes e depoziton atë pranë këshillit bashkiak përkatës. Sekretari i këshillit, për ndjekjen e procedurave të nevojshme, njofton prefektin për dorëheqjen e kryetarit.

3. Për rastet e përfundimit të mandatit të kryetarit përpara afatit, këshilli bashkiak njofton Këshillin e Ministrave nëpërmjet prefektit.

4. Në rastet e përfundimit të parakohshëm të mandatit, organizohen zgjedhjet e pjesshme për kryetarin e bashkisë, në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

5. Me përfundimin para kohe të mandatit të kryetarit të bashkisë, sipas këtij neni, deri në zgjedhjen e kryetarit të ri, funksionet e tij i kryen zëvendëskryetari i bashkisë. Në rastet kur ka më shumë se një zëvendëskryetar bashkie, këshilli përkatës, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të tij, cakton një nga zëvendëskryetarët të kryejë funksionet e kryetarit deri në zgjedhjen e kryetarit të ri.

6. Në rastin kur vendi i kryetarit të bashkisë mbetet vakant gjatë 6 muajve të fundit të mandatit të tij, këshilli përkatës zgjedh nga radhët e veta një kryetar të ri me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të tij, i cili ushtron funksionet deri në përfundim të mandatit.

Neni 62

Shkarkimi i kryetarit të bashkisë

Kryetari i bashkisë shkarkohet me vendim të Këshillit të Ministrave në rastet kur:

- a) kryen shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve;
- b) dënohet për kryerjen e një vepre penale, me vendim të formës së prerë, nga gjykata;
- c) propozohet për shkarkim nga këshilli bashkiak përkatës për mosparaqitje në detyrë për një periudhë 3-mujore të pandërprerë.

Neni 63

Simboli i kryetarit të bashkisë

1. Simboli dallues i kryetarit të bashkisë është një shirit me ngjyrat e flamurit kombëtar, me gjerësi 111 mm, i ndarë në tre sektorë me gjerësi të njëjtë, i kuq - i zi - i kuq.

2. Simboli dallues vendoset krahaqafë, nga supi i djathtë në ijen e majtë.

3. Kryetari e mban detyrimisht këtë shirit në mbledhjet solemne, pritjet zyrtare, ceremonitë

publike dhe në ceremonitë e lidhjes së martesave.

Neni 64

Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë

Kryetari i bashkisë ka këto kompetenca dhe detyra:

- a) ushtron të gjitha kompetencat në kryerjen e funksioneve të bashkisë, me përjashtim të atyre që janë kompetencë vetëm e këshillit përkatës;
- b) zbaton aktet e këshillit;
- c) merr masa për përgatitjen e materialeve të mbledhjeve për këshillin bashkiak, në përputhje me rendin e ditës së përcaktuar nga këshilli, si dhe për probleme që kërkon ai vetë;
- ç) raporton në këshill për gjendjen ekonomiko-financiare të bashkisë dhe njërive administrative përbërëse të paktën çdo 6 muaj ose sa herë kërkohet nga këshilli;
- d) raporton para këshillit sa herë kërkohet prej tij për probleme të tjera që kanë të bëjnë me funksionet e bashkisë;
- dh) është anëtar i këshillit të qarkut;
- e) emëron, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, zëvendëskryetarin/zëvendëskryetarët e bashkisë dhe i shkarkon ata;
- ë) emëron, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, administratorët e njërive administrative /lagjeve dhe i shkarkon ata;
- f) vendos për emërimin ose shkarkimin e anëtarëve të organeve drejtuese të shoqërive tregtare në pronësi të bashkisë, si dhe drejtuesit e ndërmarrjeve e të institucioneve në varësi;
- g) emëron dhe shkarkon punonjësit e tjerë të strukturave dhe njërive në varësi të bashkisë, përveç kur parashikohet ndryshe në ligjin për nëpunësin civil;
- gj) ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar bashkisë si person juridik dhe është përfaqësuesi i saj në marrëdhëniet me të tretët;
- h) merr masa për kualifikimin dhe trajnimin e personelit të administratës, të institucioneve arsimore, sociale, kulturore e sportive;
- i) kthen për rishqyrtim jo më shumë se një herë në këshill vendime, kur vëren se ato cenojnë interesat e bashkësisë. Në rastin e kthimit të vendimit të këshillit nga kryetari i bashkisë, këshilli mund të miratojë të njëjtin vendim vetëm me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve;
- j) miraton strukturën, organikën e kategoritë /klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë të administratës së bashkisë dhe të njërive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- k) emëron dhe shkarkon nëpunësit vendorë për barazinë gjinore;
- l) kujdeset për mbledhjen dhe përpunimin e statistikave vendore, të ndara sipas gjinisë, dhe siguron publikimin e tyre.

KREU XI

DREJTIMI DHE FUNKSIONIMI I STRUKTURAVE ADMINISTRATIVE TË BASHKISË

Neni 65

Administrata e njësisë administrative

1. Në njësitë administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori.
2. Administratori emërohet dhe shkarkohet nga kryetari i bashkisë dhe është përgjegjës para tij për funksionimin dhe veprimtarinë e administratës. Administratori duhet të ketë vendbanimin në njësinë administrative përkatëse.
3. Struktura dhe organika e administratës së njërive administrative janë pjesë të strukturës dhe

organikës së administratës së bashkisë.

Neni 66

Detyrat e administratës së njësisë administrative

Administrata e njësisë administrative kryen këto detyra:

- a) është zyrë e shërbimit për të gjitha procedurat administrative në kompetencën e bashkisë;
- b) mbikëqyr territorin për zbatimin e ligjit në të gjitha fushat në kompetencën e bashkisë dhe njofton strukturat kompetente të bashkisë në rast të konstatimit të veprimeve në kundërshtim me ligjin;
- c) mbështet punën e strukturave kompetente të bashkisë;
- ç) bazuar në vendimmarrjen e kryetarit të bashkisë, mund të administrojë parqet, lulishtet dhe zonat e gjelbëruara;
- d) bazuar në vendimmarrjen e kryetarit të bashkisë, mund të administrojë tregjet publike;
- dh) bazuar në vendimmarrjen e kryetarit të bashkisë, mund të administrojë këndet e lojërave, terrenet sportive, bibliotekat, shtëpitë dhe klubet e rinisë;
- e) përgatit dhe i propozon kryetarit të bashkisë planin për investimet nën juridiksionin e saj territorial, si dhe mbikëqyr, pas miratimit, zbatimin e tyre, sipas ligjit;
- ë) propozon, sipas ligjit, emërtimin e rrugëve, shesheve, institucioneve dhe objekteve që janë nën juridiksionin e saj territorial;
- f) mbështet, koordinon dhe mbikëqyr veprimtarinë e kryetarëve e të kryesive të fshatrave;
- g) i propozon kryetarit të bashkisë dhënien e titujve të nderit dhe stimujve për personat nën juridiksionin e saj territorial;
- gj) propozon marrjen e nismave në dobi të komunitetit me mundësi të barabarta dhe përfitime nga të gjithë brenda juridiksionit të saj territorial;
- h) kryen çdo funksion tjetër të deleguar nga kryetari i bashkisë.

Neni 67

Administrimi i lagjes

1. Në rastin e krijimit të lagjeve, sipas pikës 3, të nenit 6, të këtij ligji, në secilën lagje krijohet dhe funksionon administrata e lagjes, që drejtohet nga administratori i lagjes. Administratori i lagjes emërohet dhe shkarkohet nga kryetari i bashkisë dhe është përgjegjës para tij.

2. Administrata e lagjes kryen të gjitha detyrat administrative, të ngarkuara nga kryetari i bashkisë, si dhe kujdeset për zhvillimin ekonomik vendor, për përdorimin e burimeve të përbashkëta dhe sigurimin e harmonisë sociale në lagjen përkatëse. Detyrat më të hollësishme përcaktohen në aktet e nxjerra nga kryetari i bashkisë.

KREU XII

FUNKSIONIMI I STRUKTURAVE KOMUNITARE NË BASHKI

Neni 68

Struktura komunitare në qytet

1. Në qytete, në bazë të iniciativës qytetare, ngrihen dhe funksionojnë këshillat komunitarë të lagjeve. Këshillat përbëhen nga banorë të lagjes dhe organizohen mbi baza vullnetare.

2. Këshillat bashkiakë përcaktojnë rregullat e përgjithshme të organizimit e të funksionimit të këshillave komunitarë të lagjeve dhe marrëdhëniet që ato kanë me bashkinë dhe strukturat e saj.

3. Nga radhët e anëtarëve të këshillave komunitarë zgjidhen ndërlydhësit komunitarë që drejtojnë dhe organizojnë punën e këshillave.

4. Si rregull, në çdo lagje krijohet një këshill komunitar. Këshilli bashkiak mund të vendosë që në një lagje të krijohen më shumë se dy këshilla komunitarë ose bashkimin e këshillave të dy apo më shumë lagjeve.

Neni 69

Detyrat dhe të drejtat e këshillit dhe ndërlidhësit komunitar

1. Ndërlidhësi dhe këshilli komunitar mund të mbështesin funksionet qeverisëse të bashkisë në lagjen e tyre dhe mund të zbatojnë projekte në dobi dhe përfitim të komunitetit.

2. Këshillat komunitarë, në bazë të vendimeve të këshillave bashkiakë, kanë të drejtë të kryejnë funksione dhe kompetenca të caktuara që mund t'u delegohen nga këshilli. Në këtë rast, këshilli bashkiak vendos edhe për masën e financimit apo bashkëfinancimit për kryerjen e funksionit apo kompetencës së deleguar, të cilat nuk mund të përdoren në asnjë rast për shpërblime apo pagesa për anëtarët e këshillit komunitar.

3. Ndërlidhësi komunitar mund të shpërblehet për punën që kryen, sipas kriterëve të përcaktuara nga këshilli bashkiak, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Detyrat më të hollësishme të tyre përcaktohen në rregulloret dhe urdhëresat e këshillit bashkiak.

Neni 70

Struktura komunitare në fshat

1. Fshati drejtohet nga kryetari dhe kryesia e fshatit. Kryesia është organ këshillimor i kryetarit. Anëtarët e kryesisë së fshatit zgjidhen në mbledhje të fshatit, ku marrin pjesë jo më pak se gjysma e banorëve me të drejtë vote. Përbërja e kryesisë së fshatit duhet të respektojë ligjin për barazinë gjinore. Mënyrat dhe rregullat e votimit përcaktohen nga këshilli bashkiak përkatës.

2. Numri i anëtarëve të kryesisë së fshatit përcaktohet nga këshilli bashkiak në bazë të numrit të banorëve të fshatit dhe lagjeve përbërëse të tij.

3. Kryetari i fshatit zgjidhet nga kryesia e fshatit nga radhët e anëtarëve të kryesisë së fshatit.

4. Zgjedhjet e kryesisë së fshatit bëhen një herë në katër vjet, pas zgjedhjeve për këshillin bashkiak dhe jo më vonë se tre muaj pas këtyre zgjedhjeve. Në rast mosrespektimi të këtij afati, deri në zgjedhjen e kryesisë së fshatit, kryetari i bashkisë emëron përkohësisht kryetarin e fshatit. Në rastet e krijimit të vendit vakant për anëtar të kryesisë zhvillohen procedurat e sipërpërmendura të zgjedhjes për vendin vakant. Mandati i të zgjedhurit të ri vazhdon deri në përfundim të periudhës së mbetur të afatit katërvjeçar.

5. Procesi i zgjedhjes dhe veprimtaria e kryesisë së fshatit mbikëqyren nga këshilli bashkiak përkatës.

Neni 71

Detyrat dhe të drejtat e kryetarit dhe të kryesisë së fshatit

1. Kryetari dhe kryesia e fshatit kryejnë dhe mbështesin funksionet vetëqeverisëse të bashkisë në fshatin e tyre, si dhe kujdesen për zhvillimin ekonomik vendor, përdorimin e burimeve të përbashkëta dhe sigurimin e harmonisë sociale.

2. Bazuar në vendimin e kryetarit të bashkisë, kryetari ose kryesia e fshatit mund të kryejë edhe detyrat si më poshtë:

a) kujdesjen për parandalimin e ndërhyrjeve të paligjshme në rrjetin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve të ujërave të bardha dhe ujërave të ndotura, të kanaleve mbrojtëse të zonave të banuara, si dhe rrjetit të kanaleve tretësore të ujitjes dhe kullimit;

b) kujdesjen për parandalimin e ndërhyrjeve të paligjshme dhe të çdolloj dëmtimi të rrugëve, trotuareve dhe shesheve publike në fshat;

c) administrimin e varrezave të fshatit;

ç) kujdesjen për ruajtjen e pyjeve dhe kullotave, si dhe të burimeve natyrore.

3. Detyrat më të hollësishme të tyre përcaktohen në rregulloret dhe urdhëresat e këshillit bashkiak.

4. Kryetari pajiset me vulë dhe ka autoritetin të lëshojë vërtetime për fakte e të dhëna për banorët ose territorin e fshatit të tij, për të cilat ai është në dijeni, sa herë që kjo kërkohet nga bashkia, nga vetë banorët ose nga çdo institucion tjetër, në përputhje me ligjin.

5. Urdhëresat, vendimet dhe urdhrat e organeve të zgjedhura të bashkisë përkatëse janë të detyrueshme për zbatim nga kryetari dhe kryesia e fshatit.

6. Kryetari i fshatit shpërblehet për punën që kryen, sipas kritereve të përcaktuara nga këshilli bashkiak, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7. Kryetari i fshatit mund të thirret në mbledhjet e këshillit bashkiak ose merr pjesë në to me nismën e tij pa të drejtë vote. Ai ka të drejtë të shprehë mendimin e tij në mbledhje për çështje që janë të lidhura me fshatin përkatës.

KREU XIII
PËRBËRJA, KRIJIMI, MËNYRA
E ORGANIZIMIT
DHE KOMPETENCAT E KËSHILLIT
TË QARKUT

Neni 72

Përbërja e këshillit të qarkut

1. Këshilli i qarkut përbëhet nga përfaqësues të bashkive që bëjnë pjesë në qark.
2. Kryetarët e bashkive që bëjnë pjesë në qark janë kurdoherë anëtarë të këshillit të qarkut.
3. Numri i anëtarëve të këshillit të qarkut përcaktohet sipas nenit 73 të këtij ligji.
4. Funkzioni i anëtarit të këshillit të qarkut është i papajtuësëm me çdo funksion në administratën e qarkut.
5. Anëtarët e këshillit të qarkut kryejnë funksionin pa shpërblim, me përjashtim të anëtarëve që janë zgjedhur anëtarë të kryesisë së këshillit të qarkut.

Neni 73

Përcaktimi i numrit të anëtarëve të këshillit të qarkut

1. Numri i përfaqësuesve të bashkive në këshillin e qarkut caktohet në përpjesëtim me numrin e popullsisë, si më poshtë:
 - Bashkitë me popullsi deri në 20 000 banorë, 2 përfaqësues.
 - Bashkitë me popullsi 20 001 deri në 50 000 banorë, 4 përfaqësues.
 - Bashkitë me popullsi 50 001 deri në 100 000 banorë, 5 përfaqësues.
 - Bashkitë me popullsi mbi 100 000 banorë, 5 + nga një përfaqësues shtesë për çdo 1 deri në 50 000 banorë mbi 100 000 banorë.
2. Brenda numrit të përfaqësuesve për çdo bashki, sipas pikës 1, të këtij neni, përfshihet kryetari i bashkisë, si dhe përfaqësuesit e tjerë që zgjidhen nga këshilli i bashkisë.
3. Prefekti përcakton numrin e përfaqësuesve të çdo bashkie, që përfshihen në territorin e qarkut, duke u bazuar në të dhënat e numrit të popullsisë, sipas evidencave të zyrave të gjendjes civile të datës 1 janar të vitit të zgjedhjeve vendore.
4. Vendimet e këshillave bashkiakë për përfaqësuesit e tyre në këshillin e qarkut i dërgohen prefektit brenda 10 ditëve nga data e marrjes së tyre.

Neni 74

Mbledhja e parë e këshillit të qarkut

1. Këshilli i qarkut zhvillon mbledhjen e tij të parë jo më vonë se 50 ditë nga data e shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve vendore.

2. Mbledhja e parë thirret nga kryetari i bashkisë, qendër e qarkut, ose nga një e treta e anëtarëve të këshillit të qarkut. Njoftimi për mbledhjen e këshillit të qarkut i dërgohet me shkrim të gjithë anëtarëve të këshillit të qarkut jo më vonë se 10 ditë para datës së mbledhjes.

3. Mbledhja e parë e këshillit është e vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se gjysma e të gjithë anëtarëve të tij.

4. Mbledhja e parë e këshillit, deri në zgjedhjen e kryetarit të këshillit të qarkut, drejtohet nga anëtari më i vjetër në moshë.

5. Në mbledhjen e tij të parë këshilli i qarkut:

a) zgjedh komisionin e mandateve, i cili verifikon mandatet e anëtarëve të këshillit;

b) vërteton mandatet e anëtarëve të këshillit;

c) zgjedh kryetarin, zëvendëskryetarin dhe kryesinë e këshillit të qarkut, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore.

6. Këshilli i qarkut konstituohet pas vërtetimit të mandateve të jo më pak se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij.

7. Nëse nuk sigurohet pjesëmarrja e gjysmës së të gjithë anëtarëve të këshillit të qarkut, mbledhja anulohet dhe thirret çdo dhjetë ditë, derisa të sigurohet shumica e nevojshme.

8. Në rast se këshilli i qarkut nuk konstituohet deri në 90 ditë pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve vendore, prefekti ushtron të gjitha funksionet dhe kompetencat e këtij këshilli deri në çastin e konstituimit.

Neni 75

Mandati i këshilltarit të qarkut

1. Mandatin e këshilltarit të qarkut e fitojnë të gjithë kryetarët e bashkive përbërëse të tij menjëherë me marrjen e mandatit përkatës.

2. Zgjedhja e anëtarëve të këshillit të qarkut përfaqësues nga radhët e këshillit bashkiak, në përputhje me nenin 48, të këtij ligji, bëhet me votimin e listës shumemërore të kandidatëve dhe shpallet fitues kandidati ose kandidatët që kanë marrë më shumë vota.

3. Anëtarit të këshillit të qarkut i mbaron mandati kur:

a) jep dorëheqjen;

b) vdes;

c) humbet mandatin si kryetar apo këshilltar i bashkisë;

ç) vërtetohet se mandati është fituar në mënyrë të paligjshme.

4. Në rastin e krijimit të vendit vakant, që lidhet me humbjen e mandatit të anëtarit të këshillit të qarkut nga një anëtar i këshillit të një bashkie, ai zëvendësohet nga këshilli bashkiak përkatës, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore.

5. Në rast se vendi vakant krijohet nga humbja e mandatit të anëtarit të këshillit të qarkut nga një kryetar bashkie në 6 muajt e fundit të mandatit, vendin e tij e zë kryetari i zgjedhur nga këshilli bashkiak përkatës.

Neni 76

Funksionimi i këshillit të qarkut

1. Këshilli i qarkut ushtron kompetencat nga çasti i konstituimit të tij deri në konstituimin e këshillit pasardhës.

2. Mbledhja e radhës e këshillit të qarkut bëhet jo më pak se një herë në tre muajt.

3. Mbledhjet zhvillohen sipas programit të punës që bën këshilli.

4. Këshilli i qarkut mblidhet jashtë radhe me kërkesë:
 - a) të kryetarit të tij;
 - b) të kryesisë së këshillit;
 - c) të një të tretës së anëtarëve të këshillit;
 - ç) të prefektit për çështje që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tij.
5. Thirrja e mbledhjes së këshillit bëhet nga kryetari.
6. Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet, si rregull, jo më pak se 10 ditë para datës së zhvillimit të mbledhjes. Njoftimi përmban datën e mbledhjes, orën, vendin dhe rendin e ditës.
7. Mbledhja e këshillit të qarkut quhet e vlefshme, kur në të merr pjesë shumica e të gjithë anëtarëve të tij.

Neni 77

Detyrat dhe kompetencat e këshillit të qarkut

Këshilli i qarkut ushtron këto kompetenca dhe detyra:

- a) zgjedh nga përbërja e vet komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet;
- b) zgjedh nga anëtarët e këshillit kryetarin, zëvendëskryetarin dhe anëtarët e kryesisë, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, dhe i shkarkon ata;
- c) emëron dhe shkarkon sekretarin e këshillit të qarkut;
- ç) miraton strukturën, organikën dhe kategoritë /klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë të administratës së qarkut, të njësisve e të institucioneve buxhetore në varësi të qarkut, si dhe numrin e personelit të tyre, kërkesat për kualifikim, pagat dhe mënyrat e shpërbimit të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- d) miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare dhe të personave të tjerë juridikë që krijon vetë ose me të cilët është bashkë-themelues;
- dh) miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij;
- e) miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve;
- ë) organizon dhe mbikëqyr kontrollin e brendshëm;
- f) vendos për taksat e tarifat në kompetencë të qarkut, si dhe për nivelin e tyre;
- g) vendos për marrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve;
- gj) vendos për krijimin e një personi juridik me njësi të tjera të vetëqeverisjes vendore, përfshirë subjektin e kompetencave të përbashkëta, sipas nenit 14 të këtij ligji;
- h) emëron dhe shkarkon drejtuesit e ndër-marrjeve dhe të institucioneve në varësi të tij;
- i) vendos për fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së vet;
- j) vendos për vërtetimin dhe heqjen e mandatit të këshilltarit të qarkut, sipas nenit 75 të këtij ligji;
- k) miraton norma, standarde e kritere për rregullimin e disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik në nivel qarku;
- l) vendos për simbolet e qarkut;
- ll) jep tituj nderi dhe stimuj;
- m) vendos për rregullat, procedurat dhe mënyrat e realizimit të funksioneve të deleguara, në bazë dhe në zbatim të ligjit me të cilin bëhet ky delegim në qark;
- n) miraton ose shfuqizon vendimet e kryesisë së këshillit të qarkut.

Neni 78

Votimi

1. Vendimet e këshillit të qarkut merren me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve, me përjashtim të rasteve të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “ë”, “f”, “g”, “gj” e “ll”, të nenit 77, të këtij ligji, që kërkojnë votat e më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të këshillit.

Vendimet merren me jo më pak se tre të pestat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit për rastin e parashikuar në shkronjën “e”, të nenit 77, të këtij ligji.

2. Në rastet e votimit për kryetarin, zëvendës-kryetarin dhe sekretarin e këshillit, kur nuk sigurohet shumica e kërkuar, votimi ribëhet midis dy kandidatëve, që në raundin e parë kanë fituar numrin më të madh të votave. Në rast se edhe pas këtij votimi kandidatët kanë numër të barabartë votash, fituesi caktohet me short.

3. Vendimet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data e marrjes së tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Vendimet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre subjekteve që përfshihen në to.

Neni 79

Mbledhjet e hapura, seancat e këshillimeve dhe e drejta e publikut për t'u informuar

Këshilli i qarkut zhvillon mbledhje të hapura për publikun, zhvillon seanca këshillimi me organet përfaqësuese e ekzekutive të bashkive dhe me bashkësitë përkatëse, si dhe respekton të drejtën e publikut për t'u informuar, sipas përcaktimeve në nenet 17 dhe 18 të këtij ligji.

Neni 80

Pengesa ligjore për anëtarët e këshillit të qarkut

Anëtari i këshillit të qarkut është në kushtet e pengesës ligjore, në rastet e parashikuara në pikën 1, të nenit 52, të këtij ligji, dhe për të zbatohet nga kryetari i këshillit të qarkut kompetenca dhe procedura e parashikuar në pikat 2, 3 dhe 4, të nenit 52, të këtij ligji.

Neni 81

Kryesia e këshillit të qarkut

1. Kryesia e këshillit të qarkut përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari dhe nga 3 deri në 5 anëtarë të tjerë.

2. Kryetari dhe zëvendëskryetari zgjidhen e shkarkohen me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Kur nuk arrihet shumica e kërkuar, kalohet në rivotim ndërmjet dy kandidatëve që kanë fituar numrin më të madh të votave në raundin e parë.

3. Anëtarët e tjerë të kryesisë së këshillit të qarkut zgjidhen dhe shkarkohen me votim, me listë shumemërore kandidatësh, dhe shpallen fitues kandidatët që kanë marrë më shumë vota.

4. Kryesia e këshillit të qarkut thirret në mbledhje nga kryetari, jo më pak se një herë në muaj.

5. Mbledhjet e kryesisë janë të vlefshme kur marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve.

6. Funkcionet e kryetarit, zëvendëskryetarit dhe sekretarit të këshillit të qarkut janë të papajtueshme me funksionin e kryetarit të bashkisë.

Neni 82

Kompetencat e kryesisë së këshillit të qarkut

1. Kryesia e këshillit të qarkut ka këto kompetenca dhe detyra:

a) ushtron të gjitha kompetencat, me përjashtim të atyre që i janë dhënë shprehimisht këshillit të qarkut;

b) miraton projektaktet dhe materialet e tjera për mbledhjen e këshillit të qarkut, në përputhje me rendin e ditës, të përcaktuar nga këshilli, si dhe për probleme të kërkuara nga ajo vetë;

c) raporton në këshill për gjendjen ekonomiko-financiare, të paktën çdo 6 muaj ose më shpesh, sa herë kërkohet nga këshilli;

ç) raporton në këshill sa herë kërkohet prej tij për probleme të tjera që kanë të bëjnë me funksionet e qarkut;

d) ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar qarkut si person juridik.

2. Në ushtrimin e kompetencave të saj, kryesia e këshillit të qarkut nxjerr vendime, të cilat miratohen nga shumica e anëtarëve të pranishëm. Vendimet marrin fuqi detyruese për t'u zbatuar nga të gjitha organet dhe personat e ngarkuar, pasi shpallen publikisht ose u bëhen të njohura subjekteve të interesuara.

3. Vendimet e kryesisë duhet të miratohen në mbledhjen më të afërt të këshillit të qarkut, në të kundërt e humbasin fuqinë e tyre që nga fillimi.

Neni 83

Kryetari i këshillit të qarkut

1. Kryetari i këshillit të qarkut përfaqëson këshillin e qarkut në marrëdhënie me organe shtetërore, me organet e njërive të vetëqeverisjes vendore, me persona fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, si dhe ushtron këto kompetenca:

a) kryeson mbledhjet e këshillit të qarkut dhe të kryesisë së tij;

b) nënshkruan të gjitha aktet dhe procesverbalet e mbledhjeve të këshillit dhe të kryesisë së këshillit;

c) siguron zbatimin e vendimeve të këshillit të qarkut dhe të kryesisë së tij;

ç) në përputhje me tematikën e mbledhjeve të këshillit të qarkut dhe të kryesisë, përgatit raportet, projektvendimet dhe materialet e tjera të nevojshme;

d) drejton administratën e këshillit të qarkut dhe përgjigjet para këshillit për funksionimin e saj;

dh) emëron dhe shkarkon personelin e administratës së këshillit të qarkut, përveç rasteve të parashikuara ndryshe në ligjin për nëpunësin civil;

e) garanton kryerjen e funksioneve që i janë dhënë me ligj këshillit të qarkut;

ë) merr masa dhe siguron funksionim normal të të gjitha strukturave të këshillit, të mbledhjeve të këshillit dhe të kryesisë së tij;

f) ushtron kompetenca të tjera, që i ngarkohen me ligj, nga këshilli i qarkut ose nga kryesia e tij.

2. Në ushtrimin e kompetencave të tij, kryetari i këshillit të qarkut nxjerr urdhra me karakter individual.

3. Në mungesë të kryetarit, funksionet e tij kryhen nga zëvendëskryetari.

Neni 84

Sekretari i këshillit të qarkut

Sekretari i këshillit të qarkut kryen detyrat e tij njëloj me ato të sekretarit të këshillit bashkiak, të përcaktuara në nenin 57 të këtij ligji.

Neni 85

Kufizimi i autoritetit të qarkut

Vendimet e organeve të qarkut nuk mund të cenojnë autonominë e bashkive përbërëse.

KREU XIV

RIORGANIZIMI I ADMINISTRATIVO-TERRITORIAL I VETËQEVERISJES VENDORE

Neni 86

Riorganizimi administrativo-territorial

Ndarja administrativo-territoriale në fuqi mund të riorganizohet me ose pa ndryshim të kufijve

ekzistues të njërive të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me interesat ekonomikë e socialë, traditën, kulturën, lidhjet tradicionale dhe vlerat e tjera vendore, për realizimin në një nivel më të lartë të funksioneve në përfitim të bashkësisë vendore ose për zbatimin e politikave të zhvillimit vendor, rajonal dhe më gjerë.

Neni 87

Riorganizimi me ndryshim kufijsh

Riorganizimi me ndryshim të kufijve bëhet kur:

- a) një njësi e vetëqeverisjes vendore ndahet në mënyrë të plotë në dy a më shumë njësi më vete të vetëqeverisjes vendore;
- b) dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore shkrihen për të formuar së bashku në territorin tyre një njësi të vetme të vetëqeverisjes vendore;
- c) një pjesë e territorit të një njësie të vetë-qeverisjes vendore kalon në territorin dhe administrimin e një njësie tjetër të vetëqeverisjes vendore;
- ç) kërkohet një kombinim i rasteve të sipër-përmendura.

Neni 88

Riorganizimi pa ndryshim kufijsh

Riorganizimi pa ndryshim kufijsh bëhet në rastet e ndryshimit të emërimit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose në rastet e ndryshimit të vendndodhjes së qendrës të saj.

Neni 89

Mbështetja ligjore dhe propozuesi i riorganizimit

Riorganizimi i ndarjes administrativo-territoriale me ose pa ndryshim kufijsh bëhet me ligj të veçantë. Propozimi për riorganizimin e një ose më shumë njërive të vetëqeverisjes vendore, për çdo rast të veçantë, i paraqitet Kuvendit së bashku me këto fakte dhe argumente:

- a) arsyet ekonomike, sociale, kulturore, demo-grafike, administrative për nevojën dhe avantazhet e riorganizimit;
- b) mendimin e popullatës që banon në njësitë e vetëqeverisjes vendore që do të riorganizohet;
- c) hartat administrativo-territoriale, në të cilat pasqyrohen edhe ndryshimet që rrjedhin nga riorganizimi;
- ç) mënyrat e rregullimit të çështjeve financiare, të detyrimeve ndaj të tretëve ose ndaj njëra-tjetrës të njërive të qeverisjes vendore, të përfshira në riorganizim.

Neni 90

Detyrimi për të shprehur mendimin

1. Këshillat bashkiakë dhe të qarqeve, që janë të përfshirë drejtpërdrejt në riorganizim, si dhe kryetarët e tyre japin mendimin e tyre zyrtar dhe, nëse ka, edhe mendimin “kundër” të një pjese të këshilltarëve të këshillit përkatës.

2. Këshilli i Ministrave, kur ky i fundit nuk është propozues, dhe institucione të tjera shtetërore qendrore, që nuk varen nga Këshilli i Ministrave, të interesuara për riorganizimin përkatës, japin mendimin e tyre të argumentuar “pro” ose “kundër” ndaj këtij riorganizimi.

3. Organet e sipërpërmendura japin mendimin brenda 60 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për shprehje mendimi nga ana e propozuesit.

Neni 91

Rregullimi i të drejtave dhe detyrimeve të njërive të riorganizuara

1. Në çdo rast, kur riorganizimi prek çështje të të drejtave financiare, pasurore, të detyrimeve ndaj të tretëve dhe të drejta të tjera civile të njërive të vetëqeverisjes vendore, ato rregullohen sipas

legjislacionit në fuqi si të drejta dhe detyrime të personave juridikë, si rregull, nëpërmjet marrëveshjes mes palëve.

2. Në rast mosmarrëveshesh për problemet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, konfliktet zgjidhen në rrugë gjyqësore.

Neni 92

Garantimi i vazhdimit të funksioneve bazë qeverisëse

1. Në rastin e riorganizimit me ndryshim kufijsh, që krijon njësi të reja të vetëqeverisjes vendore, ose kur ky riorganizim shkakton papajtueshmëri të mandatit të shumicës së anëtarëve të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, së cilës i largohet një pjesë e territorit, në këto njësi kryhen zgjedhje vendore të pjesshme, sipas mënyrave dhe afateve të parashikuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

2. Organet e reja të vetëqeverisjes vendore, si dhe organet e tjera shtetërore qendrore e vendore kompetente marrin menjëherë masat e nevojshme që njësitë e vetëqeverisjes vendore, të krijuara ose të prekura nga riorganizimi, të funksionojnë normalisht, sipas këtij ligji, duke garantuar kryerjen e shërbimeve bazë publike për popullatën përkatëse për periudhën transitore.

3. Procedurat dhe masat për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër shtetëror në njësitë e vetë-qeverisjes vendore, të krijuara ose të prekura nga riorganizimi, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 93

Përditësimi i kufijve administrativo-territorialë

1. Këshilli i Ministrave, bazuar në ligjin në fuqi për ndarjen administrativo-territoriale, miraton me vendim hartën e përditësuar të kufijve administrativo-territorialë të njësisë të vetë-qeverisjes vendore, sipas standardeve të përcaktuara gjeohapësinore. Kjo hartë përditësohet çdo 10 vjet.

2. Këshillat bashkiakë, bazuar në ligjin në fuqi për ndarjen administrativo-territoriale, miratojnë me vendim hartën e përditësuar të kufijve ndarës administrativo-territorialë të njësisë administrative dhe fshatrave në përbërje të tyre, sipas standardeve të përcaktuara gjeohapësinore.

KREU XV

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 94

Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore të përcaktuara në nenet 12, pika 3, dhe 93, pika 1, të këtij ligji.

Neni 95

Dispozitë kalimtare

1. Deri në datën 31 dhjetor 2017, në çdo njësi administrative funksionon administrata e njësisë administrative. Nga 1 janari 2018, këshilli i bashkisë ka kompetencën të vendosë për riorganizimin e administratave të njësisë administrative, të cilat mund të mbulojnë territorin e një ose më shumë njësisë administrative brenda bashkisë, sipas nevojave të komuniteteve vendore dhe efekt-shmërisë administrative.

2. Pavarësisht nga përcaktimet e bëra në nenin 54, shkronja “i”, të këtij ligji, përbërja ekzistuese e këshillave të qarqeve qëndron në fuqi deri në formimin e këshillave të qarqeve pas zgjedhjeve vendore në vitin 2019. Në rast të krijimit të vendeve vakante, deri në plotësimin e kërkesës së shkronjës “i”, të nenit 54, të këtij ligji, ato plotësohen me kandidatë të gjinisë më pak të përfaqësuar.

3. Funksionet e reja, që u transferohen bashkive me këtë ligj, për një periudhë deri në tre vjet, do të financohen nga buxheti i shtetit me transferta specifike, sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin vjetor të Buxhetit të Shtetit.

Neni 96

Shfuqizime

Ligji nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme, si dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 97

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 17.12.2015

KRYETARI
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 8116, datë 29.3.1996

KODI I PROCEDURËS CIVILE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

(ndryshuar me ligjet nr. 8431, datë 14.12.1998; nr. 8491, datë 27.5.1999; nr. 8535, datë 18.10.1999; nr. 8812, datë 17.5.2001; nr. 9062, datë 8.5.2003; nr. 9953, datë 14.7.2008, nr. 10 052, datë 29.12.2008, nr. 49/2012, datë 19.4.2012; 122/2013, datë 18.4.2013; 160/2013, datë 17.10.2013; nr. 114/2016, datë 3.11.2016; nr. 38/2017, datë 30.3.2017, nr. 44/2021, datë 23.3.2021)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

PJESA E PARË
PJESA E PËRGJITHSHME

TITULLI I
PARIMET THEMELORE TË PROCESIT GJYQËSOR

Neni 1

Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë cakton rregulla të detyrueshme, të njëjta e të barabarta, për gjykimin e mosmarrëveshjeve civile e të mosmarrëveshjeve të tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të veçanta.

Gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështjet që i paraqiten për shqyrtim, me arsyetim se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë.

Neni 2

Vetëm palët mund të vënë në lëvizje gjykatën për fillimin e një procesi gjyqësor, përveç kur ligji parashikon ndryshe.

Palët janë të lira që në çdo kohë të tërheqin padinë, por gjithnjë përpara shuarjes së saj për efekt gjykimi ose në bazë të ligjit.

Neni 3

Kërkesa e palëve për fillimin e një procesi gjyqësor është e lidhur me përmbushjen nga ana e tyre të detyrimeve që rrjedhin prej këtij procesi, në format dhe afatet e parashikuara në këtë Kod.

Neni 4

Gjykata kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor. Për këtë qëllim, në bazë të kompetencave që i jepen nga ky Kod, vendos për afatet dhe urdhëron marrjen e masave të nevojshme.

Neni 5

Objekti i mosmarrëveshjes

Objekti i mosmarrëveshjes përcaktohet në pretendimet e palëve.

Pretendimet parashtrihen në aktin për fillimin e procesit gjyqësor, si dhe gjatë ushtrimit të të drejtave që rrjedhin nga ky proces. Objekti i mosmarrëveshjes mund të ndryshojë sipas kërkesave që lindin gjatë procesit, kur këto të fundit kanë lidhje të mjaftueshme me pretendimet e fillimit.

Neni 6

Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet.

Neni 7

Faktet

Fakt quhet çdo sjellje e njeriut, ngjarje shoqërore ose fenomen i natyrës, të cilit ligji i ngarkon një pasojë juridike.

Neni 8

Palët kanë detyrimin të paraqesin faktet mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre.

Neni 9

Gjykata fton palët për të dhënë shpjegime mbi faktet që ajo i vlerëson të nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Neni 10

Gjykata mbështet vendimin e saj vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor.

Neni 11

Provat

(Ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Provat janë të dhëna që merren prej burimeve dhe sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod dhe ligje të tjera, të cilat vërtetojnë ose rrëzojnë pretendimet ose prapësimet e pjesëmarrësve në proces.

Neni 12

Pala që pretendon një të drejtë, ka detyrim që, në përputhje me ligjin, të provojë faktet mbi të cilët bazon pretendimin e saj.

Neni 13

Faktet e njohura botërisht ose zyrtarisht nuk ka nevojë të provohen.

Faktet, për të cilat ekziston një prezumim ligjor, nuk duhet të provohen nga pala në dobi të së cilës është prezumimi.

Neni 14

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008)

Gjykata ka për detyrë që të zhvillojë një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet garantimit të zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin.

Neni 15

Palët janë të detyruara të japin ndihmesën e tyre për zhvillimin normal të hetimit gjyqësor. Gjykata i ngarkon ato me përgjegjësi në rast mosveprimi ose pengimi me faj të tyre.

Neni 16

E drejta

Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët.

Megjithatë, gjykata nuk mund të ndryshojë bazën juridike të padisë pa kërkesën e palës.

Neni 17

Gjykata fton palët që të japin shpjegime nga pikëpamja e së drejtës që ajo e çmon të nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Neni 18

Kontradiktoriteti

Asnjë palë nuk mund të gjykohet pa u dëgjuar ose pa u thirrur në gjykim.

Neni 19

Palët duhet t'i bëjnë të njohur njëra-tjetrës, në kohën e duhur, mjetet dhe faktet mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre, provat që do të paraqesin dhe dispozitat ligjore që do t'u referohen, në mënyrë që të bëhet e mundur për secilën palë mbrojtja e interesave të tyre në gjykim.

Neni 20

Gjykata duhet të ndjekë dhe të kërkojë të zbatohet parimi i kontradiktoritetit.

Ajo mbështet vendimin e saj vetëm në mjetet, shpjegimet, dokumentet e provat e tjera të treguara ose të sjella nga palët, kur këto të fundit kanë qenë në gjendje të debatojnë sipas parimit të kontradiktoritetit.

Neni 21

Kur ligji e lejon dhe rrethanat e çështjes diktojnë marrjen e një vendimi gjyqësor, pavarësisht nga dijenia e një pale, kjo e fundit ka të drejtën të ankohet në rrugë gjyqësore ndaj vendimit të dhënë.

Neni 22

Mbrojtja

Palët mund të mbrohen vetë, përveç rasteve kur përfaqësimi është i detyrueshëm.

Neni 23

Palët janë të lira të ndërtojnë mbrojtjen e interesave të tyre në gjykim, nëpërmjet përfaqësimit ose të çdo ndihme tjetër juridike, në përputhje me dispozitat në fuqi.

Neni 24

Gjykata dëgjon gjithnjë palët drejtpërsëdrejti, përveç kur ligji parashikon ndryshe.

Neni 25

Pajtimi dhe ndërmjetësimi i palëve
(*ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017*)

Është detyrë e gjykatës që të bëjë përpjekje për të pajtuar palët në mosmarrëveshje dhe/ose të njoftojë e të udhëzojë palët për mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim.

Neni 26

Karakteri publik i procesit gjyqësor
(*Ndryshuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001*)

Seancat gjyqësore janë të hapura, përveç kur parashikohet ndryshe sipas këtij Kodi.

Gjykata mund të mos lejojë pjesëmarrjen e medias, kur çmon se nuk është në dobi të gjykimit. Në çdo rast vendimi përfundimtar i gjykatës shpallet publikisht.

Neni 27

Përdorimi i gjuhës shqipe në gjykim

Në të gjitha fazat e gjykimit përdoret gjuha shqipe.

Personat që nuk dinë shqip, përdorin gjuhën e tyre. Ata marrin dijeni për provat dhe për gjithë zhvillimin e gjykimit me anë të përkthyesit.

Neni 28

Gjykata në procesin gjyqësor civil
(*Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001*)

Gjykata duhet të shprehet për të gjitha kërkesat që parashtrihen në padi, pa i kaluar kufijtë e saj, duke realizuar një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm.

Neni 29

Gjykata mbështet vendimin në provat e paraqitura nga palët ose nga prokurori, të marra në seancë gjyqësore.

Gjykata çmon provat që ndodhen në aktet, në bazë të bindjes së saj të brendshme, të formuar nga shqyrtimi në tërësinë e tyre i rrethanave të çështjes.

Neni 30

Publikimi i vendimit përfundimtar
(*Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001*)

Kur çmohet se publikimi i vendimit përfundimtar i shërben rehabilitimit dhe/ose zhdëmtimit, gjykata, me kërkesën e palës së interesuar, urdhëron publikimin e vendimit në media.

Kur njoftimi nuk jepet në afatin e caktuar nga gjykata, pala, në favorin e së cilës është dhënë vendimi, ka të drejtë të kërkojë publikimin me shpenzimet e personit që detyrohet.

TITULLI II
PADIA

Neni 31

(Ndryshuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Padia është e drejta e personit që bën pretendimin, për t'u dëgjuar, mbi themelin e këtij pretendimi, në mënyrë që gjykata ta shpallë atë të bazuar ose jo.

Pala kundërshtare ka të drejtë të diskutojë dhe të ngrejë prapësime mbi themelin dhe bazueshmërinë në ligj të këtij pretendimi.

Neni 32

(Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Padia mund të ngrihet:

- a) për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur;
- b) për vërtetimin e qenies ose mosqenies së një marrëdhënieje juridike ose një të drejte;
- c) për njohjen e vërtetësisë ose pavërtetësisë së një dokumenti me pasoja juridike për paditësin.

Neni 33

Nuk mund të ngrihet padi nga një person që i mungon zotësia juridike për të vepruar.

Neni 34

Abuzimi me të drejtat në proces
(Ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjykata, në çdo shkallë të gjyqimit, kur konstaton se palët ose përfaqësuesit e tyre me vetëdije paraqesin padi, ankime, kërkesa ose pretendime abuzive, ose të përsëritura dhe me keqdashje, ose kur kërkojnë qëllimisht të zvarrisin gjykimin, ose kur konstatohet se palët ose përfaqësuesit e tyre kanë fshehur ose shtrembëruar me keqbesim ose faj të rëndë, fakte dhe rrethana të rëndësishme që lidhen me çështjen, urdhëron me vendimin që jepet në përfundim të gjyqimit, përveç kur në këtë Kod parashikohet ndryshe, gjobitjen e përgjegjësit në shumën nga 50 000 deri në 100 000 lekë. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas rregullave për vendimet përfundimtare ose jopërfundimtare, në varësi të llojit të vendimit që i jep fund gjyqimit përkatës.

2. Nëse rezulton se pala që ka humbur gjyqin ka vepruar ose është mbrojtur në gjykim me keqbesim ose faj të rëndë, gjykata, me kërkesë të palës tjetër, e ngarkon atë përveçse me pagimin e shpenzimeve gjyqësore, edhe me shpërblimin e dëmit përkatës. Kërkesa për shpërblimin e dëmit paraqitet me shkrim nga pala e interesuar gjatë gjyqimit në shkallë të parë, derisa nuk është deklaruar i mbyllur hetimi gjyqësor dhe i nënshtrohet ankimit dhe ekzekutimit sipas rregullave të përgjithshme.

TITULLI III

GJYKATA, JURIDIKSIONI DHE KOMPETENCAT

KREU I

PËRBËRJA E GJYKATËS

Neni 35

(Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001; nr. 10 052, datë 29.12.2008; shfuqizuar shkronja "b" me ligjin nr. 49/2012; ndryshuar paragrafi i fundit me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013; ndryshuar paragrafi i dytë shkronja "a", paragrafi i katërt dhe i pestë, me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017, ndryshuar fjalia e dytë në paragrafin e katërt, shtuar fjalia pas fjalisë së parë në paragrafin e fundit, me ligjin nr. 44/2021, datë 23.3.2021)

Gjykata e shkallës së parë gjykon me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar ose tre gjyqtarë.

Me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë gjykohen këto çështje:

- a) Paditë me vlerë më shumë se 50 milionë lekë.
 - b) Shfuqizuar.*
 - c) Paditë për shpalljen e zhdukjes ose të vdekjes së personit.
 - ç) Paditë për heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar të personave.
- Çështjet e tjera gjykohen nga një gjyqtar i vetëm.

Gjykata e apelit shqyrton çështjen me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë. Gjykata e apelit shqyrton me një gjyqtar të vetëm ankimet kundër vendimeve për paditë me vlerë deri në njëzetfishin e

* Shfuqizimi ka hyrë në fuqi në datën e fillimit të funksionimit të gjykatave administrative.

pagës minimale në shkallë vendi, që rrjedhin nga marrëdhënie kontraktore, ankimin e veçantë kundër vendimit të refuzimit të kërkesës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, ankimet e veçanta kundër vendimit të gjykatës që ka shqyrtuar kundërshtimin e veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, si dhe rastet e tjera të parashikuara në këtë Kod.

Gjykata e Lartë gjykon në kolegje me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë. Për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë gjykon në kolegje me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë. Gjykata e Lartë gjykon në kolegje të bashkuara me pjesëmarrjen e të gjithë gjyqtarëve, çështjet e parashikuara shprehimisht në dispozita të tjera të këtij Kodi.

KREU II JURIDIKSIONI

Neni 36

(Shtuar paragrafi i pestë me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Në juridiksionin e gjykatave hyjnë të gjitha mosmarrëveshjet civile dhe mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të veçanta.

Juridiksioni gjyqësor civil ushtrohet sipas dispozitave të këtij Kodi dhe ligjeve të tjera.

Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata.

Është e pavlefshme çdo marrëveshje që lidhet në kundërshtim me këtë dispozitë.

Juridiksioni përcaktohet në momentin e paraqitjes së padisë në gjykatë, pavarësisht ndryshimeve të mëpasshme të faktit apo të ligjit.

Neni 37

(Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Juridiksioni i gjykatave shqiptare për personat fizikë dhe juridikë të huaj rregullohet me ligj.

Juridiksioni i gjykatave shqiptare nuk mund t'i kalohet me marrëveshje një juridiksioni të huaj, përveç kur gjykimi ka lidhje me një detyrim ndërmjet të huajve ose ndërmjet një të huaji e një shtetasi shqiptar, ose personi juridik pa banim ose qëndrim në Shqipëri, si dhe kur këto përjashtime janë parashikuar në marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

Neni 38

(Ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur e njëjta padi, midis të njëjtave palë, me të njëjtin shkak dhe objekt padie është duke u shqyrtuar njëkohësisht nga një gjykatë e shtetit të huaj dhe gjykata shqiptare, kjo e fundit mund të pezullojë gjykimin e kësaj mosmarrëveshjeje kur:

a) padia është paraqitur më parë në kohë në gjykatën e shtetit të huaj;

b) vendimi i gjykatës së shtetit të huaj është i mundshëm për t'u njohur dhe/ose ekzekutuar në Republikën e Shqipërisë;

c) gjykata shqiptare bindet se pezullimi është i nevojshëm për administrimin e duhur të drejtësisë.

2. Gjykata shqiptare mund të vazhdojë procesin në çdo kohë nëse:

a) zhduket mundësia e pasjes së dy vendimeve të papajtueshme;

b) gjykimi në gjykatën e shtetit të huaj është pezulluar ose pushuar;

c) gjykata shqiptare bindet se procesi në gjykatën e shtetit të huaj nuk do të përfundojë në kohë të arsyeshme; ose

ç) vazhdimi i gjykimit kërkohet për një administrim më të mirë të drejtësisë.

3. Gjykata shqiptare pushon gjykimin kur gjykata e shtetit të huaj zgjidh mosmarrëveshjen me vendim të formës së prerë, i cili mund të njihet dhe/ose ekzekutohet në Republikën e Shqipërisë.

Neni 39

Juridiksioni ndaj përfaqësive diplomatike e konsullore

(Ndryshuar shkronja "b" me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Anëtarët e përfaqësive diplomatike e konsullore të vendosura në Republikën e Shqipërisë nuk i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave shqiptare, përveç kur:

- a) pranojnë vullnetarisht,
- b) ekzistojnë rastet dhe kushtet e parashikuara nga Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike.

Neni 40

Juridiksioni civil i gjykatave shqiptare nuk shtrihet në përfaqësuesit e shteteve të tjera dhe në grupin e tyre të shoqërimit, kur ata qëndrojnë me ftesë zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KREU III KOMPETENCAT

A.KOMPETENCAT NË LËNDË

Neni 41

(Shtuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Në kompetencë të gjykatës së shkallës së parë janë të gjitha mosmarrëveshjet civile e mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të tjera.

Kompetenca përcaktohet në momentin e paraqitjes së padisë në gjykatë, pavarësisht ndryshimeve të mëpasshme të faktit ose të ligjit.

B. KOMPETENCAT TOKËSORE

Neni 42

Paditë ngrihen në gjykatën e vendit ku i padituri ka vendbanimin ose vendqëndrimin e tij dhe kur këto nuk dihen, në gjykatën e vendit ku ai ka banesën e përkohshme.

Kur i padituri nuk ka vendbanim, as vendqëndrim dhe as banesë të përkohshme në Republikën e Shqipërisë, paditë ngrihen në gjykatën ku banon paditësi.

Neni 43

Kur i padituri është person juridik, paditë ngrihen në gjykatën e vendit ku personi juridik ka qendrën e tij.

Paditë që rrjedhin nga marrëdhënie juridike me një degë ose agjenci lokale të personit juridik, mund të ngrihen edhe në gjykatën ku ka qendrën dega ose agjencia, si dhe në gjykatën e shkallës së parë ku personi juridik ka një ndërtesë me aktivitet ose një përfaqësues të autorizuar që të paraqitet në gjykim për objektin e padisë.

Neni 44

Paditë kundër të miturve që nuk kanë mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç ose kundër personave që u është hequr krejtësisht zotësia për të vepruar, ngrihen në gjykatën e vendit ku ka banimin përfaqësuesi ligjor i tyre.

Neni 45

Paditë për të drejta reale mbi sende të paluajtshme, për pjesëtimin e sendeve të përbashkëta dhe për posedimin ngrihen në gjykatën e vendit ku ndodhen sendet ose pjesa më e madhe e tyre.

Paditë, që rrjedhin nga kallëzimi i një punimi të ri dhe i një dëmi të mundshëm, ngrihen në gjykatën e vendit ku ka ndodhur fakti për të cilin është ngritur padia.

Neni 46

Paditë që rrjedhin nga trashëgimi, paditë për pavlefshmërinë e testamentit dhe ato për pjesëtimin e trashëgimit ngrihen në gjykatën e vendit ku trashëgimlënësi ka pasur banimin e tij të fundit dhe, kur ky nuk dihet, në gjykatën e vendit ku ndodhet e gjithë pasuria ose pjesa më e madhe e saj.

Kur trashëgimlënësi është shtetas shqiptar dhe në kohën e vdekjes së tij nuk e ka pasur banimin në Republikën e Shqipërisë, paditë e parashikuara në paragrafin e parë mund të ngrihen në gjykatën e vendit ku trashëgimlënësi ka pasur banimin e fundit në Republikën e Shqipërisë ose në gjykatën e vendit ku ndodhet pjesa më e madhe e pasurisë së tij. Kur trashëgimlënësi nuk ka pasur në Republikën e Shqipërisë as banim të fundit, as pasuri, paditë si më sipër ngrihen në gjykatën e kryeqytetit.

Neni 47

Paditë për kërkim ushqimi dhe paditë që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës, mund të ngrihen si në gjykatën e vendit ku ka banimin i padituri, ashtu dhe në gjykatën e vendit ku ka banimin paditësi.

Padia për heqjen ose pakësimin e ushqimit të caktuar ngrihet në gjykatën e vendit ku ka banimin i padituri.

Neni 48

Paditë që rrjedhin nga shkaktimi i dëmit mund të ngrihen si në gjykatën e vendit ku ka banimin i padituri, ashtu dhe në gjykatën e vendit ku është shkaktuar dëmi.

Kur kërkohet shpërblimi i dëmit të shkaktuar nga vdekja ose dëmtimi i shëndetit, padia mund të ngrihet edhe në gjykatën e vendit ku banon paditësi.

Neni 49

Paditë, për të kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm mbi sende, ngrihen në gjykatën e vendit ku ndodhen ato ose pjesa më e madhe e vlerës së tyre.

Paditë për të kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm për kryerjen ose moskryerjen e një veprimi të caktuar, ngrihen në gjykatën e vendit ku duhet të përmbushet një detyrim i tillë.

Neni 50

Paditë që kanë për objekt kundërshtimin e veprimeve të kryera nga përmbartuesi për ekzekutimin e detyruar, ngrihen në gjykatën e vendit të ekzekutimit.

Neni 51

Paditë për vërtetimin e qenies ose mosqenies së martesës, për anulimin e martesës dhe për zgjidhjen e saj, mund të ngrihen si në gjykatën e vendit ku bashkëshortët kanë pasur banimin e tyre të përbashkët të fundit ose në gjykatën e vendit ku ka banimin i padituri. Kur i padituri nuk ka banim ose vendqëndrim dhe as banesë të përkohshme në Republikën e Shqipërisë, padia ngrihet në gjykatën e vendit ku ka banimin, vendqëndrimin ose banimin e përkohshëm paditësi dhe kur as paditësi nuk i ka ato, padia ngrihet në gjykatën e kryeqytetit.

Neni 52

Kompetenca tokësore mund të ndryshohet me marrëveshje me shkrim të palëve, përveç rasteve të parashikuara në nenet 45 e 46 të këtij Kodi dhe kur ligji e ndalon këtë marrëveshje.

Neni 53

Kur janë shumë të paditur, që kanë banimin ose vendqëndrimin e tyre në vende të ndryshme, padia mund të ngrihet në gjykatën e vendit ku ka banimin ose vendqëndrimin cilido nga të paditurit.

Neni 54

E drejta e zgjedhjes ndërmjet shumë gjykatave kompetente i takon paditësit, e cila ushtrohet me ngritjen e padisë.

C. NDRYSHIMET E KOMPETENCËS PËR SHKAK TË LIDHJES SË MOSMARRËVESHJEVE

Neni 55

Gjykata që gjykon padinë kryesore është kompetente për të shqyrtuar edhe kërkesat dytësore, kundërpadinë ose ndërhyrjen kryesore. Në këtë rast gjykata merr vendim për bashkimin e tyre në një çështje të vetme.

Neni 56

(Shtuar fjalë në shkronjën "b" me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Gjykata që është kompetente në shqyrtimin e mosmarrëveshjes, me kërkesën e palëve mund të vendosë dërgimin e çështjes në një gjykatë tjetër që është edhe kjo kompetente vetëm kur:

a) në gjykatën tjetër mosmarrëveshja mund të zgjidhet më shpejt dhe më lehtë sesa në gjykatën e zgjedhur nga paditësi;

b) shihet me vend kërkesa e të paditurit, të cilit nuk i dihej vendbanimi ose vendqëndrimi, për gjykimin e mosmarrëveshjes në gjykatën e vendit ku ai ka vendbanimin ose vendqëndrimin e tanishëm.

Neni 57

(Ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur dy ose më shumë padi janë duke u gjykuar në procese të ndryshme dhe lidhen midis tyre për nga objekti ose shkaku, mund të bashkohen në një gjykim të vetëm.

2. Vendimin për bashkimin e çështjeve e merr gjykata në të cilën çështja është regjistruar më parë në kohë.

3. Bashkimi i çështjeve mundet të bëhet me kërkesë të palëve ose kryesisht, derisa nuk është nxjerrë urdhri për caktimin e seancës gjyqësore nga gjykata që merr vendimin.

4. Në rastin kur bashkohen padi, të cilat gjykohen sipas rregullave të gjykimit të shkurtuar me padi që gjykohen sipas rregullave të zakonshme, për gjykimin e çështjes zbatohen rregullat e zakonshme.

5. Kjo dispozitë nuk zbatohet në rastin kur kompetenca lëndore në çështjet në gjykim është e ndryshme.

Neni 58

Kur në të njëjtën gjykatë ose gjykata të ndryshme shqyrtohen në të njëjtën kohë mosmarrëveshje midis të njëjtave palë dhe kanë të njëjtin shkak e të njëjtin objekt, vendoset pushimi i gjykimit të mosmarrëveshjeve të paraqitura pas asaj të regjistruar më parë.

D. KUNDËRSHTIMI I JURIDIKSIONIT DHE I KOMPETENCËS

Neni 59

(ndryshuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 44/2021, datë 23.3.2021)

Gjykata në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit, qoftë edhe kryesisht, merr në shqyrtim nëse çështja që shqyrton, bën pjesë në juridiksionin gjyqësor apo atë administrativ.

Kur gjykata vendos nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, lejohet rekurs i veçantë në Gjykatën e Lartë, ndërsa kur vendos që çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor, kundër vendimit lejohet ankim bashkë me vendimin përfundimtar ose jopërfundimtar.

Neni 60

Kur një institucion shtetëror pretendon se mosmarrëveshja që ka pranuar gjykata për një shqyrtim hyn në juridiksionin administrativ, mosmarrëveshja zgjidhet nga Gjykata e Lartë me kërkesën e institucionit shtetëror ose të prokurorit.

Gjykimi i filluar pezullohet derisa të jepet vendimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes për juridiksionin. Gjykata mund të marrë vetëm masa për sigurimin e padisë dhe të kryejë veprime procedurale që nuk presin.

Neni 61

Dërgimi i çështjes gjykatës kompetente (Ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjykata, kur konstaton se nuk është kompetente për shkak të lëndës, funksionit ose të kompetencës tokësore ekskluzive, sipas neneve 45 dhe 46, të këtij Kodi, kryesisht ose me kërkesë të palëve, vendos moskompetencën e saj dhe i dërgon aktet në gjykatën kompetente.

2. Në rastet e tjera, mungesa e kompetencës tokësore mund të merret parasysht vetëm me kërkesë të palëve, derisa nuk është nxjerrë urdhri për caktimin e seancës gjyqësore.

Neni 62

(ndryshuar me ligjin nr. 44/2021, datë 23.3.2021)

Kundër vendimit të gjykatës mbi kompetencën për gjykimin e mosmarrëveshjes lejohet ankim bashkë me vendimin përfundimtar ose jopërfundimtar.

Neni 63

Ankimi pezullon gjykimin

(Ndryshuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013, shfuqizuar me ligjin nr. 44/2021, datë 23.3.2021)

Neni 64

Detyrimi për pranimin e çështjes për gjykim

(Ndryshuar me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013; hequr fjalë në paragrafin e dytë me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017, ndryshuar paragrafi i dytë dhe shtuar dy paragrafë me ligjin nr. 44/2021, datë 23.3.2021)

Çështja që dërgohet për shqyrtim nga një gjykatë në një gjykatë tjetër të së njëjtës kategori ose nga një gjykatë më e lartë, duhet të pranohet dhe të shqyrtohet nga gjykata së cilës i dërgohet.

Konfliktet për kompetencë midis gjykatave nuk lejohen, por gjykata ka të drejtë t'ia parashtojë qëndrimin e saj Gjykatës së Lartë, e cila vendos për rregullimin e kompetencës në dhomë këshillimi, me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë.

Gjykata e Lartë shprehet me vendim të arsyetuar jo më vonë se 30 ditë nga momenti i depozitimit të parashtrësës.

Gjykata e Lartë në vendimin e saj për rregullimin e kompetencës jep udhëzimet e nevojshme për procesin gjyqësor të zhvilluar dhe për vazhdimin e tij nga gjykata që deklarohet kompetente.

KREU IV RREGULLA PËR CAKTIMIN E VLERËS SË PADISË

Neni 65

Vlera e padisë llogaritet në momentin e paraqitjes së saj në gjykatë.

Kërkesat e parashtruara në të njëjtin proces kundër të njëjtit person, mbledhen ndërmjet tyre, duke përfshirë edhe kamatat e arrira, shpenzimet e kryera dhe dëmet e pretenduara.

Kur kërkohet nga shumë persona ose kundër disa personave përmbushja me kuota e një detyrimi, vlera e padisë përcaktohet nga i gjithë detyrimi.

Neni 66

Vlera e padisë që lidhet me ekzistencën, vlefshmërinë ose zgjidhjen e një marrëdhënie juridike detyrimi, përcaktohet në bazë të asaj pjese të raportit që është në mosmarrëveshje.

Në rastin kur ka mbaruar kontrata e qirasë për sende të paluajtshme, vlera përcaktohet në bazë të shumës së qirasë që kërkohet, por në qoftë se ka kontestime për vazhdimin e kontratës së qirasë, vlera përcaktohet duke mbledhur qiratë për periudhën në kontestim.

Në pjesëtimin e pasurisë, vlera përcaktohet nga vlefja e pjesës që kërkohet.

Neni 67

Në rastin e kërkimit të një detyrimi ushqimor periodik, kur titulli kundërshtohet, vlera përcaktohet në bazë të shumës së përgjithshme që duhet të jepet për dy vjet.

Në çështjet që kanë lidhje me rentat e përrjetshme, kur titulli kundërshtohet, vlera përcaktohet nga shumata e vlerave për njëzet vjet, ndërsa në rastin e rentave të përkohshme vlera përcaktohet nga shumata vjetore të kërkuara deri në dhjetë vjet.

Neni 68

Kur kërkohet një shumë parash ose një send i luajtshëm, vlera përcaktohet në bazë të shumës së treguar ose të vlerës së deklaruar nga paditësi. Në mungesë të përcaktimit ose të deklarimit, pranohet se përcaktimi i vlerës është në kompetencë të gjykatës.

I padituri mund të kundërshtojë vlerën si më sipër të deklaruar ose të prezumuar, por vetëm në fillim të mbrojtjes së tij.

Neni 69

(Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Kur kërkohet një pronë e paluajtshme ose të drejta reale mbi të, vlera e padisë përcaktohet nga vlera në treg e pronës ose e të drejtave që kërkohen.

Neni 70

Vlera e padisë që kundërshton ekzekutimin e detyruar, përcaktohet nga kredia për të cilën procedohet. Vlera e padisë së personit të tretë që kundërshton ekzekutimin e detyruar varet nga vlefja e sendeve për të cilat bëhet kundërshtimi.

KREU V PËRJASHTIMI I GJYQTARIT, KËRKESA PËR PËRJASHTIM

Neni 71

Kushtet për të qenë gjyqtar caktohen me ligj.

Neni 72

Rastet për përjashtimin e gjyqtarit

Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete kur:

1. ka interes në çështje ose në një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me atë në gjykim;

2. ai vetë ose bashkëshortja e tij është i afërt deri në shkallë të katërt apo krushqi deri në shkallë të dytë ose është i lidhur me detyrime birësimi apo bashkëjeton në mënyrë të përhershme me njërin nga palët ose nga mbrojtësit;

3. ai vetë ose bashkëshortja e tij janë në konflikt gjyqësor ose në armiqësi apo në marrëdhënie kredie apo huaje me njërin prej palëve, ose njërin prej përfaqësuesve;

4. ka dhënë këshilla ose ka shfaqur mendim për çështjen në gjykim apo ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në një shkallë tjetër të procesit, është pyetur si dëshmitar, si ekspert ose si përfaqësues i njëres apo tjetres palë;

5. është kujdestar, punëdhënës i njëres prej palëve, administrator ose ka një detyrë tjetër në një ent, shoqatë, shoqëri ose institucion tjetër që ka interesa për çështjen në gjykim;

6. në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie.

Kërkesa për heqjen dorë i paraqitet kryetarit të gjykatës përkatëse i cili vendos. Për deklarimin e heqjes dorë të kryetarit të gjykatës së shkallës së parë vendos kryetari i gjykatës së apelit dhe për kërkesën e këtij të fundit vendos kryetari i Gjykatës së Lartë.

Përmbajtja e kërkesës u njoftohet palëve.

Neni 73

Heqja dorë e gjyqtarit nga gjykimi i çështjes

(Ndryshuar fjalia e dytë me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008)

Gjyqtari, i cili vlerëson me ndërgjegje se ka shkaqe të arsyeshme për të mos marrë pjesë në shqyrtimin e një çështjeje, i kërkon kryetarit të gjykatës zëvendësimin e tij. Kryetari i gjykatës, kur e sheh me vend kërkesën, urdhëron zëvendësimin e tij me një gjyqtar tjetër, me anë të shortit.

Neni 74

Procedura për përjashtimin e gjyqtarit

(Shfuqizuar paragrafi i pestë dhe i gjashtë me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Në rastet kur është e detyrueshme heqja dorë e gjyqtarit, secila nga palët mund të kërkojë përjashtimin e tij.

Kërkesa e nënshkruar nga pala përkatëse ose nga përfaqësuesi i saj, duhet të depozitohet në sekretarinë e gjykatës kur është bërë i ditur emri i gjyqtarit apo gjyqtarëve që shqyrtojnë çështjen dhe në rastin e kundërt menjëherë pas shpalljes së gjyqtarit apo gjyqtarëve që do të gjykojnë çështjen.

Paraqitja e mëvonshme e kërkesës lejohet vetëm kur pala ka marrë dijeni më vonë për shkakun e përjashtimit ose kur gjatë ushtrimit të funksioneve, gjyqtari ka shfaqur mendim të njëanshëm e në mënyrë të papërshtatshme mbi faktet dhe rrethanat objekt gjykimi, por sidoqoftë jo më vonë se tri ditë nga marrja dijeni.

Kërkesa duhet të përmbajë shkaqet e përjashtimit, dokumentet e provat e tjera që disponohen.

Neni 75

Kompetenca për shqyrtimin e kërkesës

(Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001; nr. 122/2013, datë 18.4.2013; ndryshuar fjalë në paragrafin e parë, shtuar paragrafi i pestë dhe i gjashtë me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017, ndryshuar paragrafi i dytë dhe i tretë me ligjin nr. 44/2021, datë 23.3.2021)

Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarëve shqyrtohet në dhomë këshillimi nga një gjyqtar tjetër i së njëjtës gjykatë. Ndaj vendimit për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për përjashtim lejohet ankim së bashku me vendimin përfundimtar.

Për kërkesën e përjashtimit të gjyqtarit të gjykatës së apelit vendos një gjyqtar tjetër i kësaj gjykate, i ndryshëm nga gjyqtarët e trupit gjykues të cilit i përket gjyqtari që kërkohet të përjashtohet. Vendimi është i formës së prerë.

Për kërkesën e përjashtimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë vendos një gjyqtar tjetër i kësaj gjykate, i ndryshëm nga gjyqtarët e kolegjit të cilit i përket gjyqtari që kërkohet të përjashtohet. Vendimi është i formës së prerë.

Nuk pranohet kërkesa për përjashtimin e gjyqtarëve të caktuar për të vendosur mbi përjashtimin.

Gjyqtari për të cilin kërkohet përjashtimi ka të drejtë të paraqesë qëndrimin e tij me shkrim në lidhje me këtë kërkesë.

Në këto raste gjykimi nuk pezullohet, por gjyqtari nuk mund të japë ose të marrë pjesë në dhënien e vendimit, derisa të jepet vendimi që e deklaron të papranueshme ose që e rrezon kërkesën e përjashtimit.

Neni 76

Sanksione për kërkesën e deklaruar të papranueshme

(Ndryshuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001 dhe nr. 38/2017, 30.3.2017)

Kërkesa për përjashtim quhet e papranueshme kur nuk është bërë në mënyrën dhe në afatet e parashtruara në nenin 74 të këtij Kodi.

Vendimi që deklaron të papranueshme kërkesën ose që nuk pranon përjashtimin e gjyqtarit, përmban shpenzimet gjyqësore përkatëse, si dhe një gjobë deri në 50 000 lekë kur është person fizik dhe deri në 100 000 lekë kur është person juridik, në ngarkim të palës që, duke abuzuar, ka parashtruar një kërkesë të padrejtë.

KREU VI

SEKRETARIA GJYQËSORE

Neni 77

Detyrat e sekretarit gjyqësor

(Ndryshuar fjalë në paragrafin e tretë me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001; ndryshuar paragrafi i tretë dhe shtuar paragrafi i katërt me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013)

Sekretari gjyqësor dokumenton për të gjitha efektet, në rastet dhe në mënyrat e parashikuara nga ligji, veprimtari të mirëfillta të gjykatës, të palëve e pjesëmarrësve të tjerë në proces.

Sekretari merr pjesë në të gjitha veprimet e gjykatës për të cilat duhet të mbahet procesverbal.

Sekretari regjistron çështjet, formon fashikujt gjyqësorë, duke futur atje dokumente ose kopje të tyre të vërtetuara sipas ligjit dhe shënon menjëherë datën e depozitimit, i ruan ato, përpilon komunikimet dhe njoftimet e parashikuara nga ligji ose nga gjykata dhe detyra të tjera që lidhen me procesin gjyqësor.

Sekretari lëshon, kundrejt pagesës, kopje të akteve të përpiluara, të regjistrimeve të mbajtura me mjete të regjistrimit audio ose audiovizive, transkripte të plota ose të pjesshme të këtyre të fundit, si dhe ekstrakte autentike të akteve të përpiluara me shtypshkrim apo dorëshkrim.

Neni 78

Punonjësi i gjykatës

(Ndryshuar titulli, ndryshuar fjalë në paragrafin e parë dhe shtuar paragrafi i dytë dhe i tretë me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Punonjësi i gjykatës merr pjesë në seancë gjyqësore dhe merr masa për zbatimin e urdhrave, ndjek procedurën e njoftimit të akteve dhe kryen detyra të tjera që lidhen me procesin gjyqësor.

Punonjësi i gjykatës është përgjegjës për kryerjen e rregullt të njoftimeve. Ai merr masa për realizimin e kërkimeve të nevojshme në lidhje me adresën e personit që i drejtohet njoftimi, në regjistrat publikë, në organet e administratës shtetërore, në familje dhe tek të afërmit, në vendqëndrimin ose vendbanimin e fundit të personit që i drejtohet njoftimi, ose nëpërmjet burimeve të tjera të mundshme.

Kërkesat e punonjësit të gjykatës janë të detyrueshme për subjektet, të cilave u drejtohen. Këta të fundit duhet të kthejnë përgjigje brenda afateve të caktuara në kërkesë. Për këto veprime, punonjësi i gjykatës harton një raport, të cilin ia paraqet gjykatës.

Neni 79

Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar

(Shfuqizuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Neni 79/a

Avokatura e Shtetit

(Shtuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Avokatura e Shtetit ushtron përfaqësimin në rastet e parashikuara me ligj. Gjykata, që shqyrton çështje për të cilat me ligj përfaqësimi dhe mbrojtja kryhet nga Avokatura e Shtetit, urdhëron njoftimin e akteve kësaj të fundit, me qëllim që ajo të ketë mundësi të marrë pjesë në gjykim.

**KREU VII
EKSPERTI**

(Shfuqizuar nenet 80-83 me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

**TITULLI IV
PROKURORI**

(Shfuqizuar nenet 84-89 me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

**TITULLI V
NGRITJA E PADISË**

**KREU I
PALËT**

Neni 90
Përkufizimi

Palë në një gjykim civil janë personat fizikë ose juridikë, në emër ose kundër të cilëve zhvillohet gjykimi.

Askush nuk mund të përfaqësojë në një gjykim civil të drejtat e të tjerëve, përveç kur ligji parashikon ndryshe.

Neni 91
Zotësia për të vepruar

Kanë zotësi për të vepruar në një gjykim civil personat që ushtrojnë lirisht të drejtat, të cilat duhet të respektohen nga të tjerët.

Personat, që nuk kanë zotësi për të vepruar në një gjykim civil, mund të marrin pjesë në gjykim vetëm kur përfaqësohen, sipas dispozitave që rregullojnë zotësinë e tyre.

Neni 92
Përfaqësimi në gjyq

Personat juridikë marrin pjesë në gjykim me anë të atij që i përfaqëson, sipas dispozitave ligjore.

Neni 93

Personat që kanë zotësi për të vepruar, mund t'i kryejnë vetë të gjitha veprimet procedurale, përveç kur ligji parashikon ndryshe.

Neni 94

Kur mungon personi i cili duhet të përfaqësohet në gjyq sipas paragrafit të dytë të nenit 91 të këtij Kodi dhe ekzistojnë arsye të justifikuara që kërkojnë kryerjen e shpejtë të disa veprimeve procedurale, mund të caktohet një kujdestar i posaçëm derisa çështja të ndiqet nga ai që është ngarkuar ta përfaqësojë.

Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe për emërimin e një kujdestari të posaçëm për të përfaqësuarin, kur ka konflikt interesash me përfaqësuesin.

Neni 95

Askush nuk mund të bëjë të vlefshme në emrin e tij, në një proces gjyqësor civil, një të drejtë të një tjetri, përveç kur parashikohet shprehimisht nga ligji.

KREU II PËRFAQËSUESIT

(Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Neni 96

Pajisja me prokurë e përfaqësuesit

(Ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Si përfaqësues të palëve me prokurë mund të jenë:

- a) avokatët;
- b) bashkëshortët, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit dhe motrat;
- c) juristët dhe punonjësit e tjerë të autorizuar të institucioneve shtetërore ose të personave juridikë;
- ç) personat që lejohen nga gjykata për të qenë përfaqësues në një çështje;
- d) personat e tjerë që parashikohen me ligj se mund të jenë përfaqësues të palëve.

Nuk mund të jenë përfaqësues të palëve:

- a) personat që nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç;
- b) personat që u është hequr zotësia për të vepruar;
- c) avokatët të cilëve u është pezulluar ushtrimi i profesionit për aq kohë sa zgjat kjo masë;
- ç) gjyqtarët dhe prokuroret.

Prokura mund të jetë e përgjithshme ose e posaçme. Ajo bëhet me shkrim sipas dispozitave të Kodit Civil, si dhe me gojë përpara gjykatës që shqyrton mosmarrëveshjen.

Neni 96/a

Përfaqësimi në Gjykatën e Lartë

(Shtuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Përfaqësimi i palëve në Gjykatën e Lartë bëhet vetëm nga avokat.
2. Kjo dispozitë nuk zbatohet në rastet kur përfaqësimi bëhet nga Avokatura e Shtetit sipas ligjit.

Neni 97

Të drejta të përfaqësuesit në procesin gjyqësor

Kur palët përfaqësohen në gjykim nga përfaqësuesi, ky mund të kryejë dhe të marrë në interes të palës së vet të gjitha aktet që i nevojiten procesit, që ligji nuk e ndalon.

Në çdo rast nuk mund të kryejë akte që sjellin disponim të së drejtës, përveç rasteve kur ka fituar tagër në mënyrë të shprehur.

Neni 98

Shfuqizimi dhe heqja dorë nga prokura

I përfaqësuari mund të shfuqizojë kurdoherë prokurën dhe përfaqësuesi mund të heqë dorë në çdo kohë prej saj, por shfuqizimi ose heqja dorë nuk kanë efekt për palën tjetër, përderisa nuk është bërë zëvendësimi i përfaqësuesit.

Neni 99

Pala ose personi që e përfaqëson, kur ka cilësinë e nevojshme për të ushtruar tagrin e përfaqësuesit me prokurë, mund të paraqitet në gjykim pa praninë e ndonjë përfaqësuesi tjetër, përveç kur ligji parashikon ndryshe.

KREU III DETYRAT E PALËVE DHE TË PËRFAQËSUESVE

Neni 100

(Ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Palët dhe përfaqësuesit e tyre kanë detyrimin që gjatë procesit gjyqësor të sillen me mirëbesim dhe ndershmëri.

Neni 101

Në dokumentet që i paraqiten gjykatës dhe në diskutimet gjatë procesit gjyqësor, palët dhe përfaqësuesit e tyre nuk duhet të përdorin shprehje të papërshtatshme ose fyese.

Në çdo fazë të gjykimit, gjykata mund të urdhërojë heqjen e shprehjeve të papërshtatshme ose fyese dhe në vendimin përfundimtar të caktojë në favor të personit të fyer dhe në ngarkim të autorit të fyerjes ose të shprehjeve të papërshtatshme, një shumë lekësh me titull shpërblimi të dëmit jopasuror, kur shprehjet fyese nuk kanë lidhje me objektin e mosmarrëveshjes.

KREU IV

PËRGJEGJËSIA E PALËVE PËR SHPENZIMET GJATË PROCESIT DHE PËR DËMET GJATË PROCESIT

Neni 102

Përbërja e shpenzimeve gjyqësore

(Ndryshuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001 dhe ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Shpenzimet gjyqësore përbëhen nga tarifat dhe nga shpenzimet e tjera të nevojshme të gjykimit.
2. Tarifat gjyqësore, llojet e tyre dhe të tjera çështje që lidhen me to rregullohen me ligj të veçantë.

Neni 103

(shfuqizuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Neni 104

Mënyra e caktimit

(Shtuar paragrafi i parë me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001 dhe shfuqizuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Neni 105

(Shtuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001 dhe ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Shpenzimet për dëshmitarët, përmbauesit, ekspertët, përkthyesit dhe për këqyrjen e sendeve ose këqyrjen në vend, parapaguhën nga pala që i ka kërkuar në shumën që ka caktuar gjykata. Gjykata, duke marrë parasysh rrethanat e çështjes dhe gjendjen pasurore të palëve, me vendim, ia ngarkon njëres ose të dyja palëve shpenzimet, pavarësisht se cila prej tyre ka kërkuar pyetjen e dëshmitarëve, kryerjen e ekspertimit, thirrjen e përkthyesit ose këqyrjen.

2. Ky vendim është menjëherë i ekzekutueshëm nga shërbimi përmbaues.

Neni 105/a

(Shtuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Dëshmitarët, ekspertët dhe përkthyesit kanë të drejtë të marrin shpenzimet që kanë bërë për paraqitjen e tyre, si dhe një shpërblim për largimin e tyre nga vendi i punës.

Ekspertët kanë të drejtë të shpërblehen edhe për shërbimin e kryer.

Masa e shpenzimeve dhe e shpërblimeve, që u takojnë dëshmitarëve dhe ekspertëve, caktohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 105/b

(Shtuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001, ndryshuar fjalë në paragrafin e parë dhe ndryshuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Personat që, sipas dispozitave për tarifën, përjashtohen nga pagimi i taksës, përjashtohen edhe nga pagimi i shpenzimeve të tjera gjyqësore. Në këto raste, shpenzimet përballohen nga fondi përkatës i parashikuar në Buxhetin e Shtetit.

Personat juridikë që sipas ligjit “Për tarifatat gjyqësore” përjashtohen nga pagimi i tarifës, paguajnë shpenzimet e tjera gjyqësore.

Neni 106

Cilës palë i ngarkohen

(Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001; ndryshuar fjalë me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Tarifa, shpenzimet e tjera gjyqësore dhe shpërblimi për një avokat, në qoftë se ka pasur të tillë, të paguara nga paditësi, i ngarkohen të paditurit në masën e pjesës së padisë që është pranuar nga gjykata. Tarifa dhe shpenzimet e tjera gjyqësore, nga pagimi i të cilave pala është përjashtuar sipas nenit 105/b, i ngarkohen palës tjetër në masën e pjesës së padisë që është pranuar nga gjykata.

I padituri ka të drejtë të kërkojë pagimin e shpenzimeve gjyqësore që ka bërë, në përpjesëtim me pjesën e refuzuar të padisë.

I padituri ka të drejtë të kërkojë pagimin e shpenzimeve gjyqësore që ka bërë, edhe në rast se është vendosur pushimi i gjykimit.

Neni 107

(ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Nëse pala ndërgjyqëse ose përfaqësuesi i saj ka shkaktuar pa shkaqe të arsyeshme vonesa në gjykimin e çështjes, gjykata kryesisht mund të caktojë një tarifë gjyqësore shtesë, sipas përcaktimeve të ligjit “Për tarifatat gjyqësore”.

Kur i padituri me sjelljen e tij nuk i ka dhënë shkak ngritjes së padisë, shpenzimet gjyqësore i ngarkohen paditësit edhe sikur të pranohet padia.

Neni 108

(Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Kur çështja përfundon me pajtim, shpenzimet gjyqësore mbeten në ngarkim të secilës palë që i ka bërë, përveç kur ka marrëveshje të kundërt.

Neni 109

(Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Personi i tretë që bën ndërhyrje dytësore nuk detyrohet dhe as ngarkohet me pagimin e shpenzimeve gjyqësore.

Neni 110

(Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001 dhe me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Për caktim të gabuar të vlerës së padisë dhe për llogaritje të gabuar të tarifave dhe të shpenzimeve të tjera gjyqësore, mund të bëhet ankimi i veçantë.

2. Ankimi kundër vendimit nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të gjykatës.

KREU V

MJETET LIGJORE TË MBROJTJES

(Shfuqizuar kreu V, nenet 111-114, me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

TITULLI VI

AKTET PROCEDURALE, NJOFTIMET DHE AFATET

KREU I

FORMAT E AKTIT

Neni 115

Forma e hartimit të aktit
(Ndryshuar titulli me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Aktet procedurale, për të cilat ligji nuk kërkon forma të caktuara, mund të kryhen në formën më të dobishme për arritjen e qëllimit të tyre.

Neni 116

Gjuha e hartimit të aktit
(Shtuar titulli me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Aktet procedurale hartohen në gjuhën shqipe.

Gjykata për pyetjen e personave që nuk dinë gjuhën shqipe ose për përkthimin e dokumenteve të shkruara në gjuhë të huaj thërret përkthyesin.

Përkthyesi që nuk paraqitet pa shkaqe të përligjura, thirret me detyrim. Ai mban përgjegjësi penale dhe civile sikurse eksperti.

Neni 117

Përmbajtja e aktit procedural

Përveç kur ligji parashikon ndryshe, thirrja për në gjyq, kërkesëpadia e kundërpadia, duhet të tregojnë gjykatën, palët, objektin, shkaqet ligjore të kërkesës dhe përfundimet, si dhe datën e hartimit dhe duhet të nënshkruhen prej palës që e paraqet aktin ose nga përfaqësuesi i saj, si në original ashtu dhe në kopjet për njoftim.

Neni 118

Procesverbali

(Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001;
nr. 122/2013, datë 18.4.2013; shtuar fjalë me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Gjyqtari i vetëm ose kryetari i seancës duhet të sigurohet që të mbahet procesverbal nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv për seancën gjyqësore, si dhe për çdo veprim tjetër procedural gjyqësor që zhvillohet jashtë seance. Nëse nuk është e mundur që procesverbali të mbahet nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv, ai mbahet duke bërë një përmbledhje të saktë me shtypshkrim apo dorëshkrim.

Procesverbali duhet të tregojë:

- a) vendin ku zhvillohet veprimi procedural gjyqësor;
- b) kohën e zhvillimit të veprimit procedural gjyqësor;
- c) përbërjen e trupit gjykues dhe emrin e sekretarit të gjykatës;
- ç) gjenealitetet e pjesëmarrësve në gjykim; dhe
- d) personat e thirrur, që nuk janë paraqitur, si dhe, nëse dihet, arsyen e mungesës së tyre.

Procesverbali duhet të përshkruajë veprimet procedurale të kryera gjatë gjykimit dhe të pasqyrojë fjalë për fjalë:

- a) të gjitha kërkimet dhe kundërshtimet e palëve dhe të personave të tretë;
- b) përmbledhjen e saktë të çdo shpjegimi dhe pretendimi me shkrim të paraqitur nga pala;
- c) pyetjet dhe thëniet e personave që marrin pjesë në gjykim, duke përfshirë dëshmitarët dhe ekspertët;
- ç) provat e marra, duke përfshirë përmbajtjen e provave me shkresë që janë paraqitur, të shiritave të magnetofonit, diapozitivave e filmave;
- d) të gjitha vendimet dhe urdhrat që ka dhënë gjykata gjatë gjykimit; dhe
- dh) të gjitha pretendimet përfundimtare të palëve.

Në rast se procesverbali mbahet në formë të përmbledhur me shtypshkrim apo dorëshkrim, dhe një nga palët kërkon që pjesë nga thëniet e palës tjetër të përfshihen në procesverbal, gjykata duhet ta marrë parasysh këtë kërkesë.

Nëse procesverbali mbahet në formë të përmbledhur me shtypshkrim apo dorëshkrim, ai nënshkruhet në fund të çdo faqeje nga sekretari dhe në fund të dokumentit nga kryetari i seancës, menjëherë pas seancës, dhe përfshihet në dosjen gjyqësore.

Procesverbalit është pjesë përbërëse e dosjes gjyqësore dhe ruhet për aq kohë sa edhe vetë dosja. Rregullat e hollësishme për ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

Neni 118/1

Transkriptimi i procesverbaleve të mbajtura me mjete të regjistrimit audio ose audiovizive

(Shtuar me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013)

Transkriptimi i procesverbaleve të mbajtura me mjete të regjistrimit audio ose audiovizive përgatitet nga sekretari gjyqësor, ose teknikë të kontraktuar nga gjykata dhe që veprojnë nën mbikëqyrjen e sekretarit gjyqësor.

Transkriptimi i procesverbalit bëhet në rastet kur:

- a) kërkohet nga anëtarët e trupit gjykues;
- b) kërkohet me shkrim nga palët në gjykim ose persona të tjerë të interesuar dhe kjo kërkesë miratohet nga kryetari i seancës gjyqësore, pasi paguhen tarifat e vendosura për këtë qëllim, e cila përcaktohet me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

Transkriptimi i regjistrimit mund të bëhet për të gjitha seancat e një çështjeje, për seanca të veçanta ose për pjesë të shkëputura prej tyre, sipas kërkesës së personit që kërkon transkriptimin.

Transkriptimi mund të kërkohet edhe para se gjykata të ketë dhënë vendimin për çështjen.

Transkriptimi i bashkëngjitet dosjes gjyqësore pa cenuar vlefshmërinë e procesverbalit të mbajtur sipas nenit 118 të këtij Kodi.

KREU II

PAVLEFSHMËRIA E AKTEVE

Neni 119

Shpallja e pavlefshmërisë

Akti procedural që nuk është kryer në formën që kërkohet shprehimisht nga ligji, mund të shpallet i pavlefshëm.

Akti mund të shpallet i pavlefshëm edhe kur i mungojnë të dhënat e domosdoshme për arritjen e qëllimit të tij.

Pavlefshmëria nuk mund të shpallet kur akti ka arritur qëllimin për të cilin është destinuar.

Neni 120

(Ndryshuar paragrafi i dytë dhe i tretë me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Nuk mund të shpallet pavlefshmëria e një akti procedural pa kërkesën e palës, përveç kur ligji parashikon ndryshe.

Vetëm pala në interes të së cilës ligji parashikon një element të aktit procedural, mund të prapësojë pavlefshmërinë e aktit për mungesë të atij elementi. Prapësimi duhet të ngrihet në seancën më të parë pas njoftimit, ose menjëherë, kur dijenia merret gjatë gjykimin.

Pavlefshmëria nuk mund të prapësohet nga pala që e ka shkaktuar atë dhe as nga ajo që ka hequr dorë heshtazi.

Neni 121

Pavlefshmëria e pjeshme

Pavlefshmëria e një akti nuk ka rëndësi për aktet e mëparshme, kur këto janë të pavarura prej tij.

Pavlefshmëria e një pjese të aktit nuk prek pjesët e tjera që janë të pavarura.

Kur e meta e një akti procedural pengon një efekt të caktuar, efektet e tjera të prodhuara prej tij, për të cilat ai është krijuar, janë të vlefshme.

Neni 122

Pavlefshmëria e njoftimit

Njoftimi është i pavlefshëm kur nuk janë zbatuar dispozitat që kanë lidhje me mënyrën dhe personin të cilit i duhet dorëzuar kopja e aktit ose kur ka pasiguri të plotë për personin ose datën e njoftimit.

Neni 123

Pavlefshmëria e vendimeve gjyqësore

Pavlefshmëria e vendimeve të gjykatës që mund të shqyrtohen në gjykatën e apelit ose për të cilat mund të bëhet kërkesë në Gjykatën e Lartë, vlerësohet brenda kufijve dhe rregullave të caktuara për këto mjete të kundërshtimit.

Neni 124

Ripërtëritja e aktit

(Hequr fjalë në paragrafin e tretë me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Gjykata që shpall pavlefshmërinë e një akti procedural, kur është e mundur, duhet të veprojë për ripërtëritjen e plotë ose të pjesshme të aktit.

Kur pavlefshmëria e aktit procedural është rrjedhojë e fajësisë së sekretarit, përmbaruesit ose përfaqësuesit, gjykata me vendim i ngarkon personit përgjegjës shpenzimet për ripërtëritjen e aktit.

Me kërkesën e palës së dëmtuar, gjykata në vendimin që vendos për mosmarrëveshjen, detyron personin përgjegjës të shpërblejë dëmin e shkaktuar nga pavlefshmëria.

KREU III

VENDIMET E GJYKATËS

Neni 125

Vendimet e ndërmjetme

(Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Vendimet e ndërmjetme jepen nga gjykata në seancë gjyqësore me qëllim që t'i përgjigjet kërkesave dhe të sigurohet zhvillimi i gjykimit në pajtim me dispozitat e këtij Kodi.

Neni 126

Vendimet përfundimtare

(Ndryshuar fjalë në paragrafin e dytë me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Vendimi përfundimtar jepet nga gjykata në përfundim të gjykimit i cili zgjidh çështjen në themel.

Vendimi përfundimtar, si dhe vendimet që i japin fund procesit gjyqësor civil të parashikuara prej nenit 127 të këtij Kodi jepen në “Emër të Republikës” dhe përkatësisht duhet të përmbajnë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyra e zgjidhjes së saj.

Neni 127

Vendimet jopërfundimtare

Vendimet jopërfundimtare janë vendimet e pushimit të çështjes, me të cilët gjykata ose gjyqtari në rastet e parashikuara në këtë Kod i japin fund procesit gjyqësor civil pa e zgjidhur çështjen në themel, si edhe çdo vendim tjetër që pa e zgjidhur çështjen në themel i jep fund procedimit gjyqësor të filluar.

KREU IV

NJOFTIMET

Neni 128

Njoftimi i akteve

(Ndryshuar me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013; ndryshuar fjalë me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Njoftimi i akteve bëhet sipas mënyrave të parashikuara në këtë kre. Gjyqtari ose kryetari i trupit gjykues të çështjes kujdeset dhe kontrollon procesin e njoftimit, që kryhet nga punonjësit e gjykatës të caktuar për realizimin e tij.

Neni 129

Thirrja në gjykatë

(Ndryshuar me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013; shtuar fjalë në paragrafin e parë dhe të dytë dhe shtuar paragrafët e tretë, të katër dhe të pestë me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Thirrja në gjykatë bëhet nëpërmjet njoftimit të letërthirrjes, e cila duhet të përmbajë gjykatën që e ka nxjerrë, emrin, mbiemrin e personit të thirrur, kohën e vendin e seancës gjyqësore, mosmarrëveshjen për të cilën thirret, kohën e njoftimit të aktit, si dhe pasojat ligjore në rast se personi i thirrur nuk paraqitet në gjykatë.

Gjykata, kur e çmon të dobishme dhe kur pala ose personi i tretë ka dhënë pëlqimin paraprak, urdhëron që thirrja në gjykatë të bëhet nëpërmjet njoftimit me mjete të komunikimit elektronik, sipas rregullave të përcaktuara në këtë kre.

Kur pala është nën masë paraburgosëse, ose po vuan dënimin me burgim, gjykata kryen njoftimin në vendin e ekzekutimit të masës ose dënimit, duke urdhëruar organet përkatëse që ta shoqërojnë në gjykatë, kur pala kërkon të marrë pjesë personalisht në gjykim. Në këto raste gjykata përsërit njoftimin për personin për çdo seancë, përveç rastit kur ai kërkon të vazhdojë gjykimi në mungesë.

Kur përzgjedhja e një adrese, me qëllim njoftimi në gjykatë është parashikuar shprehimisht në kontratë nga palët, për të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga kjo kontratë, gjykata mund të kryejë njoftimin sipas kësaj mënyre.

Palët ose personat e tretë, për çdo ndryshim të mëvonshëm të adresës dhe të të dhënave elektronike të kontaktit të tyre ose të përfaqësuesit të tyre, detyrohen të njoftojnë gjykatën. Shkelja e këtij detyrimi e bën të papranueshëm pretendimin për pavlefshmëri njoftimi.

Kjo dispozitë është e zbatueshme për njoftimet në çdo fazë dhe shkallë gjykimi.

Neni 130

Rregullat e njoftimit shkresor të akteve

(Ndryshuar me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013; ndryshuar fjalë dhe paragrafi i gjashtë me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Njoftimi shkresor bëhet nëpërmjet dorëzimit nga punonjësi i gjykatës ose shërbimi postar i letërthirrjes ose akteve të tjera që duhet t'i njoftohen personit të thirrur, kudo ku ai gjendet.

Në rastin e personave që ndodhen në shërbim në ushtri, njoftimi u bëhet me anë të komandës së repartit nga i cili varen.

Në rastin e personave juridikë publikë njoftimi bëhet në qendrën e tij dhe i dorëzohet titullarit ose personave të ngarkuar për pranimin e akteve.

Në rastin e personave juridikë privatë njoftimi bëhet në qendrën e tij dhe i dorëzohet përfaqësuesit ose personit të ngarkuar për të marrë aktet dhe, në mungesë të tyre, një personi tjetër që punon në këtë qendër të personit juridik.

Në rastet kur njoftimi shkresor bëhet nëpërmjet shërbimit postar, punonjësi i gjykatës shënon mbi origjinalin dhe mbi kopjen e njoftimit edhe zyrën e postës, me anë të së cilës i është dërguar akti marrësit, me dërgesë të porositur. Dëftesa e marrjes në dorëzim duhet t'i bashkohet origjinalit të aktit dhe përfshihet në dosjen gjyqësore.

Në qoftë se personi të cilit i drejtohet njoftimi refuzon marrjen e njoftimit, nuk di ose nuk mund të nënshkruajë, punonjësi i gjykatës ose punonjësi i shërbimit postar bën shënimin përkatës në aktin objekt njoftimi dhe, kur është e mundur, e vërteton edhe me nënshkrimin e një dëshmitari të pranishëm. Në këtë rast njoftimi quhet i kryer.

Neni 131

(Ndryshuar fjalë në paragrafin e parë e të dytë, ndryshuar fjalia e dytë e paragrafit të katërt me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013; ndryshuar fjalë me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Kur nuk është i mundur njoftimi sipas dispozitës së mësipërme, njoftimi bëhet në vendbanimin apo vendqëndrimin e personit të thirrur ose në zyrën apo vendin ku ushtron veprimtarinë tregtare, industriale ose të artizanatit.

Në qoftë se personi i thirrur nuk gjendet në një nga këto vende, njoftimi i dorëzohet një personi të familjes që ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç, dhe kur nuk ndodhet ndonjë prej tyre, njoftimi mund të bëhet edhe nëpërmjet fqinjëve, që pranojnë t'ia dorëzojnë atë personit të thirrur, zyrës ose

qendrës së punës së tij, përveç kur marrësi është i mitur, nën gjashtëmbëdhjetë vjeç ose është i pazoti për të vepruar.

Kur nuk është e mundur të bëhet njoftimi, sipas paragrafit të mësipërm, kopja e njoftimit i dorëzohet portierit të ndërtesës së banimit, të zyrës apo të qendrës së punës.

Në të gjitha këto raste, personi që merr njoftimin, duhet të nënshkruajë origjinalin ose kopjen e saj, duke marrë përsipër detyrimin që kopjen tjetër t'ia dorëzojë personit të thirrur. Gjithashtu bëhet shënimi në kopjen që mban punonjësi i gjykatës edhe për marrëdhëniet e këtij personi me personin e thirrur, veprimet dhe kërkimet e bëra nga nëpunësi gjyqësor për dorëzimin e aktit personit të thirrur, si dhe vendin dhe kohën e dorëzimit.

Neni 132

(Ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur anëtarët e familjes së personit që i drejtohet njoftimi, ose fqinjët të cilëve u jepet njoftimi për t'ia dorëzuar personit të cilit i drejtohet njoftimi, nuk pranojnë të marrin në dorëzim njoftimin, nuk dinë ose nuk mund të nënshkruajnë, bëhet shënimi në kopjen e njoftimit dhe, kur është e mundur, vërtetohet edhe me nënshkrimin e një dëshmitari të pranishëm.

2. Në këtë rast njoftimi quhet i kryer.

Neni 133

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008; nr. 122/2013, datë 18.4.2013 dhe nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Kushdo mund të emërojë një person të autorizuar për marrjen e njoftimeve. Akti i emërimit depozitohet në gjykatë.

2. Punonjësi i gjykatës regjistron personin e autorizuar në portalin elektronik kombëtar, i cili krijohet dhe administrohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Neni 133/a

Njoftimi me shpallje publike

(Shtuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Njoftimi bëhet me shpallje publike nëse:

a) nuk është e mundur të realizohet njoftimi sipas parashikimeve të neneve 129, 130, 131, 132 dhe 133 dhe pasi punonjësi i gjykatës ka marrë të gjitha masat e nevojshme për gjetjen e adresës së personit që i drejtohet njoftimi; ose

b) personi, të cilit i drejtohet njoftimi, nuk ka vendbanim, vendqëndrim, nuk ka zgjedhur një banesë ose nuk ka caktuar një përfaqësues në Republikën e Shqipërisë dhe nuk ka qenë i mundur njoftimi i tij sipas njëres nga mënyrat e parashikuara nga ligji.

Neni 133/b

(Shtuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Njoftimi me shpallje publike kryhet me anë të afishimit të tij në gjykatën e vendit ku do të gjykohet mosmarrëveshja, në vendin ku personi të cilit i drejtohet njoftimi ka vendbanimin ose në vendqëndrimin e tij, si edhe në njësinë administrative në të cilën ka vendbanimin ose vendqëndrimin.

2. Kur personi të cilit i drejtohet njoftimi është një person juridik privat, njoftimi kryhet me anë të afishimit të tij në selinë e regjistruar në regjistrat publikë përkatës.

3. Njoftimi botohet edhe në një rubrikë të posaçme në faqen zyrtare në internet të gjykatës, dhe/ose në një portal elektronik kombëtar të krijuar për këtë qëllim.

4. Njoftimi me shpallje publike duhet të përmbajë:

a) palët ndërgjyqëse;

b) identitetin e palës të njoftuar me shpallje dhe adresën e vendbanimit ose vendqëndrimin;

c) datën dhe orën e gjykimit, gjykatën që shqyrton mosmarrëveshjen, objektin e mosmarrëveshjes dhe të dhënat e aktit objekt njoftimi;

ç) personin zyrtar ose zyrën në të cilën mund të marrë aktin objekt njoftimi, si dhe pasojat që mund të vijnë nga mosveprimi i palës që i drejtohet njoftimi.

5. Ky njoftim qëndron i afishuar për jo më pak se 20 ditë.

Neni 134

Njoftimi i akteve të shtetit të huaj

Njoftimi i akteve që vijnë nga organet e një shteti të huaj në një drejtim të përcaktuar nga autoritetet e këtij shteti, kryhet me dorëzimin e tyre të thjeshtë, sipas rregullave të caktuara në këtë Kod.

Neni 135

Njoftimi i akteve të shtetit të huaj bëhet nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, e cila ia përcjell ato gjykatës së rrethit të vendit ku duhet të kryhet njoftimi.

Kur ka marrëveshje të ndërsjellë për dhënien e ndihmës juridike, dërgimi për njoftim dhe njoftimi bëhet drejtpërsëdrejti midis organeve kompetente të të dy shteteve ose në ndonjë mënyrë tjetër që parashikohet në marrëveshje.

Ministria e Drejtësisë kur konstaton se kërkesa për njoftimin e një akti nuk përputhet me rregullat e parashikuara në këtë Kod, ose në marrëveshjen ndërkombëtare përkatëse, ia kthen dokumentet organit të shtetit dërgues, duke specifikuar plotësisht rregullimet e nevojshme.

Neni 136

Pala që kërkon njoftimin duhet të shoqërojë kërkesën me shpenzimet e nevojshme të njoftimit, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare ekzistuese, përveç rasteve kur ligji apo këto marrëveshje parashikojnë përjashtimin nga pagimi paraprak i shpenzimeve.

Neni 137

Akti njoftohet në gjuhën e vendit nga i cili është dërguar, por marrësi që nuk e njeh gjuhën në të cilën është përpiluar akti, ka të drejtë të refuzojë njoftimin dhe të kërkojë që ai të përkthehet në gjuhën shqipe ose në një gjuhë tjetër të njohur prej pritësit për llogari të palës kërkuese dhe me shpenzimet e saj.

Neni 138

Për njoftimin e aktit mbahet procesverbal ose plotësohet një certifikatë, në të cilën përmendet detyrimisht vendi, data e njoftimit, personit të cilit i është dorëzuar akti, lidhjet e tij me personin që i drejtohet akti, nënshkrimi dhe kur është rasti edhe arsyet që kanë penguar njoftimin.

Neni 139

Për dokumentet që bëjnë fjalë për ekzekutimin ose mosekzekutimin e kërkesave të njoftimit, veprohet në të njëjtën mënyrë sikurse për dërgimin e kërkesave për njoftim.

Neni 140

Ekzekutimi i një kërkesë njoftimi apo përcjelljeje mund të refuzohet nga autoritetet kompetente shqiptare, kur preket sovraniteti apo siguria e shtetit, si dhe kur nuk është paraqitur në përputhje me dispozitat e këtij Kodi.

Neni 141

Rregullat e njoftimit elektronik të akteve

(Ndryshuar me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013 dhe ndryshuar fjalë nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Njoftimi elektronik i akteve bëhet me mjete të komunikimeve elektronike, nëpërmjet dërgimit nga punonjësi i gjykatës të letërthirjes ose akteve të tjera që duhet t'i njoftohen personit të caktuar si marrës, në të dhënat e tij të kontaktit.

Ky njoftim duhet të pasqyrohet në një procesverbal të posaçëm, në të cilin duhet të tregohen të dhënat e kontaktit dhe mjeti i komunikimeve elektronike të përdorura për njoftim, data dhe ora e saktë e komunikimit, personi me të cilin komunikon dhe qëllimi i njoftimit.

Procesverbali hartohet nga sekretari gjyqësor dhe nënshkruhet prej tij dhe punonjësit të gjykatës të ngarkuar për kryerjen e njoftimeve. Ky procesverbal bëhet pjesë e dosjes gjyqësore.

Rregulla të detajuara për mënyrën e njoftimit elektronik përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

Neni 141/a

(Shtuar me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008; shfuqizuar me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013)

Neni 142

Njoftimi për personat me shërbim në ushtri

(Shfuqizuar me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013)

Neni 143

Mënyra të tjera njoftimi

(Ndryshuar me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013)

Në rastet kur njoftimi nuk mund të bëhet në rrugë shkresore dhe elektronike, zbatohen rregullat e parashikuara në nenin 133 të këtij Kodi.

Neni 144

Mënyra të tjera njoftimi

(Ndryshuar me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013)

Njoftimi mund të kryhet në çdo mënyrë tjetër që garanton një njoftim të rregullt për sa kohë që personi i thirrur konfirmon personalisht me shkrim se ka marrë njoftimin.

Neni 144/a

Roli i përmbaruesit në procesin e njoftimit në gjykatë

(Shtuar me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008 dhe ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Rregullat e parashikuara në këtë kre për njoftimet zbatohen edhe nga përmbaruesit gjyqësorë, kur këtë e urdhëron gjykata. Përmbaruesi gjyqësor në këtë rast kryen të njëjtat detyra me ato të punonjësit të gjykatës. Përmbaruesi gjyqësor nuk mund të veprojë si punonjës i gjykatës gjatë fazës së ekzekutimit të titullit ekzekutiv.

KREU V

AFATET

Neni 145

Afatet për kryerjen e veprimeve procedurale caktohen nga ligji dhe kur ky e lejon edhe nga gjykata. Afatet mund të jenë edhe prekluzive kur ligji e parashikon shprehimisht.

Neni 146

Afatet e vendosura nga ligji janë të zakonshme, përveç kur ligji e parashikon shprehimisht se janë të prera. Afatet e prera nuk mund të shkurtohen ose të shtyhen, qoftë edhe me pëlqimin e palëve.

Neni 147

Zgjatja e afateve

Gjykata përpara mbarimit të afatit mund të zgjasë me vendim afatin që nuk është prekluziv. Shtyrja nuk mund të jetë më e gjatë se afati i fillimit, përveç kur ka arsye veçanërisht të rënda që përligjin kërkesën.

Neni 148

Llogaritja e afateve

Kur afati është caktuar me ditë dhe me orë, përjashtohet dita dhe ora në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të fillojë afati.

Afati që është caktuar në javë, në muaj ose në vite mbaron me kalimin e asaj dite të javës së fundit ose të muajit të fundit që ka të njëjtin emër ose numër me atë të ditës që ka filluar afati. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji.

Kur dita e fundit e një afati bie në ditë pushimi, afati mbaron në ditën e punës, që vjen pas asaj të pushimit.

Neni 149

Dita e fundit e afatit vazhdon deri në orën 24.⁰⁰ të saj, por kur do të kryhet ndonjë veprim procedural ose do të paraqitet ndonjë kërkesë ose akt tjetër në gjykatë, afati mbaron në çastin e mbarimit të orarit zyrtar.

Afati nuk quhet i humbur, kur kërkesa ose akti është dërguar me postë edhe në ditën e fundit të afatit.

Neni 150

Afatet dhe pezullimi i gjykimit

Kur pezullohet gjykimi, pezullohen edhe të gjitha afatet që kanë filluar të ecin por nuk janë plotësuar. Në këtë rast, pezullimi i afatit fillon nga çasti që ka ndodhur ngjarja e cila ka shkaktuar pezullimin e gjykimit.

Neni 151

Rivendosja në afatet procedurale

(Ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Kur palët ose prokurori, për arsye që rrjedhin nga forca madhore ose që nuk mund të ishin parashikuar nga ata, kanë tejkalluar afatin procedural ligjor ose atë të përcaktuar nga gjykata, mund t'i kërkojnë gjykatës rivendosjen në këto afate procedurale, përveç kur afatet kanë karakter prekluziv.

Neni 152

(Shtuar fjali në paragrafin e parë me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008)

Kërkesa për rivendosjen e afatit të humbur shqyrtohet nga gjykata së cilës duhet t'i paraqiten edhe dokumentet që justifikojnë ose për të cilat kërkohet rivendosja e afatit. Gjatë shqyrtimit të kërkesës thirret edhe pala tjetër.

Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim i veçantë.

PJESA E DYTË

GJYKIMI NË SHKALLË TË PARË

TITULLI I

PARAQITJA E PADISË, DEKLARATËS SË MBROJTJES, VEPRIMET PËRGATITORE

(Ndryshuar titulli me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

KREU I

HARTIMI, PARAQITJA NË GJYKATË, NJOFTIMI I PADISË DHE VEPRIMET PËRGATITORE

(Ndryshuar titulli me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Neni 153
Hartimi i padisë

Gjykimi i një çështjeje në gjykatë fillon me paraqitjen e kërkesëpadisë me shkrim.

Neni 154
(Ndryshuar me ligjet nr. 8812, datë 17.5.2001; nr. 122/2013, datë 18.4.2013 dhe nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Kërkesëpadia shkruhet në gjuhën shqipe dhe duhet të përmbajë:

- a) gjykatën përpara së cilës paraqitet kërkesa;
- b) emrin, atësinë, mbiemrin, vendbanimin ose vendqëndrimin e paditësit e të paditurit dhe të personave që përkatësisht i përfaqësojnë ata, kur ka të tillë. Nëse paditësi ose i padituri është person juridik, emërtimin e tij ashtu siç figuron në regjistrat publikë, duke treguar edhe selinë ose zyrën qendrore, ku do kryhet njoftimi;
- c) objektin e padisë;
- ç) tregimin konkret të fakteve, rrethanave, dokumenteve, mjeteve të tjera provuese, të së drejtës mbi të cilat mbështetet padia, si dhe kërkimin konkret të paditësit;
- d) vlerën e padisë, në rast se objekti i saj është i vlerësueshëm.

2. Përveç këtyre kërkesave, paditësi në kërkesëpadi duhet të tregojë saktë dhe/ose të bashkëngjisë:

- a) të dhënat elektronike të kontaktit të tij ose të përfaqësuesit, nëse ka një të tillë, ku gjykata mund ta njoftojë;
- b) listën e personave që kërkon të thirren në gjykim në cilësinë e dëshmitarit, duke saktësuar emrin, atësinë, mbiemrin dhe adresën e plotë, si dhe faktet që kërkohet të provohen me to;
- c) provat që kërkohen të merren nga i padituri dhe të tretët, duke përcaktuar arsyet dhe vendndodhjen e këtyre provave;
- ç) llojin e ekspertimit që kërkohet të kryhet gjatë gjykimit;
- d) emrin, atësinë, mbiemrin ose emërtimin nëse është person juridik dhe adresën e plotë të personave të tretë që kërkon të thirren në gjykim me këtë cilësi;
- dh) aktin provues të pagimit të tarifës së padisë, sipas ligjit.

Neni 154/a
Paraqitja e kërkesëpadisë
(Shtuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Kërkesëpadia paraqitet në gjykatë nga paditësi ose nga përfaqësuesi i tij i pajisur me prokurë. Kërkesëpadia mund të paraqitet në gjykatë edhe nëpërmjet postës.

Padia iu caktohet gjyqtarëve me short.

Kur kërkesëpadia nuk plotëson kushtet e përmendura në këtë kre, gjyqtari i vetëm ia kthen paditësit në kohën e paraqitjes së saj ose ai njoftohet me shkrim për plotësimin e të metave dhe, pasi të jetë shënuar në padi data e paraqitjes, caktohet një afat për plotësimin e të metave. Deri në këtë datë padia mbetet pa veprime.

Kur paditësi nuk plotëson të metat brenda afatit të caktuar, kërkesëpadia quhet se nuk është paraqitur dhe i kthehet paditësit së bashku me aktet e tjera.

Kundër vendimit të gjyqtarit të vetëm për kthimin e kërkesëpadisë mund të bëhet ankimi i veçantë.

Kur të metat e kërkesëpadisë janë plotësuar në afatin e caktuar, ajo quhet e regjistruar që nga dita që është regjistruar në gjykatë. Në këtë mënyrë veprohet edhe kur të metat e kërkesëpadisë konstatohen gjatë gjykimit të çështjes.

Neni 155
Njoftimi paraprak i padisë
(Shfuqizuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Neni 156
Aktet që i bashkëngjiten padisë
(Ndryshuar fjalë me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Bashkë me kërkesëpadinë duhet të paraqiten:

- a) prokura, në rast se kërkesëpadia paraqitet në emër të paditësit nga përfaqësuesi i tij;
- b) kopje të kërkesëpadisë dhe të akteve provuese, në numër sa janë të paditurit, si dhe për rastin e parashikuar nga neni 197 i Kodit Civil.

Me paraqitjen e kërkesëpadisë paguhet tarifa, si dhe shpenzimet e nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore.

Kërkesëpadisë i bashkëngjitet thirrja në të cilën shënohen data e paraqitjes në gjykatë, si dhe porosia që në këtë datë të jenë të saktësuara provat që i padituri pretendon se duhen dëgjuar nga gjykata.

Neni 157

Paraqitja e padisë

(Shfuqizuar me ligjin nr. 8812, datë 15.7.2001)

Neni 158

Veprimet paraprake të gjyqtarit të vetëm

(Ndryshuar me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013 dhe nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjykata, pasi e vlerëson padinë pa të meta në zbatim të neneve 154/a dhe 156 të këtij Kodi, i kërkon të paditurit të lëshojë deklaratën e mbrojtjes, jo më vonë se 30 ditë nga njoftimi i kërkesëpadisë. Të njëjtat rregulla zbatohen edhe në rastin e paraqitjes së padisë së ndërhyrësit kryesor, ose të kundërpadisë.

2. Gjykata informon të paditurin në lidhje me përmbajtjen e nevojshme të deklaratës së mbrojtjes, sipas pikave 3 dhe 4, të këtij neni, në lidhje me mundësinë për të kërkuar ndihmë ligjore dhe pasojat ligjore në rast moslëshimi të deklaratës së mbrojtjes.

3. Deklarata e mbrojtjes hartohet në gjuhën shqipe dhe duhet të përmbajë:

- a) gjykatën përpara së cilës paraqitet deklarata e mbrojtjes;
- b) emrin, atësinë, mbiemrin, vendbanimin ose vendqëndrimin e paditësit e të paditurit dhe të personave që përkatësisht i përfaqësojnë ata, nëse ka. Nëse paditësi ose i padituri është person juridik, emërtimin e tij ashtu siç figuron në regjistrat publikë, duke treguar edhe selinë ose zyrën qendrore, ku do kryhet njoftimi;

c) tregimin konkret të fakteve, rrethanave, dokumenteve dhe provave të tjera, si dhe prapësimet dhe argumentet për kundërshtimin e padisë, nëse ka.

4. Përveç këtyre kërkesave, i padituri deklaron qartë në/ose bashkëngjitur deklaratës së mbrojtjes:

a) të dhënat e kontaktit të tij elektronik ose të përfaqësuesve të tij, nëse ka, të cilat gjykata mund t'i përdorë për ta njoftuar;

b) listën e personave që kërkon të thirren në gjykim me cilësinë e dëshmitarit, duke specifikuar saktë emrat e tyre, atësinë, mbiemrin, dhe adresën e tyre të plotë, si dhe faktet që kërkohet të provohen me to;

c) provat që kërkohen të merren tek të tretët ose te paditësi, duke përcaktuar arsyet dhe vendndodhjen e provave;

c) llojin e ekspertimit që kërkohet të kryhet gjatë gjykimit;

d) emrin, atësinë, mbiemrin ose emërtimin e personit juridik dhe adresën e plotë të personave të tretë që kërkon të thirren në gjykim me këtë cilësi;

dh) kundërpadinë, kur kërkohet prej tij ushtrimi i kësaj të drejte, sipas nenit 160 të këtij Kodi.

5. I padituri duhet të informojë gjykatën për çdo ndryshim të mëvonshëm të adresës dhe të të dhënave të kontaktit elektronik për vete ose përfaqësuesin e tij. Shkelja e këtij detyrimi i bën të papranueshme pretendimet për pavlefshmërinë e njoftimit.

6. Deklarata e mbrojtjes bashkë me provat dhe aktet e tjera bashkëngjitur i komunikohet palës paditëse nga gjykata. Pala paditëse ka të drejtë të paraqesë prova të tjera, përveç atyre të përcaktuara në kërkesëpadi, vetëm kur ato lidhen me pretendime të reja të të paditurit, të parashtruara në deklaratën e mbrojtjes.

7. Prapësimet dhe provat që mund të ngrihen ose paraqiten vetëm me kërkesë të palëve, nuk pranohen nga gjykata më pas, nëse nuk janë paraqitur së bashku me deklaratën e mbrojtjes.

Neni 158/a

Vendimet e gjyqtarit gjatë veprimeve paraprake

(Ndryshuar me ligjet nr. 8812, datë 17.5.2001; nr. 10 052, datë 29.12.2008; nr. 122/2013, datë 18.4.2013 dhe nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Në rast se nga studimi paraprak i akteve, gjyqtari konstaton mungesën e juridiksionit ose kompetencës, ose palëve u mungon zotësia për të vepruar ose përfaqësimi është në kundërshtim me ligjin, atëherë ai duhet përkatësisht të vendosë nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, dërgimin e çështjes për gjykim gjykatës kompetente, disponon me vendim, sipas parashikimeve të këtij Kodi, ose i cakton afat palëve për të rregulluar aktet e përfaqësimit.

2. Gjyqtari me vendim, pa caktuar seancë përgatitore, kryen këto veprime:

a) përjashton paditësin nga pagesa e tarifës kur janë rastet e përcaktuara me ligj dhe është bërë kërkesë nga paditësi;

b) cakton provat që do të merren në shqyrtim në seancë gjyqësore dhe cakton ekspertin në fushën përkatëse të ekspertizës, të cilin ua njofton palëve;

c) vendos për marrjen e provave dhe informacioneve tek të tretët kur palët deklarojnë dhe provojnë se nuk kanë mundësi t'i marrin vetë;

ç) vendos për marrjen e masave për sigurimin e padisë, në raste të veçanta ose të ngutshme, sipas nenit 205 të këtij Kodi;

d) nëse është e nevojshme, vendos për sigurimin e provës, sipas neneve 292-295, të këtij Kodi, dhe procedon për marrjen e saj në seancë të posaçme, sipas nenit 296 të këtij Kodi;

dh) vendos për pezullimin e gjykimit kur janë rastet e përcaktuara nga neni 297 i këtij Kodi;

e) vendos për pushimin e gjykimit kur janë rastet e përcaktuara nga neni 299 i këtij Kodi;

ë) vendos për bashkimin e padive në një gjykim të vetëm në rastet e parashikuara në këtë Kod ose për veçimin e kërtimeve;

f) vendos në lidhje me kërkesën për thirrjen e personit të tretë në gjykim, sipas nenit 193 të këtij Kodi.

Neni 158/b

Seanca përgatitore

(Shtuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001 dhe ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjyqtari cakton detyrimisht seancën e veprimeve përgatitore në rastet kur merr në shqyrtim kërkesat për ndërhyrje kryesore, dytësore, për zëvendësim procedural, kalim procedural, ndryshimin e shkakut ose shtimin, pakësimin ose ndryshimin e objektit të padisë, paraqitjen e kundërpadisë, si dhe caktimin e ekspertit.

2. Për vendimet e tjera që merren nga gjyqtari gjatë veprimeve paraprake mund të kryhet seancë përgatitore kur çmohet prej tij nevoja e thirrjes dhe dëgjimit të palëve, si dhe në raste të tjera të parashikuara në ligj.

Neni 158/c

Urdhri për caktimin e seancës gjyqësore

(Shtuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjyqtari, menjëherë pasi kryen të gjitha veprimeve paraprake dhe/ose përgatitore të nevojshme, nxjerr urdhrin për caktimin e seancës gjyqësore, i cili u njoftohet palëve dhe personave të tretë.

2. Urdhri për caktimin e seancës gjyqësore përmban:

a) datën, orën dhe vendin e zhvillimit të seancës gjyqësore;

b) palët të cilat kërkohen të pyeten nga gjykata, sipas nenit 182, të këtij Kodi, dhe, sipas rastit, dëshmitarët, që duhet të marrin pjesë në seancë gjyqësore;

c) ekspertin ose grupin e ekspertëve të caktuar nga gjyqtari;

ç) njoftimin dhe mënyrën e njoftimit të palëve dhe të personave që duhet të marrin pjesë në seancë.

3. Njoftimi drejtuar dëshmitarëve, përkthyesit dhe ekspertit, duhet të përmbajë paralajmërimin për sanksione, sipas ligjit, për mosparaqitje në seancë, pa shkak të ligjshëm.

Neni 158/ç

Veprimet e pajtimit

(Shtuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjyqtari, gjatë veprimeve përgatitore, bën të gjitha përpjekjet për të zgjidhur mosmarrëveshjen me pajtim, kur e lejon natyra e çështjes. Për këtë qëllim, kur është rasti, urdhëron edhe paraqitjen e vetë palëve.

2. Në çdo fazë të gjykimit, gjykata vë në dijeni palët lidhur me mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim dhe nëse ato pranojnë e kalon çështjen për ndërmjetësim.

3. Kur arrihet pajtimi pa filluar seanca gjyqësore, mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga palët. Gjyqtari me vendim miraton pajtimin.

4. Në rast të paraqitjes së aktmarrëveshjes për pajtim ose për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me ndërmjetësim, gjykata vendos miratimin e saj, nëse kjo e fundit nuk është në kundërshtim me ligjin.

5. Kur pajtimi arrihet në seancë gjyqësore, kushtet e marrëveshjes pasqyrohen në procesverbalin gjyqësor. Gjykata jep vendim për miratimin e tij, por në çdo rast ai nuk duhet të jetë në kundërshtim me ligjin.

6. Kundër vendimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me pajtim ose me ndërmjetësim, ose mospranimin e pajtimit, mund të bëhet ankimi i veçantë.

Neni 159

Bashkimi i kërtimeve

Në një kërkesëpadi mund të parashtrohen shumë kërtime, në rast se gjykata është kompetente për të gjitha kërkimet. Kur gjykata çmon se shqyrtimi i përbashkët i tyre, do të shkaktojë vështirësi të dukshme në zhvillimin e gjykimit, vendos që ato të shqyrtohen veç e veç.

Neni 160

Kundërpadia

(Ndryshuar paragrafi i tretë me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001 dhe paragrafi i dytë me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

I padituri ka të drejtë të paraqesë kundërpadi kur kërkitimi i kundërpadisë ka lidhje me atë të padisë ose kur midis tyre mund të bëhet kompensimi.

Kundërpadia mund të paraqitet derisa nuk është nxjerrë urdhri për caktimin e seancës gjyqësore, sipas nenit 158/c të këtij Kodi.

Kur të metat e kundërpadisë nuk plotësohen në afatin e caktuar nga gjykata, kundërpadia kthehet.

KREU II

BASHKËNDËRGJYQËSIA

Neni 161

(Shtuar shkronja "c" me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008 dhe shkronja "ç" me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Padia mund të ngrihet bashkërisht nga shumë paditës ose kundër shumë të paditurve (bashkëndërgjyqës) në rast se:

a) kanë të drejta ose detyrime të përbashkëta mbi objektin e padisë;

b) të drejtat dhe detyrimet e tyre nga pikëpamja e faktit ose e ligjit kanë po atë bazë.

c) në rast se gjykimi ka filluar dhe paditësi vëren se kërkitimi i tij shtrihet edhe ndaj një personi tjetër, atëherë mund ta shtrijë kërkimin edhe ndaj këtij të fundit, duke e thirrur si të paditur.

ç) nëse vendimi nuk mund të jepet përveçse kundrejt shumë personave, në rastin e bashkëndërgjyqësisë së detyrueshme, këta të fundit duhet të thirren si të paditur në të njëjtin proces. Gjyqtari, kur konstaton se bashkëndërgjyqësia e detyrueshme në anën e të paditurve është e paplotë, i lë palës paditëse një afat deri në 20 ditë që ta rregullojë atë, sipas shkronjës "c", të këtij neni, dhe nenit 154/a të këtij Kodi. Në rast se paditësi nuk vepron brenda afatit të mësipërm, gjykata vendos pushimin e gjykimit.

Neni 162

Secili nga bashkëndërgjyqësit kundrejt palës kundërshtare paraqitet i pavarur në mënyrë që veprimet ose mosveprimet e tij procedurale nuk u sjellin të tjerëve as dobi as dëm.

Kur, për shkak të natyrës së marrëdhënieve juridike që janë në konflikt ose për shkak të një dispozite ligjore, efekti i vendimit, që do të jepet, shtrihet në të gjithë bashkëndërgjyqësit, veprimet procedurale që janë kryer prej disa bashkëndërgjyqësve kanë efekt edhe për bashkëndërgjyqësit e tjerë që nuk janë paraqitur në gjykatë ose që nuk kanë kryer ndonjë veprim në afatin e caktuar.

Neni 162/a

Procedura e shqyrtimit të padive për shuma të vogla

(Shtuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017, ndryshuar fjalë në pikën 1 dhe ndryshuar pika 4 me ligjin nr. 44/2021, datë 23.3.2021)

1. Paditë me vlerë **deri në njëzetfishin e pagës minimale në shkallë vendi**, që rrjedhin nga marrëdhënie kontraktore, shqyrtohen nga gjykata me gjykim të shkurtuar.

2. Shqyrtimi i çështjes me gjykim të shkurtuar para gjykatës bëhet me shkrim. Gjykata mund të zhvillojë seancë gjyqësore verbale nëse e çmon të nevojshme.

3. Në lidhje me gjykimet e padive të mësipërme, zbatohen vetëm rregullat e parashikuara në paragrafin e dytë, të nenit 172, neneve 236/a, 285/a, 310, 315, 460 dhe 510 të këtij Kodi.

4. Në rast se vlera e padisë është më e vogël se njëzetfishi i pagës minimale në shkallë vendi dhe vlera e kundërpadisë tejkalon njëzetfishin e pagës minimale në shkallë vendi, gjykimi zhvillohet sipas dispozitave të përgjithshme për gjykimin e zakonshëm.

KREU III

DREJTIMI I PROCESIT

(Shfuqizuar nenet 163-164 me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

KREU IV

GJOBAT

Neni 165

Mosparaqitja në gjyq pa shkaqe të arsyeshme

(Ndryshuar masa e gjobës me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Kur dëshmitari ose eksperti, që është thirrur në gjykatë, nuk paraqitet pa shkaqe të arsyeshme, gjykata e dënon me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë dhe urdhëron sjelljen e tij me detyrim.

Neni 166

Kundërshtimi për të dëshmuar

(Ndryshuar masa e gjobës me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Kur dëshmitari pa ndonjë shkak të arsyeshëm kundërshton të dëshmojë ose eksperti të japë mendimin, gjykata i dënon me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë.

Neni 167

Mosparaqitja në gjyq e dokumentit ose e sendit nga personi i tretë

(Ndryshuar masa e gjobës me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Kur një person i tretë, që nuk është palë, nuk pranon të paraqesë një dokument ose një send, që provohet se ndodhet pranë tij dhe që i është kërkuar nga gjykata dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë.

Neni 168

Mosbindja e urdhrit të kryetarit të seancës

(Ndryshuar masa e gjobës dhe fjalia e dytë me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Kur personat që marrin pjesë në gjykimin e çështjes, si dhe personat e tjerë që asistojnë në gjykim nuk u binden urdhrave të kryetarit të seancës gjyqësore, me vendim të gjykatës mund të dënohen me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë. Në rastet kur prokurori dhe/ose avokati nuk i binden urdhrave të gjykatës, sipas këtij neni, gjykata ka detyrimin të njoftojë organet përgjegjëse për disiplinën e tyre.

Neni 169

Kundërshtimi i vendimit të dënimit

Personat që janë dënuar me gjobë, sipas dispozitave të mësipërme, mund t'i paraqitin gjykatës që i ka dënuar, brenda tri ditëve, kërkesë për heqjen e dënimit, duke treguar dhe shkaqet.

Gjykata kur i gjen me vend këto shkaqe, revokon vendimin e dënimit me gjobë si dhe urdhrin e sjelljes me detyrim. Ajo mund edhe vetëm të pakësojë gjobën e caktuar. Në rast të kundërt, refuzon kërkesën.

Afati për të paraqitur kërkesën fillon nga dita e seancës gjyqësore dhe, në rastet e parashikuara nga nenet 165 dhe 167, nga dita e njoftimit të vendimit të dënimit.

Vendimi i dhënë nga gjykata në rastet e sipërme është i formës së prerë dhe kundër tij nuk lejohet ankim.

TITULLI II

SHQYRTIMI I ÇËSHTJES

KREU I

VEPRIMET PËRGATITORE

(Shfuqizuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Neni 170

(Shfuqizuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Neni 171

Veprimet e pajtimit

(Shfuqizuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

KREU II

DREJTIMI I PROCESIT DHE SEANCA GJYQËSORE

(Shtuar titulli me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Neni 171/a

Të drejtat e gjykatës për zhvillimin e procesit gjyqësor dhe mjetet për zbatimin e tyre

(Shtuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001 dhe shtuar fjalë me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Gjykata ushtron të gjitha të drejtat e përcaktuara në këtë Kod, që janë të nevojshme për zhvillimin sa më të mirë të procesit gjyqësor.

Gjykata cakton seancat dhe afatet brenda të cilave palët dhe personat e tjerë të thirrur prej saj duhet të kryejnë aktet procedurale dhe veprime të tjera të kërkuara prej saj.

Gjykata drejton procesin gjyqësor nëpërmjet vendimeve dhe urdhrave. Vendimet dhe urdhrat e shpallura në seancë gjyqësore quhen të njohura nga palët e pranishme ose që duhej të paraqiteshin në gjykatë. Vendimet e shpallura jashtë seancës dhe ato, ndaj të cilave lejohet ankim i veçantë u komunikohen palëve të interesuara nga sekretari i seancës jo më vonë se tre ditë nga shpallja e tyre.

Neni 171/b

(Shtuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001 dhe shtuar fjalë me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Vendimet e ndërmjetme dhe urdhrat që jep gjykata në seancë gjyqësore duhet të arsyetohen dhe të mos paragjykojnë zgjidhjen e çështjes.

Vendimet mund të ndryshohen ose të revokohen nga gjykata që i ka shpallur përveç kur:

- a) janë shpallur mbi bazën e një marrëveshjeje të palëve, në rastet që ato vetë mund të disponojnë. Megjithatë, mund të revokohen nga gjykata kur është përcaktuar në marrëveshjen e palëve;
- b) në këtë Kod përcaktohet se kundër tyre mund të ushtrohet ankimi i veçantë;
- c) ligji i deklaron si të paankimueshme.

Neni 172

(Ndryshuar me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013)

Shqyrtimi i çështjes përpara gjykatës bëhet verbalisht, por palët mund të parashtrojnë me shkrim shpjegimet dhe pretendimet e tyre rreth çështjes në gjykim.

Shpjegimet dhe pretendimet me shkrim të paraqitura nga palët, në mbështetje të kërkesave dhe konkluzioneve të tyre, bëhen pjesë e dosjes gjyqësore, ose i bashkohen procesverbalit kur ai mbahet me shtypshkrim apo dorëshkrim.

Neni 173

Gjykimi me dyer të mbyllura

(Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Nuk lejohet qëndrimi në seancë gjyqësore me dyer të mbyllura i të miturve nën 16 vjeç, përveç kur ata thirren nga gjykata.

Gjykata mund të mos lejojë pjesëmarrjen e organeve të medias dhe publikut gjatë një pjese ose gjatë gjithë zhvillimit të procesit gjyqësor:

- a) në interes të moralit;
- b) të rendit publik;
- c) të ruajtjes së informacionit të klasifikuar ose sigurisë kombëtare;
- ç) kur e kërkojnë interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve dhe pjesëmarrësve në gjyq;
- d) kur përmenden sekrete tregtare ose shpikje industriale, nga publikimi i të cilave mund të cenohen interesat që mbrohen me ligj;
- dh) në masën e çmuar nga gjykata, në rrethana të veçanta, publikimi mund të paragjykojë interesat e drejtësisë.

Vendimi shpallet publikisht.

Neni 174

Çelja dhe zhvillimi i seancës gjyqësore

(Ndryshuar fjalë në paragrafin e dytë me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Në ditën dhe në orën e caktuar palët ose përfaqësuesit e tyre janë të detyruar të njoftojnë gjykatën për praninë e tyre.

Përpara se të fillojë seanca gjyqësore sekretari ose punonjësi i gjykatës thërret palët ose përfaqësuesit e tyre dhe i fton ata të zënë vendet e caktuara.

Neni 175

Pasi deklarohet çelja e seancës gjyqësore, gjykata verifikon paraqitjen e palëve dhe heton shkaqet kur njëra ose të dyja ato nuk janë paraqitur në seancë.

Në rast se mosparaqitja ka ndodhur për shkak sëmundjeje ose për ndonjë shkak tjetër të ligjshëm, gjykata shtyn gjykimin për një ditë tjetër.

Neni 176

Legjitimimi i palëve në proces

Gjykata verifikon legjitimimin si palë të personave ose të përfaqësuesve të tyre të paraqitur dhe kur është rasti i fton ata të plotësojnë aktet dhe dokumentet që rezultojnë me të meta, duke përfshirë këtu edhe aktet lidhur me përfaqësimin, gjetjen e personit dhe, kur e shih të nevojshme, u cakton palëve një afat.

Neni 177

Drejtimi i hetimit gjyqësor nga kryetari i seancës
(Shtuar fjalë në fund të paragrafit të dytë, me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013)

Kryetari i seancës gjyqësore drejton hetimin gjyqësor dhe bisedimet e palëve, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë Kod.

Kur ndonjë nga palët bën vërejtje ndaj veprimeve të kryetarit të seancës, duke pretenduar se u kufizohen ose u shkelen të drejtat e tyre, këto duhet të pasqyrohen në procesverbal kur ai mbahet në formë të përmbledhur me shtypshkrim apo dorëshkrim.

Neni 178

Sigurimi i rregullit dhe i qetësisë në seancë gjyqësore

Kryetari i seancës gjyqësore kujdeset për mbajtjen e rregullit e të qetësisë në seancë. Ai ka të drejtë të urdhërojë largimin nga salla e gjyqit të personave që prishin rregullin e qetësinë e zhvillimit të seancës gjyqësore. Kur prokurori ose avokati nuk u binden urdhrave të kryetarit të seancës gjyqësore, gjykata vë në dijeni organin përkatës të prokurorisë ose të këshillit drejtues të avokatisë dhe kërkon prej tyre marrjen e masave disiplinore. Gjykata mund të shtyjë seancën derisa të caktohet një prokuror ose një avokat tjetër.

Neni 179

Pasojat juridike të mosparaqitjes së palëve

(Ndryshuar me ligjet nr. 8812, datë 17.5.2001 dhe nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Nëse asnjë nga palët, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqitet në seancë përgatitore ose në seancë gjyqësore dhe rezulton se ka dijeni rregullisht, gjykata vendos pushimin e gjykimit.

2. Nëse paditësi, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqitet në seancë përgatitore ose në seancë gjyqësore dhe rezulton se ka dijeni rregullisht, gjykata vendos pushimin e gjykimit, kur i padituri nuk ka dorëzuar deklaratën e mbrojtjes. Kur i padituri e ka dorëzuar deklaratën e mbrojtjes, mund të kërkojë vijimin e gjykimit në mungesë të paditësit dhe gjykata, kur vlerëson se qëndrimi i të paditurit ka shkak të ligjshëm, vijon gjykimin në mungesë të paditësit.

3. Nëse i padituri, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqitet në seancë përgatitore ose në seancë gjyqësore dhe rezulton se ka dijeni rregullisht, gjykata vendos pushimin e gjykimit, nëse paditësi nuk kërkon që gjykimi të zhvillohet në mungesë.

4. Përveç kur parashikohet ndryshe në ligj, gjykata nuk njofton më palën që vendos të gjykojë në mungesë.

Neni 180

Shpallja e trupit gjykues dhe shpjegimet e palëve

(Shfuqizuar paragrafi i katërt dhe i pestë me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Pasi të jenë kryer veprimet e mësipërme, shpallet përbërja e trupit gjykues dhe zgjidhen kërkesat paraprake të palëve.

Gjykata në seancën e parë gjyqësore u kërkon palëve, që në bazë të fakteve të pretenduara prej tyre, të japin sqarimet e nevojshme, duke u vënë në dukje çështjet që nga pikëpamja procedurale i quan të nevojshme e të dobishme për gjykimin e çështjes.

Në fillim paditësi jep shpjegime rreth kërkesave të parashtruara në padi, pastaj i padituri dhe pjesëmarrësit e tjerë në proces. Secili prej tyre është i detyruar të përcaktojë faktet dhe provat mbi të cilat mbështeten pretendimet e prapësimet e tyre.

Shfuqizuar.

Shfuqizuar.

Neni 181

Përfundimi i gjykimit nga i njëjti trup gjykues

(Ndryshuar paragrafi i dytë dhe shfuqizuar paragrafi i tretë me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Gjykata duhet të organizojë punën që gjykimi i çështjes të përfundojë nga i njëjti trup gjykues.

Kur për shkaqe të përligjura, ndryshon përbërja e trupit gjykues, anëtari ose anëtarët e rinj duhet të njihen me përmbajtjen e procesit gjyqësor. Anëtari ose anëtarët e rinj mund të kërkojnë që hetimi gjyqësor të përsëritet pjesërisht ose tërësisht.

Shfuqizuar.

Neni 182

Paraqitja personalisht e palëve

Gjykata, në çdo fazë të gjykimit, ka të drejtë të kërkojë që palët të paraqiten personalisht për t'u pyetur, për rrethana që çmon se kanë rëndësi për zgjidhjen e çështjes, pavarësisht se kanë përfaqësues ose që gjykimi zhvillohet në mungesë të tyre.

Kur, me gjithë urdhrin e dhënë nga gjykata sipas paragrafit të mësipërm, pala e thirrur nuk është paraqitur pa ndonjë shkak të ligjshëm ose refuzon t'u përgjigjet pyetjeve që i bëhen, gjykata vlerëson qëndrimin e saj në harmoni me provat e tjera.

Neni 183

Zgjidhja e kërkesave të palëve

Për kërkesat e parashtruara nga palët sipas neneve 180 dhe 182 të këtij Kodi, gjykata shprehet me vendim. Në raste të veçanta, që paraqesin vështirësi gjykimi, ajo mund ta shtyjë deklarinimin e vendimit deri në tri ditë.

Gjykata, me vendim, lejon marrjen e provave dhe kur është rasti edhe mënyrën e marrjes së tyre. Refuzimi i marrjes së provës së kërkuar duhet të arsyetohet nga gjykata, pa e paragjykuar çështjen.

Neni 184

Zëvendësimi i palëve

Kur gjatë gjykimit del se padia është ngritur nga një person, që nuk ka të drejtë ta ngrejë, ose është ngritur kundër një personi ndaj të cilit nuk duhej të ngrihej, me kërkesën e palës së interesuar gjykata mund të lejojë zëvendësimin e paditësit ose të të paditurit të parë, me paditësin që i përket e drejta që të ngrejë padinë ose me të paditurin kundër të cilit duhej të ngrihej padia. Për këtë zëvendësim gjykata duhet të marrë më parë pëlqimin e të dy palëve dhe të personit që hyn në vend të tyre si palë.

Neni 185

(Ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001 dhe nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Paditësi, gjatë veprimeve përgatitore, ka të drejtë të paraqesë kërkesë me shkrim për ndryshimin e shkakut të padisë. Ai pa e ndryshuar shkakun e padisë, mund të shtojë, të pakësojë ose të ndryshojë objektin e saj.

2. Në seancë gjyqësore mund të shtohet, pakësohet ose ndryshohet vetëm objekti i padisë, kur një nevojë e tillë lind për shkak të provave të marra në seancën gjyqësore.

3. Kur ndryshimet e mësipërme bëhen në mungesë të të paditurit ose të personave të tretë të thirrur në gjykim, duhet t'u komunikohen atyre me shkrim.

4. Nuk quhet shtesë e objektit të padisë, kërkitimi i kamatës ose i të ardhurave të tjera të objektit.

Neni 186

(Ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Pas urdhrin të gjyqtarit të vetëm për caktimin e seancës gjyqësore, sipas nenit 158/c, të këtij Kodi, nuk mund të kërkojnë prova të reja dhe të pretendohen fakte të reja, përveçse kur:

a) pala e interesuar provon se, pa fajin e saj, nuk ishte në gjendje të paraqiste këto fakte dhe/ose prova të reja më parë;

b) pala e interesuar provon se nuk mund të ishte në dijeni të fakteve dhe/ose provave të reja;

c) ekziston një interes publik për pranimin e provave të reja.

2. Kjo dispozitë nuk zbatohet për marrjen e pohimit gjyqësor ose jashtëgjyqësor.

Neni 187

(Ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Pala që është deklaruar në mungesë mund të paraqitet në çdo moment të procesit gjyqësor. Ajo mund të kërkojë që të kryhen veprime procedurale për llogari të saj, lidhur me hetimin gjyqësor të zhvilluar më parë, kur vërtetohet pavlefshmërinë e thirrjes në gjyq ose mosparaqitjen për shkaqe të pavarura prej saj.

Neni 188

Vendimi i gjykatës që pranon kërkesën për ndërpyetjen ose kërkesat e tjera, sipas nenit të mësipërm, i njoftohen palës në mungesë në afatet që cakton gjykata. Aktet dhe veprimet e tjera nuk i nënshtrohen njoftimit.

KREU III

PJESËMARRJA E PERSONAVE TË TRETË NË PROCESIN CIVIL

Neni 189

Ndërhyrja kryesore

Kushdo mund të ndërhyjë në një proces gjyqësor që zhvillohet ndërmjet personave të tjerë, kur pretendon për vete tërësisht ose pjesërisht sendin ose një të drejtë që është objekt i padisë në shqyrtim, ose që lidhet me përfundimin e gjykimit, duke ngritur padi kundër të dy palëve ose njëres prej tyre.

Neni 190

(Ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Për të ndërhyrë në një proces civil, sipas nenit 189, të këtij Kodi, personi i tretë duhet të paraqesë kërkesën së bashku me padinë, derisa nuk është nxjerrë urdhri për caktimin e seancës gjyqësore, sipas nenit 158/c, të këtij Kodi, duke përmbushur kërkesat e neneve 154 dhe 156 të këtij Kodi.

Neni 191

Ndërhyrja dytësore

(Shtuar një fjali me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Kushdo mund të ndërhyjë në një proces gjyqësor që zhvillohet ndërmjet personave të tjerë, kur ka interes për të mbështetur njëren ose tjetrën palë, me të cilën bashkohet në gjykim për ta ndihmuar atë. Kërkesa së bashku me aktet provuese, nëse ka të tilla, mund të ushtrohet derisa nuk është nxjerrë urdhri për caktimin e seancës gjyqësore, sipas nenit 158/c të këtij Kodi.

Neni 192

Thirrja e personit të tretë

(Ndryshuar paragrafi i tretë me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Secila palë mund të thërresë në gjykimin e çështjes një person me të cilin mendon se e ka të përbashkët çështjen ose nga i cili mund të kërkohet një garanci ose shpërblim, që lidhet me përfundimin e çështjes.

Personi i tretë thirret me kërkesë të shkruar që paraqitet në seancën përgatitore ose në sekretarinë gjyqësore kur ka filluar shqyrtimi i padisë. Kërkesa i njoftohet menjëherë gjyqtarit i cili urdhëron që t'i njoftohet personit të tretë, mundësisht pa shtyrë seancën gjyqësore të caktuar.

Thirrja e personit të tretë mund të kryhet derisa nuk është nxjerrë urdhri për caktimin e seancës gjyqësore, sipas nenit 158/c të këtij Kodi.

Neni 193

(Ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Gjykata, kur çmon se procesi gjyqësor duhet të zhvillohet në prani të një personi të tretë, i cili rezulton se ka interes në çështje, e thërret atë derisa nuk është nxjerrë urdhri për caktimin e seancës gjyqësore, sipas nenit 158/c të këtij Kodi.

Sekretari njofton atë me letërthirrje.

Neni 194

Gjykata pranon marrjen pjesë të personit të tretë në gjykimin civil me vendim të ndërmjetëm. Kundër vendimit që refuzon marrjen pjesë të personit të tretë mund të bëhet ankim i veçantë.

Neni 195

Të drejtat procedurale të personit të tretë

Personi i tretë ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet procedurale që u lejohen palëve përveç atyre që përbëjnë disponim të objektit të padisë.

Me pëlqimin e të dy palëve personi i tretë që ka ndërhyrë vetë ose është thirrur në gjykatë nga njëra prej palëve, mund të zërë vendin e palës për të cilën ka ndërhyrë dhe kjo e fundit të dalë jashtë gjykimit.

Neni 196

Vendimi që jepet pas ndërhyrjes dytësore ose thirrjes së personit të tretë ka efekt kundrejt tij si përsa u përket marrëdhënieve të tij me personin që e ka thirrur ose për të cilin ka ndërhyrë për ta ndihmuar, ashtu dhe përsa u përket marrëdhënieve të tij me anën kundërshtare.

Neni 197

Nëse personi që është bërë garant paraqitet në gjyq dhe merr përsipër të zëvendësojë në çështje personin e garantuar, ky i fundit mund të kërkojë largimin e tij nga gjykimi, duke u përfaqësuar në gjykim nga garantuesi, në rast se palët nuk kanë kundërshtim.

Për këtë kërkim vendos gjykata por vendimi i saj mbi themelin e çështjes e shtrin efektin edhe ndaj personit të garantuar.

Neni 198

Dalja jashtë gjykimit e personit të paditur

Personi që paditet për pagimin e një detyrimi ose për dorëzimin e një sendi ose për njohjen e një të drejte reale, për të cilat ka pretendime edhe një i tretë, ka të drejtë ta thërrasë këtë në gjykim me qëllim që çështja të gjykohet midis paditësit e këtij personi dhe të kërkojë nga gjykata të dalë jashtë gjykimit duke pranuar të derdhë detyrimin ose të depozitojë sendin apo të njohë të drejtën reale, në vendin e mënyrën e caktuar prej saj.

Dalja e të paditurit jashtë gjykimit bëhet me leje të gjykatës.

Kur personi i tretë nuk pranon të marrë pjesë në gjykim vendoset pushimi i çështjes dhe shuma e derdhur ose sendi i depozituar i dorëzohen paditësit.

Neni 199

Kalimi procedural

Kur njëra nga palët vdes, çështja vazhdon nga ose kundër trashëgimtarëve të saj.

Kur pala që është person juridik mbaron, çështja vazhdon nga ose kundër personit juridik a fizik, të cilit i kanë kaluar të drejtat e detyrimet e personit juridik që ka mbaruar.

Neni 200

Kur gjatë zhvillimit të gjykimit e drejta që është në konflikt i kalon një personi tjetër me akt ndërmjet të gjallëve ose me titull të posaçëm, procesi gjyqësor vazhdon midis po atyre palëve që ishin në fillim.

Personi të cilit i ka kaluar e drejta në konflikt mund të ndërhyjë ose të thirret në gjykim si person i tretë, ose mund të zëvendësojë në gjykim palën nga e cila i ka kaluar e drejta në konflikt, por vetëm në kushtet e parashikuara nga ky Kod.

Vendimi i dhënë ka fuqi edhe kundër personit të cilit i ka kaluar e drejta në konflikt, me përjashtim të rastit kur e drejta e pronësisë mbi një send të luajtshëm është fituar me mirëbesim (neni 166 i Kodit Civil) dhe në zbatimin e rregullave mbi regjistrimin e sendeve.

Neni 201

Heqja dorë nga gjykimi

(Ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Paditësi në çdo fazë të gjykimit në shkallë të parë, mund të heqë dorë nga gjykimi i padisë. Heqja dorë ka efekt nëse i padituri e pranon atë. Megjithatë, pranimi i të paditurit nuk është i nevojshëm nëse ai, në kohën kur paditësi paraqet kërkesën për heqje dorë nga gjykimi, nuk ka dorëzuar ende deklaratën e mbrojtjes për themelin e çështjes.

2. Gjykata mund të vendosë pushimin e gjykimit edhe nëse mospranimi i të paditurit nuk ka shkak të ligjshëm.

Neni 201/a

Heqja dorë nga e drejta e padisë

(Shtuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Paditësi në çdo fazë të gjykimit mund të heqë dorë krejtësisht ose pjesërisht nga e drejta e padisë. Në këtë rast padia rrëzohet dhe paditësi nuk ka të drejtë të ngrejë përsëri po këtë padi. Heqja dorë nga e drejta e padisë përpara gjykatës së apelit sjell si rrjedhojë prishjen e vendimit të gjykatës të shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë.

KREU IV

SIGURIMI I PADISË

Kur lejohet sigurimi i padisë

Neni 202

(Shtuar fjalë në paragrafin e parë me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008)

Me kërkesën e paditësit, gjykata brenda 5 ditëve lejon marrjen e masave për sigurimin e padisë, kur ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë.

Sigurimi i padisë lejohet kur:

a) padia mbështetet në prova me shkresë;

b) paditësi jep garanci, në masën dhe në llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t'i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë.

Garancia mund të kërkohet edhe për rastin e parashikuar nga shkronja "a" e këtij neni.

Neni 203

(Shtuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013)

Sigurimi i padisë lejohet për të gjitha llojet e padive dhe në çdo fazë të gjykimit, derisa vendimi të marrë formë të prerë. Sigurimi i padisë lejohet edhe nga gjykata e apelit, kur padia është duke u shqyrtuar prej saj.

Sigurimi i padisë nuk lejohet në rastet e padive që ngrihen gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit, për të cilat zbatohet pjesa e katërt e këtij Kodi.

Neni 204

Sigurimi i padisë mund të kërkohet edhe përpara ngritjes së padisë në gjykatën e vendit ku ka banimin paditësi ose ku ndodhet pasuria me të cilën do të sigurohet padia.

Në këtë rast gjykata cakton një afat jo më shumë se pesëmbëdhjetë ditë, brenda të cilit duhet të paraqitet padia në gjykatë.

Neni 205

(Ndryshuar fjalë në paragrafin e dytë me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Sigurimi i padisë mund të lejohet për të gjithë padinë, ose vetëm për ato pjesë të saj, që gjykata i gjen të bazuara, në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 202 të këtij Kodi.

Kërkesa, si rregull, shqyrtohet në prani të palëve, por në raste të veçanta ose të ngutshme, mund të shqyrtohet në dhomë këshillimi.

Neni 206

Llojet e masave për sigurimin e padisë

(Ndryshuar shkronja "b" e paragrafit të parë, me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013)

Sigurimi i padisë bëhet:

a) me sekuestrimin e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme si dhe të kredive të debitorit;

b) me anë të masave të tjera të përshtatshme të marra nga gjykata.

Gjykata mund të lejojë sigurimin e padisë me disa nga llojet e ndryshme të masave të sigurimit, por gjithmonë për një shumë të përgjithshme jo më të madhe se atë të padisë.

Sekuestro nuk mund të vihet mbi sende që, sipas nenit 529 të këtij Kodi, nuk mund të sekuestrohen.

Neni 207

Ndryshimi dhe zëvendësimi i masave për sigurimin e padisë

Gjykata me kërkesën e njëres nga palët mund të zëvendësojë një masë sigurimi me një tjetër, pasi më parë të ketë dëgjuar edhe palën kundërshtarë.

Në këtë mënyrë veprohet edhe kur gjykata vendos heqjen e masës së sigurimit, kur çmon se është zhdukur shkak për të cilin është vënë ajo.

Neni 208

Ekzekutimi i masave për ekzekutimin e padisë

Vendimet për sigurimin e padisë ekzekutohen sipas rregullave të caktuara në këtë Kod për ekzekutimin e vendimeve mbi sendet e luajtshme dhe të paluajtshme.

Neni 209

Ankimi

Kundër vendimit të gjykatës që ka vendosur pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë, për ndryshimin ose heqjen e sigurimit të padisë, mund të bëhet ankimi i veçantë.

Ankimi i vendimit të sipërm nuk pengon vazhdimin e shqyrtimit të padisë.

Neni 210

Ankimi kundër vendimit që lejon masën e sigurimit, nuk pezullon ekzekutimin e tij.

Ankimi kundër vendimit me të cilin zëvendësohet ose hiqet masa e sigurimit, pezullon ekzekutimin e tij.

Neni 211

Rënia e masës së sigurimit të padisë

(Ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013)

Mosparaqitja e padisë brenda afatit të caktuar nga gjykata, e vërtetuar nga kryesekretari, shuan masën e sigurimit të padisë.

Kur vendoset refuzimi i padisë ose pushimi i gjykimit të saj, gjykata vendos heqjen e sigurimit të padisë, e cila zbatohet kur vendimi të marrë formën e prerë.

Garancia e dhënë sipas nenit 202 të këtij Kodi, i kthehet paditësit, në rast se pala tjetër brenda pesëmbëdhjetë ditëve pasi vendimi të ketë marrë formën e prerë, nuk paraqet padi për shpërblimin e dëmit të ardhur për një shkak të tillë.

Neni 212

Ligjërimi i masës së sigurimit të padisë

Kur në vendimin përfundimtar padia pranohet, gjykata vendos edhe ligjërimin e sigurimit të padisë.

Kur si masë sigurimi të padisë është vendosur sekuestrimi, ajo kthehet në sekuestrim ekzekutiv, pasi vendimi përfundimtar të marrë formën e prerë.

KREU V

RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR MARRJEN E PROVAVE

Neni 213

Lejimi i provave

Në zbatim të nenit 12 të këtij Kodi, gjykata me vendim lejon palët të provojnë faktet mbi të cilat i bazojnë kërkimet dhe pretendimet e tyre, duke paraqitur në gjykatë vetëm ato prova që janë të domosdoshme e që kanë lidhje me çështjen e gjykimit.

Neni 214

Pohimi gjyqësor

Pohimet e bëra në gjykatë prej palëve apo prej përfaqësuesve të tyre, çmohen nga gjykata pa nënvleftësuar provat e tjera dhe rrethanat e çështjes.

Neni 215

Letërporosia

Kur prova duhet të merret jashtë territorit të veprimtarisë së gjykatës, kjo i delegon kompetencat e saj gjykatës së vendit ku ndodhet prova, përveç kur palët e kërkojnë bashkërisht që për këtë qëllim të delegohet njëri prej anëtarëve të trupit gjykues.

Në vendimin e gjykatës caktohet një afat brenda të cilit duhet të merret prova dhe caktohet seanca tjetër për vazhdimin e gjykimit.

Neni 216

Prova merret nga gjyqtari i caktuar prej kryetarit të gjykatës që i është drejtuar kërkesa, duke pasqyruar veprimet e kryera në procesverbal, i cili i dërgohet gjykatës në afatin e caktuar.

Palët janë të lira të marrin pjesë në marrjen e provës.

Deklaratat e palëve dhe të dëshmitarëve merren në vetën e parë dhe pasi i lexohen deklaruesit, nënshkruhen prej tij.

Neni 217

Gjyqtari që procedon për marrjen e provës edhe kur delegohet sipas nenit 215 të këtij Kodi, zgjedh me vendim të gjitha çështjet që dalin gjatë marrjes së provës.

Neni 218

Dëshmitari që nuk flet ose nuk dëgjon

Kur merret në pyetje një person që nuk flet ose nuk dëgjon, në qoftë se pyetja e tyre nuk mund të bëhet me shkrim, gjykata thërret një person që i kupton shenjat e personit që merret në pyetje.

Neni 219

Ndihma juridike nga gjykatat e shteteve të huaja

Kur është e nevojshme të kryhet një veprim procedural gjyqësor jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, për sqarimin e rrethanave, konstatimin e fakteve, dërgimin e një dokumenti apo për arsye të tjera që gjykata e quan të nevojshme për sqarimin e çështjes në gjykim, gjykata nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë i kërkon ndihmën juridike përkatëse organit kompetent të shtetit tjetër.

Kur veprimi procedural juridik mund të kryhet nga përfaqësia diplomatike ose konsullore e Republikës së Shqipërisë, kërkesa i drejtohet kësaj të fundit.

Kërkesa e sipërme duhet të përcaktojë çështjet për të cilat kërkohet ndihma juridike dhe të përmbajë të dhënat e nevojshme për plotësimin e ndihmës juridike.

Kur midis dy shteteve ka marrëveshje për dhënien e ndërsjellë të ndihmës juridike, zbatohen dispozitat e kësaj marrëveshjeje.

Neni 220

Zbatimi i ligjit të huaj

Në rast se për gjykimin e një çështjeje është e nevojshme të zbatohen ligjet e një shteti tjetër, gjykata duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për t'i gjetur dhe zbatuar ato sipas përmbajtjes së tyre.

Kur çdo përpjekje e gjykatës sipas paragrafit të parë të këtij neni është e pasuksesshme dhe asnjë nga palët nuk kanë mundur t'ia sigurojnë gjykatës dispozitat e kërkuara, të vërtetuara nga organet kompetente të shtetit tjetër, gjykata vendos sipas legjislacionit shqiptar.

Neni 221

Ndihma juridike për gjykatat e shteteve të huaja

Gjykatat shqiptare u sigurojnë ndihmë juridike gjykatave të shteteve të tjera me kërkesën e tyre. Ndihma juridike nuk mund të jepet kur:

- a) dhënia e saj nuk pajtohet me parimet themelore të legjislacionit shqiptar në fuqi;
- b) objekti i kërkesës nuk është në kompetencën e gjykatave shqiptare.

Neni 222

Kërkesa për dhënien e ndihmës juridike të bërë nga gjykata e një shteti të huaj duhet të përmbajë kushtet e parashikuara nga neni i mësipërm, të jetë hartuar në gjuhën shqipe ose të jetë përkthyer në këtë gjuhë dhe t'i jenë bashkëngjitur shpenzimet e nevojshme për përkthim. Në rast të kundërt gjykata ose marrësi mund të refuzojë kryerjen e veprimeve të kërkuara.

Kur ndërmjet dy shteteve ka marrëveshje për dhënien e ndërsjellë të ndihmës juridike, zbatohen dispozitat e kësaj marrëveshjeje.

Neni 223

Marrja e provave të tretët

Gjykata, me kërkesën e palës së interesuar, mund të urdhërojë palën tjetër ose një person të tretë që nuk merr pjesë në çështje, të paraqesë në gjykim një dokument ose një send tjetër, kur çmohet e nevojshme prej saj.

Në këtë rast gjykata jep udhëzimet e nevojshme për kohën, vendin dhe mënyrën e paraqitjes së tyre. Pala që ka kërkuar marrjen e dokumentit është e detyruar të tregojë me hollësi të gjitha rrethanat që bëjnë të besueshme se ku ndodhet dokumenti, karakteristikat e tij, si dhe faktet që do të provohen me këtë dokument.

Shpenzimet e nevojshme parapaguhën nga pala që ka bërë kërkesën.

Neni 224

Gjykata mund të kërkojë zyrtarisht nga organet e administratës shtetërore të dhëna me shkrim për akte dhe dokumente që ndodhen në atë organ dhe që është e nevojshme të shqyrtohen në procesin gjyqësor. Kur të dhënat e kërkuara përbëjnë sekret shtetëror, gjykata kërkon lejen e organit qendror nga

i cili varet administrata shtetërore ku ndodhen të dhënat e kërkuara. Kur kërkesa refuzohet, kërkesa e palës quhet si e paparashtruar.

KREU VI
EKSPERTI DHE EKSPERTIMI
(Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Neni 224/a

(Shtuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001 dhe ndryshuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Kur për konstatimin ose sqarimin e fakteve, që kanë lidhje me mosmarrëveshjen në gjykim kërkohen njohuri të posaçme në fushat e shkencës, teknikës ose të artit, gjykata mund të thërrasë një ose më shumë ekspertë.

Ekspertët zgjidhen nga një regjistër elektronik i personave të licencuar, i cili administrohet dhe publikohet nga Ministria e Drejtësisë, përveç kur janë kushtet e parashikuara në nenin 224/d, pika 2, të këtij Kodi. Ekspertët caktohen sipas rregullave të përcaktuara në këtë Kod.

Neni 224/b

(Shtuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Eksperti e jep mendimin e tij me shkrim, por mund të dëgjohet në seancë gjyqësore dhe të pyetet nga gjykata dhe nga palët.

Mendimi i ekspertit nuk është i detyrueshëm për gjykatën dhe, kur kjo ka mendim të kundërt me ekspertin, duhet të arsyetojë me hollësi këtë mendim në vendimin përfundimtar ose në një vendim që jep gjatë gjyqimit.

Nuk është në misionin e ekspertit të japë një mendim juridik.

Neni 224/c

(Shtuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001; shtuar paragrafi i katërt me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Eksperti është i detyruar të përmbushë detyrat e ngarkuara nga gjykata, përveç kur parashtron shkaqe të përligjura që pranohen nga gjykata.

Mosparaqitja e ekspertit në gjykatë, pa shkaqe të përligjura, shkakton sjelljen e tij me detyrim.

Përrjashtimi i ekspertit nga pjesëmarrja e tij në gjykim bëhet kur janë kushtet e përcaktuara prej nenit 72 të këtij Kodi.

Kërkesa për përrjashtimin e ekspertit duhet t'i dorëzohet gjykatës që shqyrton çështjen, e cila vendos për të.

Neni 224/ç

Përrgjegjësia e ekspertit

(Shtuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Eksperti ka përrgjegjësi sipas Kodit Penal në rast se kundërshton të kryejë detyrën që i ngarkohet ose kryen një ekspertim të rremë.

Eksperti është i detyruar të shpërblejë dëmet që për faj të tij u janë shkaktuar palëve ose pjesëmarrësve të tjerë në proces.

Neni 224/d

Regjistri elektronik i ekspertëve

(Shtuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Ministria e Drejtësisë krijon, administron dhe vë në dispozicion për publikun një regjistër elektronik për ekspertët. Ky regjistër ndahet në seksione të ndryshme, duke grupuar ekspertët, sipas fushave të tyre të ekspertizës dhe vendit ku ata punojnë.

2. Gjyqtari cakton një ekspert jashtë regjistrit elektronik, vetëm kur, për nevoja të procesit, eksperti nevojitet nga fusha të veçanta ekspertize, për të cilat ligji nuk parashikon licencimin e tyre.

3. Ministria e Drejtësisë pranon regjistrimin e ekspertit në regjistrin elektronik, nëse ai përmbush kriteret e mëposhtme:

a) të ketë dhjetë vjet përvojë profesionale në fushën specifike apo të ngjashme. Pesë vjet përvojë profesionale e këtij lloji është e mjaftueshme nëse aplikanti ka përfunduar një trajnim profesional në fushën përkatëse;

b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) të jetë i regjistruar dhe të ketë përmbushur në mënyrë të rregullt detyrimet në organet tatimore.

4. Regjistri elektronik duhet të parashikojë një rubrikë të veçantë, ku palët e interesuara mund të vlerësojnë ekspertin në lidhje me ekspertizat e tij në të shkuarën, duke përdorur një sistem pikëzimi.

Neni 225

(Ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Eksperti emërohet nga gjykata.

2. Vendimi për emërimin e ekspertit i njoftohet atij nga sekretaria e gjykatës, e cila njofton gjithashtu edhe datën kur duhet të paraqitet në seancën e përcaktuar.

3. Eksperti, i cili nuk pranon të kryejë këtë detyrë, duhet të njoftojë gjykatën, duke dhënë argumentet përkatëse, të paktën pesë ditë para seancës.

4. Në varësi të rrethanave, palët kërkojnë menjëherë shkarkimin e ekspertit, duke parashtruar argumentet përkatëse.

Neni 226

Betimi

Gjykata përpara se eksperti të fillojë nga kryerja e detyrës, i kujton atij rëndësinë e funksioneve për të cilat është thirrur për t'i përmbushur dhe e fton të bëjë betimin se do të kryejë mirë e me nder detyrat që i janë besuar, me të vetmin qëllim që t'ia bëjë të ditur gjykatës të vërtetën.

Neni 227

Caktimi i detyrave dhe kryerja e ekspertimit

(Ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjykata, pasi merr edhe mendimin e palëve, i cakton ekspertit çështjet për të cilat duhet të merret mendimi i tij.

2. Vendimi për caktimin e detyrave të ekspertit duhet të përmbajë:

a) detyrat që i caktohen ekspertit;

b) afatin për paraqitjen nga eksperti në sekretari të aktit të ekspertimit në aq kopje sa palë janë dhe një kopje për fashikullin e gjykimit, kur ekspertimi nuk mund të kryhet aty për aty;

c) subjektin, të cilit i ngarkohet parapagimi i shpenzimeve të ekspertit dhe afati i përmbushjes së këtij detyrimi;

ç) sipas rastit, urdhërimin e subjekteve të treta për t'i lejuar ekspertit kryerjen e detyrave të caktuara nga gjykata, nëpërmjet këqyrjes, sipas dispozitave të përcaktuara në titullin I, pjesa I, kreu X, i këtij Kodi.

3. Gjykata fton palët për të tërhequr në sekretari kopjen e tyre të aktit të ekspertimit dhe pasi merr mendimin e palëve, u cakton këtyre të fundit një afat, brenda të cilit ato mund të paraqesin me shkrim mendimet dhe vërejtjet e tyre mbi aktin e ekspertimit.

4. Eksperti ka të drejtë të njihet me materialet e çështjes, të marrë pjesë në seancë gjyqësore, të bëjë pyetje, të japë shpjegime dhe të kërkojë nga palët të marrë të dhëna nga të tretët brenda kufijve të nevojshëm për kryerjen e detyrës.

5. Eksperti mund të asistohet edhe nga ndihmës të tij, por përgjegjësia për saktësinë e ekspertimit i mbetet atij.

6. Kur sipas vendimit të gjykatës për kryerjen e ekspertimit është e nevojshme që eksperti të njihet me sende, evidenca, llogari e dokumente të tjera, palët mund të jenë të pranishme dhe mund t'i paraqesin ekspertit me shkrim mendime dhe vërejtje të specialistëve të tyre, të cilët mund të pyeten me cilësinë e dëshmitarit, ose kërkesa që lidhen me plotësimin e detyrës, por gjithnjë brenda kompetencave të caktuara në vendimin e gjykatës.

7. Në rast pengese pa shkak të arsyeshëm, eksperti njofton gjykatën e cila, kur e çmon të nevojshme, urdhëron Policinë e Shtetit ta mbështesë në kryerjen e detyrave të caktuara nga gjykata.

Neni 228

Kryerja dhe vlerësimi i ekspertimit

Kur ekspertimi kryhet me praninë e gjykatës ose të gjyqtarit të deleguar, mbahet procesverbal, por gjykata mund t'i kërkojë ekspertit që të japë përfundimet e ekspertimit në një raport me shkrim.

Kur ekspertimi kryhet pa pjesëmarrjen drejtpërdrejt të gjykatës, eksperti duhet të hartojë një raport me shkrim mbi ekspertizën e kryer, në të cilën duhet të gjejnë pasqyrim edhe vërejtjet e kërkesat e palëve. Deklaratat eventuale të palëve të përmendura në raport vlerësohen nga gjykata, duke pasur parasysh rregullat e parashikuara në nenin 29 të këtij Kodi.

Raporti duhet të depozitohet në sekretari në afatin e caktuar nga gjykata.

Neni 229

Përsëritja e ekspertimit

Kur shihet se ekspertimi është i metë ose i paqartë, si dhe kur ka ndryshim mendimesh midis ekspertëve, gjykata, kryesisht ose me kërkesën e ndonjëres nga palët, mund të kërkojë sqarime plotësuese ose të urdhërojë kryerjen e një ekspertimi të ri, duke thirrur ekspertë të tjerë.

Neni 230

Pasqyrimi i përfundimeve të ekspertimit

Mendimi i ekspertit duhet të jetë i arsyetuar.

Kur ekspertët janë të një mendimi, përfundimet e ekspertimit mund t'i parashtrijë njëri që caktohet prej tyre; kur ka ndryshim mendimesh midis ekspertëve, secili prej tyre duhet të parashtrijë vetë mendimin e tij. Pasi të kenë dhënë mendimin, ekspertëve mund t'u bëhen pyetje.

KREU VII

THËNIET E DËSHMITARËVE

(Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Neni 231

Kufijtë e lejimit të provave me dëshmitarë

Prova me dëshmitarë lejohet në të gjitha rastet, përveç kur ligji për vlefshmërinë ose provimin e një veprimi juridik kërkon shkresë.

Neni 232

(Ndryshuar fjalia e dytë me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008)

Nuk lejohet prova me dëshmitarë kundër ose tej përmbajtjes së një akti zyrtar ose privat që përbën provë të plotë. Gjithashtu, nuk lejohet të provohet me dëshmitarë marrëveshja e palëve për ndryshimin e kontratës ose shuarja, me anë të pagimit ose të faljes së detyrimeve në të holla, që rrjedhin nga një kontratë e bërë me dokument.

Neni 233

Rastet e lejimit të provës me dëshmitarë

Rregullat e caktuara në dy nenet e mësipërme nuk zbatohen dhe lejohet prova me dëshmitarë:

a) kur dokumenti që kërkohet nga ligji për vlefshmërinë ose provimin e veprimit juridik ka humbur ose është prishur pa fajin e palës;

b) kur ka një fillim prove me shkresë. Quhet fillim prove me shkresë çdo shkresë, që rrjedh nga ai, kundrejt të cilit drejtohet kërkimi dhe nga përmbajtja e së cilës del se fakti i pretenduar është pothuajse i vërtetë;

c) kur veprimi juridik i bërë me shkresë është kryer:

- në kundërshtim me ligjin, në mashtrim të ligjit;

- nën ndikimin e mashtrimit, kanosjes, ose për shkak të një marrëveshje me keqbesim të bërë midis përfaqësuesit të njëres palë dhe palës tjetër;

- nën ndikimin e nevojës së madhe të palës;
- ç) kur për shkak të rrethanave në të cilat është kryer veprimi juridik ose të marrëdhënieve të posaçme të palëve, nuk ka qenë e mundur të merrej prova me shkresë.

Neni 234

Kundër ose tej përmbajtjes së një veprimi juridik të bërë me shkresë, personi i tretë është i lirë në paraqitjen e provave. Kur njëra prej palëve kontraktuese pretendon se veprimi juridik është kryer vetëm në dukje, pa pasur qëllim që palët të krijojnë pasoja juridike, ose për të mbuluar një veprim tjetër juridik, të cilin palët e kanë dashur, prova me dëshmitarë lejohet në rastet kur ka provë me shkresë të lëshuar nga pala tjetër ose deklarime të bëra prej kësaj përpara institucioneve shtetërore, nga të cilat bëhet e besueshme se veprimi juridik është kryer vetëm për dukje.

Neni 235

Ndalimi i pyetjes si dëshmitar

Nuk mund të pyeten si dëshmitarë:

- përfaqësuesit e palëve në çështje, për rrethana për të cilat kanë marrë dijëni nga të përfaqësuarit e tyre për shkak të detyrës së tyre si përfaqësues;
- personat që për shkak të metash fizike ose psikike nuk janë të aftë të kuptojnë drejt faktet që kanë rëndësi për çështjen dhe të bëjnë dëshmi të rregullt;
- bashkëshortët ende të pandarë, fëmijët, prindërit, gjyshërit, ose kushërinj, në vijë të drejtë ose të tërthortë deri në shkallë të dytë, përveç kur çështja ka lidhje me probleme personale e familjare, si dhe të miturit nën katërmbëdhjetë vjeç, përveç kur thëniet e tyre janë të domosdoshme për zgjidhjen e çështjes.

Këta persona vendosin vetë nëse do të dëshmojnë dhe nuk mund të dënohen për refuzimin për të bërë dëshmi.

Neni 236

Rregullat për dëgjimin e dëshmitarëve

Dëshmitarët dëgjojnë nga gjykata në debatin gjyqësor. Në raste të veçanta ose për shkak sëmundjeje apo për shkak të punës së veçantë që bën dëshmitari, rrethana këto që e bëjnë të pamundur paraqitjen e tij në gjykim, gjykata mund të vendosë që pyetja e tij të bëhet jashtë qendrës së gjykatës nga një anëtar i trupit gjykues. Në këto raste pyetja e dëshmitarit bëhet përpara seancës gjyqësore të radhës dhe dëshmia e marrë lexohet në seancën gjyqësore. Pyetja e dëshmitarit bëhet kurdoherë në prani të palëve apo përfaqësuesve të tyre, të cilët njoftohen rregullisht.

Dëshmia e Presidentit të Republikës merret në selinë ku ai ushtron funksionin e Kryetarit të Shtetit.

Kur duhet të merret dëshmia e Kryetarit të Kuvendit, Kryetarit të Këshillit të Ministrave, Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese ose Kryetarit të Gjykatës së Lartë, këta mund të kërkojnë të pyeten në selinë ku ushtrojnë detyrën e tyre.

Gjykata vlerëson thëniet e dëshmitarëve në harmoni ndërmjet tyre dhe me provat e tjera të marra gjatë shqyrtimit të çështjes.

Neni 236/a

Rregullat për pyetjen e dëshmitarëve për paditë me shuma të vogla

(Shtuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017, ndryshuar fjalë nr. 44/2021, datë 23.3.2021)

Në shqyrtimin e padive me vlerë deri në njëzetfishin e pagës minimale në shkallë vendi, gjykata mund të vendosë që dëshmitë e dëshmitarëve të merren me anë të deklaratave me shkrim ose videokonferencës, të siguruara jashtë ambienteve të gjykatës. Në deklaratën me shkrim të dëshmitarit duhet të shënohet paralajmërimi i përgjegjesisë ligjore për deklaram të rremë. Vërtetimi i nënshkrimit vërtetohet nga noteri ose sekretaria e gjykatës.

Neni 237

Betimi

Kryetari i seancës gjyqësore, pasi të jetë siguruar për identitetin e dëshmitarëve, i ndërgjegjëson ata për rëndësinë e misionit e të betimit përpara gjykatës dhe u njofton atyre se janë të detyruar të tregojnë të vërtetën për çfarë ata dinë në lidhje me çështjen, i paralajmëron për përgjegjësinë që ata kanë për dëshmi të rreme. Ndërkohë, sekretari gjyqësor lexon formulën e betimit si më poshtë: “I ndërgjegjshëm, betohem se do të them të vërtetën dhe vetëm të vërtetën”. Dëshmitari në këmbë përgjigjet “Betohem” dhe pret jashtë sallës së gjyqit me porosinë të mos merren vesh me njëri-tjetrin.

Neni 238

Radha e pyetjes

Radha e pyetjes së dëshmitarëve caktohet nga kryetari i seancës duke mbajtur parasysh dëshmitarët e secilës palë. Ata pyeten një nga një në prani të palëve, pa praninë e dëshmitarëve që pyeten më vonë.

Neni 239

Dëshmitari pyetet më parë nga pala që e ka kërkuar thirrjen e tij dhe pastaj nga pala tjetër. Secila nga palët ka të drejtë t'i bëjë pyetje plotësuese dëshmitarit për të sqaruar apo plotësuar përgjigjet e dhëna nga ai. Në çdo rast palët i drejtojnë pyetje dëshmitarit me leje dhe nëpërmjet gjykatës.

Gjykata mund të bëjë pyetje e të kërkojë sqarime kurdoherë që e konsideron të nevojshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes.

Neni 240

Ballafaqimi i dëshmitarëve

Kur ndërmjet thënieve të dëshmitarëve ka mospërputhje të tilla që krijojnë vështirësi për zbulimin e të vërtetës, gjykata vetë ose me kërkesën e palëve bën ballafaqimin e dëshmitarëve të pyetur më parë.

Neni 241

Ripyetja e dëshmitarit

Pas mbarimit të dëshmisë dëshmitari mund të largohet me leje të gjykatës. Në rast se ripyetja e tij mund të jetë e nevojshme, atëherë gjykata urdhëron që ai të qëndrojë në sallë pa kontaktuar me dëshmitarët e tjerë.

Neni 242

Heqja dorë nga pyetja e dëshmitarit

Pala që ka kërkuar thirrjen e një dëshmitari mund të kërkojë që ai të mos pyetet. Kërkesa merret parasysh në rast se pala tjetër është dakord dhe kur gjykata çmon se pyetja e tij nuk do të jetë e nevojshme për sqarimin e çështjes.

Neni 243

Kur gjatë gjykimit të çështjes rezultojnë të sqaruara faktet dhe pretendimet e palëve, gjykata, vetë ose me kërkesën e tyre, mund të heqë dorë nga pyetja e dëshmitarëve të tjerë të thirrur për këtë qëllim.

Neni 244

Përdorimi i shënimeve prej dëshmitarit

Gjykata mund të lejojë dëshmitarin që të përdorë shënime ose të dhëna të tjera të shkruara, kur flasin për çështje që kanë të bëjnë me llogari e të dhëna që është e vështirë të mbahen mend.

Neni 245

Denoncimi për dëshmi të rreme

Në rast se një dëshmitar bën dëshmi të rreme përpara gjykatës, kjo vendos denoncimin në prokurori për ndjekje penale.

KREU VIII SHKRESAT

Neni 246

Fuqia provuese e shkresave

Shkresat kanë fuqi provuese kur janë hartuar në formën e caktuar, kanë elementet e nevojshme për vlerën e tyre, nuk janë të copëtuara, të grisura ose të shuara, nuk kanë gërvishitje, ose shtesa midis rreshtave, ose çrregullime të tjera me shuarje dhe mund të lexohen.

Neni 247

Shkresa, kur është e dëmtuar në mënyrën e parashikuar në nenin e mësipërm, prezumohet se është bërë për të zhvleftësuar vlerën provuese të saj, përveç kur provohet e kundërta.

Neni 248

Personi që paraqet dhe përdor si mjet provues një shkresë që ka ndryshime, duhet të vërtetojë se ndryshimet janë bërë nga ai që e ka nxjerrë shkresën, ose nga ai që mund t'i shërbejë si provë, ose nga ai që i ka kaluar e drejta, ose janë bërë nga dikush tjetër me porosi të këtyre.

Neni 249

Kur shkresa që paraqitet referon në një shkresë tjetër, ajo bashkohet me këtë, përveç kur shkresa që merret zëvendëson shkresën referuese ose përmban përmbajtjen e saj të plotë.

Kur shkresa që u mor ka përmbajtje të ndryshme nga shkresa referuese, atëherë parapëlqehet përmbajtja e kësaj të fundit.

Neni 250

Shkresa në ruajtje ose në pamundësi përdorimi

Në rastet kur prova me shkresë është në ruajtje për arsye ligjore ose pamundësi përdorimi dhe nuk mund të merret, gjykata ka të drejtë që përveç mjeteve të tjera, të lejojë të merret kopje e saj e legalizuar, e cila ka fuqi provuese sikurse edhe shkresa origjinale. Kur kjo më pas ka humbur, gjykata vendos të administrohet shkresa që vërteton njësinë me origjinalin.

Neni 251

Kopja e shkresës dhe origjinali i saj

Kopjet e shkresave kur saktësia e tyre vërtetohet nga personi kompetent kanë të njëjtën fuqi provuese me origjinalin.

Neni 252

Verifikimi në vend i përmbajtjes së shkresës

Në qoftë se për shkaqe të justifikuara është e vështirë marrja e provës në gjykim ose për shkak të rëndësisë së saj ose të natyrës së saj ekziston rreziku të humbasë ose të dëmtohet, gjykata mund të urdhërojë të verifikohet shkresa nga një anëtar i trupit gjykues ose të kontrollohet me letërporosi nga gjykata e vendit ku ndodhet shkresa ose të lejojë të merret fotokopje ose fotografia e vërtetuar.

Neni 253

Aktet zyrtare

Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre. Lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar.

Neni 254

Aktet zyrtare që dalin nga organet shtetërore dhe që përmbajnë një urdhër, një vendim ose çdo masë tjetër të marrë prej tyre ose që tregojnë kryerjen e një veprimi nga ana e këtyre organeve, përbëjnë provë të plotë për përmbajtjen e tyre. Lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar.

Neni 255

Kopjet dhe shkurtimet e akteve të përmendura në nenet 253 dhe 254, të vërtetuara sipas ligjit, kanë fuqi provuese sikundër edhe origjinali.

Neni 256

Shkresat e përpiluara nga nëpunësi i shtetit të huaj ose nga personi i huaj që ushtron veprimtari publike dhe që konsiderohen si ent publik në atë vend, kanë fuqi provuese që parashikohet në nenin 253.

Neni 257

Shkresat që përpilohen në bazë të nenit 253 për kryerjen ose vërtetimin e veprimit juridik, përsa u përket deklarimeve të palëve, përbëjnë provë të plotë për të gjithë.

Dispozitat e përmendura në paragrafin e mësipërm kanë fuqi për gjithçka që përmendet në shkresë, përderisa kanë lidhje të drejtpërdrejtë me objektin kryesor të shkresës. Ato që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë konsiderohen si fillim prove me shkresë.

Neni 258

Shkresa e thjeshtë

Shkresa që është përpiluar nga një person zyrtar që nuk ka qenë kompetent ose që nuk është sipas formës së caktuar, ka fuqinë provuese të një shkrese të thjeshtë, në rast se është nënshkruar nga palët.

Neni 259

Shkresa e thjeshtë e nënshkruar nga personi që e ka lëshuar, përbën provë të plotë se deklarimet që përmban janë të atij që e ka nënshkruar, në rast se personi kundër të cilit paraqitet shkresa pranon se është nënshkruar prej tij.

Neni 260

Shkresa private quhen edhe:

- librat e tregtarëve dhe profesionistëve që i mbajnë sipas Kodit Tregtar ose dispozitave të tjera;
- librat e avokatëve, noterëve, përmbaruesve, mjekëve, farmacistëve e të profesioneve të tjera, sipas dispozitave në fuqi.

Kur paraqiten si provë pjesë nga libri ose e tëra dhe përmbajnë edhe të dhëna që nuk kanë lidhje me objektin e gjykimit, mund të merren ato pjesë të shkresës që kanë lidhje me atë.

Neni 261

Shkresa private merr datë të saktë kundrejt personave të tretë vetëm nga dita që është vërtetuar nga noteri ose nëpunësi publik kompetent sipas ligjit ose kur vdes një nga ata që e ka nënshkruar ose nuk ka qenë në gjendje fizike të shkruajë ose kur përmbajtja e tij thelbësore është përsëritur ose konstatuar në një akt zyrtar, si dhe nga dita në të cilën ka ngjarë ndonjë fakt tjetër që provon në të njëjtën mënyrë se shkresa është përpiluar në një datë të mëparshme.

Neni 262

Shkresa private përbën provë në favor të përpiluesit vetëm në qoftë se atë e paraqet pala kundërshtare ose në qoftë se bëhet fjalë për librat që përmenden në nenin 260.

Neni 263

Librat që përmenden në nenin 260, paragrafi 1 dhe 2, kur janë përpiluar në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë për sa shkruhet në to, për tregtarët ose personat e tjerë që detyrohen të mbajnë të njëjtat libra, por lejohet të provohet e kundërta kur pretendohet falsiteti. Megjithatë, kundër personave që nuk janë detyruar të mbajnë këto libra, përbëjnë provë të plotë për gjerësinë e pretendimeve, kur qenia e tyre është vërtetuar me një mënyrë tjetër dhe vetëm për një vit që nga dita e nënshkrimit, përveç kur i detyruari provon me nënshkrimin e vet përmbajtjen e tyre.

Neni 264

Detyrimi për paraqitjen e provës shkresore

(Ndryshuar titulli me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Çdo ndërgjyqës detyrohet kryesisht të paraqesë shkresat që ka përdorur për të ndihmuar në gjykimin e çështjes.

Çdo ndërgjyqës ose person i tretë detyrohet të paraqesë shkresat që disponon dhe që mund t'i vlejné si provë, përveç kur ka shkaqe serioze dhe justifikon mosparaqitjen e tyre. Si shkaqe serioze konsiderohen veçanërisht rastet kur nuk lejohet për të dëshmuar.

Neni 265

Ekzekutimi i vendimit që urdhëron paraqitjen e shkresës bëhet sipas dispozitave që kanë të bëjnë me ekzekutimin për dorëzimin e sendit ose kryerjen e veprimit.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur shkresat ndodhen në një organ shtetëror ose të personat juridikë shtetërorë, përveç kur shkresa përbën sekret shtetëror.

Neni 266

Shkresa në gjuhë të huaj

Kur shkresa është në gjuhë të huaj, ajo paraqitet bashkë me përkthimin e saj në gjuhë shqipe, të legalizuar nga ambasada apo konsullata përkatëse ose nga organi tjetër kompetent.

Kur gjykata nuk mund ta kontrollojë vetë saktësinë e përkthimit, emëron përkthyes.

Neni 267

Detyrimi për të provuar se shkresa private është origjinale

Kur origjinaliteti i shkresës private vihet në dyshim, ai që e paraqet duhet ta provojë atë, përveç kur shkresa është aq e ndryshuar sa gjykata e ka të vështirë të konstatojë se është origjinale.

Personi ndaj të cilit paraqitet shkresa private është i detyruar të deklarojë menjëherë se e pranon ose jo origjinalitetin e nënshkrimit, ndryshe shkresa konsiderohet si e pranuar.

Në qoftë se njihet ose vërtetohet origjinaliteti i nënshkrimit, quhet se është vërtetuar origjinaliteti i përmbajtjes, me rezervën e goditjes së tij për falsitet.

Neni 268

Shkresa private mund të provohet si origjinale me çdo lloj mjeti provues.

Neni 269

Procedura e krahasimit të shkresave

Kur bëhet krahasimi i shkresave, ai që paraqet provën detyrohet jo më vonë se dhjetë ditë përpara datës së caktuar për krahasim, t'i njoftojë ndërgjyqësit listën e shkresave me të cilat do të bëhet krahasimi ose të depozitojë origjinalet në sekretarinë e gjykatës. Vërtetësia e këtyre shkresave nuk duhet të kundërshtohet.

Kur shkresat që mund të krahasohen i disponon pala kundërshtare ose personi i tretë, mund të kërkohet paraqitja e tyre. Në rast kundërshtimi zbatohen rregullat e parashikuara prej nenit 265 të këtij Kodi.

Ndërgjyqësi ose personi i tretë të cilit i mohohet origjinaliteti i shkrimit ose nënshkrimit, mund të detyrohet të shkruajë para gjykatës ose gjyqtarit të deleguar me letër porosi një tekst të caktuar me të cilin do të bëhet krahasimi. Teksti i bashkohet dosjes. Gjykata çmon lirisht mohimin e ndërgjyqësit ose personit të tretë të shkruajë ose të bëjë përpjekje për të ndryshuar shkrimin e tij.

Neni 270

Goditja për falsitet

Çdo shkresë mund të goditet për falsitet. Shkresat private mund të goditen për falsitet edhe kur nga krahasimi me të tjera vërtetohet se janë origjinale.

Neni 271

Denoncimi për ndjekje penale

Kur falsifikimi i atribuohet një personi të caktuar mund të bëhet denoncimi për ndjekje penale.

Neni 272

Kur krijohen dyshime serioze për falsifikim ndaj një personi konkret edhe nëse shkresa që paraqitet si e falsifikuar vlerësohet si thelbësore për sqarimin e çështjes, gjykata ka të drejtë të pezullojë gjykimin e saj deri në përfundimin e gjykimit të çështjes penale, ose të urdhërojë të paraqiten prova për falsifikimin.

Neni 273

Provimi i falsitetit të një shkrese

Kush pretendon falsitetin e një shkrese, është njëkohësisht i detyruar të paraqesë ato shkresa që vërtetojnë falsitetin dhe të tregojë emrat e dëshmitarëve ose mjetet e tjera provuese, përndryshe pretendimi tij është i papranueshëm.

Neni 274

Kur shkresa paraqitet si e falsifikuar, pa treguar personin të cilit i atribuohet falsiteti, gjykata urdhëron marrjen e provave, vetëm kur ai që paraqet shkresën këmbëngul që të nxirret si provë dhe çmohet se ka rëndësi thelbësore për sqarimin e çështjes.

Neni 275

Sekretaria e gjykatës dërgon menjëherë kopjen e çdo vendimi që shpall shkresën si të falsifikuar te prokurori dhe në organin shtetëror që ka nxjerrë shkresën.

Shkresa që shpallet e falsifikuar nuk i jepet ndërgjyqësit, por mbetet në arkivin e gjykatës, së bashku me vendimin që shpall shkresën të falsifikuar. Në këto raste sekretari shënon mbi shkresë se ajo është e falsifikuar.

Kur jepet kopja e saj, ajo përmban edhe shënimin që përmendet në paragrafin e sipërm.

Neni 276

Personat, që nuk marrin pjesë në çështje, kur u kërkohet një shkresë që ndodhet pranë tyre dhe nuk ka mundësi ta paraqitin brenda afatit që u ka caktuar gjykata, janë të detyruar të njoftojnë gjykatën për mosparaqitjen e shkresës në afat, duke treguar edhe shkaqet. Gjykata, kur nuk i gjen me vend shkaqet e

treguara, si dhe kur nuk është lajmëruar se dokumenti i kërkuar nuk ka mundësi të dërgohet, ka të drejtë të dënojë personat përgjegjës, sipas nenit 167 të këtij Kodi.

Neni 277

Pala kundër së cilës është paraqitur si provë një shkresë mund të kundërshtojë vërtetësinë e saj në njërin nga këto mënyra:

- a) duke mohuar shkrimin ose nënshkrimin e saj në shkresën e thjeshtë;
- b) duke deklaruar se nuk di që shkrimi ose nënshkrimi në shkresën e thjeshtë të jetë e trashëgimlënësit të saj ose i personit nga i cili ajo heq të drejta;
- c) duke pretenduar se dokumenti është i falsifikuar.

Neni 278

Filmat fotografikë, kinematografikë e regjistrime të tjera

Filmat fotografikë ose filmat kinematografikë, kasetat e çdo lloji, si dhe çdo lloj tjetër regjistrimi, mund të përbëjnë provë për ngjarjet e sendet që janë regjistruar, kur gjykata bindet për saktësinë e vërtetësinë e tyre. Për këtë qëllim ajo mund të thërrasë edhe ekspertë kompetentë.

Neni 279

Fotografitë ose fotokopjet e shkresave kanë fuqi të njëjtë me origjinalin, përderisa saktësia e tyre vërtetohet nga personi, që sipas ligjit, është kompetent të nxjerrë kopje.

Neni 280

Gjykata, pas kontrollimit të vërtetësisë së dokumentit, me vendimin që jep gjatë gjykimit ose me vendimin përfundimtar, shprehet nëse dokumenti është ose jo i vërtetë. Kur rezulton se dokumenti nuk është i vërtetë, gjykata e përjashton këtë nga provat dhe, në qoftë se rezulton se dokumenti është i falsifikuar, ia dërgon prokurorit për të bërë ndjekje penale.

Gjykata, me vendimin që pranon se dokumenti është i vërtetë, dënon palën që ka pretenduar falsifikimin ose që ka mohuar shkrimin ose nënshkrimin e saj me gjobë deri në 50 000 lekë.

KREU IX POHIMET E PALËVE

Neni 281

Pohimi gjyqësor mund të jetë i rastit ose i nxitur nëpërmjet pyetjeve të bëra në mënyrë zyrtare për një qëllim të tillë.

Neni 282

Pohimi gjyqësor i rastit mund të jepet në formë verbale ose në çdo akt procedural të nënshkruar personalisht nga pala.

Neni 283

Procedura e kërimit të pohimeve të palëve

Pyetjet bëhen për fakte, rrethana dhe në mënyrë që të pohohen apo kundërshtohen pretendimet e palëve.

Gjykata, për pranimin e pyetjeve procedon në mënyrën dhe afatet e caktuara në vendimin e saj të ndërmjetëm.

Nuk lejohen të bëhen pyetje mbi fakte të ndryshme nga ato të formuluar në vendimin e gjykatës, përveç pyetjeve për të cilat palët bien dakord dhe që gjykata çmon se janë të dobishme për procesin gjyqësor. Gjykata mund në çdo rast të kërkojë sqarimet e nevojshme për përgjigjet e dhëna.

Neni 284

Pala e pyetur duhet të përgjigjet vetë personalisht. Ajo nuk mund të përdorë shënime të shkruara e të parapërgatitura. Megjithatë, gjykata mund të lejojë të përdoren shënime ose të dhëna të tjera të shkruara, kur flasin për çështje që kanë të bëjnë me llogari e të dhëna që është vështirë të mbahen mend.

Neni 285

Mosparaqitja dhe refuzimi i përgjigjes nga pala

Kur pala e pyetur nuk paraqitet ose refuzon të përgjigjet pa shkaqe të justifikuara, gjykata, duke vlerësuar edhe provat e tjera, mund t'i marrë si të pranuar faktet e parashtruara në pyetjet. Kur mosparaqitja e palës për t'u përgjigjur është me arsye, gjykata vendos shtyrjen e seancës ose marrjen e përgjigjeve edhe jashtë seancës gjyqësore.

Neni 285/a

Komunikimi me palët për paditë me shumë të vogla

(Shtuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017 ndryshuar fjalë me ligjin nr. 44/2021, datë 23.3.2021)

1. Në lidhje me paditë me vlerë deri në njëzetfishin e pagës minimale në shkallë vendi, gjykata vendos që palët të sjellin shpjegimet me shkrim ose nëpërmjet videokonferencës.
2. Me kërkesë të arsyetuar të palëve, si dhe kur gjykata e çmon të arsyeshme, ato mund të pyeten nëpërmjet mënyrave dhe mjeteve të tjera të komunikimit në distancë.
3. Aspektet vizuale dhe zanore të seancës të videokonferencës transmetohen në kohë reale të vendndodhjes me sallën ku zhvillohet procesi gjyqësor.
4. Aspektet vizuale dhe zanore të transmetuara nuk regjistrohen. Vendimet e mësipërme janë të paankimueshme.

KREU X

KËQYRJA E PERSONAVE, SENDEVE DHE KËQYRJA NË VEND, EKSPERIMENTIMI

Neni 286

Kur çmohet e nevojshme nga gjykata që një person ose një send të këqyren drejtpërdrejt prej saj, kryesisht ose me kërkesën e palëve, vendos që të bëhet këqyrja në vend e tyre me ose pa ekspertë.

Neni 287

Procedura e këqyrjes

Këqyrja e personave, e vendeve, e sendeve të luajtshme ose të paluajtshme, bëhet me vendim të gjykatës, në të cilën caktohet koha, vendi dhe mënyra e këqyrjes.

Këqyrja në vend bëhet nga vetë gjykata ose nga gjyqtari i deleguar prej saj ose nga gjyqtari i vendit ku do të bëhet këqyrja. Kur është e nevojshme mund të jetë i pranishëm edhe një ekspert teknik, i cili vepron sipas rregullave të parashikuara në kreun VI të pjesës së dytë të këtij Kodi.

Për kryerjen e këqyrjes palët njoftohen rregullisht.

Neni 288

Mosprekja e dinjitetit personal

Gjykata në këqyrjen e një personi duhet të bëjë kujdes që të mos preket dinjiteti personal. Ajo mund të mos jetë vetë e pranishme dhe të ngarkojë me këtë detyrë një ekspert të përshtatshëm.

Neni 289

Kryerja e prodhimeve fotografike dhe e filmimeve

Gjykata mund të vendosë që të kryhen edhe riprodhime fotografike të objekteve, dokumenteve dhe sendeve dhe kur është e nevojshme dhe e mundshme edhe filmime të tyre ose të përdorë mjete e veprime të tjera mekanike.

Gjykata për t'u siguruar në ekzistencën e një fakti mund të urdhërojë që kjo të verifikohet duke proceduar në një mënyrë të caktuar për riprodhimin e tij, duke siguruar prova me anë fotografish ose me filmime. Gjykata drejton vetë eksperimentin, ose kur e sheh me vend ia beson këtë një ekspertit duke zbatuar rregullat për emërimin dhe përgjegjësinë e ekspertit, të parashikuara në këtë Kod.

Neni 290

E drejta e gjykatës për të siguruar sende e të dhëna të nevojshme në këqyrje

Gjatë këqyrjes ose eksperimentit gjykata, kur e sheh të nevojshme, mund të dëgjojë dëshmitarë për të marrë të dhëna dhe për të siguruar paraqitjen e sendeve, si dhe të marrë masa për të hyrë në vende që duhet të ekspozohen ose të shqyrtohen nga gjykata.

Ajo mund të urdhërojë futjen në vendet që janë në pronësi ose në posedimin e personave që nuk lidhen me proces gjyqësor, mund të dëgjojë këta të fundit, duke marrë masat e nevojshme që të mos dëmtohen interesat e tyre.

Neni 291

Përmbajtja e procesverbalit të këqyrjes

Për këqyrjen në vend dhe në çdo këqyrje tjetër që bëhet jashtë gjykatës mbahet procesverbal në të cilin tregohen palët që kanë marrë pjesë, pretendimet dhe vërejtjet e tyre rreth këqyrjes dhe përfundimi i këqyrjes. Procesverbali nënshkruhet, sipas rastit, nga të gjithë gjyqtarët ose nga gjyqtari i vetëm, si dhe nga palët dhe personat e tjerë të ndodhur gjatë këqyrjes.

KREU XI

SIGURIMI I PROVËS

(Ndryshuar titulli me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Neni 292

Kur mund të kërkohet sigurimi i provës

Kur një provë, nga e cila varet zgjidhja e mosmarrëveshjes ose që ndikon në sqarimin e saj, ka rrezik të zhduket ose të vështirësohet marrja e saj, me kërkesën e palës së interesuar, mund të urdhërohet marrja më përpara.

Neni 293

Paraqitja dhe përmbajtja e kërkesës

Kërkesa për sigurimin e provës paraqitet në gjykatën që shqyrton çështjen dhe, në rast se padia nuk është ngritur, në gjykatën e vendit ku ka banim personi që do të pyetet ose ku ndodhet sendi që duhet të këqyret.

Neni 294

Në kërkesën për sigurimin e provës duhet të tregohen: prova që do të merret, rrethanat për vërtetimin e të cilave shërben ajo dhe arsyet që e justifikojnë marrjen e saj më përpara.

Kopja e kërkesës i komunikohet palës tjetër, përveç kur kjo nuk dihet ose kur marrja e provës nuk lejon shtytje.

Neni 295

Përmbajtja e vendimit të gjykatës

Vendimi me të cilin pranohet kërkesa për sigurimin e provës duhet të tregojë provën që do të merret dhe mënyrën e marrjes së provës.

Kundër vendimit të gjykatës me të cilin refuzohet kërkesa për sigurimin e provës, mund të bëhet ankim i veçantë.

Neni 296

Mosparaqitja e palës që ka kërkuar marrjen e provës sjell rrëzimin e kërkesës, përveç kur e kërkon pala tjetër, ose gjykata çmon se është në dobi të gjykimit.

Për mënyrën e marrjes së provës dhe për fuqinë e saj provuese zbatohen rregullat e përgjithshme.

Shpenzimet për marrjen e provës parapaguhën nga kërkuuesi dhe, në përfundim të gjykimit i ngarkohen palës, sipas rregullave të përgjithshme.

KREU XII PEZULLIMI E PUSHIMI I GJYKIMIT

a. Pezullimi i gjykimit

Neni 297

(Shtuar shkronja "db" me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Gjykata vendos pezullimin e gjykimit kur:

- a) çështja nuk mund të zgjidhet para se të zgjidhet një çështje tjetër penale, civile ose administrative;
- b) kërkohet nga të dyja palët;
- c) njëra nga palët vdes ose mbaron personi juridik;
- ç) njëra nga palët nuk ka ose më vonë ka humbur zotësinë juridike për të vepruar si palë dhe shihet e nevojshme t'i emërohet një përfaqësues ligjor;
- d) parashikohet shprehimisht në ligj.
- dh) njëra nga palët paraqet kërkesën për zgjidhje të çështjes me ndërmjetësim dhe gjykata e vlerëson të arsyeshme.

Gjatë pezullimit nuk mund të kryhen veprime procedurale.

Neni 298

(Shtuar paragrafi i pestë me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Në rastet e parashikuara nga shkronjat "c" dhe "ç" të nenit të mësipërm, pezullimi i gjykimit vazhdon gjersa të paraqitet për të marrë pjesë në çështje, ose të thirret nga pala kundërshtare, personi që hyn në të drejtat ose përfaqësuesi ligjor i palës që ka humbur zotësinë për vepruar si palë.

Në rastet e parashikuara nga shkronjat "a", "b" dhe "d" të nenit të mësipërm, gjykimi i çështjes rifillon pasi të jenë zhdukur pengesat që shkaktuan pezullimin e tij. Në këto raste, edhe kur nuk është caktuar seanca e ardhshme, pala e interesuar i drejtohet gjykatës me kërkesë për vazhdimin e gjykimit.

Gjykata cakton datën e seancës për vazhdimin e gjykimit dhe urdhëron që kjo t'u njoftohet palëve.

Gjykata mundet që edhe kryesisht të marrë masa për mënjanimin e këtyre pengesave. Gjykimi fillon nga veprimi procedural i mbetur në kohën e pezullimit të tij.

Në rastin e parashikuar nga shkronja "dh" e nenit 297, gjykimi i çështjes rifillon kur marrëveshja për ndërmjetësim të mosmarrëveshjes nuk arrihet dhe/ose është plotësuar afati prej 30 ditësh.

b. Pushimi i gjykimit

Neni 299

(Ndryshuar shkronjat "c" dhe "ç" me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Gjykata vendos pushimin e gjykimit kur:

- a) asnjëra prej palëve nuk kërkon brenda gjashtë muajve rifillimin e gjykimit të pezulluar me kërkesën e tyre, kur gjykata nuk ka caktuar në vendimin e pezullimit një seancë të ardhshme;
- b) paditësi heq dorë nga gjykimi i padisë;

c) gjykata konstaton se çështja nuk hyn në juridiksionin gjyqësor, si edhe kur padia nuk mund të ngrihej ose gjykimi nuk mund të vazhdonte. Kur këto shkaqe konstatohen nga gjykatat më të larta, ato prishin vendimin e gjykatave më të ulëta dhe vendosin pushimin e gjykimit.

ç) pushimi i gjykimit parashikohet shprehimisht në ligj.

Neni 300

Efektet juridike të pushimit të gjykimit

Pushimi i gjykimit sjell si pasojë anulimin e të gjitha veprimeve procedurale, duke përfshirë edhe vendimet që jepen gjatë gjykimit, por në rast se paditësi ngre përsëri të njëjtën padi, provat e mbledhura në gjykimin e pushuar mund të merren parasysh në gjykimin e kësaj padie, në qoftë se për marrjen rishtas të tyre ka vështirësi ose pengesa të pakapërcyeshme.

Pushimi i gjykimit nuk shuan padinë.

Neni 301

Ankimi

Kundër vendimit me të cilin vendoset pezullimi, pushimi ose refuzimi i rifillimit të gjykimit, mund të bëhet ankimi i veçantë në gjykatën e apelit, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj.

KREU XIII

PËRFUNDIMI I HETIMIT GJYQËSOR DHE DHËNIA E VENDIMIT

Neni 302

Përfundimi i hetimit gjyqësor

Pasi të jenë shqyrtuar të gjitha provat që gjykata ka pranuar të merren, pyeten palët nëse kanë kërkesa të tjera në dobi të gjykimit të çështjes dhe, në rast se ato nuk pranohen, gjykata i jep fund hetimit gjyqësor dhe fton palët të parashtrajnë pretendimet përfundimtare të tyre rreth çështjes në gjykim. Si rregull, ato i parashtrohen gjykatës me shkrim. Me kërkesën e palëve, kur kjo shihet me vend, gjykata u jep atyre një afat deri në 5 ditë, për të përgatitur parashtrësat e tyre.

Neni 303

Bisedimet përfundimtare

Në bisedimet përfundimtare, i pari e merr fjalën paditësi dhe ndërhyrësi dytësor që është bashkuar me atë e pas tij, i padituri e ndërhyrësi dytësor i bashkuar me atë dhe, kur në çështje merr pjesë edhe ndërhyrësi kryesor, ai e merr fjalën pasi flasin paditësi dhe i padituri. Këta të fundit pas ndërhyrësit kryesor kanë të drejtë të marrin përsëri fjalën.

Prokurori në çështjet që ka ngritur vetë padi flet i pari, ndërsa në çështjet në të cilat ka marrë pjesë e merr fjalën pas palëve.

Neni 304

Kërkesa për riçeljen e hetimit gjyqësor

(Ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Pasi i është dhënë fund hetimit gjyqësor, nuk mund të merren prova të tjera. Palët mund të kërkojnë çeljen e hetimit gjyqësor për marrjen e provave të reja vetëm kur janë kushtet e neneve 151 dhe 186 të këtij Kodi. Për këtë kërkesë vendos gjykata, sipas vlerësimit të rrethanave të çështjes.

Neni 305

Tërheqja e gjykatës në dhomën e këshillimit

Pasi palët kanë parashtruar përfundimet e kërkesat e tyre, gjykata deklaroi tërheqjen e saj në dhomën e këshillimit, për të dhënë vendimin përfundimtar.

Neni 306
Dhënia e vendimit

Në dhomën e këshillimit, kur bisedohet çështja dhe përpilohet vendimi, qëndrojnë vetëm gjyqtarët që përbëjnë trupin gjykues. Nuk lejohet që gjatë bisedimit të çështjes të hyjnë e të qëndrojnë aty sekretari i seancës, ekspertë ose persona të tjerë.

Neni 307

Trupi gjykues, nën drejtimin e kryetarit të seancës, shtron për bisedim dhe vendos me radhë për të gjitha çështjet që janë shqyrtuar gjatë gjykimit.

Së pari voton gjyqtari më i ri në moshë dhe së fundi voton kryetari i seancës. Asnjë nga gjyqtarët nuk mund të abstenojë nga vendimi. Mendimi i gjyqtarit të mbetur në pakicë, i parashtruar me shkrim, bashkohet me vendimin.

Në rast se rreth një çështje propozohen disa zgjidhje e nuk krijohet shumica në votimin e parë, kryetari hedh në votë dy zgjidhje për të përjashtuar njërin e me radhë, derisa zgjidhjet të mbeten vetëm dy, për të cilat bëhet votimi përfundimtar.

Neni 308

(Ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001 dhe paragrafi i dytë me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Vendimi duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues që kanë marrë pjesë në dhënien e tij. Gjyqtari, mendimi i të cilit ka mbetur në pakicë, shkruan fjalën “kundër” dhe nënshkruan vendimin.

Gjykata mund të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit, duke e dorëzuar atë të arsyetuar në sekretari jo më vonë se njëzet ditë ose të shtyjë shpalljen e arsyetuar të vendimit, deri në njëzet ditë. Arsyetimi i vendimit bëhet nga kryetari i seancës, përveç kur ai del kundër.

Neni 309

Vendimi mbështetet vetëm në të dhëna që ndodhen në aktet dhe që janë shqyrtuar në seancë gjyqësore.

Gjykata çmon provat e marra gjatë gjykimit të çështjes, sipas bindjes së saj të brendshme, të formuar nga shqyrtimi i të gjitha rrethanave të çështjes në tërësinë e tyre.

Neni 310

Përmbajtja e vendimit të gjykatës

(Shtuar pika 1/1 me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013; shtuar një fjalë në paragrafin II dhe ndryshuar pika 1.1 në paragrafin III me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017, ndryshuar fjalë në pikën 3, paragrafi II, me ligjin nr. 44/2021, datë 23.3.2021)

Vendimi duhet të përmbajë hyrjen, pjesën përshkuese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese.

I. Në hyrjen e vendimit duhet të përmenden:

1. gjykata që ka gjykuar çështjen;
2. trupi gjykues dhe sekretari;
3. koha dhe vendi i dhënies së vendimit;
4. palët, duke u shënuar identiteti dhe cilësia e tyre si paditës, i paditur, ndërhyrës, si dhe përfaqësuesit e tyre;
5. emri i prokurorit, nëse ka marrë pjesë;
6. objekti i padisë;
7. kërkimet përfundimtare të palëve;
8. mendimi i prokurorit nëse ka marrë pjesë.

II. Në pjesën përshkruese-arsyetuese duhet të përmenden:

1. rrethanat e çështjes, ashtu siç janë konstatuar gjatë gjykimit dhe përfundimet e nxjerra nga gjykata;
2. provat dhe arsyet në të cilat mbështetet vendimi;
3. dispozitat ligjore në të cilat bazohet vendimi.

Vendimi i gjykatës për paditë me vlerë deri në deri në njëzetfishin e pagës minimale në shkallë vendi duhet të përmbajë hyrjen dhe pjesën urdhëruese, sipas pikës 1 të këtij neni. Nëse palët, brenda tre ditëve nga njoftimi i këtij vendimi, njoftojnë me shkrim gjykatën se do ta ankimojnë vendimin, gjykata arsyeton vendimin dhe ua njofton palëve.

III. Në pjesën urdhëruese, ndër të tjera, duhet të përmenden:

1. çfarë vendosi gjykata;
- 1/1. nëse gjykata vendos detyrime për palët, përmbajtjen konkrete të tyre dhe se vendimi është i ekzekutueshëm nga përmbartuesi gjyqësor;
2. kujt i ngarkohen shpenzimet gjyqësore;
3. e drejta për të bërë ankim dhe afati për paraqitjen e tij.

Neni 310/1

(Shtuar me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013 dhe shfuqizuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Neni 311

Kur vendimi përmban detyrimin për dorëzimin e një sendi në natyrë ose detyrimin për kryerjen e një veprimi të caktuar, gjykata mund të tregojë në vendim afatin për ekzekutimin e vendimit.

Gjykata mund të caktojë një afat për ekzekutimin e detyrimit në të holla ose ta ndajë atë me këste, me kërkesën e palës së interesuar, duke pasur parasysh gjendjen pasurore të palëve dhe rrethanat e tjera të çështjes.

Neni 312

Ndreqja e gabimeve

Pas shpalljes së vendimit gjykata nuk mund ta anulojë ose ta ndryshojë atë. Ajo, me kërkesën e palëve ose kryesisht, mund të ndreqë në çdo kohë vetëm gabimet e bëra në shkrim ose në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të vendimit.

Gjykata, pasi thërret palët, në seancë, e shqyrton kërkesën sipas rregullave të këtij Kodi, jep vendim, i cili i bashkohet vendimit të ndrequr.

Kundër vendimit të dhënë për rastet e parashikuara në paragrafin e dytë të këtij neni, mund të bëhet ankim i veçantë në gjykatën e apelit.

Neni 313

Plotësimi i vendimit

Secila nga palët, brenda tridhjetë ditëve nga shpallja e vendimit, mund të kërkojë plotësimin e vendimit, në rast se gjykata nuk është shprehur mbi të gjitha kërkesat për të cilat pala ka paraqitur prova.

Gjykata e shqyrton kërkesën me të njëjtin trup gjykues, pasi thërret palët dhe jep këtë vendim plotësues.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, sipas rregullave të përgjithshme.

Neni 314

Sqarimi dhe interpretimi i vendimit

Gjykata ka të drejtë të japë sqarime ose të bëjë interpretimin e vendimit që ajo ka dhënë kur ky është i errët dhe e kërkojnë palët.

Kërkesa për sqarimin dhe interpretimin e vendimit mund të paraqitet në çdo kohë, gjersa vendimi nuk është ekzekutuar.

Kundër vendimeve të mësipërme mund të bëhet ankim i veçantë sipas rregullave të përgjithshme.

Neni 315
Vendimet e ndërmjetme

Vendimet që jepen gjatë gjykimit dhe që nuk janë përfundimtare, mund të ndryshohen ose të revokohen nga gjykata që i ka dhënë, përveç kur në këtë Kod parashikohet se kundër tyre mund të bëhet ankim i veçantë.

Neni 316
Njoftimi i vendimeve
(Ndryshuar me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013)

Vendimet përfundimtare, jopërfundimtare dhe të ndërmjetme të gjykatës, për të cilat është parashikuar e drejta e ankimit, u njoftohen palëve ose pjesëmarrësve të tjerë në proces, brenda tre ditëve nga marrja e vendimit ose, në rast se vendimi i arsyetuar shpallet më vonë, brenda tre ditëve pas shpalljes së vendimit të arsyetuar.

Njoftimi bëhet sipas rregullave të parashikuara në kreun IV të titullit VI të pjesës I.

KREU XIV
VENDIME ME EKZEKUTIM TË PËRKOHSHËM

Neni 317
Rastet e dhënies së vendimeve me ekzekutim të përkohshëm

Vendimi i gjykatës mund të jepet me ekzekutim të përkohshëm, kur është vendosur:

- a) detyrimi për ushqim;
- b) për shpërblimin nga puna;
- c) për rivendosjen në posedimin e banesës bashkëshortore.

Vendimi mund të jepet me ekzekutim të përkohshëm edhe kur nga vonesa e ekzekutimit, paditësi mund të pësojë dëme të rëndësishme, që nuk mund të vihen në vend, ose kur ekzekutimi i vendimit do të bëhej i pamundur, ose do të vështirësohej së tepërmi. Në këtë rast gjykata mund të kërkojë që paditësi të japë një garanci.

Neni 318
Ankimi

Kundër vendimit me të cilin pranohet ose rrëzohet kërkesa për ekzekutim të përkohshëm të vendimit, mund të bëhet ankim i veçantë.

Neni 319
Rrjedhojat nga prishja e vendimit

Kur vendimi priset nga gjykata e apelit ose Gjykata e Lartë, ekzekutimi i përkohshëm pezullohet.

Në rast se pas prishjes së vendimit të parë padia rrëzohet dhe vendimi merr formë të prerë, gjyqftuesi i parë detyrohet t'i kthejë palës tjetër gjithçka që ka marrë me ekzekutim të përkohshëm të vendimit të parë.

TITULLI III
GJYKIMET E POSAÇME

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 320
(Shfuqizuar shkronja "a" me ligjin nr. 49/2012 dhe ndryshuar shkronja "b" me ligjin nr. 114/2016, datë 3.11.2016)

Në përbërje të gjykatave të shkallës së parë krijohen seksione të veçanta për gjykimin e:

- a) shfuqizuar[†];
- b) mosmarrëveshjeve tregtare dhe të procedurave të falimentimit;
- c) mosmarrëveshjeve që lidhen me të miturit dhe familjen.

Neni 321

Presidenti i Republikës me propozimin e Ministrit të Drejtësisë cakton gjykatat në të cilat do të krijohen këto seksione, si dhe zonat ku do të shtrijnë kompetencat ato, mbi bazën e bashkimit të kompetencave tokësore të një apo disa gjykatave të shkallës së parë.

Ministri i Drejtësisë cakton numrin e gjyqtarëve për çdo seksion dhe kujdeset për kualifikimin e tyre sipas seksionit përkatës.

Neni 322

Kur është në interesin e një ndarje të drejtë të punës, kryetari i gjykatës së shkallës së parë ose zëvendësi i tij, në periudha të caktuara, mund të ngarkojë gjyqtarët e caktuar në seksione edhe me gjykimin e çështjeve të një natyre tjetër, që nuk janë të kompetencës së seksioneve të ngritura në këtë gjykatë.

Neni 323

(Shtuar paragrafi i fundit me ligjin nr. 114/2016, datë 3.11.2016)

Dispozitat e pjesës së parë dhe të dytë të këtij Kodi janë të zbatueshme për të gjitha gjykimet e posaçme, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë titull dhe në titullin IV të kësaj pjese.

Dispozitat e këtij Kodi janë të zbatueshme në çështjet e falimentimit, për aq sa nuk parashikohet ndryshe në ligjin e falimentimit.

KREU II GJYKIMI I MOSMARRËVESHJEVE ADMINISTRATIVE

Neni 324

Kompetenca lëndore

(Shfuqizuar me ligjin nr. 49/2012)

Neni 325

*(Ndryshuar me ligjin nr. 8491, datë 27.5.1999;
shfuqizuar me ligjin nr. 49/2012)*

Neni 326

*(Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001;
shfuqizuar me ligjin nr. 49/2012)*

Neni 327

Kompetencat tokësore

(Shfuqizuar me ligjin nr. 49/2012)

Neni 328

Afati

(Shfuqizuar me ligjin nr. 49/2012)

Neni 329

Pezullimi i zbatimit të aktit administrativ

(Shfuqizuar me ligjin nr. 49/2012)

Neni 330

[†] Shfuqizimi ka hyrë në fuqi në datën e fillimit të funksionimit të gjykatave administrative.

Bashkimi i padive
(Shfuqizuar me ligjin nr. 49/2012)

Neni 331

Vendimi i gjykatës
(Shtuar dy paragrafë me ligjin nr. 8491, datë 27.5.1999;
shfuqizuar me ligjin nr. 49/2012)

Neni 332

(Shfuqizuar me ligjin nr. 49/2012)

Neni 333

Ankimi
(Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001;
shfuqizuar me ligjin nr. 49/2012)

KREU III
GJYKIMI I MOSMARRËVESHJEVE TREGTARE

Neni 334

Kompetencat
(Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001 dhe me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Në kompetencë të seksioneve për gjykimin e mosmarrëveshjeve tregtare pranë gjykatave të shkallës së parë janë:

- a) mosmarrëveshjet kontraktore midis shoqërive tregtare e ndërmjet tyre dhe personave fizikë të regjistruar si tregtarë, ose ndërmjet vetë këtyre personave fizikë të regjistruar si tregtarë, kur është veprimtari tregtare për të dyja palët. Transaksionet e kryera nga një person fizik i regjistruar si tregtar, prezumohen të jenë pjesë e aktivitetit tregtar të tij përveç rasteve kur provohet ndryshe;
- b) mosmarrëveshjet ndërmjet ortakëve të shoqërive tregtare, ndërmjet shoqërisë dhe ortakëve të saj si dhe ndërmjet shoqërisë ose ortakëve të saj dhe organeve të saj administruese, kur mosmarrëveshjet lindin nga pozicioni i tyre në shoqëri, si dhe paditë e kreditorëve të ngritura sipas legjislacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare;
- c) mosmarrëveshjet lidhur me kontratën e tjetërsimit të të drejtave të anëtarëve të një shoqërie tregtare;
- ç) mosmarrëveshjet për të drejtën e emrit tregtar;
- d) shkelja e rregullave për mbrojtjen e konkurrencës;
- dh) procedurat e falimentimit;
- e) mosmarrëveshjet që rrjedhin nga prishja e shoqërive tregtare;
- ë) pretendimet për një kambial, çek e letra të tjera të kësaj natyre, të parashikuara me ligj.

Neni 335

Padia sipas nenit 334 të këtij Kodi shqyrtohet nga seksioni përkatës i gjykatës së shkallës së parë, në zonën e së cilës ka qendrën personi juridik a fizik tregtar i paditur, përveç kur palët në kontratë kanë caktuar një gjykatë tjetër, që edhe ajo është kompetente.

Kur padia paraqitet në gjykatën e shkallës së parë në territorin e së cilës ka qendrën personi juridik a fizik tregtar, kjo ia dërgon atë jo më vonë se tri ditë gjykatës ku është krijuar seksioni për gjykimin e mosmarrëveshjeve tregtare.

Neni 336

Ankimi

Ankimet kundër vendimeve të dhëna nga seksioni përkatës i gjykatës së shkallës së parë shqyrtohen në gjykatën e apelit, sipas rregullave të përgjithshme nga këshilla gjyqësore të përbëra nga gjyqtarë të specializuar në këtë fushë.

GJYKIMET PËR ZHVLEFTËSIMIN E ÇEKUT, KAMBIALIT DHE TË LETRAVE TË TJERA TE KËSAJ NATYRE

Neni 337

Personi që gëzon të drejtën për një letër me vlerë, siç janë çeku, kambiali premtimpagesa e të tjera letra me vlerë të kësaj natyre, mund të kërkojë, në rastet e parashikuara me ligj, zhvleftësimin e tyre, kur kanë humbur, janë vjedhur ose dëmtuar.

Neni 338

Kompetencat tokësore

Kërkesa shqyrtohet nga seksioni për mosmarrëveshjet tregtare të gjykatës, në zonën e së cilës duhet paguar letra me vlerë ose ka vendbanim i padituri.

Paditësi ka të drejtën e zgjedhjes.

Kur kërkesa paraqitet në gjykatën e shkallës së parë, në territorin e së cilës duhet paguar letra me vlerë, kjo, jo më vonë se tri ditë, ia dërgon gjykatës në të cilën ndodhet seksioni për gjykimin e mosmarrëveshjeve tregtare.

Neni 339

Kur ka shumë të paditur dhe paditësi nuk parapëlqen të ngrejë padinë në vendin e pagimit të letrës me vlerë, padia ngrihet në vendbanimin e çdonjërit prej të paditurve.

Neni 340

Përmbajtja e kërkesës

Në kërkesën për zhvleftësimin e çekut, kambialit e të tjera letra me vlerë të kësaj natyre, personi i interesuar, ndër të tjera, duhet të tregojë:

a) llojin e letrës dhe elementet e nevojshme për identifikimin e saj, duke i bashkëngjitur një kopje të saj të vërtetuar nga noteri;

b) rrethanat në të cilat ka ndodhur humbja, vjedhja ose dëmtimi i saj, si dhe argumentet që vërtetojnë të drejtën e tij mbi këtë letër me vlerë.

Neni 341

Në gjykimin e kësaj padie nuk mund të ngrihet kundërpadi dhe as të bashkohet me padi të tjera që mund të kenë lidhje me atë.

Neni 342

Procedura e gjyimit

Gjykata, kur sheh se janë plotësuar kërkesat e nenit 340 të këtij Kodi, jep një mendim në këshill, i cili, ndër të tjera, duhet të përmbajë:

a) identitetin e kërkuarit;

b) llojin e letrës me vlerë të përmendur në nenin 337 të këtij Kodi dhe elementet e nevojshme për identifikimin e saj;

c) urdhrin që i drejtohet paguesit për të mos i paguar prurësit letrën me vlerë;

ç) një njoftim drejtuar mbajtësit të mundshëm të letrës me vlerë, për të parashtruar të drejtat e tij brenda 30 ditëve nga dita e dhënies së vendimit, duke paralajmëruar se në rast të kundërt ajo do të zhvleftësohet.

Vendimi shpallet në gjykatë në vendin e caktuar për këtë qëllim dhe botohet në Fletoren Zyrtare, si dhe të paktën në një gazetë kombëtare.

Kopja e këtij vendimi i dërgohet edhe paguesit.

Neni 343

Mbajtësi aktual i letrës me vlerë të sipërpërmendur, brenda afatit të parashikuar në nenin e mësipërm, duhet t'i njoftojë gjykatës kundërshtimin e tij për zhvleftësimin e saj, të përcaktojë provat e nevojshme për të vërtetuar se e ka fituar me të drejtë atë dhe të dorëzojë letrën me vlerë në gjykatë ose në një bankë, në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit Civil mbi depozitat bankare e kasetat e sigurimit, derisa të zgjidhet mosmarrëveshja.

Në rastin e parashikuar nga paragrafi i parë i këtij neni, gjykata pezullon gjykimin dhe njofton personin që ka kërkuar zhvleftësimin e letrës me vlerë, për të ngritur padi për njohjen e së drejtës së tij mbi letrën e sipërme, brenda afatit prej një muaji.

Në rast se brenda këtij afati nuk ngrihet një padi e tillë, gjykata vendos pushimin e gjyimit dhe shfuqizon vendimin e saj të dhënë sipas shkronjës “c” të nenit 342 të këtij Kodi.

Neni 344

Kur mbajtësi i letrës me vlerë nuk ka kryer veprimet e parashikuara nga paragrafi i parë i nenit 343 të këtij Kodi, gjykata vendos shuarjen e të gjitha të drejtave mbi letrën me vlerë të humbur, vjedhur ose dëmtuar dhe i njeh të drejtën personit që ka kërkuar zhvleftësimin për pagesën e saj ose pajisjen me një letër me vlerë të re.

Neni 345

Në gjykimin e çështjes, sipas paragrafit II dhe III të nenit 343 dhe nenit 344 të këtij Kodi, gjykata njofton personin fizik a juridik që ka kërkuar zhvleftësimin e letrës me vlerë si dhe atë që ka lëshuar letrën me vlerë, por paraqitja e tyre nuk ndalon shqyrtimin e çështjes.

Neni 346

Kur gjykata rrëzon kërkesën për zhvleftësimin e letrës me vlerë, revokon vendimin e saj të dhënë sipas shkronjës “c” të nenit 342 të këtij Kodi, duke njoftuar pagesin.

Kundër vendimit të mësipërm si dhe vendimeve të dhëna sipas neneve 343 dhe 344 të këtij Kodi, mund të bëhet ankim sipas rregullave të përgjithshme.

Neni 347

Ushtrimi i padisë për begatimin pa shkak

Mbajtësi i letrës me vlerë të zhvleftësuar, i cili nuk ka mundur të deklarojë, për çdo shkak qoftë, të drejtat e tij mbi letrën me vlerë, sipas shkronjës “d” të nenit 342 të këtij Kodi, mund të padisë personin që i është njohur e drejta e pagesës së letrës me vlerë ose të kërkojë pajisjen me një letër tjetër si kjo, në bazë të nenit 655 të Kodit Civil.

Neni 348

Gjykimet në lidhje me patentat e të drejtat e tjera që rrjedhin nga pronësia industriale

Mosmarrëveshjet që rrjedhin nga patentat, markat tregtare dhe të shërbimit, dizenjot tregtare, modelet dhe çdo e drejtë tjetër që rrjedh nga pronësia industriale, gjykohen nga seksioni i mosmarrëveshjeve tregtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Tiranës, sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod.

KREU IV

SHQYRTIMI I MOSMARRËVESHJEVE QË LIDHEN ME FAMILJEN

Neni 349

Kompetencat lëndore

Seksionet për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve familjare pranë gjykatave të shkallës së parë janë kompetente për:

- a) shqyrtimin e mosmarrëveshjeve për zgjidhjen e martesës me shkurorezim, për pavlefshmërinë dhe për anulimin e martesës;
- b) vënien dhe heqjen e kujdestarisë mbi të miturit, mbajtjen për rritje dhe edukim të fëmijëve deri në zgjidhjen e martesës dhe ndryshimin e vendimit të gjykatës për shkak të rrethanave të reja;
- c) miratimin e birësimit;
- ç) mosmarrëveshjet lidhur me dhënien e ndihmës për jetesë;
- d) ndarjen e pasurisë bashkëshortore dhe të banesës së bashkëshortëve;
- dh) kërkesat për heqjen dhe kthimin pushtetit prindëror.

A. PROCEDURA PËR VENDOSJEN E KUJDESTARISË

Neni 350

Kompetenca tokësore

Kompetent për vendosjen ose heqjen e kujdestarisë, si dhe për heqjen ose kthimin e pushtetit prindëror, është seksioni përkatës i gjykatës së shkallës së parë ku banon i mituri.

Neni 351

E drejta për paraqitjen e kërkesës në gjykatë

Kërkesa për vendosjen e kujdestarisë i paraqitet gjykatës nga të afërmit e fëmijës së mitur dhe nga cilido që merr njoftimin për mbetjen e fëmijës pa prindër, për lindjen e një fëmije me prindër të panjohur dhe për çdo rrethanë tjetër që ligji kërkon vendosjen e kujdestarisë.

Kur në çeljen e një testamenti, noteri, që bën publikimin e tij vihet në dijeni për caktimin e një kujdestari, duhet të njoftojë gjykatën jo më vonë se 10 ditë nga marrja dijeni, e cila procedon dhe vendos jo më vonë se 15 ditë.

Neni 352

I mituri që ka mbushur moshën 16 vjeç mund të ushtrojë vetë të drejtën që t'i drejtohet gjykatës për vendosjen e kujdestarisë.

Neni 353

Caktimi i kujdestarisë

Gjykata emëron një kujdestar të vetëm edhe kur janë disa vëllezër e motra të mitur. Kur ka konflikt midis interesave të të miturve, ajo mund të caktojë edhe një kujdestar tjetër ose disa kujdestarë.

Neni 354

Gjykata emëron si kujdestar personin e caktuar me testament dhe, në mungesë të tij, një nga të afërmit në linjë të drejtë dhe, pas kësaj, në linjë të tërthortë.

Gjykata, nëse vlerëson se zgjidhja nuk është bërë në interes të fëmijës, vepron vetë për caktimin e kujdestarit.

Neni 355

Kujdestari i posaçëm

Gjykata emëron një kujdestar të posaçëm, kur këtë e kërkojnë interesat e të miturit. Kujdestaria e posaçme hiqet, kur pushojnë shkaqet për të cilat është vendosur.

Neni 356

Pyetja e të miturit nga gjykata

Gjykata, përpara se të procedojë për emërimin e kujdestarit, duhet të pyesë edhe të miturin, kur ai e ka mbushur moshën 10 vjeç.

Kujdestaria merr fund kur i mituri mbush moshën 18 vjeç ose kur e mitura martohet para kësaj moshe.

Neni 357

Zëvendësimi i kujdestarit

Me kërkesën e personave të përmendur në nenin 351, gjykata e heq kujdestarin në çdo kohë dhe e zëvendëson me një tjetër, kur vëren se ai ka shpërdorur të drejtat që i takojnë si kujdestar, kur është treguar i pakujdesshëm në kryerjen e detyrës ose kur me mënyra të tjera ka vënë në rrezik interesat e të miturit, si dhe kur vetë kujdestari kërkon shkarkimin e tij për shkaqe të arsyeshme.

Gjykata mund ta heqë kujdestarin vetëm pasi ta ketë dëgjuar ose njoftuar atë rregullisht.

B. GJYKIME NË LIDHJE ME MARTESËN

Neni 358

Padia për shkurorëzim

(Shfuqizuar me ligjin nr. 9062, datë 8.5.2003)

Neni 359

Padia e përbashkët e bashkëshortëve

(Shfuqizuar me ligjin nr. 9062, datë 8.5.2003)

Neni 360

(Shfuqizuar me ligjin nr. 9062, datë 8.5.2003)

Neni 361

Përpyjekjet e gjykatës për pajtim

(Shfuqizuar me ligjin nr. 9062, datë 8.5.2003)

Neni 362

Shtytja e shpalljes së vendimit përfundimtar

(Shfuqizuar me ligjin nr. 9062, datë 8.5.2003)

Neni 363

Pezullimi i gjykimit me kërkesën e gruas shtatzënë

(Shfuqizuar me ligjin nr. 9062, datë 8.5.2003)

Neni 364

Bashkimi i kërtimeve të tjera

(Shfuqizuar me ligjin nr. 9062, datë 8.5.2003)

Neni 365

Marrja e masave të përkohshme

(Shfuqizuar me ligjin nr. 9062, datë 8.5.2003)

Neni 366

Shpenzimet gjyqësore

(Shfuqizuar me ligjin nr. 9062, datë 8.5.2003)

Neni 367

Dërgimi i vendimit në zyrën e gjendjes civile

(Shfuqizuar me ligjin nr. 9062, datë 8.5.2003)

Neni 368

Padia për pavlefshmërinë dhe anulimin e martesës

(Shfuqizuar me ligjin nr. 9062, datë 8.5.2003)

KREU V
PJESËTIMI GJYQËSOR

Neni 369

Në gjykimin e padisë për pjesëtimin e trashëgimit ose të sendeve në bashkëpronësi, respektohen rregullat e parashikuara në nenet 207 dhe 227 të Kodit Civil.

Neni 370

Fazat e gjykimit

Gjykimi për pjesëtimin e sendeve në bashkëpronësi dhe në trashëgim, në fazën e parë të tij, ka për qëllim të hetojë e të përcaktojë të drejtën e bashkëpronësisë së ndërgjyqësve, pjesët takuese të tyre, si dhe sendet që do të pjesëtohen. Pasi të ketë marrë provat e nevojshme, gjykata, me vendim të ndërmjetëm, lejon pjesëtimin dhe përcakton rrethin e bashkëpjesëtarëve, sendet që do të pjesëtohen, si dhe pjesët takuese të secilit prej tyre.

Kundër këtij vendimi lejohet ankimi i veçantë, paraqitja e të cilit pezullon vazhdimin e mëtejshëm të gjykimit.

Neni 371

Kur palët deklarojnë se nuk kanë ankimi ndaj vendimit të ndërmjetëm të përmendur në nenin 370 të këtij Kodi, bëhet shënim në procesverbalin gjyqësor, i cili nënshkruhet edhe nga palët ose përfaqësuesit e tyre. Në një rast të tillë, si dhe në rastin kur vendimi i ndërmjetëm, që ka lejuar pjesëtimin, ka marrë formën e prerë, gjykata vazhdon gjykimin në fazën e dytë, duke marrë në shqyrtim kërkesat që mund të kenë bashkëpronarët për llogaritë që duhet të japin midis tyre dhe që rrjedhin nga marrëdhëniet e bashkëpronësisë.

Neni 372

Vlerësimi i pasurisë dhe formimi i pjesëve

Gjykata bën vlerësimin e sendeve që do të pjesëtohen, pasi më parë të ketë marrë mendimin e ekspertëve, dhe kur sendet mund të ndahen në natyrë formohen atë pjesë sa janë edhe bashkëpjesëtarët. Në secilën nga këto pjesë duhet të përfshihen, me sa është e mundur, një sasi nga sendet apo kreditë të po asaj natyre me vlerë të barabartë me pjesën takuese. Pabarazia në natyrë e sendeve midis pjesëve kompensohet në para. Gjykata vendos edhe për marrëdhëniet financiare të palëve për shkak të bashkëpronësisë.

Neni 373

Vendimi i gjykatës

(Shtuar një fjali në paragrafin e dytë me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Kur sendi ndahet në natyrë dhe pjesët e formuara janë të barabarta ose barazohen me para, gjykata harton një projekt pjesëtimi të cilin e depoziton në sekretari jo më pak se dhjetë ditë përpara seancës së ardhshme gjyqësore. Palët kanë të drejtë të parashitrojnë vërejtjet e tyre për projektin e depozituar, jo më vonë se pesë ditë përpara seancës së ardhshme gjyqësore.

Në vendimin përfundimtar gjykata cakton pjesën e secilit bashkëpjesëtar. Kur pjesët ndahen në natyrë në mënyrë të barabartë dhe e kërkon ndonjëra nga palët, ato u japin bashkëpjesëtarëve duke u hedhur në short. Gjykata mund të pranojë kërkesën e bashkëpjesëtarit për të marrë pjesën e treguar prej tij, kur ajo shihet me vend për shkak të profesionit ose të natyrës së sendeve që përfshihen në pjesën takuese. Pjesëtimi në natyrë kryhet në përputhje me rregullat urbanistike.

Neni 374

Shitja e sendit në ankand

Kur në vendimin përfundimtar është urdhëruar që një send të shitet në ankand për shkak se nuk mund të ndahet në natyrë, vendimi, pasi të ketë marrë formën e prerë, ekzekutohet nga përbaruesi gjyqësor, sipas rregullave mbi ekzekutimin e detyrueshëm.

KREU VI SHPALLJA E ZHDUKJES OSE E VDEKJES SË NJË PERSONI

Neni 375

Kërkesa

(Ndryshuar me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013)

Kërkesa për shpalljen e një personi të zhdukur ose të vdekur mund të paraqitet nga çdo person i interesuar, nga noteri, pranë të cilit personi ka redaktuar një testament me akt noterial, apo ka depozituar për ruajtje testamentin ollograf ose testamentin e posaçëm, apo nga prokurori në gjykatën ku ka pasur vendbanimin e fundit personi për të cilin kërkohet shpallja si i tillë.

Neni 376

Përmbajtja e kërkesës

Në kërkesën për shpalljen e një personi të zhdukur ose të vdekur, përveç rrethanave nëpërmjet të cilave bëhet e besueshme zhdukja ose vdekja e tij, tregohet edhe kujdestari ose përfaqësuesi ligjor i tij, për rastet kur ka të tillë.

Në kërkesën për deklarimin e një personi si të vdekur, duhet të tregohen edhe personat që janë ose mund të jenë trashëgimtarë të tij, si dhe gjithë personat e tjerë për të cilët është e ditur që nga ky fakt fitojnë ose humbin të drejta.

Neni 377

Publikimi i kërkesëpadisë

Gjykata, brenda dhjetë ditëve nga paraqitja e kërkesës për gjykim, i dërgon një kopje të saj bashkisë ose komunës, ku ka pasur banimin e tij të fundit personi që kërkohet të shpallet i zhdukur ose i vdekur, për ta shpallur në një vend të dukshëm. Kërkesa e mësipërme botohet edhe në Fletoren Zyrtare, si dhe të paktën në një gazetë lokale.

Shqyrtimi i çështjes nga gjykata nuk mund të bëhet pa kaluar gjashtë muaj nga shpallja e kërkesës ose botimit të saj në Fletoren Zyrtare.

Neni 378

Procedura e gjykimit

Gjykata, në shqyrtimin e kërkesës për shpalljen të zhdukur ose të vdekur të një personi, pyet njerëz të afërt të tij, merr të dhëna për këtë person nga bashkia ose komuna, ku ai ka pasur vendbanimin e tij të fundit, si dhe nga çdo burim tjetër që mund të japë lajme për këtë person.

Neni 379

Në shqyrtimin e kërkesës për ndryshimin ose prishjen e vendimit, që ka deklaruar një person si të vdekur, të thirren personat që kishin kërkuar deklarimin e vdekjes dhe personat që kanë fituar të drejta nga deklarimi i vdekjes.

Neni 380

Publikimi i vendimit

(Ndryshuar paragrafi i tretë me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013)

Gjykata vendos për shpalljen e një personi të zhdukur apo të vdekur, pasi të ketë dëgjuar edhe personat që përmenden në nenin 375 e 376 të këtij Kodi, si dhe prokurorin.

Gjykata urdhëron botimin e shkurtimit të vendimit në Fletoren Zyrtare ose të paktën në një gazetë lokale të caktuar prej saj ose në një mënyrë tjetër publikimi që do ta quajë të dobishme.

Gjykata mund të marrë masa për sigurimin e pasurisë trashëgimore. Ajo autorizon dhomën e noterisë në nivel vendor, që mbulon njësinë vendore të vendbanimit të fundit të të shpallurit të zhdukur

ose të vdekur, ose noterin, pranë të cilit është redaktuar testamenti me akt noterial, apo është depozituar për ruajtje testamenti ollograf ose testamenti i posaçëm, që të bëjë inventarin e pasurisë së trashëgimlënësit. Dhoma e noterisë në nivel vendor cakton një noter për të bërë inventarin e pasurisë së trashëgimlënësit. Noteri në këtë rast duhet të caktojë një person si ruajtës të pasurisë trashëgimore deri në çeljen e dëshmisë së trashëgimisë.

Neni 381

Regjistrimi i vendimit në zyrën e gjendjes civile

Vendimi i gjykatës, që e deklaron një person të zhdukur ose të vdekur, i dërgohet për regjistrim zyrës së gjendjes civile në të cilën ai ka qenë i regjistruar, pasi të sigurohet se është bërë publikimi i tij sipas dispozitës së mësipërme.

KREU VII

HEQJA OSE KUFIZIMI I ZOTËSISË PËR TË VEPRUAR

Neni 382

Kush e bën kërkesën

Heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar bëhet me kërkesë të bashkëshortit, gjinisë së afërt, të prokurorit, si dhe të personave që kanë interes të ligjshëm për këtë fakt.

Kërkesa i paraqitet gjykatës së vendit ku ka banimin personi që kërkohet t'i hiqet ose kufizohet zotësia për të vepruar.

Neni 383

Procedura e gjykimit

Kërkesa për heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar i njoftohet prokurorit. Kërkesa duhet të përmbajë faktin në të cilin ajo bazohet si dhe provat e nevojshme.

Gjykata vendos lidhur me kërkesën, pasi të ketë pyetur personin për të cilin kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, persona nga gjinia e afërt e tij, mjekun që e ka kuruar ose pasi të ketë marrë mendimin e mjekëve të tjerë ekspertë, si dhe prova të tjera që do t'i çmojë të nevojshme.

Pyetja e personit të cilit i kërkohet t'i hiqet ose kufizohet zotësia për të vepruar, bëhet në institucionin që është shtruar për mjekim ose në banesën e tij nga një gjyqtar i deleguar, kur nuk është e mundur të paraqitet vetë në gjykatë.

Neni 384

Kujdestari i përkohshëm

(Shfuqizuar me ligjin nr. 9062, datë 8.5.2003)

Neni 385

Ankimi

Kundër vendimit për heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar, mund të bëjnë ankim vetë personi i mësipërm, kujdestari i përkohshëm i tij, personi që ka bërë kërkesën, si dhe të gjithë personat e tjerë që sipas nenit 382 të këtij Kodi kanë të drejtë të kërkojnë heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar, pavarësisht nga pjesëmarrja ose jo e tyre në gjykimin e kësaj çështjeje. Në këtë rast gjykata i lejon ata të njihen me materialet e dosjes gjyqësore.

Neni 386

Dispozitë referuese

Dispozitat e parashikuara në këtë kre zbatohen edhe për kthimin e zotësisë për të vepruar.

Neni 387

Marrja dijëni e personave të interesuar për vendimin e gjykatës

Pasi vendimi me të cilin hiqet, kufizohet ose kthehet zotësia për të vepruar merr formë të prerë, një shkurtim i tij u dërgohet të gjithë gjykatave, për t'u regjistruar në një formë të veçantë, me të cilën mund të marrë dijëni cilido që ka interes.

Gjykata i dërgon një shkurtim të këtij vendimi edhe Dhomës Kombëtare të Noterëve, e cila ua bën të njohur dhomave të noterëve nëpër rrethe.

KREU VIII

VËRTETIMI GJYQËSOR I FAKTEVE

Neni 388

Kur mund të ngrihet kërkesa

Kur nga një fakt varet lindja, ndryshimi ose shuarja e të drejtave personale apo pasurore të një personi dhe akti që vërteton atë është zhdukur, ka humbur dhe nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret me ndonjë rrugë tjetër, personi i interesuar ka të drejtë të kërkojë që fakti të vërtetohet me vendim të gjykatës së shkallës së parë.

Kërkesa për vërtetimin e fakteve paraqitet në gjykatën e shkallës së parë, në territorin e së cilës ka banimin kërkuesi. Kur kërkohet vërtetimi i faktit për një send të paluajtshëm, ajo paraqitet në gjykatën e shkallës së parë në territorin e së cilës ndodhet sendi.

Në mënyrën e treguar më sipër mund të kërkohet edhe korrigjimi i gabimeve të akteve të treguara në paragrafin e parë të këtij neni.

Neni 389

Përmbajtja e kërkesës

Në kërkesën për vërtetimin e fakteve duhet të tregohen:

- a) qëllimi për të cilin kërkuesi paraqet kërkesën për vërtetimin e faktit të caktuar;
- b) shkaqet për të cilat nuk mund të merret akti ose për të cilët nuk është mundur që akti të bëhet përsëri;
- c) provat me të cilat do të provohet si shkak, për të cilin nuk është e mundur të merret akti ose ky akt nuk mund të bëhet përsëri, ashtu edhe fakti që kërkohet të vërtetohet.

Neni 390

Procedura e gjykimit

Kërkesa për vërtetimin e fakteve gjyqësore shqyrtohet në seancë gjyqësore, në prani të kërkuetit e të personave fizikë a juridikë që kanë interes në çështje. Kur çështja paraqet interes publik dhe gjykata e shëh të arsyeshme, mund të thirret edhe prokurori.

Neni 391

Vendimi i gjykatës

Në vendimin e gjykatës duhet të tregohet fakti i vërtetuar prej asaj dhe provat në bazë të të cilave është vërtetuar fakti.

Kundër vendimit, me të cilin pranohet ose nuk pranohet kërkesa, mund të bëhet ankim, sipas rregullave të përgjithshme, nga kërkuesi, si dhe nga personat fizikë a juridikë që janë thirrur për të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes.

Vendimi nuk ka fuqi provuese kundër personave fizikë a juridikë që nuk kanë qenë thirrur në rast se e kundërshtojnë faktin e vërtetuar në vendim.

Neni 392

Efektet e vendimit të gjykatës

Kur, gjatë shqyrtimit të kërkesës, lind një konflikt midis kërkuetit dhe një personi tjetër të interesuar, për të drejtën civile që ka lidhje me vërtetimin e faktit, gjykata vendos pushimin e shqyrtimit të çështjes. Në këtë rast palët mund t'i drejtohen gjykatës me padi sipas rregullave të përgjithshme.

KREU IX
NJOHJA E VENDIMEVE TË SHTETEVE TË HUAJA

Neni 393

Kushtet për zbatimin e vendimeve të dhëna nga gjykatat e huaja

Vendimet e gjykatave të shteteve të huaja njihen dhe zbatohen në Republikën e Shqipërisë, në kushtet e parashikuara në këtë Kod ose në ligje të veçanta.

Kur për këtë qëllim ka marrëveshje të posaçme ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shtetit të huaj zbatohen dispozitat e marrëveshjes.

Neni 394

Pengesat ligjore për zbatimin e vendimeve të dhëna nga gjykatat e huaja

Vendimit të një gjykate të shtetit të huaj nuk i jepet fuqi në Republikën e Shqipërisë kur:

- a) sipas dispozitave që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë, mosmarrëveshja nuk mund të jetë në kompetencën e gjykatës së shtetit që ka dhënë vendimin;
- b) kërkesëpadia dhe letërthirrja për në gjyq nuk i është njoftuar të paditurit në mungesë, në mënyrë të rregullt e në kohë, për t'i dhënë atij mundësi që të mbrohet;
- c) midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt e për të njëjtin shkak, është dhënë një vendim tjetër i ndryshëm nga gjykata shqiptare;
- ç) është duke u shqyrtuar nga gjykata shqiptare një padi që është ngritur përpara se vendimi i gjykatës së shtetit të huaj të ketë marrë formë të prerë;
- d) i është dhënë forma e prerë në kundërshtim me legjislacionin e tij;
- dh) nuk pajtohet me parimet bazë të legjislacionit shqiptar.

Neni 395

Shqyrtimi i kërkesës

Kërkesa për t'i dhënë fuqi vendimit të gjykatës së huaj i paraqitet gjykatës së apelit.

Kërkesa mund të paraqitet edhe në rrugë diplomatike, kur ajo është e lejueshme nga marrëveshjet ndërkombëtare dhe mbi bazën e reciprocitetit.

Në këto raste, në qoftë se pala e interesuar nuk ka emëruar përfaqësues, kryetari i gjykatës së apelit emëron një avokat për të paraqitur kërkesën.

Neni 396

Kërkesës për t'i dhënë fuqi vendimit të gjykatës së huaj duhet t'i bashkëngjiten:

- a) kopja e vendimit që duhet të zbatohet dhe përkthimi i tij në gjuhën shqipe i legalizuar nga noteri;
- b) vërtetim nga gjykata që e ka nxjerrë vendimin se ai ka marrë formë të prerë, si edhe përkthimi e legalizimi noterial i tij. Si kopja e vendimit ashtu edhe vërtetimi se vendimi ka marrë formë të prerë, duhet të jenë vërtetuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë;
- c) prokura, në rast se kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i të interesuarit, e përkthyer dhe e legalizuar te noteri.

Neni 397

Gjykata e apelit nuk e shqyrton çështjen në themel, por vetëm kontrollon nëse vendimi i paraqitur nuk përmban dispozita që vijnë në kundërshtim me nenin 394.

Për kërkesën e paraqitur gjykata e apelit jep vendim.

Neni 398

Zbatimi i vendimit të një gjykate të huaj

Vendimi i gjykatës së shtetit të huaj zbatohet në Republikën e Shqipërisë vetëm në bazë të vendimit të gjykatës të apelit që i jep fuqi këtij vendimi dhe ekzekutohet në përputhje me dispozitat përkatëse të këtij Kodi.

Neni 399

Vendimi i gjykatës së arbitrazhit

Dispozitat e këtij kreu zbatohen edhe për njohjen e vendimit përfundimtar të një arbitrazhi të shtetit të huaj.

KREU X

GJYKIMI I KËRKESAVE PËR KONSTATIMIN E SHKELJES SË AFATIT TË ARSYESHËM, PËRSHPEJTIMIN E PROCEDURAVE DHE SHPËRBLIMIN E DËMIT

(shtuar krejtësisht kreu X me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Neni 399/1

Objekti

(Shtuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Në kompetencë të gjykatave, sipas shkallëve të gjykimit të përcaktuar në këtë kre, hyjnë edhe shqyrtimi i kërkesave për shpërblimin e drejtë të personit që ka pësuar një dëm pasuror ose jopasuror, për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të çështjes, sipas përkufizimit të nenit 6/1 të Konventës Europiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”.

2. Dispozitat e këtij kreu përcaktojnë vlerësimin e kohëzgjatjes së arsyeshme të procesit, si edhe shpërblimin e drejtë, kur konstatohet kohëzgjatje e paarsyeshme në procedurat e hetimit, gjykimit të çështjeve, si edhe në procedurat e ekzekutimit të vendimeve.

Neni 399/2

Afati i arsyeshëm

(Shtuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Afate të arsyeshme të përfundimit të hetimit, gjykimit apo ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, për qëllimet e përcaktuara në nenin 399/1, do të konsiderohen:

a) në gjykimin administrativ në shkallën e parë dhe në apel, përfundimi i gjykimit brenda një viti nga fillimi i tij në secilën shkallë;

b) në gjykimin civil në shkallë të parë përfundimi i procesit të gjykimit brenda dy viteve, në gjykim civil në apel brenda dy vjetëve; dhe gjykimin civil në Gjykatën e Lartë, brenda dy vjetëve;

c) në procedurën e ekzekutimit të një vendimi civil apo administrativ, me përjashtim të detyrimeve periodike ose të përcaktuara në kohë, afati njëvjeçar fillon nga dita e paraqitjes së kërkesës për vënie në ekzekutim;

ç) në hetimin e veprave penale afati maksimal i kohëzgjatjes së hetimeve, sipas Kodit të Procedurës Penale;

d) në gjykimin penal në shkallë të parë, afati i gjykimit të krimeve 2 vjet dhe i kundërvajtjeve 1 vit, në gjykimin në apel përfundimi i gjykimit për krimet në një afat kohor prej 1 viti dhe për kundërvajtjet 6 muaj dhe në Gjykatën e Lartë, përfundimi i gjykimit për krimet në një afat kohor prej 1 viti dhe për kundërvajtjet 6 muaj.

2. Palët në proces mund të kërkojnë konstatimin e tejzgjatjes së procedurave, sipas nenit 399/6 pika 1, edhe pa kaluar afatet e mësipërme, duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjes, objektin e mosmarrëveshjes, të procedimit ose të gjykimit, sjelljen e organit që po kryen procedurat, si dhe të çdo personi tjetër të lidhur me çështjen, kur pretendojnë zvarritje të hetimit, gjykimit ose ekzekutimit të vendimit.

3. Në kohëzgjatjen e gjykimit ose të procedimit, nuk llogaritet koha kur çështja është pezulluar për shkaqe ligjore, kur është shtyrë për shkak të kërkesave të palës kërkuese, sipas këtij kreu, ose kur shfaqen rrethana të pamundësisë objektive për procedim.

Neni 399/3

Shpërblimi i drejtë

(Shtuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Shpërblimi i drejtë për shkeljen e afatit të arsyeshëm do të konsiderohet njohja e shkeljes, çdo masë e marrë për të përshpejtuar procedurat e hetimit, gjykimin të çështjes dhe të ekzekutimit të vendimit, dhe/ose shpërblimin e dëmit, sipas përcaktimeve të këtij kreu.

2. Cilido që është i përfshirë në një proces ligjor, në cilësinë e palës në proces, ka të drejtë shpërblimin e drejtë, siç përcaktohet nga ky nen.

Neni 399/4

Kompetenca për shqyrtimin e kërkesës ose kërkesëpadisë

(Shtuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Kërkesa për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave i drejtohet gjykatës kompetente, sipas nenit 399/6, pika 1, e këtij kreu. Sipas rastit në gjykim gjykata merr informacion nga organi i cili po zhvillon procedurat.

2. Kërkesëpadia, sipas nenit 399/6, pika 3, i drejtohet gjykatës civile të shkallës së parë kompetente, sipas rregullave të përgjithshme, vetëm pasi procedura e konstatimit të shkeljes dhe përshpejtimin të procedurës është ezauruar sipas pikës 1, të këtij neni, dhe nuk është ekzekutuar nga organi që ka kryer shkeljen vendimi i gjykatës, sipas pikës 1 të këtij neni. Të paditur në gjykim thirren Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave, ose shërbimi përmbarimor privat përgjegjës.

Neni 399/5

Paraqitja e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave

(Shtuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Kërkesa depozitohet në sekretarinë e gjykatës që është në vonesë, ose gjykatës kompetente për ekzekutimin. Kërkesa duhet të përmbajë:

a) palët ndërgjyqëse, organin që pretendohet se ka kryer shkeljen, objektin e mosmarrëveshjes ose të ekzekutimit;

b) paraqitjen e përmbledhur të fakteve të çështjes;

c) shkaqet për të cilat kërkohet konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimi i procedurave;

ç) masat që kërkohen të merren.

2. Bashkë me kërkesën duhet të depozitohen edhe:

a) aktet me të cilat provohet tejkalimi i afatit të arsyeshëm;

b) procesverbale dhe vendime të ndërmjetme;

c) aktet e praktikës përmbarimore, sipas rastit;

ç) prokura, nëse kërkesa është bërë nga avokati ose nga përfaqësuesi i ankuesit.

3. Depozitimi dhe shqyrtimi i kërkesës, sipas këtij neni, nuk pezullon gjykimin e çështjes në themel, ose procedurat përmbarimore.

Neni 399/6

Gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës ose kërkesëpadisë

(Shtuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Kërkesa për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave i drejtohet gjykatës kompetente, sipas llojit të mosmarrëveshjes penale, civile ose administrative si më poshtë:

a) në rastet kur çështja, në të cilën pretendohet të ketë shkelje, është duke u gjykuar në gjykatën e shkallës së parë, kërkesa shqyrtohet nga gjykata e apelit, në juridiksionin e të cilës ndodhet gjykata e shkallës së parë;

b) në rastet kur çështja në të cilën pretendohet të ketë shkelje, është duke u gjykuar në gjykatat e apelit, kërkesa shqyrtohet nga kolegji përkatës i Gjykatës së Lartë;

c) në rastet kur çështja në të cilën pretendohet të ketë shkelje, është duke u gjykuar në Gjykatën e Lartë, kërkesa shqyrtohet nga një kolegji tjetër i Gjykatës së Lartë;

ç) në rastet kur çështja, në të cilën pretendohet të ketë shkelje, është në procedurë ekzekutimi, kërkesa gjykohet nga gjykata e shkallës së parë, kompetente për ekzekutimin, sipas rregullave në fuqi.

2. Kur ka një vendim të formës së prerë për konstatimin e shkeljes dhe përsheptimin e procedurës, subjekti kërkues mund të paraqesë padi për shpërblimin e dëmit, sipas pikës 3 të këtij neni.

3. Kërkesëpadia për shpërblimin e dëmit i drejtohet gjykatës civile të shkallës së parë ku ka qendrën organi ndaj të cilit është konstatuar shkelja. Padia parashkruhet brenda 6 muajve nga konstatimi i shkeljes me vendim të formës së prerë.

Neni 399/7

Gjykimi i kërkesës ose kërkesëpadië

(Shtuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjykimi i kërkesëpadiës, sipas nenit 399/6, pika 3, bëhet sipas rregullave të zakonshme të gjykimit brenda një afati 3 mujor nga depozitimi i kërkesëpadiës.

2. Gjykimi i kërkesës, sipas nenit 399/6, pika 1, bëhet në dhomë këshillimi dhe gjykata që shqyrton çështjen merr vendim brenda 45 ditëve, nga paraqitja e kërkesës. Brenda 15 ditëve nga paraqitja e kësaj kërkesë, organi që pretendohet se ka kryer shkeljen, i dërgon kopje të dosjes dhe mendimin me shkrim, gjykatës që shqyrton kërkesën.

3. Në rast se gjatë shqyrtimit të kërkesës organi që po kryen veprimet, ndërmerr hapat që po kërkohen nga pala, brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës, pushon shqyrtimi i kërkesës.

4. Në rast se kërkesa refuzohet, nuk mund të përsëritet më, për të njëjtat fakte.

Neni 399/8

Marrja e vendimit

(Shtuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Pas shqyrtimit të kërkesës gjykata vendos:

a) pranimin e kërkesës, konstatimin e shkeljes dhe urdhërimin e ndërmarrjes brenda afateve të veprimeve të caktuara procedurale gjatë gjykimit ose ekzekutimit;

b) rrëzimin e kërkesës.

2. Vendimi i gjykatës është përfundimtar dhe i formës së prerë.

Neni 399/9

Pranimi i kërkesës

(Shtuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjykata vendos pranimin e kërkesës, kur vërtetohet shkelja e afatit të arsyeshëm, sipas nenit 6/1, të Konventës Europiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”.

2. Në përcaktimin e shkeljes gjykata vlerëson kompleksitetin e çështjes, objektin e mosmarrëveshjes, të procedimit ose të gjykimit, sjelljen e palëve dhe të trupit gjykues gjatë gjykimit, ose të përmarbuesit, si dhe të çdo personi tjetër të lidhur me çështjen.

Neni 399/10

Përmbajtja e vendimit për shpërblimin e dëmit

(Shtuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Pas shqyrtimit të kërkesëpadiës gjykata vendos shpërblimin e dëmit nga 50 000 lekë deri në 100 000 lekë, për çdo vit, ose muaj në raport me vitin, përtej afatit të arsyeshëm.

2. Shpërblimi i dëmit bëhet duke mbajtur parasysh:

- a) vështirësinë e procesit, në të cilin është verifikuar shkelja;
- b) sjelljen e trupit gjykues ose përmbaruesit dhe të palëve;
- c) natyrën e interesave në çështje;
- ç) vlerën dhe rëndësinë e çështjes në lidhje me objektin e mosmarrëveshjes ose ekzekutimit, e vlerësuar edhe në raport me kushtet personale të palëve.

3. Masa e shpërblimit të dëmit nuk mund të kalojë objektin e padisë ose të ekzekutimit.

Neni 399/11

Zbatimi i detyrueshëm i udhëzimeve

(Shtuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Udhëzimet dhe konkluzionet e gjykatës më të lartë, të dhëna gjatë shqyrtimit të kërkesës, sipas nenit 399/6, pika 1, janë të detyrueshme, për gjykatën që shqyrton çështjen në themel ose organin, i cili po kryen ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Neni 399/12

(Shtuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Vendimi i formës së prerë i gjykatës kompetente, sipas nenit 399/6, i përcillet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të vlerësuar nëse vonesat e shkaktuara nga gjyqtarët, sipas këtij kreu, përbëjnë shkelje disiplinore.

TITULLI IV[‡]

ARBITRAZHI

(shfuqizuar titulli me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013)

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Fusha e zbatimit

Neni 400

(Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Dispozitat e këtij kreu vlejné për procedurën e gjykimeve të arbitrazhit, kur pjesëmarrësit në proces janë me banim ose vendqëndrim në Republikën e Shqipërisë dhe kur vendi i procedurës së arbitrazhit ndodhet në territorin e saj.

Neni 401

Përcaktime

(Shfuqizuar paragrafi i tretë me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001)

- Me “procedurë arbitrazhi” kuptohet çdo procedurë e sistemit gjyqësor të arbitrazhit pavarësisht nëse ajo zhvillohet ose jo nga një institucion i përhershëm arbitrazhi.
- Me “gjykatë arbitrazhi” kuptohet një gjyqtar i vetëm arbitrazhi ose trup gjykues arbitrazhi.

Neni 402

Kompetenca lëndore

Çdo pretendim pasuror ose kërkesë që rrjedh nga një marrëdhënie pasurore, mund të jetë objekt i një gjykimi të arbitrazhit.

[‡]) Dispozitat lidhur me arbitrazhin shfuqizohen me hyrjen në fuqi të ligjit për arbitrazhin, parashikuar në nenin 30 të ligjit nr. 122/2013, datë 18.4.2013.

Kur njëra palë është shteti ose një ndërmarrje apo organizatë e kontrolluar prej tij, ajo nuk mund të pretendojë të drejtën për të mos qenë palë në një procedurë arbitrazhi.

Neni 403

Marrëveshja për arbitrazh

Mund të gjykohet me procedurë arbitrazhi vetëm në qoftë se ekziston një marrëveshje e palëve, me anë të së cilës ato pranojnë t'ia nënshtrojnë arbitrazhit mosmarrëveshjet që kanë lindur ose mund të lindin nga një kontratë e lidhur ndërmjet tyre.

Neni 404

Pavlefshmëria e marrëveshjes për arbitrazh

(Ndryshuar fjalë në paragrafin e parë dhe të dytë me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001)

Është i pavlefshëm kushti për gjykimin e mosmarrëveshjes me arbitrazh, kur nuk pasqyrohet me shkrim në vet marrëveshjen kryesore të palëve ose me një dokument tjetër të shkruar që i referohet asaj, siç mund të jetë telegrami, teleksi e çdo mjet tjetër i saktë që përbën provë shkresore.

Marrëveshja e palëve, sipas paragrafit të parë, është e pavlefshme, në rast se në atë nuk parashikohet mënyra e caktimit të arbitrit ose arbitrave, si dhe objekti i mosmarrëveshjes, kur ajo efektivisht ka lindur.

Marrëveshja për gjykimin me procedurë arbitrazhi shfuqizohet, kur një arbitër i caktuar sipas kësaj procedure nuk pranon misionin e besuar.

Neni 405

Caktimi i numrit të arbitrave

(Ndryshuar fjalia e dytë me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001)

Palët mund të merren vesh në mënyrë të pavarur për numrin e arbitrave në një gjykatë arbitrazhi dhe për mënyrën e caktimit të tyre. Në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet palëve dhe me pëlqimin paraprak të tyre, gjykata e arbitrazhit formohet nga një arbitër ose më shumë arbitra në numrin tek, që caktohen nga gjykata.

Neni 406

Fillimi i procedurës së arbitrazhit

Shqyrtimi i mosmarrëveshjes me procedurë arbitrazhi fillon me kërkesën e të dyja palëve ose të palës së interesuar.

Marrëveshja për gjykimin e çështjes me procedurë arbitrazhi mund të arrihet edhe pasi ka filluar gjykimi nga një gjykatë kompetente. Në një rast të tillë procesverbali i seancës gjyqësore nënshkruhet nga gjykata dhe nga palët ose përfaqësuesit e tyre.

KREU II

FORMIMI I GJYKATËS SË ARBITRAZHIT

Neni 407

Kush mund të jetë arbitër

Misioni i arbitrit i besohet vetëm një personi fizik që ka zotësi juridike të plotë për të vepruar. Në qoftë se për këtë qëllim është caktuar një person juridik, ky i fundit ka fuqi vetëm për të organizuar arbitrazhin.

Neni 408

Procedura e formimit të gjykatës së arbitrazhit

Gjykata e arbitrazhit quhet e formuar rregullisht kur arbitri ose arbitrat janë emëruar në përputhje me dispozitat e këtij kreu dhe ata kanë pranuar me shkrim misionin që u është besuar.

Personi që i propozohet detyra e arbitrit duhet, menjëherë pas emërimit të tij, t'u parashtojë palëve të gjitha rrethanat të cilat mund të ngjallin dyshime për paanësinë dhe pavarësinë e tij në zgjidhjen e

mosmarrëveshjes. Ai mund të mos pranohet si arbitër kur dyshimet e sipërpërmendura janë të drejta e të bazuara, si dhe kur nuk i plotëson kushtet për të cilat kanë rënë dakord palët.

Pala që ka emëruar një arbitër, mund ta përjashtojë atë vetëm për shkaqe që bëhen të njohura pas emërimit të tij.

Neni 409

Palët mund të merren vesh në mënyrë të pavarur për procedurën e mospranimit të një arbitri.

Kur mungon një marrëveshje e tillë, pala që kundërshton emërimin e arbitrit duhet t'ia bëjë të ditur këtij të fundit, brenda 10 ditëve nga marrja dijëni e emërimit, shkaqet e mospranimit.

Në rast se arbitri për të cilin është kërkuar përjashtimi nuk tërhiqet nga misioni ose procedura e caktuar nga palët nuk i jep zgjidhje këtij kundërshtimi, vendos gjykata e arbitrazhit pa pjesëmarrjen e arbitrit për të cilin është kërkuar përjashtimi. Kur edhe kjo e fundit nuk i jep zgjidhje kërkesës për përjashtim, vendos gjykata e shkallës së parë, jo më vonë se 15 ditë nga dita e ardhjes për gjykim të kësaj mosmarrëveshjeje.

Neni 410

Kur një arbitër nuk është në gjendje të plotësojë detyrat e tij për misionin e ngarkuar ose për arsye të ndryshme nuk përmbush detyrat e tij në afatin e caktuar, mandati i tij si arbitër përfundon kur ai tërhiqet nga ky mision ose kur palët merren vesh për përfundimin e këtij misioni. Zëvendësimi i tij bëhet sipas rregullave për emërimin e arbitrave.

Neni 411

Kur palët caktojnë arbitrat në numër çift, gjykata e arbitrazhit plotësohet me një arbitër të caktuar sipas marrëveshjes së palëve dhe, në mungesë të saj, nga arbitrat e emëruar prej palëve. Kur këto nuk kanë mundur të caktojnë arbitrin, ky caktohet nga kryetari i gjykatës së shkallës së parë.

Caktimi i arbitrit sipas kësaj dispozite në çdo rast duhet të bëhet brenda 15 ditëve nga marrja dijëni për një detyrim të tillë.

Neni 412

Kur një person juridik apo fizik ngarkohet nga palët që të organizojë arbitrazhin, për këtë qëllim caktohen një ose më shumë arbitra të pranuar nga palët. Në rastet kur nuk është arritur pranimi i palëve, personi i ngarkuar me organizimin e arbitrazhit fton secilën palë të caktojë arbitrin e saj dhe vepron sipas procedurës për caktimin e arbitrit të nevojshëm, për të plotësuar trupin gjykues të arbitrazhit.

Neni 413

Kohëzgjatja e misionit të arbitrit

Nëse marrëveshja e arbitrazhit nuk cakton afat, misioni i arbitrave vazhdon vetëm 6 muaj, duke filluar nga dita kur i fundit prej tyre ka pranuar këtë mision.

Afati i vendosur, sipas paragrafit të parë, me kërkesën qoftë edhe të njëjës prej palëve ose të gjykatës së arbitrazhit, mund të shtyhet nga kryetari i gjykatës së shkallës së parë.

Neni 414

Juridiksioni i gjykatës së arbitrazhit

Kur një mosmarrëveshje që është duke u shqyrtuar nga një gjykatë arbitrazhi, mbi bazën e një marrëveshjeje arbitrazhi, i dërgohet për gjykim një juridiksioni tjetër, ky i fundit duhet të deklarojë moskompetencën.

Kur procedura e arbitrazhit për shqyrtimin e mosmarrëveshjes ende nuk ka filluar, juridiksioni tjetër duhet gjithashtu të deklarojë moskompetencën, përveç kur marrëveshja e arbitrazhit është haptazi e pavlefshme.

KREU III

PROCEDURA E ARBITRAZHIT

Neni 415

Fillimi i veprimtarisë së gjykatës së arbitrazhit

Gjykata e arbitrazhit e fillon veprimtarinë e saj procedurale nga çasti kur është krijuar, përveç kur në marrëveshje janë caktuar gjithë arbitrat. Në këtë rast, quhet se e fillon veprimtarinë kur njëra prej palëve ngarkon arbitrin ose arbitrat me kryerjen e misionit të tyre.

Neni 416

Përcaktimi i procedurës së punës

Palët mund të përcaktojnë vetë procedurën e punës të gjykatës së arbitrazhit, duke pranuar rregullat e vendosura për gjykatat ose duke i referuar rregullave procedurale të një organizmi arbitrazhi të zgjedhur prej tyre.

Nëse një rregullim i tillë nuk është bërë nga palët, gjykata e arbitrazhit i cakton vetë ato, qoftë edhe duke i referuar një rregulloreje të një organizmi arbitrazhi.

Pavarësisht nga sa u parashtrua në dy paragrafët e mësipërm, gjykata e arbitrazhit është e detyruar të respektojë parimet drejtuese të procesit, të garantojë barazinë ndërmjet palëve dhe të drejtën e tyre për t'u dëgjuar në një procedurë kontradiktore.

Neni 417

Gjykata e arbitrazhit, kryesisht ose me kërkesën e palëve, vendos për kompetencën e vet, duke përfshirë edhe vlefshmërinë e marrëveshjes së arbitrazhit. Kur ajo pranon me vendim se marrëveshja e arbitrazhit është e pavlefshme, quhet se ajo e ka përfunduar misionin e saj.

Neni 418

Marrja e masave për sigurimin e padisë

Gjykata e arbitrazhit, me kërkesën e njëres prej palëve mund të vendosë marrjen e masave për sigurimin e padisë, përveç kur ka marrëveshje të kundërt ndërmjet palëve. Nëse palët nuk kanë vendosur rregulla për një qëllim të tillë, gjykata e arbitrazhit zbaton rregullat e parashikuara në këtë Kod për sigurimin e padisë.

Nëse pala tjetër nuk zbaton vullnetarisht këto masa, gjykata e arbitrazhit i drejtohet gjykatës kompetente, e cila vendos sipas rregullave të caktuara në këtë Kod.

Neni 419

Vendi i zhvillimit të arbitrazhit

Palët mund të caktojnë në marrëveshjen e arbitrazhit vendin se ku do të zhvillohet procedura e arbitrazhit. Në mungesë të marrëveshjes, vendin e cakton gjykata e arbitrazhit. Nëse edhe kjo nuk mund të marrë një vendim të tillë, atëherë vendi se ku do të zhvillohet procedura e arbitrazhit do të jetë vendbanimi ose qendra e palës së paditur.

Neni 420

Lejimi dhe marrja e provave

Palët mund të paraqitin si provë dokumentet me shkresë që atyre u duken të rëndësishme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose t'u referohen dokumenteve dhe mjeteve të tjera provuese.

Ato mund të shtojnë ose të pakësojnë objektin e padisë ose të ndryshojnë shkaku ligjor të saj deri në përfundimin e hetimit gjyqësor.

Kjo dispozitë nuk zbatohet kur palët në marrëveshjen e arbitrazhit ose në mungesë të saj, gjykata e arbitrazhit në rregulloren e pranuar prej saj, ka parashikuar ndryshe. Megjithëkëtë marrëveshja nuk duhet të prejë parimet e marrjes së lirë të provave.

Neni 421

Gjykata e arbitrazhit vepron vetë për marrjen e provave të nevojshme. Në rast se ndeshen vështirësi në marrjen e tyre, siç mund të jetë refuzimi për t'u paraqitur në gjykatën e arbitrazhit, për të paraqitur një

provë shkresore ose për të marrë të dhëna nga një institucion shtetëror a privat, këto i kërkohen gjykatës së shkallës së parë, e cila vepron sipas rregullave të përcaktuara në këtë Kod për gjykatat.

Neni 422

Gjykimi në mungesë

Kur paditësi ose i padituri nuk janë paraqitur në ditën e orën e caktuar të seancës gjyqësore pa ndonjë shkak të përligjur, gjykata e arbitrazhit zhvillon gjykimin në mungesë. Mosparaqitja e një pale nuk duhet të konsiderohet si pohim i pretendimeve të palës tjetër.

Neni 423

Zëvendësimi i arbitrit

Arbitri i emëruar duhet të ndjekë misionin e ngarkuar deri në përfundimin e tij. Ai nuk mund të abstenojë ose të heqë dorë nga gjykimi i mosmarrëveshjes, përveçse për motive të parashikuara nga neni 408 i këtij Kodi. Në një rast të tillë zëvendësimi i tij bëhet sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod.

Neni 424

Hartimi i akteve procedurale

Aktet dhe procesverbalet që kryhen gjatë procedurës së arbitrazhit, hartohen bashkërisht nga të gjithë arbitrat, përveç kur në marrëveshjen e arbitrazhit palët kanë pranuar që këto veprime të kryhen nga njëri prej tyre.

Neni 425

Marrja fund e gjykimit të arbitrazhit

Në rast se palët nuk kanë parashikuar ndryshe në marrëveshje, një gjykim arbitrazhi merr fund kur:

- a) arbitri revokohet, vdes, i dalin pengesa në plotësimin e misionit të ngarkuar ose i ka humbur plotësisht të gjitha të drejtat civile;
- b) me abstenimin ose heqjen dorë nga misioni i arbitrit, kur është rasti i parashikuar nga neni 423 i këtij Kodi;
- c) me mbarimin përfundimisht të afatit të arbitrazhit.

Neni 426

Mbyllja e hetimit gjyqësor

Pasi të jenë marrë provat e nevojshme dhe të jetë mbyllur hetimi gjyqësor, arbitri cakton datën në të cilën do të diskutohet mosmarrëveshja dhe do të merret vendimi përkatës. Pas kësaj date nuk mund të paraqiten prova e të parashtrihen kërkesa, përveç kur gjykata e arbitrazhit vlerëson ndryshe.

Neni 427

Ligji i zbatueshëm

(Ndryshuar me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001)

Gjykata e arbitrazhit zbaton legjislacionin shqiptar.

KREU IV VENDIMI I GJYKATËS SË ARBITRAZHIT

Neni 428

Dhënia e vendimit përfundimtar

Diskutimet për dhënien e vendimit zhvillohen nga gjykata e arbitrazhit pa praninë e palëve e të personave të tjerë.

Vendimi i gjykatës së arbitrazhit jepet me shumicë votash. Ai nënshkruhet nga të gjithë arbitrat. Arbitrat që kanë mendim të kundërt me shumicën, kanë të drejtë t'i parashirojnë me shkrim mendimet e tyre. Vendimi i nënshkruar nga shumica e arbitrave ka të njëjtin efekt sikur të jetë nënshkruar nga të gjithë arbitrat.

Përmbajtja e vendimit përfundimtar

Vendimi i gjykatës së arbitrazhit duhet të përmbajë përbërjen e trupit gjykues të arbitrave, datën dhe vendin e dhënies së tij, identitetin e palëve, vendbanimin, vendqëndrimin ose qendrën e tyre, emrin e mbiemrin e avokatit ose të përfaqësuesit të palëve dhe objektin e mosmarrëveshjes. Vendimi i gjykatës së arbitrazhit duhet të arsyetojë zgjidhjet e pranuar dhe të shprehet qartë për pretendimet e palëve.

Korrigjimi i gabimeve të vendimit përfundimtar dhe interpretimi i tij

Gjykata e arbitrazhit ka kompetencë të interpretojë vendimin e saj, të korrigjojë gabimet materiale dhe ta plotësojë atë për kërkesat e paditësit për të cilat nuk është shprehur, por që nuk janë kryesore. Kur gjykata e arbitrazhit nuk mund të mblidhet përsëri me të njëjtën përbërje, çështjet që përmenden në këtë nen zgjidhen nga gjykata që do të ishte kompetente në mungesë të marrëveshjes së arbitrazhit.

Urdhri i ekzekutimit të vendimit të gjykatës së arbitrazhit

Vendimi i gjykatës së arbitrazhit është i formës së prerë në lidhje me mosmarrëveshjen e shqyrtuar, sapo shpallet, përveç rasteve të parashikuara nga neni 434 i këtij Kodi.

Ai bëhet i ekzekutueshëm forcërisht në bazë të një urdhri ekzekutimi të lëshuar nga gjykata e shkallës së parë të vendit ku është dhënë vendimi. Për një qëllim të tillë, në sekretarinë e gjykatës depozitohet origjinali i vendimit me një kopje të marrëveshjes së arbitrazhit, nga një prej arbitrave ose nga pala e interesuar.

Kundër vendimit të gjykatës që lëshon urdhër ekzekutimin nuk lejohet ankimi.

(Ndryshuar fjalë në paragrafin e tretë me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Urdhrit të ekzekutimit i bashkëngjitet origjinali i vendimit të arbitrazhit.

Vendimi i gjykatës së shkallës së parë që refuzon lëshimin e urdhër ekzekutimit duhet të jetë i arsyetuar.

Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në gjykatën e apelit brenda 10 ditëve duke filluar nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.

KREU V ANKIMI KUNDËR VENDIMIT TË GJYKATËS SË ARBITRAZHIT

Rastet kur lejohet ankimi

Ndonëse palët në marrëveshje kanë parashikuar heqjen dorë nga ankimi, vendimi i gjykatës së arbitrazhit mund të ankohet në gjykatën e apelit vetëm kur:

- a) gjykata e arbitrazhit është formuar në mënyrë të parregullt;
- b) gjykata e arbitrazhit pa të drejtë ka deklaruar kompetencën apo moskompetencën e saj për gjykimin e mosmarrëveshjes;
- c) gjykata e arbitrazhit në vendimin e saj ka tejkalluar kërkesat për të cilat ka qenë investuar ose nuk është shprehur mbi një nga kërkesat kryesore të padisë;

- c) nuk është respektuar barazia e palëve dhe e drejta e tyre për t'u dëgjuar në një procedurë të mbështetur në parimin e kontradiktoritetit;
- d) vendimi i gjykatës së arbitrazhit vjen në kundërshtim me rendin publik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 435
Afati i ankimit

Ankimi në gjykatën e apelit bëhet brenda 30 ditëve nga dita që është shpallur vendimi. Mungesa e palëve në shpalljen e vendimit nuk e ngarkon gjykatën me detyrimin për njoftimin e vendimit.

Neni 436
Shqyrtimi nga gjykata e apelit

Gjykata e apelit shqyrton ankimin sipas rregullave të caktuara në këtë Kod. Kur gjykata e apelit prish ose ndryshon vendimin e gjykatës së arbitrazhit, ajo vendos për themelin e mosmarrëveshjes në kufijtë e misionit të caktuar gjykatës së arbitrazhit.

Neni 437
Moslejimi i rekursit në Gjykatën e Lartë

Kundër vendimit të gjykatës së apelit nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë.

Neni 438
Vënia në ekzekutim e vendimit

Vendimi i gjykatës së arbitrazhit mund të vihet në ekzekutim kur:

- a) palët në marrëveshjen e arbitrazhit kanë hequr dorë nga ankimi kundër vendimit të dhënë nga gjykata e arbitrazhit, në kushtet e parashikuara nga neni 434 i këtij Kodi;
- b) palët nuk kanë bërë ankim brenda afatit të parashikuar në nenin 435 të këtij Kodi, në kushtet e parashikuara nga neni 434 i këtij Kodi;
- c) gjykata e apelit ka rrëzuar kërkesën ankimore ose ka prishur ose ndryshuar vendimin e gjykatës së arbitrazhit, duke shqyrtuar çështjen në themel.

KREU VI
ARBITRAZHI NDËRKOMBËTAR

Neni 439
Formimi i gjykatës së arbitrazhit ndërkombëtar
(*Ndryshuar me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001*)

Arbitrazhi ndërkombëtar rregullohet me ligj të veçantë.

Neni 440
Përcaktimi i procedurës së arbitrazhit
(*Shfuqizuar me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001*)

Neni 441
Ligji i zbatueshëm
(*Shfuqizuar me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001*)

PJESA E TRETË

ANKIMET DHE MËNYRA E GJYKIMIT TË TYRE
(*Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001*)

TITULLI I
ANKIMET DHE PARAQITJA E TYRE
(Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

KREU I
MJETET DHE AFATET E ANKIMIT
(Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Neni 442
Mjetet e ankimit

Mjetet për t'u ankuar ndaj vendimeve të gjykatave janë: ankimi në gjykatën e apelit, rekursi në Gjykatën e Lartë, kërkesa për rishikim.

Neni 442/a
Ankimi
(Shtuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Ankimi është akti me të cilin palët ose pjesëmarrësit e tjerë në proces parashtrojnë kundërshtimet e tyre ndaj vendimit të gjykatës dhe veprimeve të përmbauesit gjyqësor, për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre.

Neni 442/b
Rekursi
(Shtuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Rekursi është akti me të cilin palët ose pjesëmarrësit e tjerë në proces parashtrojnë kundërshtimet e tyre ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë ose të gjykatës së apelit në Gjykatën e Lartë, sipas rregullave të përcaktuara në këtë Kod.

Neni 443
Afati i ankimit
(Shtuar një paragraf me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001, shtuar fjalë në paragrafin e katërt me ligjin nr. 44/2021, datë 23.3.2021)

Afati i ankimit në gjykatën e apelit, kundër vendimeve përfundimtare të gjykatës së shkallës së parë, është 15 ditë.

Afati për të bërë recurs në Gjykatën e Lartë, kundër vendimeve të gjykatës së apelit, është 30 ditë.

Afati për të kërkuar rishikimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe kundërshtimin e të tretit është 30 ditë.

Afati i ankimeve dhe rekurseve të veçanta është 5 ditë.

Neni 444
Fillimi i afateve të ankimit
(Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001 dhe nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Afatet e caktuara në nenin 443 janë të prera dhe fillojnë nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Neni 445
Prekluziviteti i ankimit
(Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001; ndryshuar fjalia e parë me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013)

Ankimi në gjykatën e apelit dhe rekursi në Gjykatën e Lartë nuk mund të bëhen pasi ka kaluar një vit nga shpallja e vendimit. Kjo dispozitë nuk zbatohet kur pala në mungesë vërteton se nuk ka qenë në dijeni të procesit gjyqësor për shkak të pavlefshmërisë së njoftimeve.

Neni 446
Gjykata ku paraqitet ankimi

Ankimi paraqitet në gjykatën që ka dhënë vendimin, ndaj të cilit ushtrohet.

Neni 447

Njoftimi i ankimit

(Zëvendësuar fjalë me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013)

Ankimi u njoftohet palëve sipas rregullave të parashikuara në kreun IV të titullit VI të pjesës I të këtij Kodi, për njoftimet e thirrjet në gjykatë.

Neni 448

Bashkimi i ankimeve

(Shtuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Të gjitha ankimet e bëra veçmas kundër të njëjtit vendim bashkohen në një proces të vetëm. Kjo dispozitë nuk zbatohet kur ankimet janë të llojeve të ndryshme.

Neni 449

Pezullimi i ekzekutimit

Ekzekutimi i vendimit të ankimuar pezullohet deri në përfundim të shqyrtimit në gjykatën e apelit, përveç kur me ligj parashikohet ndryshe. Në rastet e rekursit në Gjykatën e Lartë vendimi mund të pezullohet në Gjykatën e Lartë.

Neni 450

Mospranimi i ankimit

(Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001 dhe nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjyqtari i vetëm i gjykatës që ka dhënë vendimin, në dhomë këshillimi, menjëherë pas paraqitjes së ankimit, vendos mospranimin e ankimit kur:

- a) është paraqitur jashtë afatit;
 - b) nuk ndreqen të metat në afatin e caktuar sipas nenit 455 të këtij Kodi;
 - c) është bërë kundër një vendimi ndaj të cilit nuk lejohet ankim;
 - ç) është bërë nga një person që nuk legjitimohet të bëjë ankim;
 - d) është hequr dorë nga ankimi.
2. Kundër vendimit të mospranimit të ankimit mundet të bëhet ankim i veçantë.
3. Mospranimi i ankimit mund të deklarohet në çdo shkallë gjykimi.

Neni 450/a

(Shtuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Gjykata, kur pranon kërkesën, i komunikon kopjen e saj palës tjetër, ndërsa aktet e çështjes bashkë me ankimin, ia dërgon gjykatës së apelit të nesërmen e mbarimit të afatit të ankimit për të gjitha palët ose edhe përpara mbarimit të këtij afati, kur nga të gjitha palët janë paraqitur ankimet.

Neni 451

Vendimi i formës së prerë

Vendimi i gjykatës merr formë të prerë kur:

- a) nuk mund të bëhet ankim kundër tij;
- b) nuk është bërë ankim kundër tij brenda afateve të caktuara nga ligji ose kur ankesa është tërhequr;
- c) ankesa e paraqitur nuk është pranuar;
- ç) vendimi i gjykatës është lënë në fuqi, ndryshuar ose është pushuar gjykimi në shkallë të dytë.

Neni 451/a

(Shtuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera.

Vendimi që ka marrë formë të prerë ka fuqi vetëm për çka është vendosur midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak. Një konflikt që është zgjidhur me vendim të formës së prerë nuk mund të gjykohej përsëri, përveç kur ligji parashikon ndryshe.

KREU II
PARAQITJA E ANKIMIT DHE GJYKIMI NË APEL
(Shtuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Neni 452

Vendimet që mund të ankimohen

Mund të ankimohen në gjykatën e apelit të gjitha vendimet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë, me përjashtim të rasteve kur ankimi përjashtohet me ligj.

Neni 453

Nënshkrimi i ankimit

Ankimi që i drejtohet gjykatës së apelit duhet të nënshkruhet nga vetë pala, avokati ose përfaqësuesi i pajisur me prokurë.

Neni 454

Përmbajtja e ankimit

Në ankim duhet të tregohen:

- a) palët ndërgjyqëse;
- b) vendimi kundër të cilit bëhet ankimi;
- c) shkaqet për të cilat bëhet ankimi;
- ç) çfarë kërkohet me ankimin.

Neni 455

Dokumentet që i bashkëngjiten ankimit

(Ndryshuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Bashkë me ankimin duhet të paraqiten:

- a) kopje të ankimit dhe të dokumenteve të tjera, aq sa janë personat që marrin pjesë në çështje si palë;
- b) prokura kur ankimi paraqitet nga avokati ose përfaqësuesi i palës.

Në rast se ankimi nuk plotëson kushtet e mësipërme, si dhe ato të neneve 453 dhe 454 të këtij Kodi, gjykata njofton palën që të ndreqë të metat brenda 5 ditëve, në të kundërt ankimi kthehet.

Neni 456

Apeli kundërshtues

Pala që nuk ka bërë ankim apo pala kundër së cilës është bërë ankim, mund ta kundërshtojë atë me kundërankim brenda 5 ditëve nga dita që ka marrë njoftim për ankimin e palës tjetër.

Ankimi kundërshtues duhet t'u njoftohet palëve të tjera në gjykim, sipas rregullave për njoftimin e ankimit.

Neni 457

Ndërhyrja në ankim

(Shfuqizuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Neni 458

Rivendosja në afatin e ankimit
(Hequr fjalë me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Kur palët kanë humbur të drejtën e ankimit për shkaqe të arsyeshme, mund të paraqesin kërkesë për rivendosje në afat, përpara gjykatës që ka dhënë vendimin. Kjo kërkesë shqyrtohet nga gjykata dhe kundër vendimit të tij mund të bëhet ankim i veçantë.

Neni 459

Rënia në dekadencë e kërkimeve
(Ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur kërkimet dhe pretendimet e papranuara nga gjykata e shkallës së parë nuk përsëriten në ankim, konsiderohet sikur është hequr dorë prej tyre.
2. Në ankim nuk mund të parashtrihen kërtime të reja që nuk janë parashtruar në gjykimin në shkallë të parë.

Neni 460

Shqyrtimi i çështjes në apel

(Ndryshuar me ligjin nr. 8431, datë 14.12.1998, nr. 8812, datë 17.5.2001 dhe nr. 38/2017, datë 30.3.2017, me ligjin nr. 44/2021, datë 23.3.2021, shtuar fjalë në fjalinë e parë të pikës 5, shtuar një fjalë në pikën 5 dhe shtuar pika 5/1 me ligjin nr. 44/2021, datë 23.3.2021)

1. Relatori i çështjes në gjykatën e apelit caktohet me short.
2. Relatori cakton datën dhe orën e gjykimit në përputhje me kalendarin e shqyrtimit të çështjeve, duke marrë për bazë radhën, sipas kohës së ardhjes së dosjes në gjykatën e apelit.
3. Palët mund t'i kërkojnë me shkrim relatorit përshejtimin e shqyrtimit të çështjes për shkaqe veçanërisht të rënda dhe të motivuara, kur kjo nuk vjen në kundërshtim me ligjin.
4. Këshilli i Lartë Gjyqësor përcakton rregulla të hollësishme për zbatimin e këtij neni.
5. Njoftimi për ditën dhe orën e gjykimit, si dhe përbërjen e trupit gjykues që shqyrton çështjen bëhet nga gjykata e apelit me shpallje në ambientet e saj dhe në gjykatën përkatëse të shkallës së parë. Ky njoftim bëhet gjithashtu në faqen e internetit të gjykatës së apelit, si dhe, nëse ka, edhe në faqen e internetit të gjykatës përkatëse të shkallës së parë, dhe, me njoftim individual në rastin kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit në shkallën e parë të gjykimit. Shpallja ose njoftimi bëhet të paktën 15 ditë para datës së gjykimit. Në rast se përbërja e trupit gjykues nuk është njoftuar sipas rregullave të përcaktuara në këtë pikë, palët mund të kërkojnë shtyrjen e gjykimit, përveç rasteve kur marrin pjesë në gjykim dhe nuk kërkojnë përjashtimin e gjyqtarëve.
- 5/1. Palët kanë të drejtë që deri në 5 ditë para shqyrtimit të çështjes të paraqesin parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankim.
6. Për çështjet me rigjykim, ose kur është deklaruar riçelja e hetimit gjyqësor, ose kur çmohet të bëhet një gjykim përpara afatit 15-ditor, njoftimi u bëhet drejtpërdrejt palëve, përfaqësuesve të tyre ose prokurorit, sipas rregullave të pjesës I, titulli VI, kreu IV, "Njoftime", të këtij Kodi.

Neni 461

(Shtuar paragrafi i dytë dhe i tretë me ligjin nr. 8431, datë 14.12.1998)

Fillimisht gjykata verifikon paraqitjen e rregullt të palëve, bën bashkimin e ankimeve të bëra kundër të njëjtit vendim dhe bën përpjekje për zgjidhjen e çështjes me pajtim.

Mosparaqitja e palëve, për të cilat njoftimi është bërë me shpallje, nuk pengon shqyrtimin e çështjes, me përjashtim të rastit kur janë njoftuar shkaqe të arsyeshme për mungesën.

Gjykata nuk mund të shqyrtojë çështjen në mungesë atëherë kur dëgjimi i palëve është një nga detyrat e rigjykimit ose kur njoftimi ka qenë i parregullt.

Neni 462

Pjesëmarrja e prokurorit

(Shfuqizuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Neni 463

Heqja dorë nga ankimi

Në çdo fazë të gjykimit të çështjes në apel, ankuesi ose përfaqësuesi i tij mund të heqë dorë nga ankimi. Në këtë rast vendoset pushimi i shqyrtimit të çështjes në gjykatën e apelit.

Neni 464

Seanca gjyqësore

(Ndryshuar fjalë me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Seanca gjyqësore fillon me relacionin e njërit prej anëtarëve të trupit gjykues. Pas kësaj palët, në rast se janë paraqitur, japin shpjegime. Së pari e merr fjalën pala që ka bërë ankimin, pastaj pjesëmarrësit e tjerë në gjykim. Kur ky ka paraqitur mendimin me shkrim, lexohet nga një anëtar i trupit gjykues. Kur prokurori, mbi bazën e padisë së paraqitur prej tij, bën ankim ndaj vendimit të gjykatës, ai e merr fjalën i pari.

Neni 465

Kufijtë e shqyrtimit të çështjes në apel

(Ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjykata e apelit shqyrtton çështjen brenda kufijve të ankimit.
2. Në shqyrtimin e çështjes në apel mbahen parasysh, për aq sa janë të zbatueshme, dispozitat mbi procedurën e gjykimit në shkallë të parë.
3. Me kërkesë të palëve ose kryesisht, gjykata e apelit riçel pjesërisht ose tërësisht hetimin gjyqësor.
4. Në gjykimin në apel nuk mund të paraqiten kërkime të reja, të shtohen apo të ndryshohen elementët e padisë, me përjashtim të kërimit për shpenzimet e gjykimit në apel.
5. Gjykata e apelit mund të pranojë për shqyrtim fakte dhe prova të reja, nëse:
 - a) pala e interesuar provon se, pa fajin e saj, gjatë shqyrtimit të çështjes para gjykatës së shkallës së parë nuk ishte në gjendje të paraqiste këto fakte dhe/ose prova të reja;
 - b) pala e interesuar i ka kërkuar, por gjykata e shkallës së parë, në kundërshtim me ligjin, nuk i ka marrë këto fakte dhe/ose prova, të cilat kanë rëndësi për çështjen;
 - c) pala e interesuar provon se nuk mund të ishte në dijeni të fakteve dhe/ose provave të reja gjatë gjykimit në shkallën e parë.
6. Kjo dispozitë nuk zbatohet për marrjen e pohimit gjyqësor ose jashtëgjyqësor.

Neni 465/a

Gjykimi në apel në dhomë këshillimi

(Ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017, ndryshuar fjalë në pikën 2 dhe ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 44/2021, datë 23.3.2021)

1. Në rastet kur në Kod parashikohet gjykimi në apel në dhomë këshillimi, gjykimi bëhet mbi bazë aktesh dhe/ose dokumentesh.
2. Relatori përgatit relacionin e përmbledhur dhe cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, duke urdhëruar njoftimin e palëve, sipas nenit 460, të këtij Kodi, për përbërjen e trupit gjykues, datën, orën dhe vendin e shqyrtimit të çështjes. Palët kanë të drejtë që deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, në dhomë këshillimi, të paraqesin parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankim.
3. Gjykata në dhomë këshillimi vendos kalimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm:
 - a) për të vlerësuar nëse duhen marrë apo pranuar fakte ose prova të reja, sipas nenit 465 të këtij Kodi; ose
 - b) kur vë në diskutim çështje të faktit ose të ligjit, për të cilat palët nuk kanë paraqitur më parë mendimin e tyre.
4. Për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi mbahet procesverbal nga sekretari gjyqësor.

Neni 466

Vendimi i gjykatës së apelit

(Shtuar një paragraf pas paragrafit të parë me ligjin nr. 44/2021, datë 23.3.2021)

Gjykata e apelit pasi shqyrton çështjen vendos:

- a) lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë;
- b) ndryshimin e vendimit;
- c) prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes;
- ç) prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë në rastet e parashikuara nga neni 467 i këtij Kodi.

Kundër vendimit të gjykatës së apelit për prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pushimin e çështjes lejohet rekurs i veçantë.

Neni 466/1

(Shtuar me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013 dhe shtuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Neni 467

Dërgimi për rigjykim

*(Ndryshuar me ligjin nr. 8431, datë 14.12.1998; nr. 8812, datë 17.5.2001
nr. 122/2013, datë 18.4.2013; ndryshuar paragrafi i parë dhe i katërt me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017,
shtuar një paragraf pas paragrafit të parë me ligjin nr. 44/2021, datë 23.3.2021)*

Gjykata e apelit prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë, tërësisht ose pjesërisht, sipas kufijve të nenit 121, të këtij Kodi, dhe e dërgon çështjen për rigjykim kur:

- a) gjykata e shkallës së parë ka shkëlur dispozitat mbi juridiksionin dhe kompetencën;
- b) përbërja e trupit gjykues nuk ka qenë e rregullt ose vendimi nuk është nënshkruar nga anëtarët e tij, ose është cenuar parimi i paanësisë;
- c) gjykata e shkallës së parë ka vendosur pushimin e çështjes në kundërshtim me rregullat e përcaktuara nga ky Kod;
- ç) çështja është gjykuar në mungesë të pjesëmarrësve në proces, pa pasur dijeni për gjykimin;
- d) nuk është formuar drejt bashkëndërgjyqësia, sipas nenit 162, paragrafi i dytë, i këtij Kodi;
- dh) kur mungojnë ose janë të pavlefshme padia, procesverbali gjyqësor, ankimi, si dhe çdo dokument tjetër që ka ndikuar në dhënien e vendimit;
- e) gjykata e shkallës së parë nuk e ka kryer shqyrtimin gjyqësor të të gjitha kërtimeve lidhur me objektin e mosmarrëveshjeve.

Kundër vendimit të gjykatës së apelit për prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, tërësisht ose pjesërisht, dhe dërgimin e çështjes për rigjykim, lejohet rekurs i veçantë.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim është e detyruar t'i përmbahet vendimit të gjykatës së apelit për çdo veprim procedural të vendosur në të.

Me vendim të ndërmjetëm, gjykata mund të mos kryejë veprime të caktuara kur për rrethana të reja të dala në rigjykim, shihen të panevojshme. Ndaj këtij vendimi mund të bëhet ankimi i veçantë.

Në rigjykim nuk mund të ngrihen pavlefshmëritë e vërtetuara në gjykimet e mëparshme, kur vendimet përkatëse nuk janë prishur për to. Në rigjykim gjykata i merr të mirëqena provat e administruara rregullisht në gjykimet e mëparshme, përveç kur vendimi është prishur për shkaqet e parashikuara në shkronjat "a", "b", "ç", "d" të këtij neni. Në këto raste, gjykata administron sërish provat kur kjo është lënë detyrë nga gjykata më e lartë ose merr prova të reja, kur një gjë e tillë është e domosdoshme për të garantuar zhvillimin e një hetimi të plotë e të gjithanshëm. Në rigjykim nuk mund të bëhen pretendime të ndryshme nga ato që janë pranuar në vendimin e gjykatës së apelit, përveç nevojës për realizimin e detyrave të vëna nga ajo gjykatë.

Neni 467/a

(Shtuar me ligjin nr. 8431, datë 14.12.1998)

Gjykata e apelit kur prish vendimin nuk mund ta kthejë çështjen për rigjykim për të dytën herë por e shqyrton vetë si gjykatë e shkallës së parë.

Kur vendimi priset për shkak të moszbatimit të detyrave të caktuara nga gjykata më e lartë, pa u marrë vendim i veçantë sipas nenit 467 të këtij Kodi, gjykata e apelit, me kërkesë të palëve ngarkon trupin gjykues përkatës me shpenzimet e bëra për këtë shkak.

Neni 467/b

(Shtuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001 dhe shtuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Kur gjykata për çështjen që nuk ishte në kompetencën e saj ka dhënë një vendim të drejtë dhe, nga ana tjetër, nuk janë kapërcyer kompetencat e gjykatës së cilës i takonte çështja, gjykata e apelit ka të drejtë të mos e prishë vendimin, por të mjaftohet t'i verë në dukje gjykatës përkatëse parregullsinë e vendimit të saj.

Kur gjykata e apelit konstaton se janë kushtet e plotësimit të vendimit, të parashikuara në nenin 313, të këtij Kodi, vendos vetë për plotësimin e tij, duke ia vënë në dukje parregullsinë gjykatës së shkallës së parë.

Neni 468

(Hequr titulli dhe shtuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001 dhe shfuqizuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Neni 469

Pezullimi i ekzekutimit

(shfuqizuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 44/2021, datë 23.3.2021)

Kur priset vendimi i shkallës së parë dhe çështja dërgohet për rigjykim, pezullohet ekzekutimi i vendimit.

Neni 470

Ankimi kundër vendimeve të ndërmjetme

(Ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017, shtuar fjalë në pikën 2 dhe 3 me ligjin nr. 44/2021, datë 23.3.2021)

1. Vendimet e ndërmjetme që jepen nga gjykata e shkallës së parë mund të ndryshohen ose të tërhiqen gjatë gjykimit. Këto vendime mund të goditen me ankim së bashku me vendimin përfundimtar.

2. Megjithatë, në rastet e parashikuara shprehimisht në këtë Kod, kundër vendimeve të ndërmjetme mund të bëhet ankimi i veçantë në gjykatën e apelit ose rekurs i veçantë në Gjykatën e Lartë, brenda 5 ditëve nga njoftimi i tyre.

3. Ankimet ose rekursat e veçanta kundër vendimeve të ndërmjetme shqyrtohen në dhomë këshillimi brenda 30 ditëve nga dita e regjistrimit të tyre në gjykatën më të lartë.

Neni 471

Pezullimi i ekzekutimit të vendimit të ndërmjetëm

Paraqitja e ankimit kundër vendimit të ndërmjetëm nuk pezullon gjykimin dhe as ekzekutimin e vendimit, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Kod apo kur gjykata e apelit vendos pezullimin gjersa të japë vendimin për ankimin e veçantë.

Neni 471/a

Shqyrtimi i ankimeve kundër vendimeve jopërfundimtare

(shtuar me ligjin nr. 44/2021, datë 23.3.2021)

Ankimet dhe rekursat e veçanta kundër vendimeve jopërfundimtare shqyrtohen në dhomë këshillimi brenda 30 ditëve nga dita e regjistrimit të tyre në gjykatën më të lartë.

TITULLI II REKURSI NË GJYKATËN E LARTË

KREU I

PROCEDURAT E REKURSIT

Neni 472

Shkaqet për rekurs

(Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001; shfuqizuar shkronja "c" me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013 dhe ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Vendimet e shpallura nga gjykata e apelit dhe ato të shkallës së parë në rastet që parashikohen në këtë Kod mund të ankimohen me rekurs në Gjykatën e Lartë:

a) për zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural, të një rëndësie themelore për njehsimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore;

b) kur vendimi i ankimuar është i ndryshëm nga praktika gjyqësore e Kolegjit Civil ose praktika e njehsuar e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;

c) ka shkelje të rënda të normave procedurale, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit ose të procedurës së gjykimit, sipas nenit 467 të këtij Kodi.

2. Nuk lejohet rekurs kundër vendimeve të gjykatës së apelit për paditë me vlerë deri në 150 000 lekë.

Neni 473

(Shfuqizuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Neni 473/a

Kufijtë e shqyrtimit të rekursit

(Shtuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017, shtuar një paragraf me ligjin nr. 44/2021, datë 23.3.2021)

Gjykata e Lartë shqyrton rekursin brenda kufijve të tij, përveç kur ligji parashikon ndryshe.

Në rastet kur Gjykata e Lartë vë në diskutim çështje të ligjit, të cilat merren në shqyrtim kryesisht dhe për të cilat palët nuk kanë paraqitur më parë mendimin e tyre, përpara shqyrtimit urdhërohet njoftimi i palëve dhe caktohet afati për depozitimin e parashtrësive të tyre për çështjet e ligjit. Njoftimi në këto raste kryhet sipas rregullave të përgjithshme.

Neni 474

Nënshkrimi i rekursit

(Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001 dhe me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017 dhe nr. 44/2021, datë 23.3.2021)

Rekursi dhe të gjitha kërkesat e tjera që paraqiten në Gjykatën e Lartë nënshkruhen nga avokati që e përfaqëson palën dhe, nëse pala e kërkon, edhe nga kjo e fundit.

Neni 475

Përmbajtja e rekursit

(ndryshuar shkronja "ç" e paragrafit të parë dhe shtuar një paragraf me ligjin nr. 44/2021, datë 23.3.2021)

Rekursi duhet të përmbajë:

a) palët ndërgjyqëse;

b) vendimin që kundërshtohet;

c) paraqitjen e përmbledhur të fakteve të çështjes;

ç) shkaqet për të cilat kundërshtohet vendimi, si dhe argumentet që mbështesin pretendimin se ekzistojnë shkaqe për rekurs sipas parashikimeve të nenit 472 të këtij Kodi;

d) prokurën nëse rekursi është bërë nga avokati ose nga përfaqësuesi i ankuesit.

Rekursi mund të paraqitet sipas formatit të miratuar nga Këshilli i Gjykatës së Lartë.

Neni 476

Depozitimi i rekursit

(Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001 dhe nr. 44/2021, datë 23.3.2021)

1. Rekursi depozitohet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin në afatin prej 30 ditësh nga dita e njoftimit që u është bërë palëve.
2. Së bashku me rekursin duhet të depozitohet:
 - a) kopja e vërtetuar e vendimit të kundërshtuar dhe, kur është rasti, edhe e njoftimit kur ky është bërë;
 - b) prokura e posaçme;
 - c) aktet dhe dokumentet mbi të cilat është bazuar rekursi në atë qasje sa janë palët.
3. Kur rekursi nuk plotëson kushtet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, nuk është nënshkruar sipas nenit 474 ose nuk është paraqitur në përputhje me paragrafin e parë të nenit 475 të këtij Kodi, relatori që ka dhënë vendimin ose gjyqtari i vetëm njofton palën për të plotësuar të metat e rekursit brenda 5 ditëve. Në këtë rast shqyrtimi i rekursit bëhet në dhomë këshillimi.
4. Kur ankuesi nuk plotëson ose korrigjon të metat brenda afatit, rekursi quhet se nuk është paraqitur dhe i kthehet palës së bashku me aktet e tjera të paraqitura prej tij. Kundër vendimit të gjyqtarit për kthimin e rekursit mund të bëhet rekurs i veçantë.
5. Kur të metat e rekursit janë plotësuar në afatin e caktuar, konsiderohet i regjistruar në datën e depozitimit në gjykatë.
6. Sekretaria e gjykatës që ka dhënë vendimin e kundërshtuar, pas shqyrtimit nga gjyqtari nëse rekursi është plotësuar në afat, përcjell dosjen së bashku me dokumentet në sekretarinë e Gjykatës së Lartë.
7. Kur të metat e rekursit nuk janë konstatuar nga gjykata më e ulët, relatori i çështjes në Gjykatën e Lartë me vendim njofton palën për të plotësuar të metat brenda 5 ditëve. Kur të metat e rekursit nuk plotësohen brenda afatit, relatori, në dhomë këshillimi, vendos kthimin e rekursit. Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim.

Neni 477

Kundërrekursi

Pala kundër së cilës është paraqitur rekursi, mund ta kundërshtojë atë me kundërrekurs, i cili duhet t'i njoftohet atij që ka bërë rekursin në vendbanimin e tij brenda 20 ditëve nga njoftimi i rekursit. Në mungesë të këtij njoftimi nuk mund të paraqesë kundërrekurs, por vetëm mund të marrë pjesë në diskutim me gojë.

Për kundërrekursin zbatohen rregullat e parashikuara në nenet 456 dhe 457 të këtij Kodi.

Neni 478

Paraqitja e dokumenteve të tjera

Nuk pranohet depozitimi i akteve dhe dokumenteve që nuk janë paraqitur në shkallën e mëparshme të gjykimit, përveç atyre që kanë të bëjnë me vendimin e ankimuar dhe pranimin e rekursit ose të kundërrekursit.

Depozitimi i dokumenteve si më sipër duhet t'i njoftohet palëve të tjera.

Neni 479

Pezullimi i ekzekutimit të vendimit

(Ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:
 - a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose
 - b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.
2. Kërkesa për pezullim parashtrohet në rekurs ose më vite. Gjykata e Lartë merr masat e nevojshme që kërkesa t'i njoftohet palës tjetër dhe kërkesa të gjykohet sa më shpejt. Pala ka të drejtë të parashtrrojë me shkrim brenda tre ditëve, nga e nesërmja e marrjes dijeni mbi kërkesën për pezullim, argumentet e saj dhe kërkimet.
3. Shqyrtimi i kërkesës bëhet në dhomë këshillimi.

4. Në kushtet kur rrethanat e çështjes e diktojnë dhe ekziston rreziku se e drejta e rekursuesit do të bëhet e pamundur për t'u realizuar, me vendim të arsyetuar, mund të procedohet me shqyrtimin e kërkesës pa u njoftuar më parë palët.

5. Vendimi i Gjykatës së Lartë mbi kërkesën për pezullim duhet t'u njoftohet palëve.

6. Vendimi i Gjykatës së Lartë mbi kërkesën për pezullim mund të revokohet ose ndryshohet me kërkesë të palës. Për shqyrtimin e kërkesës për ndryshimin ose revokimin e masës së pezullimit njoftohen palët. Brenda 3 ditëve pala tjetër ka të drejtë të paraqesë me shkrim parashtrimet. Kërkesat shqyrtohen në dhomë këshillimi.

7. Në çdo rast Gjykata e Lartë arsyeton vendimin e saj.

Neni 480

Mospranimi i rekursit

(Ndryshuar me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013)

Mospranimi i rekursit vendoset në dhomë këshillimi, në kolegji me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë, në rastet kur:

- a) bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji;
- b) nuk plotësohen kërkesat procedurale të parashikuara në këtë kre;
- c) pala që ka paraqitur rekurs heq dorë prej tij.

Pala kundër së cilës është paraqitur rekursi, mund të paraqesë kundërshtimet e saj sipas rregullave të parashikuara në nenin 477 të këtij Kodi.

Shqyrtimi bëhet brenda 60 ditëve nga depozitimi i rekursit, pa praninë e palëve, por pasi janë shqyrtuar pretendimet me shkrim të tyre për çështjen e pranueshmërisë.

I njëjti trup gjykues vendos për çdo kërkesë procedurale të palëve, me përjashtim të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit.

KREU II

PROCEDURAT E GJYKIMIT

Neni 481

Gjykimi për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore

(Ndryshuar me vendimin nr. 46/1999 të Gjykatës Kushtetuese; ndryshuar titulli dhe shfuqizuar paragrafi i parë me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001, ndryshuar me ligjin nr. 44/2021, datë 23.3.2021)

1. Kolegji Civil, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosë nisjen e procedurës së gjyqimit për të njësuar ose ndryshuar praktikën gjyqësore. Nisja e procedurës për ndryshimin e praktikës gjyqësore mund të vendoset edhe nga Kryetari i Gjykatës së Lartë.

2. Vendimi i ndërmjetëm i Kolegjit Civil ose i Kryetarit të Gjykatës së Lartë për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore përcakton çështjet e shtruara për njësim ose praktikën gjyqësore të njësuar që duhet ndryshuar. Vendimi publikohet menjëherë pas arsyetimit në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë.

3. Gjykimi për njësimin e praktikës gjyqësore bëhet nga Kolegji Civil me trup gjykues prej 5 gjyqtarësh, në të cilin marrin pjesë trupi gjykues që po gjykon rekursin dhe dy gjyqtarë të tjerë të Kolegjit, të caktuar me short.

4. Gjykimi për ndryshimin e praktikës gjyqësore të njësuar bëhet nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Kryetari i Gjykatës së Lartë, si kryesues i Kolegjeve të Bashkuara, cakton datën dhe orën e gjyqimit të çështjes për ndryshimin e praktikës gjyqësore. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë gjykojnë sipas rregullave të caktuara për kolegjin kur marrin pjesë jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të Gjykatës së Lartë.

5. Data dhe ora e seancës gjyqësore u njoftohen palëve nga sekretaria gjyqësore sipas rregullave të përgjithshme të njoftimit të paktën 15 ditë përpara datës së zhvillimit të seancës.

6. Kolegji Civil ose Kolegjet e Bashkuara, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosin ndryshimin e çështjeve të shtruara për njësim ose ndryshim të praktikës gjyqësore. Ky vendim i ndërmjetëm publikohet në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë.

7. Për shkak të interesit që paraqet njësimi ose ndryshimi i praktikës gjyqësore, në këto gjykime, kur është rasti, Gjykata e Lartë mund të kërkojë mendimin me shkrim nga Avokatura e Shtetit, si dhe nga persona juridikë publikë ose privatë, që çmohet se kanë njohuri të posaçme për çështjet ligjore të shtruara për njësim ose ndryshim të praktikës gjyqësore. Gjykata e Lartë, në kërkesën për paraqitjen e mendimit me shkrim, cakton një afat brenda të cilit mund të paraqitet mendimi, që në çdo rast nuk mund të jetë më i vogël se 14 ditë. Mendimet me shkrim nuk janë detyruese dhe publikohen në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë.

8. Vendimi i Kolegjit Civil dhe Kolegjeve të Bashkuara është i detyrueshëm për gjykatat në gjykimin e çështjeve të ngjashme.

Neni 482

Shqyrtimi i çështjes

(Ndryshuar me ligjet nr. 8812, datë 17.5.2001, nr. 122/2013, datë 18.4.2013; ndryshuar paragrafi i tretë me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017, ndryshuar me ligjin nr. 44/2021, datë 23.3.2021)

1. Shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi.

2. Gjyqtari relator i caktuar me short vendos datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi në përputhje me rregullat e planifikimit të gjykimin të parashikuara në ligj.

3. Sekretaria e Gjykatës së Lartë shpall listat e shqyrtimit të rekurseve të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit. Njoftimi për ditën, orën, si dhe përbërjen e trupit gjykues që shqyrton rekursin bëhet me shpallje në ambientet e Gjykatës së Lartë, si dhe në faqen e saj të internetit dhe me njoftim individual kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimin.

4. Palët mund t'i kërkojnë me shkrim relatorit përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes për shkaqe veçanërisht të rënda dhe të motivuara, kur kjo nuk vjen në kundërshtim me ligjin.

5. Gjyqtari relator paraqet relacionin duke pasqyruar në të, veç të tjerave, arsyet e përshpejtimin të çështjes, nëse ka, përmbajtjen e vendimit të ankimuar, pretendimet dhe shkaqet e ngritura në rekurs, prapësimet e paraqitura në kundërrekurs, shqyrtimin e fakteve që kanë rëndësi për marrjen e vendimit dhe propozimin e tij për zgjidhjen ligjore të çështjes.

6. Për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi mbahet procesverbal nga sekretari gjyqësor.

Neni 482/a

Kalimi i çështjes në seancë gjyqësore

(shtuar me ligjin nr. 44/2021, datë 23.3.2021)

1. Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve në rast se:

- a) çështja paraqet rëndësi nga pikëpamja e së drejtës për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore;
- b) vlerësohet e nevojshme nga Kolegji Civil thirrja dhe dëgjimi i palëve për shkak të problematikës ose kompleksitetit të çështjes, sipas shkronjave “b” dhe “c” të nenit 472, si dhe paragrafit të dytë të nenit 473/a të këtij Kodi.

2. Vendimi i mësipërm, si dhe data dhe ora e seancës gjyqësore u njoftohen palëve nga sekretaria gjyqësore sipas rregullave të përgjithshme të njoftimit të paktën 15 ditë para datës së zhvillimit të seancës.

Neni 483

Shqyrtimi gjyqësor

(Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Në seancë gjyqësore relatori paraqet faktet që kanë rëndësi për marrjen e vendimit, përmbajtjen e vendimit të ankimuar dhe shkaqet e rekursit dhe të kundërrekursit.

Pas relatimit kryetari fton avokatët e palëve të paraqesin mbrojtjen e tyre.

Shfuqizuar.

Nuk lejohet replika, por avokatët e palëve mund që në të njëjtën seancë t'i paraqesin gjykatës mendimet e tyre, shkurtimisht, me shkrim.

Procesverbali i seancës gjyqësore mbahet nga sekretari gjyqësor.

Neni 483/a
Procedimet paragjykimore
(shtuar me ligjin nr. 44/2021, datë 23.3.2021)

1. Nëse Kolegji Civil ose Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, gjatë shqyrtimit të çështjes, në dhomë këshillimi ose në seancë gjyqësore, vendosin t'i drejtohen Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ose gjykatave të tjera ndërkombëtare sipas detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, ata marrin vendim për pezullimin e shqyrtimit të çështjes.

2. Vendimi i pezullimit zgjat deri në dhënien e vendimit nga gjykata ndërkombëtare. Palëve u njoftohet vendimi i gjykatës ndërkombëtare së bashku me datën e seancës së radhës në Gjykatën e Lartë.

Neni 484
Marrja e vendimit
(Ndryshuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Gjykata pas diskutimit të çështjes tërhiqet në dhomën e këshillimit dhe merr vendimin përkatës. Në raste të veçanta, për shkak të natyrës së ndërlikuar apo rëndësisë së çështjes, marrja e vendimit mund të shtyhet për aq ditë sa është e nevojshme.

Vendimi nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues.

Neni 485
Vendimet e Gjykatës së Lartë
(Ndryshuar me ligjet: nr. 8431, datë 14.12.1998, nr. 8812, datë 17.5.2001, nr. 38/2017, datë 30.3.2017 dhe nr. 44/2021, datë 23.3.2021)

1. Pas shqyrtimit të çështjes, Kolegji Civil ose Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vendosin:

a) mospranimin e rekursit në rastet kur është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikon neni 472 i këtij Kodi;

b) prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë;

c) prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues;

ç) prishjen e vendimeve të gjykatës së apelit dhe të gjykatës së shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë kur vendimi jopërfundimtar i gjykatës së shkallës së parë është marrë në kundërshtim me ligjin dhe kjo shkelje nuk është konstatuar nga gjykata e apelit;

d) prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit dhe pushimin e gjykimit të çështjes;

dh) ndryshimin e vendimit të shkallës së parë dhe të vendimit të gjykatës së apelit dhe zgjidhjen përfundimisht të çështjes kur zbatimi i ligjit procedural apo material nuk diktohet nga nevoja për rishqyrtimin dhe rivlerësimin e fakteve apo të provave të çështjes;

e) lënien në fuqi të vendimit të apelit.

2. Në rastet kur Kolegji Civil ose Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vendosin njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, në vendim gjykata formulon edhe rregullin e së drejtës për çdo çështje të shtruar për zgjidhje në vendimin e ndërmjetëm të marrë gjatë gjykimit të çështjes. Në këtë rast vendimi botohet në Fletoren Zyrtare.

Neni 485/a
Pasojat kur prishet vendimi i padrejtë, i cili është ekzekutuar tërësisht ose pjesërisht
(Shtuar me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008)

Kur vendimi i ri, që jepet pas prishjes, është i ndryshëm nga vendimi i parë, i cili është ekzekutuar, tërësisht ose pjesërisht, personi që ka përfituar detyrohet t'i kthejë të gjitha përfitimet e marra nga ekzekutimi i vendimit.

Neni 485/b
Njoftimi i vendimit të Gjykatës së Lartë

(shtuar me ligjin nr. 44/2021, datë 23.3.2021)

Sekretaria gjyqësore njofton vendimet e Gjykatës së Lartë sipas nenit 316 të këtij Kodi.

Neni 486

Zbatimi i detyrueshëm i udhëzimeve

Udhëzimet dhe konkluzionet e Gjykatës së Lartë janë të detyrueshme për gjykatën që rishqyrton çështjen.

Neni 487

Gabimet në arsyetimin e vendimit

(Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Nuk janë shkak për cenimin e vendimit gabimet materiale në arsyetimin e vendimit, kur zgjidhja në themel është e drejtë. Në këtë rast gjykata kufizohet vetëm me korrigjimin e arsyetimit.

Neni 488

Shpenzimet e gjykimit

Gjykata, kur rrëzon rekursin, shpenzimet e gjykimit ia ngarkon atij që ka bërë rekursin.

Neni 489

Mospërsëritja e rekursit

(Hequr fjalë me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Rekursi i deklaruar i papranueshëm nuk mund të paraqitet përsëri, qoftë edhe në rastet kur nuk ka mbaruar afati i caktuar nga ligji.

Neni 490

Heqja dorë nga rekursi

(Shtuar paragrafi i tretë me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001 dhe ndryshuar me ligjin nr. 44/2021, datë 23.3.2021)

1. Pala mund të heqë dorë nga rekursi derisa Kolegji Civil apo Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk janë tërhequr për vendim. Heqja dorë bëhet me shkrim, e nënshkruar nga vetë pala ose avokati i saj, e pajisur me prokurë për këtë qëllim.

2. Akti i heqjes dorë u njoftohet palëve. Kur hiqet dorë nga rekursi dhe në gjykim kanë marrë pjesë të gjitha palët ose përfaqësuesit e tyre, nuk ka vend për shpallje të veçantë të vendimit të mospranimit të rekursit, por palëve u vihet në dispozicion vendimi.

Neni 491

Shpenzimet, kur hiqet dorë nga rekursi

(Shfuqizuar fjalia e dytë me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Në rastet e heqjes dorë nga rekursi gjykata i ngarkon shpenzimet palës që heq dorë.

Neni 492

Ndreqja e gabimeve materiale

Nëse vendimi i shpallur nga Gjykata e Lartë përmban gabime materiale apo në përlllogaritje, pala e interesuar ka të drejtë të kërkojë me kërkesë korrigjimin apo ndreqjen e tyre brenda 60 ditëve nga njoftimi i vendimit.

Për kërkesën gjykata shprehet në dhomën e këshillimit, duke zbatuar rregullat e parashikuara në paragrafin e fundit të nenit 480 të këtij Kodi.

Neni 493

Rigjykimi

(Ndryshuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001, shtuar dy paragrafë pas paragrafit të parë me ligjin nr. 44/2021, datë 23.3.2021)

Gjykata e shkallës së parë apo gjykata e apelit kur dërgohet çështja për rigjykim zbaton të njëjtat rregulla procedurale të parashikuara në atë shkallë gjykimi.

Gjykata e Lartë, kur dërgon çështjen për rigjykim, në vendim përcakton se cila pjesë e vendimit ose gjykimit të faktit prishet dhe për cilën pjesë të mosmarrëveshjes duhet të zhvillohet rigjykim.

Rigjykimi i çështjes pas prishjes së vendimit kufizohet vetëm në shkaqet e prishjes së vendimit. Pjesët e pacenuara të vendimit apo gjykimit nga gjykata më e lartë nuk rishqyrtohen.

Detyrat e lëna nga Gjykata e Lartë janë të detyrueshme për gjykatën që rishqyrton çështjen, e cila, pasi zbaton këto detyra, vendos sipas bindjes së saj.

Në rigjykim nuk mund të ngrihen pavlefshmëritë e vërtetuara në gjykimet e mëparshme. Në rigjykim palët nuk mund të bëjnë pretendime të ndryshme nga ato të pranuar në vendimin e Gjykatës së Lartë, përveç nevojës për të arritur në përfundime që dalin nga vendimi i Gjykatës së Lartë.

TITULLI I TRETË RISHIKIMI

Neni 494

Kërkesa për rishikim dhe rastet e rishikimit

(Ndryshuar titulli me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001; shtuar paragrafi i parë me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001; shtuar shkronja “e” me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008)

Kërkesa për rishikim është akti me të cilin kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës.

Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë, kur:

a) zbulohen rrethana të reja apo prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të dihenin nga pala gjatë shqyrtimit të saj;

b) vërtetohet se thëniet e dëshmitarëve apo mendimet e ekspertëve, mbi të cilat është bazuar vendimi, kanë qenë të rreme;

c) palët ose përfaqësuesit e tyre apo ndonjë anëtar i trupit gjykues, që ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes, kanë kryer vepra të dënueshme penalisht, të cilat kanë ndikuar në dhënien e vendimit;

ç) vërtetohet se vendimi i dhënë është bazuar në dokumente të falsifikuara;

d) vendimi është bazuar në një vendim të gjykatës ose të një institucioni tjetër që më pas është prishur;

e) vendimi është në kundërshtim të hapur me një vendim tjetër të formës së prerë të dhënë midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak.

ë) kur Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të konventës europiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

Neni 495

(Ndryshuar me ligjet nr. 8812, datë 17.5.2001 dhe nr. 10 052, datë 29.12.2008)

Rishikimi i vendimeve për rrethanat e parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të nenit 494 të këtij Kodi lejohet kur ato rrethana janë vërtetuar me vendim penal të formës së prerë.

Kur ndjekja penale nuk mund të fillojë ose të përfundojë për ndonjë nga shkaqet e treguara në nenin 290 të Kodit të Procedurës Penale, ose për shkak se nuk është zbuluar personi që ka kryer falsifikimin, për vërtetimin e rrethanave të mësipërme mund të ngrihet padi në gjykatën civile.

Neni 496

(Ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Kërkesa për rishikim mund të paraqitet brenda 30 ditëve nga dita që pala provon se ka marrë dënimin për shkakun e rishikimit. Në rastet e parashikuara në nenin 495, afati prej 30 ditësh fillon nga dita që vendimi ka marrë formën e prerë.

Neni 497

Paraqitja e kërkesës

(Shtuar një paragraf me ligjin nr. 8431, datë 14.12.1998, ndryshuar paragrafi i parë dhe i tretë me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001 dhe me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Kërkesa për rishikim paraqitet para gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin, por në rast se vendimi është ankimuar në gjykatat më të larta, kompetente është gjykata më e lartë që ka shqyrtuar çështjen në themel. Gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për rishikim gjykon sipas rregullave të zbatueshme për atë shkallë gjykimi. Kërkesa duhet të përmbajë: shkakun për të cilin kërkohet rishikimi, provat përkatëse që lidhen me një nga kërkesat e nenit 494, të këtij Kodi, ditën e zbulimit ose të vërtetimit të rrethanës ose marrjes së dokumenteve.

2. Kërkesa nënshkruhet nga avokati i pajisur me prokurë dhe nëse pala e kërkon, edhe nga kjo e fundit.

3. Kërkesa e paraqitur pa u plotësuar ose në kundërshtim me kriteret e mësipërme kthehet për plotësim nga gjykata. Në rast se kërkesa nuk plotësohet brenda një afati 10-ditor, gjykata vendos mospranimin e saj.

Neni 498

Shqyrtimi i kërkesës

(Ndryshuar me ligjet nr. 8812, datë 17.5.2001 dhe nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur kërkesa është bërë jashtë rasteve të përcaktuara në nenin 494 ose kur është bërë nga ata që nuk e kanë këtë të drejtë, si dhe kur rezulton haptazi e pambështetur, gjykata vendos mospranimin e saj.

2. Kur kërkesa shqyrtohet nga gjykata e shkallës së parë ose gjykata e apelit dhe pranohet, gjykata vendos prishjen e vendimit tërësisht ose pjesërisht dhe vazhdon gjykimin e çështjes në themel.

3. Kur kërkesa shqyrtohet nga Gjykata e Lartë dhe pranohet prej saj, gjykata vendos prishjen e vendimit tërësisht ose pjesërisht dhe e dërgon atë për rigjykim në gjykatën kompetente, e cila e gjykon me një tjetër trup gjykues. Nëse shkakun e rishikimit nuk lidhet me nevojën e saktësisht të fakteve të reja, Gjykata e Lartë revokon vendimin e mëparshëm të saj dhe vendos sërish për çështjen, sipas kompetencave të saj.

4. Në rastin e përcaktuar nga shkronja “e”, e nenit 494, të këtij Kodi, gjykata kompetente prish vendimin e dytë.

5. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të apelit lejohet ankimi ose rekurs në gjykatën më të lartë, sipas rregullave të përgjithshme të ankimit ose rekursit.

6. Në rast se kërkesa shqyrtohet nga Gjykata e Lartë, kundër vendimit të saj nuk lejohet ankimi.

Neni 498/a

(Shtuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001 dhe ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Rigjykimi i çështjes nga gjykata kompetente bëhet sipas rregullave të përgjithshme.

Neni 499

Shqyrtimi paraprak

(Ndryshuar me ligjin nr. 8431, datë 14.12.1998 dhe shfuqizuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Neni 500

Pezullimi i ekzekutimit

Paraqitja e kërkesës për rishikim nuk pezullon ekzekutimin e vendimit. Por gjykata, me kërkesën e palës, mund të pezullojë ekzekutimin e vendimit, kur vlerëson se ka rrezik që mund të shkaktohet një dëm i madh e i pariparueshëm.

Neni 501

Marrja e vendimit

(Ndryshuar me ligjin nr. 8431, datë 14.12.1998 dhe shfuqizuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Neni 502

Kundërshtimi i vendimit

(Shfuqizuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

TITULLI IV

KREU IV

KUNDËRSHTIMI I TË TRETIT

(Shfuqizuar nenet 503-509 me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

PJESA E KATËRT

EKZEKUTIMI I DETYRUESHËM

TITULLI I PARË

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 510

Titujt ekzekutivë

(Ndryshuar shkronja "d" me ligjin nr. 8431, datë 14.12.1998, ndryshuar shkronja "d" me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001; shkronja "d" me ligjin nr. 9953, datë 14.7.2008 dhe shkronja "a" me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008)

Ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv.

Janë tituj ekzekutivë:

- a) vendimet civile të formës së prerë të gjykatës, që përmban një detyrim, vendimet e dhëna prej saj për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm;
- b) vendimet penale të formës së prerë në pjesën që bëjnë fjalë për të drejta pasurore;
- c) vendimet e gjykatave e të arbitrazheve të shteteve të huaja që u është dhënë fuqi sipas dispozitave përkatëse të këtij Kodi;
- ç) vendimet e një gjykate arbitrazhi në Republikën e Shqipërisë;
- d) aktet noteriale që përmbajnë detyrim në të holla, si dhe aktet për dhënien e kredive bankare ose aktet për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare;
- dh) kambialet, çeçet e ltrat me urdhër që barazohen me ato;
- e) aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë dhe ngarkohet zyra e përbarimit për ekzekutimin e tyre.

Neni 511

Urdhri i ekzekutimit

(Ndryshuar me ligjet nr. 8812, datë 17.5.2001, nr. 10 052, datë 29.12.2008, nr. 122/2013, datë 18.4.2013, nr. 114/2016, datë 3.11.2016; ndryshuar paragrafi i parë dhe dytë me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim nëpërmjet lëshimit të urdhrit të ekzekutimit, i cili:

- a) për rastet e parashikuara nga shkronja "a" dhe "b", të nenit 510, të këtij Kodi, lëshohet nga gjykata që ka dhënë vendimin në dispozitivin e vendimit;
- b) për vendimet e gjykatave të shteteve të huaja e të gjykatave të arbitrazhit të huaj, që u është dhënë fuqi në zbatimin të dispozitave të këtij Kodi, urdhri i ekzekutimit lëshohet nga gjykata që bën njohjen e vendimit, në dispozitivin e vendimit.

Nuk lëshohet urdhër ekzekutimi për vendimin e sigurimit të padisë dhe për gjobat e dhëna nga gjykata, vendimet për marrjen e detyrueshme të provës, vendimin në pjesën që urdhëron shpenzimet gjyqësore, si dhe vendimet civile të gjykatës, të dhëna për ekzekutim të përkohshëm, të cilat ekzekutohen drejtpërdrejt nga shërbimi përbarimor, pas njoftimit të vendimit.

Shqyrtimi i kërkesës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit zhvillohet nga gjyqtari pa praninë e palëve.

Gjykata lëshon urdhrin e ekzekutimit, bazuar mbi dokumentet e depozituara nga kërkuesi.

Urdhri i ekzekutimit përmban:

- a) gjenealitetet e debitorit dhe kreditorit;
- b) origjinën e detyrimit;
- c) detyrimin konkret që buron nga titulli ekzekutiv deri në momentin e lëshimit të urdhrin të ekzekutimit;
- d) kur titulli ekzekutiv, për të cilin lëshohet urdhri i ekzekutimit, është akt për dhënie kredie bankare ose detyrime monetare, Gjykata duhet të parashikojë kamatat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare.

Neni 511/1

(Shtuar me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013 dhe shfuqizuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017)

Neni 512

Ankimi për mosdhënien e urdhrin të ekzekutimit

Kundër vendimit me të cilin refuzohet dhënia e urdhrin të ekzekutimit, mund të bëhet ankim sipas rregullave mbi ankimet e veçanta.

Neni 513

Urdhri i ekzekutimit për pasuri dhe persona të veçantë

Urdhri i ekzekutimit lëshohet vetëm në një kopje.

Kur duhet të dorëzohen disa pasuri të veçanta ose kur titulli ekzekutiv është dhënë në dobi ose kundër disa personave, mund të lëshohen urdhra ekzekutimi të veçantë, duke shënuar se cila pjesë e titullit duhet të ekzekutohet për çdo urdhër ekzekutimi.

Neni 514

Lëshimi i dublikatës së urdhrin të ekzekutimit

Kur urdhri i ekzekutimit humbet ose zhduket, gjykata që e ka lëshuar, me kërkesë të kreditorit, mund t'i lëshojë këtë dublikatë në bazë të titullit ekzekutiv.

Kërkesa shqyrtohet në këshill gjyqësor pasi debitorit t'i jetë dorëzuar një kopje e saj.

Kur humbet ose zhduket vetë titulli ekzekutiv dhe nuk ka mundësi që përmbajtja e tij të nxirret nga aktet e organeve që kanë lëshuar titullin ekzekutiv, kreditori mund të ngrejë padi kundër debitorit, sipas rregullave të përgjithshme.

Neni 515

Vënia në ekzekutim

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008 dhe shkronja "v" me ligjin nr. 114/2016, datë 3.11.2016)

Urdhri i ekzekutimit vihet në ekzekutim nga shërbimi përmbarimor gjyqësor, shtetëror ose privat, me anë të përmbaruesit gjyqësor, në bazë të kërkesës së kreditorit.

Kreditori, përveç kërkesës për ekzekutim, duhet të paraqesë:

- a) titullin ekzekutiv (origjinal ose i noterizuar);
- b) urdhrin e ekzekutimit (origjinal);
- c) pagesën e tarifës sipas paragrafit të parë të nenit 525 të këtij Kodi;
- ç) sipas rastit, prokurën e personit, që përfaqëson palën kreditore.

Kur nuk plotësohen në rregull dokumentet e mësipërme për vënien në ekzekutim të urdhrin të ekzekutimit, përmbaruesi i kërkuesit një afat 5-ditor për plotësimin e mangësive. Kur kërkuesi nuk plotëson këto mangësi brenda afatit të caktuar, dokumentacioni i kthehet atij. Kur mangësitë janë shmangur në afatin e caktuar, kërkesa për vënien në ekzekutim quhet e regjistruar nga data që është paraqitur pranë përmbaruesit gjyqësor.

Vënia në ekzekutim e urdhrin të ekzekutimit bëhet brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit të kërkesës së kreditorit.

Vendimi i gjykatës për masën e sigurimit të padisë dhe gjobat e gjykatës vihen në ekzekutim brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes për ekzekutim.

Tarifa për vënien në ekzekutim të urdhrat ekzekutiv nuk parapaguhet në raste të parashikuara me ligj apo akte të tjera normative.

Neni 516

Kompetenca tokësore e përmbaruesit gjyqësor
(Shtuar fjalia e fundit me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008)

Kërkesa për zbatimin e urdhrave të ekzekutimit i drejtohet përmbaruesit gjyqësor të vendit ku ndodhen:

- a) sendet e luajtshme ose të paluajtshme ose paratë, ndaj të cilave drejtohet ekzekutimi;
- b) banimi i personit të tretë të detyruar kur ekzekutimi drejtohet kundër kredisë që ka për të marrë debitori nga ky person;
- c) vendi i ekzekutimit të detyrimit për kryerjen ose moskryerjen e një veprimi të caktuar.

Kur përmbaruesi gjyqësor konstaton se nuk është kompetent për të vënë në ekzekutim kërkesën, ia dërgon këtë përmbaruesit gjyqësor kompetent, pasi vë më parë sekuestër mbi sendin ose mbi kredinë e debitorit.

Konflikti për kompetencë nuk lejohet, por përmbaruesi gjyqësor ka të drejtë të parashtrojë moskompetencën e tij në gjykatën e shkallës së parë ku e ushtron veprimtarinë, e cila e shqyrton atë në këshill gjyqësor. Kundër vendimit të tij lejohet ankimi i veçantë.

Ky nen nuk zbatohet për personat, përmbaruesit gjyqësorë, që ushtrojnë veprimtarinë publike të shërbimit përmbarimor gjyqësor, të organizuar mbi baza private.

Neni 516/a

(Shtuar me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008)

Në çastin e fillimit të procedurës së ekzekutimit, përmbaruesi gjyqësor, në bazë të nenit 515 të këtij ligji, duhet të regjistrojë, në regjistrin qendror pranë Ministrisë së Drejtësisë, çdo kërkesë. Çdo përmbarues gjyqësor është i detyruar të njihet me të dhënat e regjistrit.

Nëse me fillimin e procedurës me objekt “Ekzekutim detyrimesh në të holla” përmbaruesi gjyqësor, nga të dhënat e marra nga regjistri qendror, vëren se kreditorë të tjerë janë në procedurë ekzekutimi ndaj të njëjtit debitor, me të njëjtin objekt, atëherë pezullon procedurën e nisur dhe drejton kreditorin e tij te përmbaruesi gjyqësor, i cili ka regjistruar i pari kërkesën për ekzekutim.

Në këtë rast, përmbaruesi gjyqësor, që ka regjistruar i pari kërkesën, vijon procedurën e ekzekutimit, në përputhje edhe me nenin 534 e në vijim të këtij Kodi.

Me pezullimin e procedurës së ekzekutimit, tarifa e vënies në ekzekutim të urdhrat të ekzekutimit, së bashku me dokumentacionin, i kthehen kreditorit.

Ky nen nuk zbatohet kur në cilësinë e palës debitore është shteti.

Neni 517

Lajmërimi për ekzekutimin vullnetar

(Hequr fjalë në paragrafin e dytë me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001, nr. 10 052, datë 29.12.2008, nr. 122/2013, datë 18.4.2013, shtuar paragrafi i fundit me ligjin nr. 114/2016, datë 3.11.2016)

Përmbaruesi gjyqësor, kur fillon ekzekutimin, i dërgon debitorit një lajmërim për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban urdhri i ekzekutimit, duke i caktuar për këtë një afat prej 5 ditësh, kur objekti i tij është pagë ose detyrim për ushqim dhe prej 10 ditësh në të gjitha rastet e tjera.

Me marrjen e lajmërimit për ekzekutim vullnetar, debitori është i detyruar të deklarojë, me shkrim, gjendjen e tij pasurore, si dhe sendet ose kredi që persona të tretë i detyrohen, nëse kjo kërkohet nga përmbaruesi gjyqësor.

Me kërkesë të debitorit gjykata e shkallës së parë të vendit të ekzekutimit, në raste të veçanta, duke marrë parasysh gjendjen pasurore të debitorit ose rrethana të tjera të çështjes dhe pasi të dëgjojë kreditorin, mundet të shtyjë afatin e ekzekutimit të detyrimit në të holla ose të ndajë këtë detyrim në këste, përveç rasteve kur ky detyrim rrjedh nga një akt për dhënien e kredisë bankare. Vendimi jepet në seancë gjyqësore, brenda 20 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës dhe kundër tij mund të bëhet ankimi i veçantë.

Përmbaruesi gjyqësor kryen lajmërimet dhe njoftimet, duke zbatuar parashikimet e pjesës I, titulli VI, kreu IV, "Njoftimet", të këtij Kodi.

Neni 518

Përmbajtja e lajmërimit

Lajmërimi duhet të përmbajë një shkurtim të përmbajtjes së urdhrit të ekzekutimit, vendin dhe adresën e kreditorit, dhe paralajmërimin që i bëhet debitorit se do të fillojë ekzekutimi i detyrueshëm, në qoftë se ekzekutimi nuk ekzekutohet vullnetarisht prej tij brenda afatit të caktuar në lajmërim.

Në rast se debitori vdes pas vënies në ekzekutim të titullit, por para se të jenë përfunduar së kryeri veprimet e nevojshme të ekzekutimit, përmbaruesi gjyqësor, para se të vazhdojë veprimet e tij, duhet t'u dërgojë trashëgimtarëve të debitorit të vdekur, kur këta janë njohur, një lajmërim të ri për të ekzekutuar këta vullnetarisht detyrimin që përmban urdhri i ekzekutimit.

Neni 519

Fillimi i ekzekutimit të detyrueshëm

Ekzekutimi i detyrueshëm nuk mund të fillojë para se të kenë kaluar afatet e parashikuara nga neni 517 i këtij Kodi, përveç kur ka rrezik se me kalimin e afatit, ekzekutimi do të bëhet i pamundshëm. Në këtë rast, përmbaruesi gjyqësor mund të fillojë menjëherë nga ekzekutimi i detyrueshëm.

Neni 520

Efektet e urdhrit të ekzekutimit ndaj trashëgimtarëve

Urdhri i ekzekutimit kundër debitorit trashëgimlënës vihet në ekzekutim mbi pasurinë e trashëgimtarëve të tij, por brenda masës së pasurisë së trashëguar prej tyre nga trashëgimlënësi.

Neni 521

Ekzekutimi ndaj personit të tretë

(Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Urdhri i ekzekutimit kundër debitorit mund të vihet në ekzekutim edhe kundër personit të tretë, që për sigurimin e detyrimit ka ngarkuar me barrë sipas ligjit një send të tij, kur kreditori kërkon ekzekutimin mbi këtë send.

Neni 522

Ekzekutimi ndaj debitorit që nuk i dihet banimi

(Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001 dhe nr. 10 052, datë 29.12.2008)

Kur banimi i debitorit nuk dihet, gjykata e shkallës së parë e vendit të ekzekutimit, me kërkesën e përmbaruesit gjyqësor, pasi sqarohet edhe vetë për këtë rrethanë, brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së përmbaruesit gjyqësor i emëron debitorit një përfaqësues, i cili shpërblehet fillimisht nga kreditori sipas nenit 525 të këtij Kodi.

Neni 523

Detyrimi për bashkëpunim

(Ndryshuar me ligjet nr. 8812, datë 17.5.2001 dhe nr. 10 052, datë 29.12.2008)

Kur për ekzekutimin e detyrueshëm është e nevojshme të çelet banesa ose ndonjë ndërtesë tjetër e debitorit, pa praninë e tij ose të një personi madhor të familjes së tij, me kërkesë të përmbaruesit gjyqësor, detyrohet të jetë i pranishëm përfaqësuesi i njësisë së qeverisjes vendore. Në çdo rast, përmbaruesi gjyqësor kërkon edhe pjesëmarrjen e dy dëshmitarëve të tjerë.

Në rast nevoje, me kërkesë të përmbaruesit gjyqësor, Policia e Rendit detyrohet ta mbështesë atë gjatë procedurave të ekzekutimit.

Kur për ekzekutimin e detyrueshëm është e nevojshme të priset objekti, të lirohet trualli, të pezullohen punimet, me kërkesë të përmbaruesit gjyqësor, inspektorati ndërtimor pranë pushtetit vendor dhe Inspektorati Kombëtar detyrohen të mbështesin përmbaruesin gjyqësor gjatë procedurave të ekzekutimit.

Për ekzekutimin e titujve ekzekutivë, me objekt “Takim dhe kujdestari fëmije”, përmbaruesi gjyqësor kërkon asistencën e psikologut, kur ky i fundit është i detyruar në bazë të ligjit për bashkëpunim.

Neni 524

Procesverbali i përmbaruesit

Përmbaruesi gjyqësor, për çdo veprim të kryer prej tij, është i detyruar të mbajë procesverbal, në të cilin përmenden dita dhe vendi i kryerjes së veprimit, kërkesat dhe deklaratimet e bëra nga palët, sendet e marra, shumata e nxjerrë dhe shpenzimet e bëra për ekzekutimin.

Neni 525

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008 dhe nr. 114/2016, datë 3.11.2016)

Tarifat fikse të përcaktuara për ekzekutimin e urdhrave ekzekutivë paguhen, fillimisht, nga kreditori dhe, pas përfundimit të procedurës së ekzekutimit, i ngarkohen debitorit. Shpenzimet e tjera, gjatë procedurës së ekzekutimit, paguhen nga pala që i ka shkaktuar ato.

Masa e tarifës së suksesit, me përjashtim të rasteve kur nuk është e aplikueshme, përcaktohet me marrëveshje midis kreditorit dhe përmbaruesit gjyqësor, sipas legjislacionit që rregullon shërbimin përmbarimor gjyqësor.

Neni 526

Ekzekutimi ndaj personit të huaj

Ekzekutimi i detyrueshëm ndaj personit të huaj publik mund të bëhet vetëm me leje të Ministrit të Drejtësisë.

Neni 526/a

Fusha e zbatimit

(Shtuar me ligjin nr. 8535, datë 18.10.1999)

Dispozitat e përgjithshme për ekzekutimin e detyrueshëm zbatohen për të gjitha llojet e titujve ekzekutivë.

Me ligj mund të vihen rregulla të posaçme për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë të caktuar, duke respektuar kërkesat e neneve 510, 511, 516, 520, 521, 523, 524, 545, 561 dhe 562 të këtij Kodi, edhe sikur të jenë tituj të fushave të veçanta të ekzekutimit të detyrueshëm sipas këtij Kodi.

TITULLI II

EKZEKUTIMI NË FUSHA TË VEÇANTA

KREU I

EKZEKUTIMI I DETYRIMEVE NË TË HOLLA KUNDREJT PERSONAVE FIZIKË E JURIDIKË

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 527

Vënia e sekuestros

Kur kërkohet ekzekutimi i një detyrimi në të holla, përmbaruesi gjyqësor, me kalimin e afatit të lajmërimit për ekzekutim (neni 517), fillon ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit dhe mbi sendet e luajtshme dhe të paluajtshme të tij, në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Neni 528

(Shtuar fjalia e fundit me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008)

Me kërkesën e debitorit, sekuestroja mund të vihet edhe mbi një pasuri tjetër të tij të ndryshme nga ajo që ka treguar kreditori, kur përmbaruesi gjyqësor çmon se kjo plotëson kërkesën e kreditorit. Me kërkesë të debitorit, sekuestroja mund të vihet, përveç pasurive të rënduara me peng dhe hipotekë, edhe mbi një pasuri tjetër të tij, të ndryshme nga ajo që ka treguar kreditori, kur përmbaruesi gjyqësor çmon se ajo plotëson kërkesën e kreditorit.

Neni 529

Sendet mbi të cilat nuk mund të vihet sekuestroja

(Shtuar pika 8 me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008)

Përjashtohen nga sekuestrimi i pasurisë së debitorit:

1. sendet e përdorimit personal të debitorit dhe të familjes së tij si: veshjet, shtresat, mbulesat, mobilet për aq sa ato janë të nevojshme për jetesën e tyre;
2. ushqimet dhe lëndët djegëse që i nevojiten debitorit dhe familjes së tij për tre muaj;
3. dekoratat dhe sende kujtimi, letra, shkresa të familjes dhe librat profesionalë;
4. librat, veglat muzikore, mjetet e artit që nevojiten për veprimtarinë shkencore dhe artistike të debitorit dhe të familjes së tij;
5. deri 3 dynmë tokë, 2 kafshë për punimin e tokës, 1 lopë, 6 dele ose 6 dhi, fara për mbjelljen e ardhshme, si dhe ushqimi i këtyre kafshëve për 3 muaj për personat që jetojnë me punë bujqësore ose blegtorale;
6. ndihma që u jepet nënave me shumë fëmijë ose të vetme, pensionet e pleqërisë, të invaliditetit ose familjarë ose bursa e studimit përveç kur detyrimi është për ushqim. Në këtë rast nuk mund të sekuestrohet më shumë se 1/2 e shumës së pensionit ose të bursës;
7. frutat natyrore një muaj para se ato të pihen.
8. sendet e nevojshme të punës për sigurimin e jetesës.

Neni 530

Shtrirja e sekuestros mbi shpërblimin nga sigurimi

Në qoftë se sendet e sekuestruara janë të siguruara, sekuestrimi shtrihet edhe në shpërblimin që u takon nga sigurimi.

Neni 531

Detyrimet e debitorit pas vënies së sekuestros

Nga çasti i vënies së sekuestros, debitori nuk ka të drejtë të disponojë sendin e luajtshëm ose të paluajtshëm ose kredinë apo të ndryshojë, dëmtojë ose të zhdukë sendin, përndryshe ka përgjegjësi, sipas dispozitave të Kodit Penal. Ky detyrim shtrihet edhe mbi personat që kanë në posedim sendin e debitorit.

Neni 532

Llogaria në bankë e zyrës së përmbarimit dhe e përmbaruesit gjyqësor

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008)

Shumat e nxjerra, me rastin e ekzekutimit ndaj debitorit, ndaj personit të tretë që i detyrohet debitorit, ndaj blerësit të sendit të shitur në dyqanet me shitje të lirë ose në ankand, derdhen në bankë në llogari të zyrës së përmbarimit ose në llogari të përmbaruesit gjyqësor.

Neni 533

Sekuestroja e pagës së debitorit

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008)

Pasi zbritet kontributi për sigurimet shoqërore dhe taksat mbi të ardhurat, përmbaruesi gjyqësor sekuestron pagën e debitorit, por pa cenuar minimumin jetik, të përcaktuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 534

Pjesëmarrja e kreditorëve të tjerë

Në çdo fazë të ekzekutimit, gjersa nuk është përgatitur nga përmbartuesi gjyqësor projekti i ndarjes së shumave të nxjerra, mund të marrin pjesë në ekzekutim edhe kreditorët e tjerë të po atij debitorit.

Marrja pjesë e kreditorëve të tjerë në ekzekutim bëhet me kërkesë të tyre të shkruar së cilës i bashkëngjitet urdhri i ekzekutimit ose një vendim nga përmbartuesi gjyqësor se urdhri i ekzekutimit i është bashkëngjitur një çështjeje tjetër që është në ekzekutim.

Neni 535

Kreditori që merr pjesë në ekzekutim bashkë me kreditorët e tjerë ka po ato të drejta që ka edhe kreditori, i cili ka vënë i pari sekuestron mbi sendet ose kreditë e debitorit, përveç kur ekzistojnë shkaqe të ligjshme të preferimit.

Veprimet e ekzekutimit, të kryera para se kreditori të marrë pjesë bashkë me kreditorët e tjerë, krijojnë të drejta edhe për ata.

Neni 536

Shteti quhet gjithmonë si kreditor që merr pjesë bashkë me kreditorët e tjerë për detyrimin që po ai debitor i ka shtetit dhe të cilët rrjedhin nga tatimet dhe nga kredi të tjera, shuma e të cilëve i është njoftuar përmbartuesit gjyqësor, para se të bëhet ndarja e shumave të tjera. Për këtë qëllim, përmbartuesi gjyqësor njofton seksionin përkatës të financës për çdo ekzekutim të filluar prej tij dhe për çdo ndarje që ai bën.

Neni 537

Projekti i ndarjes së shumave

(Ndryshuar fjalë me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Kur shuma e nxjerrë nga ekzekutimi nuk mjafton për të paguar të gjithë kreditorët, përmbartuesi gjyqësor përgatit projektin e ndarjes, duke veçuar më parë shumat që nevojiten për kreditë që paguhen me preferim dhe nga pjesa tjetër që mbetet, paguan kreditë e tjera në përpjesëtim me shumat e tyre.

Neni 538

Përmbartuesi gjyqësor njofton për përgatitjen e projektit të ndarjes së shumave të nxjerra debitorin dhe kreditorët, të cilët i thërret për këtë qëllim në një ditë të caktuar prej tij.

Në qoftë se brenda 5 ditëve nga dita e paraqitjes prej përmbartuesit gjyqësor të projektit të ndarjes nuk bëhet ankim, ndarja quhet përfundimtare dhe përmbartuesi gjyqësor i dorëzon çdo kreditori shumën që i takon.

Neni 539

Ankimi kundër projektit të ndarjes së shumave

Në rast se kundër projektit të ndarjes së shumave të nxjerra bëhet ankim, çështja së bashku me ankesën i dërgohet gjykatës së shkallës së parë e cila vendos në seancë gjyqësore, duke thirrur debitorin dhe kreditorët. Kundër vendimit të gjykatës për ndarjen e shumave të nxjerra mund të bëhet ankim i veçantë në gjykatën e apelit.

KREU II

EKZEKUTIMI MBI SENDET E LUAJTSHME

Neni 540

Inventarizimi

(Shtuar fjalë e fundit me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008)

Sekuestroja mbi sendet e luajtshme të debitorit bëhet me inventarizimin e tyre nga përmbartuesi gjyqësor. Përmbartuesi gjyqësor bën sekuestrimin e pasurive të luajtshme, mbi të cilat vendoset një etiketë e shërbimit të përmbartimit.

Neni 541

Inventarizimi përfshin vetëm sendet që ndodhen në shtëpinë e debitorit, si dhe ato që ndodhen në një lokal tjetër që është i përbashkët për debitorin dhe personat e tretë, përveç se kur del se ato janë të një personi tjetër.

Për inventarizimin mbahet procesverbal.

Neni 542

Përmbajtja e procesverbalit të inventarizimit

(Shtuar fjalë në shkronjën "c" me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Procesverballi i inventarizimit duhet të përmbajë:

- a) shënimin e urdhrin të ekzekutimit, në bazë të të cilit vihet sekuestroja;
- b) emrin, emrin e atit dhe mbiemrin e përmbartësit gjyqësor, të debitorit, kreditorit dhe të personave të tjerë që janë të pranishëm në inventarizim;
- c) vendin ku kryhet inventarizimi dhe koha e kryerjes së tij;
- ç) pretendimet e personave të tretë në lidhje me sendet e inventarizuara;
- d) përshkrimin e hollësishëm të sendeve dhe vlerësimin e tyre;
- dh) kujt i lihen për ruajtje sendet;
- e) nënshkrimin e personave që marrin pjesë në inventarizim.

Neni 543

(Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Inventarizimi bëhet në prani të debitorit. Në mungesë të debitorit, inventarizimi bëhet në prani të një personi madhor të familjes së tij dhe, kur nuk ndodhet një person i tillë, në prani të një përfaqësuesi të njësisë së qeverisjes vendore. Në çdo rast inventarizimi bëhet duke qenë të pranishëm edhe dy dëshmitarë.

Neni 544

Vlerësimi i sendeve të inventarizuara

Sendet e inventarizuara vlerësohen nga përmbartësi gjyqësor në bazë të vlerësimeve të ekspertëve, në bazë të çmimeve të tregut, duke u zbritur përqindja përkatëse e konsumimit ose e vjetërsisë së tyre.

Neni 545

Detyrimet e debitorit për sendet e lëna në ruajtje

Sendet e inventarizuara mund t'i lihen në ruajtje debitorit, i cili ka të drejtë edhe t'i përdorë, por me kusht që të mos pakësohet vlefata e tyre. Kur debitori refuzon t'i pranojë për ruajtje, përmbartësi gjyqësor emëron në këtë detyrë një person tjetër, duke i caktuar këtij një shpërblim.

Debitori ose personi i tretë, të cilëve u janë lënë në ruajtje sendet e inventarizuara, duhet të japin llogari për të ardhurat dhe shpenzimet e bëra për sendin. Këta janë përgjegjës, sipas dispozitave të Kodit Penal, për disponimin, dëmtimin ose shkatërrimin e tyre.

Neni 546

Ekzekutimi mbi sendet në bashkëpronësi

(Ndryshuar fjalë me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Kur ekzekutimi bëhet mbi sendet që janë në bashkëpronësi të debitorit dhe të personave të tjerë, përmbartësi gjyqësor, pasi bën inventarizimin e gjithë pasurisë së përbashkët, i bën kërkesë gjykatës kompetente të vendit të ekzekutimit, e cila cakton dhe ndan pjesën që i takon debitorit, sipas rregullave të parashikuara nga nenet 369-374 të këtij Kodi. Mbi këtë pjesë bëhet pastaj ekzekutimi nga përmbartësi gjyqësor.

Neni 547

Pavlefshmëria e disponimit pas vënies së sekuestros

Çdo disponim i sendit të luajtshëm nga ana e debitorit pas vënies së sekuestros është i pavlefshëm kundrejt kreditorëve që kanë kërkuar ekzekutimin, përveç kur me disponimin sendi ka kaluar në pronësi të një tjetri që ka qenë në mirëbesim (neni 166 i Kodit Civil).

Neni 548

Sekuestrimi mbi sendet e çmueshme

Sendet e çmueshme, si: ari, argjendi, platini dhe metalet e grupit të platinës në shufra, copë, monedha dhe artikuj të bërë prej tyre, gurët e çmueshëm, margaritarët dhe artikujt e bërë prej tyre, si dhe valuta e huaj, dokumentet e pagesës në valutë të huaj, si: kambiale, çeqe, mandatë e letra të tjera të kësaj natyre, si dhe tituj të huaj me vleftë, si: aksione, obligacione e kuponët përkatës i jepen për ruajtje një banke.

Neni 549

Procedura e shitjes

Përmbaruesi gjyqësor, pas vënies së sekuestros, i dërgon një lajmërim debitorit se sendet e sekuestruara do të shiten, në qoftë se brenda pesë ditëve ai nuk ekzekuton detyrimin.

Neni 550

Shitja e sendeve bëhet me anë të ankandit ose në dyqanet me shitje të lirë, ndërsa sendet e çmueshme (neni 548), të depozituara në bankë, i shiten asaj dhe merret kundërvlera e tyre nga përmbaruesi gjyqësor, në bazë të kursit zyrtar në kohën e pagesës së tyre.

Neni 551

(Shfuqizuar me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008)

Neni 552

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008)

Çmimi i sendit të sekuestruar caktohet nga përmbaruesi, në bashkëpunim me kreditorin dhe debitorin. Kur ka kundërshtime ndërmjet tyre, thirret një ekspert.

Neni 553

Shitja e lirë e sendit

(Ndryshuar me ligjet nr. 8812, datë 17.5.2001 dhe nr. 10 052, datë 29.12.2008)

Përmbaruesi e dërgon sendin për shitje në dyqane me shitje të lirë. Caktimi i shpërblimit për shitjen bëhet në marrëveshje ndërmjet përmbaruesit gjyqësor dhe shitësit. Shpërblimi nxirret nga vlera e sendit të sekuestruar pas shitjes së tij.

Në qoftë se brenda 2 muajve sendi nuk shitet në shitje të lirë, përmbaruesi gjyqësor, duke marrë edhe pëlqimin e palëve, vendos nëse duhet të vazhdojë me shitjen e lirë edhe për 30 ditë të tjera apo të kalojë në procedurë ankandi.

Neni 554

(Ndryshuar me ligjet nr. 8812, datë 17.5.2001 dhe nr. 10 052, datë 29.12.2008)

Përmbaruesi gjyqësor, pasi njofton palët se sendi, për shkak të natyrës ose të gjendjes, nuk mund të pranohet në shitje të lirë, organizon shitjen me ankand të sendit, sipas çmimit të përcaktuar në nenin 552 të këtij Kodi.

Neni 555

(Shtuar fjalia e parë me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008)

Çmimi fillestar i ankandit të parë është 80 për qind e çmimit të caktuar sipas nenit 552 të këtij ligji. Kur sendi shitet në ankand, përmbauesi gjyqësor shpall në zyrën e tij, në vendin ku ndodhet sendi dhe në vendin e caktuar për shitjen në ankand, një lajmërim ku duhet të tregohet çmimi me të cilin do të fillojë shitja në ankand, vendi, dita dhe ora që do të bëhet shitja.

Shitja nuk mund të bëhet para se të kenë kaluar pesë ditë nga shpallja.

Neni 556

Shitja në ankand e sendit bëhet ditën e caktuar në lajmërim dhe përfundon me mbarimin e orarit zyrtar të asaj dite.

Blerës quhet ofertuesi që ka dhënë çmimin më të lartë. Blerësi duhet ta paguajë çmimin menjëherë.

Në ankand nuk mund të marrin pjesë personat që tregohen në nenin 709 të Kodit Civil.

Për të gjitha veprimet e shitjes në ankand mbahet procesverbal.

Neni 557

Ankandi i dytë

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008)

Në rast se në ankandin e parë nuk është paraqitur asnjë ofertues, atëherë, brenda 10 ditëve nga përfundimi i tij, përmbauesi gjyqësor përcakton çmimin e ri, jo më të ulët se 30 për qind të çmimit fillestar, të caktuar në ankandin e parë dhe cakton një ankand të dytë për shitjen e sendit.

Në rast se në ankandin e dytë nuk është paraqitur asnjë ofertues, përmbauesi i propozon në fillim kreditorit, që, kundrejt kredisë, të marrë sendin me çmimin e ankandit të dytë. Në rast se kreditori nuk pranon ta marrë sendin, përmbauesi heq sekuestron mbi këtë send, duke ia kthyer atë debitorit dhe vijon procedurat përmbaimore mbi pasuri të tjera të tij.

Neni 558

Radha e shitjes së sendeve në ankand

Debitori ka të drejtë të caktojë radhën, sipas së cilës duhet të shiten sendet në ankand. Në qoftë se nga shitja e një ose disa sendeve nxirret një shumë e cila mjafton për të shlyer kredinë e kreditorit dhe shpenzimet e tjera që kanë lidhje me kredinë, ankandi përfundon dhe sendet e tjera nuk shiten.

Neni 559

Kalimi i pronësisë së sendit të shitur

Blerësi i sendit të shitur në dyqanin e shitjes me shitje të lirë ose në ankand bëhet pronar i tij edhe sikur sendi të mos ishte në pronësi të debitorit.

Kundër shitjes nuk mund të bëhet ankim dhe as të kundërshtohet vlefshmëria e saj, përveç rastit të parashikuar nga paragrafi i tretë i nenit 556 të këtij Kodi.

KREU III

EKZEKUTIMI MBI SENDET E PALUAJTSHME, MBI MJETET E LUNDRIMIT E TË FLUTURIMIT

Neni 560

Vënia e sekuestrros

(Shtuar një fjali në paragrafin e dytë dhe hequr fjalë me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008)

Ekzekutimi i vendimit të gjykatës apo të titujve të tjerë ekzekutivë mbi sendet e paluajtshme të debitorit bëhet me vendosjen e sekuestrros mbi to.

Sekuestroja vihet me regjistrimin e saj në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të aktit të përmbauesit gjyqësor, në të cilin shënohet lloji, natyra dhe të paktën tre kufij të sendit të paluajtshëm, vendi i ndodhjes së tij, si dhe hipotekat dhe të drejtat reale që mund të jenë vënë mbi të. Akti i përmbauesit gjyqësor regjistrohet nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së tij.

Një kopje e aktit të përmbauesit gjyqësor i komunikohet debitorit.

Neni 561

Sekuestroja mbi mjetet e lundrimit

Kur sekuestrohet një anije, në procesverbalin përkatës përmenden emri e kombësia e pronarit të anijes, emri i anijes, përshkrimi e kapaciteti i saj, si dhe të dhëna të tjera lidhur me regjistrimin e saj. Kopja e procesverbalit të sekuestrimit, si për anijet shqiptare ashtu dhe për ato të huaja, i jepet personit që mban regjistrin detar të anijes, si dhe drejtorit të portit ku është vendosur sekuestrimi, i cili njofton menjëherë pronarin e anijes.

Sekuestrimi ndalon lundrimin e anijes.

Neni 562

Sekuestroja mbi mjetet e fluturimit

Kur sekuestrohet një mjet fluturimi, në procesverbalin përkatës përmendet emri dhe kombësia e pronarit, shenjat dalluese të mjetit, vendin e regjistrimit, kapacitetin e të dhëna të tjera të kësaj natyre.

Kopja e procesverbalit të sekuestrimit i jepet komandantit të aeroportit ku është bërë sekuestrimi i mjetit.

Sekuestrimi ndalon fluturimin e mjetit. Komanda e aeroportit kur mjeti i fluturimit është i huaj, njofton menjëherë zyrën ku është regjistruar mjeti i fluturimit.

Neni 563

Verifikimi i të drejtës së pronësisë të debitorit

Përpara vendosjes së sekuestros, përmbaruesi gjyqësor sigurohet nëse sendi i paluajtshëm është në pronësi të debitorit. Për këtë, përmbaruesit gjyqësor duhet t'i paraqiten dokumente pronësie ose edhe vetë ai kërkon informata nga zyra e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme dhe, në mungesë të tyre, nga organet financiare dhe të pushtetit lokal.

Neni 564

Vlerësimi i sendit të sekuestruar

*(Ndryshuar me ligjet: nr. 10 052, datë 29.12.2008,
nr. 122/2013, datë 18.4.2013 dhe nr. 114/2016, datë 3.11.2016)*

Nëse kreditori dhe debitori, brenda një jave, nuk arrijnë një marrëveshje për vlerën e sendit, mbi të cilin është vendosur sekuestro, sendi i paluajtshëm, mbi të cilin është vendosur sekuestro, vlerësohet me vendim nga përmbaruesi gjyqësor, brenda 15 ditëve, në asistencën teknike të një eksperti të licencuar të fushës.

Në përcaktimin e vlerës së sendit, përmbaruesi gjyqësor bazohet në metodologjinë e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Përmbaruesi gjyqësor, brenda 10 ditëve nga data e caktimit të vlerës, njofton kreditorin dhe debitorin për çmimin e caktuar. Kundër vendimit të përmbaruesit gjyqësor palët mund të bëjnë ankim, sipas rregullave të parashikuara në nenin 610 të këtij Kodi.

Neni 565

Detyrimet e debitorit për sendin e lënë në ruajtje

Sendi që sekuestrohet i lihet në ruajtje debitorit derisa të bëhet shitja e tij, duke qenë i detyruar debitori të kujdeset për të, si për sendin e tij.

Në rast se debitori nuk kujdeset si duhet për sendin e lënë në ruajtje, përmbaruesi gjyqësor emëron një person tjetër për ruajtjen e tij, duke i caktuar një shpërblim. Emërimi dhe caktimi i shpërblimit bëhen në marrëveshje midis përmbaruesit dhe personit tjetër. Shpërblimi nxirret nga vlera e sendit të sekuestruar, pas shitjes së tij.

Debitori ose personi tjetër, të cilëve u është lënë në ruajtje sendi i paluajjtshëm i sekuestruar, duhet të japë llogari për të ardhurat e realizuara dhe shpenzimet e bëra për sendin. Ata përgjigjen sipas nenit 320 të Kodit Penal për veprime që bëhen pengesë për ekzekutimin e vendimit të gjykatës.

Neni 566

Pavlefshmëria e veprimeve juridike të debitorit për sendet e sekuestruara

Çdo veprim i debitorit, që përbën disponim të sendit të paluajjtshëm pas regjistrimit të sekuestrës në zyrën e regjistrimit të pasurisë së paluajjtshme, është i pavlefshëm kundrejt kreditorëve që kanë kërkuar ekzekutimin.

Neni 567

Procedura e shitjes në ankand

Pas vënies së sekuestrës, përmbaruesi gjyqësor i dërgon lajmërim debitorit se sendi i sekuestruar do të shitet, në qoftë se brenda 10 ditëve të njoftimit ai nuk e përmbush detyrimin.

Me kalimin e afatit të mësipërm, përmbaruesi gjyqësor bën shpalljen për shitjen e sendit në ankand.

Neni 568

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008; shtuar fjalë në fund të paragrafit të parë, me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013)

Shpallja për shitjen në ankand afishohet në zyrën e përmbaruesit gjyqësor dhe në vendin ku ndodhet sendi i paluajjtshëm, gjykatë, komunë, bashki, njësitë bashkiake dhe në një vend apo vende të tjera publike, që ai i çmon të përshtatshme, si dhe për 5 ditë me radhë në dy gazeta kombëtare me tirazhin më të madh. Shpallja duhet të përmbajë emrin, atësinë dhe mbiemrin e pronarit të sendit, nëse për sendin është vënë hipotekë dhe për çfarë shume të hollash, çmimin e sendit me të cilin do të fillojë shitja, vendi, dita kur do të përfundojë shitja në ankand. Shitja nuk mund të bëhet para se të kenë kaluar 15 ditë nga shpallja e ankandit.

Për shpalljen e shitjes në ankand duhet të njoftohen edhe kreditorët që kanë hipotekë. Çmimi fillestar në ankand është 80 për qind i çmimit të përcaktuar, sipas nenit 564 të këtij ligji.

Neni 569

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008)

Shitja e sendit bëhet në zyrën e përmbaruesit gjyqësor ose në një vend tjetër publik, nëse është i përshtatshëm për zhvillimin e ankandit. Ajo vazhdon 15 ditë dhe përfundon me mbarimin e orarit zyrtar të ditës së fundit që tregohet në shpalljen për shitjen në ankand.

Neni 570

Secili ofertues që merr pjesë në ankand, përpara fillimit të ankandit duhet të depozitojë si garanci në zyrën e përmbarimit një shumë të hollash të barabartë me 10 për qind të çmimit të sendit të caktuar në shpallje. Kreditori nuk le garanci, në rast se kredia e tij e kalon masën e garancisë.

Neni 571

Procesverbali për zhvillimin e ankandit

Për zhvillimin e ankandit mbahet procesverbal, në të cilin ofertuesit shënojnë, kundrejt nënshkrimit, çmimin që japin për sendin, pavarësisht nga çmimi që ka dhënë më parë. Kur ofertuesi vepron me përfaqësues, duhet të paraqitet edhe prokura noteriale.

Neni 572

Pavlefshmëria e shitjes në ankand

Debitori, përfaqësuesi i tij ligjor, përmbaruesi gjyqësor si edhe personat e tjerë që tregohen në nenin 709 të Kodit Civil, nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ankand.

Kur sendi blihet nga një person që nuk ka të drejtë të marrë pjesë në ankand, shitja është e pavlefshme. Në këtë rast, shuma e lënë si garanci nga blerësi kalon në dobi të shtetit dhe sendi me kërkesë të secilit kreditor mund të shitet përsëri në ankand, duke vepruar sipas rregullave të caktuara në këtë kapitull.

Neni 573

Shpallja e fituesit të ankandit

(Ndryshuar paragrafi i fundit me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008)

Në përfundim të ankandit, përmbartuesi gjyqësor shpall fituesin. Blerës i sendit është ai ofertues që ka dhënë çmimin më të lartë.

Pronësia mbi sendin i kalon blerësit vetëm pasi të ketë paguar të gjithë çmimin, duke zbritur prej tij shumën e lënë si garanci.

Garancitë e lëna nga persona të tjerë që kanë marrë pjesë në ankand, u kthehen atyre menjëherë pas përfundimit të ankandit.

Rregullat e hollësishme për zhvillimin e ankandit përcaktohen me udhëzim të Këshillit të Ministrave.

Neni 574

Afati i pagimit të çmimit të blerjes

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008)

Blerësi duhet të paguajë çmimin e sendit të blerë brenda 15 ditëve nga mbarimi i ankandit.

Me pagimin e çmimit dhe taksës mbi aktet për shitjen e sendit, përmbartuesi gjyqësor jep vendim për kalimin e sendit në pronësi të blerësit. Nga kjo ditë, blerësi fiton të gjitha të drejtat që kishte mbi sendin debitor.

Neni 575

Vënia në posedim të sendit të blerë

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008)

Blerësi vihet në posedim të sendit nga përmbartuesi gjyqësor brenda 10 ditëve nga pagimi i çmimit të sendit si kundrejt debitorit ose personit të cilit i është lënë në ruajtje, ashtu edhe kundrejt çdo personi të tretë që ka në posedim sendin. Personi i tretë për heqjen e sendit nga posedimi, mund të mbrohet vetëm me padinë për njohjen e së drejtës së pronësisë mbi sendin.

Neni 576

Moskthimi i garancisë

Blerësi, që nuk paguan çmimin brenda afatit të caktuar në nenin 574 humbet të drejtën e kthimit të shumës së lënë si garanci, e cila kalon në dobi të shtetit dhe për shitjen e sendit bëhet një ankand i ri, duke vepruar sipas rregullave të caktuara në këtë kre.

Neni 577

Përsëritja e ankandit

(Ndryshuar paragrafi i parë me ligjet nr. 10 052, datë 29.12.2008 dhe nr. 122/2013, datë 18.4.2013; ndryshuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 114/2016, datë 3.11.2016)

Në rast se në ankandin e parë nuk është paraqitur asnjë ofertues, atëherë, brenda 10 ditëve nga përfundimi i tij, përmbartuesi gjyqësor përcakton çmimin e ri të sendit, jo më të ulët se 30 për qind të çmimit fillestar të caktuar në ankandin e parë. Ankandi i dytë për shitjen e sendit bëhet sipas rregullave të përcaktuara në nenin 568 të këtij Kodi dhe zhvillohet 30 ditë nga e nesërmja e datës së caktimit të çmimit të ri.

Në rast se në ankandin e dytë nuk është paraqitur asnjë ofertues, atëherë, brenda 10 ditëve nga përfundimi i tij, përmbartuesi gjyqësor cakton çmimin e ri të sendit, jo më të ulët se 10 për qind të çmimit të përcaktuar nga përmbartuesi, në ankandin e dytë.

Ankandi i tretë për shitjen e sendit bëhet sipas rregullave të përcaktuara në paragrafin e parë të nenit 568, të këtij Kodi, dhe zhvillohet jo më vonë se 30 ditë nga e nesërmja e datës së caktimit të çmimit të ri.

Në rast se në ankandin e tretë nuk është paraqitur asnjë ofertues, përmbaruesi gjyqësor i propozon në fillim kreditorit, që, kundrejt kredisë, të marrë sendin me çmimin e ankandit të tretë. Në rast se kreditori, brenda 30 ditëve nga marrja e propozimit nuk pranon ta marrë sendin, përmbaruesi gjyqësor heq sekuestron mbi sendin e sekuestruar dhe vijon procedurat përmbarimore mbi pasuri të tjera të debitorit.

Kur kreditorët që kërkojnë të marrin sendin kundrejt kredisë janë disa, përmbaruesi gjyqësor deklaron blerës kreditorin që brenda 3 ditëve nga propozimi jep çmimin më të lartë se çmimi i caktuar për ankandin e ri.

Neni 578

Ekzekutimi mbi një send të paluajtshëm në bashkëpronësi

(Ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Kur ekzekutimi bëhet mbi një send të paluajtshëm që është në bashkëpronësi, për detyrimin që ka ndonjë nga bashkëpronarët bëhet sekuestrimi i sendit. Përmbaruesi gjyqësor i bën kërkesë gjykatës për veçimin e pjesës takuese të debitorit bashkëpronar dhe mbi këtë pjesë bëhet ekzekutimi. Sendi mund të shitet në tërësi, kur për këtë kanë dhënë pëlqimin të gjithë bashkëpronarët e tjerë. Pëlqimi duhet të jepet me akt noterial.

Kur sendi është në bashkëpronësi dhe debitorët janë të gjithë bashkëpronarët, për sekuestron dhe shitjen e sendit veprohet njëloj sikur sendi të ishte në pronësi të një debitorit të vetëm.

Neni 579

Diferenca midis detyrimit dhe çmimit të sendit

Kur shuma e realizuar nga shitja në ankand është më e madhe se shuma e kredisë së kreditorit apo kreditorëve, diferenca i kthehet debitorit, pasi zbriten shpenzimet e bëra për ruajtjen e sendit apo për zhvillimin e ankandit.

Neni 580

Kundërshtimi i pronësisë së sendit të shitur në ankand e të veprimeve të përmbaruesit gjyqësor

Shitja e sendit të paluajtshëm në ankand nuk ndalon personin e tretë i cili pretendon se është pronari i tij që ta kërkojë sendin me padi.

Kundër shitjes në ankand mund të bëhet ankim në gjykatë në formën e kundërshtimit të veprimeve të përmbaruesit gjyqësor. Vlefshmëria e shitjes në ankand mund të kundërshtohet me anë padie, sipas rregullave të përgjithshme, vetëm për rastin e parashikuar nga neni 556 i këtij Kodi.

KREU IV

EKZEKUTIMI MBI KREDITË E DEBITORIT DHE MBI SENDET QË PERSONAT E TRETË I DETYROHEN DEBITORIT

Neni 581

Deklarimi i pasurive të debitorit

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008)

Përpara se të vihet sekuestroja, përmbaruesi gjyqësor sigurohet për ekzistencën e kredive të debitorit dhe të sendeve, që personat e tretë i detyrohen atij.

Për këtë përmbaruesi gjyqësor njofton me shkresë personin e tretë dhe debitorin. Me marrjen e lajmërimit, pala debitore duhet të deklarojë pranë përmbaruesit gjyqësor se informacioni i paraqitur, për pasuritë e tij/saj apo të lëna në posedim personave të tretë, është i saktë e i plotë. Me marrjen e lajmërimit të sekuestrimit, personi i tretë ndalohet t'ia dorëzojë debitorit kredinë dhe sendet e tij.

Kur debitori është person juridik, deklarimi i pasurisë mund të bëhet nga një anëtar i organit drejtues, që, sipas ligjit ose statutit, ka të drejtën e përfaqësimit kundrejt të tretëve ose, në rastin e procedurave të shpërndarjes apo të falimentimit të personit juridik, mund të bëhet nga likuidatori apo administratori i falimentimit.

Ndaj debitorit, i cili jep deklarim të rremë, zbatohet neni 320 i Kodit Penal.

Neni 582

Përpara se të vihet sekuestro mbi këto sende, përmbaruesi gjyqësor sigurohet mbi ekzistencën e kredive të debitorit dhe të sendeve që personat e tretë i detyrohen atij, në bazë të dokumenteve dhe të dhënave të tjera të siguruar kryesisht nga përmbaruesi.

Neni 583

Kundërshtimi i personit të tretë

(Ndryshuar paragrafi i dytë dhe i tretë me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Personi i tretë, brenda pesë ditëve nga lajmërimi i sekuestrimit, është i detyruar t'i përgjigjet përmbaruesit gjyqësor:

a) nëse pranon se kredia ose sendet, mbi të cilat është vendosur sekuestroja, janë të debitorit dhe nëse është gati të shlyejë kredinë ose të dorëzojë sendet;

b) nëse mbi kredinë ose mbi sendet kanë pretendime edhe persona të tjerë;

c) nëse mbi kredinë ose mbi sendet është vënë sekuestër edhe në bazë të një urdhri tjetër ekzekutimi.

Personi i tretë dhe, kur ky është institucion apo ndërmarrje shtetërore, personi përkatës, që nuk jep përgjigje brenda afatit të mësipërm, dënohen nga përmbaruesi gjyqësor me gjobë nga 1 000 deri në 50 000 lekë. Kjo pasojë duhet të përmendet në lajmërimin e sekuestrimit.

Kundër vendimit të përmbaruesit mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 5 ditëve nga komunikimi i tij.

Neni 584

Kur personi i tretë në përgjigjen e tij nuk kundërshton që kredia ose sendet të jenë të debitorit, detyrohet t'ia dorëzojë këto përmbaruesit gjyqësor, i cili vepron sipas rregullave të mësipërme.

Neni 585

Kur personi i tretë në përgjigjen e tij kundërshton që kredia ose sendet të jenë të debitorit, ekzekutimi mbi to nuk mund të vazhdojë dhe kreditori duhet të ngrejë padi për të vërtetuar se kredia ose sendet që ka personi i tretë janë të debitorit të tij.

Neni 586

Kredia e siguruar me peng ose me hipotekë

Kur kredia e sekuestruar është siguruar me peng, personi që mban sendin mbi të cilin është vënë peng detyrohet të mos ia dorëzojë këtë send asnjë personi pa urdhrin e përmbaruesit gjyqësor.

Kur kredia e sekuestruar është siguruar me hipotekë, në regjistrat e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme duhet të bëhet shënim për vënien e sekuestrës.

Neni 587

Sekuestroja mbi shpërblimet e tjera

Sekuestroja mbi pagën shtrihet jo vetëm në pagën që tregohet në lajmërimin e sekuestrimit, por edhe në çdo shpërblim tjetër që debitori merr nga e njëjta punë ose nga një punë tjetër, në të njëjtin person fizik apo juridik, shtetëror apo privat.

Kur debitori ndërron vendin e punës, lajmërimi i sekuestrimit i dërgohet qendrës së re të punës nga qendra ku punonte më parë debitori dhe quhet se i është dërguar nga përmbaruesi gjyqësor. Në këtë rast si dhe në rastin që debitori pushohet nga puna duhet të lajmërohet përmbaruesi gjyqësor brenda pesë ditëve.

Neni 588

Përgjegjësia për moszbatimin e urdhrin të përmbaruesit

(Ndryshuar fjalë në paragrafin e parë dhe shtuar një paragraf pas paragrafit të parë me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Kur personi kompetent, në qendrën e punës në të cilën punon debitori, nuk bën ndalesat nga paga e debitorit, sipas lajmërimin të përmbaruesit gjyqësor ose nuk lajmëron përmbaruesin gjyqësor për kalimin

e debitorit në një punë tjetër ose për pushimin e tij nga puna, dënohen nga përmbaruesi gjyqësor me gjobë deri në 30 000 lekë.

Kundër vendimit të përmbaruesit mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 5 ditëve nga komunikimi i tij.

Personi i dënuar ka të drejtë të kërkojë shkarkimin e tij nga dënimi, sipas rregullave të caktuara në nenin 169 të këtij Kodi.

KREU V **EKZEKUTIMI I DETYRIMEVE NË TË HOLLA NDAJ INSTITUCIONEVE BUXHETORE**

Neni 589

Ekzekutimi ndaj detyrimeve të shtetit

(Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001 dhe ndryshuar paragrafi i fundit me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008)

Ekzekutimi i detyrimeve në të holla ndaj institucioneve buxhetore bëhet vetëm në llogarinë e tyre përkatëse bankare, në kredi që ata kanë të tretët dhe kur nuk ka të tilla në llogari të thesarit. Nuk lejohet ekzekutimi i detyrueshëm mbi pasurinë e luajtshme e të paluajtshme të institucionit buxhetor.

Kur institucioni buxhetor nuk ka gjendje në llogarinë bankare, as kredi të tretët dhe as në thesar, i kërkohet organit epror financiar përkatës të caktojë fondin e nevojshëm e kapitullin e buxhetit të subjektit nga do të shlyhet detyrimi ose financim të veçantë nga Buxheti i Shtetit.

Kur detyrimi i shteti është në metale të çmuara, ekzekutimi bëhet me pëlqimin paraprak të Ministrisë të Financave.

Këshilli i Ministrave nxjerr udhëzim për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit.

Neni 590

Ekzekutimi i detyrueshëm ndaj kredive të caktuara të debitorit të huaj bëhet vetëm kur nuk ka ndalim ose kufizim me ligj të veçantë ose me marrëveshje ndërkombëtare shtetërore.

Neni 591

Ekzekutimi ndaj detyrimeve të shtetit

(Shfuqizuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Neni 592

Ekzekutimi kur personi juridik shpërndahet ose falimenton

Kur detyrimi rëndon mbi një person juridik që shpërndahet ose falimenton, ekzekutimi bëhet nëpërmjet organit që realizon këto veprime, sipas dispozitave të veçanta.

KREU VI **EKZEKUTIMI MBI SHUMAT E LLOGARIVE NË BANKA**

Neni 593

Detyrimet e bankave për të informuar zyrat e përmbarimit

(Ndryshuar me ligjet nr. 8812, datë 17.5.2001 dhe nr. 10 052, datë 29.12.2008)

Përmbaruesi gjyqësor, njofton të gjitha bankat shtetërore dhe private të cilat janë të detyruara të informojnë zyrën përkatëse të përmbarimit kur kanë llogari, depozita ose kredi në emër të debitorit, në të kundërt përgjigjen sipas dispozitave të Kodit Penal.

Neni 594

Vënia e sekuestros mbi llogarinë e debitorit

Banka, me të marrë urdhrin e ekzekutimit, ve sekuestro mbi llogarinë, depozitat dhe kreditë e debitorit në masën e nevojshme për ekzekutimit e detyrimit, pa pezulluar pagimin e kredive që sipas nenit 605 të Kodit Civil paguhen me preferim ndaj kredisë për të cilën është vënë sekuestro.

Neni 595

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008)

Shumat e nxjerra nga llogaria, depozitat dhe kreditë e debitorit kalojnë në llogarinë e kreditorit në të njëjtën bankë ose në një bankë tjetër ose kur nuk ka të tilla në llogari të zyrës së përmbartimit ose në llogari të përmbartuesit gjyqësor.

Neni 596

Rastet e kthimit të urdhrin të ekzekutimit debitorit

(Shfuqizuar me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008)

Neni 597

Respektimi i radhës së preferimit

(Ndryshuar fjalë me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Kur shuma e llogarive, depozitave ose kredive nuk është e mjaftueshme për të shlyer detyrimet e paraqitura për ekzekutim, përmbartuesi gjyqësor respekton radhën e preferimit që përcaktohet në nenin 605 të Kodit Civil.

Neni 598

Sanksionet dhe ankimi ndaj tyre

Kur përmbartuesi ka bazë të dyshojë se banka pa vend nuk e ekzekuton detyrimin tërësisht ose pjesërisht, shkel afatet e ekzekutimit, ose nuk respekton radhën e preferimit, përmbartuesi ka të drejtë të verifikojë në vend dokumentacionin bankar në prani të punonjësit të ngarkuar nga organi drejtues i bankës, duke mbajtur procesverbalin përkatës.

Kur konstatohen shkelje apo parregullsi përmbartuesi fikson në procesverbal veprime dhe afate të detyrueshme për bankën.

Për shkeljet dhe parregullsitë përmbartuesi ka të drejtë të zbatojë masat e parashikuara në nenin 588 të këtij Kodi, sipas rastit, ndaj punonjësit bankar fajtor ose ndaj organit drejtues të saj, që ka urdhëruar veprime të parregullta.

Neni 599

Kundër vendimit të dënimit me gjobë mund të bëhet ankimi i veçantë në gjykatën e shkallës së parë brenda pesë ditëve nga marrja dijeni e dënimit.

Neni 600

Banka nxjerr udhëzimet e nevojshme

Banka e Shqipërisë nxjerr udhëzimet e nevojshme për mënyrën e zbatimit të dispozitave të mësipërme, të detyrueshme për të gjithë sistemin bankar.

KREU VII

EKZEKUTIMI I DETYRIMIT PËR DORËZIMIN E NJË SENDI TË CAKTUAR

Neni 601

Vënia në posedim e sendit të luajtshëm

Kur sendi i luajtshëm, për të cilin është dhënë vendim, nuk është dorëzuar vullnetarisht nga debitori, brenda afatit të caktuar në lajmërimin e përmbartuesit gjyqësor, merret në mënyrë të detyrueshme prej tij dhe i dorëzohet kreditorit.

Kur sendi nuk ndodhet pranë debitorit ose është prishur, ose pranë tij ndodhet vetëm një pjesë, merret nga debitori vlefata e sendit ose e pjesës që mungon. Kur në urdhrin e ekzekutimit nuk tregohet vlefata e sendit, kjo caktohet nga gjykata e vendit të ekzekutimit, pasi të dëgjohen palët dhe, në rast nevojë, të pyeten edhe dëshmitarë dhe ekspertë. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim i veçantë.

Neni 601/a

(Shtuar me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008)

Sendet e luajtshme, që ndodhen brenda sendit të paluajtshëm, të vënë në posedim, sipas nenit 602 të këtij Kodi, duhet të zhvendosen në përgjegjësinë e përmbaruesit dhe t'i dorëzohen debitorit ose familjarëve të tij menjëherë. Në rast se debitori ose familjarët e tij nuk janë të pranishëm gjatë lirit, përmbaruesi mund t'i magazinojë pasuritë e luajtshme në:

- a) mjedisin e liruuar, në marrëveshje me kreditorin, për një periudhë kohe prej 2 muajsh;
- b) në mjediset, që disponon shërbimi përmbarimor, për ruajtjen e sendeve, për një periudhë kohe prej 2 muajsh;
- c) në një vend neutral, ku sendet e luajtshme mund të ruhen në mënyrë të sigurt, për një periudhë kohe prej 2 muajsh;
- ç) në rezervat e shtetit, sipas rregullave në fuqi për ruajtjen e sendeve.

Për magazinimin e sendeve, sipas shkronjave "b" dhe "c" të këtij neni, shpenzimet paguhen nga debitori në çastin e marrjes në dorëzim të sendeve.

Nëse brenda 2 muajve nga lirimi, debitori nuk i kërkon sendet e tij të luajtshme, sipas shkronjave të mësipërme, apo nuk paguan të gjitha shpenzimet e lirit dhe të magazinimit, sipas shkronjave "b" dhe "c" të këtij neni, sendet e luajtshme, të sekuestrueshme, do të shiten nga përmbaruesi gjyqësor, sipas dispozitave të pjesës IV të kreut II të këtij Kodi. Përmbaruesi, pasi zbret nga shuma e përfituar nga shitja me ankand të gjitha shpenzimet për lirimin dhe magazinimin e sendeve të debitorit, derdh pjesën që mbetet në një llogari bankare, në emër të debitorit. Sendet e pasekuestrueshme i kthehen debitorit, pavarësisht vendit se ku ruhen, pa i kërkuar atij që të paguajë shpenzimet.

Sendet e luajtshme, të ndodhura brenda sendit të paluajtshëm, që nuk mund të shiten dhe nuk kërkohen nga debitori, asgjësohen apo i kalojnë institucioneve shtetërore ose enteve publike shtetërore kalim kapital.

Neni 602

Vënia në posedim e sendit të paluajtshëm

Kur sendi i paluajtshëm, për të cilin është dhënë vendim, nuk është liruuar vullnetarisht nga debitori brenda afatit të caktuar në lajmërimin e përmbaruesit gjyqësor, kreditori vihet në posedim të sendit. Për këtë përmbaruesi gjyqësor, të paktën tri ditë përpara, i njofton debitorit ditën dhe orën, në të cilën do të vërë kreditorin në posedim të sendit.

Në ditën dhe orën e caktuar përmbaruesi gjyqësor, i pajisur me urdhrin e ekzekutimit, shkon në vendin ku ndodhet sendi dhe vë kreditorin në posedim të tij, duke porositur personat e tjerë të cilët mbajnë sendin që ta njohin si pronar kreditorin.

Neni 603

Vënia në posedim e sendit të ndodhur te personi i tretë

Kur përmbaruesi gjyqësor konstaton se sendi i paluajtshëm ndodhet në posedim të një personi të tretë, i cili ka fituar për vete posedimin e sendit, pas fillimit të çështjes për të cilën është dhënë vendimi që ekzekutohet, e vë kreditorin në posedim të sendit, duke treguar në vendim se si ka konstatuar kohën në të cilën personi i tretë ka fituar posedimin.

Neni 604

Përgjegjësia penale e debitorit dhe e personit të tretë

Kur debitori ose personi i tretë, të cilit i është hequr posedimi i sendit të paluajtshëm, vihet përsëri me çdo mënyrë të paligjshme në posedimin e këtij sendi, përmbaruesi gjyqësor, me kërkesën e kreditorit, i heq atij përsëri posedimin e sendit.

Në këto raste, debitori ose personi i tretë kanë përgjegjësi, sipas dispozitave të Kodit Penal.

KREU VIII

EKZEKUTIMI I DETYRIMIT PËR KRYERJEN E NJË VEPRIMI TË KAKTUAR

Neni 605

Rastet kur lejohet kreditori të kryejë vetë ekzekutimin

Kur debitori nuk ekzekuton detyrimin e tij, që ka të bëjë me një veprim që mund ta kryejnë edhe persona të tjerë, kreditori mund të kërkojë nga përmbaruesi gjyqësor që të lejohet ta kryejë vetë këtë veprim për llogari të debitorit.

Neni 606

Sanksionet për moskryerjen e veprimit nga debitori

(Ndryshuar me ligjet nr. 8431, datë 14.12.1998 dhe nr. 8812, datë 17.5.2001)

Ndaj debitorit që refuzon, kryen në mënyrë të parregullt, nuk respekton afatet ose kryen të kundërtën e asaj që me vendim të gjykatës është i detyruar, kur nuk ka vend për përgjegjësi penale, përmbaruesi gjyqësor ka të drejtën e gjobitjes deri 50 000 lekë në çdo rast deri në ekzekutimin e detyrimit.

Kundër vendimit të përmbaruesit gjyqësor mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 5 ditëve nga komunikimi i tij.

Ndaj personave të tjerë, që sipas urdhrit të ekzekutimit ose ligjit janë të detyruar të kryejnë veprime të caktuara, në rastet e përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni, përmbaruesi gjyqësor ka të drejtën e gjobitjes deri në 50.000 lekë.

Kundër vendimit të përmbaruesit mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 5 ditëve nga komunikimi i tij.

Neni 607

(Shfuqizuar me ligjin nr. 8431, datë 14.12.1998)

Neni 608

Ankimi

(Shfuqizuar me ligjin nr. 8431, datë 14.12.1998)

KREU IX

MJETET E MBROJTJES KUNDËR EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE

Neni 609

Pavlefshmëria e titullit ekzekutiv

(Ndryshuar me ligjet nr. 10 052, datë 29.12.2008, nr. 122/2013, datë 18.4.2013 dhe nr. 114/2016, datë 3.11.2016)

Debitori mund të kërkojë në gjykatën kompetente të vendit të ekzekutimit që të deklarohet se titulli ekzekutiv është i pavlefshëm ose se detyrimi nuk ekziston, ose ekziston në një masë më të vogël ose është shuar më pas. Afati për të paraqitur këtë kërkesëpadi është 30 ditë nga marrja dijeni për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm.

Kur titulli ekzekutiv është një vendim gjyqësor ose vendim arbitrazhi, debitori mund të kundërshtojë ekzekutimin e titullit vetëm për fakte të ngjara pas dhënies së këtyre vendimeve.

Në këto raste, gjykata mund të vendosë pezullimin e vendimit me ose pa garanci. Kur titulli ekzekutiv është një akt për dhënien e kredive bankare ose akt për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare, gjykata mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit, vetëm me garanci dhe për një periudhë jo më shumë se 3 muaj, përveç rasteve kur gjykata, brenda këtij afati, vendos me vendim përfundimtar pranimin e padisë. Me kalimin e afatit 3-mujor, ose kur gjykata, brenda këtij afati, vendos refuzimin e padisë ose pushimin e gjykimit të saj, masa për pezullimin e ekzekutimit të vendimit konsiderohet e rënë nga fuqia. Pezullimi i vendimit nuk vendoset nga gjykata kur debitori pretendon se detyrimi i caktuar në titullin ekzekutiv, i cili është një akt për dhënien e kredive bankare ose akt për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare, ekziston në një masë më të vogël.

Gjykata shqyrton kërkesat për pezullimin, sipas këtij neni, brenda 5 ditëve. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim i veçantë. Gjykata e apelit e shqyrton ankimin, brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të tij në këtë gjykatë.

Kundër vendimit përfundimtar të gjykatës mund të bëhet ankim, sipas rregullave të ankimit të përgjithshëm. Gjykata e apelit e shqyrton ankimin, brenda 60 ditëve nga data e depozitimit të tij në këtë gjykatë.

Neni 610

Kundërshtimi i veprimeve të përmbaruesit gjyqësor

(Ndryshuar me ligjet nr. 8812, datë 17.5.2001, nr. 10 052, datë 29.12.2008, nr. 122/2013, datë 18.4.2013 dhe nr. 114/2016, datë 3.11.2016, shtuar paragrafi i tretë pas paragrafit të dytë me ligjin nr. 44/2021, datë 23.3.2021)

Kundër veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, të kryera në kundërshtim me procedurat e parashikuara nga ky Kod dhe kundër refuzimit të përmbaruesit gjyqësor për të kryer një veprim që ia ngarkon ligji, palët mund të bëjnë ankim në gjykatën që ekzekuton vendimin, brenda 5 ditëve nga dita e kryerjes së veprimit ose refuzimit, kur palët kanë qenë të pranishme në kryerjen e veprimit ose kanë qenë thirrur, dhe, në raste të tjera, nga dita që u është njoftuar ose kanë marrë dijeni për veprimin ose refuzimin.

Kundër veprimeve të personave, përmbaruesit gjyqësorë, që ushtrojnë veprimtarinë publike të shërbimit përmbarimor gjyqësor të organizuar mbi baza private, pala debitore mund të paraqesë ankim në gjykatën, ku ekzekutohet titulli ekzekutiv, brenda 5 ditëve nga data e kryerjes së veprimit.

Ankimet kundër veprimeve ose refuzimit të përmbaruesit gjyqësor shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar i vetëm gjatë gjithë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv kur veprimet ose refuzimi i përmbaruesit gjyqësor lidhet me të njëjtin titull ekzekutiv, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

Ankimi shqyrtohet brenda 20 ditëve nga gjykata e vendit të ekzekutimit, e cila kur e sheh të nevojshme mund të thërrasë palët dhe përmbaruesin gjyqësor.

Ankimi kundër veprimeve ose refuzimit të përmbaruesit gjyqësor nuk pezullon ekzekutimin, përveç kur gjykata vendos ndryshe. Kur titulli ekzekutiv është një akt për dhënien e kredive bankare ose akt për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare dhe gjykata ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit, masa e pezullimit konsiderohet e rënë nga fuqia me kalimin e 20 ditëve nga momenti i dhënies së vendimit të pezullimit.

Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim i veçantë.

Shqyrtimi i ankimit ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, si rregull, bëhet nga gjykata e apelit pa praninë e palëve, brenda 30 ditëve.

Përfundimisht, gjykata e apelit mund të vendosë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve brenda 45 ditëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se:

a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën e shkallës së parë, në afatet e parashikuara;

b) vendimi, kundër të cilit është paraqitur ankim, është bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë;

c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë.

Neni 611

Ankimi ndaj vendimit të gjykatës

(Shfuqizuar me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013)

Neni 612

Padia për kërkimin e sendit nga personi i tretë

Çdo person i tretë që pretendon se është pronar i sendit mbi të cilin bëhet ekzekutimi, mund të ngrejë padi për të ushtruar të drejtën e tij dhe kur është rasti për të përjashtuar sendin nga sekuestrimi dhe shitja.

Padia ngrihet kundër kreditorit dhe debitorit në gjykatën e vendit të ekzekutimit të vendimit. Në këto raste, gjykata mund të vendosë si masë të përkohshme pezullimin e ekzekutimit me ose pa garanci.

Neni 613

Efektet juridike ndaj personit të tretë

Kur gjykata pranon se personi i tretë është pronar i sendit të luajshëm të sekuestruar, por në kohën që vendimi ka marrë formë të prerë sendi është shitur në dyqanin me shitje të lirë ose në ankand, personi i tretë ka të drejtë të kërkojë nga përmbaruesi gjyqësor çmimin e shitjes, në qoftë se nuk i është dhënë kreditorit, në të kundërt ka të drejtë të kërkojë prej debitorit atë që ka përfituar nga shitja e sendit.

Kur vërtetohet se kreditori ka ditur në kohën e shitjes së sendit të luajshëm se debitori nuk ishte pronar i tij, ai detyrohet t'i kthejë pronarit të mëparshëm çmimin që ka marrë nga shitja e sendit dhe në qoftë se sendi i është dhënë atij në vend të kredisë së tij, detyrohet t'i kthejë sendin. Në këto raste kreditori ruan të drejtën e tij të kredisë kundrejt debitorit.

Neni 614

Kur gjykata pranon se personi i tretë është pronar i sendit të paluajshëm të shitur në ankand dhe në bazë të vendimit që ka marrë formë të prerë, sendi i merret blerësit, ky ka të drejtë të kërkojë nga përmbaruesi gjyqësor çmimin që ka paguar në qoftë se ky nuk i është dhënë kreditorit. Kur ky i është dhënë kreditorit ka të drejtë të kërkojë prej tij si dhe nga debitori atë pjesë të çmimit që ka marrë nga shitja e sendit.

Blerësi ka të drejtë, po ashtu, të kërkojë nga organi shtetëror kompetent që t'i kthehen shumat që ai kishte paguar si taksë për kalimin e sendit në pronësi të tij.

Kur sendi i paluajshëm i është dhënë kreditorit kundrejt kredisë së tij, në bazë të vendimit të gjykatës, sendi i merret këtij, ky ruan të drejtën e tij, të kredisë kundrejt debitorit.

KREU X PEZULLIMI E PUSHIMI I EKZEKUTIMIT

Neni 615

Pezullimi i ekzekutimit

(Ndryshuar me ligjet nr. 10 052, datë 29.12.2008 dhe nr. 122/2013, datë 18.4.2013)

Ekzekutimi pezullohet:

- a) me vendim të gjykatës në rastet e parashikuara nga ligji;
- b) me kërkesë të kreditorit;
- c) me rastet e parashikuara nga shkronjat “c” dhe “ç” të nenit 297 të këtij Kodi, me përjashtim të shitjes në ankand të një sendi të paluajshëm, për të cilin është shpallur lajmërimi;
- ç) në raste të tjera të parashikuara nga ligji;
- d) kur përmbaruesi gjyqësor, vetë ose me kujdesin e kreditorit, nuk gjen pasuri të debitorit, brenda 6 muajve nga fillimi i ekzekutimit;
- dh) kur kreditori nuk paraqitet, pa shkaqe të arsyeshme, brenda 3 muajve nga njoftimi i dytë shkresor, bërë nga përmbaruesi gjyqësor.

Pas rënies së masës së pezullimit, ekzekutimi vazhdon nga veprimi procedural i mbetur në çastin e pezullimit.

Neni 616

Pushimi i ekzekutimit

(Shfuqizuar shkronja “d” me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008; ndryshuar shkronja “c”, me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013)

Ekzekutimi pushon:

- a) kur debitori i paraqet përmbaruesit gjyqësor dëftesën me nënshkrimin e kreditorit, të vërtetuar rregullisht, se ka paguar shumën që shënohet në urdhrin e ekzekutimit, ose kuitancë të zyrës postare ose shkresë të bankës me të cilat vërtetohet se shuma që shënohet në urdhrin e ekzekutimit është derdhur në dobi të kreditorit;
- b) kur kreditori heq dorë me shkresë nga ekzekutimi;
- c) kur gjykata deklaron, me një vendim gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 609 të këtij Kodi, se titulli ekzekutiv është i pavlefshëm, ose se detyrimi nuk ekziston, ose ekziston në një masë më të vogël, ose është shuar më pas;

c) kur me vendim të gjykatës që ka marrë formën e prerë, është pranuar padia e debitorit sipas nenit 610 të këtij Kodi, ose e personit të tretë sipas nenit 613 të këtij Kodi;

d) shfuqizuar.

Neni 617

Ankimi kundër pezullimit dhe pushimit të ekzekutimit

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008)

Pezullimi i ekzekutimit, përveç rastit kur vendoset nga gjykata, si dhe pushimi i ekzekutimit vendosen nga përmbaruesi gjyqësor.

Kundër këtyre vendimeve mund të bëhet ankim në gjykatën e shkallës së parë (neni 611 i këtij Kodi).

Kur vendimi i pushimit të ekzekutimit merr formën e prerë, përmbaruesi gjyqësor e heq sekuestron e vënë mbi sendet e luajtshme ose të paluajtshme dhe në rastin e parashikuar nga shkronja “b” e nenit 616 të këtij Kodi, i kthen urdhrin e ekzekutimit kreditorit, i cili ka të drejtë të paraqesë kërkesë të re për ekzekutim brenda kohës së parashkrimit. Në këtë rast, parashkrimi i ri fillon nga dita që vendimi për pushimin e ekzekutimit ka marrë formën e prerë.

KREU XI

DISPOZITA TRANZITORE DHE TË FUNDIT

Neni 618

Çështjet që janë në gjykim në ditën e hyrjes në fuqi të këtij Kodi do të gjykohen sipas kodit të mëparshëm derisa vendimi të marrë formën e prerë sipas nenit 451 të këtij Kodi.

Neni 619

Rekurset kundër vendimeve të gjykatës së apelit dhe kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë përpara Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë të regjistruara deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij Kodi do të shqyrtohen sipas dispozitave të kodit të mëparshëm.

Neni 620

Me hyrjen në fuqi të këtij Kodi shfuqizohen: ligji nr. 6341, datë 27.6.1981 “Për Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”, ligji nr. 7537, datë 17.12.1991 “Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”, ligji nr. 7922, datë 19.4.1995 “Për një ndryshim në Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”, kreu X/I “Amortizimi” nenet 59a, 59b, 59c të ligjit nr. 7782, datë 26.1.1994 “Për disa ndryshime në dekretin nr. 3702, datë 8.7.1963 “Për Çekun”, si dhe çdo dispozitë tjetër që vjen në kundërshtim me këtë Kod.

Dispozitë kalimtare

(Parashikuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001)

Çështjet civile që janë në gjykim ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që sipas Kodit të Procedurës Civile duhet të gjykohen me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, për të cilat ky ligj parashikon gjykimin e tyre me një gjyqtar, do të vazhdojnë të gjykohen nga i njëjti trup gjykues derisa vendimi të marrë formë të prerë.

Kërkesat që kanë të bëjnë me përjashtimin e gjyqtarit, kërkesëpaditë me objekt kundërshtimi i të tretit, rishikimi i vendimit, si dhe rekurset në interes të ligjit, të paraqitura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë të gjykohen sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile

Dispozitë kalimtare

(Parashikuar me ligjin nr. 10 052, datë 29.12.2008)

Çështjet që janë në procedurë ekzekutimi në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të ekzekutohen sipas procedurave ligjore të mëparshme, derisa ekzekutimi i urdhrin ekzekutiv të jetë pezulluar, pushuar ose të ketë përfunduar.

Dispozitë kalimtare

(Parashikuar me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013; ndryshuar me ligjin nr. 160/2013, datë 17.10.2013)

Çështjet civile që janë në gjykim në gjykatën e shkallës së parë dhe në gjykatën e apelit, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë të gjykohen sipas ligjit të kohës së paraqitjes së kërkesë-padisë.

Çështjet ende të paekzekutuara nga përmbaruesit gjyqësorë, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të ekzekutohen sipas këtij ligji.

Dispozita kalimtare të parashikuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017

Neni 108

Dispozitat kalimtare

Nenet 102, 103, 104, 105, 105/b, 106, 107 dhe 110, mbi tarifat dhe shpenzimet gjyqësore, hyjnë në fuqi ditën e hyrjes në fuqi të ligjit “Për tarifat gjyqësore”.

Nenet 102, 103, 104, 105, 105/b, 106, 107 dhe 110, mbi tarifat dhe shpenzimet gjyqësore, hyjnë në fuqi ditën e hyrjes në fuqi të ligjit “Për tarifat gjyqësore”.

Neni 109

1. Çështjet civile, që janë në gjykim ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji në gjykatën e shkallës së parë, në gjykatën e apelit ose në Gjykatën e Lartë, do të vazhdojnë të gjykohen sipas dispozitave të ligjit në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesë-padisë.

2. Çështjet civile, që shkojnë për gjykim në gjykatën e apelit ose në Gjykatën e Lartë, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të gjykohen sipas dispozitave ligjore, që janë në fuqi në kohën e paraqitjes së ankimit ose të rekursit.

3. Për çështjet civile, për të cilat është vendosur prishja e vendimit dhe dërgimi i çështjes për rigjykim, sipas neneve 467 dhe 485, shkronjat “c” dhe “ç”, të këtij Kodi, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, në rigjykim do të zbatohen dispozitat e këtij ligji.

4. Për procedurat që janë duke u gjykuar në datën e hyrjes në fuqi të neneve 399/1 – 399/12, afatet kohore sipas nenit 399/2 shtyhen:

a) në gjykimet administrative në shkallë të parë dhe në apel, 6 muaj;

b) në të gjithë shkallët e gjykimit civil, një vit e 6 muaj;

c) në procedurat e përmbarimit të një gjykimi civil ose administrativ, 6 muaj;

ç) në gjykimet penale të shkallës së parë një vit për krime, 6 muaj për kundërvajtje dhe në shkallën e dytë e në Gjykatën e Lartë, 6 muaj për krime dhe 3 muaj për kundërvajtje.

Dispozitë kalimtare me ligjin nr. 44/2021, datë 23.3.2021

1. Përbërja e trupave gjykues, si dhe procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera.

2. Rekursët e paraqitura, por ende të pashqyrtuara, konsiderohen të pranueshme nëse plotësojnë parashikimet e ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të tyre.

Neni 621

Ky Kod hyn në fuqi më 1 qershor 1996.

Shpallur me dekretin nr. 1474, datë 18.4.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.

LIGJ
Nr.7850, datë 29.7.1994

PËR KODIN CIVIL TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË¹

*(ndryshuar me ligjet nr. 8536, datë 18.10.1999, nr. 8781,
datë 3.5.2001, nr. 17/2012, datë 16.2.2012, nr.121/2013,
datë 18.4.2013, nr.113/2016, datë 3.11.2016)*

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË VENDOSI:

PJESA I
PJESA E PËRGJITHSHME

TITULLI I
SUBJEKTET E SË DREJTËS CIVILE

KREU I
PERSONAT FIZIKË

A. Zotësia juridike
Neni 1

Çdo person fizik gëzon zotësi të plotë e të barabartë për të patur të drejta dhe detyrime civile, brenda kufijve të caktuar me ligj.

Neni 2

Zotësia juridike fillon me lindjen e personit gjallë dhe mbaron me vdekjen e tij. Fëmija kur lind i gjallë gëzon zotësi juridike që nga koha e zënies.

Neni 3

Të huajt gëzojnë po ato të drejta e detyrime që u njihen shtetasve shqiptarë, përveç përjashtimeve të caktuara me ligj.

Neni 4

Personit fizik nuk mund t'i kufizohen të drejtat civile, përveç përjashtimeve të caktuara me ligj. Veprimi juridik që kufizon zotësinë juridike të një personi fizik, është i pavlefshëm.

B. E drejta e emrit

Neni 5

Çdo person fizik ka të drejtën dhe detyrimin të ketë emrin dhe mbiemrin e tij që i vihen sipas ligjit. Personi, të cilit i mohohet e drejta e përdorimit të tyre ose cenohet nga përdorimi që të tjerët i bëjnë padrejtësisht, mund të kërkojë në gjykatë përdorimin e emrit ose të mbiemrit të vet, pushimin e cenimit, si dhe shpërblimin e dëmit përkatës.

Kjo kërkesë mund të paraqitet edhe nga persona që, ndonëse nuk mbajnë emrin ose mbiemrin e cenuar, apo të përdorur padrejtësisht, kanë interesa familjare të denja për t' u mbrojtur.

Gjykata kur pranon padinë urdhëron botimin e vendimit në Fletoren Zyrtare. Me kërkesën e paditësit gjykata mund të urdhërojë botimin e vendimit të saj edhe në gazeta të tjera. Pseudonimi i përdorur nga personi fizik gëzon të njëjtën mbrojtje.

C. Zotësia për të vepruar

Neni 6

Personit, kur mbush moshën tetëmbëdhjetë vjeç, i lind zotësia e plotë që me veprimet e tij të fitojë të drejta dhe të marrë përsipër detyrime civile.

Zotësinë e plotë për të vepruar e fiton me anë të martesës edhe gruaja që nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç. Ajo nuk e humbet këtë zotësi edhe kur martesa është deklaruar e pavlefshme ose është zgjidhur para se të mbushë moshën tetëmbëdhjetë vjeç.

Neni 7

I mituri, që ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç, mund të kryejë veprime juridike vetëm me pëlqimin e mëparshëm të përfaqësuesit të tij ligjor. Megjithatë ai mund të bëjë pjesë në organizata shoqërore, të disponojë atë që fiton me punën e tij, të depozitojë kursimet dhe t'i disponojë vetë këto depozita.

Neni 8

I mituri që nuk ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç, është i pazoti për të vepruar. Ai mund të kryejë veprime juridike që i përshtaten moshës së tij dhe që përmbushen aty për aty, si dhe veprime juridike që i sjellin dobi pa asnjë kundërshtpërblim. Veprimet e tjera juridike i kryen në emër të tij përfaqësuesi ligjor.

Neni 9

I mituri me moshë katërmëdhjetë vjeç deri në tetëmbëdhjetë vjeç, që është i pazoti të kujdeset për punën e tij për shkak sëmundjesh psikike ose zhvillimi të metë mendor, mund t'i hiqet zotësia për të kryer veprime juridike me vendim të gjykatës. Këto veprime mund të kryhen vetëm nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor.

Neni 10

Personit madhor, që për shkak sëmundjeje psikike ose zhvillimi të metë mendor, është tërësisht ose pjesërisht i pazoti të kujdeset për punët e tij, mund t'i hiqet ose kufizohet zotësia për të kryer veprime juridike me vendim të gjykatës.

Neni 11

Veprimi juridik që kufizon zotësinë për të vepruar është i pavlefshëm.

Ç. Banimi dhe qëndrimi

Neni 12

Banimi është vendi ku personi, për shkak të punës apo të shërbimit të përhershëm, të ndodhjes së pasurisë apo të realizimit të interesave të veta, qëndron zakonisht ose të shumtën e kohës.

Çdo person madhor ka të drejtë të caktojë lirisht vendbanimin e tij.

Personi nuk mund të ketë njëkohësisht me shumë se një vendbanim.

Kjo dispozitë nuk zbatohet për vendbanimin e veprimtarisë së tregtarit.

Neni 13

I mituri që nuk ka mbushur moshën katërbëdhjetë vjeç, ka për banim atë të prindërve të tij.

Kur prindërit kanë banime të ndryshme, fëmija e tyre nën katërbëdhjetë vjeç ka për banim atë të prindit pranë të cilit jeton.

Personi të cilit i është hequr zotësia për të vepruar dhe fëmijët nën kujdestari kanë për banim atë të përfaqësuesit të tyre ligjor.

Neni 14

Vendqëndrimi i personit është vendi ku ai ndodhet për të kryer punë ose detyra të caktuara, për të vazhduar një shkollë ose kurs të caktuar, për t'u mjekuar, për të vuajtur një dënim penal, dhe për raste të tjera të kësaj natyre.

D. Shpallja e zhdukjes dhe e vdekjes së një personi

Neni 15

Personi që mungon nga vendi i banimit ose i vendqëndrimit të fundit të tij dhe për të cilin nuk ka lajme për më shumë se dy vjet, me kërkesën e çdo të interesuari mund të shpallet i zhdukur me vendim të gjykatës.

Kur dita e lajmeve të fundit nuk mund të caktohet, afati i mësipërm fillon nga dita e parë e muajit pasardhës në të cilin janë marrë lajmet e fundit. Kur muaji nuk mund të caktohet, afati fillon nga dita 1 janar e vitit të mëpasëm.

Neni 16

Me shpalljen e zhdukjes së një personi, për administrimin e pasurisë së tij caktohet një kujdestar.

Vendimi i gjykatës, me të cilin një person është shpallur i zhdukur, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i dërgohet për regjistrim zyrës së gjendjes civile përkatëse.

Neni 17

Personi që është shpallur i zhdukur, me kërkesën e çdo të interesuari, mund të shpallet i vdekur me vendim të gjykatës, kur kanë kaluar pa patur lajme katër vjet nga dita që është shpallur i zhdukur.

Neni 18

Personi që ka humbur gjatë veprimeve luftarake dhe kjo humbje vërtetohet nga organet kompetente ushtarake, në rast se kanë kaluar pa patur lajme dy vjet, nga dita që ka hyrë në fuqi marrëveshja e paqes ose tre vjet nga mbarimi i veprimeve luftarake, mund të shpallet i vdekur me vendim të gjykatës, pa qenë nevoja të shpallet më parë i zhdukur.

Neni 19

Personi që ka humbur gjatë një fatkeqësie natyrore ose në rrethana që bëjnë të besohet se ka vdekur, mund të shpallet si i tillë me vendim të gjykatës, kur kanë kaluar pa patur lajme dy vjet nga dita që ka ngjarë fatkeqësia, pa qenë e nevojshme të shpallet më parë i zhdukur.

Kur nuk caktohet dita në të cilën ka ndodhur fatkeqësia, afati dyvjeçar fillon nga dita e parë e muajit që vjen pas atij në të cilin ka ndodhur fatkeqësia dhe, kur nuk mund të caktohet as muaji, afati fillon nga dita e parë e muajit janar të vitit të mëpasëm.

Neni 20

Kur dy ose më shumë persona kanë vdekur dhe nuk mund të provohet kush prej tyre ka vdekur më parë, për efekte juridike, quhet se të gjithë kanë vdekur në një kohë.

Neni 21

Kur shpallet vdekja e një personi të zhdukur, caktohet dita se kur ka ngjarë ajo. Kur kjo ditë nuk është e mundur të vërtetohet me saktësi, gjykata e cakton atë sipas rregullave të parashikuara në nenet e këtij Kodi.

Me kërkesën e çdo të interesuari, gjykata që ka dhënë vendimin, mund të ndryshojë datën e vdekjes, kur vërtetohet se personi ka vdekur në një ditë tjetër.

Neni 22

Vdekja e shpallur me vendim të gjykatës barazohet në të gjitha pasojat juridike me vdekjen e vërtetë.

Vendimi i gjykatës me të cilin një person është shpallur i vdekur, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i dërgohet për regjistrim zyrës së gjendjes civile përkatëse.

Neni 23

Kur personi që është shpallur i vdekur del se është i gjallë, me kërkesën e tij ose të çdo të interesuari, vendimi priset nga gjykata që e ka dhënë.

Personi që del se është gjallë ka të drejtë të kërkojë pasurinë e tij dhe pasurinë e fituar me anë të saj, qoftë edhe nga personat e tretë që e kanë fituar nga ata, të cilëve u ka kaluar kjo pasuri për shkak të deklaramit të vdekjes së tij, në kufijtë dhe kushtet e parashikuara nga ky Kod e nga Kodi i Familjes.

KREU II PERSONAT JURIDIKË

A. Dispozita të përgjithshme Përmbajtja e personit juridik

Neni 24

Personat juridikë janë publikë dhe privatë.

Neni 25

Persona juridikë publikë janë institucionet e ndërmarrjet shtetërore, që financohen vetë ose nga buxheti i shtetit, si dhe entet e tjera publike të njohura nga ligji si person juridik.

Institucionet dhe entet shtetërore, që nuk ndjekin qëllime ekonomike, nuk regjistrohen.

Neni 26

Persona juridikë privatë janë shoqëritë, shoqatat, fondacionet dhe entet e tjera me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji.

Emri i personit juridik

Neni 27

Personi juridik ka emrin e tij të plotë dhe të shkurtuar. Emri i çdo shoqërie ose organizate tjetër që zhvillon veprimtari ekonomike është firma e saj, e cila duhet të shprehë sidomos qëllimin e kësaj veprimtarie.

Qendra e personit juridik

Neni 28

Personi juridik ka qendrën atje ku ndodhet organi drejtues i tij, përveç kur në statut ose në aktin e krijimit është parashikuar ndryshe.

Zotësia e personit juridik

Neni 29

Personi juridik ka zotësi të fitojë të drejta dhe të marrë përsipër detyrime civile që nga çasti i krijimit të tij dhe, kur ligji parashikon se duhet të regjistrohet, që nga çasti i regjistrimit.

Neni 30

Personi juridik mund të kryejë çdo veprim juridik të lejuar në ligj, në aktin e krijimit ose në statut.

Neni 31

Personi juridik vepron me anë të organeve të veta të parashikuara në ligj, në aktin e krijimit ose në statut, të cilët shprehin vullnetin e tij.

Veprimet juridike të kryera nga organet e personit juridik, brenda kompetencave të tyre, quhen si të kryera nga vetë personi juridik.

Përgjegjësia e personit juridik

Neni 32

Personi juridik është përgjegjës për dëmet e shkaktuara nga organet e tij gjatë përmbushjes së detyrave të tyre.

Personi juridik përgjigjet për detyrimet e tij brenda kufijve të pasurisë së tij. Personat që kanë vepruar me cilësinë e organit të personit juridik, kanë përgjegjësi vetjake për shpërblimin e dëmeve që janë shkaktuar për fajin e tyre.

Neni 33

Shteti dhe personat juridikë shtetërorë nuk përgjigjen për detyrimet e njëri-tjetrit, përveç kur kjo është pranuar prej tyre ose është parashikuar shprehimisht në ligj.

Mbarimi i personit juridik

Neni 34

Personi juridik mbaron sipas mënyrës së caktuar në aktin e krijimit, në statut ose në ligj.

Neni 35

Me mbarimin, personi juridik pushon veprimtarinë e tij dhe vihet në likuidim.

Neni 36

Kalimi i të drejtave dhe detyrimeve në rast mbarimi të personit juridik, për të cilin kërkohet regjistrimi, sjell pasoja nga koha e regjistrimit.

Kur nuk kërkohet regjistrimi, kalimi i të drejtave dhe i detyrimeve në rastet e parashikuara nga paragrafi i mësipërm, sjell pasoja nga koha e miratimit të bilancit përkatës, në mënyrën që parashikohet në ligj, nga organi përkatës që e ka krijuar ose në statut.

Likuidimi i personit juridik

Neni 37

Likuidimi i personit juridik që ka mbaruar bëhet me realizimin e të drejtave dhe pagimin e detyrimeve nga likuidatorë të caktuar nga organi që ka vendosur mbarimin e tij.

Komisioni bën likuidimin sipas dispozitave ligjore përkatëse, statutit ose aktit të themelimit.

Neni 38

Kur personi juridik mbaron për shkak se ka zhvilluar veprimtari të kundërligjshme, pasuria e mbetur pas likuidimit i kalon shtetit. Likuidimi i personit juridik që falimenton rregullohet me ligj.

B. Shoqatat Krijimi i shoqatave

Neni 39

(Ndryshuar me ligjin nr.8781, datë 3.5.2001)

Shoqata është person juridik që krijohet me vullnetin e lirë të pesë ose më shumë personave fizikë ose jo më pak se dy personave juridikë që ndjekin një qëllim të caktuar, të ligjshëm, në të mirë dhe në interes të publikut ose të anëtarëve të saj.

Neni 39/1

(Shtuar me ligjin nr.8781, datë 3.5.2001)

Shoqata ka të drejtë të ketë në pronësi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, të realizojë të ardhura nëpërmjet administrimit të këtyre pasurive, si dhe ushtrimit të veprimtarive të tjera, në përputhje me ligjin dhe me qëllimin e objektin e veprimtarisë së shoqatës, të parashikuar në statutin e saj.

Të ardhurat e realizuara nga shoqata duhet të përdoren vetëm për realizimin e veprimtarive që parashikohen në qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së parashikuar në statutin e saj.

Nuk lejohet që shoqata të kryejë veprimtari fitimprurëse.

Neni 40

*(Shtuar paragraf dhe ndryshuar fjalia e parë
me ligjin nr.8781, datë 3.5.2001)*

Akti për krijimin e shoqatës, me kërkesë të themeluesve të saj, regjistrohet në gjykatë.

Rregullat për organizimin e funksionimin e shoqatës përcaktohen në statutin e saj, i cili duhet të hartohet me shkrim dhe të përmbajë sidomos:

a) emrin dhe qëllimin e shoqatës, qendrën e saj dhe territorin në të cilin do të zhvillojë veprimtarinë e vet;

b) kushtet e pranimit dhe të largimit të anëtarëve, si dhe të drejtat dhe detyrat e tyre;

c) organet drejtuese të shoqatës, mënyrën e formimit dhe kompetencat e tyre;

ç) afatet, mënyrën e thirrjes dhe kompetencat e mbledhjeve të përgjithshme dhe të delegatëve;

d) burimin e mjeteve materiale të saj, si dhe kontributet apo kuotat që duhet të japë çdo anëtar;

dh) mënyrën e ndryshimit të statutit dhe të mbarimit të shoqatës.

Neni 41

(Ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr.8781, datë 3.5.2001)

Shoqata themelohet nga mbledhja e themeluesve, në të cilën miratohet statuti dhe zgjidhen organet drejtuese të saj. Shoqata, me kërkesën e saj, regjistrohet në gjykatë sipas mënyrës së parashikuar në ligj.

Gjykata kontrollon pajtueshmërinë e statudit me ligjin.

Neni 42

(Ndryshuar me ligjin nr.8781, datë 3.5.2001)

Shoqata fiton cilësinë e personit juridik nga dita e regjistrimit të saj në gjykatë. Deri në ditën e regjistrimit, themeluesit e shoqatës mund të kryejnë veprimet që janë të nevojshme për themelimin dhe përmbushjen e kushteve për regjistrimin e saj.

Neni 43

(Ndryshuar me ligjin nr.8781, datë 3.5.2001)

Shoqata ka të drejtë të themelojë degë të saj kudo ku ajo e çmon të arsyeshme, për të realizuar qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së shoqatës.

Neni 43/1

(Shtuar me ligjin nr.8781, datë 3.5.2001)

Rastet dhe mënyrat e mbikëqyrjes së veprimtarisë së shoqatave nga organet kompetente shtetërore parashikohen shprehimisht në ligj.

Organizimi i shoqatës

Neni 44

Mbledhja e përgjithshme e anëtarëve ose e përfaqësuesve të tyre, është organi më i lartë i shoqatës.

Ajo thirret nga organi drejtues, sipas dispozitave përkatëse të statudit, si dhe kur e kërkon një e pesta e anëtarëve.

Neni 45

Mbledhja e përgjithshme vendos për pranimin ose përjashtimin e anëtarëve dhe për çdo çështje tjetër, që nuk është lënë në kompetencën e ndonjë organi tjetër të shoqatës.

Ajo ushtron posaçërisht mbikëqyrjen mbi të ardhurat dhe veprimet e shoqatës, si dhe mbi objektet pasurore të saj.

Neni 46

(Ndryshuar paragrafi i dytë dhe shtuar paragrafi i tretë me ligjin nr. 8781, datë 3.5.2001)

Të gjithë anëtarët e shoqatës kanë të drejtë vote të barabartë në mbledhjen e përgjithshme.

Anëtari i shoqatës nuk merr pjesë në diskutim dhe votim në rastet kur vetë ose bashkëshorti, fëmijët, gjinia a krushqia e tij janë në konflikt interesash me shoqatën, lidhur me një çështje të rendit të ditës.

Miratohen me shumicën e të gjithë anëtarëve të shoqatës vendimet për ndryshimin e statutit dhe për shpërndarjen e shoqatës, përveç kur në statut parashikohet një shumicë më e lartë votimi.

Neni 47

Organi drejtues ka të drejtën dhe detyrën të kujdeset për interesat e shoqatës, t'i mbrojë ato, si dhe të përfaqësojë shoqatën sipas kompetencave që i janë dhënë nga statuti.

Anëtarësia në shoqatë

Neni 48

Pranimi i anëtarëve të rinj, që përmbushin kushtet e nevojshme, mund të lejohet në çdo kohë.

E drejta për të dhënë dorëheqjen është e garantuar, por me kusht që të jetë paraqitur së paku gjashtë muaj para mbarimit të vitit kalendarik ose brenda afatit të parashikuar në statut.

Neni 49

E drejta e anëtarësisë në shoqatë nuk mund të tjetërsohet dhe as të kalohet me anë trashëgimie.

Neni 50

(Ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr.8781, datë 3.5.2001)

Anëtari, që largohet ose përjashtohet nga shoqata, përgjigjet për detyrimet e saj ndaj të tretëve deri në çastin e largimit të tij dhe nuk ka të drejta mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të saj.

Ata kanë detyrën të derdhin kuotat për kohën gjatë së cilës kanë bërë pjesë në shoqatë.

Neni 51

Çdo anëtar ka të drejtë të kundërshtojë në gjykatën kompetente vendimet e shoqatës që vijnë në kundërshtim me ligjin ose me statutin.

Ky kundërshtim mund të bëhet brenda një muaji nga dita kur anëtari ka marrë njoftimin për atë vendim.

Shpërndarja

Neni 52

(Ndryshuar me ligjin nr. 8781, datë 3.5.2001)

Shpërndarja e shoqatës bëhet:

- a) me vendim të mbledhjes së përgjithshme të anëtarëve të saj;
- b) kur numri i anëtarëve është nën numrin minimal të caktuar në këtë Kod ose në statut;
- c) kur qëllimi i shoqatës është përmbushur ose nuk mund të përmbushet më;
- ç) kur vërtetohet se shoqata ka ushtruar veprimtari të kundërligjshme;
- d) në raste të tjera të parashikuara nga ligji.

Gjykata, në rastet e parashikuara në ligj, mund të vendosë shpërndarjen e shoqatës, me kërkesë të çdo anëtari të shoqatës, të organeve vendimmarrëse të saj, si dhe të organeve kompetente shtetërore.

Neni 53

(Ndryshuar me ligjin nr. 8781, datë 3.5.2001)

Kur vendoset shpërndarja e shoqatës, ajo vihet në likuidim dhe çregjistrohet sipas rregullave të parashikuara në ligj.

Neni 53/1

(Shtuar me ligjin nr. 8781, datë 3.5.2001)

Gjykata, pasi të ketë marrë mendimin e subjektit që ka kërkuar shpërndarjen e shoqatës, vendos për destinimin e pasurisë që mbetet pas shpërndarjes së saj, në përputhje me rregullat e parashikuara në statut, si dhe duke patur parasysh destinacionin e tyre dhe qëllimin themelor për të cilin është themeluar shoqata.

C. Fondacionet Mënyra e krijimit

Neni 54

(Ndryshuar me ligjin nr. 8781, datë 3.5.2001)

Fondacioni është person juridik pa anëtarësi që ka për objekt arritjen e një qëllimi të ligjshëm me anë të destinimit të pasurisë në të mirë dhe interes të publikut.

Neni 55

(Ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr. 8781, datë 3.5.2001)

Fondacionet krijohen nga persona fizikë ose juridikë me akt notetial ose me testament. Akti për krijimin e fondacionit, me kërkesë të themeluesve të tij, regjistrohet në gjykatë.

Në aktin e krijimit përcaktohen sidomos emrat e themeluesve, qëllimi i fondacionit, përbërësit e pasurisë (para, letra me vlerë, ose sende të luajtshme dhe të paluajtshme), burimet dhe mënyra e financimit, organet drejtuese, kompetencat e tyre, si dhe emrat e anëtarëve të administratës.

Neni 56

(Ndryshuar me ligjin nr. 8781, datë 3.5.2001)

Fondacioni fiton cilësinë e personit juridik që nga dita e regjistrimit në gjykatë. Deri në ditën e regjistrimit, themeluesit e fondacionit ose ekzekutori i testamentit mund të kryejnë veprimet që janë të nevojshme për themelimin dhe përmbushjen e kushteve për regjistrimin e tij.

Neni 56/1

(Shtuar me ligjin nr. 8781, datë 3.5.2001)

Fondacioni ka të drejtë të ketë në pronësi pasuri të luajshme dhe të paluajshme, të realizojë të ardhura nëpërmjet administrimit të këtyre pasurive, si dhe ushtrimit të veprimtarive të tjera, në përputhje me ligjin dhe qëllimin e objektin e veprimtarive të parashikuara në statutin e fondacionit.

Të ardhurat e realizuara nga fondacioni duhet të përdoren vetëm për realizimin e veprimtarive që parashikohen në qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së parashikuar në statutin e tij.

Nuk lejohet që fondacioni të kryejë veprimtari fitimprurëse.

Neni 57

Akti për krijimin e fondacionit mund të shfuqizohet nga themeluesit para regjistrimit ose kur ende nuk ka filluar veprimtarinë përkatëse.

Akti i krijimit të fondacionit mund të kundërshtohet nga trashëgimtarët ose nga kreditorët e themeluesit.

Ushtrimi i veprimtarisë të fondacionit

Neni 58

Organet e fondacionit, mënyra e formimit dhe kompetencat e tyre caktohen nga akti i krijimit.

Çdo fondacion kryen veprimtarinë e vet në bazë të dispozitave të legjislacionit në fuqi dhe të aktit të themelimit të tij.

Neni 59

(Ndryshuar me ligjin nr. 8781, datë 3.5.2001)

Rastet dhe mënyra e mbikëqyrjes së veprimtarisë së fondacioneve nga organet kompetente shtetërore parashikohen shprehimisht në ligj.

Neni 60

(Shfuqizuar me ligjin nr. 8781, datë 3.5.2001)

Neni 61

Mosmarrëveshjet pasurore, në të cilat fondacioni është palë, zgjidhen nga gjykata kompetente.

Neni 62

(Ndryshuar me ligjin nr. 8781, datë 3.5.2001)

Shpërndarja e fondacionit bëhet:

- a) me vendim të organit më të lartë vendimmarrës të tij;
- b) kur është përmbushur qëllimi për të cilin u themelua ose kur qëllimi i tij nuk mund të përmbushet më;
- c) kur vërtetohet se fondacioni ka filluar të ushtrojë veprimtari të kundërligjshme;
- ç) në raste të tjera të parashikuara me ligj.

Gjykata, në rastet e parashikuara me ligj, mund të vendosë shpërndarjen e fondacionit me kërkesë të çdo themeluesi të tij, të organeve vendimmarrëse të fondacionit, si dhe të organeve kompetente shtetërore.

Neni 63

(Ndryshuar me ligjin nr. 8781, datë 3.5.2001)

Gjykata, pasi të ketë marrë mendimin e subjektit që ka kërkuar shpërndarjen e fondacionit, vendos për destinimin e pasurisë që mbetet pas shpërndarjes së tij, në përputhje me rregullat e parashikuara në statut, si dhe duke patur parasysh destinacionin e tyre dhe qëllimin themelor për të cilin është themeluar fondacioni.

TITULLI II PËRFAQËSIMI

KREU I KUPTIMI DHE LLOJET E PËRFAQËSIMIT

Kuptimi i përfaqësimit

Neni 64

Me përfaqësimin një person (përfaqësuesi) kryen, brenda tagreve që i janë dhënë nga ligji, nga prokura ose nga gjykata, veprime juridike në emër e për llogari të një personi fizik ose juridik tjetër (i përfaqësuar).

Përfaqësimi nuk lejohet kur veprimi juridik duhet, sipas ligjit, të kryhet nga vetë personi.

Nuk mund të veprojë si përfaqësues personi që nuk ka zotësi të plotë për të vepruar.

Kufijtë dhe pasojat e përfaqësimit

Neni 65

Tagret e përfaqësimit ligjor caktohen nga dispozitat e ligjit që i japin këtë cilësi, ndërsa tagret e përfaqësuesit të emëruar nga i përfaqësuarit caktohen me prokurë.

Tagret e përfaqësuesit mund të nxirren edhe nga rrethanat, në të cilat kryhen veprimet juridike përkatëse.

Neni 66

Veprimet juridike të kryera nga përfaqësuesi, brenda tagreve që i janë dhënë, krijojnë pasoja drejtpërdrejt për të përfaqësuarin.

Neni 67

Përfaqësuesi nuk mund të kryejë veprime juridike në emër të të përfaqësuarit as me veten e tij dhe as me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij, përveç kur i përfaqësuarit e ka lejuar këtë shprehimisht, ose kur përmbajtja e veprimit juridik nuk cenon interesat e tij.

Neni 68

Kur për kryerjen e një veprimi juridik janë caktuar dy ose më shumë përfaqësues, secili prej tyre mund ta kryejë atë pa pjesëmarrjen e përfaqësuesve të tjerë, përveç kur në prokurë është parashikuar ndryshe.

Neni 69

Përfaqësuesi detyrohet të veprojë personalisht dhe nuk mund të emërojë zëvendës të tij, përveç kur është lejuar nga i përfaqësuari, kur pasuria që përmendet në prokurë ndodhet jashtë territorit të rrethit ku banon përfaqësuesi, si dhe kur caktimi i zëvendësit çmohet i nevojshëm për mbrojtjen e interesave të të përfaqësuarit. Përfaqësuesi duhet të njoftojë menjëherë të përfaqësuarin për zëvendësin që ka caktuar, përndryshe ai përgjigjet për veprimet e zëvendësit.

Zëvendësi mund të hiqet në çdo kohë nga i përfaqësuari ose nga përfaqësuesi që e ka caktuar.

Përfaqësimi me prokurë

Neni 70

Prokura është dokumenti në të cilin i përfaqësuari, me vullnetin e tij të lirë ka përcaktuar karakterin dhe vëllimin e tagreve që i ka dhënë përfaqësuesit.

Neni 71

Prokura është e përgjithshme kur i përfaqësuari i ka dhënë përfaqësuesit tagre për të kryer veprime juridike të shumëllojshme, të cilat kanë të bëjnë me një tërësi të drejtash të të përfaqësuarit, përveç atyre që i ka përjashtuar shprehimisht.

Prokura është e posaçme kur i përfaqësuari i ka dhënë përfaqësuesit tagrin për të kryer një ose disa veprime juridike të caktuara, që karakterizohen nga një qëllim i përbashkët.

Neni 72

Prokura bëhet gjithmonë me shkresë. Çdo prokurë për të lidhur një kontratë, e cila sipas ligjit mund të bëhet vetëm me akt noterial, duhet të përpilohet në këtë formë, përndryshe është e pavlefshme. Edhe prokura për kryerjen e veprimeve para gjykatave dhe institucioneve të tjera shtetërore, duhet të bëhet me akt noterial, përveç kur me dispozita ligjore lejohet që ajo të bëhet me shkresë të thjeshtë.

Prokura në emër të personave juridikë publikë e privatë mund të bëhet edhe vetëm me nënshkrimin e drejtuesit të tij dhe me vulën përkatëse, përveç kur ligji kërkon që veprimi juridik të kryhet me akt noterial.

Neni 73

Prokura për të tërhequr dërgesa postare ose para nga zyrat postare apo nga bankat deri në një shumë të caktuar prej tyre, prokura për të tërhequr paga dhe shpërblime të tjera që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës, si dhe prokura për të tërhequr pensione, ndihma e bursa, mund të vërtetohen edhe nga:

- a) administratori i lagjes së qytetit ose kryeplaku i fshatit;

b) drejtuesi i personit juridik apo i degës së tij, ku i përfaqësuari është në marrëdhënie pune ose ndjek shkollën;

c) drejtuesi i institucionit shëndetësor ku i përfaqësuari është shtruar për mjekim;

ç) komanda e repartit ushtarak ku shërben i përfaqësuari;

d) drejtuesi i institucionit ku i përfaqësuari mbahet i arrestuar ose vuan dënimin me heqje të lirisë.

Neni 74

Ndryshimet në prokurë duhet t'u bëhen të njohura të tretëve me mjete të përshtatshme. Në mungesë të njoftimeve të tilla, këto ndryshime nuk mund t'u kundrejtohen të tretëve, përveç kur provohet që këta i dinin ndryshimet në prokurë në kohën kur është kryer veprimi juridik.

Neni 75

I përfaqësuari mund të shfuqizojë prokurën dhe përfaqësuesi të heqë dorë prej saj në çdo kohë. Çdo marrëveshje e kundërt është e pavlefshme.

Mbarimi i prokurës

Neni 76

Prokura mbaron kur:

a) përfaqësuesi ka kryer veprimet juridike për të cilat ajo ishte dhënë;

b) është plotësuar afati për të cilin ajo ishte dhënë;

c) ka vdekur përfaqësuesi apo i përfaqësuari, ose kur njëri prej tyre ka humbur zotësinë për të vepruar;

ç) ka mbaruar personi juridik përfaqësues apo i përfaqësuar;

d) i përfaqësuari ka shfuqizuar prokurën ose përfaqësuesi ka hequr dorë prej saj. Pas mbarimit të prokurës përfaqësuesi, me kërkesën e të përfaqësuarit, duhet t'i kthejë atij aktin e prokurës.

Përfaqësimi pas ndryshimeve ose mbarimit të prokurës

Neni 77

Veprimet juridike të kryera nga përfaqësuesi, pas ndryshimeve të bëra në prokurë ose pas mbarimit të saj, janë të detyrueshme për të përfaqësuarin ose për trashëgimtarët e tij, në rast se personat e tretë, me të cilët janë kryer ato veprime juridike, nuk kanë patur dijeni për ndryshimet ose për mbarimin e prokurës.

Përfaqësimi pa tagre

Neni 78

Kur një person fizik ose juridik vepron si përfaqësues pa e patur këtë cilësi, si edhe kur përfaqësuesi ka kapërcyer tagret që i janë dhënë, veprimi juridik i kryer në këto kushte nuk është i detyrueshëm për personin në emrin e të cilit janë kryer, përveç kur ky e ka miratuar atë më vonë.

Kur miratimi nuk është dhënë, personi i tretë që ka qenë në mirëbesim ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit nga përfaqësuesi.

TITULLI III
VEPRIMET JURIDIKE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Përkufizimi i veprimit juridik
Neni 79

Veprimi juridik është shfaqja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik, që synon të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë të drejta ose detyrime civile.

Veprimi juridik mund të jetë i njëanshëm ose i dyanshëm.

Format e veprimit juridik
Neni 80

Veprimi juridik mund të kryhet me shkrim, me gojë dhe me çdo lloj shfaqje tjetër të padyshimtë të vullnetit.

Shkresa mund të jetë e thjeshtë ose akt noterial.

Neni 81

Veprimi juridik me shkresë duhet të nënshkruhet nga personi që e kryen atë.

Neni 82

Personi që nuk di, ose që për shkak sëmundje ose të metash fizike nuk mund të nënshkruajë, ngarkon një person tjetër për këtë qëllim.

Nënshkrimi i këtij personi duhet të vërtetohet nga noteri, duke u treguar shkaku për të cilin personi që ka kryer veprimin juridik nuk ka mundur ta nënshkruajë vetë.

Për veprimet që kryhen në bankat dhe në institucionet e tjera të kreditit, në zyrat postare apo doganore, nënshkrimi i këtij personi vërtetohet nga një nëpunës i autorizuar i këtyre institucioneve.

Neni 83

Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të të drejtave reale mbi to, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet, përndryshe nuk është i vlefshëm.

Është i pavlefshëm veprimi juridik që nuk është bërë në formën e kërkuar shprehimisht nga ligji. Në rastet e tjera veprimi juridik është i vlefshëm, por nuk mund të provohet me dëshmitarë.

Veprimet juridike me kusht
Neni 84

Veprimi juridik është me kusht kur lindja ose shuarja e të drejtave dhe e detyrimeve të parashikuara në të, varen nga një ngjarje e cila nuk dihet nëse do të ndodhë.

Neni 85

Kushti është pezullues kur të drejtat dhe detyrimet lindin po të ndodhë ngjarja.
Kushti është zgjidhës kur të drejtat dhe detyrimet shuhen po të ndodhë ngjarja.

Neni 86

Kur vërtetimi i kushtit është ndaluar me keqbesim nga pala që do të përfitonte nga mosvërtetimi i tij, kushti quhet se është vërtetuar.

Kur vërtetimi i kushtit është shkaktuar me keqbesim nga pala që do të përfitonte nga vërtetimi i tij, kushti quhet se nuk është vërtetuar.

Neni 87

Kur e drejta që varet nga vërtetimi i kushtit cenohet ose humbet nga veprimet e palës së detyruar me kusht, kjo duhet të shpërblejë dëmin e shkaktuar në rast se kushti vërtetohet.

Neni 88

Pasojat që lidhen me vërtetimin e kushtit fillojnë nga çasti që është vërtetuar kushti, përveç kur nga përmbajtja e veprimit juridik del se këto pasoja duhet të fillojnë në një kohë të mëparshme.

Veprimet juridike me afat

Neni 89

Afati i veprimit juridik është çasti i caktuar, nga i cili fillon ose pushon fuqia juridike ose disa nga efektet e tij.

Neni 90

Afati është pezullues kur në veprimin juridik është parashikuar se pasojat e tij fillojnë nga një kohë e caktuar.

Afati është zgjidhës kur në veprimin juridik është parashikuar se pasojat e tij pushojnë në një kohë të caktuar.

Llogaritja e afateve të veprimeve juridike

Neni 91

Kur afati është caktuar me ditë, nuk llogaritet dita në të cilën ndodh ngjarja ose koha nga e cila ai duhet të fillojë.

Afati që është caktuar në javë, në muaj ose në vite, mbaron, me kalimin e asaj dite të javës së fundit ose të muajit të fundit që ka të njëjtin emër ose numër me atë të ditës që ai ka filluar. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit, afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji.

Kur dita e fundit e një afati bie në ditë pushimi, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas asaj të pushimit.

KREU II
PAVLEFSHMËRIA E VEPRIMEVE JURIDIKE

Veprime juridike të pavlefshme
Neni 92

Veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike. Të tilla janë ato që:

- a) vijnë në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit;
- b) kryhen për të mashtruar ligjin;
- c) kryhen nga të mitur nën moshën katërbëdhjetë vjeç;
- ç) bëhen në marrëveshje të palëve pa patur për qëllim që të sjellin pasoja juridike (fiktive ose të simuluar).

Neni 93

Kur veprimi juridik është bërë me qëllim për të mbuluar një veprim juridik tjetër, ky i fundit është i vlefshëm në qoftë se përmbush gjithë kushtet e nevojshme për vlefshmërinë e tij.

Veprimi juridik fiktiv ose i simuluar nuk dëmton personat e tretë të cilët në mirëbesim kanë fituar të drejta në bazë të tij.

Veprime juridike që shpallen të pavlefshme
Neni 94

Të anulueshme quhen veprimet juridike të cilat janë të vlefshme gjersa gjykata me kërkesën e të interesuarit i shpall të pavlefshme. Të tilla janë veprimet juridike të kryera nga:

- a) të miturit mbi katërbëdhjetë vjeç, kur veprimin juridik e kanë kryer pa pëlqimin e prindit ose të kujdestarit;
- b) personat, të cilët për shkak sëmundje psikike ose zhvillimi të metë mendor u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, kur veprimin juridik e kanë kryer pa pëlqimin e kujdestarit;
- c) personat, të cilët në kohën e kryerjes së veprimit juridik nuk ishin të ndërgjegjshëm për rëndësinë e veprimeve të tyre, megjithëse në atë kohë nuk u ishte hequr zotësia për të vepruar;
- ç) personi që ka kryer veprimin juridik duke qenë i mashtruar, i kanosur, në lajthim ose për shkak të nevojës së madhe.

Anulimi i këtyre veprimeve mund të kërkohet edhe pas vdekjes së personit përkatës, por vetëm kur para vdekjes është kërkuar heqja e zotësisë së tij për të vepruar.

Neni 95

Mashtrimi mund të shkaktojë që veprimi juridik të shpallet i pavlefshëm, kur gënjeshtër e përdorur nga njëra palë, për ta shpënë në gabim palën tjetër, është e tillë që pa atë pala nuk do ta kishte kryer veprimin juridik.

Kur mashtrimi është bërë nga një person i tretë, pala e mashtruar mund të kërkojë shpalljen e pavlefshmërisë së veprimit juridik vetëm kur në kohën e kryerjes së tij pala tjetër ka ditur ose duhej të dinte mashtrimin.

Neni 96

Kanosja mund të shkaktojë që veprimi juridik të shpallet i pavlefshëm, kur është e tillë sa të frikësojë personin se ai vetë, bashkëshorti, pasardhësit ose paraardhësit e tij do të pësojnë një dëm fizik ose material të padrejtë dhe të rëndë.

Kanosja mund të kryhet edhe nga një person i tretë që nuk merr pjesë në veprimin juridik.

Neni 97

Lajthimi mund të shkaktojë që veprimi juridik të shpallet i pavlefshëm vetëm në qoftë se lidhet me cilësinë e sendit, me identitetin ose cilësitë e personit tjetër, apo me rrethana aq thelbësore sa që pa ato, pala nuk do të kishte kryer veprimin juridik.

Neni 98

Lajthimi në llogaritje nuk sjell shpalljen e veprimit juridik si të pavlefshëm, por vetëm korrigjimin e tij, përveç kur gabimi në sasi ka qenë përcaktues për marrëveshjen.

Neni 99

Veprimi juridik mund të shpallet i pavlefshëm në rastin kur për shkak të nevojës së madhe, detyrimet e marra nga njëra palë janë krejt të papërfillshme në krahasim me përfitimet që nxjerr pala tjetër nga veprimi juridik.

Neni 100

Veprimi juridik i kryer nga përfaqësuesi mund të shpallet i pavlefshëm me kërkesën e të përfaqësuarit, kur vullneti i përfaqësuesit është me ves.

Kur vesi ka të bëjë me elemente të përcaktuara nga i përfaqësuari, veprimi juridik mund të shpallet i pavlefshëm, vetëm në qoftë se ishte i vesuar vullneti i këtij të fundit.

Neni 101

Kur në veprimin juridik ka rëndësi përcaktimi i mirëbesimit ose i keqbesimit, i dijenisë ose i mosdijenisë së rrethanave të caktuara, që përbëjnë kushte përcaktuese të vlefshme ose të pavlefshme të veprimit juridik, mbahet parasysh personi i përfaqësuesit, përveç kur bëhet fjalë për rrethana të përcaktuara nga i përfaqësuari.

I përfaqësuari që është në keqbesim nuk mund të përfitojë në asnjë rast nga mosdijenja ose mirëbesimi i përfaqësuesit.

Neni 102

Veprimi juridik i kryer në dëm të të përfaqësuarit për shkak marrëveshjeje me keqbesim midis përfaqësuesit dhe personit të tretë, mund të shpallet i pavlefshëm për të përfaqësuarin.

Afati i parashkrimit të padisë

Neni 103

Padia për të kërkuar që një veprim juridik të shpallet i pavlefshëm, parashkruhet brenda pesë vjetëve.

Neni 104

Afati për ngritjen e padisë fillon:

a) për veprime juridike të kryera nga persona që u është hequr ose kanë patur zotësi juridike të kufizuar për të vepruar, që nga dita që janë bërë madhorë ose që u është kthyer zotësia për të vepruar;

b) për veprime juridike të kryera me mashtrim, kanosje ose lajthim, nga dita që mashtrimi ose lajthimi janë zbuluar, ose kanosja ka pushuar, por në çdo rast, jo më shumë se tre vjet nga dita që është kryer veprimi juridik;

c) në raste të tjera, që nga dita që është kryer veprimi juridik.

Neni 105

Veprimi juridik që shpallet i pavlefshëm quhet i tillë që nga çasti kur është kryer.

Pasojat e pavlefshmërisë së veprimit juridik

Neni 106

Kur veprimi juridik është i pavlefshëm për arsye se vjen në kundërshtim me ligjin, ose është bërë me qëllim mashtrimi të ligjit, çdo gjë që palët i kanë dhënë njëra-tjetrës merret dhe kalon në të ardhurat e shtetit dhe kur nuk është e mundur të merret po ajo gjë, kërkohet vlefata e saj.

Kur njëra nga palët ka vepruar në mirëbesim, gjykata mund të vendosë që çdo gjë që ka dhënë kjo palë t'i kthehet kësaj dhe kur nuk është e mundur kthimi i po kësaj gjëje, i paguhet vlefata e saj.

Neni 107

Kur veprimi juridik shpallet i pavlefshëm për arsye se është bërë me mashtrim, kanosje, nga nevoja e madhe ose sepse mungon forma e kërkuar nga ligji, secila nga palët duhet t'i kthejë palës tjetër çdo gjë që ka marrë prej saj dhe, kur nuk është e mundur t'i kthehet po ajo gjë, t'i paguhet vlefata e saj.

Neni 108

Kur veprimi juridik konstatohet se është i pavlefshëm për arsye se është kryer nga një i mitur, që nuk ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç ose shpallet i pavlefshëm se është kryer nga një i mitur që ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç, por pa pëlqimin e prindit ose të kujdestarit të tij, secila nga palët detyrohet t'i kthejë palës tjetër çdo gjë që ka marrë prej saj dhe kur nuk është e mundur të kthejë po atë gjë, t'i paguajë vleftën. Përveç kësaj, pala që ka zotësi për të vepruar detyrohet t'i shpërblejë të miturit dëmin që ky ka pësuar për shkak se veprimi juridik konstatohet ose shpallet i pavlefshëm.

Neni 109

Kur veprimi juridik shpallet i pavlefshëm për arsye se është kryer nga një person, të cilit i është hequr krejt zotësia për të vepruar ose për arsye se është kryer nga një person të cilit i është kufizuar zotësia për të vepruar e pa patur pëlqimin e kujdestarit të tij, ose për arsye se është kryer nga një person i cili në kohën e kryerjes së veprimit juridik nuk ka patur ndërgjegjen e rëndësisë së veprimeve të tij, secila nga palët detyrohet t'i kthejë palës tjetër çdo gjë që ka marrë prej saj dhe, kur nuk është e mundur t'i kthejë po atë gjë, t'i paguajë vleftën. Përveç kësaj, pala që ka patur zotësinë për të vepruar detyrohet t'i shpërblejë palës tjetër dëmin që kjo palë ka pësuar për shkak të veprimit juridik që është shpallur i pavlefshëm, në rast se dinte ose duhet të dinte se pala tjetër nuk ka patur zotësi për të vepruar ose nuk ka patur ndërgjegjen e rëndësisë së veprimeve të saj.

Neni 110

Kur veprimi juridik shpallet i pavlefshëm për arsye se njëra nga palët ka qenë në lajthim, secila nga palët detyrohet t'i kthejë palës tjetër çdo gjë që ka marrë prej saj dhe, kur nuk është e mundur t'i kthejë po atë gjë, t'i paguajë vleftën. Përveç kësaj, pala që ka kërkuar të shpallet i pavlefshëm veprimi juridik detyrohet t'i shpërblejë palës tjetër dëmin që ajo ka pësuar për shkak se veprimi juridik është shpallur i pavlefshëm, me përjashtim të rastit kur ajo provon se nuk ka faj që ka rënë në lajthim ose se pala tjetër ka ditur ose duhet të dinte lajthimin.

Neni 111

Kur shkakut i pavlefshmërisë prek vetëm një pjesë të veprimit juridik, ky mbetet i vlefshëm në pjesët e tjera të tij, përveç kur, sipas përmbajtjes së veprimit juridik, këto pjesë paraqesin marrëdhënie të pandashme me pjesën e pavlefshme të veprimit juridik.

TITULLI IV

PARASHKRIMI I PADISË DHE DEKADENCA E TË DREJTAVE

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Përmbajtja

Neni 112

E drejta e padisë që nuk është ushtruar brenda afatit të caktuar në ligj, shuhet dhe nuk mund të realizohet më me anë të gjykatës ose të organit tjetër kompetent.

Paditë që nuk parashkruhen

Neni 113

Nuk parashkruhen:

- a) padia për rivendosjen ose mbrojtjen e një të drejte vetjake jopasurore, përveç përjashtimeve të caktuara në ligj;
- b) paditë e njohjes;
- c) padia e pjesëtimit midis bashkëpronarëve;

- ç) padia për kthimin e shumave të depozituara në bankë;
- d) paditë e tjera të parashikuara në dispozita ligjore të veçanta. Nuk parashkruhen edhe kërkesat për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimeve që janë të lidhura me padi, për të cilat nuk zbatohet parashkrimi.

Afatet e parashkrimit

Neni 114

Kur në ligj nuk është parashikuar ndryshe, parashkruhen brenda dhjetë vjetëve të gjitha paditë midis personave juridikë, midis këtyre dhe personave fizikë, si dhe midis vetë personave fizikë.

Neni 115

(Shtuar germa "e" me ligjin nr. 17/2012, datë 16.2.2012)

Parashkruhen brenda afateve prej:

- a) gjashtë muaj paditë për pagimin e kushteve penale vlerësuese;
 - b) një viti paditë e rrjedhura nga kontratat e spedicionit;
 - c) gjashtë muaj paditë që rrjedhin nga transportimet e drejtpërdrejta të mallrave dhe të udhëtarëve me anë të hekurudhës, automjeteve ose avionëve dhe prej një viti për të njëjtat padi që rrjedhin nga transportimet detare ose të përziera;
 - ç) dy vjetëve paditë për pagimin e shpërblimit sipas kontratës së sigurimit dhe risigurimit, si edhe të shumës përkatëse të rrjedhur nga sigurimi i detyrueshëm;
 - d) tre vjetëve paditë për pagimin e qirave të banesave, dyqaneve, lokaleve dhe pasurive të tjera të paluajtshme;
 - dh) tre vjetëve paditë për shpërblimin e dëmit jokontraktor dhe paditë për kthimin e përfitimit pasuror pa të drejtë.
 - e) një vit paditë për shpërblimin e dëmit jopasuror për cenimin e nderit, personalitetit ose reputacionit.
- Paditë e tjera parashkruhen brenda afateve të posaçme të caktuara në këtë Kod ose në ligje të tjera.

Neni 116

Është e pavlefshme marrëveshja e palëve për ndryshimin e afateve të parashkrimit dhe e çdo dispozite të këtij kreu.

Neni 117

Afati i parashkrimit fillon nga dita kur subjektit i ka lindur e drejta e padisë.

Neni 118

Në detyrimet kontraktore të lidhura me afat ekzekutimi, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur është plotësuar ky afat.

Kur detyrimi është i përbërë nga pagesa periodike, për secilën prej tyre afati i parashkrimit fillon në mënyrë të veçantë.

Për detyrimet kontraktore të lidhura pa afat dhe për detyrimet që ekzekutohen me kërkesën e kreditorit, afati i parashkrimit fillon nga dita kur ka lindur detyrimi.

Neni 119

Për kërkimin e sendit, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur pronari ka marrë ose duhej të merrte dijeni për cenimin dhe cenesin e së drejtës së tij.

Neni 120

Për kërkimin e shpërblimit të dëmit jokontraktor, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për dëmin e pësuar dhe për personin që e ka shkaktuar.

Neni 121

Për kthimin e shumës së parave ose të sendit që është fituar ose kursyer pa shkak, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për fitimin ose kursimin pa shkak që ka realizuar personi përkatës.

Neni 122

Për kërkimin e trashëgimit, parashkrimi i padisë fillon nga dita e çeljes së trashëgimisë.

Neni 123

Për paditë e kthimit, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur paditësi ka paguar vullnetarisht, në bazë të një detyrimi ligjor ose kontraktor, personit të tretë, për fajin e të paditurit, shumën e parave apo sendin që kërkohet me anë të kësaj padie, ose nga dita kur është dhënë vendimi i gjykatës ose arbitrazhit përkatës nga i cili ka lindur padia e regresit.

Neni 124

Parashkrimi i padisë për kërkesën kryesore shkakton që të parashkruhen edhe paditë për kërkesat e rrjedhura prej saj, pavarësisht se për këto nuk është plotësuar ende afati përkatës.

Kërkesa e palës së interesuar

Neni 125

Parashkrimi i plotësuar nuk mund të merret parasysh nga gjykata ose organi tjetër kompetent me nismën e vet, por vetëm me kërkesën e palës së interesuar.

Heqja dorë nga parashkrimi

Neni 126

Heqja dorë nga parashkrimi lejohet vetëm pasi të jetë plotësuar afati i tij.

Neni 127

Pretendimi se afati i parashkrimit është plotësuar mund të ushtrohet edhe nga kreditorët dhe nga kushdo që ka interes, në rastet kur pala përkatëse e ka ushtruar vetë.

Përbushja e detyrimit pas plotësimit të afatit

Neni 128

Debitori që ka përbushur detyrimin e tij pas plotësimit të parashkrimit, nuk mund të kërkojë kthimin e shumës së parave ose të sendit, që ka dhënë vullnetarisht, edhe sikur të mos dinte se ishte plotësuar afati i parashkrimit.

KREU II

PEZULLIMI DHE NDËRPRERJA E PARASHKRIMIT

A. Pezullimi i parashkrimit

Neni 129

Parashkrimi pezullohet:

a) midis bashkëshortëve deri në ditën kur ka marrë formë të prerë vendimi gjyqësor me të cilin është zgjidhur martesja;

b) midis fëmijëve dhe prindërve gjersa këta ushtrojnë të drejtën prindërore;

c) midis personave që ndodhen nën kujdestari dhe kujdestarëve të tyre gjersa vazhdon kujdestaria;

ç) për paditë e personave, pasuria e të cilëve është vënë në administrim, kundër administruesve përkatës të caktuar nga gjykata ose nga një organ tjetër kompetent shtetëror, gjersa të jetë miratuar raporti përfundimtar i llogarive;

d) për paditë e të miturve dhe personave të tjerë, që nuk kanë zotësi për të vepruar gjersa t'u emërohet përfaqësuesi ose të fitojnë këtë zotësi, si edhe për gjashtë muaj pasi është emëruar përfaqësuesi ose pasi kanë fituar zotësinë për të vepruar;

dh) për paditë e personit juridik kundër administratorëve të vet, gjersa këta vazhdojnë këtë detyrë pranë tij;

e) për paditë me objekt shpërblimin përkatës, të rrjedhura nga dëmtimi i shëndetit ose nga shkaktimi i vdekjes, pezullimi i parashkrimit vazhdon nga dita kur i është paraqitur kërkesa organit të sigurimeve shoqërore shtetërore dhe deri në ditën kur është caktuar pensioni ose është refuzuar ajo kërkesë;

ë) kur ka forcë madhore.

Neni 130

Koha e pezullimit nuk llogaritet në afatin e parashkrimit. Kur pas zhdukjes së shkakut pezullues, koha që mbetet për t'u plotësuar parashkrimi është më e shkurtër se gjashtë muaj, ajo zgjatet deri në gjashtë muaj.

B. Ndërprerja e parashkrimit

Neni 131

Parashkrimi ndërpritet:

a) me çdo veprim të personit fizik ose juridik të detyruar, që shpreh njohjen e saktë dhe të plotë të së drejtës të kreditorit;

b) me paraqitjen e padisë, të kundërpadisë ose të prapësimit, qoftë edhe në një gjykatë ose arbitrazh që nuk është kompetent nga pikëpamja tokësore ose lëndore për shqyrtimin e çështjes;

c) me çdo veprim që e vë debitorin në vonesë;

ç) me paraqitjen e kërkesës për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor apo të arbitrazhit përkatës, si dhe të çdo titulli ekzekutiv tjetër.

Neni 132

Parashkrimi i ndërprerë kundër njërit prej debitorëve solidarë ose njërit prej bashkëshortëve të një detyrimi të pajesëtueshëm, shtrihet edhe ndaj secilit nga këta debitorë të tjerë.

Neni 133

Parashkrimi i ndërprerë kundër debitorit kryesor shtrihet edhe ndaj dorëzanësit përkatës.

Neni 134

Koha e kaluar para se të vërtetohej shkaku ndërprerës nuk llogaritet dhe pas zhdukjes së këtij shkaku fillon një afat parashkrimi i ri.

Neni 135

Kur parashkrimi është ndërprerë për shkak të paraqitjes së padisë ose të kundërpadisë, afati i ri i parashkrimit fillon nga dita që ka marrë formë të prerë vendimi me të cilin është zgjidhur çështja në themel.

Kur është vendosur rrëzimi i padisë pa u zgjidhur çështja në themel, ose pushimi i gjykimit të çështjes, parashkrimi nuk quhet i ndërprerë.

Llogaritja e afateve të parashkrimit

Neni 136

Afati i parashkrimit të padisë, që është caktuar në javë, në muaj ose në vite mbaron me kalimin e asaj dite të javës së fundit apo të muajit të fundit që ka të njëjtin emër ose numër me atë të ditës në të cilën ka filluar afati dhe, kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit, afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji.

Kur dita e fundit e afatit të parashkrimit bie në një ditë pushimi, quhet si e fundit ajo ditë pune që vjen pas asaj të pushimit.

KREU III

PREKLUZIVITETI (DEKADENCA)

Neni 137

Kur një e drejtë duhet të ushtrohet brenda një afati prekluziv, nuk zbatohen dispozitat që rregullojnë ndërprerjen e parashkrimit. Gjithashtu, nuk zbatohen shkaqet pezulluese, përveç rasteve përjashtimore, kur vetë ligji lejon pezullimin e afatit prekluziv.

Neni 138

Është e pavlefshme çdo marrëveshje me të cilën janë caktuar afate prekluzive, që e bëjnë tejet të vështirë për njërën nga palët ushtrimin e së drejtës përkatëse.

Neni 139

Palët nuk mund të ndryshojnë urdhërimet ligjore që rregullojnë prekluzivitetin, dhe as mund të heqin dorë nga afati prekluziv i plotësuar kur ky afat është caktuar me dispozita ligjore të veçanta.

Neni 140

Afati prekluziv i plotësuar merret parasysh nga gjykata ose arbitrazhi kompetent me nismën e vet, edhe pa u kërkuar nga pala e interesuar.

PJESA II SENDET DHE PRONËSIA

TITULLI I SENDET

Neni 141

Kuptimi juridik i sendit

Send është çdo gjë që mund të përbëjë objekt pronësie ose i të drejtës tjetër reale.

Llojet e sendeve

Neni 142

Sendet janë të luajtshme dhe të paluajtshme.

Janë sende të paluajtshme toka, burimet e rrjedhjet e ujërave, drurët, ndërtesat, ndërtimet e tjera notuese të lidhura me tokën dhe çdo gjë që është e trupëzuar në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me tokën ose ndërtesën.

Të gjitha sendet e tjera, duke përfshirë edhe çdo energji tjetër natyrore, janë sende të luajtshme.

Neni 143

Dispozitat që kanë të bëjnë me sendet e paluajtshme zbatohen edhe për të drejtat reale që kanë si objekt sende të paluajtshme, si dhe për paditë përkatëse, përveç kur parashikohet ndryshe me ligj.

Dispozitat që kanë të bëjnë me sendet e luajtshme zbatohen për të gjitha të drejtat e tjera.

Regjistrimi i sendeve

Neni 144

Sendet e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to regjistrohen në regjistrat e pasurive të paluajtshme.

Regjistrohen edhe ato sende të luajtshme, për të cilat kërkohet shprehimisht nga ligji.

Frutat e sendit

Neni 145

Frutat natyrore të një sendi janë produktet që nxirren prej tij. Derisa nuk janë ndarë nga sendi, ato janë pjesë përbërëse e tij.

Frutat civile nxirren nga sendet si rrjedhojë e gëzimit të të drejtave që kanë personat mbi to.

Frutat civile fitohen në bazë të kohëzgjatjes së të drejtave dhe kur këto janë bërë të kërkueshme.

Pjesët përbërëse të sendit

Neni 146

Është pjesë përbërëse e një sendi çdo gjë që është bashkuar me të dhe nuk mund të ndahet prej tij pa iu shkaktuar një dëm thelbësor.

Sendet aksesore

Neni 147

Aksesorë janë ato sende të luajtshme që janë destinuar për t'i shërbyer në mënyrë të vazhdueshme një sendi kryesor ose për ta zbukuruar atë.

Ky destinim bëhet nga pronari i sendit kryesor ose nga personi që ka një të drejtë reale mbi atë.

Neni 148

Çdo disponim i sendit kryesor përfshin edhe aksesorët e tij, përveç kur është parashikuar ndryshe. Aksesorët mund të jenë edhe objekt i një disponimi të veçantë.

Aksesori nuk e humbet këtë cilësi të tij në rastet kur është ndarë përkohësisht nga sendi kryesor.

TITULLI II

PRONËSIA

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Përmbajtja e pronësisë

Neni 149

Pronësia është e drejta për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendet, brenda kufijve të caktuar nga ligji.

Pronësia mbi pjesët përbërëse të sendit

Neni 150

Pronarit të sendit i takon pronësia edhe mbi pjesët përbërëse të tij.

Pronësia mbi frutat e sendit

Neni 151

Pronarit të sendit i takojnë frutat natyrore që prodhon sendi, përveç kur pronësia e tyre u është kaluar të tjerëve. Në këtë rast pronësia fitohet pasi të jenë ndarë nga sendi.

Personi që merr frutat duhet që brenda vleftës së tyre të shpërblejë shpenzimet e bëra për prodhimin dhe vjeljen e tyre.

Përkatësia e sendeve

Neni 152

Sendet u përkasin personave fizikë, personave juridikë dhe shtetit.

Llojet e pasurisë publike caktohen me ligj.

Të drejtat dhe detyrimet e pronarit

Neni 153

(Ndryshuar me ligjin nr.8781, datë 3.5.2001)

Askush nuk mund të shpronësohet ose t'i kufizohet e drejta e ushtrimit të së drejtës të pronës që barazohet me shpronësimin, përveçse kur këtë e kërkojnë interesa publike dhe kurdoherë kundrejt një shpërblimi të drejtë.

Neni 154

E drejta e pronësisë mbi tokën shtrihet gjer në lartësinë dhe thellësinë që është e dobishme për ushtrimin e saj, në kushtet e parashikuara me ligj.

Neni 155

Pronari i një toke, pasi më parë t'i ketë kërkuar fqinjët që të presë degët e pemëve dhe rrënjët që i futen në tokën e tij, ka të drejtë t'i presë vetë ato, në rast se i sjellin dëm, si dhe të vjelë frutat dhe t'i përdorë ato për vete.

Frutat që bien nga pemët mbi tokë, i përkasin pronarit të tokës ku ato kanë rënë.

Neni 156

Pronari i një toke që ndodhet buzë një rrjedhe uji ose burimi publik, ka të drejtë t'i përdorë ato deri në masën që nuk dëmton interesat e pronarëve të tokave të tjera, përveç kur përdorimi rregullohet me dispozita të veçanta.

Neni 157

Pronari i një toke mund t'i kërkojë në çdo kohë pronarit të tokës fqinje, që me shpenzime të përbashkëta, të vendosen në kufijtë e tokave të tyre shenja të dukshme dallimi ose t'i ndreqin ato kur janë të dëmtuara.

Kur kufiri ndërmjet dy tokave është i paqartë dhe pronarët nuk e përcaktojnë vetë atë, secili prej tyre mund të kërkojë saktësimin e tij nga gjykata.

Neni 158

Kur mbillen drurë e shkurre në kufijtë e pronave, pronarët janë të detyruar të mbajnë largësitë e caktuara me dispozita të veçanta e kur nuk ka të tilla, nga zakonet e vendit, përveç kur pronari fqinjë ka lejuar vetë ose kur kufiri është në një rrugë ose rrjedhë uji publike.

Në mungesë të këtyre rregullave, largësitë janë: tre metra për drurët me trup të lartë dhe dy metra për drurët e tjerë.

Këto largësi nuk zbatohen për drurët e shkurret, lartësia e të cilëve nuk e kalon murin ndarës të pronave.

Neni 159

Pronari është i lirë në përdorimin e sendit, pa dëmtuar të drejtat e personave të tjerë dhe brenda kufijve që caktohen nga ligji ose nga zakonet e mira. Ai nuk mund t'u krijojë fqinjëve shqetësime të tilla si zhurma, dridhje, futje të tymit, nxehtësive, avujve ose përhapje të tjera të ngjashme, të pengojë gëzimin e pronave të tyre, duke ndryshuar rrjedhat, prurjet ose cilësinë e ujërave që rrjedhin në tokën e tij ose të ujërave nëntokësorë, si dhe të përdorë ujërat që komunikojnë lirisht me ato të tokës së tjetrit, përveç kur këto shqetësime nuk kalojnë shkallën e zakonshme të tyre.

Pronari gjatë ushtrimit të të drejtave të tij, detyrohet të marrë masa për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit përreth.

Neni 160

Pronarët duhet t'u përmbahen rregullave të caktuara në planet rregulluese ose në dispozita të veçanta, për ngritjen e ndërtesave të reja, për rindërtimin ose ndryshimin e tyre, për largësitë ndërmjet ndërtesave, për çeljen e dritareve, puseve, gropave e të punimeve të tjera të kësaj natyre.

Neni 161

Pronari është i detyruar të mbledhë ujërat që rrjedhin nga strehët e ndërtesave të tij, në mënyrë që ato të mos pikojnë mbi tokën e tjetrit. Derdhja e tyre në një rrjedhë publike mund të bëhet kur nuk ndalohet nga rregullat që kanë caktuar organet kompetente.

Pronari është i detyruar të kujdeset që ujërat dhe mbeturinat që vijnë nga toka e tij të mos derdhen në kanal in ose në tokën e tjetrit, përveç kur ndërmjet tyre ka marrëveshje të kundërt.

KREU II FITIMI DHE HUMBJA E PRONËSISË

Kalimi i pronësisë

Neni 162

E drejta e pronësisë dhe të drejta të tjera mbi sendet janë të transferueshme, përveç kur ndalohet nga ligji ose nga vetë natyra e së drejtës.

Mënyra e fitimit të pronësisë

Neni 163

Pronësia fitohet nëpërmjet mënyrave të caktuara në këtë Kod dhe mënyrave të tjera të caktuara me ligj të veçantë.

Fitimi i pronësisë me kontratë

Neni 164

Pronësia fitohet me anë të kontratës, pa qenë e nevojshme të bëhet dorëzimi i sendit. Për sendet që përcaktohen në numër, në peshë ose me masë, duhet të bëhet edhe dorëzimi i tyre.

Fitimi i pronësisë me trashëgim

Neni 165

Fitimi i pronësisë me trashëgim kryhet sipas kushteve të parashikuara në dispozitat e pjesës së tretë të këtij Kodi.

Fitimi me mirëbesim i sendeve të luajtshme

Neni 166

Personi që në bazë të një veprimi juridik për kalimin e pronësisë ka fituar kundrejt shpërblimit me mirëbesim një send të luajtshëm, bëhet pronar i këtij sendi edhe sikur tjetërsuesi të mos ishte disponues i tij.

Megjithatë fituesi, qoftë edhe me mirëbesim, nuk bëhet pronar i sendit kur ky është i vjedhur.

Fituesi me mirëbesim bëhet pronar i monedhave dhe i letrave me vlerë tek prurësi, edhe sikur këto t'i jenë vjedhur ose t'i kenë humbur pronarit ose personit juridik publik.

Dispozitat e mësipërme nuk zbatohen për sendet e luajtshme që janë të shënuara në regjistrat publikë.

Prona fitohet e lirë nga të drejtat e tjetrit mbi sendin, në rast se këto të drejta nuk rrjedhin nga titulli dhe nga mirëbesimi i fituesit.

Neni 167

Në rast se pronësia mbi një send të luajtshëm u kalon me anë kontratash disa personave, bëhet pronar ai që ka fituar posedimin e sendit me mirëbesim, edhe sikur kontrata të jetë e një date të mëvonshme.

Parashkrimi fitues

Neni 168

Personi që ka fituar me mirëbesim një send, në bazë të një veprimi juridik për kalimin e pronësisë dhe që nuk është i ndaluar nga ligji, bëhet pronar i këtij sendi, pas një posedimi të pandërprerë prej pesë vjetësh kur sendi është i luajtshëm dhe prej dhjetë vjetësh kur ai është i paluajtshëm.

Kur posedimi nuk është me mirëbesim, afatet e posedimit të pandërprerë dyfishohen. Posedimi konsiderohet i pandërprerë edhe kur fituesi i sendit ia ka dhënë posedimin një personi tjetër.

Nuk mund të fitohet me parashkrim fitues një send që është pronë publike e patjetërsueshme.

Neni 169

Personi që ka poseduar qetësisht e pa ndërprerje, duke u sjellë sikur të ishte pronar për njëzet vjet në një pronë të paluajtshme, bëhet pronar i saj.

Regjistrimi i sendit të fituar me parashkrim

Neni 170

Personi që ka fituar me parashkrim një send të paluajtshëm ka të drejtë të paraqesë padi kundër personit të mëparshëm ose trashëgimtarëve të tij për njohjen e pronësisë së vet dhe, në bazë të vendimit gjyqësor përkatës, të kërkojë që të kryhet regjistrimi i sendit nga organi kompetent shtetëror.

Pezullimi e ndërprerja e parashkrimit fitues

Neni 171

Dispozitat për pezullimin dhe ndërprerjen e parashkrimit të padisë zbatohen edhe për parashkrimin fitues.

Parashkrimi fitues ndërpritet me humbjen e posedimit. Nuk quhet ndërprerje kur poseduesi hyn përsëri në posedim brenda gjashtë muajve ose edhe më vonë me anë padie të ngritur brenda gjashtë muajve.

Sendet pa zot

Neni 172

Sendet pa zot janë ato që nuk kanë pronar ose pronari i të cilave ka hequr dorë nga pronësia.

Sendet që nuk kanë zot i takojnë shtetit. Kalimi i tyre në pronësi të shtetit bëhet me vendim të gjykatës kompetente.

Fitimi i pronësisë me bashkim e përzierje

Neni 173

Mbjelljet, si dhe ndërtesat e çdo vepër tjetër që ndodhen mbi ose nën sipërfaqen e tokës, i përkasin pronarit të saj, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Kod e në dispozita të tjera ligjore.

Neni 174

Pronari i tokës që ka bërë ndërtime e vepra të tjera dhe mbjellje me material të huaj, detyrohet të paguajë vleftën e tyre, në rast se nuk kërkohet ndarja e kthimi i tyre dhe kur kjo mund të kryhet pa u shkaktuar një dëm thelbësor ndërtimeve ose mbjelljeve të kryera.

Kur ndarja e materialeve është e mundshme dhe pronari i tokës ka vepruar me keqbesim, duhet t'i shpërblejë pronarit të materialeve dëmin e pësuar.

Neni 175

Kur ndërtesat e veprat e tjera dhe mbjelljet janë bërë nga një person i tretë me materialet e veta në tokën e tjetrit, pronari përkatës ka të drejtë t'i mbajë ato ose të kërkojë detyrimin e atij që i ka bërë t'i heqë ato me shpenzimet e tij, dhe kur është rasti të shpërblejë dëmin.

Kur pronari i tokës pranon t'i mbajë, detyrohet të paguajë vleftën e materialeve dhe të krahut të punës ose rritjen e vleftës që i është bërë pronës.

Pronari i tokës nuk mund t'i kërkojë heqjen e ndërtimeve e të mbjelljeve të kryera kur ato janë bërë me dijeninë e tij, ose me mirëbesim nga personi i tretë, si dhe kur kanë kaluar gjashtë muaj që nga dita kur pronari ka marrë njoftim për këto ndërtime e mbjellje.

Kur me mirëbesim është ngritur një ndërtesë në tokën e huaj dhe vlefte e saj është më e madhe se vlefte e tokës, personi që ka ngritur ndërtesën mund të njihet pronar edhe i tokës, me vendim të gjykatës kompetente.

Neni 176

Kur dy ose më shumë sende të luajtshme që u përkasin pronarëve të ndryshëm janë bashkuar ose përzier në një send të vetëm e që nuk mund të ndahen pa u shkaktuar një dëm thelbësor njëri-tjetrit, ose kur ndarja kërkon punë e shpenzime të tepruara, pronarët e secilit send bëhen bashkëpronarë të sendit të ri, në përpjesëtim me vleftën që pjesët e sendit kishin në momentin e bashkimit apo të përzierjes së tyre.

Kur një send i luajtshëm është bashkuar ose përzier me një tjetër në mënyrë të tillë sa duket se është pjesë aksesore e tij, sendi i ri i përket pronarit të pjesës kryesore, i cili detyrohet të paguajë vleftën përkatëse, si dhe kur është rasti të shpërblejë dëmin e shkaktuar.

Fitimi i pronësisë me përpunim

Neni 177

Personi që me punën e tij ka krijuar një send të ri të luajtshëm duke përdorur lëndën në pronësi të një personi tjetër, pavarësisht se lënda mund ose jo të marrë formën e saj të parë, bëhet pronar i sendit të ri në rast se vlefte e punës është më e madhe se ajo e lëndës, me kusht që të paguajë vleftën e saj.

Në rast të kundërt sendi i ri fitohet nga pronari i lëndës, duke paguar vleftën e punës.

Kur përpunuesi ka vepruar me keqbesim, me vendim të gjykatës sendi i ri i kalon pronarit të lëndës edhe në rast se vlefte e punës është më e madhe se ajo e lëndës, por duke paguar vleftën e kësaj të fundit.

Bashkimet e tokave nga aluvionet

Neni 178

Mbushjet me dhe të tokave e shtesat e tokës që formohen në mënyrë të natyrshme gjatë brigjeve të lumenjve a të përrenjve, i përkasin pronarit të tokës, përveç kur parashikohet ndryshe me ligj.

Tokat e liruara nga rrjedhat e ujit

Neni 179

Toka që lirohet nga një rrjedhë uji, e cila tërhiqet në mënyrë të natyrshme nga njëri breg dhe shkon në bregun tjetër, i përket pronarit të tokës nga e cila është larguar rrjedha.

Tokat e krijuara në shtratet e lumenjve

Neni 180

Ishujt dhe mbushjet me dhe që krijohen në shtratet e lumenjve janë pronë publike.

Neni 181

Kur një lum ose përria ndërron shtrat duke e lënë të vjetrin, toka që lirohet është në pronësi të pronarëve kufitarë të dy anëve (buzëve) të lumit apo të përroit, të cilët e ndajnë atë deri në mesin e shtratit të lënë sipas gjatësisë së tij.

SENDET E HUMBURA

OSE TË GJETURA

Njoftimi për gjetjen

Neni 182

Personi që ka gjetur një send të humbur, duke përfshirë edhe gjënë e gjallë të shkëputur nga tufa, është i detyruar të lajmërojë menjëherë pronarin ose personin që i ka humbur dhe kur ky nuk njihet, ta dorëzojë atë në bashkinë apo komunën, në territorin e së cilës është gjetur sendi.

Bashkia ose komuna është e detyruar të shpallë menjëherë gjetjen e sendit.

Marrja e sendit dhe pagimi i shpenzimeve

Neni 183

Pronari ose personi, të cilit i ka humbur sendi, ka të drejtë ta kërkojë atë brenda gjashtë muajve nga dita që është shpallur gjetja në bashkinë apo komunën përkatëse, pasi të ketë paguar shpenzimet e bëra për ruajtjen e sendit dhe një shpërblim për personin që ka gjetur sendin në masën 10% të vlefës së sendit, ose të çmimit të marrë, kur sipas rrethanave të paraqitura, shitja e tij ka qenë e domosdoshme.

Kur ka kundërshtime për vleftën e sendit, mosmarrëveshja zgjidhet nga gjykata.

Bashkia ose komuna mund të lejojë mbajtjen përkohësisht të sendit nga personi që e ka gjetur, të cilit i paguhen dhe shpenzimet e bëra për ruajtjen e sendit.

Sendet e humbura duhet të ruhen dhe të mirëmbahen me kujdesin e duhur.

Fitimi i pronësisë nga personi që ka gjetur sendin

Neni 184

Kur pronari ose personi që e ka humbur sendin nuk paraqiten për ta marrë atë brenda afatit të caktuar në nenin 183, sendi ose çmimi i shitjes i kalon në pronësi personit që e ka gjetur, i cili paguan shpenzimet e mbajtjes.

Sendet e gjetura në lokal

Neni 185

Sendet e gjetura në lokalet publike e private e në mjetet e transportit, duhen t'i dorëzohen menjëherë administratës së lokalit ku janë gjetur, e cila i ruan ato tri ditë. Kur nuk paraqitet pronari ose personi që i ka humbur, administrata i dorëzon ato në bashki apo në komunën përkatëse.

Thesari

Neni 186

Quhet thesar çdo send i çmueshëm, i cili duket me saktësi se ka qenë në tokë ose i fshehur prej shumë kohësh dhe që nuk mund t'i gjendet pronari.

Thesari i përket pronarit të sendit të luajtshëm apo të paluajtshëm ku është gjetur, përveç rasteve të sendeve me vlerë shkencore, kulturore, arkeologjike etj., të parashikuara nga neni 187 i këtij Kodi. Personi që zbulon thesarin ka të drejtën e një shpërblimi të arsyeshëm që nuk duhet të kalojë gjysmën e vlerës së tij.

Pronësia e shtetit mbi një kategori sendesh të luajtshme

Neni 187

Sendet e luajtshme, me vlerë kulturore, historike, arkeologjike, etnografike, si dhe sendet natyrore të rralla me rëndësi shkencore që zbulohen, shpërblyer ose nxirren nga toka ose uji, kalojnë në pronësi të shtetit.

Pronari, në pronën e të cilit janë zbuluar sende të tilla, është i detyruar të lejojë kryerjen e gjurmimeve, duke u shpërblyer dëmet e pësuar.

Personi që ka zbuluar ose ka gjetur sende të tilla, ka të drejtë të marrë nga shteti një shpërblim të arsyeshëm.

Fitimi i pronësisë me anë pushtimi

Neni 188

Pronësia mbi sendet e luajtshme të abandonuara, si dhe mbi kafshët e egra, shpendët, peshqit, frutat e egra dhe mbi sendet e tjera të luajtshme të natyrës, fitohet me anë pushtimi, në kushte të caktuara me ligj ose në dispozita të veçanta.

Tufa e bletëve

Neni 189

Pronari i një tufe bletësh ka të drejtë ta ndjekë e ta marrë atë në tokën e tjetrit, duke shpërblyer dëmin e shkaktuar.

Kur pronari i bletës së ikur nuk e ka ndjekur atë brenda tri ditëve, ose kur ajo ka hyrë në një zgjuar bletësh tjetër, pronësia mbi atë i kalon përkatësisht pronarit të tokës ku ka qëndruar blea ose pronarit të zgjoit.

Fitimi i pronësisë me anë shpronësimi

Neni 190

(Ndryshuar fjalia e parë me ligjin nr. 8781, datë 3.5.2001)

Sendet mund të shpronësohen vetëm për interesa publike të njohur me ligj dhe vetëm kundrejt një shpërblimi të drejtë. Ato kalojnë në pronësi të shtetit ose të enteve të tjera publike, në favor të të cilave është bërë shpronësimi.

Humbja e pronësisë

Neni 191

Pronësia humbet kur fitohet nga një tjetër ose kur hiqet dorë prej saj.

Heqja dorë nga pronësia mbi pasuritë e paluajtshme në dobi të një tjetri, është e vlefshme kur bëhet me akt noterial e regjistrohët.

KREU III

REGJISTRIMI I PASURIVE TË PALUAJTSHME

Neni 192

Sendet e paluajtshme dhe faktet që kanë lidhje me gjendjen juridike të tyre regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Regjistrimi bëhet në bazë të një akti publik, të një vendimi gjykate apo të një organi tjetër shtetëror kompetent, si dhe në rastet e tjera të parashikuara nga ligji.

Neni 193

Duhet të regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme:

a) kontratat për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe aktet për pjesëtimin vullnetar të tyre;

b) kontratat me të cilat krijohen, njihen, ndryshohen ose pushojnë të drejta pronësie mbi sendet e paluajtshme, të drejta uzufukti, përdorimi e bujtjeje, emfiteoze e servituti e të drejta të tjera reale;

c) aktet me të cilat hiqet dorë nga të drejta pasurore të mësipërme;

ç) vendimet e gjykatave me të cilat njihet cilësia e trashëgimtarit dhe fitohet pasuria e trashëguar;

d) aktet me të cilat krijohet një shoqëri ose një subjekt tjetër i së drejtës që ka në pronësi pasuri të paluajtshme ose gëzon të drejta të tjera reale mbi to;

dh) vendimet e gjykatave ose organeve kompetente shtetërore që përkatësisht përmbajnë fitimin ose njohjen e pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, pjesëtimin e pasurive të paluajtshme ose që deklarojnë të pavlefshme veprimet juridike për kalimin e pronësisë të regjistruar më parë rregullisht, si dhe aktet e përbarimit gjyqësor për sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme ose shitjen në ankand të tyre.

Vërtetimi gjyqësor i faktit të pronësisë nuk regjistrohet.

Neni 194

Në kontratën e dhurimit të pasurisë së paluajtshme, regjistrimi merr datën në të cilën regjistrohet pranimi, në rast se ky përmbahet në një akt të veçantë.

Neni 195

Pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi ato që janë fituar ose njohur sipas dispozitave të këtij Kodi, nuk mund të tjetërsohen dhe kur është rasti, të ngarkohen me barrë, në rast se nuk është bërë regjistrimi i tyre në regjistrat publikë.

Neni 196

Gjykatat, noterët, përmbauesit gjyqësorë dhe organet e tjera shtetërore detyrohen t'i dërgojnë për regjistrim zyrës që administrojnë regjistrin ku ndodhen pasuritë e paluajtshme, kopje të vendimit ose të aktit që përmban fitimin, njohjen, ndryshimin, pushimin e një të drejte pronësie të paluajtshme, ose një të drejte reale mbi atë, ose që deklarojnë të pavlefshme veprime juridike për kalimin e pronësisë të regjistruar më parë.

Neni 197

Duhet të regjistrohen gjithashtu:

- a) kontratat e qiradhënies së sendeve të paluajtshme për një kohë mbi nëntë vjet;
- b) kërkesë-paditë për fitimin, njohjen, ndryshimin ose pushimin e të drejtave të pronësisë ose të drejtave të tjera reale mbi pasuritë e paluajtshme;
- c) kërkesë-paditë për pjesëtimin e pasurisë së paluajtshme të përbashkët.

Neni 198

Ministria e Drejtësisë administrojnë veprimtarinë e regjistrat publik për pasuritë e paluajtshme.

Kushtet, mënyra e regjistrimit dhe e organizimit, si dhe çdo procedurë që ka lidhje me këtë veprimtari, rregullohet me ligj të veçantë.

TITULLI III BASHKËPRONËSIA

KREU I BASHKËPRONËSIA NË PJESË

Përkufizimi dhe përmbajtja

Neni 199

Ka bashkëpronësi kur një ose disa sende dhe të drejta të tjera reale u përkasin bashkërisht dy ose më shumë personave.

Pjesët e bashkëpronarëve janë të barabarta, gjersa nuk vërtetohet e kundërta.
Të drejtat dhe detyrimet e bashkëpronarëve caktohen në përpjesëtim me pjesët përkatëse.

Të drejtat e bashkëpronarëve

Neni 200

Çdo bashkëpronar ka këto të drejta:

- a) të përfitojë nga të ardhurat e sendit të përbashkët në përpjesëtim me pjesën e tij;
- b) të përdorë sendin e përbashkët sipas qëllimit të përcaktuar dhe në mënyrë që të mos i pengojë bashkëpronarët e tjerë të përdorin atë sipas të drejtave të tyre;
- c) të tjetërsojë ose disponojë në çdo mënyrë tjetër pjesën e tij në sendin e përbashkët, por kur ky është një send i paluajtshëm, mund ta shesë pjesën e tij vetëm duke respektuar të drejtën e parablerjes që kanë bashkëpronarët e tjerë sipas nenit 204 të këtij Kodi;
- ç) të kërkojë pjesëtimin e sendit të përbashkët edhe sikur të ketë një marrëveshje të kundërt, përveç kur ky pjesëtim dëmton së tepërmi qëllimin përkatës ose është ndaluar me ligj;
- d) të kërkojë kthimin jo vetëm të pjesës së tij, por të gjithë sendit të përbashkët, me kusht që ky t'u dorëzohet gjithë bashkëpronarëve.

Detyrimet e bashkëpronarit

Neni 201

Çdo bashkëpronar është i detyruar që në përpjesëtim me pjesën e vet, të paguajë shpenzimet e nevojshme për ruajtjen dhe gëzimin e sendit të përbashkët.

Neni 202

Kur sendin e përbashkët e përdorin për vete një ose disa bashkëpronarë, këta detyrohen t'u paguajnë bashkëpronarëve të tjerë shpërblimin për përdorimin e pjesëve të tyre nga dita kur u është njoftuar me shkrim kërkesa e këtij shpërblimi ose nga data e paraqitjes së padisë në gjykatën kompetente.

Administrimi i sendit të përbashkët

Neni 203

Të gjithë bashkëpronarët, pavarësisht nga vlera e pjesës përkatëse, kanë të drejtë të marrin pjesë në administrimin e sendit të përbashkët.

Sendi i përbashkët administrohet sipas mënyrës së miratuar me marrëveshjen e të gjithë bashkëpronarëve dhe kur kjo nuk është arritur, sipas mënyrës së caktuar me vendim të bashkëpronarëve që kanë më shumë se gjysmën e vleftës së tij. Vendimi i shumicës është i detyrueshëm edhe për bashkëpronarët që kanë mbetur në pakicë.

Kjo shumicë mund të vendosë që të vihet hipotekë ose peng mbi sendin e përbashkët, kur kjo është e domosdoshme për të siguruar kthimin e shumave të marra hua për mirëmbajtjen ose rindërtimin e tij.

Kur nuk është arritur kjo shumicë ose kur vendimi i saj është i dëmshëm për sendin e përbashkët, gjykata kompetente, me kërkesën e çdo bashkëpronari, vendos masat që i çmon të nevojshme dhe, sipas rastit, emëron një kujdestar për administrimin e sendit.

E drejta e parablerjes

Neni 204

Bashkëpronari, para se t'ia shesë pjesën e vet në sendin e paluajtshëm një personi që nuk është bashkëpronar, detyrohet të njoftojë me shkrim bashkëpronarët e tjerë nëse dëshirojnë të blejnë pjesën me të njëjtat kushte që do t'ia shesë personit të tretë. Në rast se këta nuk përgjigjen brenda tre muajve se dëshirojnë të blejnë pjesën, bashkëpronari është i lirë të shesë pjesën e tij në persona të tretë.

Ai duhet t'ua bëjë të njohur bashkëpronarëve të tjerë bashkëpronarin e ri.

E drejta e kreditorit mbi pjesën e bashkëpronarit

Neni 205

Çdo kreditor ka të drejtë të realizojë kredinë e vet mbi pjesën që i takon bashkëpronarit debitor në sendin e përbashkët.

Neni 206

Kreditorët dhe trashëgimtarët e ndonjë bashkëpronari mund të ndërhyjnë në pjesëtim, me shpenzimet e tyre, por nuk mund të kundërshtojnë pjesëtimin e bërë më parë, përveç kur kanë njoftuar kundërshtimin e tyre para pjesëtimit.

Në pjesëtimin e pasurisë së paluajtshme, njoftimi për kundërshtimet e përmendura në paragrafin e mësipërm, duhet të regjistrohet përpara regjistrimit të kërkesës për pjesëtim. Gjithashtu, në një pjesëtim të tillë duhet të thirren të gjithë kreditorët që kanë regjistruar kërkesat e tyre ose që kanë fituar të drejta mbi pasurinë që pjesëtohet, përpara regjistrimit të aktit të pjesëtimit ose të regjistrimit të kërkesës për pjesëtim.

Pjesëtimi i sendit të përbashkët

Neni 207

Pjesëtimi i sendit të përbashkët kryhet me marrëveshjen e të gjithë bashkëpronarëve. Kur sendi është i paluajtshëm marrëveshja duhet të bëhet me akt noterial. Kur kjo marrëveshje nuk është arritur, pjesëtimi i sendit kryhet me anë të gjykatës, duke u thirrur në gjyq të gjithë bashkëpronarët. Pjesëtimi i sendit të përbashkët bëhet me ndarjen e tij në natyrë sipas pjesëve që kanë bashkëpronarët, në qoftë se kjo ndarje është e mundshme dhe nuk dëmton qëllimin përkatës të sendit. Pabarazia e pjesëve, që rezulton nga ndarja në natyrë kompensohet me një shpërblim në para.

Kur sendi i përbashkët nuk mund të ndahet në natyrë gjykata urdhëron që ai të shitet në ankand dhe vlefata e tij të ndahet ndërmjet bashkëpronarëve, sipas pjesëve përkatëse, duke llogaritur edhe shumatat që ata duhet t'i paguajnë njëri-tjetrit për shkak të marrëdhënies së bashkëpronësisë.

Megjithatë, në vend të shitjes në ankand, gjykata, kur disa nga bashkëpronarët e kërkojnë, mund të urdhërojë që sendi t'u lihet këtyre, duke i detyruar që t'i paguajnë bashkëpronarit, i cili kërkon pjesëtimin, vleftën e pjesës së tij, sipas mënyrës dhe brenda afateve të caktuara në vendimin gjyqësor.

Kur sendi që nuk mund të ndahet në natyrë, është shtëpi banimi, gjykata ia lë në pjesë, në kushtet e sipërtreguara, atij nga bashkëpronarët që banon në atë shtëpi ose ka nevojë më shumë se të tjerët për atë sipërfaqe banimi.

Tjetërsimi i sendit të përbashkët

Neni 208

Tjetërsimi i sendit të përbashkët mund të bëhet vetëm me pëlqimin e të gjithë bashkëpronarëve.

KREU II

BASHKËPRONËSIA NË TËRËSI

A. Bashkëpronësia e detyrueshme Objektet e përbashkëta të ndërtesave

Neni 209

Në katet ose njësitë e ndara të kateve të një ndërtese që ndodhen në pronësi të veçantë të pronarëve të ndryshëm, janë në bashkëpronësi të detyrueshme të tyre, gjersa në aktin e pronësisë nuk është caktuar ndryshe, këto objekte:

a) trualli mbi të cilin është ngritur ndërtesa, themelet, muret kryesore, muret ndarëse të brendshme, shkallët, hollet, çatia ose tarraca, oxhaqet, si edhe të gjitha ato objekte të ndërtesës, që kanë karakter të tillë dhe shërbejnë për përdorim të përbashkët;

b) pusët, instalimet e ujit, instalimet elektrike, të gazit, të telefonisë e të ngrohjes qendrore, duke përfshirë edhe tubacionet dhe linjat përkatëse, si dhe kanalet e ndryshme deri në pikën e degëzimit të tyre brenda njësive të ndara të kateve.

Neni 210

E drejta e secilit bashkëpronar mbi sendet e përmendura në nenin e mësipërm, është në përpjesëtim me vleftën e katit ose të pjesëve të katit që i përkasin atij, përveç kur titulli parashikon ndryshe.

Heqja dorë nga e drejta mbi sendet e mësipërme, nuk e liron bashkëpronarin nga detyrimi për të kontribuar në shpenzimet për mbajtjen e tyre.

Pandashmëria e objekteve të përbashkëta

Neni 211

Objektet e përbashkëta të ndërtesës nuk lejohet të ndahen, përveç kur ndarja e ndonjërit prej tyre mund të kryhet pa ia vështirësuar përdorimin e tij asnjërit nga bashkëpronarët.

Përbërja e asamblesë dhe zgjedhja e kryesisë

Neni 212

Asambleja përbëhet nga pronarët e secilit kat ose njësie të ndarë të çdo kati, të cilët kanë në bashkëpronësi objektet e përbashkëta të ndërtesës.

Në mbledhjen e parë të asamblesë anëtarët e saj zgjedhin, nga gjiri i tyre, kryesinë, e cila ngarkohet të kryejë, në emër e për llogari të tyre të gjitha veprimet e nevojshme për administrimin dhe mirëmbajtjen e zakonshme të objekteve të përbashkëta, përveç atyre veprimeve që janë në kompetencë vetëm të asamblesë, si dhe të përfaqësojë në instancat gjyqësore kompetente dhe në arbitrazh.

Mbledhjet e asamblesë dhe vlefshmëria e vendimeve

Neni 213

Pas mbledhjes së parë organizuese, mbledhjet e asamblesë thirren një herë në vit. Mbledhje të tjera të asamblesë mund të thirren nga kryesia e saj ose me nismën e jo më pak se 20% të anëtarëve të saj.

Asambleja mund të çelet dhe të marrë vendime kur janë të pranishëm personalisht ose të përfaqësuar me prokurë bashkëpronarët, të cilët kanë të paktën dy të tretat e tërësisë së kuotave. Kur ky numër nuk është i pranishëm, mbledhja shtyhet dhe mbledhja pasardhëse zhvillohet në rast se merr pjesë shumica e zakonshme e bashkëpronarëve.

Vendimet e asamblesë merren me shumicë të thjeshtë votash të bashkëpronarëve, përveç rasteve kur në dispozitat e këtij kreu ose me dispozita të veçanta kërkohet një shumicë e cilësuar. Kur numri i votave është i barabartë, vota e kryetarit është vendimtare.

Kompetencat kryesore të asamblesë

Neni 214

Asambleja ka edhe këto kompetenca kryesore:

1. Miraton rregulloren për administrimin e banesës, e cila hartohet sipas rregullores tip të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

2. Krijon fondin rezervë për shpenzimet e përbashkëta, duke caktuar edhe shumën vjetore të tij.

3. Miraton preventivat e shpenzimeve që ka vendosur të kryhen gjatë vitit, si dhe ndarjen e shumës së tyre midis bashkëpronarëve. Shpenzimet e përbashkëta për mirëmbajtjen, riparimet dhe përmirësimet e zakonshme të këtyre objekteve miratohen nga asambleja me shumicë të thjeshtë votash, ndërsa shpenzimet për përmirësime të mëdha ose rinësime cilësore vendosen me shumicë të cilësuar të bashkëpronarëve që arrijnë të paktën 75% të kuotave përkatëse.

4. Emëron, kur çmohet e domosdoshme, kujdestarin e ndërtesës, duke caktuar kompetencat dhe pagën e tij.

5. Autorizon kryesinë që të sigurojë, brenda kufijve të arsyeshme, objektet që janë pronë e përbashkët, si dhe të lidhë kontrata të tjera të nevojshme për mirëmbajtjen, riparimet dhe përmirësimet e zakonshme, ose, sipas rastit, për përmirësime të mëdha apo rinësime të këtyre objekteve.

Neni 215

Vendimet e marra nga asambleja sipas dispozitave të mësipërme janë të detyrueshme për të gjithë bashkëpronarët.

Padia kundër vendimeve të asamblesë

Neni 216

Kur një vendim i asamblesë është i paligjshëm ose cenon interesat e ndonjërit nga bashkëpronarët e këtyre objekteve, çdo bashkëpronar ka të drejtë të paraqesë në gjykatën kompetente padi për pavlefshmërinë e atij vendimi, brenda tridhjetë ditëve nga data e dhënies së tij. Paraqitja e

kërkesëpadisë nuk pezullon zbatimin e vendimit të asamblesë, përveç kur gjykata ka vendosur ndryshe.

Detyrimet e bashkëpronarëve

Neni 217

Çdo bashkëpronar ka këto detyrime:

1. Të paguajë shpenzimet për ruajtjen dhe gëzimin e pjesëve të përbashkëta të ndërtesës, për kryerje shërbimesh në dobi të përbashkët dhe për ndryshime të vendosura nga shumica e bashkëpronarëve, në përpjesëtim me vleftën e pjesës së secilit, përveç kur ka marrëveshje tjetër.

Për sendet që u shërbejnë bashkëpronarëve në masë të ndryshme, shpenzimet përballohen në përpjesëtim me përdorimin që mund t'u bëjë atyre secili.

Të paguajë shpenzimet për ruajtjen dhe gëzimin e pjesëve të përbashkëta të ndërtesës, për kryerje shërbimesh në dobi të përbashkët dhe për ndryshime të vendosura nga shumica e bashkëpronarëve në përpjesëtim me vleftën e pjesës së secilit, përveç kur ka marrëveshje tjetër.

2. Të mos kryejë në katin ose njësinë e ndarjes së katit, që është në pronësi të veçantë të tij, ndërtime të cilat mund t' u shkaktojnë dëme objekteve të përbashkëta të ndërtesës.

3. Të ndreqë dëmin ose të paguajë shpenzimet për zëvendësimin e tij, që ai vetë ose një anëtar i familjes së tij i ka shkaktuar me faj, cilitdo objekti të përbashkët.

4. Të mos kryejë, pa lejen paraprake të asamblesë, në katin ose në njësinë e ndarë të katit që është në pronë të tij, shtesa ose ndryshime të cilat mund të cenojnë pamjen e jashtme të ndërtesës.

Shtesa të reja mbi katin e fundit

Neni 218

Ndërtimi mbi katin e fundit të një ndërtese, të kateve ose veprave të tjera, mund të realizohet me vendimin e shumicës prej 3/4 të bashkëpronarëve të ndërtesës.

Neni 219

Ndalohet dhënia e lejes për kryerjen e shtesave ose veprave të tilla mbi katin e fundit në qoftë se kushtet statike të ndërtesës nuk e lejojnë.

Bashkëpronarët mund të kundërshtojnë lejen e dhënë nga organi kompetent shtetëror për kryerjen e shtesave ose veprave të tilla mbi katin e fundit dhe kur provohet se ato pakësojnë ajrin apo dritën për katet e mëposhtme ose cenojnë pamjen arkitektonike të ndërtesës.

Neni 220

Ata që janë lejuar të bëjnë shtesa ose vepra të tjera në katin e fundit detyrohen të rindërtojnë tarracën, të cilën të gjithë ose një pjesë e bashkëpronarëve kishin të drejtë ta përdornin.

Shembja tërësore ose pjesore e ndërtesës

Neni 221

Kur ndërtesa shembet tërësisht ose në një pjesë që përbën jo më pak se tre të katërtat e vlerës së saj, secili bashkëpronar mund të kërkojë që të shiten në ankand trualli dhe materialet, përveç kur është vendosur ndryshe.

Kur ndërtesa është dëmtuar në një përmasë më të vogël, asambleja vendos për rindërtimin e objekteve të përbashkëta të ndërtesës dhe secili bashkëpronar i tyre detyrohet të kontribuojë në përpjesëtim me të drejtat e tij në ato objekte.

Bashkëpronari që nuk dëshiron të marrë pjesë në rindërtimin e ndërtesës, duhet t'u shesë bashkëpronarëve të tjerë ose ndonjërit prej tyre edhe objektet, të cilët janë pronë vetëm e tij, sipas vlerësimit që do të bëhet.

B. Bashkëpronësia midis anëtarëve të familjes bujqësore

Neni 222

Pronësia mbi pasurinë e anëtarëve të familjes bujqësore, u përket në tërësi anëtarëve të saj, të cilët nëpërmjet punës ose të drejtave të tjera të fituara, kanë kontribuar në krijimin e në mbajtjen e ekonomisë bujqësore.

Neni 223

Familja bujqësore përbëhet nga personat që lidhen ndërmjet tyre për shkak gjinie, martesë, birësimi ose pranimi si anëtar i saj.

Neni 224

Familja bujqësore përfaqësohet në marrëdhëniet pasurore me të tretët nga kryetari, i cili zgjidhet nga anëtarët e saj.

Neni 225

Në pasurinë e familjes bujqësore nuk përfshihen sendet e përdorimit thjesht vetjak të anëtarëve, si dhe sendet që anëtari ka fituar me të ardhurat e tij vetjake, me dhurim ose me trashëgim.

Neni 226

Anëtari i familjes bujqësore nuk mund të tjetërsojë asnjë pjesë të pasurisë së familjes bujqësore, gjersa nuk është bërë pjesëtimi i saj.

Neni 227

Çdo anëtar i familjes bujqësore mund të kërkojë pjesën e vet në pasurinë e familjes bujqësore. Ajo përcaktohet duke marrë parasysh sidomos:

- a) pasurinë që i përket tërë familjes;
- b) numrin e anëtarëve të familjes;

c) kontributin e tij në vënien ose shtimin e pasurisë së familjes duke u nisur nga sasia ose efektiviteti i këtij kontributi, si dhe nga puna dhe mjetet e dhëna në krijimin dhe mbajtjen e ekonomisë bujqësore.

Neni 228

Pjesëtimi i pasurisë së familjes bujqësore, bëhet sipas rregullave të caktuara në nenin 207 të këtij Kodi.

Kur kërkohet pjesa nga anëtarë të veçantë të saj, ajo vlerësohet dhe i jepet në para.

Kur pjesëtimi kërkohet nga disa pjesëtarë të familjes bujqësore, me qëllim që të krijohet një familje tjetër bujqësore, pjesa mund të jepet në natyrë, me kusht që toka bujqësore që u mbetet familjeve të ndara, të mos jetë nën minimumin e njësisë minimale të kultivimit. Me njësi minimale të kultivimit kuptohet toka bujqësore, që është e nevojshme për mbajtjen e një ekonomie bujqësore, sipas kushteve natyrore të krahinës apo zonës përkatëse.

Neni 229

Familja bujqësore përgjigjet për veprimet e paligjshme të kryera nga anëtarët e saj, gjatë ushtrimit të detyrave që rrjedhin nga veprimtaria ekonomike e vetë familjes bujqësore.

Neni 230

Familja bujqësore nuk përgjigjet për detyrimet ekonomike vetjake të anëtarëve, duke përfshirë edhe kryetarin e saj. Kreditorët kanë të drejtë të paguhet nga pjesa që i takon anëtarit debitor në të ardhurat e familjes bujqësore dhe nga pjesa që i takon atij në pasurinë e familjes bujqësore.

C. Bashkëpronësia ndërmjet bashkëshortëve

Neni 231

Bashkëpronësia ndërmjet bashkëshortëve rregullohet me dispozita të Kodit të Familjes.

TITULLI IV UZUFUKTI

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Përmbajtja e uzufuktit

Neni 232

Uzufukti është e drejta e një personi (uzufuktari) për të gëzuar një send që është në pronësi të një tjetri, me detyrim që ta ruajë e ta mirëmbajë atë.

Mënyra e krijimit të uzufuktit

Neni 233

Uzufukti krijohet me ligj ose me një veprim juridik. Ai mund të fitohet edhe me parashkrimin fitues.

Kohëzgjatja e uzufuktit

Neni 234

Uzufukti mund të jetë me ose pa afat, por në çdo rast nuk mund të kalojë jetën e uzufuktarit.

Kur e drejta e uzufuktit gëzohet nga një person juridik, nuk mund të zgjasë më shumë se tridhjetë vjet.

Mënyra e krijimit

Neni 235

Uzufukti që krijohet me veprim juridik duhet të bëhet me akt noterial, ndërsa kur fitohet me testament veprohet sipas dispozitave përkatëse.

Uzufukti mbi një send të paluajtshëm duhet të regjistrohet në regjistrat e pasurive të paluajtshme.

Bashkuzufukti

Neni 236

Uzufukti mund të jetë në favor të më shumë se një personi. Kur e drejta e njërit prej tyre shuhet, ajo u kalon uzufuktarëve që mbeten, në përpjesëtim me pjesët. Në këtë mënyrë veprohet deri në shuarjen e së drejtës së uzufuktarit të fundit që mbetet.

KREU II

TË DREJTAT QË RRJEDHIN NGA UZUFUKTI

Kufijtë e gëzimit të sendit në uzufukt

Neni 237

Uzufuktari gëzon sendin e vënë në uzufukt, por nuk mund të ndryshojë destinimin ekonomik që ka patur ai në fillim të uzufuktit, pa pëlqimin e pronarit ose pa autorizimin e gjykatës së rrethit, kur pronari dhe uzufuktari nuk merren vesh.

Gjatë vazhdimit të uzufuktit ose në mbarimin e tij, uzufuktari mund të heqë shtesat që i janë bërë sendit, në kushtet e paragrafit të parë të këtij neni, që mund të shkëputen pa e dëmtuar atë, duke e kthyer në gjendjen e tij fillestare, përveç kur parashikohet ndryshe në aktin e krijimit.

Përmirësimet e sendit në uzufukt

Neni 238

Uzufuktari në mbarim të uzufuktit nuk ka të drejtë të kërkojë shpërblimin për përmirësimet e bëra në send gjatë përdorimit edhe sikur të jetë shtuar vlefata e tij, përveç kur është parashikuar ndryshe në aktin e krijimit të uzufuktit.

Shtesa e vleftës mund të kompensohet me dëmet që mund t'i jenë shkaktuar sendit pa fajin e uzufuktarit.

Kur nuk ka vend për kompensim, uzufuktari mund të heqë shtesat e bëra, pa u dëmtuar sendi, përveç kur pronari pranon të paguajë vleftën e tyre, si të ishin të ndara nga sendi.

Përkatësia e frutave

Neni 239

Uzufruktari i takojnë frutat natyrore dhe ato civile që prodhon sendi gjatë kohëvazhdimit të uzufuktit.

Frutat natyrore që nuk janë ndarë nga sendi në kohën e fillimit të uzufuktit, i përkasin uzufuktarit dhe anasjelltas, kur ato nuk janë ndarë nga sendi kur mbaron uzufukti, i përkasin pronarit.

Kalimi i së drejtës së uzufuktit

Neni 240

Uzufuktari mund t'ia kalojë një tjetri këtë të drejtë për një kohë ose për gjithë kohën e qënies së saj, përveç kur në aktin e krijimit është parashikuar ndryshe.

Kalimi duhet t'i njoftohet me shkrim pronarit, përndryshe uzufuktari i mëparshëm dhe personi që ka fituar një të drejtë të tillë përgjigjen solidarisht ndaj pronarit.

E drejta e tjetërsimit

Neni 241

Uzufuktari ka të drejtë të tjetërsojë sendet objekt uzufukti në masën që ato destinohen të tjetërsohen dhe në përputhje me natyrën e tyre.

Në raste të tjera uzufuktari nuk mund të tjetërsojë sendet në uzufukt pa pëlqimin e pronarit ose pa autorizimin e gjykatës së rrethit, përveç kur në aktin e krijimit është parashikuar ndryshe.

Autorizimi nuk duhet të jepet kur preken interesat e pronarit, uzufuktarit ose të personave të tretë.

Zëvendësimi i sendit në uzufukt

Neni 242

Kur sendet në uzufukt janë tjetërsuar ose janë zëvendësuar me sende të tjera, këto i përkasin pronarit dhe njëkohësisht janë objekt i uzufuktit.

Rregulli i mësipërm vlen për gjithçka që sigurohet nga vjelja e detyrimeve objekt uzufukti, nga kompensimi për shpërblimin e dëmeve ose nga zhvleftësimi i pasurisë, kur zëvendësojnë ose përmirësojnë sendet objekt uzufukti.

Janë gjithashtu objekt uzufukti, sendet që vilen nga përfitimet e tjera që jep uzufukti, por që nuk janë fruta.

Investimet

Neni 243

Pronari dhe uzufuktari duhet të merren vesh që paratë objekt uzufukti të investohen në mënyrë frutdhënëse ose të shpenzohen në interes të pasurisë tjetër në uzufukt.

Dhënia me qira

Neni 244

Uzefruktari ka të drejtë të japë me qira sendet në uzufukt përveç kur është parashikuar ndryshe në aktin e krijimit të tij.

Kur mbaron uzufukti, pronari duhet të respektojë qiranë e filluar normalisht më parë, përveç kur zgjatja e afatit të saj është bërë pa pëlqimin e tij. Kur uzufuktari ose qiramarrësi i kanë kërkuar pëlqimin pronarit për qiradhënien dhe ky nuk është përgjigjur në afatin e caktuar, quhet se pëlqimi është dhënë.

Kur pushon uzufukti, qiradhëniet për një afat mbi pesë vjet, kanë vlerë vetëm për pesë vjet nga dita që ka filluar qiradhënia.

Gëzimi i servituteve

Neni 245

Uzefruktari gëzon të drejtat e servituteve të lidhura me pronën mbi të cilën ka uzufuktin dhe të drejtat e tjera reale që do t'i gëzonte vetë pronari, përveç kufizimeve të parashikuara në aktin e krijimit apo në ligj.

KREU III DETYRIME QË RRJEDHIN NGA UZUFUKTI

Zëvendësimi i dëmeve

Neni 246

Uzefruktari detyrohet të shpërblejë vleftën e sendit të humbur ose të dëmtimit të tij, përveç kur provon se nuk janë shkaktuar për fajin e tij.

Ai detyrohet të zëvendësojë sendet që, sipas uzufuktit, nuk kishte të drejtë t'i konsumonte.

Inventarët

Neni 247

Uzefruktari merr në dorëzim sendet në gjendjen që ndodhen para fillimit të uzufuktit.

Sendet në uzufukt merren në dorëzim me inventar të bërë me akt noterial, në prani të pronarit, pasi të jetë njoftuar në një afat të përshtatshëm. Është e drejtë e palëve që në inventar të shënohen të gjitha hollësitë që kanë lidhje me përcaktimin dhe gjendjen e sendeve që merren në uzufukt.

Inventari mund të kryhet edhe me akt privat, kur bien në marrëveshje të dy palët, që janë të pranishëm gjatë kryerjes së tij. Shpenzimet për kryerjen e inventarit janë në ngarkim të uzufuktarit, përveç kur parashikohet ndryshe në aktin e krijimit.

Njoftimet periodike

Neni 248

Uzefruktari detyrohet t'i dërgojë pronarit në fund të çdo viti një njoftim të hollësishëm me shkrim të nënshkruar prej tij, për sendet që nuk ekzistojnë më ose për sendet që i kanë zëvendësuar ato, si dhe përfitimet e tjera nga sendet në uzufukt, që nuk hyjnë në kategorinë e frutave.

Shpenzimet për kryerjen e detës vjetore, janë në ngarkim të uzufruktarit, përveç kur në aktin e krijimit është parashikuar ndryshe.

Dhënia e garancisë

Neni 249

Uzufruktari detyrohet t'i japë pronarit një garanci me shkrim për përmbushjen e detyrimeve të rrjedhura nga uzufrukti, përveç kur në aktin e krijimit është shkarkuar nga një detyrim i tillë ose kur interesat e pronarit mbi sendet në uzufrukt janë siguruar në mënyrë të mjaftueshme nga një institut i ngarkuar me këtë punë.

Prindërit që kanë uzufruktin ligjor mbi sendet në pronësi të fëmijëve të tyre, përjashtohen nga dhënia e një garancie të tillë.

Kur uzufruktari është shkarkuar nga detyrimi për dhënien e garancisë, pronarit i lind e drejta të kërkojë prej tij që t'i tregohen çdo vit sendet që i janë dhënë në uzufrukt ose të njihet me njoftimin e një institucioni krediti për paratë apo letrat me vlerë të depozituara.

Uzufruktari nuk mund të fitojë posedimin e sendeve të vëna në uzufrukt, pa plotësuar detyrimet që rrjedhin nga ky nen.

Pasojat e mosdhënies së garancisë

Neni 250

Kur uzufruktari nuk jep garanci, merren masa për administrimin e sendeve në uzufrukt. Sendet e paluajtshme jepen me qira ose i besohen një administratori të zgjedhur me marrëveshje ndërmjet pronarit e administratorit dhe kur nuk arrihet një marrëveshje e tillë, administratori caktohet nga gjykata e rrethit.

Uzufruktari ka të drejtë të mbajë për banim të tij dhe të familjes së tij, një banesë që përfshihet në uzufrukt.

Paratë që përfshihen në uzufrukt investohen me kamatë.

Sendet e luajtshme që vjetërohen ose dëmtohen nga përdorimi ose sendet ushqimore që rrezikohen të prishen, shiten dhe vlefta e tyre jepet me kamatë ose përdoret për sendet në uzufrukt.

Uzufruktari mund të kërkojë t'i lihen sende të luajtshme të mjaftueshme për përdorim vetjak.

Shpenzimet e mirëmbajtjes

Neni 251

Shpenzimet që nevojiten për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe administrimin e sendit janë në ngarkim të uzufruktarit. Janë gjithashtu në ngarkim të tij edhe shpenzimet për ndreqjet jo të zakonshme, kur ato janë rrjedhim i mospërmbushjes së detyrimeve të tij ndaj sendit në uzufrukt.

Riparimet e jashtëzakonshme janë në ngarkim të pronarit. Kur pronari refuzon t'i kryejë ato ose të tjerat që i janë ngarkuar atij, ose vonon pa arsye kryerjen e tyre, uzufruktari i kryen vetë me shpenzimet e tij, të cilat shlyhen deri në përfundimin e uzufruktit. Uzufruktari ka të drejtë të mbajë sendin e ndrequr deri në shlyerjen e shpenzimeve.

Sigurimi i uzufruktit

Neni 252

Uzufruktari duhet të sigurojë sendet në uzufukt në favor të pronarit për rreziqet që zakonisht ato duhet të sigurohen ose që janë të detyrueshme nga ligji. Në rast dëmtimi uzufukti shtrihet mbi shpërblimin e paguar.

Kur uzufukti nuk përmbush një detyrim të tillë, pronari ka të drejtë të bëjë vetë sigurimin e pronës dhe uzufruktari detyrohet t'i paguajë shpenzimet përkatëse.

Shpronësimi i sendeve në uzufukt

Neni 253

Kur sendi shpronësohet për interesa publikë, uzufukti kalon mbi shpërblimin përkatës.

Pagimi i taksave dhe i detyrimeve të tjera

Neni 254

Tatimet, taksat, shpërblimet, rentat tokësore dhe detyrimet e tjera vjetore që kanë lidhje me të ardhurat gjatë uzufuktit janë në ngarkim të uzufuktarit.

Tatimet, taksat e detyrimet e tjera në ngarkim të pronës gjatë uzufuktit, janë në ngarkim të pronarit.

KREU IV

MBARIMI I UZUFUKTIT

Neni 255

Uzufukti mbaron:

- me vdekjen e uzufuktarit ose me mbarimin e personit juridik uzufuktari;
- me mbarimin e afatit të caktuar në aktin e krijimit;
- me bashkimin e cilësive të pronarit e të uzufuktarit në një person të vetëm;
- me shkatërrimin tërësisht ose humbjen e sendit të dhënë në uzufukt;
- me mospërdorimin e uzufuktit radhazi për njëzet vjet.

Pushimi i uzufuktit

Neni 256

Uzufukti mund të pushojë kur uzufuktari shpërdoron të drejtat ose nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga uzufukti.

Megjithatë gjykata, sipas rrethanave që do të rezultojnë mund të urdhërojë që uzufuktari t'i japë garanci, në rast se ka qenë shkarkuar nga një detyrim i tillë, ose me kërkesën e pronarit t'i lihet atij administrimi i sendit në uzufukt ose një personi tjetër ose dhe dhënia me qira e sendit.

Heqja dorë nga uzufukti

Neni 257

Uzufuktari mund të kërkojë që, me shpenzimet e tij, të heqë dorë nga uzufukti për shkak të barrëve e detyrimeve që rrjedhin prej tij.

Kthimi i sendeve në uzufrukt

Neni 258

Kur mbaron uzufrukti, uzufruktari ose trashëgimtarët e tij detyrohen të vënë në dispozicion të pronarit sendet e vëna në uzufrukt.

TITULLI V PËRDORIMI E BANIMI

Neni 259

Personi që ka një të drejtë thjesht përdorimi mbi një send, e përdor atë dhe gëzon frutet e tij në masën që ka nevojë për vete e për familjen e tij.

Kur objekti i të drejtës së përdorimit është një banesë, personi ka të drejtë të banojë atje sipas nevojave të tij e të familjes së tij. Sendi ose banesa që përdoret sipas kësaj dispozite nuk mund të tjetërsohet, të rëndohet dhe as të përdoret nga persona të tjerë.

Neni 260

Dispozitat që kanë lidhje me uzufruktin zbatohen dhe për të drejtën e përdorimit dhe të banimit, për aq sa përputhen me këto të drejta.

TITULLI VI SERVITUTET

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 261

Servituti është barra që i ngarkohet një prone, për përdorimin dhe dobinë e një prone të një pronari tjetër.

Neni 262

Servituti vendoset me ligj ose me vullnetin e njeriut.

Neni 263

Pronari i pronës shërbyese nuk është i detyruar të kryejë ndonjë veprim për të bërë të mundur ushtrimin e servitutit, përveç kur në ligj ose nga titulli, parashikohet ndryshe.

Neni 264

Pronari, në favor të të cilit është vënë servituti, detyrohet t'i shpërblejë pronarit të pronës shërbyese dëmin që i shkaktohet nga krijimi i servitutit.

KREU II SERVITUTET DETYRUESE

Neni 265

Pronari i një prone që, në bazë të ligjit, ka të drejtë të kërkojë nga pronari i një prone tjetër krijimin e një servituti, në mungesë të një marrëveshjeje, mund t'i drejtohet gjykatës.

Servituti detyruar mund të krijohet edhe me akt të organit shtetëror, në rastet e parashikuara me ligj.

Vendimi duhet të përcaktojë rregullat e ushtrimit të servitutit dhe shpërblimin e dëmit përkatës.

Rrjedhja e ujërave

Neni 266

Pronari është i detyruar të pranojë në tokën e tij ujërat e shiut, të borës ose të burimeve të pashfrytëzuara, që rrjedhin natyrshëm nga një tokë me nivel më të lartë. Pronari nuk mund të ndryshojë këtë rrjedhë natyrore në dëm të një tjetri.

Uji që rrjedh mbi një tokë të mëposhtme mund të mbahet nga pronari i tokës së mësipërme, vetëm në masën që është e domosdoshme për atë tokë.

Neni 267

Në rastet kur anëbrigjet dhe shpatet e një prone që shërbenin për të ndaluar ujërat, janë shkatërruar ose dëmtuar, si dhe kur del e nevojshme që nga shkakut i ujërave të ndërtohen mbrojtësa dhe pronari i asaj prone nuk pranon t'i ndërtojë ose t'i riparojë, pronarët e dëmtuar ose që rrezikohen të dëmtohen, mundet që me shpenzimet e tyre t'i ndërtojnë ose t'i riparojnë ato.

Këto ndërtime e riparime duhet të kryhen pa iu shkaktuar pronarit të pronës shërbyese ndonjë dëm, duke respektuar rregullat e posaçme, kur ka të tilla. Kur pronari i pronës shërbyese ka kundërshtime, mosmarrëveshja zgjidhet nga gjykata.

Neni 268

Dispozitat e nenit të mësipërm zbatohen edhe kur del e nevojshme të hiqet një pengesë lëndësh të formuara në një pronë tjetër ose në një hendek, rrjedhë uji ose vijë kulluese, të cilat dëmtojnë pronat fqinje.

Neni 269

Pronari që ka një burim uji në pronën e vet është i lirë në përdorimin e tij, por pa cenuar të drejtat që mund të ketë fituar pronari i pronës më të ulët në bazë të një titulli ose me parashkrim.

Neni 270

Në rast se një rrjedhë uji u ndalon pronarëve të pronave ngjitur, hyrjen në këto ose vazhdimin e vaditjes apo të kullimit të ujërave, ata që përdorin këtë rrjedhë, detyrohen që në proporcion me

përfitimin që nxirret prej tij (ujit) të ndërtojnë e të mirëmbajnë urat e mjetet e tjera të kalimit, në mënyrë të vulltshme e të sigurt, si dhe gypat e nëndheshëm ose vepra të tjera të kësaj natyre për vazhdimin e ujitjes e të kullimit.

Neni 271

Pronari i një toke detyrohet të pranojë pa shpërblim ujërat që vijnë nga drenazhimi i një toke të mësipërme, kur ato rrjedhin natyrshëm në tokën e tij.

Kur nga kjo rrjedhë i shkaktohet dëm, ai ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe marrjen e masave për mënjanimin në të ardhmen.

Servitutet që rrjedhin nga ndërtimet

Neni 272

Rregullat për ndërtimin e banesave e të ndërtimeve të tjera, largësia ndërmjet tyre, marrja e dritës dhe e pamjes, nxjerrja e ballkoneve e ndërtime të tjera të kësaj natyre, rregullohen me ligj të veçantë duke respektuar të drejtat e pronarit të parashikuara në këtë Kod e në ligje të veçanta.

Servitutet që rrjedhin nga marrja e ujit

Neni 273

Kalimi i ujërave nëpër pronën e tjetrit duhet të kryhet në mënyrën më të vulltshme e më të përshtatshme me më pak dëme, por pa penguar ushtrimin normal të servitutit.

Neni 274

Kur kalimi i ujërave kërkohet për një kohë jo më të gjatë se nëntë vjet, pagimi i vleftës dhe i shpërblimit të dëmeve të përmendura në dispozitën e mësipërme bëhet në gjysmën e kësaj vlefte, me detyrimin që me mbarimin e afatit të rivihet gjithçka në gjendjen e mëparshme.

Ky servitut mund të bëhet i përhershëm kur kjo kërkohet para mbarimit të afatit, nëpërmjet pagimit të gjysmës tjetër, të vleftës së bashku me kamatat ligjore, nga data që ka filluar kalimi.

Kur kërkesa bëhet pas mbarimit të afatit, nuk merren parasysh pagesat për dhënien përkohësisht të kësaj të drejte.

Neni 275

Kur kalimi i ujërave duhet të kryhet duke përkrahur rrugë publike ose lumenj e ndërtime të tjera publike, zbatohen rregullat e parashikuara në dispozita të veçanta.

Neni 276

Kur në një shtëpi ose në mjediset e tjera të saj mungon uji i nevojshëm për jetesën e njerëzve ose të kafshëve dhe nuk mund të sigurohet ndryshe, ose nevojiten shpenzime të mëdha, pronari i tokës fqinje duhet të lejojë që një sasi uji teprice të përdoret në masën e domosdoshme për nevojat e

mësipërme, duke përballuar pala tjetër vleftën e ujit që kërkohet dhe shpenzimet që duhet të kryhen për këtë qëllim, si dhe kur është rasti të shpërblejë dëmin që mund të shkaktohet.

Servituti i kalimit

Neni 277

Pronari që nuk ka dalje në rrugën publike dhe nuk mund ta sigurojë atë përveç se me shpenzime të mëdha e me vështirësi, ka të drejtë të ketë rrugë kalimi nga toka fqinje, për përdorimin e përshtatshëm të pronës së vet.

Kalimi duhet të përbëjë rrugën më të shkurtër për në rrugën publike dhe me më pak dëme për pronën shërbyese.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur pronari, që i është njohur e drejta e kalimit në pronën e tjetrit, kërkon zgjerimin e arsyeshëm të rrugëkalimit për mjete, duke përfshirë edhe kalimin e mjeteve mekanike.

Neni 278

Pronari duhet të lejojë fqinjin të hyjë e të kalojë në tokën e tij sa herë ka nevojë të ndërtojë ose të ndreqë një mur apo një vepër tjetër. Ai duhet të lejojë personin që të kërkojë e të marrë gjënë e gjallë e çdo send tjetër të tij, që ndodhen aty rastësisht ose si rrjedhim i erës, ujit, ortekëve dhe forcave të tjera madhore, ndodhen në tokën e tij apo janë bashkuar me sende të tij.

Pronari mund të mos lejojë hyrjen kur merr përsipër të dorëzojë vetë sendin e ndodhur në tokën e tij. Kur është rasti pronari i tokës shpërblehet për dëmin e shkaktuar.

Neni 279

Personi që do të kalojë në tokën e tjetrit, duhet të paguajë vleftën e tokës që zihet, pa zbritur tatimet e barrët e tjera që lidhen me tokën, si dhe shpërblimin për dëmin që shkaktohet duke përfshirë edhe dëmin që vjen nga ndërprerja e tokës, nga mospërdorimi i saj, nga depozitimi i lëndëve të nxjerra e hedhja e mbeturinave. Pronari i tokës shërbyese ka të drejtë të largojë këto të fundit dhe ta përdorë sipërfaqen e tokës, por gjithnjë pa dëmtuar ushtrimin normal të servitutit.

Servituti për vendosjen e gypave, kablllove e telave

Neni 280

Pronari duhet të lejojë persona të tjerë që të ndërtojnë në pronën e tij të paluajshme kanale ose të vendosin gypa për kalimin e ujit ose të gazit, si dhe kablllo e tela telegrafikë ose elektrikë dhe instalime të tjera të kësaj natyre, por vetëm kur këto vepra nuk kanë mundësi të kryhen ndryshe ose pa u bërë shpenzime të mëdha. Pronari, kur i shkaktohet dëm, ka të drejtë të shpërblehet.

KREU III

SERVITUTET VULLNETARE

Neni 281

Pronari mund të krijojë mbi pronat e veta ose në dobi të tyre, çdo lloj servituti, me kusht që të mos jetë në kundërshtim me rendin juridik.

Servitutet vullnetare krijohen me kontratë ose me testament.

Neni 282

Servitutet janë vijuese kur ushtrimi i tyre bëhet pa qenë nevoja për veprime të herëpashërshme të njeriut, siç janë vijat e ujit, pikat e strehëve e të tjera të kësaj natyre.

Servitutet janë jovijuese, kur në ushtrimin e tyre kërkohet kryerja e veprimeve të tashme të njeriut, siç janë e drejta për të marrë ujë, për kullotjen e bagëtive e të tjera të kësaj natyre.

Servitutet mund të jenë të dukshme e të padukshme.

Të padukshme janë servitutet për të cilat nuk nevojiten punime të dukshme ose të përhershme, që janë të nevojshme për ushtrimin e tyre.

Neni 283

Servitutet vijuese e të dukshme krijohen me titull ose me parashkrimin dhjetëvjeçar.

Servitutet vijuese të padukshme dhe servitutet jovijuese, të dukshme ose jo, nuk mund të krijohen veçse me titull.

Neni 284

Kur dy prona pushojnë së qëni në pronësinë e një personi, servituti konsiderohet se ekziston në mënyrë aktive apo pasive në dobi ose kundër secilës nga pronat e veçuara, përveç kur ka marrëveshje të kundërt.

KREU IV MËNYRAT E USHTRIMIT TË SERVITUTEVE

Neni 285

E drejta e servitutit përfshin çdo gjë që është e nevojshme për ta përdorur atë.

Neni 286

Pronari, pa pëlqimin e uzufuktarit, nuk mund të ngarkojë pronën me servitute që cenojnë të drejtat e uzufuktarit.

Neni 287

Servituti mbi një pronë që u përket disa personave në bashkëpronësi mund të krijohet vetëm me miratimin e gjithë bashkëpronarëve. Servituti i krijuar nga vetëm një ose disa bashkëpronarë, hyn në fuqi kur bashkëpronarët e tjerë bashkërisht apo veçmas, kanë dhënë miratimin për krijimin e tij.

Neni 288

Personi që ka një të drejtë servituti, duhet ta përdorë atë sipas titullit të tij ose të posedimit të tij. Kur ka dyshime rreth shtrirjes dhe mënyrës së ushtrimit të tij, quhet se servituti është krijuar në mënyrë të tillë që të plotësojë nevojat e pronës dominuese, duke rënduar sa më pak pronën shërbyese.

Neni 289

E drejta e servitutit duhet të ushtrohet në kohën dhe në mënyrën që sjell më pak vështirësi e shqetësime për pronarin e pronës shërbyese.

Neni 290

Kur prona në dobi të së cilës është krijuar një servitut pjesëtohet, servituti do t'i shërbejë secilës pjesë, me kusht që barra e pronës shërbyese të mos rëndohet.

Neni 291

Pronari nuk duhet që me veprimet ose mosveprimet e tij të pakësojë përdorimin e servitutit ose ta bëjë atë më të vështirë.

Me gjithë këtë, në qoftë se kanë ndryshuar kushtet dhe pronari i pronës shërbyese rëndohet ose pengohet në ushtrimin e të drejtave të pronësisë, mund t'i kërkojë pronarit, në dobi të të cilit është vënë servituti, ndërrimin e vendit të servitutit.

Këtë të drejtë e ka edhe pronari i pronës tjetër, kur provohet se ky ndërrim sjell dobi dhe nuk dëmton pronën shërbyese.

Mbrojtja e servitutit

Neni 292

Personi që ushtron një servitut, ka të drejtë të kërkojë gjyqësisht nga kushdo që kundërshton këtë të drejtë, duke kërkuar sipas rastit rivendosjen e plotë të saj, pushimin e cenimit që i bëhet si edhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar.

KREU V SHUARJA E SERVITUTEVE

Neni 293

Servitutet shuhen:

a) Kur në një person të vetëm bashkohet pronësia e pronës mbizotëruese me atë të pronës shërbyese.

b) Kur nuk përdoret për më shumë se dhjetë vjet.

Afati i parashkrimit për servitutet jovicuese fillon të ecë nga dita kur servituti ka pushuar së përdoruri, ndërsa për servitutet vijuese nga dita kur është kryer një vepër ose është vërtetuar një fakt që pengon ushtrimin e servitutit. Për efekt të shuarjes së servitutit, llogaritet edhe koha që ai është ushtruar nga titullari i mëparshëm.

c) Kur sendet dëmtohen ose konsumohen deri në një shkallë sa nuk mund të përdoren për qëllimin e tyre.

Rikthimi në një gjendje që mund të përdoren sjell si rrjedhim edhe rivendosjen e servituteve, përveç kur kjo e drejtë është parashkruar.

Neni 294

Kur prona mbizotëruese është në bashkëpronësi, përdorimi i servitutit nga njëri prej bashkëpronarëve, ndërpret parashkrimin edhe ndaj bashkëpronarëve të tjerë.

Neni 295

Pezullimi ose ndërprerja e parashkrimit në favor të njërit nga bashkëpronarët, ka efekt edhe në favor të të tjerëve.

TTULLI VII MBROJTJA E PRONËSISË

Padia për kërkimin e sendit

Neni 296

Pronari ka të drejtë të ngrejë padi për të kërkuar sendin e tij nga çdo posedues ose mbajtës. Këtë të drejtë e ka edhe çdo bashkëpronar për sendin e përbashkët, me qëllim që ai t'u dorëzohet gjithë bashkëpronarëve.

Të drejtat e poseduesit për të ardhurat

Neni 297

Poseduesit me mirëbesim i takojnë frutat natyrore të veçuara dhe frutat civile të vjela që janë bërë të kërkueshme deri në ditën që ka marrë dijeni se është posedues i paligjshëm, ose që i është njoftuar padia e pronarit për kërkimin e sendit. Ai nuk detyrohet të shpërblejë pronarin për humbjen, dëmtimin ose pamundësinë e kthimit të sendit për çdo shkak tjetër, por pas kësaj dite ai përgjigjet për frutat e vjela ose që duhet të kish vjelë, duke vepruar me përkujdesje deri në kohën e kthimit të sendit, për shpërblimin për përdorimin e sendit, si dhe për humbjen, dëmtimin ose pamundësinë e kthimit për faj të tij.

Neni 298

Poseduesi me keqbesim për gjithë kohën e posedimit të tij, detyrohet t'i kthejë pronarit bashkë me sendin edhe frutat natyrore të veçuara e frutat civile të vjela ose që janë bërë të kërkueshme, dhe të ardhurat e tjera që duhej të vilte, si dhe të shpërblejë pronarin për përdorimin e sendit dhe për humbjen, dëmtimin ose pamundësinë e kthimit të sendit qoftë dhe pa fajin e tij.

Ai shkarkohet nga përgjegjësia kur provon se dëmi do të shkaktohej edhe sikur të kishte dorëzuar sendin në kohën e duhur, përveç kur ai është marrë me anë vepre penale.

E drejta e poseduesit për shpenzimet

Neni 299

Poseduesi me mirëbesim ka të drejtë të kërkojë pagimin e shpenzimeve të nevojshme që kanë bërë për sendin dhe shpenzimet e dobishme, në masën që këto i kanë shtuar vleftën, në qoftë se kjo vazhdon të jetë në kohën e kthimit të sendit.

Poseduesi me mirëbesim ka të drejtë të zbresë nga të ardhurat e sendit, shpenzimet që i njihen sipas kësaj dispozite. Ai ka të drejtë të mbajë sendin, gjersa t'i paguhen shpenzimet e nevojshme të dobishme.

Neni 300

Poseduesi me keqbesim ka të drejtë të kërkojë vetëm pagimin e shpenzimeve të nevojshme që ka bërë për sendin.

Neni 301

Poseduesi me mirëbesim dhe ai me keqbesim, përveç shpenzimeve që u njihen sipas neneve të këtij Kodi, nuk kanë të drejtë të kërkojnë pagimin e shpenzimeve të tjera të bëra për sendin, por vetëm kanë të drejtë të heqin nga sendi atë që kanë bashkuar dhe që mund të ndahet pa dëm, përveç kur pronari pranon të paguajë vleftën e tyre.

Padia mohuese

Neni 302

Pronari ka të drejtë të kërkojë nga cilido që e cenon në pronësinë e tij, por pa u zhveshur nga posedimi, të pushojë cenimin dhe të mos përsërisë këtë në të ardhmen, dhe, kur është rasti të shpërblejë dëmet që mund t'i ketë shkaktuar.

Kallëzimi i një punimi të ri dhe i një dëmi të mundshëm

Neni 303

Pronari, personi që gëzon një të drejtë tjetër reale ose poseduesi, të cilët kanë arsye të shqetësohen se nga një punim i ri i filluar prej të tjerëve në tokën e tyre ose të tjetërkujt, mund t'i vijë dëm sendit në pronësi ose në posedimin e tij, mund t'i drejtohet gjykatës me kusht që ky punim të mos ketë përfunduar ose të mos ketë kaluar një vit nga fillimi i tij.

Gjykata sipas rastit vendos ndalimin e punimit, shembjen ose pakësimin e tij dhe kur është rasti edhe shpërblimin e dëmit ose rrëzon padinë duke urdhëruar shpërblimin e dëmit kur rezulton se punimi ka qenë ndaluar padrejtësisht.

TTULLI VIII

POSEDIMI

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Kuptimi i posedimit

Neni 304

Posedimi është sundimi efektiv i një personi mbi një send dhe mbi të drejtat e tjera reale mbi atë. Posedimi mund të ushtrohet drejtpërsëdrejti ose nga një person që mban sendin.

Llojet e posedimit

Neni 305

Posedimi i personit jo pronar mund të jetë i ligjshëm ose i paligjshëm.

Posedimi është i ligjshëm kur poseduesi e ka posedimin nga pronari, në bazë të një veprimi juridik, në bazë të ligjit ose të një akti administrativ.

Në të gjitha rastet e tjera posedimi është i paligjshëm.

Neni 306

Posedimi i paligjshëm mund të jetë me mirëbesim ose me keqbesim.

Posedimi është me mirëbesim kur poseduesi nuk ka ditur ose nuk ishte i detyruar të dinte se posedimi i tij është i paligjshëm.

Mirëbesimi prezumohet dhe mjafton të ketë qenë në kohën e fitimit të posedimit.

Prezumime mbi posedimin

Neni 307

Poseduesi i tanishëm që ka poseduar në një kohë të mëparshme, prezumohet se ka poseduar edhe në kohën e ndërmjetme.

Neni 308

Posedimi i tanishëm nuk prezumon posedimin e mëparshëm, përveç kur poseduesi ka një titull që përbën bazën e posedimit të tij.

Në këtë rast poseduesi prezumohet që të ketë qenë poseduar që nga data e titullit.

Mënyrat e fitimit të posedimit

Neni 309

Posedimi fitohet me anë veprimesh juridike, me trashëgim dhe me pushtim.

Ai që ka fituar posedimin me mirëbesim, mund të bashkojë në posedimin e vet, edhe kohën e posedimit me mirëbesim të personit nga i cili ka fituar sendin.

KREU II

MBROJTJA E POSEDIMIT DHE E MBAJTJES

Mbrojtja e atëçastme

Neni 310

Poseduesi ka të drejtë të kundërshtojë aty për aty, duke përdorur një mbrojtje të përshtatshme, çdo veprim që ka për qëllim cenimin ose zhveshjen nga posedimi. Kur sendi është marrë me dhunë ose fshehurazi, poseduesi ka të drejtë ta marrë atë menjëherë ose në ndjekje e sipër, por duke evituar veprimet e dhunës që nuk pajtohen me rrethanat e ngjarjes.

Neni 311

E drejta për të mbrojtur posedimin i njihet edhe mbajtësit të sendit, kundër çdo personi tjetër, përveç ndaj atij nga i cili i vijnë këto të drejta.

Pushimi i cenimit të posedimit

Neni 312

Personi, që cenohet në posedimin e një sendi, mund të kërkojë brenda gjashtë muajve, pushimin e cenimit të posedimit dhe mospërsëritjen e tij në të ardhmen.

Kur posedimi është fituar me dhunë ose fshehurazi, padia mund të ngrihet brenda gjashtë muajve nga dita kur dhuna ose fshehtësia kanë pushuar.

Pushimi i cenimit të posedimit nuk mund të kërkohet nga personi që ka fituar posedimin me dhunë ose fshehurazi.

Rivendosja në posedim

Neni 313

Poseduesi, që në mënyrë të paligjshme është zhveshur nga posedimi, ka të drejtë të kërkojë brenda gjashtë muajve, rivendosjen e tij në posedim.

Këtë të drejtë nuk e ka poseduesi që ka marrë posedimin me dhunë ose fshehurazi.

Kur zhveshja është e fshehtë, afati për të kërkuar rivendosjen e posedimit fillon nga dita e zbulimit të zhveshjes.

Neni 314

Rivendosja mund të kërkohet edhe kundër atij që e ka fituar posedimin nëpërmjet një titulli, por që ka patur dijeni për zhveshjen e ndodhur.

Neni 315

Gjatë gjyqimit të padisë për pushimin e cenimit ose rivendosjen në posedim, i padituri nuk mund të pretendojë se është vetë pronar ose ka një të drejtë më të fortë se ajo e poseduesit.

PJESA III TRASHËGIMIA

TITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Kuptimi i trashëgimit

Neni 316

Trashëgimia është kalimi me ligj ose me testament i pasurisë (trashëgimit) të personit të vdekur, një ose më shumë personave (trashëgimtarë), sipas rregullave të caktuara në këtë Kod.

Neni 317

Trashëgimia me ligj zbatohet kur trashëgimlënësi nuk ka bërë testament, ose ka bërë vetëm për një pjesë të pasurisë së tij, ose kur testamenti është tërësisht ose pjesërisht i pavlefshëm.

Neni 318

Koha e çeljes së trashëgimisë

(Ndryshuar me ligjin nr. 121/2013, datë 18.4.2013)

Trashëgimia çelet kur vdes trashëgimlënësi.

Në rastin e shpalljes së personit të vdekur, trashëgimia çelet ditën kur, sipas vendimit gjyqësor, personi konsiderohet i vdekur.

Neni 318/1

Vendi i çeljes së trashëgimisë

(Shtuar me ligjin nr. 121/2013, datë 18.4.2013)

Trashëgimia çelet në vendin ku ka patur vendbanimin e fundit trashëgimlënësi. Kur vendbanimi i fundit i trashëgimlënësit nuk dihet, trashëgimia çelet në vendin ku ndodhet e gjithë pasuria e tij ose pjesa kryesore e saj.

Neni 318/2

Ligji i zbatueshëm

(Shtuar me ligjin nr. 121/2013, datë 18.4.2013)

Trashëgimia rregullohet sipas ligjit të kohës kur është çelur.

Neni 319

Është e pavlefshme çdo marrëveshje me të cilën disponohen ose përdorohen të drejta që rrjedhin nga një trashëgim ende i paçelur.

Zotësia për të trashëguar

Neni 320

Ka zotësi për të trashëguar personi që në kohën e çeljes së trashëgimisë është gjallë, ose është zënë para vdekjes së trashëgimlënësit dhe ka lindur i gjallë.

Prezumohet se ka qenë zënë në kohën e çeljes së trashëgimisë, ai që ka lindur brenda 300 ditëve nga vdekja e trashëgimlënësit.

Neni 321

Kur dy ose më shumë persona thirren për të trashëguar njëri - tjetrin dhe nuk vërtetohet se cili prej tyre ka vdekur më parë, prezumohet se të gjithë kanë vdekur në të njëjtën kohë dhe nuk kalon ndonjë e drejtë nga njëri tek tjetri.

Padenjësia

Neni 322

Nuk mund të trashëgojë si i padenjë:

- ai që me dashje ka vrarë ose ka tentuar të vrasë trashëgimlënësin, bashkëshorten, fëmijët dhe prindërit e tij;
- ai që ka bërë ndaj trashëgimlënësit kallëzim ose dëshmi të rreme, për kryerjen e një vepre penale për të cilën parashikohet dënim me vdekje ose me heqje lirie mbi 10 vjet, kur kallëzimi ose dëshmia janë deklaruar të rremë në një gjykim penal;
- ai që me mashtrim, kanosje e dhunë ka shtyrë trashëgimlënësin që të bëjë, të ndryshojë ose të shfuqizojë testamentin ose ka përpiluar vetë një testament të rremë ose e ka përdorur atë për interesa të tij apo të të tjerëve;
- ai që është sjellë ndaj trashëgimlënësit në mënyrë poshtëruese dhe që e ka keqtrajtuar atë.

Neni 323

Padenjësia e prindit ose e të paralindurit, nuk përjashton fëmijët ose të paslindurit e këtij, si kur trashëgojnë vetë, ashtu dhe kur vijnë në trashëgim me zëvendësim. Në një rast të tillë, prindi i padenjë, në pjesën trashëgimore që u vjen fëmijëve të tij nuk mund të gëzojë të drejtat e uzufuktit dhe të administrimit, që ligji u njeh prindërve mbi pasuritë e fëmijëve të tyre.

Falja e padenjësisë

Neni 324

Trashëgimlënësi ka të drejtë ta falë personin e padenjë për ta trashëguar, me kusht që falja të bëhet shprehimisht me akt noterial ose me testament, ose kur falja, ndonëse nuk është bërë shprehimisht, trashëgimlënësi ka shënuar në testament se e ka njohur padenjësinë e megjithatë e cakton atë si trashëgimtar.

Detyrimet e trashëgimtarit të padenjë

Neni 325

Personi i përjashtuar nga trashëgimi si i padenjë detyrohet të kthejë frutat dhe çdo të ardhur tjetër që ka marrë nga pasuria në trashëgim pas çeljes së trashëgimisë.

Zëvendësimi

Neni 326

Zëvendësimi lejon vënien e zëvendësuesve në vendin, shkallën dhe në të drejtat e atij që zëvendësojnë.

Neni 327

Zëvendësimi në vijë të drejtë i të paslindurve, bëhet pa kufi dhe në të gjitha rastet, qoftë kur fëmija e trashëgimlënësit të konkurrojë me të paslindurit e një fëmije tjetër të paravdekur, qoftë dhe kur fëmijët e trashëgimlënësit kanë vdekur para tij dhe të paslindurit e këtyre janë ose jo në shkallë të njëjta, ose të numrit të tyre sipas barqeve.

Neni 328

Për të paralindurit në vijë të drejtë nuk ka zëvendësim; më i afërti përjashton të tjerët.

Neni 329

Në vijë të tërthortë, zëvendësimi pranohet në favor të fëmijëve e të paslindurve, të vëllezërve e motrave të trashëgimlënësit, edhe sikur këta të konkurrojnë me ungjit apo emtat e tyre apo me të paslindurit e tyre në shkallë të njëjtë ose jo.

Fitimi i trashëgimit

Neni 330

Trashëgimi fitohet me vdekjen e trashëgimlënësit.

Neni 331

Me çeljen e trashëgimit, trashëgimtarit i kalon edhe posedimi i trashëgimlënësit mbi pasurinë trashëgimore, pa qenë nevoja për të vënë dorë mbi atë.

Neni 332

Trashëgimtari mund të fitojë të gjithë pasurinë e trashëgimlënësit ose një pjesë të saj, ose vetëm një send të caktuar apo një të drejtë tjetër pasurore.

Neni 333

Heqja dorë nga trashëgimia

(Ndryshuar me ligjin nr. 121/2013, datë 18.4.2013)

Heqja dorë nga trashëgimia duhet të bëhet me deklaratë të shkruar, që regjistrohet te noteri i njësisë vendore ku është çelur trashëgimia, ose me deklaratë noteriale të redaktuar nga noteri.

Heqja dorë mund të bëhet edhe me anë të një përfaqësuesi të pajisur me prokurë të posaçme.

Pas regjistrimit të heqjes dorë nga trashëgimia, noteri kryesisht lëshon një dëshmi të re trashëgimie, ku pasqyrohet ndryshimi në rrethin e trashëgimtarëve, si dhe pjesët e tyre takuese, të cilën ia dërgon personit që ka kërkuar lëshimin e dëshmisë fillestare të trashëgimisë.

Neni 334

Ai që ka hequr dorë nga trashëgimi, quhet se nuk është thirrur ndonjëherë në trashëgim. Heqja dorë nga trashëgimi nuk përjashton trashëgimtarin nga e drejta për të kërkuar legët.

Neni 335

Heqja dorë nga trashëgimi mund të bëhet brenda 3 muajve nga çelja e trashëgimisë dhe kur trashëgimtari është jashtë shtetit, jo më vonë se 6 muaj.

Për trashëgimtarin që në kohën e çeljes së trashëgimisë nuk ka lindur, afati i heqjes dorë nga trashëgimi fillon nga dita e lindjes.

Afati i heqjes dorë nga trashëgimi pezullohet për shkaqet që vlejné për parashkrimin e padies.

Neni 336

(Ndryshuar fjalë me ligjin nr. 121/2013, datë 18.4.2013)

Kur nuk dihet a ka trashëgimtarë, ose kur trashëgimtarët mungojné dhe nuk ka lajme për ta, noteri i njësisë vendore ku është çelur trashëgimia, kryesisht ose me kërkesën e çdo të interesuari, cakton një afat, jo më pak se gjashtë muaj nga çelja e trashëgimisë, brenda të cilit ata duhet të deklarojnë në se heqin dorë nga trashëgimi. Në qoftë se brenda këtij afati nuk bëhet ndonjë deklaram i tillë, prezumohet se trashëgimlënësi nuk ka lënë trashëgimtarë.

Neni 337

Heqja dorë nga trashëgimi, e bërë para çeljes së trashëgimisë, ose kur bëhet me kusht, me afat, ose për një pjesë të trashëgimit, apo në dobi të njërit nga trashëgimtarët e tjerë, është e pavlefshme.

Neni 338

Nuk mund të hiqet dorë nga trashëgimi, kur gjatë afatit tremujor, trashëgimtari me veprimet e tij është sjellë si trashëgimtar.

Veprimet që kryhen vetëm për të ruajtur pasurinë trashëgimore, nuk konsiderohen si sjellje prej trashëgimtari.

Trashëgimtarët që kanë hequr ose fshehur sende nga trashëgimi, humbasin të drejtën e heqjes dorë dhe mbeten trashëgimtarë edhe sikur të kenë deklaruar heqjen dorë nga trashëgimi.

Neni 339

Trashëgimtari që ka deklaruar rregullisht heqjen dorë ose jo nga trashëgimi, nuk mund ta shfuqizojë më pas këtë deklaram.

Neni 340

Kur trashëgimtari vdes para se të kalojë afati për heqjen dorë nga trashëgimi, e drejta për heqjen dorë u kalon trashëgimtarëve të tij.

Pagimi i detyrimeve

Neni 341

Trashëgimtarët përgjigjen për detyrimet që rëndojnë mbi pasurinë trashëgimore në përpjesëtim me pjesët e tyre, gjer në vleftën e pasurisë trashëgimore që kanë marrë.

Quhen detyrime që rëndojnë mbi pasurinë trashëgimore, ato të trashëgimlënësit, shpenzimet e varrimit të tij dhe shpenzimet që nevojiten për ruajtjen dhe administrimin e pasurisë trashëgimore, deri sa ajo t'u kalojë trashëgimtarëve përkatës.

Neni 342

Kur në një trashëgim, një ose disa prona të paluajtshme janë të rënduara me hipotekë, secili trashëgimtar ka të drejtë të kërkojë që këto prona të lirohen nga hipoteka para se të bëhet formimi i pjesëve trashëgimore.

Megjithëkëtë, trashëgimtari që e ka shlyer detyrimin që rrjedh nga hipoteka e vënë mbi një send të paluajtshëm në pjesën trashëgimore të tij, ka të drejtën e kthimit ndaj trashëgimtarëve të tjerë, në proporcion me pjesët e tyre.

Neni 343

Masat për sigurimin e pasurisë trashëgimore

(Ndryshuar me ligjin nr. 121/2013, datë 18.4.2013)

Kur shihet e nevojshme të mbrohen interesat e trashëgimtarëve, të personave që mund të përfitojnë nga disponimet me testament, të kreditorëve të trashëgimlënësit ose të shtetit, noteri i njësisë vendore ku është çelur trashëgimia, kryesisht, ose me kërkesën e çdo të interesuari, bën inventarin e pasurisë trashëgimore.

Noteri që bën inventarin mund të caktojë një person si ruajtës të pasurisë trashëgimore.

Derisa të mos jenë hequr masat e mësipërme, trashëgimtari që mund të ketë filluar nga administrimi i pasurisë trashëgimore, nuk mund ta tjetërsojë atë veçse me lejen e gjykatës.

Neni 344

(Ndryshuar me ligjin nr. 121/2013, datë 18.4.2013)

Kur nuk dihet a ka trashëgimtarë ose kur trashëgimtarët mungojnë dhe nuk ka lajme për ata ose kur trashëgimtarët ligjorë apo testamentorë kanë hequr dorë nga trashëgimi dhe nuk dihen trashëgimtarët e tyre, noteri i njësisë vendore ku është çelur trashëgimi, kryesisht ose me kërkesën e çdo të interesuari, emëron një kujdestar të trashëgimit.

Shkurtimi i aktit noterial të emërimit të kujdestarit shpallet në Fletoren Zyrtare.

Neni 345

Kujdestari kërkon kryerjen e inventarit të pasurisë trashëgimore, merr masa për administrimin e pasurisë, ushtron të drejtën e padisë dhe u përgjigjet padive në lidhje me këtë pasuri, depoziton në bankë paratë që ndodhen në trashëgim ose që rrjedhin prej tij, kryen veprime të tjera të kësaj natyre dhe jep llogari në mbarim të administrimit.

Neni 346

Me miratimin e gjykatës kujdestari paguan detyrimet që rëndojnë mbi pasurinë trashëgimore, ekzekuton detyrimet në lidhje me leget dhe barrët dhe, kur shihet e nevojshme, tjetërson edhe pasuri trashëgimore.

Neni 347

Detyra e kujdestarit pushon me paraqitjen e trashëgimtarit.

Neni 348

Dëshmia e trashëgimisë

(Ndryshuar me ligjin nr. 121/2013, datë 18.4.2013)

Cilësia si trashëgimtar dhe pjesët takuese në trashëgimi caktohen në dëshminë e trashëgimisë, të lëshuar nga noteri, pas paraqitjes së certifikatës së vdekjes së trashëgimlënësit, sipas rregullave të caktuara në këtë Kod dhe në ligjin për noterinë.

Dëshmia e trashëgimisë ligjore lëshohet nga noteri i njësisë vendore ku ka patur vendbanimin e fundit trashëgimlënësi. Kur vendbanimi i fundit i trashëgimlënësit nuk dihet, dëshmia e trashëgimisë ligjore lëshohet nga noteri që ushtron veprimtarinë në njësinë vendore ku ndodhet e gjithë pasuria e tij ose pjesa kryesore e saj.

Dëshmia e trashëgimisë testamentare lëshohet nga noteri, pranë të cilit është redaktuar testamenti me akt noterial, apo është depozituar për ruajtje testamenti ollograf ose testamenti i posaçëm. Në rast se i njëjti trashëgimlënës ka lënë më shumë se një testament, dëshmia e trashëgimisë testamentare lëshohet nga noteri, pranë të cilit është redaktuar apo depozituar për ruajtje testamenti i fundit. Dëshmia e trashëgimisë testamentare, në rastet kur testamenti ollograf ose testamenti i posaçëm nuk janë dërguar për ruajtje pranë noterit, lëshohet nga noteri që ushtron veprimtarinë në njësinë vendore ku ka patur vendbanimin e fundit trashëgimlënësi. Kur vendbanimi i fundit i trashëgimlënësit nuk dihet, dëshmia e trashëgimisë testamentare, në rastet kur testamenti ollograf ose testamenti i posaçëm nuk janë dërguar për ruajtje pranë noterit, lëshohet nga noteri që ushtron veprimtarinë në njësinë vendore ku ndodhet e gjithë pasuria e tij ose pjesa kryesore e saj.

Dëshmia e trashëgimisë redaktohet në numër të barabartë me trashëgimtarët e përcaktuar në të. Noteri, në momentin e redaktimit, lëshon dëshminë e trashëgimisë në numër të barabartë me kërkuessit, ndërsa kopjet e tjera të redaktuara ruhen nga noteri dhe mund të tërhiqen nga trashëgimtarët e tjerë, sipas kërkesës së tyre.

Rregullat e hollësishme për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë, si dhe për regjistrimin e testamenteve përcaktohen nga ligji për noterinë.

Padia për kërkimin e trashëgimit

Neni 349

Trashëgimtarit mund të kërkojë me padi nga kushdo që posedon tërësisht ose pjesërisht pasurinë trashëgimore, njohjen e tij si trashëgimtar dhe dorëzimin e pasurisë trashëgimore dhe të pasurisë së fituar me anë të saj, sipas rregullave mbi posedimin me mirëbesim dhe me keqbesim.

Neni 350

Padia për kërkimin e trashëgimit mund të ngrihet edhe kundër personit që mban pasurinë trashëgimore në bazë të një dëshmie trashëgimi, qoftë dhe kur ky është shteti. Personi që ka fituar me mirëbesim ndonjë send të pasurisë trashëgimore nga një trashëgimtar i tillë, nuk është i detyruar të kthejë sendin edhe sikur të jetë fituar me kundërshpërblim.

Poseduesi me mirëbesim që ka tjetërsuar po në mirëbesim sende nga pasuria trashëgimore, është vetëm i detyruar që t'i kthejë trashëgimtarit paditës çmimin e sendit të shoqëruar me faturën përkatëse. Kur këto të fundit nuk janë shlyer, këtij i kalon e drejta për të kërkuar shlyerjen e tyre.

Neni 351

Padia për kërkimin e trashëgimit nuk parashkruhet, përveç efekteve të parashkrimit fitues për sende të veçura.

Neni 352

Dispozitat që kanë lidhje me posedimin, zbatohen edhe për posedimin e sendeve në trashëgim, përsa i përket kërkimit të frutave, të shpenzimeve të kryera ose për përmirësimet dhe shtesat e bëra.

Pjesëtimi i trashëgimit

Neni 353

Cilido nga bashkëtrashëgimtarët ka të drejtë të kërkojë në çdo kohë pjesëtimin e pasurisë trashëgimore edhe sikur trashëgimlënësi të ketë urdhëruar ndryshe.

Neni 354

(Ndryshuar me ligjin nr. 121/2013, datë 18.4.2013)

Pjesëtimi i pasurisë trashëgimore bëhet me marrëveshje midis trashëgimtarëve, e cila miratohet me akt noterial.

Nëse trashëgimtarët nuk bien dakord për pjesëtimin e pasurisë trashëgimore, noteri, mbi bazën e parimit të paanësisë, si dhe duke mbajtur në konsideratë rregullat e pjesëtimit të pasurisë, sipas këtij Kodi, i ofron trashëgimtarëve mundësitë ligjore për pjesëtimin e pasurisë trashëgimore dhe arritjen e një marrëveshjeje midis tyre. Në këtë rast noteri i sqaron ata për të drejtat dhe detyrat, si dhe i paralajmëron për pasojat që vijnë nga nënshkrimi i marrëveshjes, me qëllim që të mos dëmtohen interesat e tyre nga mosdijenja e ligjit.

Kur trashëgimtarët nuk bien dakord edhe me zgjidhjet e ofruara nga noteri, pjesëtimi i pasurisë trashëgimore bëhet nga gjykata kompetente për shqyrtimin e padive që rrjedhin nga trashëgimia.

Neni 355

Pjesëtimi i pasurisë trashëgimore bëhet sipas rregullave të parashikuara në nenin 207 të këtij Kodi dhe në dispozitat e tjera të këtij kreu.

Neni 356

Në formimin e pjesëve takuese duhet që, sa të jetë e mundur, në secilën prej tyre të bëjnë pjesë nga po ajo sasi sendesh të luajtshme ose të paluajtshme, të drejtash reale ose kredish, që kanë natyrë e vleftë të njëjtë.

Neni 357

Kur kreditorët kanë vënë sekuestro mbi sendet e luajtshme të pasurisë trashëgimore, ose kanë kundërshtuar pjesëtimin sipas nenit 206 të këtij Kodi, ose shumica e bashkëtrashëgimtarëve e shohin të nevojshme pagimin e detyrimeve që rëndojnë mbi trashëgimin, sendet e luajtshme shiten në ankand.

Neni 358

Bashkëshorti i trashëgimlënësit ka të drejtë të kërkojë pjesën që i takon në pasurinë e përbashkët të fituar me punë nga bashkëshortët gjatë martesës.

Bashkëtrashëgimtarët, që me punën ose të ardhurat e tyre kanë ndihmuar në shtimin e pasurisë së lënë në trashëgim, kanë të drejtë të kërkojnë pjesën e tyre në pasurinë e sipërme të shtuar, sipas kontributit të dhënë.

Neni 359

Pjesa e anëtarit që vdes në pasurinë e familjes bujqësore u kalon trashëgimtarëve të tij, pavarësisht nga anëtarësia ose jo e tyre në ekonominë bujqësore.

Kur vdes anëtari i fundit i ekonomisë bujqësore, pasuria u kalon trashëgimtarëve të tij sipas rregullave të caktuara në këtë Kod.

TITULLI II TRASHËGIMIA ME LIGJ

Neni 360

Trashëgimtarët ligjorë janë fëmijët, fëmijët e fëmijëve, bashkëshorti, prindërit, vëllezërit e motrat dhe fëmijët e vëllezërve e të motrave të paravdekur, gjyshi e gjyshja e të paralindurit e tjerë, personat e paaftë për punë në ngarkim të trashëgimlënësit, të afërmit e tjerë deri në shkallën e gjashtë, si dhe shteti. Këta thirren në trashëgim sipas radhës të caktuar në këtë Kod.

Neni 361

(Ndryshuar paragrafi i tretë me ligjin nr. 8781, datë 3.5.2001)

Në rradhë të parë thirren në trashëgim fëmijët dhe bashkëshorti i aftë ose i paaftë për punë, duke trashëguar secili në pjesë të barabarta.

Kur një nga fëmijët ka vdekur para trashëgimlënësit, është bërë i padenjë për të trashëguar, ka hequr dorë nga trashëgimi, ose është i përjashtuar nga trashëgimi, në vend të tij hyjnë me zëvendësim fëmijët e tij dhe kur për shkaqet e sipërme nuk mund të jenë trashëgimtarë, vijnë në trashëgim të paslindurit e tyre pa kufizim. Në këtë rast, pjesa e prindit që nuk trashëgon, ndahet ndërmjet të paslindurve në pjesë të barabarta.

Kur përveç bashkëshortit, nuk ka trashëgimtarë të tjerë, të radhës së parë, në trashëgimi thirren ata të radhës pasardhëse, të parashikuar në nenin 363 të këtij Kodi dhe kur nuk ka të tillë, thirren trashëgimtarët e radhës tjetër pasardhëse, të parashikuar në nenin 364 të këtij Kodi.

Në çdo rast bashkëshorti merr 1/2 pjesë të trashëgimit.

Kur nuk ka trashëgimtarë të radhëve të sipërme, trashëgimi i mbetet bashkëshortit pasjetues.

Neni 362

(Ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr. 8781, datë 3.5.2001)

Fëmijët e lindur jashtë martese, kur atësia ose mëmësia është njohur rregullisht, si dhe fëmijët e birësuar barazohen me fëmijët e lindur nga martesa.

I birësuari nuk trashëgon në familjen e origjinës së tij dhe as kjo nuk e trashëgon atë.

Neni 363

Në radhë të dytë thirren në trashëgim prindërit e trashëgimlënësit dhe personat e paaftë për punë, të cilët të paktën 1 vit para vdekjes së trashëgimlënësit, bashkëjtonin me atë si anëtarë të familjes dhe në ngarkim të tij.

Neni 364

Në radhë të tretë thirren në trashëgim personat e paaftë për punë në ngarkim të trashëgimlënësit që përmenden në nenin 363 të këtij Kodi, kur nuk ka trashëgimtarë të tjerë të radhës së dytë, gjyshi e gjyshja, vëllezërit e motrat, si dhe fëmijët e vëllezërve e të motrave të paravdekur. Të sipërmit trashëgojnë në pjesë të barabarta, pa u bërë dallimi ndërmjet vëllezërve e motrave të një ati ose vetëm të një nëne, ndërmjet gjyshit e gjyshes nga ana a babës ose e nënës.

Neni 365

Kur trashëgimlënësi nuk ka lënë të paslindur, as prindër ose të paralindur të tjerë, as vëllezër ose motra, apo të paslindur të këtyre, pasuria e trashëgimlënësit u kalon të afërmeve më të afërt të tij, pa bërë dallim ndërmjet vijës atërore dhe asaj amësore, por gjithsesi jo më tej se shkalla e gjashtë.

Neni 366

Kur trashëgimlënësi nuk ka lënë trashëgimtarë deri në shkallën e gjashtë, thirret në trashëgim shteti.

Neni 367

Shteti nuk përgjigjet për detyrimet e trashëgimlënësit tej vleftës së pasurisë të fituar.

E drejta e shtimit për sendet shtëpiake

Neni 368

Trashëgimtarët që bashkëjetojnë me trashëgimlënësin në kohën e vdekjes së tij, kur thirren në trashëgim, marrin tej pjesës që u takon në pasurinë trashëgimore sendet shtëpiake të përdorimit të zakonshëm, përveç kur trashëgimlënësi ka disponuar ndryshe në testament.

Trashëgimia sipas radhëve

Neni 369

Trashëgimtarët e një radhe të mëpasshme thirren në trashëgim vetëm kur nuk ka trashëgimtarë të radhës së mëparshme ose kur këta të gjithë janë bërë të padenjë ose kanë hequr dorë nga trashëgimi ose janë përjashtuar nga trashëgimi, përveç kur nga trashëgimtarët e radhës së dytë mbetet trashëgimtari i paaftë për punë dhe ka trashëgimtarë të radhës së tretë.

E drejta e shtimit

Neni 370

Kur një nga bashkëtrashëgimtarët që thirret në trashëgim ka vdekur para trashëgimlënësit, ose është bërë i padenjë, ose ka hequr dorë nga trashëgimi, ose është përjashtuar nga trashëgimi dhe nuk ka persona që trashëgojnë me zëvendësim, pjesa që i takon atij u shtohet pjesëve të bashkëtrashëgimtarëve të asaj radhe.

Trashëgimtari i paaftë për punë

Neni 371

Trashëgimtarë të paaftë për punë janë ata që në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit nuk kanë mbushur moshën 16 vjeç, ose 18 vjeç kur vazhdojnë mësimet, burrat që kanë mbushur moshën 60 vjeç dhe gratë që kanë mbushur moshën 55 vjeç si dhe, pavarësisht nga mosha, ata që janë invalidë të grupit të parë dhe të grupit të dytë.

TITULLI III

TRASHËGIMIA ME TESTAMENT

Kuptimi i testamentit

Neni 372

Testamenti është një veprim juridik i njëanshëm i kryer nga vetë trashëgimlënësi, me anë të të cilit ky disponon pasurinë e tij për kohën pas vdekjes.

Testamenti nuk mund të bëhet prej dy ose më shumë personave po në një akt, as edhe në dobi të një të treti, as me disponime reciproke.

Zotësia për të disponuar me testament

Neni 373

Testament mund të bëjë çdo person që ka mbushur moshën 18 vjeç, si dhe gruaja nën këtë moshë kur është e martuar.

I mituri nga 14 gjer në 18 vjeç mund të bëjë testament vetëm për pasurinë që ka fituar me punën e tij.

Personi të cilit me vendim gjyqi i është hequr zotësia për të vepruar, si dhe ai që në kohën e bërjes së testamentit nuk është në gjendje për të kuptuar rëndësinë e veprimit të tij, nuk mund të bëjë testament.

Zotësia për të fituar me testament

Neni 374

Janë të pazotë për të fituar me testament ata që janë të pazotë për të trashëguar me ligj me përjashtim të fëmijëve të pandërmjetshëm të një personi të caktuar dhe të gjallë në kohën e vdekjes së testatorit edhe sikur ata fëmijë të mos jenë zënë ende.

Neni 375

Kujdestari nuk mundet në asnjë rast të përfitojë nga disponimet testamentare të personit në kujdestari kur ato janë bërë para miratimit të llogarisë përfundimtare, edhe sikur testatori të ketë vdekur pas miratimit të llogarisë.

Janë të vlefshme disponimet e bëra në favorin e kujdestarit, kur ky është i paralindur, i paslindur, vëlla, motër ose bashkëshorti i testatorit.

Neni 376

Disponimi testamentar në favor të personave të pazotë që përmenden në nenet 374 e 375 të këtij Kodi, është i pavlefshëm edhe sikur të jetë fshehur nën formën e një kontrate me shpërblim ose të jetë bërë nën emrin e një personi të ndërvënë.

Quhen persona të ndërvënë: i ati, e ëma, të paslindurit dhe bashkëshorti i personit të pazot.

Caktimi i trashëgimtarit

Neni 377

Trashëgimlënësi që nuk lë të paslindur ose të paralindur, ose vëllezër apo motra, ka të drejtë të disponojë me testament pasurinë e vet, në favor të çdo personi fizik apo juridik.

Përjashtimi nga trashëgimia

Neni 378

Trashëgimlënësi edhe pa caktuar trashëgimtarë në testament mund të përjashtojë nga trashëgimia ligjore një ose më shumë trashëgimtarë të tij.

Rezervë ligjore

Neni 379

Trashëgimlënësi nuk mund të përjashtojë nga trashëgimia ligjore fëmijët e tij të mitur ose trashëgimtarë të tjerë të mitur që trashëgojnë me zëvendësim (neni 361, paragrafi i dytë), si dhe trashëgimtarët e tij të tjerë të paaftë për punë në qoftë se thirren në trashëgim, dhe as të cenojë me testament në çdo mënyrë qoftë, pjesën që u takon këtyre trashëgimtarëve në bazë të trashëgimisë ligjore, përveç kur këta janë bërë të padenjë për të trashëguar.

Neni 380

Kur testatori disponon me testament një uzufrukt ose një rentë jetësore, të ardhurat e të cilave kalojnë ato të pjesës së disponueshme, trashëgimtarët që kanë të drejtë në rezervën ligjore munden të ekzekutojnë këtë disponim ose të heqin dorë nga të drejtat mbi pjesën e disponueshme.

Po këtë të drejtë zgjedhjeje e kanë edhe personat që përfitojnë nga rezerva ligjore në rast se testatori ka disponuar pronësinë e zhveshur të një pjese që kalon masën e disponueshme.

Zëvendësimi

Neni 381

Trashëgimlënësi mund të caktojë në testament që në rast se trashëgimtari vdes para tij ose bëhet i padenjë, ose heq dorë nga trashëgimi, ta marrë trashëgimin një nga trashëgimtarët e tjerë që tregohen në nenet 361, 363, 364 të këtij Kodi, dhe kur nuk ka asnjë nga këta, ta marrë një njeri tjetër.

Por trashëgimlënësi nuk mund të detyrojë trashëgimtarin që të ruajë dhe, pas vdekjes së tij t'ia dorëzojë një personi tjetër të gjithë ose një pjesë të trashëgimit që ka marrë.

E drejta e shtimit

Neni 382

Kur trashëgimlënësi ua ka lënë të gjithë pasurinë e tij trashëgimtarëve të caktuar në testament dhe një nga këta trashëgimtarë ka vdekur para tij, ose është bërë i padenjë, ose ka hequr dorë nga trashëgimi dhe trashëgimlënësi nuk ka caktuar për këto raste një trashëgimtar tjetër në vend të tij, si dhe kur një trashëgimtar është përjashtuar nga trashëgimi, pjesa që i takon atij u shtohet pjesëve të bashkëtrashëgimtarëve të tjerë të caktuar në testament në përpjesëtim me pjesët e tyre trashëgimore.

Në qoftë se disa nga trashëgimtarët janë caktuar së bashku në një pjesë të pasurisë, shtimi bëhet vetëm midis këtyre bashkëtrashëgimtarëve.

Neni 383

Kur trashëgimlënësi ka lënë me testament vetëm një pjesë të pasurisë së tij, edhe sikur në këtë pjesë të ketë caktuar së bashku shumë trashëgimtarë, pjesa e atij që për shkaket e treguara në nenin e sipërm nuk mund ose nuk do të jetë trashëgimtar, u kalon trashëgimtarëve ligjorë të trashëgimlënësit.

Legu dhe barra

Neni 384

Trashëgimlënësi mund të ngarkojë trashëgimtarin ose trashëgimtarët e caktuar në testament, nga ata që tregohen në nenet 361, 363, 364 të këtij Kodi, që t'u japin një ose më shumë trashëgimtarëve ligjorë një përfitim pasuror nga trashëgimi, pa i bërë këta trashëgimtarë (legu).

Kur trashëgimlënësi, që nuk ka trashëgimtarë nga ata që tregohen në nenet 361, 363, 364, ka caktuar në testament si trashëgimtarë persona të tjerë, mund t'i ngarkojë këta me lege në dobi të çdo njeriu.

Dispozitat e zotësisë për të trashëguar vlejné edhe për personin që i është lënë legu.

Neni 385

Legatari ka të drejtë të kërkojë frutat ose kamatat që rrjedhin nga legu, nga dita që i është caktuar dorëzimi i legut dhe në mungesë të saj, nga dita e njoftimit të kërkesëpadisë.

Ato mund të kërkojnë nga dita e vdekjes së trashëgimlënësit, kur trashëgimlënësi ka disponuar shprehimisht ose kur legu është një depozitë në para.

Neni 386

Trashëgimlënësi mund të ngarkojë trashëgimtarin ose trashëgimtarët e caktuar në testament që të kryejnë ndonjë veprim të dobishëm për shoqërinë ose ndonjë veprim tjetër, pa i dhënë të drejtë një personi të caktuar mbi këtë veprim (barrë).

Kur trashëgimlënësi i lë me testament pasurinë shtetit, organeve të tij, ose enteve të ndryshme, ka të drejtë të caktojë qëllimin për të cilin duhet të përdoret pasuria.

Neni 387

Kur trashëgimtari i ngarkuar me legun ose barrën ka vdekur para trashëgimlënësit, ose është bërë i padenjë ose ka hequr dorë nga trashëgimi dhe trashëgimlënësi nuk ka caktuar një trashëgimtar tjetër në vend të tij, për ekzekutimin e detyrimeve në lidhje me legun ose me barrën ngarkohen bashkëtrashëgimtarët ose trashëgimtarët ligjorë, të cilëve u shtohet ose u kalon pjesa e atij, që për shkaqet e sipërme nuk mund ose nuk do jetë trashëgimtar. Në qoftë se ekzekutimi i detyrimeve në lidhje me legun ose barrën është lidhur ngushtë me personin e atij, që për shkaqet e sipërme nuk mund ose nuk do jetë trashëgimtar, legu ose barra mbetet pa fuqi.

Neni 388

Në rast se ndërmjet trashëgimtarëve, asnjëri prej tyre nuk është ngarkuar nga trashëgimlënësi testamentar për të shlyer legun, secili trashëgimtar detyrohet të kontribuojë për shlyerjen e tij sipas pjesës takuese.

Neni 389

Kur sendi i dhënë në leg është treguar vetëm si lloj ose si masë, e drejta e zgjedhjes i takon trashëgimtarit, por sendi nuk mund të jetë nën kualitetin mesatar.

Neni 390

Kur personi, të cilit i është lënë legu, ka vdekur para trashëgimlënësit ose është bërë i padenjë ose ka hequr dorë nga legu dhe trashëgimlënësi nuk ka caktuar një person tjetër në vend të tij, legu shkon në dobi të trashëgimtarit të ngarkuar me atë leg. Por në qoftë se legu u është lënë shumë

personave së bashku, pjesa e atij që nuk mund ose nuk do të marrë legun u shtohet bashkëpjesëtarëve të tij në përpjesëtim me pjesët e tyre.

Neni 391

Personi, të cilit i është lënë legu, ka të drejtë të kërkojë nga trashëgimtari i ngarkuar ekzekutimin e detyrimit në lidhje me legun.

Ekzekutimi i detyrimit të trashëgimtarit në lidhje me barrën mund të kërkohej nga ekzekutori i testamentit, nga bashkëtrashëgimtarët, nga organizatat përkatëse shtetërore ose private.

Detyrimet në lidhje me legun dhe barrën ekzekutohen pas detyrimeve që rëndojnë mbi pasurinë trashëgimore.

Format e testamentit

Neni 392

Testamenti bëhet në dy forma: ollograf dhe me akt noterial.

Testamenti ollograf

Neni 393

Testamenti ollograf shkruhet tërësisht me dorën e testatorit duke vënë datën dhe nënshkrimin e vet.

Data e testamentit duhet të tregojë ditën, muajin dhe vitin. Nënshkrimi vihet në fund të disponimeve.

Neni 394

Personi që nuk është i zoti të lexojë dorëshkrimin e vet nuk mund të bëjë testament ollograf.

Neni 395

Personat që nuk dëgjojnë (shurdhë) ose që nuk dëgjojnë e nuk flasin (shurdhëmemeçë), mund të disponojnë me testament ollograf ose me testament të marrë nga noteri, sipas rregullave të parashikuara në ligjin “Për noterinë”.

Neni 396

Testamenti ollograf mund të depozitohet tek noteri për ruajtje sipas dispozitave për depozitimin e dokumenteve në noteri.

Testamenti me akt noterial

Neni 397

Testamenti me akt noterial redaktohet nga noteri dhe nënshkruhet nga trashëgimlënësi në prani të noterit.

Kur trashëgimlënësi nuk di, ose për shkak sëmundjeje ose të metash fizike nuk mund të nënshkruajë, testamenti nënshkruhet sipas rregullave të parashikuara në ligjin “Për noterinë”.

Testamente të posaçme

Neni 398

(Shfuqizuar fjalët “ose sekretari” me ligjin nr. 8781, datë 3.5.2001)

Në vendet ku nuk ka noter, testamenti mund të vërtetohet nga kryetari i bashkisë ose i komunës.

Neni 399

Testamenti i një personi që ndodhet në shërbim ushtarak, mund të vërtetohet nga komandanti i njësisë ushtarake në të cilën ai bën pjesë dhe kur është shtruar në spital për mjekim nga drejtori i spitalit.

Neni 400

Testamenti i një personi që ndodhet në një anije shqiptare në lundrim ose që ka qëndruar në një liman të huaj, mund të vërtetohet nga kapiteni i anijes.

Neni 401

Disponimi me testament i bërë me kusht pezullues, mbetet pa efekt kur personi në favor të cilit është bërë, vdes para trashëgimlënësit.

Revokimi i testamentit

Neni 402

Testamenti me një datë të mëvonshme lë pa fuqi atë me datë të mëparshme në tërësi ose vetëm për pjesën që nuk pajtohet me testamentin e ri.

Testamenti mbetet pa fuqi edhe me anë të një deklarate të bërë nga trashëgimlënësi në noteri.

Pavlefshmëria e testamentit

Neni 403

Testamenti është i pavlefshëm kur bëhet nga një person që nuk mund të bëjë testament (neni 373).

Neni 404

Testamenti është i pavlefshëm kur nuk është bërë në formën e kërkuar nga ligji.

Neni 405

Testamenti është i pavlefshëm kur disponohet me testament në dobi të personave që nuk mund të trashëgojnë (nenet 374, 375).

Neni 406

Testamenti është i pavlefshëm kur disponimi me testament është në kundërshtim me nenet 377 e 384 të këtij Kodi.

Neni 407

Testamenti është i pavlefshëm kur disponimi me testament i trashëgimlënësit, i përjashton nga trashëgimia ligjore trashëgimtarët e tij të mitur ose të paaftë për punë ose cenon pjesën e tyre ligjore.

Neni 408

Testamenti është i pavlefshëm kur disponimi me testament është bërë në kundërshtim me ligjin ose në mashtrim të ligjit.

Neni 409

Testamenti është i pavlefshëm kur disponimi me testament është bërë me ndikimin e mashtrimit, kanosjes ose dhunës, ose për shkak të një lajthimi, pa të cilën trashëgimlënësi nuk do kishte bërë këtë disponim.

Neni 410

Kur testamenti deklarohet nga gjykata i pavlefshëm, në trashëgim thirren trashëgimtarët ligjorë, përveç kur është rasti i shtimit në dobi të trashëgimtarëve të caktuar në testament sipas nenit 381.

Kur deklarohen të pavlefshme vetëm disa nga disponimet e testamentit, disponimet e tjera mbeten në fuqi.

Neni 411

Padia për pavlefshmërinë e testamentit ose të disponimit me testament mund të ngrihet nga trashëgimtari dhe nga çdo tjetër person i interesuar brenda tre vjetëve nga çelja e trashëgimisë.

Neni 412

Kur disponimi me testament është i pavlefshëm për shkak se disponimi nga trashëgimlënësi ka përjashtuar nga trashëgimia ligjore trashëgimtarët e tij të mitur ose të paaftë për punë ose cenon pjesën e tyre ligjore (neni 407), trashëgimtari, i përjashtuar nga trashëgimi ose të cilit i është cenuar pjesa ligjore, ka të drejtë të kërkojë nga trashëgimtarët e tjerë, sipas rastit, dorëzimin ose plotësimin e pjesës që i takon atij në bazë të trashëgimisë ligjore.

Neni 413

Për caktimin e kësaj pjese bashkohet e gjithë pasuria që kishte trashëgimlënësi në kohën e vdekjes së tij, duke u zbritur detyrimet që rëndojnë mbi trashëgiminë dhe pjesëtohet me numrin e

trashëgimtarëve që do të thirreshin në trashëgim në qoftë se trashëgimlënësi nuk do kishte bërë testament.

Ekzekutori i testamentit

Neni 414

Trashëgimlënësi mund të ngarkojë një ose më shumë persona për të ekzekutuar testamentin.

Caktimi si ekzekutor duhet të pranohet prej këtij në vetë testamentin ose me një deklaratë të veçantë që i bashkohet testamentit.

Në qoftë se trashëgimlënësi nuk cakton ekzekutor të testamentit, ekzekutimi i këtij u ngarkohet trashëgimtarëve të caktuar në të.

Neni 415

Ekzekutori i testamentit duhet të bëjë inventarin e pasurisë trashëgimore, duke ftuar të marrin pjesë trashëgimtarët dhe personat e tjerë që përfitojnë nga testamenti.

Ekzekutori i testamentit administron pasurinë trashëgimore, duke kryer veprimet që janë të nevojshme për ekzekutimin e disponimeve të testamentit, por nuk mund të tjetërsojë pasurinë trashëgimore, përveç kur shfaqet nevoja dhe me lejen e gjykatës, e cila vendos pasi më parë të dëgjojë trashëgimtarët.

Neni 416

Gjykata e rrethit, me kërkesën e trashëgimtarëve ose të personave që kanë interes, mund të shkarkojë nga detyra ekzekutorin e testamentit për shkelje të rënda të detyrës së tij ose për pazotësi në administrimin e pasurisë trashëgimore.

Neni 417

Tagret e ekzekutorit testamentar nuk transmetohen në trashëgimtarët e tij.

Neni 418

Kur janë shumë ekzekutorë testamentarë, në mungesën e të tjerëve mund të veprojnë edhe njëri prej tyre, por të gjithë ata janë përgjegjës solidarë për sendet që u janë besuar, përveç kur testatori u ka ndarë detyrat.

PJESA IV DETYRIMET

TITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHME

KREU I KUPTIMI DHE LINDJA E DETYRIMEVE

Kuptimi i detyrimit

Neni 419

Detyrimi është një marrëdhënie juridike me anën e së cilës një person (debitori) detyrohet të japë diçka ose të kryejë apo të mos kryejë një veprim të caktuar në dobi të një personi tjetër (kreditore), i cili ka, gjithashtu, të drejtë të kërkojë t'i jepet diçka, ose të kryhet apo të mos kryhet veprimi.

Lindja e detyrimeve

Neni 420

Detyrimet lindin nga kontratat ose nga ligji.

Natyrë ekonomike e detyrimit

Neni 421

Objekt i detyrimit duhet të ketë një vlerësim ekonomik dhe t'i përgjigjet interesave qoftë dhe jopasurore të kreditorit.

Korrektesa e pjesëmarrësve në detyrim

Neni 422

Kreditore dhe debitorë duhet të sillen ndaj njëri-tjetrit me korrektesë, me paanësi dhe sipas kërkesave të arsyes.

KREU II

DETYRIMET SOLIDARE

Neni 423

Detyrimi është solidar kur kreditore ose secili nga kreditorët ka të drejtë të kërkojë ekzekutimin e të njëjtit detyrim tërësisht apo pjesërisht si nga debitorët së bashku, ashtu dhe nga secili prej tyre veç e veç.

Neni 424

Detyrimi është solidar kur del nga vullneti i palëve ose është parashikuar me ligj.

Neni 425

Detyrimi është solidar edhe kur debitorët të jenë detyruar secili në mënyrë të ndryshme ose dhe kur debitorë i përbashkët të jetë detyruar në mënyrë të ndryshme ndaj secilit kreditor.

Neni 426

Ekzekutimi i detyrimit nga njëri prej debitorëve solidarë i shkarkon të gjithë debitorët e tjerë.

Debitorët solidarë shkarkohen nga detyrimi edhe nëpërmjet dhënies së një sendi në ekzekutim të detyrimit apo të kompensimit të kredisë nga njëri prej debitorëve solidarë ndaj kreditorit.

Neni 427

Qenia në vonesë e kreditorit ndaj njërit nga debitorët solidarë e shtrin efektin ndaj të gjithë debitorëve të tjerë.

Debitori solidar nuk mund të kompensojë detyrimin e tij me kreditë që kanë debitorët e tjerë ndaj kreditorit.

Debitori solidar nuk mund t'i kundrejtojë kreditorit prapësimet personale të debitorëve të tjerë.

Çdonjëri nga debitorët solidarë nuk duhet që me veprimet e tij të rëndojë pozitën e të tjerëve, përveç kur parashikohet ndryshe në ligj.

Neni 428

Debitori ka të drejtë të zgjedhë për të paguar njërin apo tjetrin kreditor solidar, përveç kur është penguar më parë me anë të një njoftimi me shkrim prej ndonjërit prej tyre.

Kreditorët janë solidarë kur secili prej tyre ka të drejtën të kërkojë pagimin e gjithë detyrimit dhe pagimi i bërë njërit prej tyre, liron debitorin ndaj gjithë kreditorëve.

Neni 429

Përtëritja e detyrimit që bën debitori me njërin nga kreditorët, shkarkon të gjithë debitorët e tjerë, përveç kur kreditori i ka ruajtur të drejtat ndaj tyre.

Falja e detyrimit të bërë njërit prej debitorëve solidarë, shkarkon të gjithë debitorët e tjerë. Kur falet vetëm pjesa e një debitori, detyrimi i debitorëve të tjerë pakësohet për aq sa është pjesa e falur.

Bashkimi i cilësive të kreditorit me atë të debitorit solidar në një person të vetëm, shuan detyrimin e debitorëve të tjerë, për pjesën e këtij debitori.

Neni 430

Në marrëdhëniet ndërmjet tyre debitorët solidarë marrin pjesë në shlyerjen e detyrimit secili sipas pjesës së vet.

Debitori që ka ekzekutuar një detyrim solidar, ka të drejtë të kërkojë nga debitorët e tjerë pagimin në pjesë të barabarta të detyrimit të ekzekutuar prej tij, përveç kur në ligj ose në kontratë është parashikuar ndryshe.

Kur debitori solidar, që ka ekzekutuar detyrimin, nuk ka mundur të nxjerrë nga një debitor pjesën e tij të detyrimit, ajo ndahet sipas rastit në pjesë të barabarta ose proporcionalisht ndërmjet debitorëve të tjerë, duke përfshirë edhe atë.

Neni 431

Debitorët solidarë janë të detyruar të përballojnë në proporcion me pjesët e tyre të gjitha shpenzimet që vërtetohen se kanë qenë të nevojshme të kryhen nga debitorët që kanë ekzekutuar detyrimin.

Neni 432

Debitori solidar që ekzekuton detyrimin duhet t'i kundrejtojë kreditorit prapësimet e përbashkëta për të gjithë debitorët, përndryshe i humb e drejta të kërkojë nga debitorët e tjerë pjesën që atyre u takon për shlyerjen e detyrimit. Gjithashtu, ai e humbet këtë të drejtë edhe kur nuk ka njoftuar debitorët e tjerë se ka ekzekutuar detyrimin dhe, si rrjedhim njëri nga debitorët e tjerë ka ekzekutuar veçmas atë.

Neni 433

Ndërprerja e parashkrimit me veprimet e kreditorit ndaj njërit prej debitorëve solidarë, si dhe ndërprerja e parashkrimit nga njëri prej kreditorëve solidarë ndaj debitorit të përbashkët, ka efekt si ndaj debitorëve të tjerë, ashtu edhe ndaj kreditorëve të tjerë.

Pezullimi i parashkrimit ndaj njërit debitor ose ndaj njërit kreditor solidar, nuk ka efekt ndaj të tjerëve.

Heqja dorë nga parashkrimi në përputhje me nenin 126 të këtij Kodi e bërë nga njëri prej debitorëve solidarë, nuk ka efekt ndaj të tjerëve, ndërsa heqja dorë nga parashkrimi nga njëri prej kreditorëve solidarë, ka efekt ndaj të tjerëve.

Neni 434

Debitori solidar të cilit i kërkohet pagimi i pjesës së tij nga detyrimi, nuk mund t'i kundrejtojë debitorit, që ka paguar atë, parashkrimin e padisë së kreditorit, përveç kur ai vetë dhe debitori që kërkon pjesën kanë patur mundësinë që t'i kundrejtonin parashkrimin e plotësuar.

Ky paragraf nuk zbatohet kur me marrëveshje debitorët solidarë kanë vendosur ndryshe.

Neni 435

Në rast se ekzekutimi i detyrimit bëhet i pamundur, për fajin ose gjatë vazhdimit të vonesës së njërit ose disa debitorëve solidarë, debitorë të tjerë nuk shkarkohen nga detyrimi për plotësimin e tij.

Kreditori mund të kërkojë shpërblimin e dëmit të shkaktuar për një shkak të tillë, vetëm nga debitorët solidarë ose nga secili prej tyre, për fajin e të cilëve është bërë i pamundur ekzekutimi i detyrimit ose që kanë qenë me vonesë. Debitorët e tjerë mbetën solidarë vetëm për detyrimin e parë.

Vonesa e njërit nga debitorët solidarë nuk sjell ndonjë pasojë juridike për debitorët e tjerë.

KREU III DETYRIMET ALTERNATIVE

Neni 436

Detyrimi është alternativ kur debitori shkarkohet prej tij, duke përmbushur njërin nga llojet e tij të përmendura veç e veç sipas dëshirës së tij, ose të kreditorit apo të një të treti. Debitori nuk mund të kërkojë nga kreditori të pranojë përmbushjen e detyrimit pjesërisht nga njëri lloj e pjesërisht nga lloji tjetër i tij.

Neni 437

E drejta e zgjedhjes i takon debitorit, përveç kur është parashikuar nga ligji apo nga kontrata që t'i lihet kreditorit apo një të treti.

Zgjedhja bëhet e parevokueshme me përmbushjen e njërit nga llojet e detyrimit, ose me njoftimin e deklaratës së zgjedhjes palës tjetër ose të dy palëve, kur e drejta e zgjedhjes i takon një të treti. Kur e drejta e zgjedhjes u takon shumë personave dhe ata nuk merren vesh, gjykata u cakton atyre një afat. Kur zgjedhja nuk bëhet në afatin e caktuar, atë e bën gjykata.

Neni 438

Kur në një detyrim alternativ, debitori nuk ekzekuton ndonjërin nga llojet e detyrimeve në afatin e caktuar, e drejta e zgjedhjes i kalon kreditorit.

Në rast se e drejta e zgjedhjes i është lënë kreditorit dhe ky nuk e ka ushtruar në afatin e caktuar në marrëveshje ose të caktuar nga debitori, zgjedhja i kalon këtij të fundit.

Kur e drejta e zgjedhjes i është lënë një të treti dhe ai nuk e ushtron në afatin e caktuar, zgjedhja bëhet nga gjykata.

Kur kjo e drejtë u është lënë disa personave, gjykata u cakton atyre një afat. Në rast se zgjedhja nuk bëhet në afatin e caktuar, ajo bëhet nga gjykata.

Neni 439

Detyrimi alternativ është i thjeshtë kur njëri nga të dy llojet e detyrimit nuk mund të bëhet objekt detyrimi, ose kur përmbushja e tij është bërë e pamundur pa fajin e asnjërës palë.

Neni 440

Kur e drejta e zgjedhjes i është lënë debitorit, detyrimi alternativ bëhet i thjeshtë në rast se njëri nga të dy llojet e detyrimit bëhet i pamundur dhe për fajin e tij. Në rast se kjo pamundësi ndodh për fajin e kreditorit, debitori shkarkohet nga detyrimi kur ai nuk pranon të zbatohet detyrimi tjetër dhe të kërkojë shpërblimin e dëmit.

Kur zgjedhja i është lënë kreditorit, debitori shkarkohet nga detyrimi kur pamundësia e përmbushjes së njërit nga të dy llojet e detyrimit ka ndodhur për faj të kreditorit dhe ky nuk pranon të ekzekutohet lloji tjetër i detyrimit dhe të kërkojë të shpërblehet dëmi. Në rast se zgjedhja i është lënë kreditorit dhe pamundësia i ngarkohet debitorit, kreditori mund të zgjedhë detyrimin tjetër ose të kërkojë shpërblimin e dëmit.

Neni 441

Kur të dy llojet e detyrimit janë bërë të pamundura dhe debitori duhet të përgjigjet për njërin prej tyre, ai duhet të paguajë vleftën e detyrimit që është bërë i pamundur i fundit, në qoftë se zgjedhja i është lënë atij.

Në qoftë se e drejta e zgjedhjes i është lënë kreditorit, ky ka të drejtë të kërkojë vleftën e njërit ose tjetrit lloj detyrimi.

KREU IV DETYRIME TË PJESËTUESHME E TË PAPJESËTUESHME

Detyrime të pjesëtueshme

Neni 442

Kur shumë debitorë ose kreditorë marrin pjesë në të njëjtin detyrim dhe ky është i pjesëtueshëm, secili debitor është i detyruar të ekzekutojë dhe secili kreditor ka të drejtë të kërkojë një pjesë të barabartë të detyrimit, përveç kur në kontratë ose në ligj është parashikuar ndryshe.

Detyrime të papjesëtueshme

Neni 443

Kur janë shumë debitorë në të njëjtin detyrim, që është i papjesëtueshëm, të gjithë debitorët quhen debitorë solidarë.

Detyrimi është i papjesëtueshëm nga vetë natyra e tij si i tillë dhe nga qëllimi i palëve në kontratë. Në të tilla raste detyrimi mbetet i papjesëtueshëm edhe për trashëgimtarët e debitorëve.

Neni 444

Detyrimet e papjesëtueshme rregullohen nga dispozita që kanë lidhje me detyrimet solidarë, përveç sa parashikohet në këtë kre.

KREU V DETYRIMET MONETARE

Neni 445

Detyrimi për të paguar një shumë parash shlyhet me vleftën e vet nominale, përveç kur rezulton ndryshe nga ligji ose nga kontrata.

Neni 446

Detyrimi monetar përmbushet me monedhën që është në qarkullim në shtetin ku bëhet pagimi ose me monedhën e pranuar në kontratë.

Neni 447

Kur kreditori ka një llogari rrjedhëse në shtetin ku duhet ose mund të bëhet pagesa, debitori mund të përmbushë detyrimin duke kredituar në këtë llogari shumën përkatëse, përveç kur kreditori e ka përjashtuar pagesën në këtë llogari.

Pagesa quhet e kryer në momentin e kreditimit të saj në llogari.

Neni 448

Pagesa kryhet në vendbanimin e kreditorit në datën e pagesës. Kreditori mund të caktojë një vend tjetër brenda kufijve të shtetit ku ka vendbanimin në kohën e pagimit ose të lindjes së detyrimit.

Neni 449

Në rast se pagimi duhet të kryhet në një vend tjetër nga vendbanimi i kreditorit në kohën e lindjes së detyrimit dhe përmbushja e këtij detyrimi do të vështirësohej së tepërmi, debitori mund të pezullojë pagimin derisa kreditori të ketë caktuar një vend tjetër i cili do të mënjante shpenzimet e tepërta.

Neni 450

Shpërblimi për dëmin e shkaktuar si rrjedhim i vonesës në pagimin e një shume parash, përbëhet nga kamatat e arrira, prej datës së fillimit të vonesës së debitorit, me monedhën zyrtare të vendit ku bëhet pagimi. Përqindja e kamatës caktohet me ligj.

Në mbarim të çdo viti kamatat e arrira i shtohen shumës së detyruar mbi bazën e të cilës është bërë llogaritja e tyre.

Kamata ligjore paguhet pa qenë i detyruar kreditori të provojë ndonjë dëm. Kur kreditori provon se ka pësuar një dëm më të madh se kamata ligjore, debitori detyrohet t'i paguajë atij pjesën tjetër të dëmit.

Neni 451

Kur detyrimi lidhet me pagesën e një shume parash në monedhë që nuk ka kurs zyrtar në shtetin ku duhet të kryhet pagesa, debitori ka të drejtë të ekzekutojë detyrimin në monedhën që ka kurs zyrtar në shtetin ku duhet të kryhet pagesa, përveç kur në ligj ose në kontratë parashikohet ndryshe.

Neni 452

Kur detyrimi lidhet me pagesën e një shume parash në monedhë të ndryshme nga ajo e vendit ku duhet të kryhet pagesa dhe debitori pretendon se nuk është në gjendje të shlyejë detyrimin në këtë monedhë, kreditori mund të pranojë shlyerjen në monedhën e vendit të kryerjes së pagesës.

Rregulli i mësipërm zbatohet edhe kur debitori detyrohet të bëjë pagesën me monedhën e pranuar në fillim.

Neni 453

Kur detyrimi duhet të ekzekutohet me një monedhë të ndryshme nga ajo e pranuar në fillim, konvertimi duhet të bëhet me kursin zyrtar të këmbimit të ditës së pagimit.

Neni 454

Neni 450 i këtij Kodi nuk i heq të drejtën kreditorit që të kërkojë shpërblimin e dëmit të pësuar nga fakti që nga dita e vënies në vonesë të debitorit ka pësuar ndryshime kursi i këmbimit të monedhës që përcaktohet në detyrim.

TITULLI II
EKZEKUTIMI DHE SHUARJA E DETYRIMEVE

KREU I
EKZEKUTIMI I DETYRIMEVE

Neni 455

Debitori dhe kreditori duhet të tregojnë kujdesin e duhur e të jenë të përpiktë në përmbushjen e detyrimit sipas përmbajtjes së tij.

Neni 456

Detyrimi për dorëzimin e një sendi të caktuar përmban edhe kujdesin që duhet të tregohet për ruajtjen e tij në dorëzim.

Neni 457

Kur objekti i detyrimit është dorëzimi i sendeve të përcaktuara vetëm në lloj, ato nuk mund të jenë me cilësi më të dobët se sa cilësia mesatare.

Neni 458

Dorëzimi i sendeve bëhet sipas mënyrës së caktuar në kontratë dhe kur kjo nuk është caktuar bëhet:

- a) me dhënien e tyre në dorë personit që ka fituar pronësinë e tyre ose personit që heq të drejta prej tij;
- b) me dhënien transportuesit ose postës për t'ia dorëzuar fituesit, në vendin e treguar prej tij;
- c) me dhënien fituesit në dorë ose dërgim nëpërmjet postës të dokumenteve (fletë ngarkese, dëshmi depozitimi) që i japin të drejtën e disponimit të mallit.

Neni 459

Debitori nuk mund të ekzekutojë detyrimin pjesë-pjesë edhe sikur ai të jetë i pjesëtueshëm, pa pëlqimin e kreditorit.

Neni 460

Detyrimi mund të ekzekutohet edhe nga një person i tretë, që nuk është debitor, përveç kur kreditori është i interesuar që ekzekutimi të bëhet nga debitori, ose kur kreditorit i është njoftuar kundërshtimi i debitorit.

Vendi i ekzekutimit të detyruar

Neni 461

Në rast se vendi ku duhet të ekzekutohet detyrimi nuk caktohet në kontratë, nga ligji ose nuk kuptohet nga vetë natyra e detyrimit, ekzekutimi bëhet:

- a) për dorëzimin e një sendi të paluajtshëm, në vendin ku ndodhet ai;
- b) për sendet që janë të përcaktuara në mënyrë individuale, në vendin ku ndodheshin kur lindi detyrimi;
- c) për dorëzimin e një sendi të përcaktuar në lloj dhe në sasi, në vendin ku debitori ushtron veprimtarinë e tij profesionale ose në vendbanimin e tij;
- ç) për detyrimet në para, sipas rregullave të përcaktuara në kreun V të pjesës IV të këtij Kodi.

Neni 462

Kreditori nuk mund të detyrohet të pranojë një gjë të ndryshme nga sa është përcaktuar në objektin e detyrimit edhe sikur vlefte e gjësë së ofruar të jetë më e madhe.

Afati i ekzekutimit të detyrimit

Neni 463

Ekzekutimi i detyrimit duhet të bëhet në afatin e caktuar në kontratë. Kur në kontratë nuk është caktuar afat ose ekzekutimi i detyrimit është lënë në kërkimin e kreditorit, ky mund të kërkojë ekzekutimin në çdo kohë dhe debitori duhet ta ekzekutojë atë brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga dita e kërkimit.

Neni 464

Afati i caktuar në kontratë prezumohet se është caktuar në dobi të debitorit, përveç kur nga vullneti i palëve ose natyra e detyrimit del ndryshe. Ekzekutimi i detyrimit para mbarimit të afatit nuk quhet i pavlefshëm, përveç kur afati është caktuar në dobi të kreditorit.

Neni 465

Debitori nuk mund të pretendojë të drejtën e afatit kur:

- a) ka falimentuar;
- b) nuk ka dhënë garancitë e premtuara;
- c) garancitë që sigurojnë kredinë janë pakësuar për fajin e tij, përveç kur ato mbeten, përbëjnë ende një siguri të mjaftueshme për ekzekutimin e detyrimit.

Ekzekutimi ndaj kreditorit

Neni 466

Ekzekutimi i detyrimit duhet t'i bëhet vetë kreditorit ose përfaqësuesit të vet, ose një personi të autorizuar nga kreditori, nga ligji ose nga gjykata.

Ekzekutimi i detyrimit që i bëhet një personi që nuk është autorizuar për ta pranuar, e shkarkon debitorin vetëm në rast se kreditori ka pranuar më vonë ekzekutimin, ose vërtetohet se ka përfituar prej tij.

Ekzekutimi ndaj një të treti

Neni 467

Debitori që ekzekuton një detyrim ndaj një personi, i cili sipas rrethanave të padyshimta duket se është i autorizuar ta pranojë atë, shkarkohet nga detyrimi në qoftë se provon se ka qënë në mirëbesim.

Personi që ka pranuar ekzekutimin e detyrimit, është i detyruar t'i kthejë kreditorit të vërtetë, atë që ka marrë nga ekzekutimi i detyrimit.

Ekzekutimi ndaj kreditorit të pazotë për të vepruar

Neni 468

Kur ekzekutimi i detyrimit i është bërë një kreditori që nuk ka zotësi për të vepruar, shkarkon debitorin po aq sa ka vajtur në dobi të këtij kreditori, ose të përfaqësuesit të tij ligjor.

Ekzekutimi për llogari të shumë detyrimeve

Neni 469

Kur ekzekutimi kryhet për llogari të shumë detyrimeve dhe ndaj të njëjtut kreditor, debitori mund të përcaktojë në kohën e ekzekutimit se cilin detyrim po ekzekuton.

Kur nuk ekziston një përcaktim i debitorit për radhën e ekzekutimit, në fillim ekzekutohet detyrimi që i ka kaluar afati, nëse ekzistojnë më shumë të tillë, ekzekutimi fillon nga detyrimi me vlerë dhe në rast se janë disa të tillë, fillon nga më i vjetri dhe kur këta kanë të njëjtën vjetërsi, ekzekutimi bëhet proporcionalisht.

Neni 470

Ekzekutimi në para për llogari të një detyrimi të caktuar, përmban në fillim shlyerjen e shpenzimeve, pastaj atë të kamatave të arrira dhe pastaj të vetë detyrimit e të kamatave të zakonshme ndaj tij.

Kreditori mund të refuzojë pagesën, në rast se debitori gjatë ekzekutimit cakton një renditje tjetër ose mund të mos pranojë shlyerjen e plotë të vleftës së detyrimit; pa marrë edhe kamatat e arrira, ato në vazhdimësi, si dhe shpenzimet përkatëse.

Neni 471

Kreditori mund të mos pranojë ekzekutimin e detyrimit për dorëzimin e një sendi të ndryshëm nga ai që është përcaktuar në kontratë edhe sikur vlefta e sendit të ofruar të jetë e barabartë apo më e madhe.

Shpenzimet e ekzekutimit, dëftesat përkatëse

Neni 472

Shpenzimet janë në ngarkim të atij që ekzekuton detyrimin, ndërsa shpenzimet e dëftesës janë në ngarkim të atij, në favor të të cilit ajo është lëshuar.

Neni 473

Për çdo pagesë të kryer në ekzekutim të detyrimit kreditori jep një dëftesë, përveç kur rezulton ndryshe nga kontrata.

Në rast se kreditori disponon një dokument nga përmbajtja e të cilit rezulton detyrimi, debitori që e ka ekzekutuar atë mund të kërkojë kthimin ose prishjen e dokumentit, përveç kur kreditori ka interesa të arsyeshëm për ruajtjen e tij dhe me kusht që ai të shënojë në dokument ekzekutimin e detyrimit.

Kur kreditori refuzon të zbatojë detyrimin sipas paragrafit të mësipërm, debitori mund të pezullojë ekzekutimin e detyrimit. Kur kreditori pretendon se ka humbur dokumentin detyrohet t'i japë debitorit një deklaratë me shkrim ku të pranohet ekzekutimi i detyrimit. Deklarata duhet të jetë noteriale kur kërkohet nga ligji.

Neni 474

Kur pagesat e njëllajta për shlyerjen e detyrimit duhet të bëhen në mënyrë periodike, dëftesat e lëshuara për dy pagesa radhazi prezumojnë kryerjen edhe të pagesave të mëparshme.

Dëftesa e lëshuar nga kreditori për detyrimin kryesor, prezumon se janë shlyer gjithashtu edhe kamatat e shpenzimet e këtij detyrimi.

Lirimi i sendeve nga garancitë

Neni 475

Kreditori që ka pranuar ekzekutimin e detyrimit, duhet të lirojë sendet nga garancitë reale që janë dhënë për sigurimin e ekzekutimit të detyrimit edhe nga çdo ndalim tjetër që mund të kufizojë përdorimin e pasurisë.

KREU II

EFEKTET E MOSEKZEKUTIMIT TË DETYRIMEVE DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 476

Çdo mangësi në ekzekutimin e detyrimeve e detyron debitorin të shpërblejë dëmin që ka pësuar kreditori, përveç kur ai provon se mospërmbushja nuk ka ndodhur për fajin e tij.

Në këtë rast kreditori ka të drejtë:

- a) të kërkojë ekzekutimin në natyrë të detyrimit, veçanërisht dorëzimin e sendit ose kryerjen e punimeve, si dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga vonesa e ekzekutimit; ose
- b) shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga mosekzekutimi i detyrimit.

Neni 477

Debitori që në ekzekutimin e detyrimit përdor punën e të tretëve përgjigjet për veprimet e tyre, të kryera me faj, si të ishin të vetat.

Neni 478

Kur detyrimi ka lidhje me veprime që mund të kryhen edhe nga persona të tjerë dhe debitori nuk ekzekuton detyrimin, kreditori ka të drejtë të kërkojë t'i kryejë ai vetë për llogari të debitorit.

Neni 479

Çdo marrëveshje që përjashton ose kufizon palët nga përgjegjësia për mosekzekutimin e detyrimeve është e pavlefshme.

Neni 480

Kur ekzekutimi i detyrimit bëhet i pamundur për fajin e debitorit, kreditori ka të drejtë të kërkojë prej tij shpërblimin e dëmit të shkaktuar.

Debitori është me faj kur, me dashje ose nga pakujdesia, ka krijuar rrethana që e kanë bërë të pamundur ekzekutimin ose kur nuk ka marrë masa për ta ndaluar atë.

Vonesa e debitorit

Neni 481

Debitori që nuk përmbush një detyrim të kërkueshëm në afatin e caktuar, quhet se është në vonesë (morë), përveç kur mosekzekutimi është rrjedhim i rrethanave që nuk kanë lidhje me fajin e debitorit.

Debitori vihet në vonesë me anë të një njoftimi me shkrim. Nuk është e nevojshme vënia në vonesë kur:

- a) debitori ka deklaruar me shkrim se nuk dëshiron të ekzekutojë detyrimin;
- b) ka kaluar afati brenda të cilit do të ekzekutohej detyrimi.

Kur debitori vdes dhe afati i caktuar për ekzekutimin e detyrimit mbaron pas vdekjes së tij, trashëgimtarët e tij quhen se janë në vonesë me mbarimin e 15 ditëve nga dita e njoftimit me shkrim nga kreditori.

- c) Kur detyrimi rrjedh nga një akt i paligjshëm.

Neni 482

Debitori që është në vonesë nuk çlirohet nga pamundësia e papritur e përmbushjes së detyrimit, edhe sikur kjo të jetë shkaktuar pa fajin e tij e të kreditorit, përveç kur provon se objekti i detyrimit do të ishte shkatërruar apo dëmtuar edhe sikur të ishte nën kujdesin e kreditorit.

Humbja ose dëmtimi i një sendi të marrë në mënyrë të paligjshme, nuk e shkarkon personin që e ka marrë atë nga detyrimi për të rikthyer vleftën e tij.

Neni 483

Dispozitat mbi vonesën nuk zbatohen për detyrimet që përmbajnë mosveprime. Çdo veprim i kundërt përbën mospërmbushje të detyrimit.

Neni 484

Kreditori mund të mos pranojë ofertën e debitorit që është me vonesë për ekzekutimin e detyrimit, në rast se ajo nuk përmban edhe shpërblimin e dëmit të pësuar dhe shpenzimet e bëra gjatë vonesës, ose kur kreditori për shkak të vonesës së debitorit nuk ka interes për ekzekutimin e detyrimit.

Neni 485

Debitori që ka një kredi të kërkueshme ndaj kreditorit të tij, mund të pezullojë zbatimin e detyrimit deri në pagesën e kredisë, me kusht që ndërmjet kredisë dhe detyrimit të ketë lidhje të mjaftueshme, siç mund të jetë ndër të tjera, qenia e një raporti të vetëm juridik ose të marrëdhënieve që palët kanë patur rregullisht. Pezullimi i ekzekutimit të detyrimit nuk mund të kërkohet kur:

- a) ekzekutimi i detyrimit nga pala tjetër bëhet i pamundur për shkak të vonesës së kreditorit, ose është i pamundur në mënyrë të përhershme;
- b) kredia e palës tjetër është e pasekuestrueshme.

Neni 486

Dëmi që duhet të shpërblehet nga debitori për mosekzekutimin e detyrimit përbëhet nga të gjitha humbjet e pësuar nga pakësimi i pasurisë, si dhe fitimi që mund të nxirrej në kushtet e zakonshme të tregut (fitimi i munguar). Bëjnë pjesë në shpërblimin për riparimin e dëmit edhe shpenzimet e arsyeshme e të nevojshme për të parandaluar ose për të pakësuar dëmin, që kanë lidhje me rrethanat mbi të cilat bazohet përgjegjësia e palës, shpenzimet e arsyeshme e të nevojshme për të përcaktuar dëmin dhe përgjegjësinë, si dhe ato që janë nevojitur për të gjetur një zgjidhje jashtëgjyqësore të përmbushjes së detyrimit.

Neni 487

Në kontratë me detyrime të dyanshme, palët duhet të ekzekutojnë detyrimin e tyre në të njëjtën kohë, përveç kur nga kontrata ose nga natyra e detyrimit del se njëra palë duhet të ekzekutojë detyrimin e saj më parë se tjetra.

Neni 488

Kur në një kontratë me detyrime të dyanshme, ekzekutimi i detyrimit të një pale është bërë i pamundur pa fajin e asnjërës palë, secila prej tyre nuk ka të drejtë të kërkojë nga tjetra ekzekutimin e detyrimit ose shpërblimin e dëmit, përveç kur në ligj ose në kontratë është parashikuar ndryshe. Secila nga palët ka të drejtë të kërkojë nga pala tjetër që t'i kthejë atë që është dhënë për ekzekutimin e detyrimit.

Neni 489

Në qoftë se në një kontratë me detyrime të dyanshme, ekzekutimi i detyrimit të një palë është bërë i pamundur, për shkak se pala tjetër ka rënë në paaftësi paguese, ose ka falimentuar ose për ndonjë rrethanë tjetër të ndodhur për faj të saj, pala tjetër ka të drejtë të mos zbatojë detyrimet e

veta, derisa t'i garantohet ekzekutimi i detyrimit në dobi të saj, ose të kërkojë shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga mosekzekutimi i kontratës.

Neni 490

Kur është vendosur që kreditorit t'i paguhet shpërblimi për mosekzekutimin e detyrimit ose për ekzekutimin me vonesë të tij, gjykata duke marrë parasysh gjendjen pasurore të debitorit, mund të caktojë një afat tjetër për pagimin e këtij shpërblimi, ose të lejojë që të paguhet me këste.

Vonesa e kreditorit

Neni 491

Kreditori është në vonesë kur pa ndonjë shkak të ligjshëm nuk pranon ekzekutimin e detyrimit nga ana e debitorit, ose që për shkak të rrethanave të krijuara me faj prej tij, nuk përmbush detyrimin ndaj debitorit, pa të cilin ky nuk mund të ekzekutojë detyrimin e tij.

Neni 492

Kur kreditori është në vonesë, debitori ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit të shkaktuar prej saj dhe lirohet nga përgjegjësia në rast se më vonë ekzekutimi i detyrimit të tij bëhet i pamundur, përveç kur pamundësia e ekzekutimit ndodh për fajin e tij.

Në detyrimet në para, kur kreditori është në vonesë, debitori nuk paguan kamatë.

Neni 493

Kur dëmi i ardhur nga mosekzekutimi i detyrimit është shkaktuar ose është shtuar edhe nga veprimet ose mosveprimet me faj të kreditorit, ose kur ky nuk ka treguar kujdesin e duhur për pakësimin e këtij dëmi, gjykata sipas rastit mund të pakësojë shumën e shpërblimit të dëmit ose të shkarkojë krejtësisht debitorin nga detyrimi për shpërblimin e tij.

Neni 494

Kreditori gjatë vonesës së tij nuk mund të kërkojë marrjen e masave për një ekzekutim të detyruar.

Neni 495

Kur kreditori është në vonesë ose nuk gjendet, debitori ka të drejtë të ekzekutojë detyrimin duke e depozituar sendin në një person që ushtron veprimtari depozitimi ose në një vend që caktohet nga gjykata e vendit të ekzekutimit të detyrimit. Kur objekt i detyrimit janë para, letra ose dokumente me vleftë ose sende të çmueshme, depozitohen në bankë.

Me depozitimin ndërpritet kamata.

Në rastet kur depozitimi kërkon shpenzime të mëdha, bëhet me vështirësi ose sendi që vihet në depozitë prishet shpejt ose për vetë natyrën e tij, nuk mund të lihet në depozitë, debitori, pasi të ketë lajmëruar kreditorin, kërkon nga gjykata që të lejohej të shesë sendin e mësipërm dhe vleftën e nxjerrë nga shitja ta depozitohet në bankën e shtetit në emër të kreditorit.

Kur debitori tërheq sendin e depozituar para se të jetë pranuar nga kreditori, depozitimi quhet se nuk është bërë.

Depozituesi i dorëzon sendin kreditorit vetëm pasi ky të ketë shlyer të gjitha shpenzimet për ekzekutimin e detyrimit.

KREU III ZËVENDËSIMI DHE KALIMI I KREDISË

Zëvendësimi i debitorit

Neni 496

Zëvendësimi i debitorit me një person tjetër, i cili merr përsipër detyrimin, mund të bëhet vetëm me pëlqimin e kreditorit. Debitori i zëvendësuar shkarkohet nga detyrimi i tij ndaj kreditorit.

Garancitë e dhëna nga persona të tretë për detyrimin shuhen, në rast se këta nuk kanë dhënë pëlqimin që ato të mbeten edhe për debitorin e ri. Pengu ose hipoteka e dhënë nga debitori i mëparshëm mbeten në fuqi.

Neni 497

Kreditorit mund t'i kundrejtohen nga debitori i ri të gjitha prapësimet që rrjedhin nga detyrimi që ai ka marrë përsipër dhe që mund t'i kundrejtonte edhe debitori i mëparshëm, përveç atyre që lidhen me personin e këtij të fundit.

Neni 498

Marrëveshja sipas të cilës debitori dhe një person i tretë bëhen bashkëdebitorë në një detyrim, kur është marrë pëlqimi i kreditorit, nuk mund të priset ose të ndryshohet, pa pëlqimin e kreditorit. Të dy bashkëdebitorët përgjigjen ndaj tij solidarisht.

Kalimi i kredive

Neni 499

(Shtuar paragrafi i tretë me ligjin nr. 8536, datë 18.10.1999)

Kreditori mund t'ia kalojë kredinë e vet një personi tjetër edhe pa miratimin e debitorit, me kusht që kredia të mos ketë karakter të ngushtë personal dhe kalimi të mos jetë ndalur nga ligji. Veçanërisht nuk lejohet kalimi i kredisë një personi tjetër, kur rrjedh nga shkaktimi i vdekjes ose i dëmtimit të shëndetit, si dhe i kredive që nuk mund të sekuestrohen.

Palët në një marrëveshje mund të përjashtojnë kalimin e kredisë, por marrëveshja nuk mund t'i kundrejtohet atij që i kalon kredia po të mos provohet se ai e njihet atë në momentin e kalimit.

Dispozitat për kalimin e kredisë nuk zbatohen ndaj kredive që lidhen me transaksione financiare, ndaj të cilave janë vendosur barrë siguroese, sipas kriteve të përcaktuara me ligj të veçantë.

Neni 500

Kredia kalon së bashku me privilegjet, garancitë dhe aksesorët e tjerë, duke përfshirë edhe kamatat për kohën e kaluar, përveç kur në kontratë parashikohet ndryshe.

Personi që bën kalimin e kredisë nuk mund t'i kalojë personit tjetër posedimin e sendit të marrë peng pa miratimin e palës tjetër (pengdhënësit). Në të kundërtën kreditori mbetet ruajtës i pengut.

Neni 501

Kalimi i kredisë duhet të bëhet me shkresë, ndryshe nuk është i vlefshëm.

Neni 502

Kalimi kredisë ka efekt ndaj debitorit dhe ndaj personave të tretë, nga dita që debitori e ka pranuar ose i është njoftuar nga kreditori i mëparshëm ose nga kreditori i ri.

Debitori që ka ekzekutuar detyrimin e tij, përpara se të ishte njoftuar për kalimin e kredisë, shkarkohet nga detyrimi.

Neni 503

Kur kredia u është kaluar disa personave të veçantë, preferohet në shlyerje kalimi që i është njoftuar më përpara debitorit, ose që është pranuar më parë nga debitori, me një dokument (shkresë) me datë të saktë edhe sikur data të jetë e mëvonshme.

Neni 504

Kalimi i kredisë nuk cenon mjetet mbrojtëse të debitorit.

Debitori mund t'i kundrejtojë kreditorit të ri prapësimet që mund t'i drejtonte kreditorit të mëparshëm, në kohën që i është njoftuar kalimi i kredisë.

Ai mund të kërkojë t'i bëhet kompensimi i një kredie ndaj kreditorit të parë, qoftë dhe ende e pakërkueshme në atë kohë, me kusht që të mos jetë bërë e kërkueshme mbas cedimit të kredisë.

Neni 505

Kur kalimi i kredisë bëhet me titull barësor kreditori është garant për ekzistencën e kredisë në kohën e kalimit të saj.

Kur kalimi bëhet falas, kreditori nuk është garant për ekzistencën e kredisë.

Neni 506

Kreditori që kalon kredinë nuk përgjigjet për paaftësinë paguese të debitorit, përveç kur ka marrë përsipër garancinë.

Në këtë rast përgjigjet për aq sa ka marrë. Veç kësaj duhet të përgjigjet për kamatat, për shpenzimet e kalimit, dhe ato që personi që i ka kaluar kredia ka bërë për ndjekjet ligjore ndaj debitorit dhe të shpërblejë dëmin.

Marrëveshja që synon të rëndojë përgjegjësinë e personit që kalon kredinë, është e pavlefshme. Kur kreditori që kalon kredinë ka garantuar aftësinë paguese të debitorit, garancia pushon, në qoftë se mosekzekutimi i kredisë për paaftësi paguese të debitorit ka ardhur nga pakujdesia e kreditorit të ri për të ndjekur çështjen ndaj debitorit.

Neni 507

Kreditori që bën kalimin e kredisë duhet t'i dorëzojë kreditorit tjetër dokumentet që provojnë kredinë, të cilat janë në posedimin e tij.

Kur është kaluar vetëm një pjesë e kredisë, kreditori detyrohet t'i dorëzojë kreditorit tjetër një kopje autentike të dokumenteve.

KREU IV SHUARJA E DETYRIMEVE

Përtëritja

Neni 508

Detyrimet shuhen me përtëritje, kur palët me marrëveshje zëvendësojnë detyrimin fillestar, me një detyrim tjetër të ndryshëm nga i pari.

Neni 509

Dorëzania, pengu dhe hipoteka e kredisë fillestare shuhen përveç kur palët janë marrë vesh shprehimisht që ato të ruhen edhe për kredinë e re.

Neni 510

Përtëritja është e pavlefshme në rast se detyrimi fillestar është i pavlefshëm.

Kur detyrimi fillestar rrjedh nga një titull i anulueshëm, përtëritja është e vlefshme në rast se debitori ka marrë përsipër detyrimin e ri, duke njohur vesin e titullit fillestar.

Falja e detyrimit

Neni 511

Deklarata me shkrim e kreditorit për faljen e detyrimit, e shuan atë kur i njoftohet debitorit, përveç kur ky i fundit deklaron brenda një afati të caktuar se nuk dëshiron të përfitojë nga falja.

Neni 512

Kur debitori ka në dorë dokumentin privat që provon detyrimin, prezumohet se ky është shuar me falje, përveç kur provohet se dokumenti nuk i është kthyer nga kreditori me dashje.

Neni 513

Heqja e garancisë ndaj detyrimit, nuk prezumon faljen e tij.

Kompensimi

Neni 514

Kur dy persona i detyrohen njëri-tjetrit në para ose në sende të një lloji e të zëvendësueshme dhe detyrimet e tyre janë të kërkueshme, të sakta e të caktuara në shumë ose në sasi, detyrimet e të dy

palëve shuhen, duke bërë kompensimin ndërmjet tyre. Detyrimet shuhen deri në shumën ose sasinë e detyrimit më të vogël.

Neni 515

Kompensimi shuan të dy detyrimet nga data e bashkimit të tyre.

Kur për njërën nga kreditë ose mbi të dyja janë paguar kamata, kompensimi bëhet deri në afatin e fundit në të cilën janë paguar kamatat.

Parashkrimi nuk e ndalon kompensimin, në rast se nuk është plotësuar në ditën kur është bërë bashkimi i të dy detyrimeve.

Neni 516

Kompensimi bëhet me anë të një deklaratë që njëra palë i dërgon palës tjetër.

Deklarata nuk mund të bëhet me afat ose me kusht.

Kur kompensimi nuk mbulon gjithë kredinë ose kur kreditori ka nevojë të mbajë titullin e kredisë për të ushtruar të drejtat e tjera të tij, mund ta mbajë atë me kusht që të shënojë në titull përmbajtjen e deklaratës dhe t'i japë palës tjetër një kopje të titullit të kredisë.

Neni 517

Kur deklarata për kompensimin e dhënë nga njëra palë, nuk pranohet nga pala tjetër, ajo detyrohet të njoftojë menjëherë palën që ka dërguar deklaratën, duke parashtruar shkaqet e mospranimit.

Neni 518

Nuk mund të kompensohen pa pëlqimin e kreditorit:

- a) kreditë që rrjedhin nga shkaktimi i vdekjes ose i dëmtimit të shëndetit;
- b) kreditë që nuk mund të sekuestrohen;
- c) kreditë që rrjedhin nga tatimet dhe taksat.

Neni 519

Kompensimi nuk kryhet kur është në dëm të personave të tretë që kanë fituar të drejta uzufrikti ose pengu mbi kredinë.

Neni 520

Dorëzanësi mund të kundrejtojë kompensimin e detyrimit të kreditorit ndaj debitorit kryesor. Debitori kryesor nuk mund të kundrejtojë kompensimin e detyrimit të kreditorit ndaj dorëzanësit.

Neni 521

Kur dy detyrime nuk janë të pagueshme në një vend, nuk mund të bëhet kompensimi i tyre, veçse duke llogaritur shpenzimet e nevojshme për transferimin e tyre në vendin e ekzekutimit.

Neni 522

Kur kreditë dhe detyrimet monetare përfshihen në një llogari të vetme, ato kompensohen menjëherë, sipas renditjes që palët kanë pranuar në marrëveshje dhe në mungesë të saj sipas rregullave të parashikuara në nenet 469 dhe 470 të këtij Kodi.

Pala që administron llogarinë, pasi e mbyll atë me kompensimin e bërë, i njofton palës tjetër se cila është mbetja, datën e saktë të llogaritjes, si dhe zërat që përbëjnë llogarinë dhe që nuk i janë komunikuar ende palës tjetër.

Në qoftë se pala tjetër nuk kundërshton atë në një afat të arsyeshëm, mbetja e njoftuar konsiderohet si e pranuar nga palët.

Neni 523

Kur në një deklaratë kompensimi nuk tregohen në mënyrë të mjaftueshme detyrimet e përfshira në kompensim, zbatohen rregullat e parashikuara në nenin 470 të këtij Kodi.

Secila palë mund të kundërshtojë menjëherë kompensimin e bërë, në rast se llogaritja e detyrimit, e shpenzimeve dhe e interesave nuk është kryer sipas rregullave të sipërpërmendura.

Bashkimi i cilësive të kreditorit dhe debitorit në një të vetëm

Neni 524

Detyrimi shuhet kur cilësitë e kreditorit dhe të debitorit bashkohen në një person të vetëm.

Kur ky bashkim merr fund, detyrimi lind përsëri.

Neni 525

Bashkimi nuk kryhet kur është në dëm të personave të tretë që kanë fituar të drejta uzufuktivi ose pengu mbi kredinë.

Shuarja për shkak pamundësie ekzekutimi

Neni 526

Detyrimi shuhet kur ekzekutimi i tij bëhet i pamundur pa fajin e debitorit dhe para se ky të jetë vënë në vonesë.

Detyrimi shuhet edhe kur debitori ndonëse është në vonesë, provon se pamundësia do të ekzistonte edhe sikur të ishte kreditori në vendin e tij.

Në këto raste, debitori duhet t'i kthejë kreditorit atë që ka fituar pa shkak.

Neni 527

Kur pamundësia për ekzekutimin e detyrimit është e përkohshme, debitori nuk është përgjegjës për vonesën e ekzekutimit për kohën që ajo zgjat.

Por, detyrimi shuhet edhe kur pamundësia zgjat për aq kohë sa sipas titullit të detyrimit dhe natyrës së tij, debitori nuk mund të detyrohet më ta kryejë atë ose kreditori nuk ka më interes.

Neni 528

Kur ekzekutimi i detyrimit bëhet i pamundur vetëm pjesërisht, detyrimi ekzekutohet në pjesën që mund të ekzekutohet.

Neni 529

Kur objekti i detyrimit është dorëzimi i një sendi dhe ky dëmtohet tërësisht, ose humbet pa fajin e debitorit dhe para se ky të vihet në vonesë, kreditori hyn në të drejtat e debitorit lidhur me këtë send, në varësi të faktit që ka shkaktuar pamundësinë e ekzekutimit të detyrimit. Kreditori ka të drejtë të kërkojë nga debitori atë çka ka marrë si rrjedhojë e shpërblimit të dëmeve.

TITULLI III MJETET PËR TË SIGURUAR EKZEKUTIMIN E DETYRIMEVE

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 530

Kreditori mund të shpërblehet me të gjithë pasurinë e tashme dhe të ardhshme të debitorit të tij, përveç rasteve kur me ligj është parashikuar ndryshe.

Një pronë mund të rëndohet nga pronari i saj, me qëllim që të sigurohet pagimi i një detyrimi.

Neni 531

Kreditorët kanë të drejta të barabarta për t'u shpërblyer me pasurinë e debitorit, përveç shkaqeve të ligjshme të preferimit.

Janë shkaqe të ligjshme të preferimit privilegjet, pengu dhe hipoteka.

Neni 532

Pengu dhe hipoteka mund të vihen vetëm për një detyrim efektiv.

Pengu dhe hipoteka mund të vihen si për një detyrim të pronarit të sendit të lënë peng ose hipotekë, ashtu dhe për një detyrim të një personi tjetër.

Neni 533

Pengu ose hipoteka mund të garantojë një kredi ekzistuese ose një kredi të ardhshme. Kredia për të cilën jepet garancia duhet të jetë e përcaktuar qartë.

Pengu ose hipoteka mund të vihet edhe për një detyrim me kusht.

Neni 534

Pengu ose hipoteka shtrihen përkatësisht mbi të gjitha punimet që përmirësojnë vleftën e pronës, kreditë dhe shpërblimet që u shtohen ose që zëvendësojnë pasurinë e rënduar, duke përfshirë edhe atë që kompensohet nga zhvleftësimi.

Neni 535

Në qoftë se sendet e lëna peng ose hipotekë humbasin ose zhvleftësohen, pagesa e shumave, për të cilat detyrohen siguruesit ose të tretët që përgjigjen për zhdëmtimin, nxirren nga pagesa e kredive që lidhen me pengun ose hipotekën, përveç rastit kur ato përdoren për të ndrequr humbjen ose zhvleftësimin e sendeve.

Neni 536

Në qoftë se sendi i dhënë në peng ose i lëshuar në hipotekë humbet ose dëmtohet qoftë dhe për rast faktor, në mënyrë që të mos dëmtohen të drejtat e kreditorit, ky i fundit mund të kërkojë që t'i jepet garanci e plotë mbi sende të tjera dhe, në mungesë të saj, mund të kërkojë pagesën e menjëhershme të kredisë së tij.

Neni 537

Pengu dhe hipoteka janë të papjesëtueshme edhe sikur detyrimi të jetë i pjesëtueshëm.

Neni 538

Kur pengu ose hipoteka janë vënë për të siguruar një detyrim të një personi tjetër, pronari i sendit të lënë peng ose hipotekë mund t'i kundrejtojë kreditorit të gjitha prapësimet që mund t'i kundrejtonte debitori dhe të kërkojë kompensimin e detyrimit me kreditë që ka debitori ndaj kreditorit.

Neni 539

Kur kreditori nuk paguhet tërësisht nga sendi i lënë peng ose hipotekë, ka të drejtë që pjesën e kredisë së papaguar ta nxjerrë nga çdo pasuri tjetër e debitorit, por pa patur të drejtën e preferimit ndaj kreditorëve të tjerë, siç e kishte për sendin e lënë peng, ose hipotekë.

Neni 540

Është e pavlefshme marrëveshja sipas së cilës përcaktohet se në mungesë të pagesës së kredisë në afatin e caktuar, pronësia mbi sendin e hipotekuar ose të dhënë peng i kalon kreditorit.

KREU II KUSHTI PENAL

Neni 541

Për mosekzekutimin ose ekzekutimin jo në mënyrën e duhur të detyrimeve, palët mund të parashikojnë në kontratë pagimin e një shume të hollash ose kryerjen e një detyrimi tjetër, për riparimin e dëmit ose për të nxitur ekzekutimin e detyrimit.

Neni 542

Kreditori nuk mund të kërkojë në të njëjtën kohë pagimin e kushtit penal dhe ekzekutimin e detyrimit.

Neni 543

Kur kushti penal është caktuar për rastin e mosekzekutimit të detyrimit dhe debitori nuk ekzekuton detyrimin e tij, kreditori ka të drejtë të kërkojë pagimin e kushtit penal, si dhe shpërblimin e pjesës së dëmit që kalon kushtin penal.

Kur kushti penal është caktuar për rastin e ekzekutimit të detyrimit jo në mënyrën e duhur, dhe debitori nuk e ka ekzekutuar detyrimin e tij në mënyrën e duhur, kreditori ka të drejtë të kërkojë ekzekutimin e detyrimit dhe pagimin e kushtit penal, si dhe shpërblimin e pjesës së dëmit që kalon kushtin penal.

Neni 544

Kur kushti penal është tepër i madh në krahasim me dëmin e pësuar nga kreditori, gjykata me kërkesën e debitorit mund të pakësojë kushtin disiplinor deri në nivelin e dëmit të pësuar.

Neni 545

Marrëveshja për kushtin penal duhet të bëhet me shkresë, pavarësisht nga madhësia e tij dhe nga forma që kërkohet për kontratën kryesore.

KREU III PENGU

Përkufizimi

Neni 546

*(Shtuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 8536, datë 18.10.1999;
shtuar fjali në fund të paragrafit të dytë
me ligjin nr. 121/2013, datë 18.4.2013)*

Pengu vihet mbi një pasuri të luajtshme, mbi një të drejtë ndaj prurësit, ose me urdhër, ose mbi uzufuktin e kësaj pasurie ose të drejte. Pengu krijohet duke vendosur pasurinë ose titullin në posedim të kreditorit ose të një të treti të caktuar me marrëveshje midis palëve.

Dispozitat për pengun nuk zbatohen ndaj kredive që lidhen me transaksione financiare, ndaj të cilave janë vendosur barrë siguroese, sipas kriterëve të përcaktuara me ligj të veçantë. Dispozitat për pengun nuk zbatohen edhe në rastet e marrëveshjeve të kolateralit financiar, të cilat rregullohen me ligj të veçantë.

Forma e kontratës

Neni 547

Kontrata e pengut duhet të bëhet me shkresë ose tek noteri, ndryshe është e pavlefshme. Ajo duhet të përfshijë gjithashtu një përshkrim të pronës së lënë peng. Në rastin e pengut të pjesëve, pengu duhet të regjistrohet në librin e anëtarëve të shoqërisë. Në rastin e pengut të aksioneve, pengu duhet të regjistrohet në librin e aksionarëve, në aksionet e lëna peng.

Mund të lihet peng e gjitha ose një pjesë e pronave të përdorura në një ndërmarrje që vepron si një koncern veprues. Në një rast të tillë pengu është efektiv kur pronat i besohen një pale të tretë ose një kreditori, i cili nga ana e tij, do t'i menaxhojë ato si një koncern veprues i pandashëm.

Mbrojtja e kreditorit

Neni 548

Kreditori që ka humbur posedimin e sendit të marrë peng, përveç padisë posedimore mund të ushtrojë edhe padinë e rivendikimit, në qoftë se kjo i takon pengdhënësit.

Të drejta e detyrime të palëve

Neni 549

Kreditori detyrohet ta ruajë sendin e marrë në peng dhe përgjigjet, sipas rregullave të përgjithshme, për humbjen dhe dëmtimin e tij.

Personi që ka dhënë pengun detyrohet të paguajë shpenzimet e kryera për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e sendit.

Neni 550

Në qoftë se sendi i dhënë peng sjell fryte ose të ardhura, kreditori ka të drejtë t'i bëjë ato të vetat, duke i përdorur së pari për shpenzimet dhe kamatat dhe pastaj për kredinë, përveç kur është parashikuar ndryshe në kontratë.

Neni 551

Kreditori nuk mund të përdorë sendin e dhënë peng pa patur pëlqimin e pengdhënësit, përveç kur përdorimi është i nevojshëm për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tij.

Ai nuk mund ta japë sendin në peng ose t'ua lërë të tjerëve në përdorim.

Neni 552

Në qoftë se kreditori shpërdoron sendin e dhënë në peng, pengdhënësi mund të kërkojë vënien e sendit në sekuestro.

Neni 553

Personi që ka dhënë pengun nuk mund të kërkojë kthimin e sendit, në qoftë se nuk janë paguar tërësisht kredia, kamatat, si dhe shpenzimet që kanë lidhje me detyrimin dhe me pengun.

Në qoftë se pengu është dhënë nga një debitor, i cili ka ndaj të njëjtit kreditor një detyrim tjetër të lindur pas vënies së pengut dhe që është bërë i kërkueshëm përpara detyrimit të mëparshëm, kreditori ka vetëm të drejtën të mbajë sendin deri sa të paguhen plotësisht të dy kreditë.

Neni 554

Në rast se sendi i dhënë në peng cenohet ose i pakësohet vlefata në mënyrë të tillë që dyshohet nëse do të jetë i mjaftueshëm për sigurimin e kreditorit, ky i fundit, pasi të njoftojë pengdhënësin, mund të kërkojë prej gjykatës autorizimin për të shitur sendin.

Gjykata kur jep autorizim për shitje vendos edhe për depozitimin e çmimit të blerjes për të garantuar kredinë.

Pengdhënësi mund të shmangë shitjen dhe të kërkojë prej gjykatës kthimin e pengut, duke ofruar një garanci tjetër reale, të cilën gjykata e çmon të mjaftueshme.

Në rast cenimi ose pakësimi të vlefatës së sendit të dhënë peng, pengdhënësi mund të kërkojë prej gjykatës autorizim për të shitur sendin, në qoftë se atij i paraqitet një rast i favorshëm.

Gjykata, kur jep autorizimin për shitje, vendos edhe për kushtet e shitjes dhe të depozitimit të çmimit të blerjes.

Neni 555

Kur sendet e lëna peng prishen, dëmtohen ose shpronësohen për interesa publikë, kreditorët që janë të siguruar me peng, kanë të drejtë të paguhen me preferim, sipas radhës së preferimit që kanë patur kreditë e tyre, nga shumata e shpërblimit të sendit ose nga çmimi i shpronësimit të tij.

Procedura e shitjes

Neni 556

Përpara se të procedohet për shitjen kreditori, me anë të gjykatës, i paraqet debitorit kërkesën për të paguar detyrimin dhe

aksesorët e tij duke e paralajmëruar atë se në rast të kundërt do të kryhet shitja. Ky njoftim i duhet bërë edhe palës së tretë që ka dhënë pengun, në rastet kur kjo palë ekziston.

Në qoftë se kërkesa nuk kundërshtohet brenda pesë ditësh, kreditori mund ta shesë sendin në ankand ose, po qe se sendi ka një çmim tregu, mund ta shesë atë edhe me këtë çmim, me anë të një personi të autorizuar për shitje të tilla.

Kur pengu përfshin shumë sende, gjykata, e mbështetur në kundërshtimin e pengdhënësit, kufizon shitjen vetëm për sendin, vlefata e të cilit në lidhje me sendet e tjera, mjafton për të paguar debininë.

Për shitjen e sendit të dhënë peng palët mund të merren vesh për të përdorur edhe forma të tjera.

Neni 557

Kreditori pengmarrës, në mbarim të afatit detyrohet të vjelë të drejtat që rrjedhin nga kredia e marrë peng dhe kur kjo ka për objekt para ose sende të tjera të barazvlershme, vetë ose me kërkesën e debitorit duhet t'i depozitojë ato në vendin e caktuar në marrëveshje dhe, në mungesë të saj, në vendin e caktuar nga gjykata. Kur afati i kredisë i garantuar me pengun ka mbaruar, kreditori mban

nga shuma e marrë atë sa nevojiten për përmbushjen e të drejtave të tij dhe mbetjen ia kthen pengdhënësit.

Neni 558

Kreditori mund të kërkojë nga gjykata që sendi t'i lihet atij me pagesë deri në shlyerjen e detyrimit, sipas vlerësimit të bërë nga ekspertë ose sipas çmimit të tregut, në qoftë se sendi ka një çmim tregu.

Neni 559

Në qoftë se kredia e dhënë në peng rezulton nga një dokument, pengdhënësi detyrohet t'ia japë këtë dokument kreditorit.

KREU IV HIPOTEKA

Përkufizimi i hipotekës

Neni 560

Hipoteka është një e drejtë reale që vihet mbi pasurinë e debitorit ose të një të treti, në dobi të kreditorit, për të siguruar përmbushjen e një detyrimi.

Sendet e hipotekueshme

Neni 561

Janë të hipotekueshme:

1. Sendet e paluajtshme.
2. Uzufuktet e këtyre sendeve përveç uzufuktit ligjor të prindërve, si dhe të drejtat enfitoteike mbi këto sende.

Llojet e hipotekave

Neni 562

Hipoteka vihet në bazë të kontratës ose të ligjit dhe me regjistrimin e saj. Kontrata duhet të bëhet me akt noterial.

Hipoteka ligjore

Neni 563

Kanë hipotekë në bazë të ligjit:

- a) shitësi e çdo tjetërsues tjetër mbi sendet e paluajtshme të tjetërsuara për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga tjetërsimi;
- b) bashkëtrahëgimtarët, anëtarët e shoqërive me aktivitet ekonomik e bashkëpjesëtarët e tjerë mbi sendet e paluajtshme të përbashkëta, në pjesët që u kanë takuar atyre për pagimin e shumave të caktuara për barazimin dhe plotësimin e pjesëve.

Neni 564

Servitutet që janë regjistruar pas regjistrimit të një hipoteke, nuk mund t'i kundrejtohen kreditorit hipotekar.

Paragrafi i mësipërm zbatohet edhe për të drejtën e uzufuktit, të përdorimit dhe të banimit.

Hipoteka gjyqësore

Neni 565

Vendimi i gjykatës për pagimin e një shume parash, për përmbushjen e detyrimeve të vlerësuara apo për shpërblimin e dëmeve që do të rrjedhin më pas, përbën titull për vënien e hipotekës tek pasuria e debitorit.

Hipotekë mund të vihet edhe në bazë të një vendimi arbitrazhi që përbën titull ekzekutiv.

Neni 566

Kur hipoteka jepet nga një person që nuk është pronar i sendit, regjistrimi i saj quhet i vlefshëm vetëm kur sendi fitohet prej tij.

Hipoteka mbi sendet e ardhshme

Neni 567

Hipoteka mbi një send të ardhshëm, mund të regjistrohet vetëm kur të ekzistojë sendi.

Shtrirja e hipotekës

Neni 568

Hipoteka siguron kredinë për aq sa kjo do të jetë në kohën e shlyerjes së saj, duke përfshirë edhe kamatat, shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga vonesa e ekzekutimit, si dhe shpenzimet e bëra për nxjerrjen e kredisë.

Neni 569

Hipoteka e vënë mbi pjesën e vet nga njëri prej pjesëtarëve në bashkëpronësi sjell efekt në lidhje me atë send ose me atë pjesë të sendit që do t'i jepet atij pas ndarjes.

Në qoftë se gjatë ndarjes njërit pjesëtar i jepet një send tjetër dhe i pahipotekuar prej tij, hipoteka kalon mbi këtë send me të njëjtën shkallë regjistrimi sikurse origjinali dhe brenda kufijve të vleftës së sendit të hipotekuar më përpara, me kusht që hipoteka të regjistrohet përsëri brenda 90 ditëve nga regjistrimi i së njëjtës ndarje.

Vendi i regjistrimit

Neni 570

Hipoteka regjistrohet në zyrën e regjistrimit të pasurisë të paluajtshme të vendit ku ndodhet kjo pasuri.

Neni 571

Detyrimet që rrjedhin nga titujt me urdhër ose tek prurësi mund të garantohen me hipotekë.

Efektet e pasaktësive të aktit

Neni 572

Hipoteka është e pavlefshme, kur në kontratën e hipotekës, ose në aktin bazë për vënien e hipotekës, apo në kërkesën për vënien e saj, në bazë të ligjit, ka pasaktësi për personin e kreditorit, të debitorit, të pronarit të sendit të lënë në hipotekë, për vetë sendin ose për shumën e kredisë të siguruar me hipotekë.

Shpenzimet e regjistrimit

Neni 573

Shpenzimet e regjistrimit të hipotekës janë në ngarkim të debitorit, përveç kur është parashikuar ndryshe, por ato duhet të parapaguhën nga kërkuesi.

Radha e hipotekave

Neni 574

Hipoteka sjell efekt dhe zë radhë nga data e regjistrimit të saj edhe kur titulli është për një kredi të ardhshme ose të kushtëzuar.

Neni 575

Numri rendor i regjistrimeve përcakton radhën e tyre.

Kur në të njëjtën kohë shumë persona paraqesin kërkesë për të regjistruar në hipotekë ndaj të njëjtit person dhe po mbi ato prona, regjistrimi bëhet me të njëjtin numër dhe ky fakt shënohet në dëftesën që regjistruesi i jep secilit prej kërkuesve.

Neni 576

Hipotekat e regjistruara me të njëjtin numër dhe po mbi ato prona, konkurrojnë me njëra-tjetrën, në përpjesëtim me vleftën e tyre përkatëse.

Neni 577

Regjistrimi i një kredie shërben për të vënë në po atë radhë shpenzimet e aktit, të regjistrimit e të përtëritjes, si dhe shpenzime të tjera që nevojiten për procedurat ekzekutive.

Regjistrimi i një kredie në para që sjell kamatë, bën që kamata të qëndrojë në të njëjtën radhë përparësie me atë, me kusht që kamata të jetë përcaktuar në regjistrim.

Kamata në këtë rast kufizohet në dy vitet paraardhëse, si dhe në vitin në vazhdim në ditën që është vënë dorë e deri në ditën e mbylljes së procedimit të zbatimit forcërisht.

Efektet e hipotekës

Neni 578

Regjistrimi i hipotekës ka efekt për një periudhë prej 20 vjetësh nga data e kryerjes së tij. Efekti pushon në qoftë se nuk përtërihet përpara mbarimit të këtij afati. Pas mbarimit të afatit të treguar më sipër, kreditori mund të kryejë një regjistrim të ri, por në këtë rast hipoteka zë radhë dhe ka efekt kundrejt palëve të treta sipas datës së regjistrimit të ri.

Neni 579

Kalimi i kredisë së siguruar me hipotekë një personi tjetër dhe vënia e sekuestros mbi këtë kredi ka efekt pasi të jetë bërë shënimi përkatës në regjistrimin e hipotekës.

Neni 580

Në qoftë se kreditori që ka hipotekë mbi një ose më shumë prona del i dëmtuar për shkak se me çmimin e tyre është paguar tërësisht ose pjesërisht një kreditor i mëparshëm, hipoteka e të cilit shtrihej mbi prona të tjera të të njëjtit debitor, mund të nënvendësohet në hipotekën e regjistruar në favor të kreditorit të paguar, me qëllim që të ushtrojë padinë hipotekore mbi ato prona, duke u parapëlqyer ndaj kreditorëve të tjerë që vijnë pas tij në regjistrim. Po këtë të drejtë kanë edhe kreditorët që dëmtohen për shkak të nënvendësimit të sipërpërmendur.

Zbritja e hipotekës

Neni 581

Zbritja e hipotekave bëhet duke e kufizuar vetëm në një pjesë të pasurisë së treguar në regjistrim ose duke pakësuar shumën për të cilën është vënë regjistrimi.

Neni 582

Kërkesa për zbritjen e hipotekave sipas nenit të mësipërm nuk pranohet, në qoftë se sasia e pasurisë apo shuma ka qenë caktuar me marrëveshje ose me vendim gjykate.

Megjithatë, kur janë bërë pagesa të pjesëshme, që shuajnë të paktën një të pestën e detyrimit fillestar, mund të kërkohet një pakësim përpjesëtimor i shumës.

Kur është vënë hipotekë mbi një ndërtesë, hipotekuesi që pas regjistrimit ka bërë mbindërtime, mund të kërkohet që hipoteka të pakësohet, në mënyrë që mbindërtimet të përjashtohen.

Shuarja e hipotekës

Neni 583

Hipoteka shuhet:

- a) me shuarjen e detyrimit;
- b) me humbjen e sendit të lënë në hipotekë, duke respektuar të drejtat e parashikuara prej nenit 536 të këtij Kodi;
- c) me heqjen dorë të kreditorit;

- ç) me pagimin e çmimit të shitjes me anë të ekzekutimit të detyrueshëm, kreditorëve të siguruar me hipotekë, sipas radhës së regjistrimit të tyre;
- d) me kalimin e afatit për të cilin ishte kufizuar hipoteka.

Fshirja e regjistrimit të hipotekës

Neni 584

Regjistrimi i hipotekës fshihet:

- a) me pëlqimin e kreditorit të dhënë me akt noterial;
- b) me vendim të formës së prerë të gjykatës që urdhëron fshirjen.

Fshirja e regjistrimit shuan hipotekën. Kur shkaku i shuarjes së detyrimit deklarohet i pavlefshëm, hipoteka lind dhe regjistrohet përsëri, por regjistrimi merr numër rendor të ri.

KREU V DORËZANIA

Përmbajtja

Neni 585

Dorëzania është një veprim juridik me të cilën një person (dorëzanësi), detyrohet t'i sigurojë kreditorit ekzekutimin e detyrimit të një personi të tretë (debitori kryesor).

Dorëzania është e vlefshme edhe kur debitori nuk ka dijeni për atë.

Neni 586

Dorëzania qëndron vetëm për një detyrim efektiv.

Dorëzania mund të jepet si për një detyrim të ardhshëm, ashtu dhe për një detyrim me kusht.

Forma dhe vlefshmëria

Neni 587

Dorëzania duhet të bëhet me shkresë.

Neni 588

Dorëzania nuk është e vlefshme në qoftë se nuk është i vlefshëm detyrimi kryesor. Ajo mund të jepet si për debitorin kryesor, ashtu dhe për dorëzanësin e tij.

Efektet e dorëzanisë dhe detyrimet e palëve

Neni 589

Dorëzanësi përgjigjet për aq sa detyrohet debitori kryesor, duke përfshirë edhe pagimin e kamatës, shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga vonesa e ekzekutimit dhe të shpenzimeve të tjera që ka bërë kontraktori për të nxjerrë kredinë e tij, përveç kur në marrëveshje pranohet që dorëzania të jepet edhe për një pjesë të detyrimit, ose me kushte më të lehta ose më të pakta se detyrimi kryesor.

Dorëzania që kalon detyrimin ose që jepet në kushte më të rënda se detyrimi kryesor, është e vlefshme vetëm deri në kufijtë e këtij të fundit.

Neni 590

Dorëzanësi është i detyruar solidarisht mbi debitorin kryesor për ekzekutimin e detyrimit, përveç kur është parashikuar ndryshe me marrëveshje.

Palët mund të merren vesh që dorëzanësi të mos jetë i detyruar të paguajë para kryerjes së të gjitha veprimeve të nevojshme, që detyrojnë debitorin të paguajë detyrimin. Në rast se dorëzanësi paditet dhe kërkon të përdorë një të drejtë të tillë, ai duhet të tregojë pasurinë e debitorit kryesor që do t'i nënshtrohet ekzekutimit. Dorëzanësi është i detyruar të parapaguajë shpenzimet e nevojshme, në qoftë se palët nuk janë marrë vesh ndryshe.

Neni 591

Kur disa persona janë bërë dorëzanës për të njëjtin debitor, për të siguruar të njëjtin detyrim, secili prej tyre përgjigjet për të gjithë detyrimin, përveç kur ka marrëveshje për ndarjen e tij.

Neni 592

Dorëzanësi ka të drejtë t'i kundrejtojë kreditorit të gjitha prapësimet që mund t'i kundrejtonte këtij debitori dhe të kërkojë kompensimin e asaj që kreditori i detyrohet debitorit edhe sikur ky të ketë hequr dorë nga këto të drejta ose të ketë pranuar detyrimin.

Neni 593

Dorëzanësi që ka ekzekutuar detyrimin në vend të debitorit, zë vendin e kreditorit në të gjitha të drejtat e tij ndaj debitorit.

Neni 594

Kur janë shumë debitorë kryesorë të detyruar solidarisht për të njëjtin detyrim, dorëzanësi që ka dhënë garanci për të gjithë ata, ka të drejtën e padisë së kthimit nga secili prej tyre për të marrë shumën që ka paguar.

Neni 595

Kur dorëzanësi ka ekzekutuar detyrimin e debitorit pa u paditur në gjyq dhe pa lajmëruar debitorin kryesor, ky mund t'i kundrejtojë dorëzanësit të gjitha prapësimet që do të mund t'i kundrejtonte kreditorit në kohën e ekzekutimit të detyrimit.

Dorëzanësi që ka ekzekutuar detyrimin e debitorit nuk ka të drejtë të kërkojë me padi nga debitori atë që ka ekzekutuar për të, në rast se edhe debitori ka ekzekutuar detyrimin e tij për shkak se dorëzanësi nuk e ka lajmëruar për ekzekutimin e detyrimit që ka bërë ai vetë.

Në të dy rastet, dorëzanësi ka të drejtë të ngrejë padi kundër kreditorit dhe të kërkojë atë që ka ekzekutuar për debitorin kryesor.

Neni 596

Debitori që ka ekzekutuar detyrimin duhet të lajmërojë menjëherë dorëzanësin. Në rast të kundërt, dorëzanësi, që ka ekzekutuar detyrimin e debitorit, nuk e humbet të drejtën që të kërkojë nga debitori atë që ka ekzekutuar për të. Debitori, në këtë rast, është i detyruar të ekzekutojë për të dytën herë detyrimin, por ka të drejtë që të ngrejë padi kundër kreditorit për atë që ky ka fituar pa shkak.

Shuarja e dorëzanisë

Neni 597

Dorëzania shuhet me shuarjen e detyrimit kryesor.

Neni 598

Dorëzanësi shkarkohet nga detyrimi i tij në rast se kreditori ka hequr dorë nga privilegjet, pengu dhe hipoteka që i siguronin kredinë dhe për këtë shkak dorëzanësi nuk mund të zërë vendin e tij në këto të drejta.

Neni 599

Kur kreditori pranon vullnetarisht një pasuri, ose çdo gjë tjetër për pagimin e detyrimit kryesor, dorëzanësi lirohet nga detyrimi i tij edhe sikur kreditorit t'i rezultojë më pas një shkak evinkcioni.

Neni 600

Dorëzania shuhet në qoftë se kreditori nuk ka ngritur padi kundër dorëzanësit brenda gjashtë muajve nga dita e mbarimit të afatit të ekzekutimit të detyrimit.

Kur afati i ekzekutimit të detyrimit nuk është caktuar as në kontratën e dorëzanisë, as në një marrëveshje tjetër, dorëzania shuhet me kalimin e një viti nga dita e lidhjes së kontratës së dorëzanisë.

KREU VI

KAPARI DHE PRIVILEGJET

A. Kapari

Përmbajtja

Neni 601

Kapar quhet shuma në të holla që njëra nga palët i jep tjetrës për llogari të shumës që do t'i paguhet në bazë të kontratës, me qëllim që të vërtetojë lidhjen e kontratës dhe të sigurojë ekzekutimin e saj.

Efektet juridike

Neni 602

Kur kontrata nuk ekzekutohet nga faji i palës që ka dhënë kaparin, kjo palë e humbet kaparin; kur kontrata nuk ekzekutohet nga faji i palës që ka marrë kaparin, kjo palë është e detyruar të kthejë dyfishin e kaparit. Pala që ka faj për moszekutimin e kontratës është e detyruar t'i shpërblejë palës tjetër edhe dëmin, duke llogaritur në shpërblimin e këtij dëmi dhe shumën e kaparit, përveç kur në kontratë është parashikuar ndryshe.

B. Preferimet (privilegjet)

Neni 603

Preferimi është një e drejtë, të cilën ligji e jep duke patur parasysh shkakun e kredisë.

Kreditë që caktohen si të preferuara, kanë përparësi nga gjithë kreditë e tjera.

Midis shumë kredive të preferuara, përparësia në ekzekutim përcaktohet nga ligji, sipas llojit të preferimit.

Neni 604

Kreditë që janë njëlloj të preferuara, konkurrojnë ndërmjet tyre në proporcion me shumën e secilës kredi.

Radha e preferimit

Neni 605

(Ndryshuar me ligjin nr. 8536, datë 18.10.1999)

(Shtuar paragrafi i fundit me ligjin nr. 113/2016, datë 3.11.2016)

Paguhen me preferim, sipas radhitjes së tyre kreditë e mëposhtme:

a) kreditë që rrjedhin nga transaksionet financiare të siguruara me barrë siguroese për çmimin e blerjes së një objekti të veçantë;

b) kreditë që rrjedhin nga pagat në marrëdhëniet e punës ose të shërbimit dhe detyrimet për ushqim, por jo më shumë se për 12 muaj;

c) kreditë e sigurimeve shoqërore për kontributet e papaguara së bashku me kamatat, si dhe kreditë e punonjësve për dëmet e pësura nga mospagimi prej punëdhënësit të kontributeve të mësipërme;

ç) kreditë që rrjedhin nga shpërblime për shkak vdekjeje e dëmtimi të shëndetit;

d) kreditë e autorëve dhe të trashëgimtarëve të tyre për shpërblimet që rrjedhin nga tjetërsimi i plotë ose i pjesshëm i të drejtave të tyre në fushën intelektuale për detyrimet e lindura gjatë dy vjetëve të fundit;

dh) kreditë e shtetit, që rrjedhin nga detyrimet ndaj buxhetit dhe kreditë e institutit të sigurimeve shtetërore për sigurimet e detyrueshme, të përcaktuara me ligj;

e) kreditë, që rrjedhin nga transaksionet financiare, të siguruara me barrë siguroese, sipas kriterëve të përcaktuara me ligj;

ë) kreditë, që rrjedhin nga pagat në marrëdhëniet e punës ose të shërbimit dhe detyrimet për ushqim tej kufirit të caktuar në shkronjën “b” të këtij neni;

f) shpërblimi i ndërmjetësimit që rrjedh nga kontrata e agjencisë, kur ai rrjedh gjatë vitit të fundit të shpërblimit;

g) kreditë e siguruara me hipotekë ose me peng që nuk krijojnë barrë siguroese, sipas ligjit, nga vlefata e sendeve në hipotekë ose të lëna peng;

gj) kreditë që rrjedhin nga shpenzimet e gjyqit për ruajtjen e sendit dhe ato për veprime ekzekutive, të bëra në interesin e përbashkët të kreditorëve, nga vleftha e shitjes së sendeve;

h) kreditë e dhëna nga bankat, të cilat nuk përfshihen në shkronjën “e” dhe kreditë që rrjedhin nga sigurimet vullnetare;

i) kreditë për furnizimin me farëra, plehra kimike, insekticide, ujë për ujitje dhe për punimet e kultivimit e të mbledhjes së prodhimeve bujqësore, mbi prodhimin (frutet) bujqësor të vitit, për të cilin janë përdorur kreditë.

Kur ka disa kredi sipas shkronjës “a” dhe shkronjës “e” të këtij neni, radha e preferimit, përcaktohet sipas kritereve të përcaktuara me ligj të veçantë. Kur ligji i veçantë nuk i jep një kredi sipas shkronjës “a” preferim mbi kreditë sipas shkronjës “e”, kredia sipas shkronjës “a” do të preferohet sipas shkronjës “e”.

Përfshihen nga radha e preferimit sipas këtij neni kreditë sipas shkronjës “e”, që janë dhënë aktualisht, të cilat do të preferohen përpara kredive sipas shkronjës “dh” në rastet që vijnë:

- kredia sipas shkronjës “e” është regjistruar sipas ligjit, ndërsa kredia sipas shkronjës “dh” nuk është regjistruar;

- kredia sipas shkronjës “e” është regjistruar sipas ligjit, përpara regjistrimit të kredisë sipas shkronjës “dh”.

Radha e preferimit, e parashikuar në këtë nen, nuk zbatohet në procedurën e falimentimit, parashikuar me ligj të veçantë.

Neni 606

Kreditori mund ta mbajë sendin që i nënshtrohet privilegjit derisa të shpërblehet për kredinë e tij dhe mund ta shesë atë sipas rregullave të caktuara për shitjen e pengut.

Kundërshtimi i veprimeve juridike të debitorit

Neni 607

(Shtuar paragrafi i fundit me ligjin nr. 113/2016, datë 3.11.2016)

Kreditori ka të drejtë të kërkojë që të deklarohen të pavlefshme veprimet juridike të kryera nga debitori me qëllim që të pakësojë sasinë ose vleftën e pasurisë së tij në dëm të kreditorit, me kusht që kredia të ketë lindur më parë se të jetë kryer veprimi juridik.

Kur veprimi juridik është bërë me kundërshtëpërbllim, duhet që edhe personi, me të cilin debitori ka kryer këtë veprim, të ketë patur dijeni për qëllimin e dëmtimit të debitorit. Por kur ky person është bashkëshort, prind, gjysh, fëmijë ose fëmijë e fëmijës, vëlla ose motër e debitorit, dijenia e qëllimit të dëmtimit prezumohet, gjersa të provohet e kundërta.

Me deklarimin e veprimit juridik si të pavlefshëm, nuk cenohen të drejtat që kanë fituar me kundërshtëpërbllim personat e tretë me mirëbesim para ngritjes së padisë për deklarimin e pavlefshmërisë së veprimit juridik.

Ky nen nuk zbatohet në procedurën e falimentimit, parashikuar me ligj të veçantë.

TITULLI IV

DETYRIMET QË RRJEDHIN NGA SHKAKTIMI I DËMIT

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Përgjegjësia për shkaktimin e dëmit

Neni 608

Personi që, në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar.

Personi që ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj.

Dëmi quhet i paligjshëm kur është rrjedhim i shkeljes ose i cenimit të interesave dhe i të drejtave të tjetrit, që mbrohen nga rendi juridik ose nga zakonet e mira.

Neni 609

Dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit ose mosveprimit të personit.

Mospengimi i një ngjarjeje nga personi që ka detyrimin ligjor për ta mënjeluar, e ngarkon atë me përgjegjësi për dëmin e shkaktuar.

Neni 610

Është e pavlefshme marrëveshja që paraprakisht përjashton ose kufizon përgjegjësinë e personit që ka kryer dëm me faj.

Neni 611

Nuk është përgjegjës ai që i shkakton dëm tjetrit për mbrojtjen e nevojshme të tij ose të një të treti.

Neni 612

Personi që ka shkaktuar dëmin duke qenë i shtrënguar nga nevoja për të shpëtuar veten ose të tjerët nga rreziku i atëçastëm i një dëmi të rëndë, rrezik i cili nuk ka qenë shkaktuar dhe as nuk mund të mënjanohej prej tij, detyrohet të shpërblejë dëmin. Gjykata, duke marrë parasysh rrethanat e posaçme të çështjes, mund ta shkarkojë plotësisht ose pjesërisht këtë person nga detyrimi i shpërblimit të dëmit.

Dëmi nga të miturit dhe personat e pazotë për të vepruar

Neni 613

I mituri që nuk ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç dhe personat që janë krejt të pazotë për të vepruar nuk përgjigjen për dëmin e shkaktuar.

Prindërit, kujdestari ose ata të cilëve u janë besuar ose kanë në mbikëqyrje persona të pazotë për të vepruar, janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga veprimet e paligjshme të fëmijëve nën moshën katërmëdhjetë vjeç, të personave nën kujdestarinë e tyre dhe të atyre që i kanë nën mbikëqyrje e me të cilët banojnë, por që nuk kanë zotësi për të vepruar, përveç kur provojnë se nuk kanë mundur të ndalonin shkaktimin e dëmit.

Neni 614

I mituri që ka mbushur moshën katërbëdhjetë vjeç, përgjigjet për dëmin e paligjshëm të shkaktuar prej tij.

Prindërit ose kujdestari përgjigjen për dëmin e mësipërm kur i mituri nuk nxjerr të ardhura nga puna ose nuk ka vetë pasuri, përveç kur provojnë se nuk kanë mundur të ndalonin shkaktimin e dëmit.

Dëmi nga personat nën mbikëqyrje

Neni 615

Mësuesit dhe personat e tjerë që kanë nën mbikëqyrje të mitur ose personat që u mësojnë të tjerëve një mjeshtëri ose profesion, janë përgjegjës për dëmin e paligjshëm të shkaktuar të tjerëve nga nxënësit ose personat që kanë nën mbikëqyrje, ose personat që mësojnë mjeshtëri apo profesion pranë tyre, të shkaktuar gjatë kohës që kanë qenë nën mbikëqyrje të tyre të drejtpërdrejtë, përveç kur provojnë se nuk kanë mundur të ndalonin shkaktimin e dëmit.

Neni 616

Për dëmin përgjigjet edhe personi që në momentin që e ka shkaktuar atë, nuk ka patur ndërgjegjen e veprimeve të tij.

Gjykata, mund të ulë masën e dëmshpërblimit, duke marrë parasysh moshën, shkallën e ndërgjegjes për veprimet e kryera, si dhe kushtet ekonomike të palëve, përveç kur për fajin e tij ka sjellë veten në këtë gjendje.

Publikimet mashtruese ose të pasakta

Neni 617

Kur vërtetohet se një person ka përgjegjësi ndaj një personi tjetër, për shkak se ka publikuar të dhëna të pasakta, jo të plota ose mashtruese, gjykata me kërkesën e personit të dëmtuar, detyron personin tjetër që të publikojë një përgënjeshttrim, në mënyrën që ajo do ta quante të përshtatshme.

Gjykata mund të urdhërojë publikimin e përgënjeshttrimit edhe kur vërtetohet se publikimi i të dhënave nuk është i paligjshëm dhe i kryer me faj, se autori i tyre nuk kishte dijeni për karakterin e pasaktë ose të paplotë të këtyre të dhënave.

Përgjegjësia e punëdhënësit

Neni 618

Punëdhënësi është përgjegjës për dëmet e shkaktuara të tretëve për fajin e punonjësve që janë në shërbim të tij, gjatë ushtrimit të detyrave që u janë besuar prej tij.

Personi juridik është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga organet e tij në kryerjen e detyrave të tyre.

Neni 619

Në qoftë se një person që ushtron veprimtari në kuadrin e detyrës të një tjetri dhe sipas udhëzimeve të tij, pa qenë punonjës i tij, është përgjegjës për dëmin e shkaktuar gjatë kësaj veprimtarie ndaj të tretit.

Personi tjetër është gjithashtu përgjegjës ndaj të tretit.

Përgjegjësia e përfaqësuesit

Neni 620

Në qoftë se veprimtaria e përfaqësuesit në ushtrimin e pushteteve që i janë caktuar, sjell një përgjegjësi me faj ndaj një të treti, i përfaqësuari është gjithashtu përgjegjës ndaj këtij personi.

Përgjegjësia nga përdorimi i kafshëve

Neni 621

Pronari i një kafshe ose ai që e përdor atë është përgjegjës për dëmin e shkaktuar prej saj, përveç kur provon se ka patur kontrollin e sjelljes së kafshës nga e cila është shkaktuar dëmi dhe nuk ka mundur ta mënjanonte atë.

Përgjegjësia nga ushtrimi i një veprimtarie të rrezikshme

Neni 622

Personi që kryen një veprimtari të rrezikshme nga natyra e saj ose nga natyra e sendeve të përdorura dhe u shkakton dëm personave të tjerë, detyrohet të shpërblejë dëmin, përveç kur provon se ka përdorur të gjitha masat e përshtatshme e të nevojshme për mënjanimin e dëmit.

Neni 623

Pronari i një ndërtese ose i një ndërtimi është përgjegjës për dëmet e shkaktuara nga të metat e çdo ves tjetër që ka lidhje me ndërtimin ose me mirëmbajtjen e tyre.

Por pronari i ndërtesës ose i ndërtimit ka të drejtë t'u kërkojë personave përgjegjës ndaj tij, të shpërblejnë dëmet që ka pësuar.

Përgjegjësia për mjedisin

Neni 624

Personi që me faj ka cenuar mjedisin, duke e keqësuar, ndryshuar ose dëmtuar atë, tërësisht ose pjesërisht, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar.

Neni 625

(Ndryshuar me ligjin nr.17/2012, datë 16.2.2012)

Personi që pëson një dëm jopasuror ka të drejtë të shpërblehet kur:

- a) ka pësuar një dëmtim të shëndetit, të integritetit fizik ose psikik të tij;
- b) është cenuar nderi, personaliteti ose reputacioni i tij;
- c) është cenuar e drejta e emrit;
- ç) është cenuar respektimi i jetës private;

d) është cenuar kujtimi i një të vdekuri. Në këtë rast bashkëshorti i personit të vdekur ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë mund të kërkojnë shpërblimin e dëmit jopasuror.

Përgjegjësia solidare

Neni 626

Kur dëmi është shkaktuar nga shumë persona së bashku, këta përgjigjen ndaj të dëmtuarit solidarisht.

Padia e kthimit

Neni 627

Personi që ka shpërblyer dëmin ka të drejtë të kërkojë nga secili shkaktar i dëmit pjesën e tij në përpjesëtim me shkallën e fajësisë të secilit dhe të tërësisë së pasojave të rrjedhura. Kur kjo nuk mund të përcaktohet, prezumohet se shkalla e fajësisë është e barabartë.

Prindërit ose kujdestarët që kanë paguar shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga të miturit ose nga personat të cilëve u është hequr krejt zotësia për të vepruar, nuk kanë të drejtë të kërkojnë nga këta kthimin e shpërblimit të dëmit që kanë paguar.

KREU II

PËRGJEGJËSIA QË RRJEDH NGA PRODUKTET

A. Përgjegjësia e prodhuesit

Neni 628

Prodhuesi është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga të metat e produkteve të tij, përveç kur:

a) prodhuesi nuk ka vënë në qarkullim produktet;

b) sipas rrethanave të vërtetuara, vlerësohet se të metat që kanë shkaktuar dëmin nuk ekzistojnë në kohën e vënies në qarkullim të produktit, ose ato kanë lindur më vonë;

c) produkti nuk ka qenë prodhuar për shitje ose ndonjë formë tjetër shpërndarjeje, me qëllim të caktuar ekonomik të prodhuesit, as edhe i prodhuar ose i shpërndarë në kuadrin e një ndërmarrjeje ose veprimtarie profesionale;

d) të metat janë rrjedhim i faktit se produkti ka qenë në përputhje me rregullat e vëna nga organet publike;

e) njohuritë shkencore e teknike nuk kanë mundur të zbulojnë të metat në kohën e vënies në qarkullim të produktit;

ë) është fjala për prodhimin e një lënde të parë ose fabrikimin e një pjese përbërëse të produktit, të cilat në formimin e produktit rezultojnë me të meta, ose si rrjedhojë e udhëzimeve të gabuara të dhëna nga prodhuesi i produktit.

Neni 629

Përgjegjësia e prodhuesit pakësohet ose hiqet kur, sipas rrethanave, dëmi është shkaktuar si nga të metat e produktit, ashtu edhe nga faji i personit të dëmtuar ose të një personi, për të cilin personi i dëmtuar është përgjegjës.

Përgjegjësia e prodhuesit nuk pakësohet kur dëmi është rrjedhim i përbashkët i të metave të produktit dhe sjelljes së një të treti.

Neni 630

Një send quhet se është me të meta kur nuk jep sigurinë që pritet prej tij, duke patur parasysh gjithë rrethanat e në veçanti:

- a) paraqitjen e produktit;
- b) përdorimin e arsyeshëm që pritet prej produktit;
- c) kohën e vënies në qarkullim të produktit.

Produkti nuk mund të quhet se është me të meta duke u nisur nga fakti se një produkt më i perfeksionuar është vënë në qarkullim më vonë se ai.

Neni 631

“Produkt” në kuptim të këtij Kodi quhet një send i luajtshëm edhe sikur ai të jetë trupëzuar në një send të luajtshëm ose të paluajtshëm, si dhe elektriciteti, duke përfshirë produktet bujqësore dhe produktet e rrjedhura nga gjuetia.

Me produkte bujqësore kuptohen prodhimet e tokës, të blegtorisë dhe të peshkimit, përveç kur këto kanë pësuar një përpunim të parë.

“Prodhues” në kuptimin e këtij Kodi quhet prodhuesi i një produkti të përfunduar, të një lënde të parë ose fabrikuesi i një pjese përbërëse të produktit, si dhe çdo person tjetër që paraqitet si i tillë (prodhues), duke vënë mbi produktin emrin e tij, markën ose një shenjë tjetër dalluese.

Pa mënjnuar përgjegjësinë e prodhuesit, quhet si “prodhues” çdo person që importon një produkt me qëllim shitjeje, dhënieje me qira, leasingu, ose një formë tjetër shpërndarjeje, në kuadrin e veprimtarisë së tij tregtare. Në këtë rast, përgjegjësia e tij është e njëjtë me atë të prodhuesit.

Neni 632

Kur prodhuesi nuk mund të identifikohet, çdo furnizues do të konsiderohet si prodhues, përveç kur brenda një afati të arsyeshëm, ai i tregon personit të dëmtuar identitetin e prodhuesit ose të personit që ka furnizuar produktin.

Neni 633

Kur, në zbatim të paragrafit të parë të nenit 628 të këtij Kodi, shumë persona janë përgjegjës për të njëjtin dëm, secili prej tyre është përgjegjës për të gjithë dëmin.

Neni 634

1. Padia për shpërblimin e dëmit e ngritur kundër prodhuesit, në zbatim të paragrafit të parë të nenit 628 të këtij Kodi, parashkruhet me kalimin e tre vjetëve duke filluar nga dita që personi i dëmtuar ka patur ose duhej të kishte patur dijeni për dëmin, të metat dhe identitetin e prodhuesit.

2. E drejta e personit të dëmtuar kundër prodhuesit për shpërblimin e dëmit, sipas paragrafit të parë të nenit 628 të këtij Kodi, shuhet me kalimin e dhjetë vjetëve, nga dita që prodhuesi ka vënë në qarkullim produktin që ka shkaktuar dëmin.

B. Publikimi mashtrues

Neni 635

Personi që publikon ose shkakton bërjen publike të një njoftimi lidhur me produktet ose shërbimet, që ofron vetë në rastin e një veprimtarie profesionale, ose të një ndërmarrjeje, ose të një personi për të cilin ai vepron, kryen një veprim të paligjshëm në qoftë se njoftimi është mashtrues në një ose disa drejtime të mëposhtme:

- a) natyra, përbërja, sasia, cilësia, karakteristikat ose përdorimet e mundshme;
- b) origjina, mënyra ose data e prodhimit;
- c) madhësia e prodhimit stok të tij;
- ç) çmimi ose metoda e llogaritjes së tij;
- d) arsyeja ose qëllimi i ofertës speciale;
- dh) cilësitë e atribuara, dëshmitë ose vlerësime të tjera të bëra nga të tretët, ose deklarata të lëshuara prej tyre, terminologjia shkencore ose profesionale e përdorur, të dhënat teknike ose statistikore;
- e) kushtet e livrimit të produkteve, të ushtrimit të shërbimeve ose të kryerjes së pagesës;
- f) shtrirja, përmbajtja dhe kohëzgjatja e garancisë;
- g) identiteti, cilësitë, kompetencat ose tagret e atij që fabrikon ose ka fabrikuar produktet, që ofron ato ose të atij që kryen shërbim, që drejton, mbikëqyr ose ndihmon në këto veprimtari;
- gj) krahason me produkte dhe shërbime të tjera.

Neni 636

Personi që ka vepruar në mënyrë të paligjshme sipas dispozitës së sipërme, është përgjegjës për dëmin e shkaktuar, përveç kur provon se nuk ka faj për ardhjen e tij.

Neni 637

Kur publikimi mashtrues, i parashikuar prej nenit 635 të këtij Kodi, i ka shkaktuar ose rrezikon t'i shkaktojë dëm një tjetri, me kërkesën e tij, gjykata urdhëron ndalimin e menjëhershëm të tij dhe detyrimin e personit përgjegjës për të kryer një përgënjeshttrim publik, në mënyrën që gjykata do ta gjejë të përshtatshme.

C. Konkurrenca e pandershme

Neni 638

Në varësi të dispozitave që kanë lidhje me mbrojtjen e shenjave dalluese dhe të drejtave të patentës, veprimet e konkurrencës së pandershme kryhen prej cilitdo që:

1. përdor emrat ose shenjat dalluese të cilat mund të sjellin ngatërresë me emrat dhe shenjat dalluese të përdorura ligjërisht nga të tjerë, ose imiton produktet e një konkurrenti ose kryen veprime të cilat mund të sjellin ngatërresa me produktet dhe veprimtarinë e një konkurrenti;
2. trajton si të vetat cilësitë e produkteve ose të ndërmarrjes së konkurrentit;
3. përdor vetë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi çdo mjet tjetër që nuk përputhet me parimet e ndershmërisë profesionale dhe mund të dëmtojë veprimtarinë e tjetrit.

Neni 639

Vendimi që vërteton veprime të konkurrencës së pandershme ndalon vazhdimin e tyre dhe përcakton masat e nevojshme me qëllim që të zhduken pasojat.

Në qoftë se këto veprime janë kryer me faj, personi që i ka kryer detyrohet të shpërblejë dëmin.

KREU III SHPËRBLIMI I DËMIT

Neni 640

Dëmi pasuror që shpërblehet përbëhet nga humbja e pësuar dhe fitimi i munguar.

Shpërblehen gjithashtu shpenzimet e kryera në mënyrë të arsyeshme për të shmangur ose pakësuar dëmin, ato që kanë qenë të nevojshme për të përcaktuar përgjegjësinë dhe masën e dëmit, si dhe shpenzimet e arsyeshme të kryera për të siguruar shpërblimin në rrugë jashtëgjyqësore.

Neni 641

Personi që i ka shkaktuar tjetrit një dëm në shëndetin e tij, detyrohet ta shpërblejë dëmin, duke patur parasysh humbjen ose pakësimin e aftësisë për punë të të dëmtuarit, shpenzimet që janë bërë për mjekimin e tij, si dhe shpenzime të tjera që kanë lidhje me dëmin e shkaktuar.

Neni 642

Masa e shpërblimit të dëmit mund të ndryshojë në të ardhmen, në varësi të përmirësimit apo rëndimit të shëndetit ose të shtimit apo pakësimit të aftësisë për punë të të dëmtuarit, në krahasim me kohën e caktimit të shpërblimit dhe të ndryshimeve që mund të ketë pësuar paga e të dëmtuarit.

Neni 643

Kur është shkaktuar vdekja e një personi, dëmi që duhet të shpërblejë përbëhet nga:

a) shpenzimet për ushqim e jetesë të fëmijëve të tij të mitur, të bashkëshortes dhe prindërve të paaftë për punë që kanë qenë në ngarkim të të vdekurit, plotësisht ose pjesërisht, si dhe të personave që banonin në familjen e të vdekurit dhe që gëzonin prej tij të drejtën e ushqimit;

b) shpenzimet e duhura për varrimin e të vdekurit, në masën që ato i përgjigjen rrethanave personale e familjare të të vdekurit.

Personi që ka shkaktuar dëmin mund të kundrejtojë të njëjtat mjete mbrojtëse që do t'i kundrejtonte të vdekurit.

Gjykata, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes, mund të vendosë që shpërblimi të jepet në natyrë, ose në para, njëherësh ose me këste.

Neni 644

Kur personi që ka kryer veprimin apo mosveprimin e paligjshëm krahas dëmit të shkaktuar, ka patur edhe një përfitim të dukshëm, gjykata me kërkesën e palës së dëmtuar duke pasur parasysh

natyrën e dëmit, shkallën e fajësisë e rrethana të tjera të çështjes mund të llogarisë në shpërblimin e dëmit, tërësisht apo pjesërisht përfitimin.

Neni 645

Kur shkaktohet vdekja ose dëmtimi i shëndetit të një personi që fiton nga sigurimet shoqërore, dëmi shpërblehet në mënyrën e caktuar me ligj.

Neni 646

Për një person që nuk ka qenë në marrëdhënie pune ose nuk ka qenë i siguruar, masa e shpërblimit të dëmit të rrjedhur nga vdekja ose dëmtimi i shëndetit, caktohet nga gjykata në bazë të pagës që merr një punonjës i asaj kategorie me të cilën mund të barazohet edhe puna që kryente ose mund të kryente i dëmtuari.

Neni 647

I mituri i dëmtuar, kur mbush moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe nuk ka pagë nga puna e tij, ka të drejtë që në vend të shpërblimit që merr për jetesë, të kërkojë të shpërblehet për humbjen e aftësisë së tij për punë me pagën mesatare të një punonjësi, sipas kriterëve të nenit 646 të këtij Kodi.

Me mbushjen e moshës tetëmbëdhjetë vjeç ka të drejtë që në vend të shpërblimit që merr, të kërkojë të shpërblehet me pagën mesatare të një punëtori të asaj kategorie që do të kishte fituar ose duhej të kishte fituar po të mos ishte shkaktuar dëmtimi i shëndetit.

Neni 647/a

Mënyra dhe kriteret e caktimit të përgjegjësisë civile dhe të masës së dëmit jopasuror

(Shtuar me ligjin nr. 17/2012, datë 16.2.2012)

Shpërblimi i dëmit jopasuror për cenimin e nderit, personalitetit ose reputacionit të personit, synon rivendosjen e të drejtës së shkelur, në mënyrë proporcionale me dëmin e pësuar dhe caktohet në bazë të rrethanave të çështjes. Për përcaktimin e përgjegjësisë civile dhe masës së dëmit jopasuror, gjykata mban parasysh edhe:

- a) mënyrën, formën dhe kohën e përhapjes së thënieve apo kryerjes së veprimeve;
- b) shkallën e respektimit të rregullave të etikës profesionale nga autori i thënieve;
- c) format dhe shkallën e fajësisë;
- ç) faktin nëse thëniet kanë cituar apo referuar në mënyrë të saktë thëniet e një personi të tretë;
- d) faktin nëse thëniet janë të rreme, veçanërisht në rastin e cenimit të reputacionit;
- dh) faktin nëse thëniet kanë të bëjnë me çështje të jetës private të personit të dëmtuar dhe raportin e tyre me një interes publik;
- e) faktin nëse thëniet përbëjnë opinione ose thënie që përmbajnë vetëm pasaktësi faktike të parëndësishme;
- ë) faktin nëse thëniet kanë lidhje me çështje me interes publik, ose me persona në funksione shtetërore a kandidatë për zgjedhje;

f) kryerjen e veprimeve për të parandaluar apo ulur masën e dëmit të tilla si bërja e përgënjeshtimit për thënien e rreme, si dhe çdo masë tjetër të marrë nga autori i thënieve për vënien në vend të nderit, personalitetit ose reputacionit të personit të dëmtuar;

g) faktin nëse autori i thënieve të rreme ka nxjerrë përfitime nga përhapja e tyre, si dhe masën e këtij përfitimi;

gj) faktin nëse dëmshpërblimi mund të rëndojë ndjeshëm gjendjen financiare të shkaktuesit të dëmit.

TITULLI V GJERIMI I PUNËVE TË TË TJERËVE

Neni 648

Personi që, pa qenë i detyruar, merr përsipër me ndërgjegje dhe për një qëllim të arsyeshëm gjerimin e punëve ose interesave të tjetrit, është i detyruar ta vazhdojë atë derisa personi i interesuar të jetë në gjendje të kujdeset vetë.

Neni 649

Personi i interesuar duhet të përmbushë detyrimet që gjeruesi ka marrë përsipër në emër të tij, të përjashtojë gjeruesin nga detyrimet që ka marrë në emër të vet dhe t'i paguajë atij shpenzimet e nevojshme e të dobishme që nga dita që janë bërë dhe, kur është rasti, t'i shpërblejë edhe dëmin që mund të ketë pësuar si rrjedhim i gjerimit, por me kusht që veprimet e kryera nga gjeruesi, të mos kenë qenë ndaluar nga personi i interesuar.

Kur gjeruesit, përveç gjerimit të punëve, i është dashur për këtë qëllim të ushtrojë një profesion, ka të drejtë të shpërblehet në përputhje me çmimet ose tarifatat e caktuara për aktivitete të tilla.

Neni 650

Gjeruesi ka të drejtë të kryejë veprime juridike në emër të personit të interesuar, në masën që interesi i këtij të fundi plotësohet në mënyrë të përshtatshme.

Neni 651

Gjeruesi u nënshtrohet detyrimeve të njëjta që rrjedhin nga një kontratë porosie.

Gjykata, duke marrë parasysh rrethanat të cilat kanë ndikuar tek gjeruesi për të marrë përsipër gjerimin, mund të pakësojë dëmshpërblimin për dëmin që është shkaktuar për faj të tij.

Neni 652

Personi i interesuar, me anë miratimi të veprimtarisë të gjeruesit, mund të tërheqë të drejtën e tij për të kërkuar dëmshpërblim nga gjeruesi, sipas dispozitës së mësipërme. Për këtë qëllim personit të interesuar duhet t'i jepet një afat i arsyeshëm.

TITULLI VI PAGIMI I PADETYRUAR

Neni 653

Cilido që ka bërë një pagim të padetyruar, ka të drejtë të kërkojë kthimin e asaj që ka paguar, si dhe të gëzojë frytet dhe kamatat nga dita e pagimit, nëse personi që ka marrë pagesën është në keqbesim, dhe nga dita e kërkesës për kthim, kur personi është në mirëbesim.

Neni 654

Personit që ka paguar detyrimin e një tjetri duke besuar se ishte debitor, në bazë të një lajthitjeje të kryer pa faj, mund t'i kthehet ajo që ka paguar, me kusht që kreditori të mos jetë privuar në mirëbesim prej titullit dhe garancive të kredisë.

Kthimi i pagesës duhet të shoqërohet me frytet dhe kamatat, në kushtet e parashikuara në dispozitat e mësipërme.

TITULLI VII BEGATIMI PA SHKAK

Neni 655

Personi që, pa shkak të ligjshëm, ka fituar ose ka kursyer diçka në dëm të një personi tjetër, detyrohet të shpërblejë këtë të fundit për humbjet pasurore që ka pësuar, brenda caqeve të begatimit.

Neni 656

Kur begatimi pa ndonjë shkak të ligjshëm ka për objekt një send të caktuar, personi që e ka marrë atë, duhet ta kthejë në natyrë, së bashku me të ardhurat që ka nxjerrë ose duhet të nxirrte dhe ka të drejtë të kërkojë pagimin e shpenzimeve që ka bërë, sipas dispozitave për kërkimin e sendit nga poseduesi i paligjshëm.

Neni 657

Nuk mund të kërkohet kthimi i asaj që personi ka dhënë vullnetarisht për ekzekutimin e një detyrimi, i cili, megjithëse i pakërkueshëm, nuk është i pavlefshëm.

Neni 658

Padia për begatimin pa shkak nuk mund të ngrihet kur i dëmtuari mund të ngrejë një tjetër padi për të kërkuar shpërblimin e dëmit të pësuar.

PJESA V
KONTRATAT

TITULLI I
KONTRATAT NË PËRGJITHËSI

KREU I
DISPOZITA PARAPRAKE

Përmbajtja e kontratës
Neni 659

Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike.

Neni 660

Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi.

Kontrata me detyrime të njëanshme e të dyanshme
Neni 661

Kontrata është me detyrim të njëanshëm, kur njëra palë merr përsipër detyrime ndaj palës tjetër pa patur kjo e fundit ndonjë detyrim ndaj saj.

Neni 662

Kontrata është me detyrime të dyanshme, kur palët detyrohen reciprokisht ndaj njëra-tjetrës.

**Konditat e nevojshme për lidhjen
dhe vlefshmërinë e kontratës**
Neni 663

Konditat e nevojshme për qenien e kontratës janë: pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin, shkaku i ligjshëm në të cilin mbështetet detyrimi, objekti që formon lëndën e kontratës dhe forma e saj e kërkuar nga ligji.

Lidhja e kontratës
Neni 664

Kur kontrata përmban vetëm detyrimin e propozuesit, pritësi mund ta refuzojë propozimin brenda afatit të caktuar, ose që rrjedh nga natyra e marrëveshjes. Në mungesë të një refuzimi të tillë, kontrata quhet e lidhur.

Neni 665

Personi që propozon përfundimin e një kontrate është i lidhur me propozimin, përveç kur kjo lidhje është përjashtuar. Kur propozimi refuzohet ose nuk pranohet në afatin e caktuar, quhet i rënë.

Kur nuk është caktuar afat, propozuesi është i lidhur me propozimin e bërë, gjer në kohën që zakonisht apo sipas rrethanave, është e nevojshme që këtij t'i arrijë përgjigja e palës tjetër.

Neni 666

Propozimi për të lidhur një kontratë, që i bëhet një personi të pranishëm, pa iu caktuar një afat për pranimin, e humbet fuqinë e tij, në qoftë se personi i pranishëm nuk e pranon propozimin menjëherë.

Neni 667

Kur propozuesi ka caktuar një afat për pranimin, është e nevojshme që përgjigja të vijë brenda afatit.

Propozuesi mund ta quajë të vlefshëm pranimin e vonuar, por duhet të njoftojë menjëherë palën tjetër.

Kur pranimi është dërguar në kohë, por i ka mbërritur propozuesit me vonesë dhe ky nuk dëshiron të jetë i lidhur me atë, duhet të njoftojë në çast pranuesin.

Neni 668

Propozimi për të lidhur një kontratë e humbet fuqinë e tij, në qoftë se propozuesi njofton palën tjetër, para se asaj t'i ketë arritur propozimi, se e ka tërhequr atë.

Ky rregull vlen edhe për tërheqjen e pranimin nga pala tjetër.

Neni 669

Kur me kërkesën e propozuesit, ose duke marrë parasysh natyrën e marrëveshjes e rrethanat që kanë lidhje me atë, rezultojnë që nuk ish e nevojshme pritja e pranimin të shprehur të propozimit, ose detyrimi do të kryhej pa marrë një përgjigje paraprake, kontrata quhet e lidhur, në kohën e në vendin ku ka filluar zbatimi i saj.

Pala që zbaton detyrimin duhet të njoftojë menjëherë palën tjetër për fillimin e ekzekutimit të kontratës, përndryshe detyrohet të shpërblejë dëmin.

Neni 670

Pranimi i propozimit që nuk përputhet me përmbajtjen e tij, quhet mospranim dhe njëkohësisht si një propozim i ri.

Neni 671

Oferta vlen si propozim, kur përmban elementet thelbësore të kontratës, që kërkohet të përfundohet, përveç kur rezultojnë ndryshe nga rrethanat e çështjes.

Neni 672

Pala kontraktuese mund të heqë dorë nga kontrata, brenda shtatë ditëve nga përfundimi i saj, pa treguar arsyet, kur:

- kontrata është përfunduar në vendin e punës ose të banimit të njëres palë, gjatë një eskursionit të organizuar në një mjedis publik, ose në kushte të tilla, që nuk i korrespondojnë një situatë normale bisedimesh;

- në kontratën që ka për objekt dhënien e një kredie për të blerë një send konsumi, shitësi duhet të njoftojë me shkrim blerësin për të drejtën e heqjes dorë nga kontrata e lidhur në kushtet e sipërme, për ndryshe afati i heqjes dorë është një vit.

Neni 673

Një ndërmarrje që zë një pozitë dominuese në treg, është e detyruar të kontraktojë me cilindo që kërkon një detyrim, i cili bën pjesë në objektin e veprimtarisë së saj, në përputhje me ligjet e zakonet e mira tregtare.

Përfundimi i një kontrate, nuk mund të refuzohet pa një arsye të ligjshme.

Neni 674

Palët gjatë zhvillimit të bisedimeve për hartimin e kontratës, duhet të sillen me mirëbesim ndaj njëra-tjetrës.

Pala që ka ditur, ose që duhej të dinte shkakun e pavlefshmërisë së kontratës dhe nuk ia ka bërë të ditur atë palës tjetër, detyrohet të shpërblejë dëmin që kjo e fundit ka pësuar, për shkak se besoi pa fajin e vet në vlefshmërinë e kontratës.

Neni 675

Në rast se një palë kontraktuese disponon njohuri profesionale dhe pala tjetër i ngjall asaj besim të plotë, e para ka detyrim t'i japë asaj me mirëbesim, informata e udhëzime.

Neni 676

Kontrata quhet e lidhur kur palët kanë shfaqur në mënyrë të ndërsjellë vullnetin e tyre, duke u marrë vesh për të gjitha kushtet thelbësore të saj.

Shfaqja e vullnetit mund të jetë e shprehur ose në mënyrë heshtësore.

Shkaku i paligjshëm

Neni 677

Në një kontratë, shkaku ligjor është i paligjshëm kur vjen në kundërshtim me ligjin, rendin publik, ose kur kontrata bëhet mjet për të shmangur zbatimin e një norme.

Objekti i kontratës

Neni 678

Objekti i kontratës duhet të jetë i mundshëm, i ligjshëm, i caktueshëm ose që mund të përcaktohet.

Neni 679

Kontrata e bërë me kusht pezullues ose me afat, është e vlefshme në rast se detyrimi, që fillimisht është i pamundur, bëhet i mundshëm përpara përmbushjes së kushtit ose mbarimit të afatit.

Neni 680

Kontrata mund të përmbajë kryerjen e veprimeve për sende në të ardhmen, përveç kur ndalohet shprehimisht nga ligji.

KREU II INTERPRETIMI I KONTRATËS

Neni 681

Kur interpretohet një kontratë, duhet të sqarohet se cili ka qenë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para e pas përfundimit të kontratës.

Neni 682

Kushtet e kontratës interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e aktit.

Kontrata duhet të interpretohet në mirëbesim nga palët.

Neni 683

Në rast dyshimi, kontrata ose kushtet e saja interpretohen në kuptimin në të cilin mund të ketë ndonjë efekt dhe jo në atë, sipas të cilit nuk do të kishte ndonjë efekt.

Neni 684

Kushtet e kontratës, që mund të merren me dy kuptime, interpretohen sipas praktikës së vendit ku është përfunduar kontrata.

Kur njëra nga palët është sipërmarrëse, kushtet me dy kuptime interpretohen sipas praktikës së vendit ku ndodhet selia e ndërmarrjes.

Neni 685

Fjalët dhe shprehjet që mund të kenë dy kuptime, duhet të merren në kuptimin më të përshtatshëm me natyrën e kontratës.

Kushtet e përgjithshme

Neni 686

Kushtet e përgjithshme të kontratës, të përgatitura prej njëres palë kontraktuese, kanë efekt ndaj palës tjetër, në qoftë se në momentin e përfundimit të kontratës kjo e fundit i ka njohur ose duhej t'i kishte njohur, duke treguar një përkujdesje të zakonshme.

Janë të pavlefshme kushtet e përgjithshme që sjellin një humbje ose dëmtim të shpërpjesëtuat të interesave të palës kontraktuese, posaçërisht kur ato ndryshojnë në mënyrë thelbësore nga parimet e barazisë e të paanësisë të shprehura në dispozitat e këtij Kodi që rregullojnë marrëdhëniet kontraktuale.

Nuk krijojnë efekte juridike ato kushte të cilat vendosin në dobi të atij që i ka përgatitur ato më përpara, kufizime për përgjegjësinë, mundësinë për t'u tërhequr nga kontrata, për të pezulluar zbatimin e saj, ose që caktojnë ndaj palës tjetër afate dekadence, ose kufizime ndaj së drejtës për të bërë propësime, ndaj lirisë kontraktore, në marrëdhënie me të tretët, kushteve të arbitrazhit ose shmangies nga kompetencat e organeve gjyqësore, përveç kur janë miratuar veçmas me shkrim nga pala tjetër.

Neni 687

Në kontratat e përfunduara duke nënshkruar modularë ose formularë, që synojnë të disiplinojnë në mënyrë uniforme marrëdhënie kontraktore të caktuara, kushtet e shtuara tek këta modularë ose formularë kanë përparësi ndaj kushteve fillestare të modularëve e formularëve të sipërpërmendur, sa kohë që nuk përputhen me ato, edhe pse nuk kanë qenë shfuqizuar.

Neni 688

Në çdo rast, kushtet e përfshira në kushtet e përgjithshme të kontratës apo në modularë e formularë, që kanë qenë dhënë prej njëres nga palët kontraktuese, kur ka dyshim, interpretohet në dobi të palës tjetër.

Neni 689

Kur, me gjithë zbatimin e normave të parashikuara në këtë kre, kontrata mbetet e errët, kjo duhet të merret në kuptimin më pak të rënduar për të detyruarin, po qe se është pa shpërblim, dhe në kuptimin që realizon përputhjen e interesave të palëve në mënyrë të paanshme, po qe se është me shpërblim.

KREU III EFEKTET E KONTRATAVE

Neni 690

Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të prishet ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj.

Neni 691

Kontrata ka efekt ndaj të tretëve në rastet e parashikuara me ligj.

Neni 692

Efektet juridike të kontratës shtrihen edhe tek trashëgimtarët me titull universal, përveç kur në kontratë është parashikuar ndryshe.

Neni 693

Kontrata detyron palët jo vetëm përsa është parashikuar në atë, por edhe për të gjitha pasojat që rrjedhin nga zbatimi i ligjit.

Kontrata në dobi të një të treti

Neni 694

Kontrata në dobi të një personi të tretë është e vlefshme kur personi që e lidh ka interes për atë.

Personi që ka pranuar premtimin në dobi të të tredit ose ky i fundit, apo personat që heqin të drejta prej tij, kanë të drejtë të kërkojnë zbatimin e kontratës, përveç kur ka marrëveshje tjetër.

Kontrata nuk mund të priset ose të ndryshohet pas momentit që personi i tretë ka deklaruar se pranon të përfitojë nga lidhja e saj, përveç kur propozuesi e ka rezervuar këtë të drejtë.

Në rast revokimi të lidhjes së kontratës, ose të refuzimit të personit të tretë për të përfituar prej saj, detyrimi mbetet në dobi të propozuesit, përveç kur rezulton ndryshe nga vullneti i palëve ose nga natyra e kontratës.

Neni 695

Pala që ka bërë premtimin në dobi të personit të tretë, mund t'i kundrejtojë këtij prapësimet që rrjedhin nga kontrata, por jo ato që rrjedhin nga marrëdhëniet me palën tjetër.

E drejta për t'u tërhequr nga kontrata

Neni 696

Në rast se njëres nga palët i është dhënë e drejta për t'u tërhequr nga kontrata, kjo e drejtë mund të ushtrohet për sa kohë që kontrata nuk ka filluar të zbatohet.

Në kontratat me zbatim të vazhdueshëm ose periodik, kjo e drejtë mund të ushtrohet edhe më tej, por tërheqja nuk ka efekte për ekzekutimet e kryera ose që janë në kryerje e sipër.

Kur në kontratë është parashikuar pagimi i një kompensimi për tërheqjen, kjo ka efekt kur është kryer pagimi, përveç kur ka marrëveshje të kundërt.

Premtimi për kryerjen e një detyrimi

Neni 697

Personi që i ka premtuar një tjetri se një person i tretë do të ekzekutojë një detyrim, ose do të kryejë një veprim në dobi të tij, është i detyruar të shpërblejë palën tjetër, në qoftë se personi i tretë nuk pranon të ekzekutojë detyrimin ose të kryejë veprimin e premtuar.

Zgjidhja e kontratës

Neni 698

Në kontrata me detyrime të ndërsjella, kur njëra nga palët kontraktuese nuk përmbush detyrimet e veta, pala tjetër kontraktuese, sipas rastit, mund të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ose zgjidhjen e kontratës, përveç shpërblimit të dëmit.

Neni 699

Kontrata nuk mund të zgjidhet në qoftë se mospërmbushja e detyrimit prej njëres nga palët ka rëndësi të pakët për interesat e palës tjetër.

Neni 700

Pala kontraktuese mund të njoftojë me shkrim palën tjetër që nuk ka përmbushur detyrimin, që ta përmbushë atë në një afat të përshtatshëm, duke deklaruar se, po qe se pas këtij afati kontrata nuk ekzekutohet, ajo do të quhet patjetër e zgjidhur.

Neni 701

Në qoftë se afati i caktuar për kryerjen e detyrimit të njëres nga palët duhet quajtur thelbësor për interesin e palës tjetër, kjo e fundit kur dëshiron të kërkojë zbatimin pavarësisht nga mbarimi i afatit, duhet t'i bëjë njoftimin palës tjetër brenda tri ditëve, përveç marrëveshjes së kundërt.

Neni 702

Palët mund të parashikojnë në kontratë që ajo të zgjidhet kur një detyrim i caktuar nuk përmbushet sipas kushteve të parashikuara.

Në këtë rast kontrata zgjidhet kur pala e interesuar i deklaron palës tjetër se do të përdorë kushtin e zgjidhjes së kontratës.

Neni 703

Zgjidhja e kontratës për mospërmbushje të detyrimeve ka efekt prapaveprues midis palëve, përveç kontratave me ekzekutim të vazhduar ose periodik për të cilat efekti i zgjidhjes nuk shtrihet në veprimet e kryera më parë.

Zgjidhja e kontratës, qoftë edhe me marrëveshje të palëve, nuk paragjykon të drejtat e fituara nga të tretët, me përjashtim të efekteve të regjistrimit të kërkesës për zgjidhjen e kontratës.

Neni 704

Për zgjidhjen e kontratës zbatohen edhe dispozitat e pjesës së përgjithshme të detyrimeve përveç dispozitave që rregullojnë kontratat e veçanta.

TITULLI II KONTRATAT E VEÇANTA

KREU I SHITJA DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 705

Kontrata e shitjes ka për objekt kalimin e pronësisë së një sendi ose kalimin e një të drejte kundrejt pagimit të një çmimi.

Neni 706

Në shitjen që ka për objekt fitimin në të ardhmen të një sendi ose të një të drejte, fitimi i pronësisë bëhet sapo sendi ose e drejta pranohet se ekzistojnë.

Përveç kur palët kanë dashur të përfundojnë një kontratë me kusht pezullues, shitja është e paefektshme në qoftë se sendi nuk pranohet se ekziston.

Neni 707

Në qoftë se palët nuk e kanë caktuar çmimin, as nuk janë marrë vesh për mënyrën e caktimit të tij, në mungesë të ndonjë akti të organeve kompetente publike, prezumohet se palët kanë dashur t'i referohen çmimit të zbatuar normalisht nga shitësi në kohën e lidhjes së kontratës.

Kur është fjala për sende që kanë çmim burse apo tregu, çmimi caktohet në bazë të listave të tregut të vendit ku do të bëhet dorëzimi, ose nga ato të vendit që është më afër tij.

Në qoftë se çmimi është caktuar mbi bazën e peshës së sendeve, në rast dyshimi ai duhet të caktohet në bazë të peshës neto.

Palët mund t'ia besojnë caktimin e çmimit një të treti, të emëruar në kontratë ose që mund të emërohet më vonë.

Neni 708

Shpenzimet e kontratës së shitjes dhe shpenzimet e tjera të lidhura me të, janë në ngarkim të blerësit, përveç kur në marrëveshje parashikohet ndryshe.

Ndalime të veçanta të blerjes

Neni 709

Nuk mund të blejnë drejtpërdrejt, me anë të një tjetri, ose në ankand:

a) personat që administrojnë ose ruajnë sende të huaja në bazë të ligjit ose të emërimit nga shteti, sendet që administrojnë ose ruajnë;

b) personat zyrtarë që janë të ngarkuar të bëjnë shitje me ekzekutim të detyrueshëm, sendet që këta shesin;

c) gjyqtarët, prokurorët, përmbaruesit, noterët dhe avokatët, sendet për të cilat ka grindje përpara gjykatës në të cilën bëjnë pjesë ose ushtrojnë funksionet e tyre, përveç kur këta janë bashkëpronarë mbi ato.

Detyrime të shitësit në shitjen e pasurisë së luajtshme

Neni 710

Detyrimet kryesore të shitësit janë:

1. t'i dorëzojë sendin blerësit;
2. kur fitimi i pronësisë mbi sendin, ose i të drejtave reale mbi të, nuk është pasojë e menjëhershme e kontratës, duhet të dorëzojë të gjitha dokumentet përkatëse për fitimin e pronësisë së tyre, sipas kushteve të parashikuara nga kontrata apo nga ligji;
3. të garantojë blerësin nga zhveshja, nga veset dhe nga mospërputhja e cilësive të sendit me kontratën.

Neni 711

Sendet dorëzohen në gjendjen në të cilën ndodhen në momentin e përfundimit të kontratës. Sendet duhet të dorëzohen së bashku me aksesorët, shtesat dhe frytet që nga dita e përfundimit të kontratës, përveç kur palët kanë parashikuar ndryshe në kontratë.

Në qoftë se shitësi nuk është i detyruar të dorëzojë sendet në një vend tjetër të caktuar, ai i shlyen detyrimet e dorëzimit duke ia dhënë sendet transportuesit të parë për t'ia kaluar blerësit, kur kontrata e shitjes përfshin transportin e sendeve.

Në rast se kontrata nuk përfshin transportin e sendeve dhe u referohet sendeve të caktuara individualisht, ose në lloj apo sasi, që duhen tërhequr nga një sasi e caktuar ose që duhet të fabrikohen ose të prodhohen dhe në qoftë se në momentin e përfundimit të kontratës, palët e dinin që sendet ndodheshin ose duhet të fabrikoheshin apo të prodhoheshin në një vend të caktuar, shitësi detyrohet t'i verë sendet në dispozicion të blerësit në atë vend.

Në rastet e tjera, shitësi është i detyruar që t'i verë sendet në dispozicion të blerësit, në vendin ku sendet ndodheshin në kohën e shitjes ose, kur një vend i tillë nuk mund të përcaktohet, në vendin ku shitësi kishte banimin e tij ose qendrën e veprimtarisë së vet.

Neni 712

Shitësi duhet të dorëzojë sendet:

1. në datën e caktuar në kontratë ose që është e përcaktueshme në bazë të kontratës;
2. në çdo moment të periudhës së kohës që është caktuar ose që është e caktueshme sipas kontratës, përveç kur del nga rrethanat se i është lënë blerësit të zgjedhë datën;
3. në çdo rast tjetër brenda një afati të arsyeshëm që nga përfundimi i kontratës.

Neni 713

Kur shitësi detyrohet të lëshojë dokumentet lidhur me sendet, ato lëshohen në kohën, në vendin dhe në formën e parashikuar në kontratë. Në qoftë se dokumentet i ka lëshuar përpara këtij momenti, ai mund të rregullojë çdo defekt të tyre deri në momentin e parashikuar për lëshimin e tyre, në qoftë se ushtrimi i një të drejte të tillë nuk i sjell blerësit shqetësime ose një shpenzim të paarsyeshëm. Në këto raste ai ruan të drejtën të kërkojë shpërblimin e dëmit.

Neni 714

Në shitjen me dokumente, shitësi shkarkohet nga detyrimi i dorëzimit të sendeve të shitura, duke i dhënë blerësit dokumentin e shitjes dhe dokumentet e tjera të caktuara në kontratë ose në ligj.

Neni 715

Shitësi duhet të dorëzojë sendet në cilësinë, sasinë dhe llojin e kërkuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe të ambalazhuara në mënyrën e caktuar në kontratë.

Quhet se sendet nuk janë në përputhje me kontratën po qe se nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm, të përcaktuar nga kontrata, përveç kur ka marrëveshje të kundërt. Kur një përcaktim i tillë nuk është i mundur, sendet quhet se nuk janë në përputhje me kontratën, në qoftë se nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sende të njëjtit lloj. Në qoftë se shitja është bërë mbi bazën e një modeli ose kampioni, shitësi duhet të dorëzojë sende që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose të kampionit.

Në qoftë se kontrata nuk përmend rregullat e vendosjes apo të ambalazhimit të sendeve, quhet se këto sende nuk janë në përputhje me kontratën po qe se nuk janë të vendosura ose të ambalazhuara sipas mënyrës së zakonshme për sende të njëjtit lloj ose, në mungesë të një mënyre të tillë të zakonshme, në një mënyrë që të jetë e përshtatshme për të ruajtur dhe për të mbrojtur sendet.

Shitësi nuk është përgjegjës për të metat e sendeve të cilat, në momentin e përfundimit të kontratës, blerësi i dinte ose për të cilat nuk ka marrë dijeni për fajin e vet, përveç kur të metat kanë të bëjnë me cilësinë që sendet duhet të kishin patur sipas kontratës ose sipas njoftimit të shitësit.

Neni 716

Shitësi është përgjegjës për çdo mangësi ose mospërputhje që ekzistonte në momentin e kalimit të rrezikut tek blerësi, edhe kur e meta shfaqet pas këtij momenti.

Shitësi është përgjegjës edhe për mospërputhjen që vërtetohet pas momentit të treguar në paragrafin e mësipërm e që vjen nga mospërmbushja e një detyrimi çfarëdo të tij, duke përfshirë edhe garancinë sipas së cilës, për një periudhë të caktuar kohe sendet do të mbeten të përshtatshme për përdorimin e tyre normal ose për ndonjë përdorim të posaçëm, ose do të ruajnë cilësinë dhe karakteristikat e caktuara.

Neni 717

Blerësi e humb të drejtën për të kundërshtuar për të metat e sendit, në qoftë se nuk denoncon tek shitësi, duke specifikuar natyrën e tyre, brenda dhjetë ditëve nga zbulimi, përveç kur palët ose ligji kanë caktuar një afat tjetër.

Në çdo rast blerësi e humb të drejtën për të kundërshtuar për të metat e sendit në qoftë se nuk e ushtron këtë të drejtë brenda dy vjetëve nga data kur sendet i janë dorëzuar atij, po qe se ky afat nuk është në kundërshtim me kohëzgjatjen e një garancie kontraktore.

Neni 718

Shitësi nuk mund të përfitojë nga rregullat e parashikuara në nenin e mësipërm, në qoftë se të metat kanë të bëjnë me fakte për të cilat ka dijeni ose që nuk mund të mos i dinte dhe nuk ia ka bërë të ditur blerësit.

Neni 719

Shitësi duhet të dorëzojë sendet, të shkarkuara nga çdo e drejtë apo pretendim i të tretëve, përveç kur në kontratë është parashikuar ndryshe.

Neni 720

Blerësi duhet t'i bëjë të ditur shitësit të drejtat apo pretendimin e të tretëve mbi sendin duke specifikuar natyrën e tyre, brenda një afati të arsyeshëm nga momenti kur ka marrë dijeni ose duhej të merrte dijeni për to, ndryshe humb të drejtat e parashikuara nga neni i mësipërm.

Shitësi gjithashtu nuk mund të përdorë dispozitat e paragrafit të mësipërm po qe se ishte në dijeni të të drejtave apo të pretendimeve të të tretëve, apo të natyrës së tyre.

Neni 721

Blerësi mund të pezullojë pagimin e çmimit kur ka arsye të druhet se sendi ose një pjesë e tij mund të rivendikohen nga të tretë, përveç kur shitësi jep garancinë përkatëse.

Pagesa nuk mund të pezullohet në qoftë se rreziku njihet nga blerësi në momentin e shitjes.

Neni 722

Në rastin kur dorëzimi i sendeve me të meta përbën një mospërmbushje të rëndësishme të detyrimeve kontraktore, blerësi ka të drejtë të kërkojë:

1. në momentin e denoncimit, të parashikuar në nenin 717 të këtij Kodi ose brenda një periudhe kohe të arsyeshme nga ai denoncim, dorëzimin e sendeve si shtesë apo zëvendësim;

2. eliminimin e të metave me anë të ndreqjes, kur kjo është e arsyeshme të merret parasysh në gjithë rrethanat konkrete. Kërkesa për ndreqjen duhet të bëhet në momentin e denoncimit të parashikuar në nenin 717 apo brenda një periudhe kohe të arsyeshme nga ky denoncim;

3. të kërkojë uljen e çmimit;

4. të deklarojë zgjidhjen e kontratës.

Blerësi mund t'i caktojë shitësit një afat të arsyeshëm për përmbushjen e këtyre detyrimeve. Në varësi të afatit blerësi nuk mund të përdorë asnjë mjet juridik për mospërmbushjen, përveç kur është njoftuar nga shitësi se ky i fundit nuk do të përmbushë detyrimin në afatin e caktuar.

Në çdo rast blerësi nuk humb të drejtën të kërkojë shpërblimin e dëmit.

Neni 723

Kur dorëzimi i sendeve me të meta përbën një mospërmbushje të parëndësishme të kontratës, blerësi mund të kërkojë:

1. heqjen ose ndreqjen e të metave të sendeve të dorëzuara,

ose

2. uljen e çmimit.

Blerësi mund t'i caktojë shitësit një afat të arsyeshëm për përmbushjen e këtyre detyrimeve. Në varësi të afatit, blerësi nuk mund të shfrytëzojë asnjë mjet juridik për këtë mospërmbushje, përveç rastit kur është njoftuar nga shitësi se ky nuk do të përmbushë detyrimin në afatin e caktuar.

Kur shitësi nuk plotëson kërkesën e parashikuar në pikën 1 të këtij neni brenda afatit të caktuar nga blerësi, ky i fundit mund të kërkojë uljen e çmimit të sendeve të sipërme.

Në çdo rast blerësi nuk e humb të drejtën të kërkojë shpërblimin e dëmit.

Neni 724

Përveç zgjidhjes nga ligji të kontratës si rrjedhim i qenies të afatit si kusht thelbësor, kur nuk është bërë dorëzimi i sendit, blerësi mund ta deklarojë të zgjidhur kontratën në qoftë se shitësi nuk i dorëzon sendet brenda afatit shtesë të caktuar nga blerësi ose në qoftë se deklaron se nuk do të bëjë dorëzimin brenda këtij afati.

Neni 725

Në qoftë se shitësi i ka dorëzuar sendet, blerësi e humb të drejtën të shpallë të zgjidhur kontratën kur:

1. në rastin e dorëzimit të vonuar blerësi nuk ka kërkuar zgjidhjen e kontratës brenda një kohe të arsyeshme, por jo më shumë se 15 ditë nga momenti kur ka marrë dijeni se dorëzimi është kryer;

2. në rast mospërmbushje të ndryshme nga dorëzimi i vonuar, brenda një kohe të arsyeshme, por jo më shumë se 15 ditë:

a) nga momenti kur ka marrë dijeni ose duhej të kishte dijeni për mospërmbushje;

b) pas mbarimit të afatit shtesë eventualisht të caktuar prej tij sipas nenit 717 të këtij Kodi.

Neni 726

Në qoftë se shitësi dorëzon vetëm një pjesë të sendeve, apo në qoftë se vetëm një pjesë e sendeve të dorëzuara është në përputhje me kontratën, zbatohen nenet 717, 720 lidhur me pjesën që mungon ose nuk përputhet.

Blerësi mund të shpallë kontratën tërësisht të zgjidhur vetëm në qoftë se dorëzimi i pjesshëm ose jo në përputhje me kushtet e saj, përbën një mospërmbushje të rëndësisë së veçantë ose thelbësore.

Neni 727

Në rastin kur blerësit i është marrë sendi si pasojë e të drejtave që një i tretë ka paraqitur mbi të, shitësi është i detyruar të shpërblejë dëmin sipas nenit 744.

Në rastin kur blerësit i është marrë pjesërisht sendi dhe se në bazë të rrethanave ai nuk do të përfundonte kontratën, zbatohet paragrafi i mësipërm.

Neni 728

Blerësi, i paditur nga një i tretë që pretendon se ka të drejta mbi sendin e shitur, duhet ta thërasë shitësin në çështje. Kur nuk e bën këtë dhe në dëm të tij është dhënë një vendim i formës së prerë, humbet të drejtën e garancisë për evinksion në qoftë se shitësi provon se ekzistonin arsye të mjaftueshme për të refuzuar kërkesën.

Blerësi që ka njohur vullnetarisht të drejtën e të tretit, e humb të drejtën e garancisë për evinksion në qoftë se nuk provon se nuk ekzistonin arsye të mjaftueshme për të penguar marrjen e sendit.

Neni 729

Në qoftë se blerësi ka shmangur marrjen e sendit me anën e pagimit të një shume parash, shitësi mund të shkarkohet duke kthyer shumën e paguar, interesat e saj, si dhe të gjitha shpenzimet.

Detyrimet e blerësit në shitjen e pasurisë së luajtshme

Neni 730

Detyrimi i blerësit për të paguar çmimin përfshin marrjen e masave dhe respektimin e formaliteteve të kërkuara nga kontrata ose nga dispozita të veçanta për kryerjen e pagimit.

Neni 731

Në rast se blerësi nuk është i detyruar të paguajë çmimin në një vend tjetër të caktuar, ai duhet ta paguajë atë në vendbanimin ose qendrën zyrtare të shitësit ose, kur pagimi duhet të bëhet në kohën e dorëzimit të sendeve ose dokumenteve, në vendin e dorëzimit.

Neni 732

Në qoftë se blerësi nuk është i detyruar të paguajë çmimin në një moment tjetër të caktuar, ai duhet ta paguajë atë kur shitësi vë në dispozicion të tij sendet apo dokumentet që i përfaqësojnë. Në qoftë se kontrata përfshin transportin e sendeve, shitësi mund të kryejë spedicionin me kusht që sendet ose dokumentet, që i përfaqësojnë ata, t'i dorëzohen blerësit para pagimit të çmimit.

Neni 733

Blerësi duhet të paguajë çmimin në datën e caktuar ose të përcaktueshme në bazë të kontratës ose ligjit, pa qenë nevojë e kërkesës së shitësit.

Neni 734

Detyrimi i blerësit për marrjen në dorëzim është kryerja e çdo veprimi që mund të pritët prej tij në mënyrë të arsyeshme, për t'i lejuar shitësit të bëjë dorëzimin dhe blerësi të tërheqë sendet.

Neni 735

Në qoftë se në kontratë parashikohet se blerësi duhet të përcaktojë formën, madhësinë ose karakteristika të tjera të sendeve, dhe në qoftë se ky nuk e bën këtë përcaktim në datën e caktuar ose brenda një kohe të arsyeshme pas marrjes së kërkesës së shitësit, ky mund ta kryejë vetë këtë përcaktim në përputhje me kërkesat e blerësit, për të cilat mund të jetë në dijeni.

Në qoftë se shitësi e bën vetë përcaktimin, duhet të njoftojë blerësin për rregullat e këtij përcaktimi dhe të vendosë një afat të arsyeshëm brenda të cilit blerësi mund të kryejë një përcaktim tjetër. Në qoftë se pasi të ketë marrë këtë njoftim, blerësi nuk e përdor këtë mundësi brenda afatit të vendosur, përcaktimi i bërë nga shitësi është i detyrueshëm.

Neni 736

Shitësi mund t'i caktojë blerësit një afat shtesë të arsyeshëm për përmbushjen e detyrimeve të veta. Me përjashtim të rastit kur shitësi nuk ka marrë njoftim nga blerësi se ky nuk do ta përmbushë detyrimin brenda afatit të caktuar, gjatë kësaj periudhe, shitësi nuk mund të përdorë asnjë mjet ligjor për përmbushjen e detyrimeve. Gjithsesi shitësi nuk humbet të drejtën për të kërkuar shpërblimin e dëmit për vonesën në përmbushje.

Neni 737

Shitësi mund ta deklarojë kontratën të zgjidhur:

1. në qoftë se mospërmbushja nga ana e blerësit e një detyrimi që rrjedh nga kontrata ose nga ligji përbën një mospërmbushje me rëndësi të veçantë ose thelbësore;

2. në qoftë se blerësi nuk përmbush detyrimet e tij për të paguar çmimin ose për të marrë në dorëzim sendet në afatin shtesë të caktuar nga shitësi, ose deklaron se nuk do ta bëjë brenda këtij afati.

Në qoftë se blerësi ka paguar çmimin, shitësi humb të drejtën të shpallë kontratën të zgjidhur po qe se këtë nuk e kërkon:

1. në rastin e përmbushjes së vonuar të detyrimeve të blerësit, para se të marrë dijëni për ekzekutimin e detyrimit;

2. në rastin e një mospërmbushjeje tjetër të ndryshme nga mospërmbushja e vonuar, brenda një kohe të arsyeshme:

a) që nga momenti kur ka marrë dijëni ose duhet të kishte marrë dijëni për një mospërmbushje të tillë;

b) pas mbarimit të afatit shtesë të caktuar prej tij, ose pasi blerësi të ketë deklaruar se nuk do të përmbushë detyrimet e veta brenda këtij afati shtesë.

Neni 738

Përveç marrëveshjeve ose zakoneve tregtare të kundërta, në qoftë se sendet e shitura duhet të transportohen nga një vend në tjetrin, dhe shitësi nuk është i detyruar të bëjë dorëzimin në një vend të caktuar në kontratë, rreziku i kalon blerësit kur sendi i dorëzohet transportuesit të parë për t'ia dërguar blerësit, edhe sikur sendet të jenë të ngarkuara në mënyrë të paambalazhuar.

Në qoftë se shitësi detyrohet t'ia dorëzojë sendet transportuesit në një vend të caktuar në kontratë, rreziku kalon tek blerësi vetëm kur sendet i dorëzohen transportuesit në vendin e përmendur. Fakti që shitësi është i autorizuar të mbajë dokumentet përfaqësuese të sendeve, nuk ndikon në kalimin e rrezikut.

Neni 739

Në qoftë se shitësi ka kryer një mospërmbushje thelbësore të kontratës, dispozitat e nenit të mëparshëm nuk privojnë mjetet juridike që blerësi ka në dorë ndaj mospërmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Dispozita të përbashkëta për detyrimet e shitësit dhe të blerësit

Neni 740

Njëra palë mund të pezullojë përmbushjen e detyrimeve të veta në qoftë se, pas përfundimit të kontratës, del qartë se pala tjetër nuk do të përmbushë pjesën thelbësore të detyrimeve të saj si rrjedhim:

1. të një pamundësie të rëndë në aftësinë e vet për ta përmbushur ose në aftësinë e vet paguese;
2. të mënyrës në të cilën përgatitet për të filluar ose vazhduar zbatimin e kontratës.

Në qoftë se shitësi i ka shitur sendet, para se të shfaqeshin kushtet e përmendura në paragrafin e mësipërm, ai mund të kundërshtojë dorëzimin e sendeve blerësit edhe sikur ky të zotërojë një dokument që e legjitimon atë për t'i marrë.

Një kundërshtim i tillë ka efekt ekskluzivisht në marrëdhëniet midis blerësit dhe shitësit.

Pala që pezullon zbatimin duhet të njoftojë menjëherë palën tjetër dhe duhet të vazhdojë përmbushjen në qoftë se pala tjetër jep garanci të përshtatshme lidhur me përmbushjen e detyrimeve të saj.

Neni 741

Në rastin e një kontrate shitjeje me dorëzime të pjesshme, kur mospërmbushja nga ana e njëres palë kontraktuese ndaj njërit prej detyrimeve të saj lidhur me një dorëzim, përbën një mospërmbushje me rëndësi të veçantë të kontratës që lidhet me këtë dorëzim, pala tjetër mund ta shpallë kontratën të zgjidhur për sa i takon këtij dorëzimi.

Në qoftë se mospërmbushja nga ana e njëres palë kontraktuese e detyrimeve të veta lidhur me një dorëzim, i jep palës tjetër arsye të bazuara për të gjykuar se do të ndodhë një mospërmbushje thelbësore lidhur me dorëzimet e ardhshme, kjo mund ta shpallë kontratën të zgjidhur për të ardhmen, mjafton që këtë ta bëjë brenda një kohe të arsyeshme.

Blerësi që e shpall kontratën të zgjidhur për sa i takon një dorëzimi mundet, në të njëjtën kohë, të shpallë zgjidhjen për dorëzimet e bëra më parë ose për dorëzimet e ardhshme në qoftë se për shkak të ndërvarësisë së tyre këto dorëzime nuk do të mund të përdroreshin për qëllimin e caktuar nga palët në kontratë.

Neni 742

Në rastin e zgjidhjes së kontratës, shitësi duhet të kthejë çmimin dhe t'i paguajë blerësit shpenzimet dhe pagimet e bëra ligjërish.

Blerësi duhet të kthejë sendin, në qoftë se ky nuk ka humbur ose është shkatërruar si rrjedhim i veseve të tij.

Neni 743

Në qoftë se njëra palë vonon të paguajë çmimin ose çdo shumë tjetër, pala tjetër ka të drejtë të kërkojë kamatat për këto shuma pa cenuar shpërblimin e dëmit.

Neni 744

Shitësi duhet t'i kthejë blerësit çmimin e paguar, edhe sikur sendit t'i jetë pakësuar vleftha ose të jetë dëmtuar. Në qoftë se ulja e vlefthës ose dëmtimi vijnë si pasojë e një veprimi të blerësit, nga shuma e mësipërme duhet zbritur përfitimi që ka nxjerrë blerësi, përveç sa parashikohet në nenin 640.

Neni 745

Në qoftë se kontrata është zgjidhur dhe po që se, në mënyrë të arsyeshme dhe brenda një afati të arsyeshëm pas zgjidhjes, blerësi ka kryer një blerje për të zëvendësuar ose shitësi i ka rishitur sendet, pala që kërkon dëmshpërblimin mund të marrë diferencën midis çmimit të parashikuar në kontratë dhe çmimit të shitblerjes zëvendësuese, si dhe çdo shpërblim tjetër që mund të kërkohet në bazë të nenit të mësipërm.

Shitja me rezervë e pronës

Neni 746

Kur çmimi i shitjes paguhet me këste, blerësi e fiton pronësinë e sendit me pagimin e këstit të fundit të çmimit, duke marrë përsipër rreziqet që në çastin e dorëzimit. Kalimi me rezervë i pronësisë me kushtin e sipërm duhet të pasqyrohet në kontratë.

Neni 747

Kalimi i pronësisë sipas dispozitës së mësipërme, mund t'u kundrejtohet kreditorëve të blerësit, kur rrjedh nga një akt i shkruar në datë të saktë përpara masës për sigurimin e kredisë.

Kur objekti i shitjes janë sende të paluajtshme ose sende të luajtshme të regjistruara, zbatohen dispozitat mbi regjistrimin.

Neni 748

Mospagimi vetëm i një kësti, që nuk kalon një të tetën e çmimit, nuk sjell zgjidhjen e kontratës, dhe blerësi ruan të drejtën e afatit lidhur me këstet e mëvonshme, pavarësisht nga ndonjë marrëveshje e kundërt.

Neni 749

Kur zgjidhja e kontratës është rrjedhim i mospërmbushjes së detyrimeve të blerësit, shitësi duhet të kthejë pagesat e bëra, përpos të drejtës për një shpërblim për përdorimin e sendit, apo shpërblimit të dëmit.

Kur në kontratë është parashikuar që pagesat e bëra t'i mbesë, shitësit me titull dëmshpërblimi, gjykata sipas rrethanave të çështjes mund të pakësojë këtë dëmshpërblim.

Neni 749/a

(Shtuar me ligjin nr. 8536, datë 18.10.1999)

Rregullat e parashikuara nga nenet 746, 747, 748 dhe 749 nuk zbatohen për shitjet me rezervë të pronës, lidhur me transaksione financiare me barrë siguroese, për të cilat zbatohen rregullat e përcaktuara me ligj të veçantë.

Shitja e sendeve të paluajtshme

Neni 750

Shitja e sendeve të paluajtshme kryhet sipas mënyrave të parashikuara në nenin 83 të këtij Kodi, përndryshe është e pavlefshme.

Neni 751

Shitja me kusht e sendeve të paluajtshme regjistrohet në regjistrat e pasurisë së paluajtshme pasi të jetë vërtetuar kushti.

Neni 752

Kur një send i paluajtshëm i caktuar shitet, duke treguar përmasat dhe me një çmim të vendosur mbi bazën e një pagese për çdo njësi matëse, blerësi ka të drejtë për një zbritje të çmimit, në qoftë se madhësia efektive e sendit të paluajtshëm është më e vogël se ajo e treguar në kontratë.

Në qoftë se përmasat e sendit rezultojnë më të mëdha se ato që tregohen në kontratë, blerësi duhet të paguajë shtesën e çmimit, por ka të drejtë të heqë dorë nga kontrata kur teprica tejkalon një të njëzetën pjesë të madhësisë së deklaruar.

Neni 753

Në rastin kur çmimi përcaktohet në lidhje me vetë sendin e paluajtshëm dhe jo me madhësinë e tij, edhe pse kjo është dhënë, nuk bëhet ulje ose ngritje çmimi, përveç kur madhësia reale është më e vogël ose më e madhe se një e njëzeta pjesë e asaj të treguar në kontratë.

Në rastin kur duhet paguar një çmim shtesë, blerësi mund të zgjedhë ose heqjen dorë nga kontrata ose nga pagimi i shtesës.

Neni 754

Në qoftë se dy ose më shumë sende të paluajtshme janë shitur me të njëjtën kontratë për një çmim të vetëm dhe të njëjtë, duke treguar madhësinë e secilit prej tyre, dhe del se sasia është më e vogël tek njëri dhe më e madhe tek tjetri, bëhet kompensimi deri në sasinë e duhur; e drejta për shtesën ose për pakësimin e çmimeve bëhet në përputhje me dispozitat e caktuara më sipër.

Neni 755

E drejta e shitësit për shtesën dhe e blerësit për pakësimin e çmimit ose për heqjen dorë nga kontrata parashkruhet dy vjet pas dorëzimit të sendit të paluajtshëm.

Neni 756

E drejta e blerësit për të kundërshtuar të metat e sendit të paluajtshëm, parashkruhet me kalimin e pesë vjetëve nga momenti i dorëzimit të sendit.

KREU II SHKËMBIMI

Neni 757

Shkëmbimi është kontrata që ka për objekt kalimin e ndërsjellë të pronësisë së sendeve ose të të drejtave të tjera nga njëri kontraktues tek tjetri.

Neni 758

Shkëmbyesi, në rast se ka pësuar marrjen e sendit dhe nuk ka ndërmend ta rimarrë atë, ka të drejtë të marrë vleftën e tij, sipas dispozitave të caktuara për shitjen, si dhe shpërblimin e dëmit.

Neni 759

Shpenzimet e shkëmbimit dhe shpenzime të tjera shtesë janë në ngarkim të të dy palëve në pjesë të barabarta, përveç kur ka marrëveshje të kundërt.

Neni 760

Rregullat e caktuara për kontratën e shitjes zbatohen edhe për kontratën e shkëmbimit, për aq sa janë në pajtim me atë.

KREU III DHURIMI

Neni 761

Dhurimi është një kontratë me anë të së cilës njëra palë i kalon në pronësi pa shpërblim palës tjetër një send të caktuar ose një të drejtë reale të cilat kjo i pranon.

Nuk përbën dhurim heqja dorë nga një e drejtë para se të fitohet ajo, ose heqja dorë nga trashëgimi.

Neni 762

Dhurimi nuk mund të përmbajë veçse pasurinë e tashme të dhuruesit. Në qoftë se përfshin pasurinë e ardhshme, dhurimi është i pavlefshëm përsa i takon kësaj.

Neni 763

Dhurimi, që ka për objekt detyrimet periodike, shuhet me vdekjen e dhuruesit, përveç rasteve kur në kontratë është parashikuar ndryshe.

Neni 764

Dhurimi i sendeve të paluajtshme duhet të bëhet me akt publik dhe të regjistrohet, përndryshe është i pavlefshëm.

Pranimi mund të bëhet me po atë akt, ose me akt të mëvonshëm. Në këtë rast dhurimi quhet i përfunduar nga momenti kur akti i pranimit i është njoftuar dhuruesit.

Në qoftë se ka për objekt sende të luajtshme, ai është i vlefshëm kur ato specifikohen duke treguar edhe vleftën e tyre në kontratën e dhurimit.

Kontrata quhet e lidhur nga çasti i dorëzimit të sendit.

Përpara se kontrata të jetë lidhur, dhuruesi ose pranuesi i dhurimit mund të revokojnë deklaratën e tyre.

Neni 765

Dhurimi mund të kundërshtohet për lajthitje të shkakut, kur ky lidhet me faktin ose me të drejtën, po qe se shkakun rrjedh nga akti dhe ka shtyrë dhuruesin të bëjë dhurimin.

Neni 766

Dhuruesi për mospërmbushjen ose vonesën në dhurim, është përgjegjës vetëm për qëndrime të kryera me dashje ose me pakujdesi të rëndë.

Neni 767

Dhuruesi mund të vërë si kusht kthimin e sendeve të dhuruara, si për shkak të vdekjes së përparshme të pranuesit të dhurimit, ashtu edhe të vdekjes së përparshme të pasardhësve të tij.

Kthimi mund të ndodhë vetëm në favor të dhuruesit. Marrëveshja në favor të të tjerëve konsiderohet si e palidhur.

Neni 768

Dhurimi mund të rëndohet me kusht ose me barrë. Dhuruesi është i detyruar të përmbushë barrën brenda kufijve të vleftës së sendit të dhuruar.

Për të përmbushur barrën mund të veprojnë, përveç dhuruesit dhe çdokush i interesuar.

Zgjidhja e kontratës së dhurimit për mospërmbushje të barrës mund të kërkohet nga dhuruesi ose trashëgimtarët e tij, në qoftë se është parashikuar në aktin e dhurimit.

Barra e paligjshme ose e pamundur quhet e paqenë, ajo gjithsesi e bën të paqenë dhurimin në qoftë se ka përbërë të vetmin shkak përcaktues të kontratës.

Neni 769

Dhuruesi detyrohet t'i japë garanci pranuesit të dhurimit për përkatësinë e sendit të dhuruar dhe zhveshjen që mund të pësojë nga të tjerët për sendet e dhuruara, në këto raste:

1. në qoftë se ka premtuar shprehimisht garancinë;
2. në qoftë se marrja e sendit varet nga mashtrimi e nga qëndrime personale të tij;
3. në qoftë se dhurimi i ngarkon barrë pranuesit të dhurimit ose dhurimi është për shkak shpërblimi, raste në të cilat garancia vihet deri në vleftën e barrës ose të tërësisë së premtimeve të marra nga dhuruesi.

Neni 770

Garancia e dhuruesit nuk shtrihet në të metat e asaj çka është dhuruar, përveç kur dhuruesi ka vepruar me mashtrim, si dhe kur ka marrëveshje të posaçme.

Neni 771

Dhuruesi, për dhurimet që nuk janë të zakonshme ose që nuk janë bërë për shpërblim, mund të kërkojë revokimin e dhurimit kur ai që ka marrë dhurimin:

a) me dashje ka vrarë ose ka tentuar të vrasë dhuruesin, bashkëshortin ose fëmijët, ose prindërit e tij;

b) pa të drejtë nuk i jep dhuruesit ushqim kur është i detyruar sipas ligjit.

Padia për revokimin e dhurimit duhet të ngrihet brenda një viti nga dita që dhuruesi ka marrë njoftim për shkaqet që i japin të drejtë që të kërkojë revokimin e dhurimit.

Padia e filluar mund të vazhdohet edhe nga trashëgimtarët e dhuruesit ose mund të ngrihet nga vetë këta, në rast se dhuruesi ka vdekur brenda vitit, nga dita që ka lindur shkakun për të ngritur padinë.

Heqja dorë që më parë nga padia është e pavlefshme.

Revokimi i dhurimit nuk cenon të drejtat që kanë fituar të tretët mbi sendin e dhuruar para se të ngrihet padia.

KREU IV FURNIZIMI

Neni 772

Furnizimi është një kontratë me të cilën njëra palë detyrohet, kundrejt pagesës së një çmimi, të kryejë në dobi të palës tjetër furnizime periodike ose të vazhdueshme të sendeve.

Sendet e furnizuar mund të jenë të luajtshme ose të paluajtshme, gjithashtu mund të jenë në trajtë energjie ose titujsh krediti.

Neni 773

Kur nuk është përcaktuar sasia e furnizimit nënkuptohet se marrëveshja është për sasinë që përkon me nevojat normale të palës që furnizohet deri në kohën e përfundimit të kontratës.

Në qoftë se palët kanë vendosur vetëm kufirin maksimal dhe minimal për furnizimin ose për shërbimet e veçanta, i takon atij që ka të drejtën e furnizimit të vendosë brenda kufijve të mësipërm për sasinë e duhur.

Në qoftë se sasia e furnizimit duhet të përcaktohet sipas nevojave mbi një sasi minimale të caktuar në kontratë, pala që furnizohet përgjigjet për sasinë përkatëse sipas nevojave në rast se tejkalohe sasia minimale.

Neni 774

Në furnizimin me karakter periodik, në qoftë se çmimi do të përcaktohet sipas nenit 707 të këtij Kodi, merret parasysh koha e mbarimit të furnizimeve të veçanta dhe vendi ku këto duhet të kryhen.

Neni 775

Në furnizimin me karakter periodik, çmimi përkon me dokumentin e furnizimeve të veçanta.

Në furnizimin me karakter të vazhdueshëm çmimi paguhet sipas afateve të zakonshme.

Neni 776

Afati i caktuar në kontratë për furnizime të veçanta prezumohet si i vendosur në dobi të dy palëve.

Në qoftë se palës që furnizohet i është dhënë e drejta të caktojë afatin e furnizimeve të veçanta, ajo duhet t'i njoftojë datën furnizuesit me anë të një paralajmërimi në një kohë të arsyeshme.

Neni 777

Në rast mospërbushjeje prej njëres nga palët të detyrimeve të veçanta, pala tjetër mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës, në qoftë se mospërbushja ka një rëndësi të veçantë dhe është e tillë sa që dëmton besimin në sigurinë e përmbushjeve të mëpasshme.

Neni 778

Në qoftë se pala që ka të drejtë për t'u furnizuar nuk e ka përmbushur detyrimin dhe mospërbushja është me pak rëndësi, furnizuesi nuk mund të pezullojë zbatimin e kontratës pa bërë më parë një paralajmërim të arsyeshëm.

Neni 779

Në rast se në kontratë është vendosur kushti i ekskluzivitetit në favor të furnizuesit, pala tjetër nuk mund të përfitojë furnizime të të njëjtit lloj nga të tretët dhe as mund të realizojë, me mjetet e veta, prodhimin e sendeve që formojnë objektin e kontratës, në qoftë se për këtë nuk ka marrëveshje të kundërt ose kur në ligj disponohet ndryshe.

Neni 780

Në qoftë se kushti i ekskluzivitetit është vendosur në dobi të palës që ka të drejtë për t'u furnizuar, furnizuesi nuk mund të bëjë as drejtpërdrejt dhe as tërthorazi furnizime të të njëjtit lloj e që formojnë objektin e kontratës, në zonën për të cilën është dhënë ekskluziviteti dhe brenda afatit të kontratës.

Kushti i ekskluzivitetit, që përmbahet në një kontratë furnizimi, përbën një kusht barrësor që kërkon miratim të posaçëm me shkrim.

Neni 781

Pala që ka të drejtën për t'u furnizuar, kur merr përsipër detyrimin për të shtuar shitjen e sendeve për të cilat ka ekskluzivitet, në zonën që i është caktuar, përgjigjet për dëmet që shkaktohen nga mospërbushja e këtij detyrimi, edhe në qoftë se kontratën e ka zbatuar për sasinë minimale që është caktuar.

Neni 782

Në qoftë se kohëzgjatja e furnizimit nuk është vendosur, secila nga palët mund të tërhiqet nga kontrata, duke njoftuar paraprakisht furnizuesin brenda afatit të vendosur prej tyre dhe, në mungesë të tij, brenda një afati të arsyeshëm, duke marrë parasysh edhe natyrën e furnizimit.

Neni 783

Në kontratën e furnizimit zbatohen edhe dispozitat që rregullojnë kontratën për furnizimet e veçanta, për aq sa nuk vijnë në kundërshtim me dispozitat e mësipërme.

KREU V ENFITEOZA

Kuptimi i enfiteozës

Neni 784

Enfiteoza është një kontratë, me të cilën një personi i jepet e drejta të përdorjë e të përmirësojë një pasuri të paluajtshme, kundrejt një shpërblimi periodik në të holla ose në natyrë.

Neni 785

Kohëzgjatja e enfiteozës caktohet në kontratë.

Neni 786

Kontrata e enfiteozës duhet të bëhet në formën që kërkohet për kalimin e pronësisë për pasuritë e paluajtshme.

Të drejtat e detyrimet e pronarit dhe të enfiteozëmarrësit

Neni 787

Enfiteozëmarrësi e gëzon sendin sikurse dhe pronari, me përjashtim të kufizimeve të parashikuara në kontratën për krijimin e enfiteozës.

Megjithatë ai nuk mundet që, pa pëlqimin e pronarit, të përdorë sendin në një destinacion tjetër.

Neni 788

Enfiteozëmarrësit i përkasin frytet natyrore të ndara, frytet civile që janë bërë të kërkueshme gjatë enfiteozës dhe të drejtat e përdorimit të nëntokës në kufijtë e parashikuar me ligj, përveç kur në kontratë është parashikuar ndryshe.

Neni 789

Kur prona në enfiteozë humbet tërësisht, enfiteoza shuhet dhe enfiteozëmarrësi shkarkohet nga detyrimi përkatës për të ardhmen. Kur prona humbet ose dëmtohet në pjesë të dukshme e të rëndësishme të saj, aq sa nuk mund të sigurohen të ardhura sa të shlyhet shpërblimi i caktuar në kontratë, mund të kërkohet një ulje e tij ose prishja e kontratës, duke shlyer palët detyrimet reciproke.

Kërkesa duhet të bëhet brenda një viti nga dita që ka ndodhur humbja ose dëmtimi i pronës në enfiteozë.

Enfiteozëmarrësi nuk mund të kërkojë shkarkimin nga detyrimi për pagimin e shpërblimit ose uljen e tij, për shkak mosprodhimi ose humbje të fryteve, qoftë edhe për rast faktor.

Neni 790

Dhënia e pronës në nënenfiteozë nuk lejohet.

Neni 791

Enfiteozëmarrësi mund të kërkojë në çdo kohë zgjidhjen e kontratës dhe mbarimin e enfiteozës, përveç kur parashikohet ndryshe në kontratë.

Enfiteozëdhënësi mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës dhe mbarimin e enfiteozës, kur enfiteozëmarrësi nuk ka shlyer detyrimin përkatës për dy periudha rresht, dëmton ose nuk mirëmban e përmirëson pronën e nuk përmbush në mënyrë të dukshme detyrimet që rrjedhin nga kontrata.

Neni 792

Tatimet dhe detyrimet e tjera që rëndojnë mbi pronën janë në ngarkim të enfiteozëmarrësit, përveç kur në ligj parashikohet ndryshe.

Kur në kontratë këto detyrime janë lënë në ngarkim të pronarit, ato nuk mund të kalojnë shpërblimin e caktuar për enfiteozën.

Neni 793

Në rast tjetërsimi të enfiteozës, enfiteozëmarrësi i ri dhe ai përpara tij, detyrohen solidarisht për shpërblimin e papaguar të enfiteozës, përveç kur enfiteozëmarrësit të mëparshëm i është njoftuar akti i tjetërsimit prej enfiteozëdhënësit.

Në rast tjetërsimi të një të drejte të tillë prej pronarit, fituesi nuk mund të kërkojë përmbushjen e detyrimeve nga enfiteozëmarrësi përpara se atij t'i njoftohet akti i tjetërsimit.

Neni 794

Kur në kontratë nuk parashikohet ndryshe, enfiteozëmarrësi gjatë vazhdimit të enfiteozës ose kur ajo pushon, ka të drejtë t'i heqë ndërtime, punimet e tjera e mbjelljet e kryera jashtë kushteve të enfiteozës ose që i janë blerë pronarit, por gjithnjë pa dëmtuar pronën e duke kthyer atë në gjendjen e mëparshme.

Neni 795

Kur zgjidhet kontrata, enfiteozëmarrësit i takon vlefata e përmirësimeve të kryera në masën që është rritur vlefata e pronës, kur ajo ekziston në kohën e kthimit të saj.

Neni 796

Enfiteozëmarrësi ka të drejtë të mbajë sendin e dhënë në enfiteozë, deri në shlyerjen e kredive që rrjedhin prej saj. Çdo marrëveshje e kundërt është e pavlefshme.

Pronari ka të drejtë të mbajë sendet që i takojnë enfiteozëmarrësit deri në shlyerjen e detyrimeve ndaj tij.

Neni 797

Kur lind nevoja të bëhen ndreqje të jashtëzakonshme në pronën e dhënë në enfiteozë, enfiteozëmarrësi është i detyruar të njoftojë pronarin dhe t'i japë atij mundësi për t'i kryer ato.

Enfiteozëdhënësi nuk është i detyruar të kryejë ndonjë riparim të zakonshëm.

Neni 798

Personat që gëzojnë bashkërisht një të drejtë enfiteotike përgjigjen solidarisht për pagimin e shpërblimit për enfiteozën.

Kur prona e dhënë në enfiteozë ndahet dhe ata gëzojnë pjesë të saj, secili përgjigjet për detyrimet që rrjedhin nga enfiteoza, proporcionalisht me vleftën e pjesës që gëzon.

Neni 799

Dispozitat e këtij kreu zbatohen edhe kur enfiteoza gëzohet nga një ose disa persona juridikë, përveç kur ajo ndalohet nga ligji.

Neni 800

Enfiteozëmarrësi mund të fitojë në dobi të pronës servitute aktive dhe ta ngarkojë atë me servitute pasive, për një kohë sa parashikohet në kontratë, gjithnjë duke njoftuar enfiteozëdhënësin me shkresë.

KREU VI QIRAJA

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 801

Qiraja është kontrata me të cilën njëra palë (qiradhënësi) detyrohet t'i japë palës tjetër (qiramarrësit) një send të caktuar, në gëzim të përkohshëm kundrejt një shpërblimi të caktuar.

Neni 802

Qiradhënësi duhet:

1. t'i dorëzojë qiramarrësit sendin në kohën e caktuar dhe në gjendje që të lejojë përdorimin për të cilën palët janë marrë vesh;
2. të kujdeset për të mbajtur sendin në po këtë gjendje;
3. të garantojë gëzimin e qetë gjatë periudhës së qirasë.

Neni 803

Qiraja nuk mund të lidhet për një kohë më të gjatë se tridhjetë vjet, përveç kur parashikohet ndryshe nga ligji. Në qoftë se ajo është lidhur për një periudhë kohe më të gjatë ose pa afat, ka fuqi vetëm për afatin e sipërm.

Për ndërtesat që përdoren për banim, kontrata e qirasë nuk mund të lidhet për një kohë më të gjatë se pesë vjet.

Për sende të luajtshme të dhëna për pajisjen e një sendi të paluajtshëm, afati është baraz me kohëzgjatjen e qirasë së këtij të fundit.

Kontrata e qirasë, për një kohë më të gjatë se një vit, duhet bërë me shkresë.

Neni 804

Qiramarrësi, që ka ekzekutuar në rregull detyrimet që kanë rrjedhur nga kontrata, ka të drejtën që të preferohet ndaj personave të tjerë në rast se, me mbarimin e kohës së qerasë, do të lidhet kontrata e re.

Të drejta e detyrime të qiradhënësit

Neni 805

Qiradhënësi duhet të kryejë, gjatë periudhës së qirasë, të gjitha riparimet, me përjashtim të punimeve për mirëmbajtjen e përditshme që janë në ngarkim të qiramarrësit.

Për sende të luajtshme, shpenzimet për ruajtjen e për mirëmbajtjen e zakonshme janë në ngarkim të qiramarrësit, përveçse kur me marrëveshje parashikohet ndryshe.

Kur sendi i dhënë me qira ka nevojë për riparime, që nuk janë në ngarkim të qiramarrësit, ky është i detyruar të njoftojë qiradhënësin.

Në rast riparimesh urgjente qiramarrësi mund t'i kryejë ato drejtpërdrejt, kundrejt kthimit të shpenzimeve, me kushte që të njoftojë menjëherë qiramarrësin.

Neni 806

Në qoftë se në kohën e dorëzimit, sendi i dhënë me qira cenohet nga të meta që ulin në mënyrë të dukshme vlerën e përdorimit të kontraktuar, qiramarrësi mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës,

ose zbritjen e çmimit të qirasë, përveç kur ai ka patur dijani për të metën ose ajo është lehtësisht e dallueshme.

Qiradhënësi është i detyruar t'i paguajë qiramarrësit dëmet e ardhura nga veset e sendit, në qoftë se nuk provon se, pa patur faj, nuk ka patur dijani për këto vese në momentin e dorëzimit.

Në qoftë se veset e sendit vënë para një rreziku të madh shëndetin e qiramarrësit ose të familjes apo të vartësve të tij, qiramarrësi mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës edhe po qe se veset njiheshin prej tij.

Neni 807

Marrëveshja, me të cilën përjashtohet ose kufizohet përgjegjësia e qiradhënësit për veset e sendit, nuk ka efekt në qoftë se qiradhënësi ia ka fshehur me keqbesim qiramarrësit ato, ose kur veset janë të tilla që të pengojnë gëzimin e sendit.

Neni 808

Dispozitat e neneve të mësipërme janë të zbatueshme edhe në rastet e veseve të sendit të ndodhura gjatë qirasë.

Neni 809

Në qoftë se gjatë qirasë sendi i dhënë me qira ka nevojë për riparime urgjente, qiramarrësi duhet të lejojë kryerjen e tyre. Në qoftë se sendi nuk riparohet brenda një kohe të arsyeshme, qiramarrësi ka të drejtë për një ulje përpjesëtimore të qirasë.

Neni 810

Qiradhënësi detyrohet të garantojë qiramarrësin nga shqetësimet që pakësojnë vlerën e përdorimit dhe të gëzimit të sendit, të shkaktuara nga të tretët që pretendojnë se kanë të drejta mbi të njëjtin send.

Qiradhënësi nuk është i detyruar të garantojë qiramarrësin nga shqetësimet e të tretëve që nuk pretendojnë të kenë të drejta mbi sendin. Në këtë rast qiramarrësi ruan të drejtën të ngrejë padi kundër të tretëve në emrin e tij.

Neni 811

Në qoftë se të tretët që krijojnë shqetësime pretendojnë se kanë të drejta mbi sendin e dhënë me qira, qiramarrësi është i detyruar ta njoftojë menjëherë qiradhënësin, përndryshe ngarkohet me shpërblimin e dëmit.

Në qoftë se të tretët veprojnë në rrugë gjyqësore, qiradhënësi është i detyruar të marrë pjesë në proces, po qe se thirret.

Të drejta e detyrime të qiramarrësit

Neni 812

Qiramarrësi duhet:

1. të marrë në dorëzim sendin dhe ta përdorë për qëllimin që është parashikuar në kontratë dhe, kur nuk është parashikuar, sipas qëllimit që del nga natyra e sendit;
2. të kryejë pagesën në afatet e caktuara.

Neni 813

Qiramarrësi përgjigjet për humbjen dhe dëmtimin e sendit të cilat ndodhin gjatë kontratës së qirasë.

Neni 814

Qiramarrësi duhet t'ia kthejë qiradhënësit sendin në të njëjtën gjendje që e ka marrë, në përputhje me përshkrimin e bërë nga palët në kontratë, përveç dëmtimit ose konsumimit të zakonshëm nga përdorimi i sendit në përputhje me kontratën.

Në mungesë të përshkrimit në kontratë prezumohet se qiramarrësi e ka marrë sendin në gjendje të mirë përdorimi.

Qiramarrësi nuk përgjigjet për humbjen ose dëmtimin e shkaktuar si pasojë e vjetërsisë. Sendet e luajshmë duhet të kthehen në vendin ku janë marrë në dorëzim.

Neni 815

Qiramarrësi që është në vonesë për të kthyer sendin, detyrohet t'i japë qiradhënësit pagesën e caktuar deri në dorëzim, përveç detyrimit për të shpërblyer dëmin përkatës.

Neni 816

Përveç kur parashikohet ndryshe në ligj, qiramarrësi nuk ka të drejtë të shpërblehet për përmirësimet e bëra sendit të marrë me qira. Por në qoftë se ka patur pëlqimin e qiradhënësit, ky është i detyruar t'i paguajë një kompensim që i korrespondon shumës më të vogël midis shumës së shpenzimeve dhe vleftës së rezultatit të dobishëm në kohën e dorëzimit. Kur qiramarrësi nuk ka të drejtë kompensimi, vlefta e përmirësimeve mund të kompensojë dëmtimet që kanë ndodhur për pakujdesinë e rëndë të qiramarrësit.

Neni 817

Qiramarrësi që ka bërë shtesa në sendin e marrë me qira, ka të drejtë t'i heqë ato në mbarim të qirasë, kur kjo mund të kryhet pa dëmtuar sendin, përveç kur pronari pranon t'i mbajë vetë shtesat. Në këtë rast ky duhet t'i paguajë qiramarrësit një kompensim të barabartë me shumën më të vogël midis shpenzimeve dhe vleftës të shtesave në kohën e ridorëzimit.

Në qoftë se shtesat nuk mund të ndahen pa dëmtuar sendin dhe përbëjnë një përmirësim të tij, zbatohen rregullat e parashikuara nga neni 810.

Neni 818

Qiramarrësi, veç marrëveshjes së kundërt, ka të drejtë të japë me nënqira sendin që ka marrë me qira, por nuk mund t'ia kalojë kontratën një tjetri pa pëlqimin e qiradhënësit.

Për sende të luajtshme dhënia me nënqira bëhet me pëlqimin e qiradhënësit.

Neni 819

Qiradhënësi, pa cenuar të drejtat e tij ndaj qiramarrësit, mund të ngrejë padi kundër nënqiramarrësit për të kërkuar çmimin e nënqirasë për të cilën ky i fundit është ende debitor në momentin e ngritjes së padisë dhe për ta detyruar atë të përmbushë të gjitha detyrimet e tjera që rrjedhin nga kontrata e nënqirasë.

Shpallja e pavlefshme e kontratës së qirasë ose zgjidhja e saj ka efekt edhe ndaj nënqiramarrësit, dhe vendimi i marrë midis qiradhënësit dhe qiramarrësit ka efekt edhe ndaj tij.

Mbarimi i kontratës së qirasë

Neni 820

Qiraja me afat të caktuar nga palët, pushon me mbarimin e afatit, pa qënë e nevojshme shpallja e mbarimit të saj.

Qiraja në të cilën nuk caktohet afat nuk pushon, në qoftë se përpara afatit të vendosur sipas nenit 803 të këtij Kodi njëra nga palët njofton palën tjetër se heq dorë nga qiraja.

Përsëritja e kontratës së qirasë

Neni 821

Qiraja përtërihet në qoftë se, pasi të ketë mbaruar afati i saj, qiramarrësit i lihet në përdorim sendi i dhënë me qira pa kundërshtimin e qiradhënësit.

Qiraja e re rregullohet me të njëjtat kushte si e mëparshmeja, por kohëzgjatja e saj caktohet si për qiratë me afat të caktuar.

Marrëdhëniet me të tretët

Neni 822

Kontrata e qirasë mund t'i kundrejtohet të tretit që ka fituar sendin e dhënë me qira, me kusht që kontrata të ketë një datë të saktë para tjetërsimit të sendit.

Dispozitat e paragrafit të mësipërm nuk zbatohen për qiranë e sendeve të luajtshme të paregjistruara në regjistrat publikë, në qoftë se fituesi ka siguruar posedimin me mirëbesim.

Qiraja e sendeve të paluajtshme të paregjistruara nuk i kundrejtohet fituesit të tretë, veç brenda afatit të 9 vjetëve nga fillimi i qirasë.

Fituesi duhet të respektojë qiranë në çdo rast në qoftë se ka marrë përsipër detyrimin ndaj tjetërsuesit.

Neni 823

Në qoftë se qiraja nuk ka datë të saktë, por mbajtja e saj prej qiramarrësit si datë është përpara kalimit të pronësisë, fituesi nuk është i detyruar të respektojë qiranë, veçse për kohëzgjatjen që përkon me atë të vendosur për qiratë me afat të pacaktuar.

Neni 824

Në qoftë se qiramarrësi është përjashtuar nga fituesi, sepse kontrata e qirasë nuk kishte një datë të saktë përpara kalimit të pronësisë, qiradhënësi detyrohet të shpërblejë dëmin.

Neni 825

Fituesi është i detyruar të respektojë kontratën e qirasë qysh nga dita e fitimit për të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontrata e qirasë.

A. Qiraja për pasuritë e paluajtshme me natyrë bujqësore DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 826

Kontrata e qirasë të pasurisë së paluajtshme që shërben për kultivimin bujqësor për një kohë mbi nëntë vjet, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet në regjistrin publik.

Neni 827

Qiradhënësi me anë inventari i dorëzon qiramarrësit pasurinë e paluajtshme si tokën bujqësore, kullotat, ndërtesat e banimit e ato ndihmëse në shërbim të veprimtarisë bujqësore e blegtorale, si dhe sendet e luajtshme në shërbim të kësaj veprimtarie. E drejta e kundërshtimit të përmbajtjes së inventarit dhe prezumimi i saktësisë së tij rregullohet sipas dispozitave të këtij kreu.

Neni 828

Qiradhënësi përballon detyrimet dhe taksat financiare që rëndojnë mbi pasurinë e paluajtshme.

Neni 829

Qiradhënësi ka të drejtë që në çdo kohë të ushtrojë kontroll mbi pasurinë e dhënë me qira për të përcaktuar nëse qiramarrësi respekton marrëveshjen sipas detyrimeve të vëna në kontratë, sipas natyrës dhe rregullave agroteknike.

Neni 830

Qiramarrësi shlyen çmimin e qirasë në kohën dhe në mënyrën e caktuar në kontratë. Çmimi i qirasë mund të jetë në natyrë dhe në të holla.

E drejta e kultivimit

Neni 831

E drejta e kultivimit nënkupton të drejtën e njëres nga palët kontraktuese që të vendosë se çfarë do të kultivohet nga një periudhë në tjetrën. Kjo e drejtë rregullohet me marrëveshje të palëve.

Kur çmimi i qirasë përbëhet tërësisht ose kryesisht me prodhime bujqësore nga produktet që kultivohen në pasurinë e paluajtshme të dhënë me qira, e drejta e kultivimit i takon qiradhënësit, në rast se në kontratë ose sipas zakonisht të vendit, nuk parashikohet ndryshe. Kur çmimi i qirasë përbëhet tërësisht ose pjesërisht nga një shumë parash që i jepet qiradhënësit, e drejta e kultivimit i takon qiramarrësit, në rast se në kontratë ose sipas zakonisht të vendit, nuk parashikohet ndryshe.

Neni 832

Pala që ka të drejtën e kultivimit, kur nuk i njofton palës tjetër planin e kultivimit në kohën e duhur dhe kur pritja e mëtejshme e këtij njoftimi mund të sjellë pasoja serioze në kultivimin bujqësor, kjo e drejtë i kalon palës tjetër.

Koha dhe shpenzimet e kultivimit

Neni 833

Qiramarrësi vendos me përgjegjësinë e tij për kohën kur do të kryejë veprimet e kultivimit dhe për mënyrat dhe të rejat agroteknike që do të zbatojë. Qiramarrësi në këtë drejtim mund të bëjë vetëm rekomandime.

Neni 834

Shpenzimet që nevojiten për kultivimin përballohen nga qiramarrësi. Kur çmimi i qirasë përbëhet tërësisht apo kryesisht nga produkti që kultivohet, qiradhënësi i parapaguan pa kamatë qiramarrësit ato shpenzime që mund të kërkohen për kultivimin, në rast se ky i fundit nuk mundet t'i përballojë vetë.

Parapagimi i dhënë i kthehet qiradhënësit nga prodhimi i të korrave të ardhshme.

Shlyerja e çmimit të qirasë

Neni 835

Çmimi i qirasë shlyhet sipas afateve të caktuara në kontratë. Në mungesë të një caktimi të tillë, shlyhet në fund të çdo viti të kontratës, kur çmimi është caktuar në para.

Viti i kontratës së qirasë fillon ditën kur qiramarrësit i dorëzohet pasuria e marrë me qira.

Neni 836

Kur çmimi i qirasë përbëhet nga një pjesë e prodhimit bujqësor ose në raport me atë, qiradhënësit i dorëzohet pjesa që i takon sipas kërkesës së tij, pasi të jenë mbledhur të korrat.

Në mungesë të marrëveshjes respektohet zakoni i vendit.

Neni 837

Qiramarrësi mund të kërkojë uljen e çmimit të qirasë ose shtyrjen e pagimit të saj, kur rrethana të paparashikuara ose ngjarje të jashtëzakonshme e kanë ulur prodhimtarinë e një viti në të paktën gjysmën në krahasim me prodhimtarinë normale.

Neni 838

Qiramarrësi mund të kërkojë që të rishikohet çmimi i qirasë në favorin e tij, duke patur parasysh prodhimtarinë e zakonshme, rëndësinë e humbjes së pësuar, fitimet që ka patur ai vitet e mëparshme dhe ato që mund të sigurojë gjatë kohës që kontrata është në fuqi.

Neni 839

Në rast zgjidhje të kontratës, qiramarrësi nuk është i detyruar të lërë farërat për të mbjellat e ardhshme, përveç kur në kontratë ose nga zakoni i vendit parashikohet ndryshe.

Neni 840

Qiramarrësi nuk gëzon të drejtën e marrjes së frutave, të cilat në kohën e përfundimit të kontratës, ende nuk ishin vjelë. Por gjykata mund të pranojë që qiramarrësit t'i paguhen shpenzimet që mund të ketë bërë për kultivimin e frutave. Gjithsesi ky shpërblim nuk mund të kalojë vlerën e frutave që përfiton qiramarrësi.

B. Qiraja e sendeve prodhuese

Neni 841

Kur qiraja ka për objekt gëzimin e një sendi prodhues, të luajtshëm ose të paluajtshëm, qiramarrësi duhet të përkujdeset për administrimin e tij në përputhje me destinimin ekonomik të sendit.

Neni 842

Në qoftë se palët nuk e kanë përcaktuar kohëzgjatjen e qirasë, secila prej tyre mund të tërhiqet nga kontrata duke e njoftuar tjetrën qysh më përpara në një kohë të përshtatshme.

Neni 843

Qiradhënësi duhet:

1. të dorëzojë sendin me aksesoret e vet në gjendje të përshtatshme për përdorimin dhe prodhimin për të cilin është destinuar;
2. të kryejë me shpenzimet e veta riparimet e jashtëzakonshme për të cilat sendi ka nevojë gjatë kohës së qirasë.

Neni 844

Qiradhënësi mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës në qoftë se qiramarrësi nuk vë në shërbim të sendit mjetet e nevojshme për administrimin e tij, në qoftë se nuk zbaton rregullat teknike dhe në qoftë se ndryshon në mënyrë të qëndrueshme destinimin ekonomik të sendit.

Neni 845

Qiramarrësi mund të ndërmarrë nisma për rritjen e prodhimitarisë së sendit të marrë me qira, mjafton që ato të mos sjellin detyrime për qiradhënësin, ose të mos i shkaktojnë cenime të të drejtave të tij.

Neni 846

Në qoftë se si pasojë e një ligji ose e një vendimi të detyrueshëm për administrimin prodhues të sendit, raporti kontraktor rezulton i ndryshuar dukshëm, në mënyrë të tillë që njëra palë të humbasë dhe tjetra të fitojë, mund të kërkohet një shtesë apo një zbritje e çmimit të qirasë, ose sipas rrethanave, zgjidhja e kontratës, përveç kur parashikohet ndryshe nga ligji.

Neni 847

Qiramarrësi nuk mund ta lëshojë sendin me nënqira pa lejen e qiradhënësit.

Kur qiramarrësi shkel një detyrim të tillë, qiradhënësi mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës.

E drejta për të kaluar kontratën e qirasë një tjetri përfshin dhe nënqiranë, përveç kur palët kanë disponuar ndryshe në kontratë.

Neni 848

Dispozitat e kontratës së qirasë zbatohen edhe për qiranë e sendeve prodhuese, në masën që pajtohen me to.

C. Qiraja financiare (leasing)

Neni 849

Me kontratën e qirasë financiare, njëra palë detyrohet të vërë në dispozicion të palës tjetër, për një kohë të caktuar, një send të luajtshëm ose të paluajtshëm, kundrejt një pagese me afate periodike, të përcaktuar në lidhje me vleftën e sendit, me kohëzgjatjen e kontratës dhe, eventualisht me elemente të tjera sipas marrëveshjes së palëve.

Sendi duhet të jetë fituar ose të jetë ndërtuar nga qiradhënësi sipas dëshirës dhe përshkrimit të qiramarrësit, dhe ky i fundit ka të drejtë të fitojë pronësinë, në mbarim të afatit të kontratës, kundrejt pagesës së një shume të paracaktuar.

Qiradhënësi përgjigjet ndaj qiramarrësit sipas rregullave të përgjithshme për mosdorëzimin e sendit ose vonesën në dorëzimin e sendit, si dhe për të metat e sendit.

Me marrëveshje mund të parashikohet që qiramarrësi, para se të kërkojë nga qiradhënësi të drejtat e tij, duhet t'i drejtohet atij që i dha sendin (furnizuesit) për të drejtat e tij ose që i janë kaluar atij.

KREU VII SIPËRMARRJA

Përmbajtja

Neni 850

Sipërmarrja është kontrata me të cilën njëra palë (sipërmarrësi) detyrohet, që me mjetet e saj dhe duke marrë përsipër rrezikun, të kryejë një vepër (punë), ose të bëjë një shërbim apo një zbatim të pavarur të punimeve, ndërsa pala tjetër detyrohet ta pranojë atë kundrejt çmimit të caktuar në kontratë.

Caktimi i çmimit

Neni 851

Kur palët nuk e kanë caktuar çmimin e sipërmarrjes dhe as nuk kanë vendosur mënyrën për ta përcaktuar atë, ai llogaritet në bazë të tarifave ekzistuese ose në bazë të zakonit të vendit. Në rast mosmarrëveshjeje, caktohet nga gjykata.

Sigurimi i materialeve

Neni 852

Materialet e nevojshme për kryerjen e veprës duhet të sigurohen nga sipërmarrësi, në qoftë se marrëveshja nuk parashikon ndryshe.

Të drejta e detyrime të sipërmarrësit

Neni 853

Sipërmarrësi duhet të paralajmërojë në kohën e duhur porositësin:

- a) kur materiali i dhënë nga porositësi për veprën është me cilësi jo të mirë, kur kjo zbulohet gjatë punimeve dhe dëmton cilësinë e veprës;
- b) kur udhëzimet e porositësit nuk mund të zbatohen ose kur zbatimimi i tyre bën që vepra të mos jetë e qëndrueshme ose e përshtatshme;
- c) kur ka rrethana, që nuk varen nga sipërmarrësi, të cilat ndikojnë që vepra të mos jetë e qëndrueshme ose e përshtatshme.

Sipërmarrësi përgjigjet për dëmin që pëson porositësi, po qe se nuk e paralajmëron atë përse më sipër.

Neni 854

Sipërmarrësi ka të drejtë që të heqë dorë nga zbatimimi i kontratës dhe të kërkojë që të shpërblehet për dëmin që ka pësuar kur porositësi nuk zëvendëson materialin me cilësi jo të mirë ose të papërshtatshëm, ose kur nuk ndryshon udhëzimet për kryerjen e veprës, megjithëse është paralajmëruar në kohën e duhur prej tij.

Neni 855

Sipërmarrësi përgjigjet për humbjen ose dëmtimin e materialit që i është dhënë nga porositësi, përveç kur provohet se humbja ose dëmtimi i tij ka ndodhur për shkak se materiali ka qenë i një cilësie jo të mirë, ose i papërshtatshëm, ose për shkak të zbatimit të udhëzimeve të porositësit për

kryerjen e veprës, megjithëse për këto sipërmarrësi kishte paralajmëruar në kohën e duhur porositësin.

Neni 856

Sipërmarrësi ka të drejtë të kërkojë t'i paguhet puna e kryer prej tij, kur vepra, para se t'i dorëzohet porositësit, humbet ose dëmtohet për shkak se materiali ka qenë i një cilësie jo të mirë, ose i papërshtatshëm, ose për shkak të zbatimit të udhëzimeve të porositësit për kryerjen e veprës, megjithëse për këto sipërmarrësi kishte paralajmëruar në kohën e duhur porositësin.

Neni 857

Sipërmarrësi nuk mund të japë me nënsipërmarrje kryerjen e veprës ose kryerjen e shërbimeve, pa u marrë pëlqimi nga porositësi.

Neni 858

Sipërmarrësi nuk mund të ndryshojë mënyrat e caktuara në kontratë për kryerjen e veprës, pa pëlqimin me shkrim të porositësit. Edhe kur është dhënë pëlqimi, sipërmarrësi, po qe se çmimi i plotë i veprës është caktuar në total, nuk ka të drejtë të kompensohet për ndryshimet ose për shtesat, përveç kur ka marrëveshje të kundërt.

Neni 859

Në qoftë se për kryerjen e veprës sipas standardeve është e nevojshme që projekti të ndryshohet dhe për këtë gjë palët nuk merren vesh, mosmarrëveshja zgjidhet nga gjykata.

Në qoftë se ndryshimet në çmimet tejkalojnë një të gjashtë të madhësisë së çmimit të caktuar, sipërmarrësi mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës dhe sipas rrethanave, një shpërblim të përshtatshëm të dëmeve.

Në qoftë se ndryshimet janë të konsiderueshme, porositësi mund të tërhiqet nga kontrata duke paguar një dëmshpërblim të përshtatshëm.

Të drejta e detyrime të porositësit

Neni 860

Porositësi mund të bëjë ndryshime në projekt, me kusht që madhësia e tyre të mos kalojë një të gjashtë të çmimit të përgjithshëm të caktuar. Sipërmarrësi ka të drejtë të kompensohet për punimet kryesore të kryera, edhe pse çmimi i veprës është caktuar në total.

Paragrafi i mësipërm nuk zbatohet për ndryshimet në projekt që, megjithëse u përmbahen caqeve të lartpërmendura, sjellin ndryshime të konsiderueshme në natyrën e veprës ose në anën sasiore të kategorive të veçanta të punimeve të parashikuara në kontratë për kryerjen e së njëjtës vepër.

Neni 861

Porositësi ka të drejtë të kontrollojë kryerjen e punimeve dhe gjendjen e tyre me shpenzimet e veta.

Kur, gjatë punimeve, zbulohet se kryerja e tyre nuk vazhdon sipas kushteve të caktuara në kontratë dhe sipas standardeve, porositësi mund të caktojë një afat të arsyeshëm brenda të cilit sipërmarrësi duhet të pajtohet me ato kushte. Kur afati i caktuar ka kaluar pa sjellë ndonjë dobi, kontrata zgjidhet, pa cenuar të drejtën e porositësit për shpërblimin e dëmeve.

Neni 862

Në qoftë se si rrjedhim i rrethanave të paparashikuara, kanë ndodhur rritje ose ulje të kostos së materialeve ose të krahut të punës, që përcaktojnë një rritje ose një zbritje në një masë më të madhe se një e dhjeta e çmimit të përgjithshëm të caktuar, sipërmarrësi ose porositësi mund të kërkojnë rishikimin e çmimit. Ky rishikim mund të caktohet vetëm për masën e diferencës që tejkalon një të dhjetën. Kur gjatë punimeve hasen vështirësi të karakterit gjeologjik, hidrik dhe të tjera të ngjashme me to, të paparashikuara nga palët, të cilat e bëjnë mjaft më të vështirë detyrën e sipërmarrësit, ky ka të drejtë për një kompensim të përshtatshëm.

Neni 863

Porositësi, përpara se të marrë në dorëzim veprën e mbaruar, ka të drejtë ta kontrollojë atë.

Kontrolli duhet të kryhet nga porositësi, sapo sipërmarrësi të krijojë kushtet e duhura për kontrollin. Në qoftë se, me gjithë ftesën e bërë prej sipërmarrësit, porositësi nuk e kryen kontrollin pa patur arsye të bazuara, ose kur nuk njofton rezultatin e kontrollit brenda një afati të shkurtër, vepra konsiderohet e pranuar.

Në qoftë se porositësi merr në dorëzim veprën pa paraqitur ndonjë rezervë, ajo konsiderohet e pranuar edhe pse nuk është kryer kontrolli.

Sipërmarrësi ka të drejtë të kërkojë të paguhet me vleftën e caktuar kur vepra pranohet nga porositësi, përveç kur ka marrëveshje të kundërt.

Garancia dhe denoncimi i të metave të veprës

Neni 864

Sipërmarrësi detyrohet të japë garanci për deformimet dhe veset e veprës. Garancia nuk kërkohet kur porositësi e ka pranuar veprën dhe deformimet ose veset njiheshin prej tij ose ishin të dallueshme, përveç kur ato janë fshehur me keqbesim nga sipërmarrësi.

Porositësi duhet t'i njoftojë sipërmarrësit deformimet ose veset brenda 60 ditëve nga zbulimi i tyre me kusht dekadence, që sjell humbjen e kësaj të drejte. Njoftimi nuk është i domosdoshëm kur sipërmarrësi i ka njohur e pranuar deformimet dhe veset ose kur i ka fshehur ato.

Padia kundër sipërmarrësit parashkruhet brenda dy vjetëve nga data e dorëzimit të veprës. Porositësi i paditur për pagim mund të zbatojë gjithmonë garancinë, me kusht që deformimet dhe veset të njoftohen brenda 60 ditëve nga data e zbulimit dhe para se të kenë kaluar dy vjet nga data e dorëzimit.

Neni 865

Porositësi mund të kërkojë që deformimet ose veset të eliminohen me shpenzimet e sipërmarrësit, ose që çmimi të zbritet përpjesëtimisht, duke ruajtur të drejtën e shpërblimit të dëmit në rast se sipërmarrësi ka faj.

Por, në qoftë se deformimi ose cenet e veprës janë të tilla sa e bëjnë atë krejt të papërshtatshme për destinimin e saj, porositësi mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës.

Neni 866

Kur sipërmarrja ka për objekt ndërtesa ose sende të tjera të paluajtshme të cilat, për nga natyra e tyre, kanë destinim afatgjatë, po qe se, gjatë një periudhe prej dhjetë vjetësh nga përfundimi, vepra, për shkak të tokës ose për defekt të ndërtimit, shembet tërësisht ose pjesërisht, ose paraqet rrezik të dukshëm shembjeje ose defekte të tjera të rënda, sipërmarrësi përgjigjet kundrejt porositësit dhe palëve që fitojnë të drejta prej tij, me kusht që denoncimi i tyre të bëhet brenda një viti nga zbulimi.

E drejta e porositësit parashkruhet brenda një viti nga kallëzimi.

Neni 867

Sipërmarrësi, për të ushtruar të drejtën e padisë së kthimit kundrejt nënsipërmarrësve, duhet që t'i njoftojë ata për denoncimin brenda gjashtëdhjetë ditëve nga marrja dijeni me kusht dekadence, që sjell humbjen e kësaj të drejte.

Zgjidhja e kontratës dhe pasojat juridike

Neni 868

Porositësi mund të tërhiqet nga kontrata, edhe kur ka filluar zbatimin e veprës ose kryerja e shërbimit, me kusht që ta kompensojë sipërmarrësin për shpenzimet e kryera, për punimet e bëra dhe për fitimin e munguar.

Neni 869

Kur kontrata zgjidhet sepse zbatimin e veprës është bërë i pamundur si pasojë e një shkakut që nuk mund t'i atribuohet asnjërës palë, porositësi paguan pjesën e veprës së kryer në kufijtë brenda të cilëve është e dobishme për të, në përpjesëtim me çmimin e caktuar për të gjithë veprën.

Neni 870

Kur materiali që i është dhënë sipërmarrësit nga porositësi, ose kur vepra e përgatitur me këtë material humbet ose dëmtohet, si dhe kur përfundimi i veprës bëhet i pamundshëm pa fajin e asnjërit prej tyre, por në çdo rast pasi sipërmarrësi të jetë në vonesë për dorëzimin e veprës, ky është i detyruar t'i shpërblejë porositësit vleftën e materialit dhe nuk ka të drejtë të kërkojë prej tij që t'i paguajë punën e kryer.

Neni 871

Kur vepra e përgatitur me material të sipërmarrësit humbet ose dëmtohet, si dhe kur përfundimi i saj bëhet i pamundshëm para se të ketë mbaruar afati për dorëzimin e veprës, por në çdo rast pa fajin e asnjërit prej tyre, sipërmarrësi nuk ka të drejtë t'i kërkojë porositësit që t'i paguajë vleftën e materialit dhe punën e kryer.

Neni 872

Kur vepra e përgatitur me material të sipërmarrësit humbet ose dëmtohet, si dhe kur përfundimi i saj bëhet i pamundshëm pa fajin e sipërmarrësit ose të porositësit, por pasi porositësi është në vonesë për marrjen e veprës në dorëzim, ky detyrohet t'i paguajë sipërmarrësit vleftën e materialit dhe punën e kryer.

Neni 873

Kontrata e sipërmarrjes nuk zgjidhet me vdekjen e sipërmarrësit, përveç kur personi i sipërmarrësit konsiderohej i domosdoshëm për kryerjen e veprës. Porositësi mundet gjithmonë të tërhiqet nga kontrata, po qe se trashëgimtarëve të sipërmarrësit, nuk mund t'u besohet për kryerjen e mirë të veprës ose të shërbimit.

Neni 874

Në rastin e zgjidhjes së kontratës për shkak të vdekjes së sipërmarrësit, porositësi detyrohet t'u paguajë trashëgimtarëve vleftën e veprës së kryer, duke u mbështetur në çmimin e caktuar, si dhe shpenzimet e kryera për ekzekutimin e pjesës së mbetur, por vetëm brenda kufijve në të cilët vepra e kryer dhe shpenzimet e bëra janë të dobishme për të.

Porositësi ka të drejtë të kërkojë dorëzimin, kundrejt një kompensimi të përshtatshëm, të vleftës së materialeve të përgatitura dhe planeve në zbatim e sipër, për aq sa lejojnë normat për mbrojtjen e shpikjeve dhe të pronësisë intelektuale.

Neni 875

Personat të cilët, duke qenë në varësi të sipërmarrësit, kanë ushtruar veprimtarinë e tyre për zbatimin e veprës ose kryerjen e shërbimit, mund të ngrenë padi drejtpërdrejt kundër porositësit për të marrë atë çka u takon deri në plotësimin e detyrës që porositësi ka ndaj sipërmarrësit në kohën kur ata ngrenë padinë.

Dispozitë referuese

Neni 876

Kur sipërmarrja ka për objekt kryerje shërbimesh të vazhdueshme ose periodike, zbatohen, për aq sa janë të pajtueshme, normat e këtij titulli dhe ato lidhur me kontratën e furnizimit.

KREU VIII TRANSPORTI

A. Transporti i personave

Neni 877

Me kontratën e transportit të personave, transportuesi merr përsipër të transportojë persona nga njëri vend në një vend tjetër.

Neni 878

Përveç përgjegjesisë për vonesën dhe për mospërmbushjen në kryerjen e transportit, transportuesi përgjigjet për fatkeqësitë që godasin personin udhëtar gjatë udhëtimit dhe për humbjen ose për dëmtimin e sendeve që udhëtari merr me vete, në qoftë se nuk provon se ka marrë të gjitha masat e përshtatshme për shmangien e dëmit, dhe në lidhje me rrethanat e posaçme të rastit.

Janë të pavlefshme kushtet që kufizojnë përgjegjësinë e transportuesit për rreziqet që godasin udhëtarin.

Kjo dispozitë zbatohet edhe në kontratat e transportit falas.

Neni 879

Në transportin me itinerare që lidhen njëri me tjetrin, çdo transportues përgjigjet për udhëtimin e vet.

Megjithatë, dëmi për vonesën ose për ndërprerjen e udhëtimit llogaritet duke patur parasysh të gjithë rrugën.

B. Transporti i sendeve

Neni 880

Me kontratën e transportit të sendeve, transportuesi merr përsipër të transportojë sende nga një vend në një vend tjetër.

Neni 881

Transportuesi duhet t'i vërë sendet e transportuara në dispozicion të marrësit në vendin, në afatin dhe nëpërmjet mënyrave të treguara në kontratë.

Në qoftë se dorëzimi nuk duhet të kryhet pranë marrësit, transportuesi duhet ta njoftojë atë menjëherë për mbërritjen e sendeve të transportuara.

Në qoftë se nga dërguesi është lëshuar një fletë shoqërimi, transportuesi duhet t'ia tregojë atë marrësit.

Neni 882

Dërguesi duhet t'ia tregojë transportuesit me saktësi emrin e marrësit dhe vendin e destinimit, llojin, peshën, sasinë dhe numrin e sendeve për t'u transportuar dhe të dhëna të tjera të nevojshme për kryerjen e transportit.

Në qoftë se për kryerjen e transportit nevojiten dokumente të posaçme, dërguesi duhet t'ia japë ato transportuesit në momentin kur dorëzon sendet për t'u transportuar.

Janë në ngarkim të dërguesit dëmet që rrjedhin nga mungesa ose pasaktësia e të dhënave ose nga mosdorëzimi apo parregullsia e dokumenteve.

Neni 883

Me kërkesën e transportuesit, dorëzuesi lëshon një fletë shoqërimi me nënshkrimin e vet, e cila përmban emrin e vet, vendqëndrimin ose qendrën e punës, vendin dhe datën e lëshimit, të dhënat e paraqitura në nenin e mësipërm dhe kushtet e caktuara për transportin.

Kur fletëshoqërimi jepet në disa kopje, numri i kopjeve duhet të tregohet në çdo ekzemplar. Kopjet e mbetura humbasin vlerën pasi sendet i dorëzohen mbajtësit të titullit.

Këto të dhëna janë të besueshme, derisa të mos jetë provuar e kundërta kundrejt transportuesit, i cili ka për detyrë t'i verifikojë ato, duke zbatuar përkujdesjen profesionale.

Me kërkesën e dërguesit, transportuesi lëshon një dublikatë të fletës të shoqërimit me nënshkrimin e vet ose, në qoftë se nuk i është lëshuar fleta e shoqërimit, një fletëmarrje në dorëzim, që të përmbajë të njëjtat të dhëna.

Neni 884

Kontrata e transportit quhet e lidhur nga çasti që është bërë dokumenti i transportimit dhe dërguesi i mallrave ka bërë pagesën e transportimit, përveç kur në kontratë ose në ligj parashikohet ndryshe.

Neni 885

Në qoftë se fillimi ose vazhdimi i transportit pengohet ose vonohen së tepërmi për shkaqe që nuk mund t'i ngarkohen transportuesit, ky menjëherë duhet t'i kërkojë udhëzime dërguesit, duke marrë masa për ruajtjen e sendeve që i janë dorëzuar atij.

Transportuesi ruan të drejtën e ripagimit të shpenzimeve.

Në qoftë se transporti ka filluar, ai ka të drejta edhe për pagimin e çmimit në përpjesëtim me rrugën që ka kryer, përveç rastit kur ndërprerja e transportit ka ndodhur për shkak të humbjes së plotë të sendeve si pasojë e rastit faktor.

Po qe se rrethanat e bëjnë të pamundur marrjen e udhëzimeve nga dërguesi, ose në qoftë se udhëzimet nuk janë të zbatueshme, transportuesi mund t'i depozitojë sendet ose, po qe se rrezikohen të dëmtohen, ose përbëjnë një rrezik të konsiderueshëm për sigurinë e vendeve ku janë ruajtur, ai mund të marrë masa për shitjen e tyre me çmimin më të mirë.

Transportuesi duhet të njoftojë menjëherë dërguesin për depozitimin ose shitjen.

Rregullat e mësipërme zbatohen edhe në rastin kur pritësi nuk gjendet ose refuzon apo vonon të kërkojë marrjen në dorëzim të sendeve, edhe në rastin kur lind mosmarrëveshje midis disa marrësve ose për të drejtën e marrësit për marrjen në dorëzim apo për ekzekutimin e saj.

Neni 886

Dërguesi mund të pezullojë transportimin dhe të kërkojë kthimin e sendeve, ose të urdhërojë dorëzimin tek një marrës tjetër i ndryshëm nga ai i treguar në fillim ose mund të vendosë ndryshe, gjithmonë duke ruajtur detyrimin për të riparuar shpenzimet dhe për të shpërblyer dëmet që rrjedhin nga urdhri i dytë.

Kur nga ana e transportuesit i është lëshuar dërguesit një dublikatë e fletës së shoqërimit ose e fletë ngarkesës, dorëzuesi nuk mund të disponojë sendet e dorëzuara për transport po qe se nuk i paraqet transportuesit dublikatën ose faturën për të treguar të dhënat e reja. Këto duhet të nënshkruhen edhe nga transportuesi.

Dërguesi nuk mund të disponojë sende të transportuara qysh prej momentit kur ato kanë kaluar në dispozicion të pritësit.

Neni 887

Të drejtat që rrjedhin nga kontrata e transportit ndaj transportuesit i kalojnë pritësit nga momenti kur, pasi sendet kanë mbërritur në destinacion ose ka skaduar afati në të cilin duhet të kishin mbërritur. Pritësi kërkon marrjen në dorëzim nga transportuesi, pritësi nuk mund të ushtrojë të drejtat që lindin nga kontrata, përveç se duke i paguar transportuesit kreditë që rrjedhin nga transporti dhe faturat që shoqërojnë sendet e transportuara. Kur ka mosmarrëveshje për shumën e detyruar, marrësi duhet të depozitohet diferencën e vënë në dyshim pranë një të treti.

Neni 888

Transportuesi që i dorëzon pritësit sendet pa mbledhur kreditë e veta ose faturat që shoqërojnë sendet e transportuara, ose pa kërkuar depozitimin e shumës së diskutueshme, është përgjegjës ndaj dërguesit për vleftën që i detyrohet atij dhe nuk mund t'i kërkojë këtij të fundit pagimin e kredive të veta. Megjithatë e drejta për të paditur pritësin nuk cenohet.

Përgjegjësia për humbjen ose dëmtimin e sendeve gjatë transportimit

Neni 889

Transportuesi është përgjegjës për humbjen dhe dëmtimin e sendeve të dorëzuara atij qysh nga momenti kur i merr, deri në momentin kur ia dorëzon pritësit, po qe se nuk provon që humbja ose dëmtimi janë pasojë e rastit faktor, e veprimit të dërguesit, të pritësit ose të pronarit të sendeve të dërguara, nga frot ose nga lloji e nga veset e vetë sendeve.

Në qoftë se transportuesi i pranon sendet për transportim pa rezervë, prezumohet se sendet nuk paraqesin të meta të dukshme ambalazhi.

Transportuesi, me kërkesën e pritësit, detyrohet të mbajë procesverbal për humbjen ose dëmtimin e sendeve të dorëzuara për transportim.

Neni 890

Transportuesi duhet të njoftojë pritësin pa vonesë dhe përpara dorëzimit të sendeve, për dëmet që sendet mund të kenë pësuar.

Neni 891

Në qoftë se sendet kanë humbur ose janë dëmtuar, dëmi llogaritet, përveç marrëveshjes së kundërt, sipas çmimit të tyre në kohën e ngarkimit nga ana e transportuesit. Po qe se sendet dëmtohen, transportuesi duhet të shpërblejë dëmin në masën e diferencës midis vleftës së sendeve në momentin e ngarkimit dhe vleftës në momentin e dorëzimit.

Neni 892

Pritësi ka të drejtë të sigurohet, me shpenzimet e veta, përpara marrjes në dorëzim, për identitetin dhe gjendjen e sendeve të transportuara.

Neni 893

Marrja në dorëzim pa rezervë e sendeve të transportuara duke paguar transportuesin për aq sa i takon, heq mundësinë për ngritje të padisë që rrjedh nga kontrata, përveç rastit të mashtrimit ose të pakujdesisë së rëndë të transportuesit. Nuk cenohen të drejtat për të kërkuar humbjen e pjeshme ose për dëmtime të tilla që nuk mund të dallohen në momentin e marrjes në dorëzim, me kusht që transportuesi të njoftohet menjëherë sa të zbulohet dëmi dhe jo më vonë se 20 ditë nga data e marrjes në dorëzim.

Neni 894

Kur transportuesi detyrohet t'i përcjellë sendet e transportuara përtej linjave të tij, nëpërmjet transportuesish të tjerë, pa marrë nga dorëzuesi një fletë shoqërimi të drejtpërdrejtë për në vendin e destinimit, prezumohet që ai merr, për transportin përtej linjave të veta, detyrimet e një spedicioneri.

Transportimi i kryer nga disa transportues

Neni 895

Në transportin e sendeve që kryhet bashkërisht nga disa transportues të njëpasnjëshëm me një kontratë të vetme, transportuesit përgjigjen solidarisht për përmbushjen e kontratës nga vendi fillestar i nisjes deri në vendin e destinimit.

Transportuesi që paditet për një veprim për të cilin nuk ka përgjegjësi, ka të drejtën e padisë kundrejt transportuesve të tjerë, qoftë veç e veç, qoftë bashkërisht. Po qe se del se veprimi që ka sjellë dëmtimin ka ndodhur në rrugën e njërit prej transportuesve, ky detyrohet të bëjë shpërblimin e plotë të dëmit; në rast të kundërt, detyrohen të shpërblejnë transportuesit përpjesëtimisht me rrugët e tyre, duke përjashtuar ata transportues që provojnë se dëmi nuk ka ndodhur në rrugën e vet.

Neni 896

Transportuesit e njëpasnjëshëm kanë të drejtë të deklarojnë, në fletëshoqërimin ose në një akt të veçantë, gjendjen e sendeve për t'u transportuar në momentin kur u janë dorëzuar atyre. Në mungesë të deklaratës, prezumohet se i kanë marrë në gjendje të mirë dhe në përputhje me fletë shoqërimin.

Përgjegjësia e dërguesit dhe e transportuesit për vonesën

Neni 897

Kur dorëzimi i sendeve për transportim ose dorëzimi i sendeve pritësit nuk bëhet në afatet e caktuara në kontratë, pala që është në vonesë shpërblen dëmin përkatës.

Neni 898

Kreditë që rrjedhin nga transporti kanë privilegj mbi sendet e transportuara deri sa këto të mbeten pranë transportuesit. Transportuesi mund të mbajë sendin që i nënshtrohet privilegjit deri sa të shpërblehet kredia e tij dhe mundet edhe ta shesë sipas rregullave të caktuara për shitjen e pengut.

Përgjegjësia e transportuesit të fundit

Neni 899

Transportuesi i fundit përfaqëson transportuesit e mëparshëm për mbledhjen e kredive përkatëse që lindin nga kontrata e transportit dhe për ushtrimin e privilegjit mbi sendet e transportuara. Në qoftë se ai nuk i mbledh kreditë ose nuk ushtron privilegjin, përgjigjet para kreditorëve paraardhës për shumat e detyruara, përveç të drejtës së padisë kundrejt pritësit.

Dispozitë referuese

Neni 900

Për transportimet me rrugë ujore, ajrore dhe për ato hekurudhore e postare, kur mungon legjislacioni i posaçëm, zbatohen dispozitat e kësaj kontrate.

KREU IX HUAPËRDORJA

Neni 901

Me kontratën e huapërdorjes, njëra palë (huadhënësi) i jep palës tjetër (huamarrësit), pa kundërshtëpërblim, një send të caktuar që ta përdorë përkohësisht dhe kjo palë detyrohet ta kthejë atë send në afatin e caktuar në kontratë. Kur nuk është caktuar afat, sendi kthehet me kërkesën e Palës që ka dhënë sendin.

Neni 902

Kontrata e huapërdorjes quhet e lidhur nga çasti që është dorëzuar sendi.

Neni 903

Huamarrësi detyrohet ta mbajë dhe ta ruajë sendin me përkujdesje. Ai nuk mund ta përdorë atë ndryshe nga përdorimi i caktuar në kontratë ose nga natyra e sendit. Huamarrësi nuk mund t'ia japë një të treti sendin për përdorim pa pëlqimin e huadhënësit. Kur huamarrësi nuk përmbush detyrimet e lartpërmendura huadhënësi mund të kërkojë kthimin e menjëhershëm të sendit, përveç shpërblimit të dëmit.

Neni 904

Huamarrësi është përgjegjës për humbjen ose dëmtimin e sendit, përveç kur provon se humbja ose dëmtimi i sendit do të kishte ndodhur edhe në rast se do të ishte dhënë në huapërdorje.

Neni 905

Në qoftë se huamarrësi e përdor sendin ndryshe nga sa është caktuar në kontratë ose nga natyra e tij dhe për një kohë më të gjatë se sa duhej, përgjigjet për humbjen e ndodhur edhe nga rasti faktor, përveç kur provon se sendi do të humbiste njëllë, si të mos përdorej ndryshe, si të ishte kthyer në kohën e caktuar në kontratë.

Neni 906

Huamarrësi nuk mund të kërkojë pagimin e shpenzimeve që ka bërë për të përdorur sendin.

Neni 907

Në qoftë se gjatë afatit të caktuar, ose përpara se huamarrësi të ketë pushuar së përdoruri sendin sipas kontratës, huadhënësi ndodhet përpara një nevojë të ngutshme dhe të paparashikuar të sendit, ai mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës dhe kthimin e menjëhershëm të sendit.

Neni 908

Në rast vdekjeje të huamarrësit, huadhënësi, edhe po të jetë caktuar një afat, mund të kërkojë nga trashëgimtarët kthimin e menjëhershëm të sendit.

Neni 909

Huamarrësi është i detyruar të bëjë me shpenzimet e tij ndreqjet e zakonshme të sendit të dhënë në huapërdorje, përveç kur në kontratë është parashikuar ndryshe, ndërsa ndreqjet e tjera bëhen nga huadhënësi.

Neni 910

Po qe se gjatë huapërdorjes huamarrësi është detyruar, për të ruajtur sendin, që të kryejë shpenzime të jashtëzakonshme, të nevojshme dhe të ngutshme dhe se për këto nuk ka patur mundësi të njoftonte huadhënësin, ky duhet t'ia paguajë huamarrësit.

Neni 911

Po qe se sendi i huapërdorur ka patur të meta të tilla që dëmtojnë atë që e përdor, huadhënësi detyrohet të shpërblejë dëmin sa kohë që, duke i ditur të metat e sendit, nuk ka njoftuar huamarrësin.

Neni 912

Kur mbaron afati i kontratës së huapërdorjes, ose kur kontrata zgjidhet para këtij afati, huamarrësi është i detyruar t'i kthejë huadhënësit sendin po në atë gjendje në të cilën e mori me

ndryshimet e zakonshme të shkaktuara nga përdorimi i tij, ose në gjendjen e parashikuar në kontratë. Gjersa nuk provohet e kundërta prezumohet se sendi është marrë në gjendje të mirë.

KREU X
POROSIA
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 913

Porosia është një kontratë me të cilën njëra palë detyrohet të kryejë një ose më shumë veprime juridike për llogari të palës tjetër.

Neni 914

Në qoftë se të porositurit i është dhënë kompetenca për të vepruar në emër të porositesit, zbatohen dispozitat mbi përfaqësimin.

Neni 915

I porosituri që vepron në emrin e vet fiton të drejta dhe merr përsipër detyrime që rrjedhin nga veprimet e kryera me të tretët, edhe po qe se këta kanë patur dijeni për porosinë.

Të tretët nuk kanë asnjë lidhje me porositesin. Megjithatë porositesit, duke zënë vendin e të porositurit, mund të ushtrojë të drejtat e kredisë që rrjedhin nga zbatimi i porosisë, përveç kur mund të cenojë të drejtat që gëzon i porosituri në bazë të dispozitave të mëposhtme.

Neni 916

I porosituri është i detyruar të kryejë punët ose veprimet juridike që i janë ngarkuar sipas udhëzimeve të porositesit. Ai mund të largohet nga këto udhëzime vetëm kur kjo është e domosdoshme për të mbrojtur interesat e porositesit dhe nuk ka mundësi që të merret vesh më parë me të.

Neni 917

Porosia përfshin jo vetëm veprimet për të cilat është dhënë, por edhe ato akte që janë të domosdoshme për kryerjen e tyre.

Porosia e përgjithshme nuk përfshin aktet që tejkalojnë administrimin e zakonshëm të punës, po qe se nuk cilësohen shprehimisht.

Neni 918

Porositesit mund të rivendikojë sendet e luajtshme të fituara për llogari të vet nga i porosituri që ka vepruar në emrin e vet, pa cenuar të drejtat e fituara nga të tretët për efektet e posedimit me mirëbesim.

Po qe se sendet e fituara nga i porosituri janë pasuri e paluajtshme ose pasuri e luajtshme të regjistruara në regjistrat publikë, i porosituri është i detyruar t'ia rikthejë porositesit.

Neni 919

Kreditorët e palës së porositur nuk mund të ushtrojnë të drejtat e tyre mbi sendet që gjatë ekzekutimit të porosisë, i porosituri i ka vetësuar me emrin e vet, me kusht që kur është fjala për pasuri të luajtshme ose për kredi, porosia të vërtetohet nga një provë me shkrim që përmban datë të saktë përpara vënies dorë ose, kur është fjala për pasuri të paluajtshme ose për pasuri të luajtshme të regjistruara në regjistrat publikë, regjistrimi i aktit të rikthimit ose i kërkesës gjyqësore që synon të përfitojë kthimin e përmendur të përmbajë një datë përpara vehtësimit.

Neni 920

Porosia prezumohet se është me shpërblim. Masa e shpërblimit, kur nuk caktohet nga palët, përcaktohet në bazë të tarifave profesionale ose zakonit dhe në mungesë të tyre nga gjykata.

Neni 921

I porosituri detyrohet të zbatojë porosinë me besnikëri dhe përkujdesje. Ai duhet t'i bëjë të ditur porositësit rrethanat e krijuara që mund të sjellin revokimin e saj.

I porosituri detyrohet gjithashtu që të zbatojë porosinë personalisht, përveç rastit kur është autorizuar t'ia kalojë një të treti, kur është i detyruar nga rrethanat, ose në mbrojtje të interesave të porositësit.

Neni 922

I porosituri duhet të marrë masa për ruajtjen e sendeve që janë dërguar për llogari të porositësit dhe të mbrojë të drejtat e këtij të fundit kundrejt transportuesit, po qe se sendet paraqesin shenja dëmtimi ose kur kanë mbërritur me vonesë.

Neni 923

Porositësi, përveç se kur me marrëveshje është parashikuar ndryshe, detyrohet të furnizojë të porositurin me mjetet e nevojshme për kryerjen e porosisë dhe për përmbushjen e detyrimeve që me atë synim i porosituri i ka marrë përsipër në emrin e vet.

Neni 924

I porosituri është i detyruar t'i japë porositësit, kur ky i kërkon, të gjitha informatat që kanë lidhje me kryerjen e porosisë, së bashku me dokumentet justifikuese, t'i japë atij llogari posa të ketë kryer porosinë, si dhe t'i kthejë atij çdo gjë që ka marrë për shkak të kryerjes së porosisë.

Neni 925

Porositësi duhet të paguajë të porositurin për parapagesat, së bashku me kamatat ligjore qysh nga dita kur janë kryer si dhe t'i paguajë shpërblimin që i takon.

Porositësi duhet gjithashtu të shpërblejë dëmet që i porosituri ka pësuar për shkak të detyrës.

Neni 926

Kreditë në para të rrjedhura nga punët e veprimet që i porosituri ka kryer, kanë përparësi ndaj porositësit dhe ndaj kreditorëve të tij.

Shuarja e porosisë

Neni 927

Porosia shuhet me vdekjen, pazotësinë për të vepruar ose falimentimin e porositësit ose të të porositurit, përveç marrëveshjes tjetër ose kur rezulton ndryshe nga natyra e rrethanave të krijuara. Megjithatë, kur shuarja e porosisë mund të cenojë interesat e porositësit, i porosituri, trashëgimtarët ose përfaqësuesit detyrohen të vazhdojnë administrimin deri kur porositësi, trashëgimtarët e tij ose përfaqësuesit e vet, të jenë në gjendje të merren vetë drejtpërdrejt me çështjen.

Heqja dorë nga porosia dhe efektet juridike

Neni 928

I porosituri mund të heqë dorë nga kontrata por, po qe se në marrëveshje është parashikuar e kundërta, ai përgjigjet për dëmet, përveç kur heqja dorë bëhet për një shkak të drejtë.

Porosia e dhënë në interes të të porositurit ose të tretëve nuk shuhet me revokim nga ana e porositësit, përveç kur është vendosur ndryshe në kontratë ose ajo bëhet për një shkak të drejtë, por nuk shuhet për shkak të vdekjes ose për pazotësinë për të vepruar që i ndodh porositësit.

Neni 929

Emërimi i një të porosituri të ri për të njëjtën marrëveshje ose kryerja e kësaj nga ana e porositësit sjell heqjen e porosisë, dhe ka efekt qysh nga dita kur i janë njoftuar të porositurit.

Neni 930

Heqja dorë nga porosia me shpërblim dhe për një kohë të caktuar ose për një punë të caktuar, detyron porositësin të shpërblejë dëmet, po qe se është bërë përpara mbarimit të afatit apo të kryerjes së punës, përveç kur ekziston një shkak i drejtë.

Kur porosia është me afat të pacaktuar, heqja dorë detyron porositësin për shpërblimin e dëmit, po qe se nuk është bërë një njoftim paraprak në kohën e përshtatshme, përveç rastit kur ka një shkak të drejtë për revokim.

Neni 931

I porosituri që heq dorë nga porosia pa ndonjë shkak të drejtë duhet t'i shpërblejë dëmet porositësit. Kur porosia është me afat të pacaktuar, i porosituri që heq dorë pa ndonjë shkak të drejtë detyrohet të shpërblejë dëmin po qe se nuk ka bërë një njoftim paraprak në kohën e përshtatshme.

Në çdo rast, heqja dorë duhet bërë në një mënyrë dhe në një kohë të tillë që porositësi të marrë masa për të vepruar ndryshe, përveç rastit të një vështirësie të madhe nga ana e të porositurit.

Neni 932

Në qoftë se porosia është dhënë nga disa persona me një akt të vetëm dhe për një çështje me interes të përbashkët, heqja dorë nuk ka efekt kur nuk është bërë nga të gjithë të porositurit, përveç rastit kur ka një shkak të drejtë për heqjen dorë.

Neni 933

Aktet që i porosituri ka kryer përpara se të marrë vesh shuarjen e porosisë janë të vlefshme kundrejt porositësit dhe trashëgimtarëve të tij.

Neni 934

Porosia e dhënë disa personave që mendohet të punojnë bashkërisht shuhet edhe po qe se shkak i shuarjes ka të bëjë vetëm me njërin prej të porositurve, përveç kur në marrëveshje është parashikuar ndryshe.

KREU XI KOMISIONI

Përmbajtja

Neni 935

Kontrata e komisionit është një porosi që ka për objekt blerjen dhe shitjen e sendeve për llogari të porositësit dhe në emër të komisionerit.

Të drejta e detyrime të palëve

Neni 936

Porositësi është i detyruar t'i paguajë komisionerit të gjitha shpenzimet që ka bërë për kryerjen e porosisë dhe shpërblimin që parashikohet në kontratën e komisionit, si dhe ta shkarkojë nga çdo detyrim që komisioneri ka marrë ndaj të tjerëve për kryerjen e komisionit.

Neni 937

Komisioneri presumohet se është i autorizuar që të lejojë vonesa në pagim, në përputhje me zakonet e vendit ku kryen veprimin, në qoftë se kur porositësi nuk ka vendosur ndryshe.

Në qoftë se i porosituri lejon vonesa në pagim, pavarësisht nga ndalimi i porositësit ose nga zakoni i vendit, porositësi mund të kërkojë nga ai pagimin e menjëhershëm, përveç të drejtës së komisionerit për të përfituar avantazhet e ardhura nga vonesa në pagim.

Komisioneri që ka lejuar vonesën në pagim duhet t'i tregojë porositësit se cila ishte pala e kontraktuar dhe afati i dhënë, përndryshe veprimi quhet se është kryer pa u lejuar vonesë dhe zbatohet paragrafi i mësipërm.

Neni 938

Komisioneri nuk përgjigjet për ekzekutimin nga ana e personit të tretë të kontratës së lidhur nga komisioneri me të, për llogari të porositësit, përveç kur në kontratën e komisionit parashikohet ndryshe.

Neni 939

Kur komisioneri ka kryer veprimin juridik në kushte më të dobishme nga ato të udhëzimeve që i kishte dhënë porositësi, gjithçka që komisioneri ka fituar në këtë rast kalon në dobi të porositësit.

Neni 940

Komisioneri ka të drejtë të largohet nga udhëzimet që i ka dhënë porositësi vetëm kur, për shkak të ndryshimit të rrethanave, një largim i tillë bëhet i nevojshëm për interesat e porositësit, dhe komisioneri nuk mund të merret vesh më parë me porositësin ose, kur, megjithëse e ka pyetur, nuk ka marrë përgjigje në kohën e duhur.

Neni 941

Komisioneri është i detyruar të lidhë kontratë sigurimi për sendet e porositësit që ndodhen pranë tij, vetëm po të jetë parashikuar në kontratën e komisionit, ose po të jetë sigurimi i detyrueshëm në bazë të ligjit.

Neni 942

Porositësi mund të ndryshojë radhën e përfundimit të marrëveshjes sa kohë që komisioneri nuk e ka përfunduar. Në këtë rast i takon komisionerit një pjesë e shpërblimit për ndërmjetësim që përcaktohet duke u mbajtur parasysh shpenzimet e kryera dhe puna e bërë.

Neni 943

Në komisionin për shitjen dhe blerjen e mallrave, titujve, valutave dhe vlerave të tjera që kanë një çmim liste ose një çmim të caktuar nga organet shtetërore, po qe se porositësi nuk ka vendosur ndryshe, komisioneri mund të përfshijë në të njëjtin çmim, të fiksuar në momentin e ekzekutimit të porosisë, sendet që duhet të blejë, ose të blejë për vetë sendet që duhet të shesë, duke ruajtur të drejtën për shpërblimin për ndërmjetësim.

Dispozitë referuese

Neni 944

Dispozitat mbi porosinë zbatohen edhe për komisionin gjersa nuk parashikohen ndryshe në këtë kre.

KREU XII
SPEDICIONI (DËRGESA)

Përmbajtja
Neni 945

Kontrata e spedicionit (dërgesës) është një porosi me të cilën spedicioneri merr përsipër detyrimin për të lidhur në emër dhe për llogari të porositësit, një kontratë transporti dhe për të kryer të gjitha veprimet ndihmëse.

Të drejta e detyrime të palëve
Neni 946

Deri sa spedicioneri nuk ka lidhur kontratën e transportit me transportuesin, dërguesi mund të revokojë urdhrin e dërgesës, duke i paguar spedicionerit shpenzimet e kryera dhe duke i dhënë atij një shpërblim të përshtatshëm për shërbimin e kryer.

Neni 947

Në zgjedhjen e rrugës, mjetit dhe mënyrave të transportit të mallit, spedicioneri detyrohet të zbatojë udhëzimet e porositësit dhe, në mungesë të tyre, të veprojë sipas interesit më të mirë të tij. Shpërblimet, zbritjet nga çmimi dhe përfitimet tarifore të realizuara nga spedicioneri duhet t'i kreditohen porositësit, përveç kur në marrëveshje parashikohet ndryshe.

Neni 948

Masa e shpërblimit që i takon spedicionerit për kryerjen e detyrës përcaktohet, kur nuk ka marrëveshje për të, sipas tarifave profesionale ose, kur këto mungojnë, sipas zakoneve të vendit ku kryhet dërgesa.

Parapagesat dhe kompensimet për shërbimet ndihmëse të kryera nga spedicioneri, likuidohen në bazë të dokumenteve justifikuese, veç në qoftë se ripagimi dhe kompensimet janë përcaktuar paraprakisht me një shumë të përgjithshme totale.

Neni 949

Spedicioneri, i cili me mjetet e veta ose të tjetërkujt, merr përsipër kryerjen e transportit tërësisht ose pjesërisht, ka të drejtat dhe detyrimet e transportuesit.

KREU XIII
AGJENCIA
(Ndryshuar krejtësisht kreu me ligjin nr. 121/2013, datë 18.4.2013)

Neni 950
Dispozita të përgjithshme

Me kontratën e agjencisë, njëra palë merr përsipër, në mënyrë të vazhdueshme dhe me shpërblim, që të lidhë kontratat në një zonë të caktuar, për llogari të palës tjetër.

Secila palë ka të drejtë të marrë nga pala tjetër një kopje të kontratës të nënshkruar prej saj.

Neni 951 **Ekskluziviteti**

Palë porositëse nuk mund të ketë njëkohësisht më shumë se një agjent në të njëjtën zonë apo për të njëjtin grup klientësh dhe për të njëjtën fushë të veprimtarisë.

Gjithashtu, agjenti nuk mund të trajtojë njëkohësisht, në të njëjtën zonë apo për të njëjtën grup klientësh dhe për të njëjtën fushë, kontratat e disa ndërmarrjeve në konkurrencë midis tyre.

Neni 952 **Të drejtat dhe detyrimet e palëve**

Agjenti tregtar, në ushtrimin e aktiviteteve të tij, duhet të kujdeset për interesat e porositësit dhe të veprojë me korrektësi dhe mirëbesim për të përmbushur detyrimet e tij. Agjenti tregtar duhet në veçanti:

- a) të përpiqet për të negociuar dhe, kur është rasti, të lidhë kontratat për të cilat është ngarkuar;
- b) t'i njoftojë porositësit çdo informacion të nevojshëm që ai disponon;

c) të zbatojë udhëzimet e arsyeshme të dhëna nga porositësi. Porositësi, në marrëdhëniet e tij me agjentin tregtar, duhet të veprojë me korrektësi dhe mirëbesim për të përmbushur detyrimet e tij. Porositësi duhet në veçanti:

a) të vërë në dispozicion të agjentit tregtar dokumentacionin e nevojshëm që ka të bëjë me kontratat në fjalë;

b) t'i sigurojë agjentit tregtar informacionet e nevojshme për përmbushjen e kontratës së agjencisë, veçanërisht të njoftojë agjentin tregtar në një afat kohor të arsyeshëm, sapo ai parashikon që volumi i kontratave do të jetë në mënyrë të dukshme më i ulët se ai, të cilin agjenti tregtar do të priste normalisht.

Porositësi, gjithashtu, duhet të informojë agjentin tregtar në një afat kohor të arsyeshëm, për pranimin, refuzimin ose mosekzekutimin e një kontrate që agjenti tregtar ka siguruar për porositësin.

Palët nuk mund të shmangen nga zbatimi i dispozitave të këtij neni.

Neni 953 **Shpërblimi i agjentit tregtar**

Në mungesë të ndonjë marrëveshjeje ndërmjet palëve mbi këtë çështje, agjenti tregtar ka të drejtën e shpërblimit që agjentët tregtarë, të caktuar për kontratat që formojnë objektin e kontratës së tij të agjencisë, përfitojnë zakonisht në vendin ku ai ushtron aktivitetin e tij. Nëse nuk ekziston një praktikë e tillë zakonore, agjenti tregtar duhet të ketë të drejtën për një shpërblim të arsyeshëm, duke patur parasysh të gjitha aspektet e kontratës.

Konsiderohen si shpërblim i agjentit të gjitha elementet e pagesës që përfiton ai dhe që ndryshojnë sipas numrit apo vlerës së veprimeve tregtare.

Në mungesë të zakoneve të tilla, agjenti tregtar ka të drejtën e një shpërblimi të arsyeshëm, që merr parasysh të gjitha elementet që kanë të bëjnë me veprimin.

Neni 954

Agjenti tregtar ka të drejtën e shpërblimit për kontratat e përfunduara gjatë periudhës së kontratës së agjencisë:

- a) nëse kontrata është përfunduar si rezultat i veprimit të tij;
- b) nëse kontrata është përfunduar me një të tretë, të cilin ai kishte fituar më parë si klient për kontrata të të njëjtit lloj;
- c) nëse ai ka një të drejtë ekskluzive për një zonë gjeografike të caktuar ose një grupi klientësh dhe kontrata është kryer me një klient që i përket kësaj zone dhe/ose këtij grupi.

Për një kontratë të përfunduar pas përfundimit të kontratës së agjencisë, agjenti tregtar ka të drejtën e shpërblimit:

a) nëse kontrata i detyrohet kryesisht përpjekjeve të tij të kryera gjatë kontratës së agjencisë, pavarësisht se kontratat janë përfunduar në një afat kohor të arsyeshëm, pas mbarimit të kontratës së agjencisë; ose

b) nëse porosia e një të treti ka qenë marrë nga porositësi ose nga agjenti tregtar para mbarimit të kontratës së agjencisë.

Agjenti tregtar nuk ka të drejtën e shpërblimit nëse ai i detyrohet agjentit tregtar paraardhës, përveç kur nuk rezulton nga rrethanat që është e drejtë që shpërblimi të ndahet mes agjentëve tregtarë.

Shpërblimi bëhet i pagueshëm në momentin dhe në masën kur paraqitet një nga rrethanat e mëposhtme:

- a) pala porositëse ka ekzekutuar kontratën;
- b) pala porositëse duhej të kishte ekzekutuar kontratën, në përputhje me marrëveshjen e lidhur me palën e tretë;
- c) pala e tretë ka ekzekutuar kontratën.

Shpërblimi merret më vonë kur një i tretë ka ekzekutuar pjesën e tij të kontratës apo do të duhej ta kishte ekzekutuar, nëse pala porositëse do të kishte ekzekutuar pjesën e tij të kontratës.

Shpërblimi paguhet jo më vonë se dita e fundit e muajit që vjen pas tremujorit, në të cilin bëhet i kërkueshëm.

Nuk mund të shmanget me marrëveshje zbatimi i kësaj dispozite në dëm të agjentit tregtar.

Neni 955

E drejta për shpërblim mund të shuhet vetëm në qoftë se dhe në masën në të cilën:

- a) vendoset se kontrata ndërmjet të tretit dhe porositësit nuk do të ekzekutohet; dhe
- b) mosekzekutimi nuk i detyrohet rrethanave që i ngarkohen porositësit.

Agjenti tregtar duhet të rikthejë shpërblimin që ka marrë nëse e drejta për marrjen e tij nuk ekziston më.

Nuk mund të shmanget me marrëveshje zbatimi i kësaj dispozite në dëm të agjentit tregtar.

Neni 956

Pala porositëse i dorëzon agjentit një ekstrakt llogarie të shpërblimeve që i takon këtij, jo më vonë se ditën e fundit të muajit që vjen pas tremujorit, në të cilin bëhet i pagueshëm. Ekstrakt llogaria duhet të tregojë elementet thelbësore, në bazë të të cilave është kryer përlllogaritja e shpërblimeve.

Agjenti ka të drejtë që t'i jepen të gjitha informacionet, në veçanti një ekstrakt i librave kontabël, që janë në dispozicion të porositësit, të nevojshme për të verifikuar shumën e shpërblimeve të paguara.

Nuk mund të shmanget me marrëveshje zbatimi i kësaj dispozite në dëm të agjentit tregtar.

Neni 957

Mbarimi dhe zgjidhja e kontratës së agjencisë

Kontrata e agjencisë me kohë të caktuar kur vazhdon të zbatohet nga palët edhe pas mbarimit të kohës, shndërrohet në kontratë me afat të pacaktuar. Nëse kontrata e agjencisë është me kohë të pacaktuar, secila nga palët mund të tërhiqet nga kjo kontratë, duke njoftuar paraprakisht palën tjetër brenda një afati të caktuar.

Afati i njoftimit paraprak nuk mund të jetë më i shkurtër se një muaj për vitin e parë të kohëzgjatjes së kontratës, dy muaj për vitin e dytë të filluar, tre muaj për vitin e tretë të filluar, 4 muaj për vitin e katërt, 5 muaj për vitin e pestë dhe 6 muaj për vitin e gjashtë dhe për të gjitha vitet në vazhdim. Nëse palët merren vesh për afate paralajmërimi më të gjata, afati i paralajmërimit që duhet të respektojë pala porositëse nuk duhet të jetë më i shkurtër se afati që duhet të respektojë agjenti. Përveç kur me marrëveshje është caktuar ndryshe nga palët, mbarimi i afatit të paralajmërimit duhet të përkojë me ditën e fundit të muajit kalendarik. Të njëjtat rregulla zbatohen dhe për kontratën e agjencisë me kohë të përcaktuar, të shndërruar në kontratë me kohë të papërcaktuar, me kushtin që në llogaritjen e afatit të paralajmërimit duhet të mbahet parasysh afati i mëparshëm.

Në mbarim të kontratës së agjencisë, porositësi detyrohet t'i paguajë agjentit një shpërblim në masën dhe nëse:

a) agjenti ka siguruar klientë të rinj për palën porositëse ose i ka zhvilluar dukshëm kontratat me klientët ekzistues dhe pala porositëse ka ende përfitime të konsiderueshme që rrjedhin nga kontratat me këta klientë;

b) pagesa e këtij shpërblimi është e drejtë, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat, sidomos shpërblimin që agjenti tregtar humbet dhe që rezultojnë nga veprimet me këta klientë, si dhe nga kufizimi i aktiviteteve të tij profesionale që i detyrohen ekzistencës së një klauzole të moskonkurrencës.

Shuma e shpërblimit nuk mund të tejkalojë një vlerë të barabartë me shpërblimin vjetor të llogaritur nga mesatarja vjetore e shpërblimeve të marra nga agjenti tregtar gjatë pesë viteve të fundit. Nëse kontrata përfshin një afat më të shkurtër se pesë vjet, shpërblimi llogaritet mbi mesataren e periudhës së kontratës. Përfitimi i shpërblimit nuk e përjashton agjentin nga e drejta për shpërblimin e mundshëm të dëmeve.

Agjenti tregtar ka të drejtë për shpërblimin e dëmit që ka pësuar si rezultat i përfundimit të marrëdhënieve me palën porositëse.

Ky dëm rezulton veçanërisht kur mbarimi i kontratës ka ndodhur në kushte:

a) të cilat shmangin agjentin tregtar nga shpërblimi që mund të kishte fituar me përmbushjen në mënyrën e duhur të kontratës, duke i siguruar në të njëjtën kohë porositësit përfitime të konsiderueshme të lidhura me veprimtarinë e agjentit tregtar; dhe/ ose

b) të cilat nuk i kanë mundësuar agjentit që të rimburojë kostot dhe shpenzimet që ka bërë për përmbushjen e kontratës, sipas udhëzimeve të porositësit.

E drejta për shpërblim lind, gjithashtu, edhe kur kontrata e agjencisë përfundon si rezultat i vdekjes së agjentit tregtar dhe mund të kërkohet nga trashëgimtarët e tij. Agjenti tregtar humbet të

drejtën për shpërblim nëse, brenda një viti nga mbarimi i kontratës, nuk i komunikon porositësit qëllimin për të mbrojtur të drejtat e tij.

Neni 958

Nuk paguhet shpërblim kur:

a) pala porositëse e zgjidh kontratën për shkak të një mospërmbushjeje që i atribuohet agjentit, e cila justifikon një zgjidhje të menjëhershme të kontratës;

b) agjenti zgjidh kontratën, përveç rastit kur përfundimi justifikohet nga rrethanat që i atribuohen porositësit, ose për shkak të moshës, paaftësisë ose sëmundjes së agjentit tregtar, për të cilat atij nuk mund t'i kërkohet, në mënyrë të arsyeshme, vazhdimi i veprimtarisë;

c) agjenti nuk përmbush personalisht të drejtat dhe detyrimet që ai ka në bazë të kontratës së agjencisë, por ia kalon ato një pale të tretë.

Neni 959

Palët nuk mund të shmangin, para mbarimit të kontratës, zbatimin e neneve 957 dhe 958 në dëm të agjentit tregtar.

Neni 960

Marrëveshja që parashikon një kufizim të aktiviteteve profesionale të agjentit tregtar pas përfundimit të kontratës quhet klauzolë e moskonkurrencës.

Marrëveshja e moskonkurrencës është e vlefshme kur bëhet me shkrim. Ajo duhet t'i përkasë një zone gjeografike ose grupi të klientëve, të besuar agjentit tregtar, si dhe llojin e kontratave, për të cilat agjenti tregtar kishte përfaqësimin, sipas kontratës së agjencisë.

Klauzola e moskonkurrencës është e vlefshme për një periudhë jo më shumë se 2 vjet nga dita e përfundimit të kontratës.

Neni 961

Marrëveshja e garancisë së nënshkruar nga agjenti

Një marrëveshje, me anë të së cilës agjenti garanton që një klient do të paguajë çmimin e mallrave që përbëjnë objektin e kontratës, të cilën e ka negociuar apo përfunduar ai, është e vlefshme vetëm nëse dhe për aq sa ajo është bërë me shkrim, mbulon vetëm kontratat e specifikuar shprehimisht në marrëveshje dhe është e arsyeshme për sa i përket interesave të palëve, sidomos për sa i përket shumës së shpërblimit që përfiton agjenti. Në çdo rast shuma e vendosur si garanci nuk mund të jetë më e madhe se shpërblimi që agjenti do të përfitonte prej kësaj kontrate.

KREU XIV
KALIMI I PASURISË KREDITORËVE
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 962

Kalimi i pasurisë është kontrata me të cilën debitori ngarkon kreditorët e vet ose disa prej tyre për të likuiduar të gjitha ose disa veprimtari të tij për t'i shpërndarë midis tyre fitimet e nxjerra në përmbushje të kredive të tyre.

Neni 963

Kalimi i pasurisë duhet bërë me shkrim, ndryshe është i pavlefshëm.

Në qoftë se midis pasurive të ceduara ka edhe kredi, atëherë zbatohen dispozitat e neneve 502 e 503 të këtij Kodi.

Neni 964

Administrimi i pasurisë së kaluar u takon kreditorëve përkatës. Ata mund të ngrejné padi për të gjitha çështjet pasurore që lidhen me atë pasuri, përfshirë edhe paditë për mbrojtjen e posedimit.

Neni 965

Debitori nuk mund të disponojë sendet e kaluara kreditorëve. Kreditorët, kreditë e të cilëve ekzistonin përpara kalimit të pasurisë dhe që nuk kanë ndërhyrë, mund të kërkojnë ekzekutimin mbi gjithë këtë pasuri.

Kreditorëve, që u ka kaluar pasuria, në rast se kalimi ka për objekt vetëm disa veprimtari të debitorit, nuk mund të kërkojnë ekzekutimin për veprimtari të tjera, para shlyerjes së atyre që janë lidhur me kalimin e pasurisë.

Të drejta e detyrime të palëve

Neni 966

Kreditorët që kanë lidhur kontratën ose kanë aderuar në të, duhet të parapaguajnë shpenzimet e nevojshme për likuidimin dhe kanë të drejtë të marrin shumën nga të ardhurat prej likuidimit.

Neni 967

Kreditorët duhet t'i ndajnë midis tyre shumat e nxjerra në përpjesëtim me kreditë përkatëse, përveç rasteve të preferimeve. Mbetja i takon debitorit.

Neni 968

Debitori ka të drejtë të kontrollojë administrimin dhe të marrë një raportim mbi gjendjen financiare në fund të likuidimit, ose në fund të çdo viti po qe se administrimi zgjat më shumë se një vit.

Po qe se është emëruar një likuidues, ai duhet t'ia japë raportimin edhe debitorit.

Neni 969

Debitori shkarkohet ndaj kreditorëve vetëm nga dita kur ata marrin pjesën që u takon nga të ardhurat prej likuidimit dhe vetëm në kufijtë e shumës që kanë marrë, përveç kur ka marrëveshje të kundërt.

Neni 970

Debitori mund të tërhiqet nga kontrata duke ofruar t'u paguajë detyrimet dhe interesat atyre me të cilët ka kontraktuar ose që janë bashkuar në këtë kontratë. Tërheqja ka efekt nga dita e pagimit.

Debitori detyrohet të paguajë shpenzimet e gjërimit.

Zgjidhja e kontratës

Neni 971

Kontrata mund të zgjidhet po qe se debitori, pasi ka deklaruar se e kalon të gjithë pasurinë e vet, ka fshehur një pjesë të konsiderueshme të saj, ose po që se ka fshehur humbjet apo ka paraqitur humbje që nuk ekzistonin.

Neni 972

Kontrata mund të zgjidhet për shkak mospërmbushjeje sipas rregullave të përgjithshme.

KREU XV NDËRMJETËSIMI

Përmbajtja

Neni 973

Ndërmjetës është ai që vë në lidhje dy ose më shumë palë për përfundimin e një marrëveshjeje, pa qenë i lidhur me asnjërin prej tyre në marrëdhënie bashkëpunimi, varësie ose përfaqësimi.

Shpërblimi

Neni 974

Kur nuk ka marrëveshje, ose kur tarifat profesionale, ose zakonet nuk japin ndonjë përcaktim, madhësia e shpërblimit dhe përpjesëtimi në të cilin ky rëndon mbi secilën nga palët, caktohet nga gjykata.

Të drejta e detyrime të palëve

Neni 975

E drejta e ndërmjetësit për shpërblim lind kur kontrata e ndërmjetësimi i sjell efektet e veta dhe pavarësisht nga ndodhitë e mëvonshme të saj.

Paragrafi i mësipërm nuk zbatohet kur kontrata e ndërmjetësimit mund të shpallet e pavlefshme, ngaqë ndërmjetësi kishte dijeni për arsyen e pavlefshmërisë.

Neni 976

Ndërmjetësi ka të drejtë të paguhet për shpenzimet prej personit për të cilin janë kryer shpenzimet edhe kur marrëveshja nuk është përfunduar, përveç kur është zgjidhur ndryshe me marrëveshje ose nga zakonet.

Neni 977

Në qoftë se marrëveshja është përfunduar me ndërhyrjen e disa ndërmjetësve, secili prej tyre ka të drejtë për një kuotë shpërblimi.

Neni 978

Ndërmjetësi duhet t'u njoftojë palëve rrethanat për të cilat ai ka dijeni e që kanë të bëjnë me vlerësimin dhe me sigurinë e marrëveshjes, të cilat mund të ndikojnë në përfundimin e saj.

Ndërmjetësi përgjigjet për vërtetësinë e nënshkrimit në dokumentet dhe për xhirimet e fundit të titujve të transmetuara nëpërmjet tij.

Neni 979

Detyrat e ndërmjetësuesit profesionist në marrëveshje për mallra ose për tituj janë:

1. të ruajë kampionet e mallrave të shitura me anë kampionesh, derisa të ekzistojë mundësia e mosmarrëveshjeve për identitetin e mallit;
2. t'i japë blerësit një listë të nënshkruar të titujve për të cilët është biseduar duke treguar serinë dhe numrin;
3. të shënojë në librin përkatës të dhënat kryesore të kontratës që lidhet me ndërhyrjen e tij dhe t'u japë palëve kopjen e çdo shënimi të tillë të nënshkruar prej tij.

Neni 980

Ndërmjetësi mund të ngarkohet nga njëra prej palëve për ta përfaqësuar në veprimet lidhur me zbatimin e kontratës së lidhur me ndërhyrjen e tij.

Neni 981

Ndërmjetësi, që nuk i tregon njërit kontraktues emrin e kontraktuesit tjetër, përgjigjet për zbatimin e kontratës dhe, kur e ka zbatuar atë, merr të drejtat ndaj kontraktuesit të patreguar.

Në qoftë se, pas lidhjes së kontratës, kontraktuesi i patreguar shfaqet para palës tjetër ose tregohet nga ndërmjetësi, secili nga kontraktuesit mund të ngrejë padi drejtpërdrejt kundër tjetrit, por pa cenuar përgjegjësinë e ndërmjetësit.

KREU XVI
DEPOZITA
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 982

Depozita është kontrata me të cilën njëra palë merr nga tjetra një send të luajtshëm me detyrimin për ta ruajtur dhe për ta kthyer në natyrë.

Neni 983

Kontrata e depozitës quhet e lidhur nga çasti që është dorëzuar sendi për ruajtje.

Neni 984

Depozita prezumohet se është me shpërblim, përveç kur nga cilësia profesionale e depozitarit ose nga rrethanat e tjera kuptohet një vullnet i ndryshëm i palëve.

Të drejta e detyrime të palëve

Neni 985

Depozitari duhet të ruajë sendin me kujdes. Ai nuk mund ta përdorë atë vetë dhe as t'ua japë në depozitë të tjerëve, pa pëlqimin e depozituesit. Në qoftë se sendin e përdor pa pëlqimin e depozituesit, depozitari është përgjegjës për humbjen ose dëmtimin e tij deri në shkakun faktor.

Po ta kërkojnë rrethanat e ngutshme, depozitari mund të ushtrojë ruajtjen në një mënyrë të ndryshme nga marrëveshja, duke njoftuar depozituesin menjëherë sapo të jetë krijuar mundësia.

Neni 986

Depozitari është i detyruar të kthejë sendin e lënë depozitë në çdo kohë që e kërkon depozituesi edhe sikur të jetë caktuar një afat për kthimin e tij, përveç kur afati është caktuar në interes të depozitarit.

Kthimi i sendit të lënë depozitë bëhet në vendin ku sendi duhej të ruhej, përveç përmbushjes së palëve kthimi bëhet me shpenzimet e depozituesit.

Neni 987

Në qoftë se depozita është pa shpërblim, gjykata mund të ulë masën e shpërblimit të dëmit.

Neni 988

Depozituesi është i detyruar t'i paguajë depozitarit shpenzimet e bëra për ruajtjen e sendit, në qoftë se nuk janë përfshirë në shpërblim.

Neni 989

Kur nuk është caktuar një afat për kthimin e sendit të lënë depozitë, depozitari ka të drejtë të kërkojë në çdo kohë që të shkarkohet nga detyrimi i tij për ruajtjen e sendit, duke lajmëruar depozituesin që të marrë prapë sendin brenda një afati të mjaftueshëm që i cakton vetë.

Neni 990

Depozituesi është i detyruar të shpërblejë dëmin që i është shkaktuar depozitarit nga të metat e fshehta të sendit, në qoftë se, duke i ditur këto, nuk ia ka njoftuar depozitarit.

Neni 991

Kur depozituesit e një sendi janë më shumë se një dhe ata nuk merren vesh lidhur me kthimin e tij, vendos gjykata.

Kështu veprohet edhe kur një depozitues i vetëm ka lënë disa trashëgimtarë, po që se sendi nuk është i ndashëm.

Kur depozitëmarrësit janë më shumë se një, depozituesi ka të drejtë të kërkojë kthimin nga personi që mban sendin, i cili duhet të njoftojë menjëherë të tjerët.

Neni 992

Në qoftë se sendi është depozituar edhe në interes të një të treti dhe ky i fundit u ka njoftuar depozituesit dhe depozitëmarrësit pranimin e tij, depozitëmarrësi nuk mund të shkarkohet duke ia kthyer sendin depozituesit, pa miratimin e të tretit.

Neni 993

Depozitëmarrësi është i detyruar të kthejë frytet e sendit të cilat ai i ka vjelë.

Neni 994

Trashëgimtari i depozitëmarrësit që ka tjetërsuar sendin në mirëbesim, duke mos ditur se mbahej në depozitë, detyrohet vetëm të kthejë shpërblimin e marrë.

Në qoftë se ky nuk është paguar ende, depozituesi merr të drejtat e tjetërsuesit.

Neni 995

Depozitëmarrësi duhet t'i kthejë sendin depozituesit ose personit të caktuar për ta marrë, pa qenë nevoja që depozituesi të provojë se është pronar.

Në qoftë se depozitëmarrësi paditet nga një person që rivendikon pronësinë e sendit ose pretendon se ka të drejta mbi të, depozitëmarrësi duhet të denoncojë mosmarrëveshjen tek depozituesi dhe të kërkojë të përjashtohet nga gjykimi duke treguar vetë personin, përndryshe duhet të shpërblejë dëmet. Në këtë rast ai mund të shkarkohet nga detyrimi për të kthyer sendin, duke e depozituar atë sipas mënyrave të caktuara nga gjykata, me shpenzimet e depozituesit.

Neni 996

Në qoftë se ruajtja e sendit i hiqet depozitarit si rrjedhim i një fakti për të cilin ai nuk është fajtor, ai shkarkohet nga detyrimi për të kthyer sendin, por duhet t'i njoftojë menjëherë depozitarit faktin për të cilin ka humbur mbajtjen e sendit, përndryshe ngarkohet me shpërblimin e dëmit.

Depozituesi ka të drejtë të marrë atë që, si pasojë e vetë faktit, depozitari ka siguruar dhe merr të drejtat që i takojnë këtij të fundit.

Neni 997

Kreditë që rrjedhin nga depozita në dobi të depozitarit kanë privilegj mbi sendin e dhënë në depozitë. Depozitari mund të mbajë sendin që është në privilegj derisa të shpërblehet për kredinë e tij dhe mundet edhe ta shesë sipas dispozitave për pengun.

Neni 998

Kur sendi i lënë depozitë nuk është tërhequr në afatin e caktuar në kontratë ose pas lajmërimit që i ka bërë depozitari, ky nuk përgjigjet për humbjen ose dëmtimin e sendit që ngjan pas kalimit të afatit, përveç kur humbja ose dëmtimi është shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia e rëndë e tij.

Në rastet e sipërme, depozitari ka të drejtë të kërkojë nga gjykata që të lejojë shitjen e sendit të lënë në depozitë sipas rregullave të ekzekutimit të detyrueshëm.

Shumat e nxjerra nga shitja e sendit, pasi të zbriten shumat që ka për të marrë depozitari, i jepen depozituesit ose depozitohen në bankë në emër të tij.

Dispozitë referuese

Neni 999

Në qoftë se depozita ka për objekt një sasi të hollash ose sendesh të tjera të barasndërrueshme, dhe depozitari ka të drejtën t'i përdorë, ky fiton pronësinë dhe detyrohet të kthejë po të njëjtën sasi nga i njëjti lloj dhe me të njëjtën cilësi.

Në raste të tilla zbatohen dispozitat lidhur me huan, kur nuk vijnë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë depozitën.

A. Depozita në magazinat e përgjithshme

Neni 1000

Magazinat (depot) e përgjithshme që veprojnë si depozitare janë përgjegjëse për ruajtjen e sendeve të depozituara, përveç kur provohet se dëmi ka ardhur nga rasti faktor, nga natyra e sendeve ose nga defekte të sendeve ose të ambalazhit.

Depozitari duhet në çdo rast të ushtrojë veprimtaritë e nevojshme për të kufizuar dëmin.

Neni 1001

Magazinat depozitare duhet të ruajnë sendet e depozituara veçmas njëra nga tjetra, gjithashtu duhet t'i pajisin me shenja dalluese që të tregojnë përkatësinë e sendit ndaj depozituesit.

Përveç pëlqimit të shprehur të depozituesit, ata nuk mund të përziejnë midis tyre sende të barasndërrueshme të të njëjtit lloj e cilësi.

Depozituesi ka të drejtë të inspektojë sendet e depozituara dhe të tërheqë kampionet e përdorimit.

Neni 1002

Kur depot e përgjithshme kanë lëshuar një titull përfaqësimi të sendeve të depozituara, depozitari duhet t'ia kthejë sendet vetëm kreditorit që është legjitimuar nga titulli.

Neni 1003

Depot e përgjithshme pasi njoftojnë depozituesin, mund të fillojnë shitjen me çmim më të lartë të sendeve kur, në mbarim të kontratës sendet nuk janë tërhequr, ose depozita nuk është përtërirë, dhe në çdo rast, kur sendet rrezikohen të humbasin ose përbëjnë një rrezik të madh për sigurinë e vendeve ku janë depozituar.

Të ardhurat nga shitja, pasi zbritet kostoja dhe shpenzimet e mbetura të depozitës, duhet t'i dorëzohen depozituesit pa vonesë.

B. Depozita në hotel

Neni 1004

Hotelierët janë përgjegjës për dëmtimin, shkatërrimin ose humbjen e sendeve që klientët kanë sjellë në hotel.

Konsiderohen të sjella në hotel:

1. sendet që ndodhen gjatë kohës në të cilën klienti strehohet aty;
2. sendet të cilat hotelieri, një anëtar i familjes së tij ose një ndihmës i tij marrin përsipër të ruajnë, jashtë hotelit, gjatë periudhës së kohës në të cilën klienti ndodhet i strehuar;
3. sendet të cilat hotelieri, një anëtar i familjes së tij ose një ndihmës i tij marrin përsipër të ruajnë qoftë në hotel, qoftë jashtë tij, për një kohë të arsyeshme, para ose pasi klienti të ketë bujtur.

Përgjegjësia që përmend ky nen kufizohet në vlef tën e asaj që është vjedhur, dëmtuar ose humbur deri në ekuivalentin e njëqindfshit të çmimit të qirasë së banimit për një ditë.

Neni 1005

Përgjegjësia e hotelierit është e pakufizuar:

1. kur sendet janë dorëzuar për ruajtje;
2. kur ka refuzuar të marrë në ruajtje sende të cilat kishte detyrë t'i pranonte. Hotelieri ka për detyrë të pranojë letrat me vlerë, paratë dhe sendet me vlerë; ai mund të mos pranojë t'i marrë kur bëhet fjalë për objekte të rrezikshme ose që, duke marrë parasysh rëndësinë dhe kushtet e administrimit të hotelit, kanë vlerë të rëndësishme ose përmasa shumë të mëdha.

Hotelieri mund të kërkojë që sendi i dorëzuar të jetë i vendosur në një mbështjellje të mbyllur ose të vulosur.

Neni 1006

Hotelieri nuk është përgjegjës kur vjedhja, dëmtimi ose humbja vijnë:

1. nga klienti, nga personat që e shoqërojnë, që janë në shërbim të tij, ose që e vizitojnë;
2. nga forca madhore;
3. nga natyra e sendeve.

Neni 1007

Hotelieri është përgjegjës, pa mundur të invokojë kufijtë e parashikuar në paragrafin e fundit të nenit 1004, kur vjedhja, dëmtimi ose humbja e sendeve të sjella nga klienti në hotel janë shkaktuar për faj të tij, të anëtarëve të familjes së tij ose të ndihmësve të tij.

Neni 1008

Përveç rastit të parashikuar në nenin 985, klienti nuk mund të përdorë dispozitat e mësipërme po qe se, pasi të ketë konstatuar vjedhjen, dëmtimin ose humbjen, denoncon faktin tek hotelieri me një vonesë të pajustificueshme.

Neni 1009

Janë të pavlefshme marrëveshjet ose deklaratat që synojnë të përjashtojnë ose të kufizojnë paraprakisht përgjegjësinë e hotelierit.

Neni 1010

Dispozitat e mësipërme nuk zbatohen për automjetet, për sendet e lëna në to dhe as për kafshët e gjalla.

Neni 1011

Për vlerësimin e përgjegjësisë, ose për të caktuar kufirin e shpërblimit, dispozitat për depozitat në hotel zbatohen edhe ndaj sipërmarrësve të klinikave shëndetësore publike dhe private, institucioneve për shfaqje publike, shtëpive të pushimit, hotel- pensione, restoranteve dhe për të gjitha rastet në të cilat, nga vetë veprimtaria e posaçme e zhvilluar nga sipërmarrësi, klienti nuk mund të kujdeset personalisht për ruajtjen e sendeve.

Neni 1012

Kreditë e hotelierit, për shpërblimet e kryera ndaj personave bujtës, kanë privilegj mbi sendet e sjella prej tyre në hotel e në vartësitë e tij dhe që vazhdojnë të ndodhen aty.

Privilegji ka efekt edhe në dëm të të tretëve, që kanë të drejta mbi vetë këto sende, me kusht që hotelieri të jetë në dijeni për këto të drejta në kohën kur sendet janë sjellë në hotel.

KREU XVII LLOGARIA RRJEDHËSE

Neni 1013

Llogaria rrjedhëse është një kontratë me të cilën palët detyrohen të regjistrojnë në një llogari kreditimet reciproke, duke e konsideruar të padisponueshme dhe të pakthyeshme deri në mbylljen e llogarisë. Teprica e llogarisë është e kthyeshme me mbarimin e afatit.

Në qoftë se nuk është kërkuar pagimi, teprica konsiderohet e rinovuar për një kohë të pacaktuar.

Neni 1014

Përfshihen nga llogaria rrjedhëse, kreditë që nuk mund të kompensohen.

Kur kontrata vepron ndërmjet sipërmarrësve, përfshihen nga llogaria kreditë e huaja për ndërmarrjet përkatëse.

Neni 1015

Mbi gjendjen përfitohet kamata në masën e vendosur në kontratë dhe në mungesë të këtyre nga ligji, por gjithnjë brenda kufijve të caktuara prej tij.

Neni 1016

Për llogarinë rrjedhëse paguhet komisioni si dhe shpenzimet që janë dashur për veprimet që kanë lidhje me derdhjet. Këto të drejta nuk bëjnë pjesë në llogari, përveç kur në marrëveshje parashikohet ndryshe.

Neni 1017

Përfshirja e një kredie në llogarinë rrjedhëse, nuk përjashton ushtrimin e të drejtës së padisë dhe e të drejtave të tjera, lidhur me aktin nga i cili rrjedh kredia.

Kur akti i mësipërm është i pavlefshëm, ose shpallet si i tillë, ose i zgjidhur, pjesa përkatëse e parave përjashtohet nga llogaria rrjedhëse.

Neni 1018

Kur kredia e përfshirë në llogari është e siguruar me një garanci reale ose personale, klienti ka të drejtë të përdorë këtë garanci për tepricën ekzistuese në favor të tij nga mbyllja e llogarisë e deri në arkëtimin e kredisë së garantuar.

Paragrafi i mësipërm zbatohet edhe në qoftë se për kredinë ekziston një bashkëdetyrim solidar.

Neni 1019

Përveç kur palët kanë parashikuar ndryshe në kontratë, përfshirja në llogarinë rrjedhëse e një kredie ndaj një të treti, prezumohet si e bërë me kushtin që të paguhet. Në rastin kur kredia nuk përmbushet, marrësi ka të drejtën të veprojë për mbledhjen, marrjen e shumës së parave nga llogaria, duke riintegruar atë që ka bërë derdhjen. Mund të merret kjo shumë parash nga llogaria edhe pasi ushtron pa rezultat të drejtat e tij kundrejt debitorit.

Neni 1020

Në rast se kreditori i një klienti ka sekuestruar mbetjen eventuale të llogarisë që i takon debitorit të tij, klienti tjetër nuk mundet, me derdhje të reja të cenojë të drejtat e kreditorit. Nuk konsiderohen si derdhje të reja ato që janë bërë në vartësi nga të drejtat e rrjedhura para sekuestrimit.

Klienti ndaj të cilit është bërë sekuestrimi ose është vënë pengu duhet të njoftojë anën tjetër. Secili prej tyre mund të tërhiqet nga kontrata.

Neni 1021

Mbyllja e llogarisë me likuidimin e tepricës bëhet me mbarimin e afateve të përcaktuara në kontratë dhe në mungesë të tyre, në përfundim të çdo 6-mujori të llogaritur që nga data e lidhjes së kontratës.

Neni 1022

Kalimi i veprimeve në llogari nga një klient në një tjetër nënkuptohet i pranuar në qoftë se nuk është kundërshtuar në afatin e caktuar prej palëve ose në afatin që mund të konsiderohet i përshtatshëm sipas rrethanave.

Pranimi i veprimit nuk përfshin të drejtën për ta kundërshtuar për gabime shkrimi ose llogaritjeje, për mosveprim ose dublime.

Kundërshtimi duhet të bëhet brenda 6 muajve nga data e kalimit të llogarisë, lidhur me likuidimin e mbylljen, e cila duhet të dërgohet rekomande. Rivendosje në afat nuk lejohet.

Neni 1023

Kur kontrata është lidhur për një kohë të pacaktuar, secila prej palëve mund të tërhiqet nga kontrata në çdo mbyllje të llogarisë, duke njoftuar të paktën 10 ditë përpara.

Në rastin e një ndalimi të ushtrimit të këtij aktiviteti, të paaftësisë për të vepruar, të paaftësisë paguese ose vdekjes së njëres prej palëve, secila prej tyre, ose trashëgimtarët e tyre, kanë të drejtën të tërhiqen nga kontrata.

Zgjidhja e kontratës ndalon përfshirjen në llogari të shumave të reja, por pagimi i mbetjes nuk mund të kërkohet vetëm pas skadimit të periudhës së përcaktuar në nenin 1021.

KREU XVIII KONTRATAT BANKARE

A. Depozitat bankare

Neni 1024

Kur depozitohet një shumë parash pranë një banke, kjo fiton pronësinë dhe është e detyruar t'i kthejë në të njëjtën lloj monedhe, me skadimin e afatit të përcaktuar ose me kërkesën e depozituesit, duke patur parasysh periudhën e lajmërimit të përcaktuar nga palët ose nga zakoni bankar.

Neni 1025

Në rast se banka lëshon një librezë depozite kursimi, derdhjet dhe tërheqjet duhet të shënohen në librezë.

Shënimet mbi librezë të firmosura nga nëpunësi i bankës, që është i caktuar për këtë shërbim, përbëjnë provë të plotë midis bankës dhe depozituesit.

Është e pavlefshme çdo marrëveshje e kundërt.

Neni 1026

Në qoftë se librezat e kursimit është e pagueshme tek prurësi, banka që padashje dhe pa faj të rëndë kryen shërbimin përballë poseduesit, nuk përgjigjet edhe në qoftë se ky nuk është depozituesi. E njëjta dispozitë zbatohet në rastin kur librezat e depozitës e pagueshme tek prurësi të jetë lëshuar në emër të një personi të caktuar.

Janë të përjashtuara dispozitat e ligjeve të veçanta.

Neni 1027

Banka që merr dhe pranon depozitat e titujve në administrim duhet t'i ruajë titujt duke marrë interesat ose dividendët, të verifikojë tregtimin për çmimin ose për ripagimin e kapitalit, duke treguar kujdes për grumbullimin e të ardhurave për llogarinë e depozituesit, dhe në përgjithësi të kujdeset për mbrojtjen e të drejtave që kanë të bëjnë me titullin. Shumat e grumbulluara duhet të jenë të kredituara në llogarinë e depozituesit.

Në qoftë se për titujt e depozituar duhet të ushtrohet një e drejtë zgjedhjeje, banka duhet të kërkojë në kohë udhëzimet e nevojshme nga depozituesit dhe t'i realizojë ato, në qoftë se në rast nevoje ka marrë fonde të nevojshme. Në mungesë të këtyre udhëzimeve, të drejtat e zgjedhjeve duhet të shiten për llogari të depozituesit nëpërmjet agjentëve të këmbimit.

Bankës i takon një kompensim në masën e përcaktuar nga marrëveshja e palëve ose ajo që përdoret zakonisht, përveç pagimit të shpenzimeve të bëra prej saj.

Është e pavlefshme çdo marrëveshje me të cilën përjashtohet banka nga ruajtja dhe administrimi i titujve me një kujdesje të zakonshme.

B. Shërbimi bankar dhe kasetat e sigurimit

Neni 1028

Banka, për shërbimin e kasetave të sigurimit, përgjigjet kundrejt përdoruesit për aftësinë paguese, ruajtjen e lokalit dhe për paprekshmërinë e kasetës, përveç ndonjë rasti faktor.

Neni 1029

Kur kasetat është në emër të disa personave, hapja e saj i njihet secilit prej tyre, përveç ndonjë marrëveshjeje të kundërt.

Në rast vdekje të mbajtësit të vetëm ose të njërit të këtyre mbajtësve, banka që ka marrë njoftimin mund të lejojë hapjen e kasetës me marrëveshjen e të gjithë atyre që e kanë të drejtë, ose sipas mënyrës së përcaktuar nga gjykata.

Neni 1030

Kur afati i kontratës ka mbaruar, banka mbas një lajmërimi të mbajtësit ose me kalimin e gjashtë muajve nga data e mbarimit, mund t'i kërkojë gjykatës autorizimin për hapjen e kasetës. Lajmërimi mund të bëhet edhe nëpërmjet postës rekomande të konfirmuar.

Hapja kryhet në praninë e një noteri duke patur parasysh edhe masat që gjykata i quan të nevojshme. Gjykata mund të urdhërojë marrjen e masave të nevojshme për ruajtjen e objekteve të

gjetura duke përfshirë edhe shitjen e një pjese të tyre, që është e nevojshme për të plotësuar shpenzimet e bëra nga banka.

C. Hapja (çelja) e kredisë bankare

Përkufizimi

Neni 1031

Hapja e kredisë bankare është një kontratë me të cilën banka detyrohet të mbajë në dispozicion të palës tjetër një shumë parash, për një periudhë të caktuar kohe ose për një kohë të pacaktuar.

Neni 1032

Përveç kur ka marrëveshje tjetër, në qoftë se nuk është rënë dakord ndryshe, kredimarrësi mund ta përdorë disa herë kredinë, sipas formave të përdorimit, dhe mundet që me derdhjet e mëtejshme të rivendosë disponibilitetin e tij.

Derdhjet dhe tërheqjet realizohen pranë bankës ku ka lindur kjo marrëdhënie, përveç kur është parashikuar ndryshe nga palët.

Neni 1033

Në qoftë se për hapjen e kredisë është dhënë një garanci reale ose personale, kjo nuk shuhet për faktin se kredimarrësi, në momentin e mbarimit të kësaj marrëdhënieje, pushon së qeni debitor i bankës. Kur garancia bëhet e pamjaftueshme, banka mund të kërkojë një garanci suplementare ose zëvendësimin e garantit.

Kur kredimarrësi nuk vepron në përputhje me kërkesat, banka pakëson kredinë në mënyrë proporcionale me pakësimin e vlerës së garancisë ose mund të heqë dorë nga kontrata.

Neni 1034

Banka nuk mund të tërhiqet nga kontrata përpara mbarimit të afatit të kontratës, përveç rasteve të arsyeshme, ose kur ka marrëveshje tjetër. Heqja dorë ndërpret menjëherë përdorimin e kredisë, por banka duhet të caktojë një afat të paktën prej pesëmbëdhjetë ditësh për kthimin e shumave të përdorura dhe ato plotësuese.

Kur dhënia e kredisë është në një kohë të pacaktuar, secila prej palëve mund të tërhiqet nga kontrata nëpërmjet lajmërimit në afatin e caktuar në kontratë, që përdoret zakonisht ose, në mungesë të tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditëve.

Ç. Paradhënia bankare

Disponim i sendeve të dhëna peng

Neni 1035

Në paradhënien bankare me pengun mbi titujt ose mbi mallrat, banka nuk mund të disponojë mbi sendet për të cilat është vënë pengu, në qoftë se ka lëshuar një dokument në të cilin këto sende janë individualizuar.

Marrëveshja e kundërt duhet të provohet me shkresë.

Neni 1036

Banka duhet të kujdeset për llogari të kontraktuesit për sigurimin e mallrave të lëna peng në qoftë se, për nga vetë natyra, vlera dhe vendndodhja e tyre siguri i përgjigjet përkujdesjeve të zakonshme.

Neni 1037

Banka, përveç detyrimeve që i takojnë, ka të drejtën që t'i paguhen shpenzimet që ka bërë për ruajtjen e mallrave dhe të titujve, përveç kur e ka marrë përsipër një gjë të tillë.

Neni 1038

Kontraktuesi, edhe përpara mbarimit të afatit të kontratës, mund të tërheqë titujt ose mallrat e lëna peng, duke bërë më parë një pagesë proporcionale ndërmjet shumave të marra paradhënie dhe të shumave të tjera që i përkasin bankës sipas nenit të mësipërm, në qoftë se teprica e kredisë rezulton e pagarrantuar në mënyrë të mjaftueshme.

Neni 1039

Në qoftë se vlera e garancisë pakësohet të paktën në një të dhjetën në krahasim me vlerën e saj në kohën e lidhjes së kontratës, banka mund t'i kërkojë debitorit një garanci plotësuese, me paralajmërimin se në mungesë të saj do të vepronet për shitjen e këtyre mallrave ose titujve të dhëna peng. Në qoftë se debitori nuk vepron në përputhje me kërkesat, banka mund të veprojë për shitjen e tyre në bazë të dispozitave për pengun.

Banka ka të drejtën e pagimit të menjëhershëm të tepricës të llogarisë që nuk është përmbushur plotësisht nga shumat e rezultuara nga shitja

Neni 1040

Në qoftë se me garancitë e një ose më shumë kredive janë bllokuar depozita në para, mallra ose tituj që nuk kanë qenë të individualizuar ose për të cilat i është lënë bankës mundësia për t'i disponuar, banka duhet të kthejë vetëm shumën ose një pjesë të mallrave ose të titujve që tejkalojnë shumën e kredive të garantuara. Ky tejkalim përcaktohet në lidhje me vlerën e mallrave ose të titujve në kohën e mbarimit të kredive.

D. Veprimet bankare me llogari rrjedhëse

Neni 1041

Kur depozita, çelja e kredisë ose veprimet e tjera bankare janë rregulluar në llogarinë rrjedhëse, klienti mund të disponojë në çdo kohë shumat që rezultojnë në kredinë e tij, përveç kur rezerva e afatit, është parashikuar në marrëveshje.

Neni 1042

Në rast se midis bankës dhe klientit ekzistojnë disa marrëdhënie ose disa llogari, edhe në monedha të ndryshme, teprica aktive dhe pasive kompensohen në mënyrë reciproke, përveç kur ka marrëveshje të kundërt.

Neni 1043

Në rastin kur llogaria likuiduese është në emër të disa personave, me të drejtën për të kryer veprime edhe në mënyrë individuale, këta persona quhen kreditorë ose debitorë solidarë të tepricave të llogarisë.

Neni 1044

Në rast se veprimet në llogarinë rrjedhëse janë për një kohë të pacaktuar, secila prej palëve mund të tërhiqet nga kontrata, duke lajmëruar palën tjetër brenda afatit të caktuar në kontratë ose në mungesë të tij, brenda 15 ditëve.

Neni 1045

Banka përgjigjet sipas dispozitave që rregullojnë kontratën e porosisë për ekzekutimin e detyrimeve të marra nga depozituesi ose nga një klient tjetër.

Në qoftë se ky detyrim duhet të kryhet aty ku nuk ekzistojnë degë të bankës, kjo mund të ngarkojë për ekzekutim një bankë tjetër.

Neni 1046

Për llogarinë rrjedhëse zbatohen edhe nenet 1016,1019,1022.

E. Skontoja bankare Përkufizimi

Neni 1047

Skontoja është kontrata me anë të së cilës banka, duke zbatuar kamatën i jep klientit vleftën e një kredie ndaj të tretëve, që nuk ka mbaruar akoma, nëpërmjet cedimit.

Skontoja e kambialeve

Neni 1048

Në qoftë se skontoja bëhet nëpërmjet xhimit të kambialit ose të çekut bankar, banka në rast se nuk kryhet pagimi, përveç të drejtave të rrjedhura nga titulli, gëzon edhe të drejtën e kthimit të paradhënies.

Ruhen dispozitat e ligjeve të veçanta lidhur me çekun dhe kambialin.

Neni 1049

Banka që ka skontuar kambialet e dokumentuara, gëzon mbi mallin të njëjtin privilegj që ka edhe i porosituri, deri sa titulli përfaqësues është në posedimin e tij.

KREU XIX HUAJA

Neni 1050

Me kontratën e huas njëra palë (huadhënësi) i jep në pronësi palës tjetër (huamarrësit) një shumë të hollash ose sende që përcaktohen në numër, me peshë ose me masë dhe huamarrësi detyrohet t'i kthejë huadhënësit aq të holla, ose aq sende të atij lloji dhe të asaj cilësie, brenda afatit të caktuar në kontratë ose, kur nuk është caktuar afat, me kërkesën e huadhënësit.

Neni 1051

Përveç kur me marrëveshje të palëve është parashkuar ndryshe, huamarrësi duhet t'i paguajë huadhënësit kamatat.

Kamatat, për të cilat është rënë dakord, paguhet çdo vit, përveç kur palët kanë parashkuar ndryshe.

Mospagimi i kamatave përbën mospërbushje thelbësore të detyrimit.

Neni 1052

Në rast se palët janë marrë vesh për kthimin me këste të parave ose të sendeve dhe huamarrësi nuk përmbush detyrimin e pagimit të dy kësteve ose nuk përmbush, me një vonesë prej më shumë se tre muaj, pagimin e vetëm një kësti, huadhënësi mund të kërkojë kthimin e menjëhershëm të parave ose të sendeve të dhënë hua.

Neni 1053

Kur kthimi i sendeve të dhëna hua është bërë i pamundur ose tepër i vështirë pa fajin e debitorit, ky është i detyruar të paguajë vleftën e tyre, duke marrë parasysh kohën dhe vendin në të cilën do të bëhej kthimi.

Neni 1054

Huadhënësi është përgjegjës për dëmin që i ka shkaktuar huamarrësit, për të metat e sendeve të dhëna hua, në qoftë se nuk provon se nuk ishte faji i tij që nuk kishte dijeni për ato.

Në qoftë se huaja është pa shpërblim, huamarrësi është përgjegjës vetëm në rastin kur, duke i ditur cenet, nuk e ka njoftuar huadhënësin për to.

Neni 1055

Kush ka premtuar të japë hua, mund të refuzojë të përmbushë detyrimin, po qe se kushtet pasurore të palës tjetër janë në gjendje të tillë sa e bëjnë tepër të vështirë kthimin dhe huadhënësit nuk i janë ofruar garanci të përshtatshme.

KREU XX FRANCHISING

Përkufizimi

Neni 1056

Kontrata franchising përmban një raport detyrimesh të vazhdueshme me të cilin ndërmarrje të pavarura detyrohen ndërmjet njëra-tjetrës që të nxisin e të zhvillojnë bashkërisht tregtinë dhe kryerjen e shërbimeve, në zbatim të detyrimeve të veçanta.

Detyrimet e franchisor-it

Neni 1057

Franshizori (franshizdhënësi) ka detyrimin të vërë në dispozicion të franshizë (franshizmarrësit) një tërësi të standardizuar të drejtash jo materiale, modelesh, skicash, idesh fitimi, tregtimi dhe organizimi e njohuri të tjera të përshtatshme për zhvillimin e tregtisë. Ndërkaq ai është i detyruar të ruajë gjithë këtë program detyrimesh nga cenimi prej të tretëve, ta zhvillojë atë vazhdimisht dhe të mbështesë zbatimin e tij nga franshizmarrësi me udhëzime, informacione e perfeksionime.

Marrëdhëniet parakontraktore

Neni 1058

Në bisedimet për përfundimin e kontratës palët duhet t'i tregojnë njëra-tjetrës gjendjen e punëve tregtare që kanë të bëjnë me kontratën franshize dhe veçanërisht programin e detyrimeve franshize, si dhe të informojnë njëri-tjetrin sipas parimeve të mirëbesimit. Ata janë të detyruar të ruajnë sekretin e informatave konfidenciale, edhe po të mos përfundohet kontrata.

Kush shkel këtë detyrim, detyrohet të shpërblejë dëmin. Kjo e drejtë parashkruhet me kalimin e tre vjetëve nga dita e pushimit të bisedimeve.

Pala që ka marrë pjesë në bisedime mund të kërkojë pagimin e shpenzimeve të bëra me besim të ligjshëm në përfundimin e kontratës, e cila nuk u përfundua për shkak të një sjelljeje të qëllimshme të palës tjetër.

Forma e kontratës

Neni 1059

Kontrata e franchisingut duhet të bëhet me shkresë duke përcaktuar ndër të tjera një përkufizim të njëzëshëm të detyrimeve të ndërsjella të palëve, kohëzgjatjen e kontratës dhe të elementeve të tjera thelbësore të saj. Teksti i kontratës duhet të përmbajë një përshkrim të plotë të programit e të detyrimeve franshinzore.

Heqja dorë nga kontrata

Neni 1060

Kohëzgjatja e kontratës vendoset me marrëveshje të palëve, duke respektuar kërkesat e diktuar nga tregtia dhe shërbimet përkatëse.

Kur në kontratë nuk është përcaktuar afat, ose afati është më tepër se dhjetë vjet, secila palë ka të drejtë të heqë dorë nga kontrata, duke e njoftuar palën tjetër një vit më parë.

Në rast pushimi të kontratës si rrjedhim i plotësimit të afatit ose heqjes dorë prej saj dhe përpara paraqitjes aktuale të raportit të punëve, palët, të udhëhequra nga parimet e mirëbesimit, bëjnë një përpjekje për të rënë dakord për ripërtëritjen e kontratës në kushte të njëjta ose të ndryshuara.

Ndalimi i konkurrencës

Neni 1061

Edhe pas pushimit të marrëdhënieve kontraktore palët kanë reciprokisht detyrimin për një konkurrencë të ndershme.

Mbi këtë bazë, franshiz marrësit mund t'i imponohet një ndalim i konkurrencës lokale për një kohë deri në një vit.

Në qoftë se nga ndalimi i konkurrencës rezulton një pakësim i veprimtarisë së tij profesionale, franshiz marrësit i jepet një kompensim financiar i barasvlershëm, pa marrë parasysh pushimin e kontratës.

Përgjegjësia e franchiz marrësit

Neni 1062

Franshizdhënësi përgjigjet për qenien e të drejtave dhe të njohurive të programit të detyrimeve franshize. Në rast se të drejtat nuk do të ekzistonin ose në qoftë se franshizdhënësi do të shkelte të tjera detyrime kontraktore me mënyrë të fajshme, franshiz marrësi ka të drejtë të pakësojë shpërblimin. Shuma e pakësuar duhet të vendoset me kompetencë me anën e një eksperti të paanshëm. Franshiz marrësi mund të kërkojë shlyerjen e dëmit të shkaktuar nga mosqenia e elementeve të programit të detyrimeve ose nga shkelja me faj e kontratës nga ana e franshizdhënësit.

Neni 1063

Franshizdhënësi mund të kërkojë shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga shkelja me faj e kontratës, në veçanti nga zbatimi i pamjaftueshëm i programit të detyrimeve franshize, nga ana e franshiz marrësit.

Heqja dorë

Neni 1064

Në rast shkelje detyrimesh kontraktore që vënë seriozisht në rrezik qëllimin për zhvillimin e tregtisë, pala kontraktuese ka të drejtën të heqë dorë nga kontrata, pa iu referuar afatit.

KREU XXI KONTRATA E RENTËS JETORE

Neni 1065

Renta jetore mund të krijohet kundrejt shpërblimit (me titull barrësor) nëpërmjet tjetërsimit të një pasurie të luajtshme ose të paluajtshme ose të një shume parash.

Renta jetore mund të krijohet edhe me anë dhurimi ose me testament, duke respektuar kërkesat e ligjit për veprime juridike të tilla.

Neni 1066

Renta jetore mund të jepet për të gjithë jetën e përfituesit ose të një personi tjetër. Ajo mund të formohet edhe për gjithë jetën e një ose disa personave.

Neni 1067

Kur renta është formuar në favor të shumë personave, pjesa e një përfituesi të vdekur më parë, rritet në favor të të tjerëve, përveç kur ka marrëveshje të kundërt.

Neni 1068

Kontrata e rentës jetore e krijuar në favorin e një personi, i cili në kohën e kontratës kishte vdekur, është e pavlefshme.

EFEKTET E KONTRATËS SË RENTËS JETORE

Neni 1069

Personi në dobi të të cilit është krijuar renta jetore, me titull barrësor, mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës, në qoftë se personi që jep rentën nuk jep garancitë ose ul garancitë e dhëna në marrëveshje.

Neni 1070

Mospagimi i kësteve të arrira të rentës jetore nuk i jep të drejtën personit, në favor të të cilit është krijuar renta, që të kërkojë zgjidhjen e kontratës; por vetëm mund të kërkojë që të sekuestrohen e të shiten pasuritë e debitorit të tij dhe nga të ardhurat e shitjes të përdoret një shumë e mjaftueshme për të siguruar pagimin e rentës.

Neni 1071

Debitori i rentës nuk mund të shkarkohet nga detyrimi për pagimin e saj edhe sikur të ofrojë pagimin e shumës së parave ose të gjësë së marrë, qoftë dhe duke hequr dorë nga pagimi i kësteve të shlyera.

I sipërmi është i detyruar të paguajë rentën për të gjithë kohën që është krijuar, sado i rëndë që të jetë bërë detyrimi i rentës, përveç kur ka marrëveshje të kundërt.

Neni 1072

Renta jetore i jepet personit, në favor të të cilit është krijuar, në proporcion me numrin e ditëve që ka jetuar. Në rast se në marrëveshje është parashikuar që të parapaguhet me këste, secili prej tyre fitohet nga dita që plotësohet afati i pagimit.

Neni 1073

Në rast se renta jetore është krijuar mbi bazën e një titulli pa shpërblim, mund të parashikohet (ose të vendoset) që kjo të jetë e pasekuestrueshme.

SHOQËRIA E THJESHTË KREU XXII

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1074

Shoqëria është një kontratë me të cilën dy apo më shumë persona merren vesh për të ushtruar një aktivitet ekonomik, me qëllim që të ndajnë fitimet që rrjedhin prej tij.

Personi anëtar i shoqërisë duhet të vërë në dispozicion të këtij aktiviteti para, sende apo shërbime.

Neni 1075

Në shoqërinë e thjeshtë kontrata nuk është objekt i ndonjë forme të veçantë, përveç kur kërkohet nga natyra e sendeve të bashkuara.

Shoqëria është e thjeshtë, kur nuk paraqet cilësitë dalluese të shoqërisë tregtare të rregulluara në Kodin Tregtar.

MARRËDHËNIET MIDIS ANËTARËVE

Neni 1076

Anëtari është i detyruar të paguajë kontributet e caktuara në kontratën e shoqërisë. Presumohet se anëtarët janë të detyruar të kontribuojnë, në pjesë të barabarta midis tyre, sa është e nevojshme për arritjen e qëllimit të shoqërisë, përveç kur në kontratë është parashikuar ndryshe.

Neni 1077

Kontrata e shoqërisë mund të ndryshohet vetëm me pëlqimin e të gjithë ortakëve, në qoftë se në marrëveshje nuk është rënë dakord ndryshe.

Neni 1078

Për sendet e dhëna në pronësi, garancia e kërkuar nga anëtari dhe kalimi i rreziqeve rregullohen nga dispozitat mbi shitjen.

Neni 1079

Anëtari që ka kontribuar në kredi, përgjigjet për paaftësinë paguese të debitorit, brenda caqeve të treguara në nenin 506 të këtij Kodi për rastin e marrjes me marrëveshje të garancisë.

Neni 1080

Përveç se kur me marrëveshje është parashikuar ndryshe, administrimi i shoqërisë i takon secilit prej anëtarëve veçmas nga të tjerët.

Po qe se administrimi u takon veçmas disa anëtarëve, secili prej tyre ka të drejtë të kundërshtojë veprimin që dëshiron të kryejë një tjetër, përpara se ky të kryhet.

Shumica e anëtarëve, e përcaktuar sipas pjesës së çdo anëtari në fitim, zgjidh mosmarrëveshjen.

Neni 1081

Në qoftë se administrimi u takon në mënyrë të përbashkët disa anëtarëve, është i nevojshëm pëlqimi i të gjithë ortakëve administratorë për kryerjen e veprimeve të shoqërisë.

Në qoftë se është vendosur që për administrimin ose për veprime të caktuara të jetë i nevojshëm miratimi i shumicës, kjo përcaktohet sipas paragrafit të fundit të nenit 1080 të këtij Kodi.

Në rastet e parashikuara në këtë nen, administratorët e veçantë nuk mund të kryejnë vetëm ndonjë veprim, veç në raste të ngutshme, kur duhet shmangur një dëm që i kanoset shoqërisë.

Neni 1082

Heqja e administratorit të emëruar në kontratën e shoqërisë mund të bëhet për një shkak të drejtë.

Administratori i emëruar me një akt të veçantë mund të hiqet sipas dispozitave të kontratës së porosisë. Në një rast të tillë heqja e tij mund të kërkohet edhe në rrugë gjyqësore nga çdo anëtar.

Neni 1083

Të drejtat dhe detyrimet e administratorëve rregullohen me dispozitat mbi porosinë. Administratorët janë përgjegjës solidarisht ndaj shoqërisë për përmbushjen e detyrimeve që u janë ngarkuar me ligj ose nga kontrata e shoqërisë, përveç kur provojnë se nuk kanë faj.

Neni 1084

Anëtarët që nuk marrin pjesë në administrim kanë të drejtë që të marrin njoftim nga administratorët për ecurinë e punëve të shoqërisë, të konsultohen me dokumentet që lidhen me administrimin dhe të marrin një raport kur të jenë kryer punët për të cilat është krijuar shoqëria.

Në qoftë se kryerja e punëve të shoqërisë zgjat më shumë se një vit, anëtarët kanë të drejtë të marrin raportin e administratës në fund të çdo viti, përveç rastit kur kontrata parashikon një afat tjetër.

Neni 1085

Përveç marrëveshjes së kundërt, çdo anëtar ka të drejtë të marrë pjesën e vet të fitimeve pas miratimit të raportit.

Neni 1086

Pjesët që u takojnë anëtarëve në fitimet ose në humbjet prezumohen në përpjesëtim me kuotat e kontribuara. Në qoftë se vlera e kontributeve nuk përcaktohet nga kontrata, caktohet nga gjykata.

Në qoftë se kontrata përcakton vetëm pjesën e çdo anëtari në fitimet, në të njëjtën masë prezumohet se duhet të përcaktohet edhe pjesëmarrja në humbjet.

Neni 1087

Çdo marrëveshje që përjashton një ose më shumë anëtarë nga pjesëmarrja në fitimet ose humbjet, është e pavlefshme.

Marrëdhënie me të tretët

Neni 1088

Shoqëria fiton të drejta dhe merr përsipër detyrime me anë të anëtarëve që kanë të drejtën për ta përfaqësuar.

Në mungesë të dispozitave të tjera në kontratë, përfaqësimi i takon çdo anëtari administrator dhe shtrihet për të gjitha aktet që përfshihen në objektin e shoqërisë. Ndryshimet dhe shuarja e tagrave të përfaqësimit rregullohen me dispozitat për përfaqësimin.

Neni 1089

Kreditorët e shoqërisë mund të kërkojnë të drejtat e tyre mbi pasurinë e shoqërisë. Për detyrimet e shoqërisë gjithashtu përgjigjen personalisht ose solidarisht anëtarët që kanë vepruar në emër dhe për llogari të shoqërisë dhe, po të ketë marrëveshje tjetër, edhe anëtarët e tjerë.

Marrëveshja duhet t'u bëhet e ditur të tretëve me mjete të përshtatshme, në mungesë të marrjes dijeni, kufizimi i përgjegjësisë ose përjashtimi nga përgjegjësia solidare nuk mund t'u kundrejtohet atyre që nuk kanë patur dijeni për të.

Neni 1090

Anëtari, të cilit i kërkohet pagimi i detyrimeve të shoqërisë, mund të kërkojë, edhe kur shoqëria është në likuidim, ekzekutimin paraprak ndaj pasurisë së shoqërisë, duke treguar sendet mbi të cilat kreditori mund të shpërblehet më së miri.

Neni 1091

Ai që bëhet anëtar në një shoqëri të krijuar më parë, përgjigjet së bashku me anëtarët e tjerë për detyrimet e shoqërisë përpara se ta ketë fituar cilësinë e anëtarit.

Neni 1092

Kreditori i veçantë i anëtarit, deri sa zgjat shoqëria, mund të kërkojë të drejtat e tij mbi fitimet që i takojnë debitorit, si dhe marrjen e masave ruajtëse (konservative) mbi kuotën që i takon këtij të fundit në likuidim.

Në qoftë se sende të tjera të debitorit janë të pamjaftueshme për të shpërblyer kreditë e tij, kreditori i veçantë i anëtarit mund të kërkojë, veç kësaj, në çdo kohë likuidimin e kuotës së debitorit të tij. Kuota duhet të likuidohet brenda tre muajve nga paraqitja e kërkesës, përveç kur është vendosur shpërndarja e shoqërisë.

Neni 1093

Nuk pranohet kompensimi midis detyrimit që një i tretë ka ndaj shoqërisë dhe kredisë që ky ka ndaj një anëtari.

SHPËRNDARJA E SHOQËRISË

Neni 1094

Shoqëria shpërndahe:

1. me mbarimin e afatit;
2. me realizimin e objektit të shoqërisë ose për pamundësinë e realizimit të tij;
3. me vullnetin e të gjithë anëtarëve;
4. për shkaqe të tjera të parashikuara në kontratën e shoqërisë.

Neni 1095

Kontrata e shoqërisë zgjatet në heshtje për një kohë të pacaktuar kur, sado që ka kaluar afati i parashikuar në kontratë, anëtarët vazhdojnë të kryejnë veprime të shoqërisë.

Neni 1096

Pas shpërndarjes së shoqërisë anëtarët administrues ruajnë pushtetin e administrimit vetëm për çështjet e ngutshme, derisa të ndërmerren veprimet e nevojshme për likuidimin.

Neni 1097

Në qoftë se kontrata nuk parashikon mënyrën e likuidimit të pasurisë dhe anëtarët nuk janë në një mendje për ta përcaktuar atë, likuidimi bëhet nga një ose disa likuidues, të emëruar me pëlqimin e të gjithë ortakëve ose, në rast mosmarrëveshjeje, nga gjykata.

Likuiduesit mund të revokohen me vullnetin e të gjithë ortakëve dhe në çdo rast nga gjykata me kërkesën e arsyetuar të njërit ose të disa anëtarëve.

Neni 1098

Detyrimet dhe përgjegjësitë e likuiduesve rregullohen sipas rregullave të vendosura nga administratorët, përderisa nuk parashikohet ndryshe nga dispozitat e mëposhtme ose nga kontrata e shoqërisë.

Neni 1099

Administratorët duhet t'u dorëzojnë likuiduesve sendet dhe dokumentet e shoqërisë dhe t'u paraqesin atyre llogarinë e administrimit për periudhën pas raportimit të fundit.

Likuiduesit duhet të marrin në dorëzim sendet dhe dokumentet e shoqërisë dhe të hartojnë, së bashku me administratorët, inventarin nga ku të rezultojë gjendja aktive dhe pasive e pasurisë së shoqërisë. Inventari duhet të nënshkruhet nga administratorët dhe nga likuiduesit.

Neni 1100

Likuiduesit mund të kryejnë aktet e nevojshme për likuidim dhe, po qe se anëtarët nuk kanë parashikuar ndryshe, mund të shesin edhe në bllok pasurinë e shoqërisë dhe të bëjnë marrëveshje e kompromise.

Ata përfaqësojnë shoqërinë edhe në gjykim.

Neni 1101

Likuiduesit nuk mund të ndërmarrin veprime të reja. Në rast të kundërt ata përgjigjen personalisht dhe solidarisht për punët e filluara.

Neni 1102

Likuiduesit nuk mund të ndajnë midis anëtarëve, qoftë edhe pjesërisht, pasurinë e shoqërisë, derisa të mos jenë paguar kreditorët e shoqërisë, ose të mos jenë vënë mënjanë shumat e nevojshme për të paguar ata.

Në qoftë se fondet në dispozicion janë të pamjaftueshme për pagimin e detyrimeve të shoqërisë, likuiduesit mund t'u kërkojnë anëtarëve derdhjet për të cilat ata ende detyrohen në kuotat përkatëse dhe, po të jetë nevoja, shumat e nevojshme në kufijtë e përgjegjësisë përkatëse dhe në përpjesëtim me pjesën e secilit në humbjet. Në të njëjtin përpjesëtim pjesëtohet midis anëtarëve detyrimi i anëtarit me paaftësi për të paguar.

Neni 1103

Anëtarët që kanë kontribuar me pasuri për t'u përdorur, kanë të drejtë ta marrin atë përsëri në gjendjen në të cilën ndodhet. Po qe se sendet kanë humbur ose janë dëmtuar për shkaqe që mund t'u ngarkohen administratorëve, anëtarët kanë të drejtë për shpërblimin e dëmit në ngarkim të pasurisë së shoqërisë, përveç rastit kur mund të ngrihet padi kundër administratorëve.

Neni 1104

Pasi shlyhen detyrimet e shoqërisë, aktivi i mbetur destinohet për pagimin e kuotave të kontributeve. Teprica e mundshme ndahet midis anëtarëve në përpjesëtim me pjesën e secilit në fitim.

Vleftha e kuotave të kontributeve që nuk kanë për objekt shuma parash, përcaktohet sipas vlerësimit që është bërë në kontratë ose, në mungesë të tij, sipas vleftës që ata kanë patur në momentin kur janë dhënë.

Neni 1105

Në qoftë se në marrëveshje është parashikuar që ndarja e sendeve të bëhet në natyrë, zbatohen dispozitat mbi ndarjen e sendeve të përbashkëta.

ZGJIDHJA E MARRËDHËNIES
SË NJË ANËTARI ME SHOQËRINË
Neni 1106

Çdo anëtar mund të tërhiqet nga shoqëria kur ajo është formuar për një kohë të pacaktuar ose për gjithë jetën e njërit prej anëtarëve.

Veç kësaj mund të tërhiqet në rastet e parashikuara në kontratën e shoqërisë ose kur ekziston një shkak i drejtë.

Në rastet e parashikuara në paragrafin e parë, tërheqja duhet t'u komunikohet anëtarëve të tjerë të paktën tre muaj përpara.

Neni 1107

Përveç kur në kontratën e shoqërisë është parashikuar ndryshe, në rast vdekjeje të njërit prej anëtarëve, të tjerët duhet të likuidojnë kuotën në favor të trashëgimtarëve, veç kur preferojnë të shpërndajnë shoqërinë ose ta vazhdojnë më vete trashëgimtarët, dhe këta japin pëlqimin.

Neni 1108

Përfshirja e një anëtari mund të ndodhë për shkak mospërmbushjeje të rëndësishme të detyrimeve që rrjedhin nga ligji ose nga kontrata e shoqërisë, si dhe për ndalimin, pazotësinë ose për dënimin e tij me një masë që përfshin edhe ndalimin, qoftë edhe të përkohshëm, nga detyrat zyrtare.

Anëtari që ka dhënë si kontribut në shoqëri veprën e vet ose gëzimin e një sendi, mundet gjithashtu të përjashtohet për shkak të papërshtatshmërisë së menjëhershme për të kryer veprën e dhënë ose për humbjen e sendit, që ka ndodhur për shkaqe që nuk mund t'u ngarkohen administratorëve.

Gjithashtu, mund të përjashtohet anëtari që ka kontribuar me anë të transferimit të pronësisë së një sendi, në qoftë se ky humbet përpara se sendi të fitohet nga shoqëria.

Neni 1109

Përfshirja vendoset nga shumica e anëtarëve, duke mos përfshirë në numrin e tyre anëtarin për t'u përjashtuar dhe ka efekt pas 30 ditëve nga data kur i është bërë njoftimi anëtarit të përjashtuar.

Brenda këtij afati ortaku i përjashtuar mund të paraqesë kundërshtim përpara gjykatës, e cila mund të pezullojë zbatimin e vendimit.

Po qe se shoqëria përbëhet nga dy anëtarë, përjashtimi i njërit bëhet nga gjykata me kërkesën e tjetrit.

Neni 1110

Përjashtohen nga shoqëria edhe:

- a) anëtari që është deklaruar i falimentuar;

b) anëtari ndaj të cilit një kreditor i tij i caktuar ka arritur të ketë të drejtën e likuidimit të kuotës sipas nenit 1092 të këtij Kodi.

Përfshirja e parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni nuk zbatohet në rastet kur falimentimi i anëtarit është pasojë e falimentimit të shoqërisë.

Neni 1111

Në rastin kur nga shoqëria largohet vetëm një anëtar, ky dhe trashëgimtarët e tij kanë të drejtë vetëm për një shumë të hollash që përfaqësojnë vlerën e kuotës.

Likuidimi i kuotës bëhet në bazë të gjendjes pasurore të shoqërisë ditën kur ndodh largimi i anëtarit.

Në qoftë se ka aktivitete në vazhdim, anëtari dhe trashëgimtarët e tij kanë pjesë në fitimet dhe humbjet që kanë të bëjnë me këto aktivitete. Përveç sa parashikohet në nenin 1092, pagimi kuotës që i takon ortakut duhet bërë brenda 6 muajve nga dita e largimit të tij.

Neni 1112

Në rastin kur nga shoqëria largohet vetëm një anëtar, ky ose trashëgimtarët e tij janë përgjegjës ndaj të tretëve për detyrimet e shoqërisë deri në ditën kur ai është larguar.

Largimi duhet t'u bëhet i ditur të tretëve me mjete të përshtatshme, përndryshe, ajo nuk mund t'u kundrejtohet të tretëve që, jo për fajin e tyre, nuk e kanë ditur.

KREU XXIII SIGURIMI

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1113

Me kontratën e sigurimit, njëra palë (siguruesi), në qoftë se vërtetohet ngjarja e parashikuar në kontratë, detyrohet:

a) në rastin e sigurimit të pasurisë t'i shpërblejë palës tjetër ose një personi të tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, dëmin e pësuar brenda kufijve të shumës që është parashikuar në kontratë;

b) në rastin e sigurimit të personit t'i paguajë palës tjetër ose një personi të tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, shumën e sigurimit që është parashikuar në kontratë.

I siguruari detyrohet të paguajë primin (çmimin e sigurimit) të caktuar në kontratë.

Siguruesi mund të jetë person publik ose privat.

Neni 1114

Kontrata e sigurimit duhet të bëhet me shkresë, me anë të dëshmisë të sigurimit (policës së sigurimit) që siguruesi i lëshon të siguarit, përndryshe është e pavlefshme.

Neni 1115

Në dëshminë e sigurimit të tregohen sidomos:

a) emri i siguruesit;

b) emri i personit të siguruar, në rastin e sigurimit të personit, pasuria e siguruar dhe vendi ku ndodhet kjo pasuri në rastin e sigurimit të pasurisë;

c) ngjarja me vërtetimin e së cilës siguruksi të përmbushë detyrimin që ka marrë në kontratë;

ç) fillimi dhe mbarimi i kontratës së sigurimit (afati i sigurimit);

d) koha nga e cila fillon përgjegjësia e siguruksit;

e) vlerësimi i pasurisë në ato raste që kjo gjë kërkohet për një lloj të caktuar sigurimi;

ë) primet e sigurimit dhe afatet e pagimit të tyre.

Kur sipas ligjit ose sipas kontratës shpërblimi i sigurimit ose shumat e sigurimit duhet t'i paguhen jo vetëm të siguruksit, por edhe një personi të tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata. Ky kusht duhet të tregohet në dëshminë e sigurimit.

Neni 1116

Kur humbet dëshmia e sigurimit, siguruksi, me kërkesën dhe shpenzimet e të siguruksit, duhet të lëshojë një dublikatë të saj.

Neni 1117

I siguruksi duhet t'i njoftojë siguruksit, me rastin e lidhjes së kontratës, të gjitha rrethanat për të cilat ka dijeni dhe që kanë rëndësi thelbësore për përcaktimin e natyrës dhe të masës së rrezikut.

Quhet se kanë rëndësi thelbësore të gjitha rrethanat për të cilat siguruksi ka pyetur me shkresë të siguruksin.

Kontrata e sigurimit e lidhur pa u marrë përgjigja në ndonjë nga këto pyetje, nuk mund të jetë, për këtë shkak, e pavlefshme.

Neni 1118

Kur pas lidhjes së kontratës së sigurimit del se i siguruksi duke ditur ka dhënë informata jo të sakta në kërkesën ose në dokumentet e paraqitura prej tij dhe në bazë të të cilave është lidhur kontrata e sigurimit, siguruksi brenda tre muajve nga marrja dijeni ka të drejtë:

a) të ndryshojë masën e primit të sigurimit, të shumës së sigurimit ose afatin e sigurimit;

b) të zgjidhë kontratën e sigurimit në rast se ka rrethana të tilla, që po t'i dinte siguruksi nuk do të kishte lidhur kontratën. Në këtë rast, primet e sigurimit deri në kohën që kërkohet prishja e kontratës, e në çdo rast primi i sigurimit për t'u paguar në vitin e parë të kontratës, nuk i kthehen të siguruksit.

Në qoftë se vërtetohet ngjarja e sigurimit përpara se të fillojë afati i treguar në paragrafin e mësipërm, siguruksi nuk është i detyruar të paguajë shumën e sigurimit.

Kur kontrata e sigurimit është lidhur për më shumë se një person ose sende, ajo mbetet e vlefshme për ata persona ose sende, të cilëve nuk u referohen deklaratimet e pasakta apo heshtja.

Neni 1119

Dhënia e informatave të pasakta në kërkesën ose në dokumentet e paraqitura, në bazë të të cilave është lidhur kontrata e sigurimit, ose lënia në harresë e informatave kur vërtetohet se nuk janë bërë me dashje ose nga pakujdesia e rëndë, nuk përbën shkak për zgjidhjen e kontratës, por siguruksi

mund të heqë dorë nga kontrata, duke e njoftuar të siguarin me shkrim, brenda 3 muajve nga marrja dijani e tyre.

Në qoftë se ngjarja e sigurimit vërtetohet përpara se pasaktësitë e informatave ose lënia në harresë e tyre, të njihen nga siguruesi, ose përpara se të jetë deklaruar heqja dorë nga kontrata, shuma e detyruar ulet në proporcion me diferencën midis shumës së caktuar në kontratë dhe asaj që do të ishte zbatuar, nëse do të njihesh gjendja e vërtetë e fakteve.

Neni 1120

Kur kontrata e sigurimit lidhet në emër e për llogari të të tretëve dhe këta janë në dijeni për pasaktësinë e deklarimeve ose të harresave në lidhje me rrezikun (rastin e sigurimit), në favor të siguruesit zbatohen dispozitat e neneve 1118, 1119 të këtij Kodi.

Neni 1121

Kontrata e sigurimit është e pavlefshme, në qoftë se vërtetohet se rreziku i sigurimit nuk ka ekzistuar asnjëherë ose ka pushuar së qeni para përfundimit të kontratës.

Neni 1122

Kontrata e sigurimit zgjidhet në qoftë se rreziku i sigurimit pushon së qeni pas përfundimit të kontratës, por siguruesi ka të drejtën e pagimit të primeve, derisa pushimi i qenies së rrezikut të sigurimit t'i jetë njoftuar ose t'i jetë bërë e ditur në një mënyrë tjetër.

Neni 1123

I siguruari gjatë kohës që kontrata e sigurimit është në fuqi detyrohet t'i njoftojë siguruesit të gjitha ndryshimet e rrethanave për të cilat ka marrë dijeni pas lidhjes së kontratës së sigurimit dhe që mund të influencojë mbi shtimin e rrezikut.

Në qoftë se i siguruari nuk bën njoftimin e sipërm, siguruesi ka të drejtë, që nga çasti i shtimit të rrezikut, të ndryshojë masën e primit të sigurimit, të shumës së sigurimit, afatin e sigurimit ose të zgjidhë kontratën.

Kur i siguruari nuk pranon ndryshimin ose zgjidhjen e kontratës, ka të drejtë t'i drejtohet me padi gjykatës.

Neni 1124

Kontrata e sigurimit hyn në fuqi në orën 24.00 të ditës së përfundimit të kontratës dhe mbaron në orën 24.00 të ditës së fundit të kohëzgjatjes së kontratës.

Kur afati i kontratës është mbi 10 vjet, palët me kalimin e këtij afati dhe në rast se nuk kanë ndonjë marrëveshje të kundërt, kanë të drejtë të heqin dorë nga kontrata, duke bërë një paralajmërim 6 muaj më parë.

Kontrata mund të zgjatet heshtazi një ose disa herë, por në çdo rast jo më shumë se për dy vjet.

Kjo dispozitë nuk zbatohet për kontratën e sigurimit të jetës.

Neni 1125

Kontraktuesi detyrohet t'i paguajë siguruesit primin e sigurimit në afatet e caktuara në kontratë. Në qoftë se primi ose kësti i parë i tij nuk paguhet në afat, sigurimi pezullohet deri në orën 24.00 të ditës që kontraktuesi paguan shumën që detyrohet.

Kur kontraktuesi nuk paguan primet në vazhdim, sipas afateve të caktuara, sigurimi pezullohet nga ora 24.00 e ditës së pesëmbëdhjetë pas mbarimit të afatit të pagimit dhe siguruesi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës.

Neni 1126

Kur vërtetohet ngjarja e sigurimit, i siguruari detyrohet të njoftojë siguruesin brenda afatit të parashikuar në kontratë. Në qoftë se i siguruari nuk bën këtë njoftim, siguruesi ka të drejtë të mos paguajë shpërblimin e sigurimit ose shumën e sigurimit.

Neni 1127

I siguruari ose personi i tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata e sigurimit, detyrohet të provojë se ka ndodhur ngjarja e sigurimit dhe, në sigurimin e pasurisë të provojë edhe sasinë e dëmit, si dhe t'i njoftojë siguruesit, sipas kërkesës së këtij, të gjitha informatat që janë në dijeni të tij dhe që kanë lidhje me ngjarjen e sigurimit. Në rastin e sigurimit të personit, kur vërtetohet humbja e aftësisë për punë, bëhet edhe ekspertimi mjekësor.

Kur nuk përmbushen detyrimet e sipërme, siguruesi ka të drejtë të mos paguajë shpërblimin e sigurimit ose shumën e sigurimit.

Neni 1128

Shpërblimi i sigurimit ose shuma e sigurimit që duhet t'i paguhet jo të siguararit, por personit të tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, nuk mund të sekuestrohet për borxhet e të siguararit.

Siguruesi ka të drejtë të ndalojë nga shpërblimi i sigurimit ose nga shuma e sigurimit atë që ka për të marrë i siguruari nga e njëjta kontratë e sigurimit (primin etj.).

Neni 1129

Siguruesi mund t'i kundrejtojë personit, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, të gjitha prapësimet që ai mund t'i kundrejtojë të siguararit nga e njëjta kontratë sigurimi.

Neni 1130

Kur një person lidh një kontratë sigurimi në emër të një tjetri, pa patur një tagër të tillë prej tij, ky i fundit mund të pranojë kontratën e lidhur edhe pas vërtetimit të ngjarjes së sigurimit.

Personi që ka lidhur kontratën është i detyruar të zbatojë vetë detyrimet që rrjedhin nga kontrata, deri në momentin kur siguruesi ka marrë njoftim për pranimin ose jo të saj, nga personi në emër të të cilit është lidhur kontrata.

Çmimi i sigurimit i paguhet siguruesit nga kontraktuesi i mësipërm, për të gjithë periudhën deri në momentin kur siguruesi ka marrë dijeni për mospranimin e kontratës.

Neni 1131

Siguruesi nuk është përgjegjës kur vdekja ose humbja e aftësisë për punë të të siguarit, si dhe kur humbja ose dëmtimi i pasurisë janë shkaktuar drejt për drejt nga veprime lufte, përveç kur në kontratën e sigurimit është parashikuar ndryshe.

Neni 1132

Kushtet për llojet e ndryshme të sigurimit vullnetar të pasurisë dhe të personit caktohen në kontratë.

Neni 1133

Dispozitat e këtij kreu nuk shtrihen mbi sigurimin e detyrueshëm, i cili rregullohet nga dispozita të veçanta.

Sigurimi në lundrimin detar rregullohet nga Kodi i Lundrimit Detar.

SIGURIMI I PASURISË

Neni 1134

Personi që lidh kontratën e sigurimit të pasurisë ose personi i tretë, në dobi të të cilit lidhet kontrata, duhet të ketë interes pasuror në objektin e siguruar përndryshe kontrata e sigurimit është e pavlefshme.

Neni 1135

Kur pas lidhjes së kontratës së sigurimit pushon interesi pasuror i të siguarit, ose i personit të tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, kjo quhet e zgjidhur.

Neni 1136

Shuma e sigurimit nuk mund të jetë më e madhe se vlefë e pasurisë. Kjo vlefë, për disa lloje sigurimi, mund të jetë e përcaktuar në kontratën e sigurimit edhe me anë vleftësimi të pasurisë.

Me vlefë duhet të kuptohet vlera më e madhe që ka patur pasuria në kohën e vërtetimit të rastit faktor.

Në sigurimin e prodhimeve të tokës, dëmi përcaktohet në raport me vlerën që do të kishin prodhimet në kohën e pjekjes së tyre, ose kur mblidheshin zakonisht.

Kur është siguruar vetëm një pjesë e vleftës së pasurisë, shumta e sigurimit nuk mund të jetë më e madhe se vlefë e pjesës së pasurisë të siguar.

Kur shkelen kushtet e sipërme, kontrata e sigurimit është e vlefshme, sipas rastit, për një shumë të barabartë me vleftën ose me pjesën e vleftës së pasurisë të siguar.

Neni 1137

Kur pasuria e siguruar humbet ose dëmtohet, shpërblehet, sipas rastit, vlefë e saj brenda kufijve të shumës së sigurimit ose pakësimi i vleftës së pasurisë, përveç kur në kontratën e sigurimit është parashikuar ndryshe.

Siguruesi përgjigjet për fitimin e munguar, vetëm në qoftë se është parashikuar shprehimisht në kontratë.

Neni 1138

Kur pasuria e siguruar ka humbur pjesërisht ose është dëmtuar dhe për këtë është paguar shuma jo e plotë e sigurimit, pasuria që ka mbetur quhet e siguruar gjer në fund të afatit të caktuar në kontratë për një shumë të barabartë me diferencën midis shumës së sigurimit dhe shpërblimit që është paguar.

Neni 1139

Kur shuma e sigurimit është më e vogël nga vleftha e pasurisë së siguruar, shpërblimi i dëmit caktohet në përpjesëtim me raportin midis shumës së sigurimit dhe vleftës së pasurisë të siguruar, përveç kur në kontratë parashikohen ndryshe.

Neni 1140

I siguruari detyrohet të ruajë me kujdes pasurinë e siguruar, sipas dispozitave kundër zjarrit, dispozitave agronomike dhe veterinare. Siguruesi ka të drejtë të kontrollojë pasurinë e siguruar dhe të kërkojë nga i siguruari që të marrë masa për ruajtjen e mirë të pasurisë dhe për zhdukjen e çrregullimeve që janë konstatuar. Kur i siguruari shkel detyrimin e sipërm, siguruesi ka të drejtë të zgjidhë kontratën e sigurimit.

Neni 1141

Kur vërtetohet ngjarja e sigurimit, i siguruari detyrohet të marrë të gjitha masat që varen nga ai për të shpëtuar dhe ruajtur pasurinë e siguruar me qëllim që të ndalohet ose pakësohet dëmi.

Siguruesi nuk detyrohet të paguajë shpërblim për atë pjesë të dëmit që u shkaktua nga mosmarrja prej të siguruarit të masave që mund të merreshin prej tij për të shpëtuar dhe ruajtur pasurinë e siguruar.

Siguruesi detyrohet të paguajë shpenzimet për masat e nevojshme që janë marrë për të shpëtuar dhe ruajtur pasurinë e siguruar, pavarësisht nëse është arritur ose jo qëllimi, përveç kur siguruesi provon se mjetet e përdorura dhe shpenzimet e bëra, janë përdorur ose janë bërë pa kujdes. Siguruesi përgjigjet për dëmet materiale të shkaktuara mbi sendet e siguruara nga mjetet e përdorura nga i siguruari për të shmangur ose zvogëluar dëmet e ndodhura në ngjarjen e sigurimit, përveç kur provon që mjetet e tilla janë përdorur pa kujdes dhe pa qenë të domosdoshme.

Neni 1142

Siguruesi që ka paguar shpërblimin e sigurimit ka të drejtë të kërkojë kthimin e shumës së paguar nga personat që janë përgjegjës për shkaktimin e dëmit.

Neni 1143

Siguruesi shkarkohet nga detyrimi për të paguar shpërblimin e sigurimit, në qoftë se rasti i sigurimit është shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia e rëndë e të siguruarit ose e personit në dobinë e të cilit është lidhur kontrata e sigurimit.

Në sigurimin e pasurisë së personave, siguruesi shkarkohet nga detyrimi për të paguar shpërblimin e sigurimit edhe kur ngjarja e sigurimit është shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia e rëndë e anëtarëve madhorë të familjes së të siguruarit.

Neni 1144

Kur pasuria e siguruar kalon në pronësinë e një personi tjetër, kontrata e sigurimit quhet e zgjidhur. Në këtë rast primi i paguar i kthehet të siguruarit në përpjesëtim me kohën që mbetet gjer në mbarimin e afatit të kontratës së sigurimit.

Neni 1145

Kur për të njëjtin rrezik sigurimi janë lidhur veçmas disa kontrata sigurimi në sigurues të ndryshëm, i siguruari duhet të njoftojë secilin sigurues, për të gjitha sigurimet.

Kur i siguruari me qëllim nuk jep njoftimin e sipërm, siguruesit nuk janë të detyruar të paguajnë shpërblimin e dëmit.

Kur vërtetohet ngjarja e sigurimit, i siguruari duhet të njoftojë të gjithë siguruesit, duke i treguar secilit emërtimin e të tjerëve sigurues.

I siguruari ka të drejtë të kërkojë nga secili sigurues shlyerjen e dëmit të detyruar sipas kontratës, por gjithsesi shumat e shlyera së bashku nuk duhet të kalojnë shumën e dëmit.

Neni 1146

Siguruesi që ka paguar shumën e dëmit ka të drejtën e regresit ndaj siguruesve të tjerë për ndarjen e shumës së detyruar sipas kontratave përkatëse.

Kur një sigurues është me paaftësi paguese, pjesa e tij ndahet ndërmjet siguruesve të tjerë.

Neni 1147

Sigurimi i mallrave kundër rreziqeve të transportimit tokësor, ujor të brendshëm dhe ajror përfshin të gjitha dëmet që mund të pësojnë mallrat gjatë transportimit të tyre, përveç kur është caktuar ndryshe nga ligji.

Neni 1148

Kontrata e sigurimit të mallrave kundër rreziqeve të transportimit hyn në fuqi që nga çasti që mallrat i janë dorëzuar transportuesit dhe vazhdon gjer sa këto t'i dorëzohen pritësit, përveç kur në kontratë është parashikuar ndryshe.

Neni 1149

Kur mallrat e transportuara merren në dorëzim nga pritësit pa u mbajtur në këtë rast procesverbal, siguruesi nuk përgjigjet për dëmtimin ose mungesën e mallrave, përveç kur është parashikuar ndryshe me ligj.

SIGURIMI I PERSONIT

Neni 1150

Kontrata e sigurimit të personit mund të lidhet për rastin e vërtetimit të ngjarjeve që kanë të bëjnë me jetën dhe aftësinë për punë të të siguruarit

Neni 1151

Në kontratën e sigurimit të personit shuma e sigurimit caktohet me marrëveshje të palëve dhe sipas dispozitave të tjera mbi sigurimet.

Neni 1152

Kontrata e sigurimit është e vlefshme edhe kur sigurohet jeta e një të treti. Caktimi i personit bëhet në kontratën e sigurimit, ose me deklaratë me shkrim të mëvonshme, që i njoftohet siguruesit, ose me testament.

Neni 1153

I siguruari mund të caktojë në kontratën e sigurimit që, në rast se ai vdes, shuma e sigurimit t'i paguhet një anëtar të familjes së tij, një personi tjetër, shtetit, ose një personi tjetër juridik publik.

Neni 1154

I siguruari gjatë kohës që kontrata e sigurimit është në fuqi, ka të drejtë që të zëvendësojë me një tjetër personin që ka caktuar për të marrë shumën e sigurimit. Për këtë i siguruari detyrohet të njoftojë me shkresë siguruesin dhe të paraqesë dëshminë e sigurimit për të bërë në të shënimet e nevojshme.

Neni 1155

Caktimi i personit që përfiton nga sigurimi mund të revokohet nga kontraktuesi në formën dhe mënyrën që përdoret për caktimin e tij.

Revokimi nuk mund të bëhet nga trashëgimtarët pas vdekjes së kontraktuesit, pasi të jetë vërtetuar ngjarja e sigurimit e personi ka deklaruar se e dëshiron këtë përfitim.

Heqja dorë e kontraktuesit dhe deklarata e përfituesit duhet t'i njoftohen me shkrim siguruesit.

Neni 1156

Caktimi i personit që përfiton nga sigurimi, dhe pse mund të jetë i parevokueshëm, nuk ka efekt kur është rasti i parashikuar në shkronjën “a” të nenit 771 të këtij Kodi.

Neni 1157

Kur në dëshminë e sigurimit nuk është treguar personi që mund të marrë shumën e sigurimit, si dhe kur personi i treguar ka vdekur para të siguruarit, pa u zëvendësuar me një person tjetër, ose kur ai me dashje ka vrarë, ose ka tentuar të vrasë të siguruarin, shuma e sigurimit i paguhet të siguruarit, dhe në qoftë se ky ka vdekur, trashëgimtarëve të tij ligjorë ose me testament.

Neni 1158

Kur për të marrë shumën e sigurimit janë caktuar më shumë persona dhe disa prej tyre kanë vdekur para të siguruarit, ose disa prej tyre me dashje kanë vrarë ose kanë tentuar të vrasin të siguruarin, pjesët që u takojnë këtyre ndahen midis personave të tjerë të caktuar për të marrë shumën e sigurimit në përpjesëtim me pjesën që i është caktuar secilit prej tyre.

Në rast se në kontratë nuk përmenden pjesët e personave të caktuar për të marrë shumën e sigurimit, prezumohet se ato janë të barabarta

Neni 1159

Ndryshimet e profesionit ose të veprimtarisë së të siguruarit kur sjellin pushimin e efekteve të sigurimit, në rast se ato nuk rritin rrezikun në mënyrë të tillë që, në qoftë se kjo gjendje e re do të kishte ekzistuar në kohën e lidhjes së kontratës, siguruesi nuk do ta kishte lidhur atë.

Në rast se ndryshimet janë të një natyre të tillë që, gjendja e re edhe po të kishte ekzistuar në kohën e lidhjes së kontratës, siguruesi do ta kishte lidhur kontratën për një çmim më të lartë, pagimi i shumës së sigurimit pakësohet në përpjesëtim me çmimin më të ulët, të caktuar në raport me atë çmim që ka qenë përcaktuar në fillim.

Në qoftë se i siguruari njofton për ndryshimet e mësipërme siguruesin, ky, brenda 15 ditëve, duhet të deklarojë nëse do të zgjidhë kontratën apo të pakësojë shumën e sigurimit ose të ngrejë çmimin.

I siguruari, brenda 15 ditëve duhet të deklarojë nëse pranon ndryshimet e sipërme në kontratë. Në qoftë se i siguruari deklaron se nuk i pranon ato, kontrata zgjidhet.

Neni 1160

Shuma e sigurimit, që pas vdekjes së të siguruarit është caktuar t'i paguhet personit në dobinë e të cilit është lidhur kontrata e sigurimit, nuk përfshihet në pasurinë trashëgimore të të siguruarit.

Neni 1161

Shumat e sigurimit që rrjedhin nga kontratat e sigurimit të personit, paguhen pavarësisht nga shumat që mund të paguhen nga sigurimet shoqërore.

TITULLI III DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 1162

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë zbatohet për marrëdhëniet juridike të krijuara pas hyrjes në fuqi të tij.

Neni 1163

Për parashkrimin e padisë dhe parashkrimin fitues, që kanë filluar të ecin para hyrjes në fuqi të këtij Kodi, por që nuk janë plotësuar sipas dispozitave të mëparshme, do të zbatohen këto të fundit.

Neni 1164

Dispozitat e këtij Kodi lidhur me posedimin, zbatohen edhe për posedimet që kanë filluar përpara hyrjes në fuqi të tij.

Neni 1165

Rregullimi juridik i afatit dhe i çmimit të qirasë në kontratën e qirasë së banesave, do të vazhdojë të bëhet sipas dispozitave të mëparshme, deri në liberalizimin e plotë të kësaj kontrate me dispozita të veçanta.

Neni 1166

Kontratat e veçanta të lidhura para hyrjes në fuqi të tij dhe që vazhdojnë të zbatohen, do të rregullohen sipas dispozitave të këtij Kodi.

Neni 1167

Ligji nr.6340, datë 26.6.1981 “Për Kodin Civil”, përveç dispozitave për bashkëpronësinë ndërmjet bashkëshortëve, ligji nr. 2362, datë 16.11.1956 “Për organizatat shoqërore që nuk ndjekin qëllime ekonomike”, ligji nr.7688, datë 13.3.1993 “Për bashkëpronësinë në banesa”, ligji nr. 7695, datë 7.4.1993 “Për fondacionet” nenet 1-15, dekreti nr.600, datë 22.7.1993 “Për pengun dhe hipotekën”, miratuar me ndryshime me ligjin nr.7753, datë 30.9.1993, shfuqizohen.

Neni 1168

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë hyn në fuqi më 1 nëntor 1994.

Dispozitë e parashikuar me ligjin nr.17/2012, datë 16.2.2012

Për çështjet civile me objekt shpërblimin e dëmit jopasuror ndaj reputacionit, që janë ende në proces në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të zbatohet legjislacioni civil në fuqi, në kohën e ngritjes së padive për shpërblimin e dëmit jopasuror.

Dispozitë kalimtare

(Parashikuar me ligjin nr. 121/2013, datë 18.4.2013)

Dispozitat për trashëgiminë janë të zbatueshme vetëm për kërkesat për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë, të bëra pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Çështjet gjyqësore me objekt “kërkesë për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë” do të vazhdojnë të shqyrtohen nga gjykata kompetente, sipas ligjit të kohës së paraqitjes së kërkesës.

Dispozitat mbi agjencinë janë të zbatueshme për kontratat e agjencisë, të lidhura pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

LIGJ
Nr. 44/2015

KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

KREU I
QËLLIMI, FUSHA E ZBATIMIT DHE PËRKUFIZIME

Neni 1

Qëllimi i ligjit

Ky Kod ka për qëllim të sigurojë realizimin efektiv të funksioneve publike administrative në shërbim të personave, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshëm të tyre, në realizimin e këtyre funksioneve, duke zbatuar parimin e procesit të rregullt ligjor.

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Ky Kod zbatohet kur organi publik, në ushtrimin e funksioneve publike administrative, të rregulluara nga e drejta administrative:

a) vendos për të drejtat, detyrimet dhe interesat e ligjshëm të personave, si dhe çdo rast tjetër, kur ligji parashikon shprehimisht nxjerrjen e një akti administrativ;

b) lidh një kontratë administrative apo kryen një veprim tjetër administrativ, i cili ka të bëjë me të drejtat, detyrimet dhe interesat e ligjshëm të personave.

2. Dispozitat e këtij Kodi zbatohen edhe për rastet kur:

a) personat juridikë, publikë apo privatë, që ushtrojnë funksione vetë-rregulluese në fushën e profesioneve të rregulluara, të krijuara me ligj apo që u është dhënë e drejta e ushtrimit të këtyre funksioneve, në bazë të legjislacionit në fuqi, vendosin sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni;

b) personat privatë, të cilëve u është dhënë e drejta për të ushtruar funksione, detyra ose kompetenca publike, në bazë të legjislacionit në fuqi, vendosin sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni;

c) personat juridikë, publikë apo privatë, të cilët ofrojnë shërbime publike, vendosin mbi të drejtat dhe detyrimet e përdoruesve të shërbimit.

3. Parimet e sanksionuara në këtë Kod zbatohen për aq sa është e mundur edhe mbi aktet normative nënligjore.

Neni 3

Përkufizimet

Në këtë Kod termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Akti administrativ”:

a) “Akti administrativ individual” është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

b) “Akti administrativ kolektiv” është një shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që i drejtohet një grupi subjektsh, anëtarët e të cilit janë të përcaktuar individualisht ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

c) “Akti i garancisë” është një akt administrativ individual, me anë të të cilit organi publik, nëse kjo parashikohet me ligj të veçantë, mund të sigurojë paraprakisht, se ai do të nxjerrë ose nuk do të nxjerrë një akt të caktuar administrativ individual në një datë të mëvonshme.

2. “Akt normativ nënligjor” është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij.

3. “Diskrecioni i organit publik” është e drejta e këtij të fundit për të ushtruar autoritet publik për të përmbushur një qëllim të ligjshëm, në rastet kur ligji parashikon pjesërisht modalitetet për të arritur këtë, duke i dhënë hapësirë vlerësimi zgjedhjeve të organit publik.

4. “Kontrata administrative” është një marrëveshje, e cila krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie konkrete, sipas së drejtës publike dhe në të cilën të paktën njëra nga palët kontraktuese është një organ publik.

5. “Kompetenca administrative” është tërësia e kompetencave lëndore dhe kompetencave territoriale të organit të administratës publike, siç është parashikuar në ligj dhe aktet nënligjore.

6. “Organ publik” është çdo organ i pushtetit qendror, i cili kryen funksione administrative, çdo organ i enteve publike, në masën që ato kryejnë funksione administrative; çdo organ i pushtetit vendor që kryen funksione administrative; çdo organ i Forcave të Armatosura, për aq kohë sa kryejnë funksione administrative, si dhe çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislati në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve administrative publike.

7. “Palë” është:

a) çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi; ose

b) një palë që nuk ka një të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pikat 2 dhe 3, të këtij Kodi, por që të drejtat ose interesat e saj ligjshëm mund të cenohen nga rezultati i procedurës.

8. Person është çdo person fizik, juridik, si dhe çdo subjekt i së drejtës, sipas legjislati në fuqi.

9. “Procedurë administrative” është veprimtaria e një organi publik, me qëllim përgatitjen dhe miratimin e veprimeve konkrete administrative, ekzekutimin e tyre dhe rishikimin e tyre me mjete ligjore administrative.

10. “Veprim administrativ” është akti administrativ, kontrata administrative dhe çdo veprim tjetër administrativ.

11. “Veprim tjetër administrativ” është çdo formë e njëanshme e veprimtarisë së organit publik në ushtrimin e funksioneve të tij publike, që nuk plotëson kriteret për të qenë akt administrativ apo kontratë administrative dhe që sjell pasoja juridike për të drejtat subjektive dhe interesat legjitimë.

12. “Veprimtari administrative” është tërësia e akteve dhe veprimeve, që përbëjnë dhe shprehin vullnetin e administratës publike, si dhe ekzekutimin e vullnetit.

KREU II
PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 4

Parimi i ligjshmërisë

1. Organet publike ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca.

2. Të drejtat apo interesat e ligjshëm të një pale nuk mund të cenohen nga veprimi administrativ, përveç se kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor.

Neni 5

Parimi i transparencës

Organet publike ushtrojnë veprimtarinë administrative në mënyrë transparente dhe në bashkëpunim të ngushtë me personat fizikë dhe juridikë të përfshirë në të.

Neni 6

Parimi i informimit

1. Çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion publik, që ka të bëjë me veprimtarinë e organit publik, pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon të drejtën e informimit.

2. Në rastet kur informacioni i kërkuar refuzohet, organi publik merr vendim të arsyetuar me shkrim, i cili përmban edhe udhëzimet për ushtrimin e së drejtës për ankim dhe i njoftohet menjëherë palëve në proces.

Neni 7

Parimi i mbrojtjes së sekretit shtetëror

Çdo nëpunës publik, si dhe çdo person që merr pjesë ose thirret për pjesëmarrje në një procedurë administrative, është i detyruar të mos përhapë të dhëna që i janë bërë të ditura gjatë procedurës administrative, kur ato përbëjnë “Sekret shtetëror”, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 8

Parimi i mbrojtjes së konfidencialitetit

Pjesëmarrësit në një procedurë administrativ kanë të drejtë të kërkojnë që të dhënat e tyre personale dhe konfidenciale të trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 9

Parimi i mbrojtjes së të dhënave

1. Organi publik ka detyrimin që gjatë përpunimit të ligjshëm e të drejtë të të dhënave personale, të të dhënave që lidhen me veprimtarinë tregtare ose profesionale, me të cilat njihet gjatë procedurës administrative dhe që mbrohen sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, të ndërmarrë masa lidhur me mbrojtjen, ruajtjen, mospërhapjen, si dhe konfidencialitetin e tyre.

2. Detyrimi për mbrojtjen, ruajtjen, mos-përhapjen, si dhe konfidencialitetin shtrihet edhe mbi nëpunësin publik, gjatë edhe pas mbarimit të ushtrimit të detyrës.

Neni 10

Parimi i dhënies së ndihmës aktive

1. Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre.

2. Organi publik promovon mundësinë e palës për të aksesuar autoritetin publik në mënyrë elektronike. Kjo mundësi nuk është e lidhur me ndonjë detyrim të palës për të përdorur mjete të komunikimit elektronik.

3. Organi publik, që zhvillon procedurën administrative, siguron që padija e palës të mos përkeqësojë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave që pala gëzon sipas ligjit.

Neni 11

Parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit

Diskrecioni ushtrohet ligjërisht kur ai është në përputhje me kushtet e mëposhtme:

- a) është i parashikuar me ligj;
- b) nuk tejkalon kufijtë e ligjit;
- c) zgjedhja e organit publik është bërë vetëm për të arritur objektivin për të cilin është lejuar diskrecioni dhe është në përputhje me parimet e përgjithshme të këtij Kodi;dhe;
- ç) zgjedhja nuk përbën një shmangie të pajustificuar nga vendimet e mëparshme të marra nga i njëjti organ në raste të njëjta apo të ngjashme.

Neni 12

Parimi i proporcionalitetit

1. Çdo veprim administrativ, i cili, për arsye të mbrojtjes së interesit publik ose të të drejtave të të tjerëve, mund të kufizojë një të drejtë individuale, ose mund të cenojë interesa legjitimë, zhvillohet në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

2. Veprimi administrativ është në përputhje me parimin e proporcionalitetit vetëm kur ky veprim është:

- a) i nevojshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj dhe e arrin atë me mjetet dhe masat që cenojnë më pak të drejtat apo interesat legjitimë të palës;
- b) i përshtatshëm për të arritur qëllimin e parashikuar në ligj; dhe
- c) në përpjesëtim të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë.

Neni 13

Parimi i drejtësisë dhe i paanësisë

Në ushtrimin e funksioneve të tij, organi publik trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha subjektet me të cilat krijon marrëdhënie.

Neni 14

Parimi i objektivitetit

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, organet publike marrin në konsideratë dhe i japin rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën administrative.

Neni 15

Parimi i përgjegjësisë

Organet publike dhe nëpunësit e tyre, kur kryejnë një procedurë administrative, mbajnë përgjegjësi për dëmet që u shkaktojnë palëve, në përputhje me legjislacionin përkatës.

Neni 16

Parimi i marrjes së vendimeve

Në përputhje me dispozitat e këtij Kodi, një organ publik merr vendime për të gjitha çështjet e ngritura nga një palë, të cilat janë në kompetencë të tij.

Neni 17

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit

1. Organi publik ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me parimin e barazisë.
2. Palët, që janë në situata të njëjta objektive, trajtohen në të njëjtën mënyrë. Në raste të veçanta, kur bëhet një trajtim i diferencuar, ky trajtim duhet të justifikohet vetëm nga karakteristikat objektive që lidhen me rastin e veçantë.
3. Organi publik, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, shmang çdo diskriminim për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, shtetësisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicioneve gjenetike, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë ose për çdo shkak tjetër.

Neni 18

Parimi i deburokratizimit dhe i efijencës

1. Procedura administrative nuk i nënshtrohet ndonjë forme të caktuar, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligji.
2. Procedura administrative zhvillohet sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se afati kohor i parashikuar me ligj për të, me sa më pak kosto për organin publik dhe për palët, në mënyrë që të arrihet çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm.

Neni 19

Parimi i mospagimit në procedurat administrative

1. Procedura administrative është pa pagesë, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe.
2. Tarifa për zhvillimin e një procedure administrative nuk mund të jetë më e madhe se kostoja mesatare e nevojshme për zhvillimin e procedurës, përveçse kur parashikohet ndryshe në ligj.
3. Organi publik që zhvillon procedurën nuk kërkon pagesën e tarifave edhe në rastet kur kjo parashikohet me ligj, kur palët janë në pamundësi për të paguar. Kategoritë që janë në kushte pamundësie përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 20

Gjuha dhe përkthimi në procedurën administrative

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, procedura administrative kryhet në gjuhën dhe shkrimin shqip.

2. Nëse pala duhet të paraqesë një kërkesë brenda afatit dhe e bën këtë në një gjuhë të huaj, organi publik e njofton palën për detyrimin për ta paraqitur kërkesën në gjuhën dhe shkrimin shqip. Nëse për arsye teknike pala nuk është në gjendje të sigurojë përkthimin brenda datës së përfundimit të afatit të rregullt për paraqitjen e kërkesës, organi publik cakton një afat shtesë të përshtatshëm, brenda të cilit duhet të sigurohet një përkthim i kërkesës dhe dokumenteve të nevojshme.

3. Afati i parashikuar në pikën 2, të këtij neni, fjalia e parë konsiderohet se është respektuar vetëm nëse organi publik merr përkthimin brenda afatit shtesë të caktuar dhe të njoftuar nga organi publik.

4. Nëse kërkesat, të cilat përcaktojnë fillimin e afatit, brenda të cilit organi publik duhet të veprojë, merren në një gjuhë të huaj, afati fillon në datën kur organit publik i vihet në dispozicion një përkthim i tyre.

5. Nëse organi publik nuk përcakton dhe nuk i njofton palës një afat shtesë për përkthimin dhe pasojat ligjore, sipas fjalisë së dytë, të pikës 2, të këtij neni, kërkesa në gjuhë të huaj vlerësohet e paraqitur brenda afatit.

Neni 21

Parimi i kontrollit

Veprimtaria administrative i nënshtrohet:

a) kontrollit administrativ, në përputhje me dispozitat e këtij Kodi mbi mjetet ligjore administrative dhe legjislacionit në fuqi;

b) kontrollit të gjykatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi; dhe/ose

c) çdo kontrolli tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

PJESA E DYTË

JURIDIKSIONI, KOMPETENCA, DELEGIMI DHE ZËVENDËSIMI

KREU I

JURIDIKSIONI DHE KOMPETENCA

Neni 22

Përcaktimi i juridiksionit dhe kompetencës

1. Fusha e ushtrimit të veprimtarisë dhe tërësia e kompetencave të organeve publike, të rregulluara nga legjislacioni në fuqi, përbën juridiksionin administrativ.

2. Kompetencat e organeve publike janë të përcaktuara me ligj, me akt nënligjor, si dhe veprimet administrative të nxjerra në zbatim të tyre. Ushtrimi i tyre është i detyrueshëm.

3. Delegimi ose zëvendësimi i kompetencave mund të bëhet vetëm nëse:

a) parashikohet shprehimisht në ligj;

b) ligji parashikon organin ose nëpunësin zëvendësues ku bëhet delegimi ose zëvendësimi.

Neni 23

Verifikimi i kompetencës

1. Me fillimin e procedurës administrative, organi publik verifikon nëse ka apo jo kompetencë lëndore dhe tokësore për të vendosur për çështjen objekt shqyrtimi.

2. Çdo ndryshim ligjor ose nënligjor i mëvonshëm i kompetencës nuk ka efekt, përveç rasteve kur organi, në të cilin procedura ka nisur, nuk ekziston më, ose kur legjislacioni i ri parashikon ndryshe.

Neni 24

Mungesa e kompetencës

1. Kur një organ publik merr një kërkesë, për një çështje që e vlerëson jashtë kompetencës të vet, ia përcjell kërkesën menjëherë, dhe në çdo rast jo më vonë se dy ditë nga marrja e saj, organit publik kompetent dhe njofton kërkuesin për këtë.

2. Afatet për kërkuesin vlerësohen të respektuara nëse kërkesa është paraqitur në kohë pranë organit jokompetent, ndërsa afatet përkatëse për organin publik kompetent fillojnë të llogariten nga data e marrjes së kërkesës.

3. Palët nuk mund të përcaktojnë apo të ndryshojnë, me marrëveshje, kompetencën e organit publik.

Neni 25

Ndalimi i heqjes dorë nga kompetenca

1. Çdo veprim administrativ, që ka për qëllim heqjen dorë të organit publik nga e drejta për të ushtruar kompetencat ligjore, është i pavlefshëm.

2. Detyrimi për ushtrimin e kompetencave lëndore dhe tokësore dhe parashikimi i pikës 1, të këtij neni, nuk përjashtojnë të drejtën e organit publik për të deleguar kompetencën e tij ligjore në favor të organeve të tjera të administratës, sipas procedurave të parashikuara në këtë Kod.

Neni 26

Kompetenca në rastet urgjente

Nëse organi publik kompetent nuk mund të veprojë apo të veprojë menjëherë për shmangien e një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm që mund t'i shkaktohet interesit publik apo të drejtave a interesave të të tretëve, prefekti në nivel vendor dhe Kryeministri në nivel qendror, kryesisht apo me kërkesë, marrin masa urgjente për shmangien e dëmit. Në këto raste, informohet menjëherë organi publik kompetent për masat e marra.

Neni 27

Mosmarrëveshjet e kompetencave

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, konkurrimi i kompetencave ndërmjet dy ose më shumë organeve publike zgjidhet me marrëveshje me shkrim midis tyre.

2. Në rast se ato nuk arrijnë në një marrëveshje, konflikti zgjidhet nga:

- a) Kryeministri, në rast të konfliktit ndërmjet ministrive të ndryshme;
- b) ministri ose titullari i institucionit qendror ose epror, për institucionet e varësisë;
- c) gjykata administrative, për të gjitha rastet e tjera, për të cilat ajo është kompetente.

3. Zgjidhja e konfliktit mund të kërkohet nga secili prej organeve të përfshira, me marrjen dijeni të konfliktit.

4. Konflikti sipas shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 2, të këtij neni, zgjidhet brenda 10 ditëve nga dita e depozitimit të kërkesës.

KREU II

DELEGIMI I KOMPETENCAVE DHE ZËVENDËSIMI I TYRE

Neni 28

Delegimi i kompetencave

1. Organet publike kompetente mund të delegojnë kompetencat e tyre ligjore te një organ tjetër publik.

2. Organet publike kompetente mund të delegojnë kompetencat e dhëna me ligj ose me akte nënligjore tek organet e tyre vartëse.

3. Organet kolegjiale të administratës publike nuk mund t'i delegojnë kompetencat e tyre në favor të drejtuesve të tyre.

4. Organi i deleguar ndalohet të nëndelegojë te një organ i tretë kompetencat e përfituara përmes delegimit.

5. Çdo vendim i organit delegues, që ka për qëllim autorizimin e organit të deleguar për të nëndeleguar kompetencat e nëndeleguara, është i pavlefshëm.

Neni 29

Procedura e delegimit

1. Kur ligji e lejon, delegimi i kompetencave bëhet në çdo rast me vendim të organit delegues për organet në varësi të tij dhe me vendim ose me marrëveshje në ato raste kur organi i deleguar nuk është në varësi të organit delegues.

2. Në aktin e delegimit përcaktohen:

a) kompetencat e deleguara;

b) financimi i detyrave të deleguara;

c) institucioni i ngarkuar me mbikëqyrjen, si dhe objekti e instrumentet e mbikëqyrjes;

ç) kriteret e ndërprerjes dhe mekanizmat për kryerjen e detyrave të deleguara, në rast të ndërprerjes së delegimit;

d) datën e fillimit të ushtrimit kompetencave të deleguara.

3. Delegimi i kompetencave botohet në Fletoren Zyrtare ose në buletinet e njoftimeve publike. Në rastet e organeve të qeverisjes vendore, delegimi botohet në gazetën e njësisë së qeverisjes vendore apo në buletinet zyrtare të akteve të njësisë të qeverisjes vendore dhe, kur nuk ekziston një i tillë, njoftimi përkatës afishohet në vende publike.

PJESA E TRETË

GARANTIMI I PAANSHMËRISË SË ADMINISTRATËS PUBLIKE

Neni 30

Pengesat ligjore

Nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjial nuk përfshihet në një procedurë administrative vendimmarrëse, në rastet kur:

a) ka një interes personal të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen në shqyrtim;

b) bashkëshorti, bashkëjetuesi ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen në shqyrtim;

c) nëpunësi publik, ose anëtari i organit kolegjial ose edhe personat e parashikuar në shkronjën "b", të këtij neni, kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në një çështje objektive të njëjtë dhe me të njëjtat rrethana ligjore me çështjen në shqyrtim;

ç) nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjial ka marrë pjesë si ekspert, këshilltar, përfaqësues ose avokat privat në çështjen në shqyrtim;

d) personat e përmendur në shkronjën "b", të këtij neni, kanë marrë pjesë si ekspertë përfaqësues, këshilltarë apo avokatë në çështjen në shqyrtim;

dh) ndaj nëpunësit publik ose personave të parashikuar në shkronjën "b", të këtij neni, ka nisur një proces gjyqësor nga palët në procedurën administrative në shqyrtim;

e) çështja në shqyrtim është një ankim kundër një vendimi të marrë nga nëpunësi publik ose nga personat e parashikuar në shkronjën "b" të këtij neni;

ë) nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjial ose personat e përmendur në shkronjën "b", të

këtij neni, janë debitorë ose kreditorë të palëve të interesuara në procedurën administrative në shqyrtim;

f) nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjal ose personat e përmendur në shkronjën “b”, të këtij neni, kanë marrë dhurata nga palët përpara ose pas fillimit të procedurës administrative shqyrtim;

g) nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjal ose personat e përmendur në shkronjën “b”, të këtij neni kanë marrëdhënie të tilla, të cilat vlerësohen sipas rrethanave konkrete se do të përbënin arsye serioze për njëanshmëri me palët në procedurën administrative në shqyrtim;

gj) nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjal ose personat e përmendur në shkronjën “b”, të këtij neni, janë përfshirë në çdo lloj mënyre në:

i) negociime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e nëpunësit apo personave të përmendur në shkronjën “b”, të këtij neni, gjatë ushtrimit të funksionit apo negociime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat, pas lënies së detyrës, të kryera nga ai gjatë ushtrimit të detyrës;

ii) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër;

h) në çdo rast kur parashikohet nga legjislacioni në fuqi.

Neni 31

Vetëdeklarimi i pengesave ligjore dhe kërkesa për përjashtim

1. Nëse nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjal të organit publik vëren një nga pengesat e parashikuara në nenin 30, të këtij Kodi, ai njofton menjëherë me shkrim eprorin e tij ose organin kolegjal.

2. Çdo nëpunës tjetër, i cili ka dijeni mbi rastet e konfliktit të interesit, në përputhje me nenin 30, të këtij Kodi, njofton në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

3. Pala mund të kërkojë përjashtimin e pjesëmarrjes së një nëpunësi apo të një anëtari të organit kolegjal nga një procedurë administrative, deri në kohën e marrjes së vendimit, duke parashtruar arsyet për të cilat kërkohet përjashtimi nga vendimmarrja. Kërkesa bëhet me shkrim, i drejtohet eprorit dhe përmban të gjitha provat e mundshme në të cilat ajo mbështetet.

4. Në çdo rast, deri në marrjen nga eprori të një vendimi përfundimtar, nëpunësi pezullohet nga procesi vendimmarrës.

Neni 32

Vendimmarrja dhe efektet e përjashtimit

1. Eprori ose organi kolegjal, i njoftuar sipas nenit 31, të këtij Kodi, merr vendim për përjashtimin ose konfirmimin e nëpunësit, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit ose kërkesës së palëve.

2. Kur eprori vendos përjashtimin e nëpunësit, në vendimin e përjashtimit caktohet edhe nëpunësi zëvendësues. Nëse organi kolegjal përjashton një anëtar dhe ligji nuk parashikon anëtarë zëvendësues, procedura administrative vazhdon pa zëvendësuar anëtarin e përjashtuar.

3. Kur, për shkak të ligjit apo për shkak të situatës konkrete, vërtetohet se është i pamundur zëvendësimi i një zyrtari me një zyrtar tjetër, lejohet vendimmarrja nga nëpunësi publik.

4. Në rastet e përjashtimit dhe pamundësisë së zëvendësimit, organi funksionon si i tillë pa pjesëmarrjen e anëtarit të përjashtuar.

PJESA E KATËRT
PROCEDURA ADMINISTRATIVE

KREU I
PJESËMARRJA NË PROCEDURËN ADMINISTRATIVE

Neni 33

Pala në procedurën administrative

1. Palë në procedurën administrative, përveç sa parashikohet në nenin 3, të këtij Kodi, është çdo person:

- a) me kërkesë të të cilit ka filluar procedura administrative;
- b) ndaj të cilit ka filluar procedura administrative, ose të cilit i drejtohet apo synohet t'i drejtohet vendimi i procedurës administrative; ose
- c) me të cilin organi publik synon të lidhë apo ka lidhur një kontratë administrative.

2. Në procedurën administrative janë gjithashtu palë edhe mbajtësit e interesave publikë të autorizuar me ligj, si dhe mbajtësit e interesave kolektivë apo interesave të gjerë të publikut, nëse këta interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative.

3. Organi publik që zhvillon procedurën administrative, me kërkesë apo kryesisht, përfshin si palë në procedurë çdo person tjetër, të përcaktuar ose lehtësisht të përcaktueshëm, të ndryshëm nga ato të parashikuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, të cilin, rezultati i procedurës administrative mund ta cenojë në të drejtat apo interesat e tij të ligjshëm.

Neni 34

Zotësia për të vepruar në procedurën administrative

1. Një organ publik, palë në një procedurë administrative, vepron nëpërmjet përfaqësuesit ligjor të përcaktuar sipas ligjit ose titullarit të institucionit, kur nuk ka përfaqësues ligjor të caktuar.

2. Zotësia për të vepruar, në një procedurë administrative, e personave të tjerë rregullohet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 35

Përfaqësimi i palës

1. Pala mund t'i kryejë të gjitha veprimet procedurale personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit, në përputhje me parashikimet e këtij Kodi.

2. Në rastin kur pala vepron e përfaqësuar, organi publik kryen veprimet procedurale me përfaqësuesin.

3. Organi publik mund të kërkojë kryerjen e një ose disa veprimeve procedurale drejtpërdrejt nga pala, në rastet kur parashikohet shprehimisht nga ligji. Në këtë rast, organi publik njofton edhe përfaqësuesin.

Neni 36

Përfaqësuesi i caktuar kryesisht

1. Organi publik, që kryen procedurën, e pezullon procedurën dhe i kërkon autoritetit kompetent sipas ligjit, caktimin e përfaqësuesit ligjor ose përkatësisht zëvendësimin e tij, kur konstaton se palës që nuk ka zotësi të plotë për të vepruar ose ka zotësi të kufizuar për të vepruar nuk i është caktuar ende përfaqësuesi ligjor ose ai ka konflikt interesash me të përfaqësuarin.

2. Në rastin e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, nëse është urgjente dhe nëse e kërkon interesi i palës, organi publik cakton një përfaqësues të përkohshëm për kryerjen e një veprimi të caktuar procedural, ose deri në caktimin apo zëvendësimin e përfaqësuesit ligjor.

3. Organi publik, që kryen procedurën administrative, mund të caktojë një përfaqësues sipas parashikimeve të pikës 2, të këtij neni, edhe kur:

- a) identiteti i palës është i panjohur;
 - b) megjithëse identiteti i palës njihet, është i pamundur njoftimi i saj;
 - c) pala është në pamundësi objektive për të ndjekur interesat e vet dhe nuk ka zgjedhur një përfaqësues;
- ç) pala nuk ka vendqëndrim në Shqipëri dhe nuk ka zgjedhur një përfaqësues brenda afatit të dhënë nga organi publik.

4. Organi publik njofton menjëherë palën për caktimin e përfaqësuesit. Në rastet e parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 3, të këtij neni, organi publik njofton caktimin e përfaqësuesit nëpërmjet njoftimit publik, sipas parashikimeve të këtij Kodi.

5. Përfaqësuesi i caktuar kryesisht, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni, merr pjesë dhe e përfaqëson palën në gjithë procedurën administrative, ose vetëm në veprimin procedural për të cilin është caktuar, deri në paraqitjen e palës apo të përfaqësuesit të zgjedhur prej saj.

Neni 37

Përfaqësuesi i përbashkët

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, dy ose më shumë palë mund të marrin pjesë së bashku në të njëjtën procedurë administrative. Në këtë rast, palët mund të zgjedhin njërin prej tyre si përfaqësues të përbashkët, apo mund të zgjedhin një përfaqësues tjetër të përbashkët, sipas parashikimeve të nenit 38 të këtij Kodi.

2. Edhe kur zgjedhin njërin prej tyre si përfaqësues të përbashkët, secila nga palët mund të marrë pjesë në procedurën administrative personalisht, mund të paraqesë deklarata dhe të ushtrojë mjetet e ankimit në mënyrë të pavarur.

Neni 38

Përfaqësuesi i zgjedhur

1. Pala mund të zgjedhë një përfaqësues, me qëllim kryerjen e disa ose të gjitha veprimeve procedurale në procedurën administrative, përveç rastit kur kërkohet që vetë pala personalisht, të japë një deklaratë ose të kryejë një veprim tjetër procedural.

2. Zgjedhja e përfaqësuesit, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhet në formë të shkruar, deklarohet verbalisht përpara organit publik dhe regjistrohet nga ky fundit ose në çdo formë tjetër të përshtatshme.

3. Zgjedhja e përfaqësuesit është e vlefshme nëse bëhet në formën e përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni. Kjo formë zbatohet edhe në rastin e zgjedhjes së një përfaqësuesi të përbashkët ndërmjet palëve, sipas parashikimit të nenit 37 të këtij Kodi.

4. Pala, kur e vlerëson të nevojshme, mund të kryejë personalisht veprime procedurale apo të japë deklarata, edhe nëse ka zgjedhur një përfaqësues. Pala e pranishme, kur përfaqësuesi jep një deklaratë verbale, menjëherë mund ta ndryshojë ose revokojë këtë deklaratë.

Neni 39

Ndihmësi

1. Pala mund të paraqitet në organin publik në një seancë dëgjimore, e shoqëruar nga një ndihmës, i cili e ndihmon atë në çështje specifike, të nevojshme për procedurën administrative.

2. Çdo deklaratë e ndihmësit konsiderohet si e dhënë nga pala kur kërkohet shprehimisht prej tij/saj. Në çdo rast, pala mund të kundërshtojë aty për aty deklaratën e ndihmësit.

Neni 40

Zotësia për të qenë përfaqësues apo ndihmës

Çdo person që gëzon zotësi të plotë për të vepruar, në bazë të Kodit Civil, mund të veprojë si përfaqësues apo ndihmës, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

KREU II

PARASHIKIME TË PËRGJITHSHME MBI PROCEDURËN ADMINISTRATIVE

Neni 41

Fillimi i procedurës administrative

1. Procedura administrative fillon kryesisht ose me kërkesë.
2. Fillimi i procedurës kryesisht është në diskrecionin e organit publik. Organi publik është i detyruar të fillojë procedurën administrative kryesisht kur:
 - a) ligji ose akti nënligjor parashikon fillimin e procedurës;
 - b) situata faktike është e tillë që organi publik duhet të fillojë procedurën administrative për mbrojtjen e interesit publik.
3. Procedura administrative konsiderohet e filluar:
 - a) me kryerjen e çdo veprimi procedural nga organi publik në rastin e procedurës së filluar kryesisht; ose
 - b) me paraqitjen e kërkesës përpara organit publik, në rastin e procedurës së filluar me kërkesë.

Neni 42

Komunikimi me palët

1. Në rastet kur procedura administrative fillohet nga organi i publik, ky i fundit njofton të gjitha palët në proces për fillimin e veprimeve.
2. Njoftimi, sipas pikës 1, të këtij neni, bëhet me shkrim apo në një takim me palën dhe përmban këto të dhëna:
 - a) adresën postare dhe/ose elektronike të organit publik, që zhvillon procedurën dhe nëpunësin përgjegjës për të;
 - b) informacion lidhur me kompetencën e organit publik, qëllimin e procedurës dhe çështjet për të cilat do të merren vendime;
 - c) palët në procedurën administrative;
 - d) informacion për të drejtën e njohjes së dosjes dhe zyrën ose vendin ku mund të njihet dosja;
 - e) informacion për të drejtën e palës për të dëgjuar, mënyrat dhe afatin e ushtrimit të kësaj të drejte;
 - f) datën e fillimit të procedurës dhe afatin brenda të cilit do të merret dhe njoftohet vendimi përfundimtar, në rast se zbatohet një afat i tillë.
3. Kur njoftimi bëhet me takim, organi publik mban procesverbal për dokumentimin e veprimit të kryer.
4. Organi publik nuk është i detyruar të komunikojë me palët në rastet kur çështja është “Sekret shtetëror”, sipas klasifikimeve të bëra me ligj ose kur në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme komunikimi mund të cenojë efektivitetin e procedurës administrative.

Neni 43

Njësia dhe nëpunësi përgjegjës

1. Në një procedurë administrative, të filluar sipas parashikimeve të nenit 41, të këtij Kodi, organi publik vepron nëpërmjet nëpunësit përgjegjës, të përcaktuar sipas rregullave të këtij neni.
2. Titullari i organit publik, nëse nuk është përcaktuar ndryshe me ligj ose akt nënligjor, cakton

paraprkisht një njësi përgjegjëse për çdo tip procedure administrative në kompetencë të organit, në përputhje me rregullat e brendshme të veprimtarisë së tij. Ky vendim bëhet publik me çdo mjet të përshtatshëm.

3. Drejtuesi i njësisë përgjegjëse merr përsipër vetë ose cakton me akt të shkruar nëpunësin përgjegjës për zhvillimin e procedurës administrative. Nëpunësi përgjegjës zhvillon procedurën administrative dhe në përfundim propozon me shkrim vendimin përfundimtar, ndërsa vendimi merret dhe nënshkruhet nga personi i përcaktuar nga ligji ose aktet nënligjore. Nëse vendimi është i ndryshëm nga ai i propozuar, duhet të shoqërohet me arsyetimin përkatës.

4. Në rastet e parashikuara nga ligji nëpunësi përgjegjës, pasi zhvillon procedurën administrative, vendos për çështjen me vendim përfundimtar dhe e nënshkruan atë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligji.

5. Organi kolegjal mund të ngarkojë njërin nga anëtarët e tij të zhvillojë veprime procedurale administrative. Në këtë rast, anëtari i ngarkuar vë në dijeni mbi rezultatet e procedurës administrative organin kolegjal, i cili vendos për çështjen.

Neni 44

Fillimi i procedurës administrative me kërkesë

1. Kur procedura administrative fillon me kërkesë të palës, organi publik duhet të marrë masat e nevojshme për përgatitjen sa më mirë të çështjes.

2. Organi publik shqyrton paraprkisht kërkesën lidhur me përmbushjen e kritereve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji dhe në përfundim:

a) njofton palën kërkuese me shkrim se kërkesa është pranuar për vazhdimin e procedurës;

b) njofton palën kërkuese me shkrim për plotësimin e të metave lidhur me plotësimin e kritereve formale ligjore, duke caktuar një afat të arsyeshëm. Në këtë rast organi publik ndihmon në mënyrë aktive palën për plotësimin e të metave të konstatuara. Mosplotësimi i të metave brenda afatit të caktuar përbën shkak për mospranimin e kërkesës. Kundër këtij vendimi pala mund të ankohet sipas procedurës të parashikuar në këtë Kod;

c) njofton palën kërkuese se janë të nevojshme veprime të mëtejshme administrative para se të vendosë pranimin ose jo të kërkesës. Në këtë rast organi cakton edhe një afat të arsyeshëm për kryerjen e veprimeve të mëtejshme.

KREU III

TË DREJTAT E PALËVE GJATË PROCEDURËS ADMINISTRATIVE

Neni 45

E drejta e palëve për njohje me dosjen

1. Të gjitha palët në një procedurë administrative kanë të drejtë të njihen me dokumentet e dosjes së kësaj procedure, si dhe të marrin kopje të tyre.

2. Organi publik, i përfshirë në procedurën administrative, brenda 5 ditëve nga paraqitja e kërkesës, siguron në mjediset e tij të punës kushte për mbajtjen e të dhënave, si dhe kushte për njohjen dhe marrjen e kopjeve të dokumenteve, sipas pikës 1 të këtij neni. Në raste të veçanta, kur është më e përshtatshme për kërkuësin, njohja me dosjen mund të bëhet edhe në mjediset e një organi tjetër publik ose në përfaqësitë konsullore dhe diplomatike të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit.

3. Dokumentet që përmbajnë të dhëna personale, tregtare ose profesionale, mund të merren ose të përdoren nga të tretët vetëm me pëlqimin e individit, të cilit i përkasin këto të dhëna. Pëlqimi nuk kërkohet nëse dokumentet do të përdoren për qëllime të parashikuara në ligj ose akte nënligjore.

4. Kur dokumentacioni administrohet në formë elektronike, organi publik i siguron palës mjetet e

nevojshme teknike për njohjen me të. Organi publik mund t'i bëjë dokumentet elektronike të aksesueshme nga interneti, nëse kjo nuk cenon sigurinë e të dhënave të mbrojtura sipas ligjit.

5. Lëshimi i kopjeve të dokumenteve bëhet kundrejt një pagese, që përcaktohet në vendimin e organit publik dhe në çdo rast nuk kalon koston e riprodhimit të tyre.

Neni 46

Kufizimi i së drejtës së palëve për njohje me dosjen

E drejta e palëve, sipas nenit 45, të këtij Kodi, kufizohet vetëm në ato raste dhe në atë masë që parashikohet nga legjislacioni në fuqi.

Neni 47

E drejta për të paraqitur mendime dhe shpjegime

Të gjitha palët, në çdo fazë të procedurës, kanë të drejtë të paraqesin mendime dhe shpjegime për faktet, rrethana apo çështje ligjore, si dhe të depozitojnë prova ose të paraqesin propozime për zgjidhjen e çështjes.

Neni 48

Detyrimi i vlerësimit

Organi publik, në çdo rast, është i detyruar të vlerësojë me shkrim mendimet dhe shpjegimet e të gjitha palëve të paraqitura, në përputhje me nenin 47 të këtij Kodi.

KREU IV

NJËSIMI I DOKUMENTEVE DHE VËRTETIMI I NËNSHKRIMIT

Neni 49

Njësimi i akteve të veta

1. Çdo organ publik, me kërkesë, mund të lëshojë kopje ose pjesë të njësuar me origjinalin të akteve të nxjerra nga ai vetë ose të dokumenteve të tjera nën administrimin e tij.

2. Njësimi me origjinalin nuk bëhet nëse, sipas rrethanave, rezulton se origjinali përmban ndryshime, mospërputhje, fshirje, fjalë, figura ose shenja të palexueshme, gjurmë të fshirjes së tyre, ose kur vazhdimësia e dokumentit të përbërë nga disa fletë është ndërprerë.

3. Përjashtimisht, në rastet e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, kur origjinali është ekzemplari i vetëm ekzistues i dokumentit, njësimi mund të bëhet duke bërë shënimin për mangësitë e konstatuara.

4. Njësimi me origjinalin bëhet nëpërmjet vendosjes së shënimit të njësimit në fund të kopjes. Ky shënim duhet të përmbajë:

- a) një përshkrim të saktë të dokumentit që njësohet;
- b) deklarin që kopja është e njëjtë me origjinalin ose që është një ekstrakt i tij;
- c) vendin dhe datën e njësimit;
- ç) organin publik që bën njësimin dhe vulën e tij zyrtare;

d) emrin dhe nënshkrimin e nëpunësit përgjegjës për njësimin.

5. Afati për lëshimin e kopjes së njësuar është 10 ditë nga dita kur depozitohet kërkesa.

6. Në rast të mospërmbushjes së kërkesës apo refuzimit nga ana e organit publik, kërkuesit i lind e drejta për t'u ankuar për moslëshimin e kopjes së njësuar, sipas këtij Kodi.

7. Parashikimet e këtij neni zbatohen për aq sa është e mundur për njësimin me origjinalin të dokumenteve të tjera, të ruajtura në formën e fotografimit, filmimit apo të ruajtura në çdo mjet tjetër teknik.

Neni 50

Njësimi në lidhje me dokumentet elektronike

Njësimi i kopjeve në letër të një dokumenti elektronik lidhur me një nënshkrim elektronik, të kopjeve të një dokumenti elektronik, prodhuar për të riprodhuar një dokument me shkrim, si dhe certifikimin e kopjeve të një dokumenti elektronik në një tjetër format teknik, të ndryshëm nga dokumenti origjinal i lidhur me nënshkrimin elektronik, dhe çdo vërtetim tjetër në lidhje me dokumentet në formë elektronike, rregullohet me ligj të veçantë.

Neni 51

Njësimi i dokumenteve të lëshuara nga organe të tjera publike

1. Një organ publik mund të njësojë kopje ose pjesë të dokumenteve të lëshuara nga një organ tjetër publik, nëse kopja ose pjesa e dokumentit janë të nevojshme për zhvillimin e procedurës përpara vetë organit që bën njësimin dhe nëse pala e interesuar paraqet origjinalin e dokumentit të lëshuar nga organi tjetër.

2. Rregullat për njësimin, të parashikuara në nenin 49, të këtij Kodi, zbatohen për aq sa është e mundur edhe për rastin e parashikuar në pikën 1 të këtij neni. Shënimi i njësimimit përmban të dhëna identifikuese të personit që ka paraqitur dokumentin origjinal.

3. Organi publik regjistron çdo njësim të kryer dhe mban një kopje të njësuar të aktit.

Neni 52

Vërtetimi i nënshkrimeve

1. Çdo organ publik i autorizuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vërteton nënshkrimet kur dokumenti i nënshkruar kërkohet t'i paraqitet një autoriteti ose organi tjetër publik, të cilit duhet t'i paraqitet dokumenti i nënshkruar.

2. Vërtetimi i nënshkrimit bëhet vetëm kur nënshkrimi është bërë ose pranuar në prani të nëpunësit të organit publik të ngarkuar për këtë qëllim.

3. Shënimi i vërtetimit vendoset afër nën-shkrimit që vërtetohet dhe duhet të përmbajë:

a) një deklaratë se nënshkrimi është i vërtetë;

b) identitetin e saktë të personit, nënshkrimi i të cilit vërtetohet, si dhe shënimin nëse nëpunësi përgjegjës për vërtetimin është bindur për identitetin e personit dhe nëse nënshkrimi është bërë ose pranuar në prani të tij;

c) deklaratën se vërtetimi bëhet vetëm për paraqitjen pranë një autoriteti ose një organi tjetër publik dhe emrin e këtij autoriteti apo organi;

ç) vendin dhe datën e vërtetimit, si dhe nën-shkrimin e nëpunësit përgjegjës për vërtetimin dhe vulën zyrtare.

4. Pikat 1 deri në 3 të këtij neni zbatohen për aq sa është e mundur edhe për vërtetimin e shenjave të tjera të identifikimit personal.

KREU V
AFATET

Seksioni 1

Afatet e veprimeve procedurale për palët, shtyrja dhe rivendosja në afat

Neni 53

Përcaktimi dhe shtyrja e afateve procedurale

1. Afatet për kryerjen e një veprimi procedural nga palët, të quajtura në vazhdim “afatet procedurale”, përcaktohen nga ligji ose aktet nënligjore.

2. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit.

3. Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.

Neni 54

Rivendosja në afat

1. Përveçse kur ndalohet shprehimisht me ligj, pala mund të kërkojë rivendosjen në afat, nëse është penguar për shkaqe të arsyeshme për respektimin e afatit procedural, me përjashtim të rasteve kur afatet kanë karakter prekluziv.

2. Rivendosja në afat mund të kërkohet:

- a) për afatet e përcaktuara për paraqitjen e kërkesës fillestare;
- b) në lidhje me afatet për kryerjen e veprimeve gjatë procedurës administrative;
- c) për afatet për paraqitjen e mjeteve të ankimit; si dhe
- ç) për çdo afat tjetër në dëm të palës.

3. Kërkesa për rivendosjen në afat duhet të bëhet brenda 15 ditëve nga dita kur janë eliminuar pengesat, por jo më vonë se 1 vit nga data e përfundimit të afatit të humbur. Në të njëjtin afat duhet kryer edhe veprimi procedural, për të cilin pala ka humbur afatin për shkaqe të arsyeshme.

4. Afati 1-vjeçar, i përcaktuar në pikën 3, të këtij neni, nuk zbatohet në rastin e forcës madhore.

Neni 55

Vendimi dhe pasojat e rivendosjes në afat

1. Kërkesa për rivendosjen në afat paraqitet dhe shqyrtohet nga organi publik kompetent që zhvillon procedurën administrative ose organi kompetent që vendos mbi mjetet ligjore administrative, ose organi që vazhdon ekzekutimin në përputhje me çështjen. Organi para të cilit është paraqitur kërkesa për rivendosjen në afat merr vendim brenda 15 ditëve.

2. Depozitimi i kërkesës shkakton pezullimin e të gjitha veprimeve procedurale të kryera si pasojë e humbjes së afatit.

3. Kundër vendimit të organit publik për mospranimin e kërkesës për rivendosjen në afat, mund të bëhet ankim sipas rregullave të parashikuara nga ky Kod dhe legjislacioni në fuqi.

4. Pranimi i kërkesës për rivendosjen në afat shkakton anulimin e të gjitha veprimeve procedurale, të kryera si pasojë e humbjes së afatit.

Seksioni 2
Llogaritja e afateve

Neni 56
Llogaritja e afateve

1. Përveç kur parashikohet ndryshe nga ligji, afatet caktohen në ditë, muaj ose vite. Përfundimi i afatit mund të përcaktohet edhe me një datë të caktuar kalendarike.

2. Kur afati caktohet në ditë, në llogaritjen e tij përfshihet dita kur ka ndodhur ngjarja, nga e cila fillon të ecë afati.

3. Afati i përcaktuar në muaj ose vite mbaron me kalimin e asaj dite, atij muaji apo atij viti të fundit, që ka të njëjtin numër me atë të ditës, në të cilën ka ndodhur ngjarja nga e cila ka filluar të ecë afati. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit, afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji.

4. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj.

Neni 57
Prezumime për llogaritjen e afateve

1. Dita e paraqitjes së kërkesës, për efekt të llogaritjes së afateve procedurale që ecin në dëm të palës, konsiderohet ajo e:

- a) depozitimit të kërkesës në postë, kur kërkesa dërgohet me postë të porositur;
- b) depozitimit të kërkesës në kutinë postare të organit publik;
- c) paraqitjes së kërkesës në degët e institucionit, në prefekturë apo përfaqësitë diplomatike ose zyra konsullore;
- ç) paraqitjes në komandën ose institucionin e ndalimit të personave;

d) regjistrimit nga pajisja përkatëse për marrjen e mesazheve, nëse dokumenti elektronik dërgohet elektronikisht ose kërkesa në formë të shkruar dërgohet me faks. Ky komunikim nuk passjell humbjen e afateve. Nëse dokumenti i dërguar nuk është i lexueshëm, organi publik njofton pa vonesë dërguesin duke i kërkuar ta ridërgojë në një mënyrë tjetër të përshtatshme.

2. Dita e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, konsiderohet edhe si dita kur ka ndodhur ngjarja, për efekt të llogaritjes së afateve që ecin kundër organit publik.

KREU VI
KËRKESA DHE PARAQITJA E SAJ

Neni 58
Forma dhe përmbajtja e kërkesës

1. Përveçse kur ligji parashikon një formë të caktuar, çdo kërkesë, me të cilën personat i drejtohen organit në një procedurë administrative, mund të jetë:

- a) në formë të shkruar;
- b) të deklarohet verbalisht para organit publik dhe të regjistrohet nga ky i fundit; ose
- c) të bëhet në çdo formë tjetër të përshtatshme.

2. Kërkesa duhet të jetë mjaftueshëm e qartë për të përcaktuar kërkuesin dhe qëllimin e saj, përveçse kur ligji parashikon një përmbajtje të caktuar.

3. Kërkesa konsiderohet në formë të shkruar edhe kur ajo dërgohet me faks ose në rrugë elektronike, me kusht që të tregojë qartë autorin e saj. Ligji mund të kërkojë që kërkesa të nënshkruhet me dorë.

Neni 59
Paraqitja e kërkesës

1. Kërkesa paraqitet drejtpërdrejt në organin publik kompetent ose në çdo zyrë apo degë të tij. Kërkesa drejtuar një organi publik qendror mund të paraqitet edhe në çdo prefekturë, në territorin e së cilës pala ka vendqëndrimin, nëse organi publik qendror nuk ka zyrë ose degë në atë territor.

2. Kërkesa mund të paraqitet edhe në përfaqësitë diplomatike, zyrat konsullore të Republikës së Shqipërisë, në shtetin ku pala ka vendqëndrimin apo vendbanimin e saj.

3. Zyrat, degët, prefektura, përfaqësitë diplomatike apo zyrat konsullore ia dërgojnë pa vonesë kërkesën dhe, në çdo rast, brenda 48 orëve nga paraqitja e saj, organit publik kompetent dhe njoftojnë kërkuesin.

4. Personat që shërbejnë në Forcat e Armatosura mund ta paraqesin kërkesën e tyre në komandën përkatëse ku kryejnë shërbimin, ndërsa personat e ndaluar apo që ekzekutojnë dënimin penal me burgim mund ta paraqesin atë pranë institucionit ku gjenden të ndaluar ose ku ekzekutojnë dënimin penal me burgim.

5. Në përputhje me pikat 1 deri në 4, të këtij neni, kërkesa mund t'i paraqitet drejtpërdrejt organit publik brenda orarit zyrtar. Për paraqitjen e kërkesave verbale, organi publik mund të caktojë një orar të posaçëm brenda orarit zyrtar. Orari i posaçëm nuk është i zbatueshëm kur paraqitja e kërkesës lidhet me ndonjë afat që ecën në dëm të kërkuesit.

6. Kërkesa me shkrim mund të dërgohet edhe me postë të porositur, mjete elektronike ose faks, drejtpërdrejt në adresën përkatëse zyrtare të organit kompetent, të cilit i drejtohet ose në kutinë postare të organit publik. Kërkesat urgjente mund të bëhen edhe me telefon, nëse është e mundur, sipas natyrës së kërkesës.

7. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim organet publike dhe procedurat administrative, në të cilat paraqiten kërkesat me mjete elektronike dhe kërkesat teknike përkatëse. Kërkesat teknike duhet të jenë jodiskriminuese dhe t'i referohen produkteve dhe teknologjive përgjithësisht të disponueshme dhe ndërvepruese me produktet e teknologjisë së komunikimit dhe informacionit në përdorim të përgjithshëm. Çdo organ publik publikon kërkesat teknike në faqen e tij zyrtare të internetit.

Neni 60
Regjistrimi dhe vërtetimi i paraqitjes së kërkesës

1. Marrja e kërkesës regjistrohet në organin publik ku paraqitet, sipas rendit kronologjik të paraqitjes në një regjistër të posaçëm. Regjistri i kërkesave për fillimin e procedurës administrative përmban informacionin e mëposhtëm:

- a) numrin e kërkesës;
- b) datën e dorëzimit;
- c) objektin e kërkesës;
- d) numrin dhe emërtimin e dokumenteve që i bashkëngjiten kërkesës; dhe
- e) identitetin dhe adresën e kërkuesit.

2. Nëse dy ose më shumë kërkesa mbërrijnë me të njëjtën dërgesë postare pranë organit publik, ato konsiderohen të depozituara pranë këtij organi, në të njëjtën kohë.

3. Personit që paraqet kërkesën, në çdo rast, i lëshohet një vërtetim që konfirmon faktin e pranimit të kërkesës, objektin e saj, datën dhe listën e dokumenteve të bashkëlidhura, nëse ka të tilla. Depozitimi me postë të porositur vërtetohet nga dokumenti postar që duhet të përmbajë të njëjtat të dhëna.

4. Me kërkesë të personit, në rastin e dërgimit të kërkesës me mjete elektronike ose faks, vërtetimi sipas pikës 3, të këtij neni, i dërgohet pa vonesë në të njëjtën adresë dhe me të njëjtat mjete, me të cilat është kryer dërgimi.

Neni 61

Depozitime të tjera

Rregullat e përcaktuara në këtë Kod për paraqitjen e kërkesës zbatohen edhe për paraqitjen e mendimeve, shpjegimeve, komenteve, dekla-ratave, si dhe dokumenteve të tjera, në kuadër të procedurës administrative.

Neni 62

Pasaktësitë në kërkesën e palës së interesuar për fillimin e procedurës administrative

1. Në qoftë se kërkesa e palës së interesuar për fillimin e procedurës administrative nuk është paraqitur në përputhje me kërkesat e neneve 58 dhe 59, të këtij Kodi, kërkuessit i kërkohet me shkrim që të korrigjojë pasaktësitë ekzistuese.

2. Me përjashtim të rasteve kur në ligjet e veçanta parashikohet ndryshe, organi publik i drejtohet kërkuessit për korrigjimin e pasaktësive brenda 7 ditëve nga dita e regjistrimit të kërkesës dhe i cakton kërkuessit një afat për plotësimin e pasaktësive.

3. Pavarësisht nga parashikimet e pikave 1 dhe 2, të këtij neni, dhe për aq sa është e mundur, organi publik i korrigjon vetë pasaktësitë e kërkesës, duke mos i dëmtuar interesat ligjorë të palëve të interesuara.

4. Kur kërkuessi plotëson pasaktësitë brenda afatit të përcaktuar, ajo quhet e regjistruar nga dita që është regjistruar në organin publik.

5. Kur kërkuessi nuk plotëson pasaktësitë brenda afatit të caktuar dhe këto pasaktësi nuk mund të plotësohen nga organi publik, sipas pikës 3, të këtij neni, kërkesa quhet se nuk është regjistruar dhe i kthehet kërkuessit bashkë me aktet e tjera.

Neni 63

Kërkesa verbale për fillimin e procedurës administrative

Nëse paraqitet një kërkesë verbale, nëpunësi regjistron të dhënat e mëposhtme:

- a) numrin e kërkesës;
- b) datën e deklaramit;
- c) objektin e kërkesës verbale;
- ç) numrin dhe emërtimin e dokumenteve që i bashkëngjiten kërkesës, nëse ka të tilla; dhe
- d) identitetin dhe adresën e kërkuessit.

Neni 64

E drejta e plotësimit, ndryshimit dhe e tërheqjes së kërkesës

1. Një palë që ka dorëzuar një kërkesë mund ta plotësojë ose ndryshojë atë, vetëm kur qëllimi i kërkesës së ndryshuar bazohet në të njëjtën situatë faktike si kërkesa fillestare.

2. Një palë, me anë të një kërkesë me shkrim, mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga procedura administrative dhe të heqë dorë nga të drejtat dhe interesat e saj ligjorë, përveç rasteve kur kjo ndalohe me ligj. Ndryshimi apo tërheqja e kërkesës mund të kryhet në çdo kohë, për sa kohë që organi publik nuk ka marrë një vendim përfundimtar. Pas tërheqjes së një pale, organi publik vendos përfundimin e procedurës administrative. Në këtë rast, organi publik njofton palët e tjera, nëse ka.

3. Vendimi i organit publik për t'i dhënë fund procedurës administrative, pas tërheqjes së njërës prej palëve, mund të ankimohet nga çdo palë tjetër.

4. Tërheqja e një pale nuk çon në përfundimin e procedurës administrative, në rast se organi publik vlerëson se vazhdimësia e procedurës është në interes publik ose në interesin e ligjshëm të palëve të tjera.

Neni 65

Verifikimi paraprak përpara fillimit të procedurës administrative

Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme:

- a) nëse të drejtat apo interesat e kërkuara nga palët janë subjekt i ndonjë kufizimi kohor;
- b) legjitimitimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative;
- c) nëse afati i përcaktuar me ligj për dorëzimin e kërkesës është respektuar;
- ç) nëse kërkesa e një pale për fillimin e një procedure administrative mund të shqyrtohen së bashku me kërkesat e palëve të tjera, nëse bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore.

KREU VII

DHE VENDIMET E NDËRMJETME

Neni 66

Çështjet paraprake

1. Nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë.

2. Nëse shqyrtimi i çështjes paraprake mund të fillojë vetëm me kërkesë të palës, organi kompetent për zhvillimin e procedurës pezullon procedurën, duke njoftuar njëkohësisht palën për të drejtën që ajo ka për të paraqitur kërkesën për çështjen konkrete.

3. Nëse zgjidhja e çështjes paraprake kërkon iniciativën kryesisht të organit tjetër publik, organi kompetent për zhvillimin e procedurës kërkon fillimin e procedurës nga organi tjetër.

Neni 67

Vendimet e ndërmjetme

1. Organi publik, që është kompetent për marrjen e vendimit përfundimtar, mund të marrë edhe vendime të ndërmjetme, kur gjykohet se mosmarrja e masave të caktuara do të shkaktonte një dëm të rëndë e të riparueshëm mbi interesin publik, apo të drejtave ose interesave të ligjshëm të palëve.

2. Vendimet e ndërmjetme mund të merren me nismën e organit publik ose me kërkesën e palëve të interesuara.

3. Vendimi për marrjen e masave të ndërmjetme duhet të jetë i arsyetuar, me afat të përcaktuar dhe u njoftohet palëve.

Neni 68

Përfundimi i vendimeve të ndërmjetme

1. Vendimet e ndërmjetme përfundojnë automatikisht në rastet e mëposhtme:

- a) përfundon procedura administrative ose mbaron afati, brenda të cilit duhet të ishte dhënë vendimi përfundimtar;
- b) kur mbaron afati i caktuar në vendimin e ndërmjetëm;
- c) në rastet e tjera të parashikuara shprehimisht me ligj.

2. Organi publik shfuqizon vendimet e ndërmjetme, nëse gjatë procedurës bie shkak i parashikuar në pikën 1, të nenit 67, të këtij Kodi.

Neni 69
Pajtimi i palëve

1. Gjatë gjithë zhvillimit të një procedure administrative me palë kundërshtare, nëpunësi përgjegjës i organit publik duhet të përpiqet t'i pajtojë palët në procedurë, kur e lejon natyra e çështjes.
2. Akti i pajtimit mes dy ose më shumë palëve në një procedurë administrative bëhet në formë të shkruar dhe pasi të lexohet dhe të nënshkruhet nga palët bëhet i plotfuqishëm. Një kopje e këtij akti u jepet palëve në procedurë.
3. Akti i pajtimit mes dy ose më shumë palëve në një procedurë administrative ka efekt të njëjtë me atë të aktit administrativ.
4. Organi kompetent publik nuk pranon pajtim mes palëve në procedurë në qoftë se pajtimi është në dëm të interesit publik ose në dëm të interesave të ligjshëm të personave të tjerë fizikë dhe juridikë.

KREU VIII
VENDIMMARRJA E PËRBASHKËT DHE NDIHMA NDËRMJET ORGANEVE PUBLIKE

Neni 70
Vendimmarrja e përbashkët e organeve publike

1. Kur sipas ligjit, dy ose më shumë organe publike vendosin për një çështje administrative, në kuadër të një procedure administrative të vetme, ato përcaktojnë me marrëveshje organin që do të nxjerrë aktin administrativ të përbashkët, i cili përfshin edhe vendimin e organit tjetër.
2. Pavarësisht parashikimeve të pikës 1, të këtij neni, secili prej organeve të përfshira merr vendimin, në përputhje me kompetencën përkatëse.
3. Nëse, sipas ligjit, vendimmarrja e një organi publik bazohet në një pëlqim paraprak, konfirmim, miratim ose mendim të një organi tjetër publik, ky i fundit vendos dhe njofton organin publik brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës, përveç rasteve kur ligji parashikon një afat të ndryshëm.
4. Nëse organi publik, të cilit i lind detyrimi për të dhënë pëlqimin, konfirmimin, miratimin apo mendimin e nevojshëm për miratimin e aktit, nuk përgjigjet brenda afatit të parashikuar në pikën 3, të këtij neni, prezumohet se qëndrimi i tij është pozitiv.
5. Përveç kur parashikohet ndryshe në ligj, mosmarrëveshjet lidhur me pikën 1, të këtij neni, zgjidhen sipas nenit 27 të këtij Kodi.

Neni 71
Ndihma administrative

1. Organi publik, mund t'i kërkojë ndihmë administrative një organi tjetër publik, për kryerjen e një apo disa veprimeve të nevojshme, në kuadër të një procedure administrative.
2. Ndihma administrative kërkohet në rastet kur:
 - a) për arsye të ligjshme, organi kërkues nuk mund t'i kryejë vetë këto veprime;
 - b) kryerja e veprimeve nga organi kërkues nuk është efektive apo kostot për kryerjen e tyre janë shumë më të larta, në krahasim me koston e kryerjes së tyre nga organi tjetër;
 - c) është e nevojshme njohja me dokumente, fakte, apo mjete të tjera të provës, në administrim të organit tjetër.
3. Përveç kur parashikohet ndryshe në ligj, organi publik mund ta zgjedhë organin të cilit i kërkon ndihmë, duke vlerësuar koston dhe efektivitetin.

Neni 72

Refuzimi i kërkesës për ndihmë administrative

1. Organi, të cilit i kërkohet ndihma administrative, nuk mund ta refuzojë atë, me përjashtim të rasteve të pamundësisë objektive për kryerjen e veprimeve të kërkuara. Në këtë rast, organi kërkues njoftohet menjëherë dhe në çdo rast jo më vonë se 2 ditë nga marrja e kërkesës për ndihmë administrative.

2. Mosmarrëveshja ndërmjet dy organeve zgjidhet nga organi epror i organit të cilit i kërkohet ndihmë. Në rastet kur ky organ nuk ekziston, veprimi kryhet nga organi që kërkon ndihmën administrative.

Neni 73

Procedura e ndihmës administrative

1. Organi, të cilit i kërkohet ndihmë administrative, i nënshtrohet procedurave dhe detyrimeve ligjore të parashikuara në ligj për organin, që ka kërkuar ndihmën administrative, dhe kryen veprimet e kërkuara sa më shpejt të jetë e mundur.

2. Organi kërkues, në kërkesën për ndihmë, informon organin tjetër për procedurat dhe detyrimet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

KREU IX

PIKAT E SHËRBIMIT ME NJË NDALESË

Neni 74

Pikat e shërbimit me një ndalesë

Për të gjitha shërbimet, për të cilat është përcaktuar sipas ligjeve të posaçme një pikë e shërbimit me një ndalesë, zbatohen dispozitat e këtij Kodi. Në këto raste, të gjitha procedurat administrative kryhen nëpërmjet pikave të shërbimit me një ndalesë.

Neni 75

Përgjegjësitë e pikave të shërbimit me një ndalesë

1. Pikat e shërbimit me një ndalesë janë përgjegjëse për:

- a) këshillimin e të interesuarve në të njëjtën mënyrë si organi publik kompetent;
- b) pranimin e kërkesave për nxjerrjen e një akti administrativ apo kryerjen e një veprimi tjetër administrativ, si dhe paraqitjen e mendimeve, shpjegimeve, propozimeve, komenteve, dokumenteve apo mjeteve ligjore administrative, në përputhje me këtë Kod, dhe transferimin e tyre organit publik kompetent;
- c) njoftimin e kërkuesit për çdo akt dhe veprim procedural të organit publik kompetent, si dhe për çdo komunikim ndërmjet palës së interesuar dhe organit publik kompetent, në lidhje me aktivitetin specifik.

2. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, ekzistenca e pikave të shërbimit me një ndalesë nuk cenon kompetencën e secilit prej organeve publike, të përfshira në procedurën administrative, si dhe të drejtën e të interesuarve t'i drejtohen drejtpërdrejt organit publik kompetent.

3. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj, pika e shërbimit me një ndalesë është organi publik kompetent për aktin më të rëndësishëm administrativ, të lidhur me fillimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga organet publike të përfshira. Mosmarrëveshjet ndërmjet organeve publike të përfshira në veprimtarinë, të cilat kryhen nëpërmjet pikave të shërbimit me një ndalesë, zgjidhen në përputhje me nenin 27 të këtij Kodi.

Neni 76

Informimi dhe procedura

1. Pikat e shërbimit me një ndalesë informojnë apo vënë në dispozicion të të interesuarve, të gjithë informacionin e nevojshëm për procedurën administrative. Informacioni përfshin edhe të dhëna për mjetet dhe kushtet për aksesin në regjistrat publikë dhe në bazat e të dhënave shtetërore, si dhe për mjetet e ankimit, në rast mosmarrëveshjeje. Shërbimet e përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të këtij Kodi, dhe në këtë pikë kryhen drejtpërdrejt në pikën e shërbimit me një ndalesë, si dhe nëpërmjet postës apo mjeteve elektronike.

2. Afatet për organin publik fillojnë të llogariten me depozitimin e kërkesës dhe të dokumentacionit të plotë në pikën e shërbimit me një ndalesë, apo sipas rregullave të përcaktuara në nenin 57, të këtij Kodi, pavarësisht nga koha e nevojshme për transferimin tek organi publik kompetent.

3. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim:

a) veprimtaritë ekonomike, si dhe procedurat administrative, lidhur me fillimin dhe ushtrimin e veprimtarisë, të cilat kryhen nëpërmjet pikave të shërbimit me një ndalesë;

b) organet publike që shërbejnë si pika shërbimi me një ndalesë apo krijon organe publike të posaçme për këtë qëllim;

c) procedurat e brendshme të komunikimit ndërmjet pikës së shërbimit me një ndalesë dhe organit publik kompetent;

ç) procedurat dhe standardet për sportelet pritëse të qytetarëve dhe zyrave mbështetëse përgjegjëse për përpunimin e të dhënave dhe finalizimin e shërbimeve publike në qendrat e shërbimit me një ndalesë.

KREU X

HETIMI ADMINISTRATIV

Seksioni 1

Parimet e hetimit administrativ

Neni 77

Parimi i hetimit kryesisht

1. Organi publik heton kryesisht të gjitha faktet dhe vlerëson të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes.

2. Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin, qëllimin dhe shtrirjen e hetimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është i nevojshëm për zgjidhjen e çështjes.

3. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, dokumentet që vërtetojnë akte, fakte, cilësi apo gjendje subjektive, të nevojshme për zhvillimin e hetimit administrativ, administrohen kryesisht nga organi që zhvillon procedurën administrative, kur janë në administrim të tij apo të organeve të tjera publike. Organi publik mund t'i kërkojë palës vetëm elementet e nevojshme për identifikimin e tyre.

Neni 78

Bashkëpunimi gjatë hetimit administrativ

1. Pala bashkëpunon me organin publik në përcaktimin e fakteve dhe rrethanave të nevojshme për zgjidhjen e çështjes. Ligji mund të parashikojë shprehimisht detyrimin e mëtejshëm të palës për të paraqitur informacione, prova, dokumente, deklarata apo për t'u paraqitur personalisht përpara organit publik.

2. Palëve nuk mund t'u kërkojë të paraqiten personalisht pranë organit publik, nëse komunikimi me to mund të sigurohet me mjete të tjera më të përshtatshme.

3. Palët mund t'i paraqesin deklaratat e tyre në formë të shkruar apo verbale. Për shkak të problematikës ose kompleksitetit të çështjes, palëve mund t'u kërkohe t'i paraqesin deklaratat e tyre me shkrim.

Neni 79

Subjektet e procedurës hetimore

1. Procedura hetimore zhvillohet nga organi publik, në kompetencën e të cilit është marrja e vendimit përfundimtar.

2. Organi publik kompetent për marrjen e vendimit mund t'ia delegojë të drejtën për zhvillimin e procedurës hetimore organit vartës, me përjashtim të rasteve kur delegimi ndalohet me ligj.

3. Organi publik, që ka kompetencë për zhvillimin e procedurës hetimore, mund t'i ngarkojë organit vartës detyra specifike hetimore.

Seksioni 2

Mjetet e kërkimit të provës

Neni 80

Kuptimi dhe mjetet e kërkimit të provës

1. Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, organi publik mund:

- a) të mbledhë deklarata nga palët, dëshmitarët dhe ekspertët;
- b) të marrë dokumente dhe dokumente të tjera të dokumentuara nëpërmjet mjeteve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike;
- c) të vizitojë dhe të kontrollojë mallrat apo vende të përfshira.

2. Dispozitat e parashikuara ligjin për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative mbi mjetet e provave zbatohen për aq sa është e mundur në procedurën administrative, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Kod.

3. Faktet tashmë të njohura për autoritetin publik ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme.

Neni 81

Vlerësimi i provave

Organi publik çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ.

Neni 82

Barra e provës

1. Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.

2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.

3. Në mënyrë që të mbështesin pretendimet e tyre, palët mund t'i bashkëlidhin kërkesës për fillimin e procedurës administrative dokumente ose fakte të ndryshme.

4. Palët mund t'i kërkojnë organit publik që të marrë masat e nevojshme për të siguruar përdorimin e provave të zotëruara prej tij gjatë procedurës administrative.

Neni 83

Paraqitja e provave para një organi tjetër

1. Nëse paraqitja e provave para organit publik që zhvillon procedurën është e vështirë, kërkon kohë ose ka kosto të lartë, organi publik mund të vendosë, kryesisht apo me kërkesë të palës, që marrja tërësisht e provave ose e një pjese të tyre të bëhet nga një organ tjetër publik.

2. Në këtë rast zbatohen, për aq sa është e mundur, parashikimet e neneve 71 dhe 73, të këtij Kodi, për ndihmën administrative.

Neni 84

Metodat për paraqitjen e informacionit dhe provave

Në rastet kur palët janë të detyruara të paraqesin informacion ose prova, pala duhet të njoftohet me shkrim apo në mënyrë verbale, sipas afateve dhe parashikimeve të këtij Kodi.

Neni 85

Mosparaqitja e provave

1. Në qoftë se palët nuk i përgjigjen njoftimit, administrata mund të bëjë një njoftim të ri ose të ndërpresë procedurën, kur një gjë e tillë nuk cenon ndonjë interes publik.

2. Mungesa e përgjigjes ndaj njoftimit mund të merret në konsideratë për qëllimet e të provuarit, në përputhje me rrethanat e çështjes, por në asnjë rast kjo nuk e çliron organin publik nga detyrimi për t'i kërkuar vetë provat dhe faktet dhe për të dhënë një vendim përfundimtar.

3. Në ato raste kur informacioni apo dokumentet e kërkuara nga palët janë të domosdoshme për shqyrtimin e pretendimit të ngritur nga vetë palët, procedura pezullohet deri në sigurimin e informacionit dhe palët njoftohen për këtë gjë.

Neni 86

Sigurimi i provave

1. Kur një provë, nga e cila varet zgjidhja e çështjes ose që ndikon në sqarimin e saj, ka rrezik të zhduket ose të vështirësohet ose bëhet e pamundur marrja e saj, organi publik, kryesisht apo me kërkesën e justifikuar të palës, mund të vendosë marrjen më parë të kësaj prove (sigurimi i provës).

2. Organi publik që zhvillon procedurën administrative mund të vendosë sigurimin e provës edhe përpara fillimit të procedurës administrative. Sigurimi i provës mund të bëhet edhe në çdo fazë të procedurës administrative. Përgjegjësia për sigurimin e provave bie mbi organin publik që zhvillon procedurën.

3. Shpenzimet që krijohen gjatë veprimeve të ndërmarra nga administrata për sigurimin e provave, përveç atyre provave që zotërohen prej saj, mbulohe nga pala e interesuar që i kërkon ato.

Seksioni 3

Njoftimi dhe dëgjimi i palëve

Neni 87

Njoftimi dhe e drejta për t'u dëgjuar para marrjes së vendimit përfundimtar

1. Përpara se të merret vendimi përfundimtar, organi publik, përveç rasteve të parashikuara nga neni 64, i këtij Kodi, njofton palën lidhur me të drejtën e saj për t'u dëgjuar.

2. Njoftimi, sipas pikës 1, të këtij neni, bëhet me shkrim, apo në një takim me palën, dhe përmban këto të dhëna:

- a) organin publik që zhvillon procedurën dhe nëpunësin publik përgjegjës;
- b) palët e përfshira;
- c) informacion për të drejtën e inspektimit të dosjeve dhe zyrës dhe vendin ku kjo mund të ushtrohet;
- ç) provat e administruara, rezultatet e hetimit, si dhe rezultatet e pritshme të procedurës administrative dhe motivimin përkatës;
- d) informacionin për të drejtën e palës për t'u dëgjuar dhe mënyrën dhe afatin e ushtrimit të kësaj së drejte;
- dh) datën e fillimit të procedurës dhe afatin kohor, brenda të cilit do të merret dhe njoftohet vendimi, në qoftë se një afat i tillë është i zbatueshëm.

3. Afati i parashikuar sipas shkronjës "dh", të pikës 2, të këtij neni, nëse nuk parashikohet nga ligji ose aktet nënligjore, përcaktohet nga organi publik, në përputhje me nenin 53 të këtij Kodi.

Neni 88

Ushtrimi i së drejtës për t'u dëgjuar

1. E drejta e palës për t'u dëgjuar ushtrohet në çdo formë të përshtatshme dhe brenda afatit të përcaktuar nga organi publik.
2. Palët, në ushtrimin e së drejtës për t'u dëgjuar, mund të paraqesin komente edhe për vlerësimin e provave të administruara, rezultatet e hetimit dhe rezultatin e mundshëm të procedurës.
3. Organi publik merr vendimin përfundimtar vetëm pas kalimit të afatit të përcaktuar për ushtrimin e së drejtës për t'u dëgjuar nga pala. Mosushtrimi i kësaj së drejte nga ana e palës në afatin e përcaktuar, nuk shkakton shtyrjen e marrjes së vendimit përfundimtar.

Neni 89

Përfundimi nga e drejta për t'u dëgjuar

Procedura administrative mund të mbyllet pa njoftuar dhe pa i dhënë mundësinë palës për t'u dëgjuar, vetëm në rastet e mëposhtme:

- a) marrja e vendimit përfundimtar është urgjente, për shkak të dëmit që mund t'i shkaktohet për shkak të vonesës interesit publik;
- b) palët kanë paraqitur paraprakisht mendimet, komentet dhe shpjegimet e plota gjatë procedurës administrative;
- c) gjatë zhvillimit të procedurës administrative rezulton qartë se vendimi do të jetë tërësisht në favor të palës;
- ç) në një procedurë administrative që bazohet në një procedurë konkurruese publike; ose kur
- d) është parashikuar shprehimisht me ligj.

KREU XI

PËRFUNDIMI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE

Neni 90

Përfundimi i procedurës administrative

1. Procedura administrative, e nisur me kërkesë, përfundon me një vendimarrje përfundimtare për çështjen, përkatësisht një akt administrativ apo një kontratë administrative. Në vendimin përfundimtar për çështjen, organi publik vendos për të gjitha çështjet e ngritura nga palët gjatë procedurës dhe që nuk kanë marrë zgjidhje gjatë tij.

2. Përfundimi i procedurës administrative, të nisur kryesisht, është në diskrecion të organit publik, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji.

3. Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ.

Neni 91

Afati për përfundimin e procedurës administrative

1. Procedura administrative, e nisur me kërkesë, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, përfundon sa më shpejt të jetë e mundur dhe brenda afatit të përcaktuar nga ligji i posaçëm.

2. Në mungesë të afateve të përcaktuara nga ligji i posaçëm, afati për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë.

3. Nëse ligji parashikon detyrimin e palës për të paraqitur dokumente ose prova, si pjesë ose së bashku me kërkesën për fillimin e procedurës, afatet e përcaktuara sipas pikave 1 ose 2, të këtij neni, fillojnë nga paraqitja e plotë e tyre.

4. Në rastin e gjendjes së jashtëzakonshme, procedura administrative përfundon brenda 3 muajve nga dita e përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme.

5. Mosrespektimi i afateve kohore, të parashikuara në këtë nen, duhet të justifikohet nga organi përgjegjës para organit epror ose nga nëpunësi përgjegjës përpara eprorit të tij, brenda 10 ditëve nga përfundimi i afatit ose nga përfundimi i gjendjes së jashtëzakonshme.

Neni 92

Zgjatja e afatit të procedurës

1. Përveç kur ndalohet shprehimisht nga ligji, në raste të justifikuara, për shkak të kompleksitetit të çështjes, organi publik mund të zgjasë vetëm një herë afatin e përcaktuar sipas nenit 91 të këtij Kodi.

2. Zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar.

3. Zgjatja e afatit dhe data e përfundimit të afatit të zgjatur i njoftohen palës brenda afatit fillestar. Njoftimi duhet të përmbajë edhe arsyetimin për zgjatjen e afatit.

Neni 93

Vdekja e palës, mbarimi i personit juridik

1. Nëse pala, person fizik, vdes gjatë zhvillimit të procedurës administrative që zhvillohet për një çështje të karakterit personal, organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative, pa marrë një vendim përfundimtar për çështjen. Në çdo rast tjetër, nëse organi publik vlerëson nëse pjesëmarrja e palës është e domosdoshme, pezullon procedurën përkohësisht deri në identifikimin e trashëgimtarëve.

2. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, edhe në rastin e mbarimit të personit juridik, kur ky i fundit është palë, organi publik deklaron përfundimin e procedurës administrative pa marrë një vendim përfundimtar.

Neni 94

Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës

1. Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.

2. Organi publik mund të deklarojë përfundimin e procedurës së nisur me kërkesë, pa vendim përfundimtar edhe nëse rezulton qartazi nga rrethanat se pala që ka paraqitur kërkesën, nuk ka më interes

për vazhdimin e procedurës dhe e ka braktisur atë.

3. Në çdo rast, tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës nuk ndikon në vazhdimin e tij, nëse organi publik çmon se vazhdimi i procedurës është në interes publik, me përjashtim të rasteve kur procedura është e tillë që mund të fillojë vetëm me kërkesën e palës.

4. Procedura deklarohet e braktisur pa një vendim përfundimtar për çështjen, në qoftë se pala e interesuar, për fajin e saj, ka qenë pasive gjatë afatit për përfundimin e procedurës administrative të parashikuar në nenin 91 të këtij Kodi.

5. Braktisja e procedurës nuk e shuan të drejtën, të cilën individi kishte kërkuar të njëj.

Neni 95

Pamundësia në objekt apo qëllim

Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.

Neni 96

Mospagimi i tarifave

1. Procedura e nisur me kërkesë, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, si pasojë e mospagimit brenda afatit të përcaktuar, të tarifave, pagimi i të cilave, sipas ligjit është kusht për nxjerrjen e vendimit përfundimtar, me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe në këtë Kod.

2. Nëse pala paguan dyfishin e shumës brenda 10 ditëve nga përfundimi i afatit fillestar për pagesën e tarifës, organi publik përfundon procedurën administrative duke marrë vendimin përfundimtar përkatës.

Neni 97

Miratimi në heshtje

1. Nëse pala ka kërkuar në procedurën administrative nxjerrjen e një akti administrativ shkresor dhe organi publik nuk njofton vendimin brenda afatit të përcaktuar me ligj apo akt nënligjor për përfundimin e procedurës dhe nuk njofton zgjatjen e afatit ose nuk njofton vendimin brenda afatit të zgjatur, kërkesa konsiderohet si e miratuar dhe akti administrativ shkresor i kërkuar si i miratuar në heshtje (akti në heshtje) në rastet kur është parashikuar nga ligje të veçanta.

2. Pala ka të drejtë të kërkojë nga autoriteti publik, i cili nuk ka nxjerrë aktin administrativ të kërkuar, një konfirmim me shkrim se kërkesa e saj konsiderohet të jetë miratuar në përputhje me pikën 1 të këtij neni. Konfirmimi përmban tekstin e kërkesës, datën e paraqitjes së saj dhe faktin që organi publik nuk ka njoftuar vendimin e tij brenda afatit të përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Nëse autoriteti nuk nxjerr një konfirmim në përputhje me pikën 2, të këtij neni, brenda 7 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës së palës sipas pikës 2, të këtij neni, ose në të njëjtën kohë nuk nxjerr aktin administrativ të kërkuar, pala mund të ngrejë padi në gjykatën kompetente për çështjet administrative, për të saktësuar të drejtat dhe detyrimet ndërmjet paditësit dhe organit publik.

PJESA E PESTË
VEPRIMTARIA ADMINISTRATIVE

KREU I
AKTI ADMINISTRATIV

Seksioni 1

Kërkesat formale të aktit administrativ

Neni 98

Forma e aktit administrativ

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, akti administrativ ka formë të shkruar në letër ose elektronike, verbale, ose çdo formë tjetër të përshtatshme.
2. Akti administrativ verbal konfirmohet në formë të shkruar në letër ose elektronike, kur pala e kërkon këtë menjëherë.
3. Organi publik është i detyruar të konfirmojë pa vonesë përmbajtjen e aktit verbal, në formë të shkruar në letër ose elektronike.
4. Konfirmimi, sipas pikave 2 dhe 3, të këtij neni, megjithëse nuk është akt administrativ, duhet të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 99 të këtij Kodi.
5. Aktet e organeve kolegjiale bëhen në formë shkresore. Këto akte regjistrohen në një procesverbal, pa të cilin ato nuk sjellin asnjë pasojë juridike.

Neni 99

Kërkesat e formës së aktit administrativ të shkruar në letër ose elektronik

1. Në çdo rast akti administrativ duhet të tregojë qëllimin e tij.
2. Akti administrativ i shkruar në letër ose elektronik përmban:
 - a) pjesën hyrëse, që përmban:
 - i) emrin e organit publik që nxjerr aktin;
 - ii) palët të cilave u drejtohet akti;
 - iii) datën e miratimit;
 - iv) bazën ligjore;
 - b) pjesën arsyetuese;
 - c) dispozitivin që tregon:
 - i) pjesën urdhëruese që tregon çfarë është vendosur;
 - ii) kohën e hyrjes në fuqi të aktit;
 - iii) të drejtën e ankimit, përfshirë organin publik apo gjykatën ku mund të paraqitet ankimi, mjetet e ankimit, afatin dhe mënyrën e përlllogaritjes së tij për paraqitjen e ankimit.
3. Nëse nuk parashikohet ndryshe nga ligji, akti administrativ i shkruar në letër përmban nënshkrimin, emrin dhe mbiemrin e shkruar të nëpunësit përgjegjës, apo përkatësisht të kryetarit dhe të sekretarit të organit kolegjial.
4. Akti administrativ elektronik nënshkruhet në mënyrë elektronike në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto raste, kërkesat e pikës 3, të këtij neni, zëvendësohen me nënshkrimin elektronik të organit publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 100

Arsyetimi i aktit

Akti administrativ i shkruar në letër ose elektronik, si dhe akti administrativ i konfirmuar, sipas nenit 98, pikat 2 dhe 3, të këtij Kodi, duhet të jetë i arsyetuar. Arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë

dhe përmban:

- a) shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë akti;
- b) shpjegimin e përmbledhur të rezultatit të hetimit administrativ dhe të vlerësimit të provave;
- c) bazën ligjore të aktit dhe një shpjegim pse kushtet ligjore për zbatimin e tij plotësohen në këtë rast;
- ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar.

Neni 101

Aktet që nuk kërkohen të arsyetohen

Akti administrativ i shkruar në letër ose elektronik, si dhe akti administrativ i konfirmuar, sipas nenit 98, pikat 2 dhe 3, të këtij Kodi, nuk kërkohet të jetë i arsyetuar në rastet kur:

- a) përjashtohet shprehimisht nga ligji i posaçëm;
- b) akti administrativ, i nxjerrë me kërkesën e palës, përbën pranimin e plotë të saj dhe nuk cenon të drejtat apo interesat e palëve;
- c) aktet që miratojnë vendimet e marra nga bordet, juritë apo komisionet e ngritura nga organet publike, si dhe urdhrat e eprorëve, që kanë të bëjnë me çështje të organizimit dhe funksionimit të brendshëm, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe;
- ç) akti shpall publikisht një akt administrativ kolektiv;
- d) organi nxjerr një akt administrativ në vijim të praktikës së ndjekur për zgjidhjen e çështjeve objektivisht të njëjta.

Neni 102

Kushte shtesë për aktin administrativ dobiprurës

1. Një akt administrativ dobiprurës mund të shoqërohet me një ose më shumë prej kushteve të mëposhtme shtesë:

- a) një ngjarje, e cila nuk është e sigurt se do të ndodhë dhe me ndodhinë e së cilës varet fillimi apo fundi i një të drejte, përfitimi ose barre (kushti);
- b) një datë ose një periudhë kohore, në të cilën një e drejtë, një përfitim ose barrë, përkatësisht do të fillojë, përfundojë ose zgjasë;
- c) një rezervë nga ana e organit publik sa i përket shfuqizimit; dhe/ose
- ç) një kusht shtesë që kërkon që përfituesi të kryejë, të ndalojë një veprim të caktuar ose të lejojë një veprim të caktuar.

2. Kushti shtesë, i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, lejohet vetëm në rastet kur:

- a) ai nuk kundërvepron me qëllimin e aktit administrativ; dhe
- b) ai nuk është i ndaluar me ligj.

Neni 103

Akti i garancisë

1. Akti i garancisë nxirret nga organi publik kompetent vetëm me kërkesë të palëve dhe ka në çdo rast formë të shkruar.

2. Nëse para lëshimit të aktit të garancisë, organi publik kompetent vlerëson se duhet të ketë dëgjuesë me një ose më shumë persona ose, sipas ligjit, kërkohet pjesëmarrja e një organi tjetër publik, akti i garancisë nxirret pas dëgjësës së personit apo personave ose pjesëmarrjes së organit publik.

3. Nëse pas lëshimit të aktit të garancisë, faktet ose baza ligjore e çështjes ndryshojnë në një masë të tillë që nëse organi do të ishte në dijeni të këtij ndryshimi, nuk do ta kishte lëshuar aktin e garancisë, atëherë ky i fundit nuk është më i detyrueshëm për organin publik.

Seksioni 2

Pasojat juridike të aktit administrativ

Neni 104

Fillimi dhe përfundimi i pasojave juridike të aktit administrativ

1. Një akt administrativ fillon të sjellë pasoja juridike ndaj palës së cilës i drejtohet apo interesat e së cilës preken nga akti, me njoftimin e përmbajtjes së aktit palëve.

2. Akti administrativ i miratuar në heshtje fillon të sjellë pasoja juridike, në ditën e përfundimit të afatit për njoftimin e tij, sipas nenit 97 të këtij Kodi.

3. Një akt administrativ mund të fillojë të sjellë pasoja juridike në një datë tjetër, të caktuar shprehimisht nga vetë akti, por në asnjë rast përpara njoftimit të palës, sipas pikës 1 të këtij neni. Në këtë rast, data e fillimit të pasojave juridike caktohet shprehimisht në pjesën e dispozitivit të aktit administrativ të shkruar.

4. Një akt administrativ sjell pasoja juridike:

a) për sa kohë nuk është anuluar apo shfuqizuar, kryesisht apo si rezultat i ushtrimit të mjeteve ligjore administrative ose gjyqësore;

b) për sa kohë nuk ka përfunduar afati i aktit ose nuk është përmbushur qëllimi i tij; ose

c) për çfarëdo arsyeje tjetër të parashikuar nga ligji.

Neni 105

Efektet prapavepruese

Aktet administrative kanë fuqi prapavepruese në rastet e mëposhtme:

a) kur akti nxirret në zbatim të një vendimi gjyqësor, i cili, nga ana e tij, ka deklaruar të pavlefshëm një akt administrativ;

b) kur vetë ligji i jep aktit fuqi prapavepruese;

c) organi kompetent mund t'i japë fuqi prapavepruese aktit kur kjo lejohet nga ligji dhe është në favor të palëve të interesuara dhe nuk dëmton të drejtat e një pale të tretë.

Neni 106

Botimi i akteve në Fletoren Zyrtare

1. Botimi i akteve administrative në Fletoren Zyrtare është i detyrueshëm, kur një gjë e tillë kërkohet nga ligji.

2. Mosbotimi i aktit në Fletoren Zyrtare, kur kjo kërkohet shprehimisht nga ligji, shkakton moshyrjen në fuqi të aktit.

Seksioni 3

Ligjshmëria, pavlefshmëria dhe korrigjimi i aktit administrativ

Neni 107

Ligjshmëria e aktit administrativ

Akti administrativ është i ligjshëm nëse është nxjerrë nga organi publik kompetent, në përputhje me parimet dhe kërkesat ligjore të parashikuara në këtë Kod, si dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 108

Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm

Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme:

a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me:

i) kompetencën e organit publik;

- ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose
- iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit;
- b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën veprë penale;
- c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal;
- ç) në çdo rast tjetër të parashikuar shpre-himisht në ligj.

Neni 109

Paligjshmëria e aktit administrativ

Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:

- a) organi publik që e ka nxjerrë ka vepruar në mungesë të kompetencës;
- b) është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative;
- c) është në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ;
- ç) është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas pikës 2, të nenit 4, të këtij Kodi;
- d) është në kundërshtim me ligjin material;
- dh) është rezultat i diskrecionit të ushtruar në mënyrë jo të ligjshme; apo
- e) nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

Neni 110

Pasojat dhe konstatimi i pavlefshmërisë absolute

1. Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë. Ai konsiderohet se nuk ekziston.

2. Pavlefshmëria absolute e aktit mund të konstatohet në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, të çdo të interesuari, nga organi publik që e ka nxjerrë atë, organi epror i tij apo organi që është kompetent të shqyrtojë mjetet ligjore administrative, si dhe nga gjykata kompetente për çështjet administrative, sipas ligjit.

3. Në rast se një pjesë e aktit është absolutisht e pavlefshme dhe kjo pjesë është aq e rëndësishme sa që organi publik nuk do ta kishte nxjerrë aktin pa të, i gjithë akti është i absolutisht i pavlefshëm.

Neni 111

Konstatimi i detyrueshëm i aktit absolutisht të pavlefshëm

Organi publik ka detyrimin të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nëse vjen në dijeni për rastet e parashikuara në nenin 108 të këtij Kodi.

Neni 112

Korrigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ

1. Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ.

2. Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korrigjohet, si dhe të çdo kopje të njësuar të tij.

Anulimi dhe shfuqizimi i aktit administrativ

Neni 113

Procedura dhe pasojat e anulimit dhe shfuqizimit

1. Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror apo nga një organ tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj.
2. Anulimi i një akti administrativ ka pasoja për të shkuarën, ndërsa shfuqizimi i aktit administrativ ka pasoja vetëm për të ardhmen. Anulimi dhe shfuqizimi mund të jenë të pjesshëm apo të tërësishëm.
3. Anulimi ose shfuqizimi bëhen me një akt të ri me shkrim, i cili anulon, shfuqizon, ndryshon apo plotëson aktin e parë.

Neni 114

Anulimi dhe shfuqizimi diskrecionar i një akti administrativ të paligjshëm

1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 108, të këtij Kodi, një akt administrativ i paligjshëm mund të anulohet apo të shfuqizohet, me qëllimin rivendosjen e ligjshmërisë.
2. Nëse pala përfituese është në mirëbesim, një akt administrativ dobiprurës i paligjshëm, nuk mund të anulohet, por vetëm mund të shfuqizohet.
3. Pala përfituese nuk vlerësohet se është në mirëbesim nëse ka qenë në dijeni të shkaqeve të paligjshmërisë së aktit ose nuk ka qenë në dijeni të tyre për shkak të pakujdesisë së rëndë apo nëse akti është nxjerrë, bazuar në informacionin materialisht të gabuar apo jo të plotë të dhënë, me faj, nga vetë pala.

Neni 115

Anulimi i një akti administrativ të ligjshëm

Një akt administrativ i ligjshëm mund të anulohet, nëse pala në një akt administrativ që i nënshtrohet një detyrimi sipas shkronjës “ç”, të pikës 1, të nenit 102, të këtij Kodi, nuk e ka plotësuar tërësisht detyrimin apo nuk e ka bërë këtë brenda afatit të caktuar kohor.

Neni 116

Shfuqizimi i një akti administrativ të ligjshëm

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, një akt administrativ i ligjshëm mund të shfuqizohet, vetëm nëse shfuqizimi është i domosdoshëm për të parandaluar apo eliminuar një dëmtim serioz të jetës dhe shëndetit të njerëzve apo sigurisë publike dhe kjo nuk mund të bëhet në mënyra tjera që cenojnë më pak të drejtat apo interesat e ligjshëm të fituar të palës.
2. Pala përfituese, në rast të shfuqizimit të parashikuar në pikën 1, të këtij neni, ka të drejtën e kompensimit nëse ka hyrë në marrëdhënie financiare nga të cilat nuk mund tërhiqet ose mund tërhiqet vetëm duke pësuar dëme që nuk do të ishte e arsyeshme të kërkohen nga ajo.
3. Masa e kompensimit nuk duhet të tejkalojë interesin e arsyeshëm që ka pala në vazhdimin e sjelljes së pasojave juridike të aktit që shfuqizohet. Pala nuk përfiton kompensim për fitimin e munguar.

Neni 117

Afati për anulimin dhe shfuqizimin

1. Shfuqizimi, në rastin e parashikuar në pikën 1, të nenit 116, të këtij Kodi, mund të bëhet në çdo kohë.
2. Në çdo rast tjetër, të ndryshëm nga ai i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, anulimi ose shfuqizimi mund të bëhet brenda 30 ditëve nga dita kur organi publik është njohur me faktet që çojnë në anulimin

ose shfuqizimin, por jo me vonë se 5 vjet nga njoftimi i aktit administrativ.

Neni 118

Kthimi i pagesave dhe kontributeve në rastin e anulimit

1. Të gjitha pagesat apo kontributet, të cilat tashmë janë paguar nga pala dhe/ose nga organi publik, në bazë të një akti të anuluar, duhet të kthehen.

2. Masa e kthimit të pagesave dhe kontributeve, e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, përcaktohet në aktin e anulimit dhe llogaritet nga organi publik, sipas dispozitave për begatimin pa shkak, në përputhje me legjislacionin civil.

KREU II

KONTRATA ADMINISTRATIVE

Neni 119

Kushtet dhe kërkesat e kontratës administrative

1. Organi publik, për realizimin e një interesi publik, të cilit i shërben, por pa cenuar interesat apo të drejtat e palëve të treta, mund të lidhë një kontratë administrative, nëse plotësohen këto kushte:

a) forma kontraktore nuk ndalohet shprehimisht nga ligji ose nuk bie në kundërshtim me vetë natyrën e çështjes administrative; dhe

b) organi publik është i autorizuar nga ligji të vendosë për çështjen me diskrecion.

2. Kontrata administrative lidhet në formë të shkruar, përveç rasteve kur ligji parashikon një formë tjetër të posaçme.

3. Kontrata nënshkruhet nga palët apo përfaqësuesit në mënyrë manuale apo elektronike, në përputhje me modalitetet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Nënshkrimi në emër të organit publik bazohet mbi një autorizim të lëshuar nga organi përkatës.

Neni 120

Kontrata administrative zëvendësuese

1. Organi publik mund të lidhë një kontratë administrative zëvendësuese me palën, së cilës mund t'i drejtonte një akt administrativ, nëse interesi publik realizohet më mirë nëpërmjet kontratës administrative.

2. Në kontratën zëvendësuese, pala tjetër, jo organ publik, detyrohet të kryejë a të mos kryejë një veprim, ose të japë diçka kundrejt kryerjes së një veprimi nga organi publik. Ky detyrim i shërben organit publik për përmbushjen e një funksioni publik administrativ, sipas qëllimit të përcaktuar në kontratë.

3. Në tekstin e kontratës administrative zëvendësuese arsyetohet se interesi publik mbrohet më mirë me lidhjen e kësaj kontrate.

Neni 121

Kontrata administrative ndërmjet organeve publike

Organet publike mund të lidhin ndërmjet tyre kontrata për rregullimin e marrëdhënieve për kryerjen e veprimtarive në interes të përbashkët.

Neni 122

Pavlefshmëria e kontratës administrative

Pavlefshmëria e kontratës administrative rregullohet sipas dispozitave të Kodit Civil që parashikojnë pavlefshmërinë e veprimit juridik. Gjithashtu, kontrata administrative është e pavlefshme në rastet e mëposhtme:

a) nuk janë respektuar kërkesat e parashikuara në nenin 119 të këtij Kodi;

b) nuk janë respektuar kërkesat për lidhjen e kontratës administrative zëvendësuese, të para-

shikuara në nenin 120 të këtij Kodi.

Neni 123

Ndryshimi, prishja apo tërheqja nga kontrata administrative

1. Nëse, për shkak të rrethanave të shfaqura pas lidhjes së kontratës dhe të paparashikueshme në kohën e lidhjes së saj, vazhdimi i ekzekutimit të detyrimeve të kontratës bëhet shumë i vështirë për njërën nga palët kontraktuese, ato mund të bien dakord për ndryshimin apo prishjen e kontratës.

2. Organi publik mund të tërhiqet nga kontrata administrative në mënyrë të njëanshme për të shmangur ose për të ndaluar cenimin e interesit publik.

3. Tërheqja bëhet me akt administrativ të shkruar dhe të arsyetuar, kundrejt kompensimit të dëmit që i është shkaktuar palës tjetër.

Neni 124

Zbatimi i dispozitave të tjera ligjore

Për çështjet e parregulluara shprehimisht nga ky Kod për kontratën administrative, zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë apo të parashikimeve të posaçme ligjore.

Neni 125

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve kontraktuese, që buron nga një kontratë administrative, zgjidhet drejtpërdrejt nga gjykata kompetente për çështjet administrative.

KREU III

VEPRIMET E TJERA ADMINISTRATIVE NËN REGJIMIN E SË DREJTËS ADMINISTRATIVE

Neni 126

Veprime të tjera administrative nën regjimin e së drejtës administrative

1. Veprime të tjera administrative, nën regjimin e së drejtës administrative, janë çdo formë e njëanshme e veprimtarisë së organit publik në ushtrimin e funksioneve të tij publike, të cilat nuk plotësojnë kriteret për të qenë një akt administrativ apo kontratë administrative dhe që sjellin pasoja juridike për të drejtat subjektive dhe interesat legjitimë.

2. Veprimi tjetër administrativ, nën regjimin e së drejtës publike, është i ligjshëm nëse është në përputhje me parimet e këtij Kodi dhe brenda kompetencës së organit publik.

KREU IV

KRYERJA E TËRTHORTË E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Neni 127

Kryerja e tërthortë e shërbimeve publike

1. Në rastin e veprimtarisë në funksion të dobishmërisë publike apo të shërbimeve publike, që kryhen nga subjektet private apo ato publike, nën regjimin e së drejtës private, organi rregullator,

mbikëqyrës a licencues, sipas ligjit, duhet të sigurojë, nëpërmjet ushtrimit të mbikëqyrjes, vazhdimësinë, universalitetin, koston e pranueshme, cilësinë e përshtatshme të shërbimit, objektivitetin dhe transparencën e procedurave dhe mosdiskriminimin e përfituesit të shërbimit publik.

2. Kryerja e tërthortë e shërbimeve publike nuk duhet t'i ofrojë përfituesit të shërbimit më pak mbrojtje ligjore, në krahasim me situatën kur ky shërbim kryhej drejtpërdrejtë nga organi publik.

PJESA E GJASHTË MJETET LIGJORE ADMINISTRATIVE

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 128

Legjitimimi dhe mjetet e ligjore administrative

1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj të ligjshëm cenohen nga ky veprim apo mosveprim.

2. Përveç kur parashikohet ndryshe nga ligji, mjetet ligjore administrative mund të ushtrohen për shkak të paligjshmërisë.

3. Mjetet ligjore administrative janë:

a) ankimi administrativ, i cili përfshin:

i) Ankimin administrativ ndaj aktit administrativ ose mosveprimit të organit publik për nxjerrjen e aktit të brenda afatit të parashikuar dhe/ose veprimit procedural të organit publik gjatë procedurës administrative (Ankimi administrativ ndaj aktit administrativ); ose

ii) kundërshtimi administrativ ndaj një veprimi tjetër administrativ nën regjimin e së drejtës administrative (Kundërshtimi administrativ);

b) rishikimi.

4. Pala nuk ka të drejtë të ushtrojë për së dyti mjetet ligjore administrative për të njëjtën çështje.

Neni 129

Shterimi i mjeteve ligjore administrative

Shterimi i ankimit administrativ, është kusht paraprak për ngritjen e padisë në gjykatën kompetente për çështjet administrative, përveç rasteve kur:

a) ligji nuk parashikon organ më të lartë për paraqitjen e ankimit administrativ, ose kur organi më i lartë administrativ nuk është konstituuar;

b) ligji parashikon shprehimisht të drejtën për t'u ankuar drejtpërdrejt në gjykatë;

c) organi më i lartë në shqyrtimin e ankimit administrativ ka cenuar, me vendimin e tij, të drejtat apo interesat personale të ligjshëm të një personi, i cili nuk ka qenë palë në procedurën administrative.

KREU II ANKIMI ADMINISTRATIV NDAJ AKTIT ADMINISTRATIV

Seksioni 1

Kërkesat formale të ankimit administrativ ndaj aktit administrativ

Neni 130

Ankimi administrativ ndaj aktit administrativ dhe qëllimi tij

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, ankimi administrativ mund të paraqitet ndaj një akti administrativ ose ndaj mosveprimit të organit publik për nxjerrjen e aktit të brenda afatit të parashikuar.

2. Një veprim procedural i organit publik gjatë procedurës administrative, mund të ankimohet veçmas, vetëm kur ankimi parashikohet shprehimisht nga ligji.

3. Veprimi procedural, sipas pikës 2, të këtij neni, është çdo akt, veprim apo mosveprim i organit publik gjatë procedurës administrative, që nuk është një akt administrativ përfundimtar apo akti administrativ i përfundimit të procedurës administrative, parashikuar në nenin 90 të këtij Kodi.

Neni 131

Përmbajtja e ankimit administrativ ndaj aktit administrativ

1. Ankimi administrativ ndaj aktit përcakton:

a) subjektin që ushtron ankimin administrativ;

b) organin që shqyrton ankimin administrativ;

c) aktin administrativ, i cili kundërshtohet ose aktin administrativ të kërkuar, i cili nuk është nxjerrë;

ç) objektin dhe shkaqet për të cilat bëhet ankimi.

2. Pavarësisht parashikimeve të pikës 1, të këtij neni, çdo kërkesë drejtuar organit publik vlerësohet si ankim administrativ ndaj aktit edhe nëse nuk është emërtuar shprehimisht si i tillë. Në këtë rast, qëllimi për t'u ankuar ndaj një akti administrativ, apo për të kërkuar nxjerrjen e një akti, duhet të jetë mjaftueshëm i qartë.

Neni 132

Afatet e ankimit administrativ ndaj aktit administrativ

1. Ankimi administrativ ndaj aktit administrativ duhet të paraqitet brenda 30 ditëve nga data kur ankuesi ka marrë njoftim për nxjerrjen ose refuzimin e nxjerrjes së aktit administrativ.

2. Në rastin e mosveprimit administrativ, me përjashtim kur miratimi në heshtje është i zbatueshëm, ankimi duhet të paraqitet jo më parë se 7 ditë dhe jo më vonë se 45 ditë nga data e përfundimit të afatit të caktuar ose të shtyrë, për përfundimin e procedurës administrative.

Neni 133

Efektet e ankimit administrativ ndaj aktit administrativ

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, ankimi administrativ ndaj aktit, i paraqitur në përputhje me kërkesat e neneve 130-132, të këtij Kodi, pezullon ekzekutimin e aktit deri në njoftimin e vendimit të ankimit.

2. Nëse në aktin administrativ përfshihen dy ose më shumë palë me interesa të njëjtë, ankimi administrativ ndaj aktit të paraqitur nga njëra nga palët, i shtrin efektet e pezullimit ndaj të gjitha palëve të përfshira.

3. Zbatimi i aktit administrativ ndaj aktit nuk pezullohet kur:

a) akti administrativ synon mbledhjen e taksave, tatimeve dhe të ardhurave të tjera buxhetore;

b) akti administrativ ka të bëjë me masa policore;

c) organi publik, i cili shqyrton ankimin, vlerëson se zbatimi i menjëhershëm është në interes të rendit publik, shëndetit publik dhe të interesave të tjerë publikë.

4. Kundër aktit që vendos ndalimin e efektit pezullues të ankimit, mund të bëhet ankim i drejtpërdrejtë në gjykatën kompetente për çështjet administrative, brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

Neni 134

Organi të cilit i drejtohet ankimi

1. Përveçse kur nuk parashikohet ndryshe nga ligji, ankimi ndaj një akti administrativ mund t'i drejtohet organit publik që:

- a) ka nxjerrë ose ka kompetencë të nxjerrë aktin;
- b) organit publik epror të organit të parashikuar në shkronjën "a", të pikës 1, të këtij neni; ose
- c) një organi tjetër publik të përcaktuar shprehimisht me ligj.

2. Nëse ankimi i është drejtuar njërit prej organeve të parashikuara në shkronjat "b" dhe "c", të pikës 1, të këtij neni, ato ia përcjellin pa vonesë organit kompetent.

3. Ankimi ndaj mosveprimit administrativ mund t'i drejtohet drejtpërdrejt organeve të parashikuara në shkronjat "b" dhe "c", të pikës 1, të këtij neni. Nëse ankimi i është drejtuar organit të parashikuar në shkronjën "a", të këtij neni, ai ia përcjell, pa vonesë, një prej organeve të parashikuara në shkronjat "b" dhe "c", të pikës 1, të këtij neni, së bashku me dosjen e çështjes dhe një raport të shkruar për arsyet e heshtjes.

Neni 135

Kushtet për pranimin e ankimit

Ankesa është e pranueshme nëse plotëson këto kushte:

- a) nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji;
- b) ankuesi ka legjitimitet në përputhje me nenin 128 të këtij Kodi;
- c) është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga neni 132 i këtij Kodi; dhe
- ç) çfarëdo kushti tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj.

Seksioni 2

Procedura e shqyrtimit të ankimit administrativ ndaj aktit

Neni 136

Procedura e shqyrtimit të ankimit nga organi publik kompetent

1. Ankimi ndaj një akti administrativ shqyrtohet, në radhë të parë, nga vetë organi publik kompetent, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj.

2. Organi publik kompetent fillimisht shqyrton nëse ankimi është i pranueshëm dhe vetëm nëse ankimi është i pranueshëm, shqyrton ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e aktit administrativ të ankimit. Nëse është e nevojshme, organi publik kompetent mund të kryejë hetime administrative shtesë.

3. Nëse anulimi, shfuqizimi ose ndryshimi i aktit administrativ të ankimit apo nxjerrja e aktit të refuzuar do t'i shkaktonte dëm një pale tjetër, organi kompetent duhet t'i japë asaj mundësinë për t'u dëgjuar, sipas neneve 87 dhe 88, të këtij Kodi, përpara marrjes së vendimit për ankimin e paraqitur.

4. Kur organi publik kompetent vlerëson se ankimi është i pranueshëm dhe plotësisht i bazuar, ai me një akt të ri administrativ anulon, shfuqizon ose ndryshon aktin e ankimit, ose përkatësisht nxjerr aktin e refuzuar, siç është kërkuar nga pala.

5. Kur organi publik kompetent vlerëson se ankimi nuk është i pranueshëm dhe plotësisht i bazuar, pa vonesë dhe pa u shprehur mbi të, e përcjell atë për shqyrtim dhe vendimmarrje tek organi epror, së bashku me të gjitha dokumentet përkatëse të dosjes dhe një raport me shkrim të qëndrimit të tij.

Neni 137

Procedura e shqyrtimit të ankimit nga organi epror

1. Në rastin e parashikuar nga pika 5, e nenit 136, të këtij Kodi, organi epror shqyrton ankimin e

përcjellë nga organi kompetent dhe, nëse është e nevojshme, zhvillon hetime shtesë, apo urdhëron organin kompetent që të zhvillojë hetime shtesë dhe të njoftojë për to. Pikat 2 dhe 3, të këtij neni, zbatohen edhe në këtë rast.

2. Organi epror, me akt administrativ, refuzon ankimin nëse ai rezulton të jetë i papranueshëm apo i pabazuar.

3. Nëse organi epror vlerëson se pjesa urdhëruese e aktit administrativ të ankimuar është e ligjshme, por arsyet e dhëna janë të tjera nga ato që ka dhënë organi kompetent publik në aktin e ankimuar, apo vlerëson se arsyetimi i tij nuk është i plotë, ai refuzon ankimin dhe paraqet arsyetimin e ri.

4. Nëse organi epror vlerëson se ankimi është i pranueshëm dhe i bazuar, ai vendos përfundimisht me një akt të ri duke anuluar, shfuqizuar apo ndryshuar, plotësisht apo pjesërisht, aktin e ankimuar, ose përkatësisht duke nxjerrë aktin e kërkuar nga pala.

5. Nëse nuk është parashikuar shprehimisht ndryshe nga ligji, akti i organit epror mund të jetë vetëm në dobi të palës ankuese.

Neni 138

Ankimi ndaj mosveprimit administrativ

1. Ankimi ndaj mosveprimit administrativ shqyrtohet drejtpërdrejtë nga organi epror. Organi epror i kërkon menjëherë organit kompetent, që pa vonesë të paraqesë dosjen e çështjes dhe një raport me shkrim mbi arsyet e heshtjes administrative.

2. Organi epror, fillimisht, shqyrton nëse ankimi është i pranueshëm dhe vetëm nëse ankimi është i pranueshëm, vendos mbi kërkesën e palës, siç i është parashtruar organit kompetent.

3. Organi epror vendos mbi kërkesën në bazë të dosjes së çështjes apo, nëse është e nevojshme, zhvillon hetime administrative shtesë, apo urdhëron organin kompetent që të zhvillojë këto hetime shtesë dhe ta njoftojë për rezultatet e hetimit.

4. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, organi epror zgjidh çështjen duke nxjerrë një akt përfundimtar.

Neni 139

Përmbajtja dhe pasoja të aktit që zgjidh ankimin

1. Përveç kërkesave të nenit 100 të këtij Kodi, arsyetimi i aktit administrativ që zgjidh ankimin, përmban edhe një vlerësim të të gjitha pretendimeve të parashtruara nga pala në ankim.

2. Përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe me ligj, akti që zgjidh ankimin ka pasoja juridike në të kaluarën. Pikat 2 dhe 3, të nenit 114, të këtij Kodi, zbatohen për sa është e mundur edhe në këtë rast.

Neni 140

Afati për njoftimin e aktit që zgjidh ankimin

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, akti administrativ që zgjidh ankimin nxirret dhe i njoftohet palës brenda 30 ditëve nga paraqitja e ankimit.

2. Afati i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, mund të zgjatet kur është e nevojshme kryerja e hetimeve administrative shtesë. Neni 92, i këtij Kodi, zbatohet gjithashtu për shtyrjen e afatit të parashikuar sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Neni 93, i këtij Kodi, nuk zbatohet në rastin e ankimit administrativ.

KREU III

KUNDËRSHTIMI ADMINISTRATIV

Neni 141

Objekti i kundërshtimit administrativ

1. Në rastin e kundërshtimit administrativ ndaj një veprimi tjetër administrativ, nën regjimin e së

drejtës administrative, pala mund të kërkojë nga organi publik:

- a) ndalimin e kryerjes së një veprimi tjetër administrativ;
- b) kryerjen e një veprimi tjetër administrativ, për të cilin pala ka të drejtë, nëse ky veprim është kërkuar nga pala, por organi publik nuk ka vepruar;
- c) tërheqjen apo ndryshimin e një deklarate publike;
- ç) shpalljen të paligjshëm të një veprimi tjetër administrativ dhe ndreqjen e pasojave të shkaktuara prej tij.

2. Pala, në rastin e kundërshtimit administrativ për kryerjen e tërthortë të shërbimeve të dobishmërisë publike dhe të shërbimeve të tjera publike, mund të kërkojë ushtrimin e funksioneve rregullatore apo të mbikëqyrjes nga organi rregullator, mbikëqyrës apo licencues, me qëllim përfitimin nga pala kundërshtuese të një shërbimi, për të cilën ka të drejtë sipas ligjit, dhe respektimin nga subjekti privat apo publik të detyrimeve të parashikuara në pikën 1, të nenit 127, të këtij Kodi.

Neni 142

Përmbajtja e kundërshtimit administrativ dhe afati

1. Neni 131, i këtij Kodi, zbatohet, për aq sa është e mundur, për formën e kundërshtimit administrativ.

2. Kundërshtimi administrativ paraqitet brenda 15 ditëve nga data që pala ka marrë dijeni për faktin të cilin e kundërshton.

Neni 143

Shqyrtimi i kundërshtimit administrativ

1. Kundërshtimi administrativ, në rastin e kryerjes së tërthortë të shërbimeve publike, i drejtohet dhe shqyrtohet nga organi publik rregullator, mbikëqyrës, apo licencues. Pala e ankimuar vihet në dijeni pa vonesë për masat e marra nga ky organ.

2. Në rastin e parashikuar në shkronjat “a”, “c” e “ç”, të nenit 141, të këtij Kodi, kundërshtimi i drejtohet dhe shqyrtohet nga organi kompetent.

3. Në rastin e parashikuar në shkronjën “b”, të nenit 141, të këtij Kodi, kundërshtimi i drejtohet dhe shqyrtohet nga organi epror. Nëse organi epror vendos në favor të palës, ai i cakton organit kompetent një afat për kryerjen e veprimit tjetër administrativ të kërkuar.

4. Vendimi i shqyrtimit të kundërshtimit merret dhe i njoftohet palës brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së tij. Kundër vendimit mund të ngrihet padi drejtpërdrejtë në gjykatën kompetente për çështjet administrative.

KREU IV
RISHIKIMI

Neni 144
Rishikimi

1. Rishikimi është mjete ligjor administrativ, me anë të të cilit kërkohet anulimi apo ndryshimi i një akti administrativ të nxjerrë apo nxjerrja e një akti administrativ të refuzuar, kundër të cilit ankimi nuk është më i pranueshëm për shkak të kalimit të afatit të parashikuar nga ky Kod.

2. Pala mund të kërkojë rishikim, nëse zbulohen rrethana ose prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk diheshin dhe mund të diheshin prej saj gjatë zhvillimit të procedurës administrative që ka çuar në nxjerrjen e aktit administrativ.

Neni 145

Afati kohor dhe paraqitja

1. Kërkesa për rishikim duhet të paraqitet brenda 30 ditëve nga dita që pala ka marrë dijeni për shkakun e rishikimit, por në çdo rast jo më vonë se 2 vjet nga dita që ka lindur shkakun e rishikimit.

2. Kërkesa i dorëzohet organit që ka nxjerrë apo ka refuzuar aktin administrativ, i cili kërkohet që të rishikohet.

Neni 146

Vendimi për rishikimin

Organi që ka nxjerrë ose ka refuzuar aktin administrativ, kur konstaton se akti administrativ ose refuzimi administrativ do të ishin të paligjshëm, nëse do të nxirrej në rrethanat aktuale mbizotëruese, përkatësisht e anulon aktin, e ndryshon atë, ose nxjerr aktin e refuzuar. Në rast të kundërt, rishikimi refuzohet.

PJESA E SHTATË NJOFTIMI

KREU I RREGULLAT E PËRGJITHSHME TË NJOFTIMIT

Neni 147

Njoftimi i përshtatshëm

1. Organi publik i komunikon palës ose një subjekti tjetër, të përfshirë në procedurën administrative, veprimin administrativ ose veprimin procedural me anë të njoftimit.

2. Në qoftë se nuk është parashikuar ndryshe me ligj, organi publik është i lirë të vendosë mënyrën e duhur të njoftimit të veprimeve administrative apo ndonjë njoftim tjetër, në kuadrin e procedurës administrative, shqyrtimit të mjeteve ligjore administrative ose procedurës së ekzekutimit të aktit administrativ.

3. Në çdo rast, organi publik kryen njoftimin, duke pasur parasysh efektivitetin e tij, mbrojtjen ligjore të interesave të palës, transparencën dhe koston.

Neni 148

Format e njoftimit

1. Njoftimi, kur pala është e pranishme, mund të bëhet verbalisht, apo në çdo mënyrë tjetër të përshtatshme të njoftimit.

2. Një dokument i shkruar mund të njoftohet nëpërmjet dërgimit me postë, mjeteve elektronike, faks apo njoftimit formal, sipas parashikimeve të këtij Kodi.

Neni 149

Marrësi i njoftimit

1. Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë Kod, njoftimi i bëhet palës personalisht. Përgjithësisht, kur organi publik është njoftuar për caktimin e një përfaqësuesi ose personit përgjegjës për njoftimet, njoftimi i bëhet këtij të fundit.

2. Njoftimi që i bëhet përfaqësuesit ose personit përgjegjës të njoftimeve, vlerësohet se i është bërë personalisht palës.

Neni 150

Personi përgjegjës për njoftimet

1. Në rast se 20 apo më shumë palë, me kërkesa të njëjta, nuk kanë një përfaqësues të përbashkët, ato me kërkesë të organit publik, janë të detyruara të caktojnë një person përgjegjës të përbashkët për njoftimet, brenda një afati të përcaktuar nga organi publik.

2. Nëse personi përgjegjës për njoftimet nuk përcaktohet brenda afatit, organi publik cakton si person përgjegjës për njoftimin një nga palët, pasi të ketë marrë miratimin e tij. Në çdo rast, caktimi i personit përgjegjës për njoftimin kryhet në përputhje me procedurën e parashikuar në pikën 2, të nenit 38, të këtij Kodi.

3. Në aktin që i njoftohet personit përgjegjës të përbashkët për njoftimet përcaktohen të gjitha palët, të cilave u drejtohet njoftimi.

Neni 151

Vendi i njoftimit

1. Njoftimi bëhet në:

- a) vendbanimin ose vendqëndrimin e marrësit;
- b) çdo vend, ku marrësi ndodhet, përfshirë dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale;
- c) selinë ose çdo vend ku ushtron veprimtarinë marrësi, nëse ky i fundit është person juridik;
- ç) vendin e punës;
- d) vendin e ushtrimit të veprimtarisë ose zyrën e marrësit;
- dh) çdo vend tjetër, i specifikuar dhe i njoftuar paraprakisht nga pala.

2. Pika 1 zbatohet për aq sa është e mundur edhe në rastet e njoftimit të përfaqësuesit të palës ose personit përgjegjës për njoftimet.

Neni 152

Njoftimi ndërkombëtar

Njoftimi për shtete të huaja, organizatat ndërkombëtare, apo personat që gëzojnë imunitet diplomatik, bëhet nëpërmjet institucionit që mbulon çështjet e jashtme, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji.

Neni 153

Njoftimi në raste të posaçme

1. Njoftimi i personave që ndodhen në shërbim në Forcat e Armatosura ose në njësitë e ministrisë që mbulon çështjet e brendshme, bëhet nëpërmjet administratës së tyre.

2. Njoftimi i personave të privuar nga liria në vendet e ndalimit ose institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, bëhet nëpërmjet administratës së institucionit përkatës ku ndodhet personi. Në çdo rast, administrata e institucionit duhet të dokumentojë marrjen e njoftimit.

Neni 154

Gabimi në njoftim

Nëse palës marrëse, për shkak të një gabimi në kryerjen e njoftimit të bërë nga organi publik, i shkaktohet përkeqësim i situatës ligjore, njoftimi vlerësohet se është bërë në ditën kur marrësi provon se ka marrë dijeni për njoftimin.

KREU II

MËNYRAT DHE MJETET E NJOFTIMIT

Seksioni 1

Njoftimi me postë dhe mjete elektronike

Neni 155

Njoftimi nëpërmjet postës

1. Njoftimi me postë bëhet nëpërmjet postës së thjeshtë apo të porositur.

2. Për efekt të këtij Kodi, një shkresë, dërguar me postë të thjeshtë apo të porositur, vlerësohet e njoftuar në ditën e tretë nga data e postimit të dokumentit për adresat brenda Republikës së Shqipërisë, dhe ditën e pestë për adresat jashtë territorit të vendit.

3. Pika 2, e këtij neni, nuk zbatohet nëse marrësi provon se dokumenti nuk është marrë, apo është marrë në një ditë të mëvonshme.

Neni 156

Njoftimi nëpërmjet mjeteve elektronike

1. Njoftimi nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik apo me faks bëhet kur marrësi ka rënë paraprakisht dakord për këtë mënyrë njoftimi dhe nëse ligji nuk parashikon një formë tjetër të detyrueshme njoftimi. Nëse njoftimi është i palexueshëm, marrësi mund t'i kërkojë organit publik ta ridërgojë njoftimin në një formë tjetër më të përshtatshme.

2. Një shkresë, dërguar me mjete të komunikimit elektronik, vlerësohet e marrë në përputhje me parashikimet e ligjit për komunikim elektronik.

3. Një shkresë e dërguar me faks vlerësohet e njoftuar në ditën e tretë nga data e dërgimit.

4. Pikat 2 dhe 3, të këtij neni, nuk zbatohen nëse marrësi provon se shkresa nuk është marrë, apo është marrë në një datë të mëvonshme.

Seksioni 2

Njoftimi formal

Neni 157

Njoftimi formal

Njoftimi i një shkrese mund të bëhet edhe nëpërmjet njoftimit formal, në rastet kur kjo parashikohet shprehimisht nga ligji, apo kur vendoset nga vetë organi publik.

Neni 158

Mënyrat e njoftimit formal

Njoftimi formal bëhet nëpërmjet dorëzimit personalisht, njoftimit nëpërmjet të tretit apo postës, si dhe nëpërmjet publikimit elektronik, njoftimit publik apo botimit zyrtar, sipas parashikimeve të neneve 159 deri në 163 të këtij Kodi.

Neni 159

Dorëzimi personalisht

1. Nëpunësi i organit publik i dorëzon personalisht shkresën marrësit në një nga vendet e njoftimit të parashikuara nga ky Kod. Dorëzimi personalisht pasqyrohet në një procesverbal. Procesverbali përfshin të dhënat për identifikimin e shkresës së dorëzuar, datën e dorëzimit dhe nënshkruhet nga nëpunësi dhe marrësi.

2. Nëse marrësi nuk gjendet në vendin e njoftimit, nëpunësi i organit publik bën një përpjekje të dytë për dorëzimin personalisht, jo më parë se 24 orë dhe jo më vonë se 72 orë nga përpjekja e parë.

3. Kur marrësi nuk gjendet përsëri apo kur ai refuzon marrjen në dorëzim, nëpunësi bën shënimin përkatës në një procesverbal dhe kur është e mundur e vërteton situatën me nënshkrimin e një dëshmitari të pranishëm. Në këtë rast, nëpunësi i organit publik vendos një shënim në mjediset e vendit të njoftimit, duke përcaktuar marrësin dhe zyrën përkatëse në organin publik ku mund të tërhiqet shkresa. Në shënim përcaktohet data dhe ora e lënies së shënimit, dhe data që vlerësohet si data e kryerjes së njoftimit sipas pikave 4 dhe 5 të këtij neni.

4. Dorëzimi, sipas pikës 3, të këtij neni, vlerësohet i kryer pas 3 ditëve nga data e vendosjes së

shënimit.

5. Dorëzimi bëhet vetëm gjatë ditëve të punës, nga ora 7⁰⁰ deri në 19⁰⁰.

Neni 160

Njoftimi nëpërmjet të tretit

1. Kur nuk është i mundur njoftimi, sipas nenit të mësipërm, dhe marrësi nuk gjendet, nëpunësi i organit publik bën dorëzimin nëpërmjet një të tretit, që pranon t'ia dorëzojë njoftimin marrësit, sipas kësaj radhe preference:

a) një personi të familjes që ka mbushur moshën 16 vjeç, në vendin e njoftimit të parashikuar në nenin 151, pika 1, shkronja "a", e këtij Kodi;

b) një fqinji madhor, në vendin e njoftimit, të parashikuar në nenin 151, pika 1, shkronja "a", e këtij Kodi;

c) një punonjësi apo portierit, në vendin e njoftimit, të parashikuar në nenin 151, pika 1, shkronjat "c" deri në "d", të këtij Kodi.

2. Dorëzimi, sipas pikës 1 të këtij neni, nuk mund të bëhet nëpërmjet një personi që merr pjesë në të njëjtën procedurë dhe ka interesa të kundërt me marrësin.

3. Personi i tretë, që pranon të bëjë dorëzimin, nënshkruan procesverbal, ku merr përsipër t'ia dorëzojë njoftimin personit të thirrur. Nëpunësi publik pasqyron në procesverbal të dhënat lidhur me marrëdhënien e personit të tretë me marrësin, të dhënat për identifikimin e shkresës së dorëzuar dhe datën e dorëzimit personit të tretë.

4. Nëse personi i tretë refuzon marrjen në dorëzim, nëpunësi bën shënimin përkatës në një procesverbal dhe, kur është e mundur, e vërteton refuzimin me nënshkrimin e një dëshmitari të pranishëm.

5. Në rastin e parashikuar në pikën 4, të këtij neni, shkresa lihet në kutinë postare të vendbanimit apo të vendqëndrimit të marrësit. Data dhe ora e lënies në kutinë postare dhe data, e cila vlerësohet si dita e kryerjes së njoftimit, sipas pikave 6 dhe 7, të këtij neni, shënohen nga nëpunësi në zarfin e shkresës dhe reflektohen në procesverbalin përkatës.

6. Dorëzimi vlerësohet i bërë pas 3 ditëve nga data e marrjes në dorëzim të shkresës nga personat e tretë ose nga data e lënies në kutinë postare.

7. Dorëzimi, sipas këtij neni, bëhet vetëm gjatë ditëve të punës, nga ora 7⁰⁰ deri në 19⁰⁰.

Neni 161

Njoftimi nëpërmjet publikimit elektronik

1. Njoftimi mund të bëhet nëpërmjet publikimit në një regjistër elektronik, të hapur për publikun, në rastin e parashikuar nga ligji i posaçëm dhe vetëm nëse marrësi është vënë në dijeni paraprakisht për datën e saktë kur bëhet publikimi.

2. Njoftimi, sipas pikës 1, të këtij neni, vlerësohet si i bërë në datën e përcaktuar për publikimin vetëm nëse dokumenti është publikuar faktikisht në atë datë.

3. Njoftimi i një dokumenti elektronik mund të bëhet edhe nëpërmjet shkarkimit nga një server i caktuar, i mbyllur për publikun, vetëm nëse palës i sigurohet, paraprakisht, akses nëpërmjet mjeteve elektronike autentike të identifikimit, dhe nëse ajo është vënë në dijeni me një njoftim paraprak për datën, apo periudhën e saktë kur dokumenti mund të shkarkohet.

4. Njoftimi, sipas pikës 3, të këtij neni, vlerësohet si i bërë në datën e shkarkimit të tij nga serveri. Nëse shkresa nuk është shkarkuar në datën e përcaktuar, organi publik i dërgon palës një njoftim të dytë. Nëse shkresa nuk është shkarkuar në datën e caktuar në njoftimin e dytë, ajo njoftohet në një mënyrë tjetër të përshtatshme.

Neni 162
Njoftimi publik

1. Njoftimi publik bëhet në këto raste:

a) kur palët janë të panjohura;

b) kur vendi për njoftimin nuk është i njohur dhe njoftimi nuk është i mundur, sipas nenit 151 të këtij Kodi;

c) kur çdo formë tjetër njoftimi është e papërshtatshme apo e pamundur;

ç) në çdo rast tjetër të përcaktuar shprehimisht nga ligji.

2. Njoftimi publik bëhet nëpërmjet shpalljes së shkresës në një kënd të posaçëm për njoftimet në selinë e organit dhe në degët ose në zyrat e tij vendore, në prefekturën apo në një vend tjetër dhe ku mendohet se mund të merret dijeni nga ai/ajo, të cilit i drejtohet.

3. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni. Ky afat mund të zgjatet nga organi publik, për shkaqe të justifikuara. Data e shpalljes dhe heqjes së njoftimit përcaktohet në shkresën e vendosur në mjediset e përmendura në pikën 2 të këtij neni.

4. Përveç shpalljes së shkresës në mjediset e përmendura në pikën 2, të këtij neni, organi publik publikon aktin në faqen e tij të internetit dhe gjithashtu mund ta botojë edhe në shtypin e shkruar, në dy gazetat me tirazh më të madh.

5. Në rastin e njoftimit të një akti administrativ, teksti i shpallur përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 99, të këtij Kodi, me përjashtim të pjesës arsyetuese. Ai shoqërohet me të dhëna për zyrën, vendin dhe mënyrën e njohjes me përmbajtjen e plotë të aktit administrativ.

Neni 163
Botimi zyrtar

1. Njoftimi nëpërmjet botimit në Fletoren Zyrtare ose në buletinet e njoftimeve zyrtare është i detyrueshëm kur:

a) njoftimi i drejtohet një grupi personash, anëtarët e të cilit janë ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme dhe çdo formë tjetër njoftimi vlerësohet si e pamundur apo e papërshtatshme; ose

b) parashikohet shprehimisht në ligj.

2. Neni 162, pika 5, e këtij Kodi, zbatohet për aq sa është e mundur edhe për botimin zyrtar.

3. Përveçse kur parashikohet ndryshe në ligj, njoftimi, sipas këtij neni, vlerësohet i kryer brenda 10 ditëve nga data e botimit.

PJESA E TETË
EKZEKUTIMI I AKTIT ADMINISTRATIV

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 164

Akti i ekzekutueshëm

1. Akti administrativ mund të ekzekutohet vetëm pasi ka hyrë në fuqi.

2. Akti administrativ fillon të ekzekutohet:

a) pas përfundimit të afatit të ankimit administrativ, nëse nuk është bërë ankim;

b) pas njoftimit të aktit administrativ, në qoftë se ankimi administrativ nuk lejohet;

c) pas njoftimit të aktit administrativ, në qoftë se, sipas ligjit, ankimi administrativ nuk ka efekt pezullues;

c) pas njoftimit të vendimit për heqjen e efektit pezullues të ankimit, në përputhje me nenin 133 të këtij Kodi;

d) pas njoftimit të vendimit që zgjidh ankimin, nëse ky i fundit e ka refuzuar apo nuk e ka pranuar apelimin.

3. Vendimi organit publik, i cili ndryshon aktin e ankimuar, bëhet i ekzekutueshëm pasi i njoftohet palës.

Neni 165

Parimet e ekzekutimit të detyrueshëm

1. Përveç rasteve të ekzekutimit të menjëhershëm, të parashikuara në nenin 179, të këtij Kodi, organi publik nuk mund të kryejë asnjë veprim ekzekutimi përveçse në zbatim të një akti administrativ, i cili është bërë i ekzekutueshëm sipas këtij Kodi.

2. Ekzekutimi i akteve administrative realizohet me mënyrën dhe mjetet e ekzekutimit, të cilat garantojnë ekzekutimin, duke shkaktuar dëmin më të vogël të mundshëm ndaj të drejtave dhe interesave të ligjshëm të subjektit, ndaj të cilit kryhet ekzekutimi.

Neni 166

Aktet që nuk mund të ekzekutohen

Përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe, akti administrativ i ekzekutueshëm, sipas nenit 164, të këtij Kodi, nuk ekzekutohet nëse:

- a) efekti i tij është pezulluar në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- b) kundër tij është bërë një ankim me efekt pezullues;
- c) kanë kaluar 5 vjet nga data në të cilin akti është bërë i ekzekutueshëm.

Neni 167

Organi kompetent për ekzekutim të detyrueshëm

Përveçse kur ligji parashikon shprehimisht një organ tjetër, ekzekutimi i detyrueshëm është në kompetencën e organit publik që ka nxjerrë aktin fillestar, pavarësisht nëse ai është ndryshuar apo zëvendësuar nga organi epror, si pasojë e ankimit administrativ, apo nga gjykata.

Neni 168

Subjekti i ekzekutimit

Ekzekutimi kryhet ndaj palës, e cila duhet të përmbushë detyrimin, sipas aktit administrativ që ekzekutohet, apo edhe ndaj trashëgimtarëve të palës, nëse detyrimi nuk ka karakter ngushtësisht personal.

KREU II

EKZEKUTIMI VULLNETAR I AKTIT ADMINISTRATIV

Neni 169

Njoftimi për ekzekutimin vullnetar

1. Përveç rasteve të ekzekutimit të menjëhershëm, sipas nenit 179, të këtij Kodi, organi publik kompetent i dërgon subjektit të ekzekutimit një njoftim për të ekzekutuar detyrimin, sipas aktit administrativ, dhe i lë atij një afat të arsyeshëm.

2. Njoftimi i ekzekutimit vullnetar bëhet në formë të shkruar dhe i dërgohet formalisht subjektit të ekzekutimit.

Neni 170

Përmbajtja e njoftimit vullnetar

Njoftimi për ekzekutimin vullnetar duhet të përmbajë:

- a) një shkurtim të aktit administrativ që do të ekzekutohet;
- b) një informacion mbi mënyrën e ekzekutimit dhe të dhëna të tjera të nevojshme për ekzekutimin;
- c) paralajmërimin që i bëhet subjektit të ekzekutimit që në rastet e mosekzekutimit vullnetar, brenda afatit të caktuar në njoftim, fillon ekzekutimi i detyrueshëm.

KREU III EKZEKUTIMI I DETYRUESHËM I AKTIT ADMINISTRATIV

Neni 171

Koha e ekzekutimit të detyrueshëm

Ekzekutimi i detyrueshëm në ditët e pushimit dhe festave zyrtare, si dhe ekzekutimi ndërmjet orës 19⁰⁰ - 7⁰⁰ mund të kryhet vetëm në rast urgjence nëse, si pasojë e mosekzekutimit, cenohet interesi publik, bazuar në një urdhër me shkrim të arsyetuar të organit kompetent për ekzekutimin.

Neni 172

Njoftimi për ekzekutimin e detyrueshëm

1. Përveç rasteve të ekzekutimit të menjëhershëm, sipas nenit 179, të këtij Kodi, nëse detyrimi nuk zbatohet vullnetarisht, organi publik kompetent njofton subjektin e ekzekutimit për ekzekutimin e detyrueshëm.

2. Njoftimi i ekzekutimit vullnetar bëhet në formë të shkruar, i njoftohet formalisht subjektit të ekzekutimit dhe përbën akt administrativ.

3. Nëse paraqitja e ankimit nuk ka efekt pezullues, sipas ligjit të posaçëm ose nëse gjatë procedurës administrative rezulton qartazi se pala nuk e përmbush vullnetarisht detyrimin, njoftimi është pjesë e vetë aktit administrativ që ekzekutohet.

Neni 173

Përmbajtja e njoftimit për ekzekutimin e detyrueshëm

1. Njoftimi për ekzekutimin e detyrueshëm duhet të përmbajë:

- a) një shkurtim të aktit administrativ që do të ekzekutohet;
- b) datën dhe orën e planifikuar për kryerjen e ekzekutimit.
- c) një informacion mbi mënyrën e ekzekutimit dhe të dhëna të tjera të nevojshme për ekzekutimin.

2. Në rastin kur ekzekutimi i detyrueshëm bëhet në përputhje me nenin 176, të këtij Kodi, njoftimi përmban, nëse është e mundur, edhe shumën e shpenzimeve të ekzekutimit.

Neni 174

Ekzekutimi i detyrueshëm i detyrimeve në të holla

Ekzekutimi i detyrimeve në të holla kryhet nga organi publik kompetent, sipas dispozitave të ligjit që rregullon procedurat tatimore dhe ligjit për kundërvajtjet administrative, të cilat zbatohen, për aq sa është e mundur.

Neni 175

Ekzekutimi i detyrimeve jofinanciare

1. Detyrimet jofinanciare janë ato detyrime që kanë të bëjnë me kryerjen e një veprimi, lejjimin e kryerjes së një veprimi apo ndalimin e kryerjes së një veprimi nga subjekti i ekzekutimit, me përjashtim të pagesës në të holla.

2. Ekzekutimi i detyrueshëm i detyrimeve jofinanciare kryhet nëpërmjet njërit prej instrumenteve të

ekzekutimit, të parashikuara në nenet 176 deri në 178 të këtij Kodi.

Neni 176

Ekzekutimi i detyrimeve jofinanciare nëpërmjet të tretëve

1. Organi publik kompetent për ekzekutimin mund të ngarkojë një person të tretë për përmbushjen e detyrimeve jofinanciare nëse:

a) detyrimi jofinanciar është një veprim i një natyre të tillë, që mund të përmbushet nga një person i tretë;

b) subjekti i ekzekutimit nuk e ka përmbushur apo e ka përmbushur pjesërisht detyrimin jofinanciar.

2. Përmbushja e detyrimit nga personi i tretë bëhet me shpenzimet e subjektit të ekzekutimit.

3. Organi publik kompetent për ekzekutimin llogarit shpenzimet dhe urdhëron subjektin e ekzekutimit të depozitojë paraprakisht shumën e nevojshme për mbulimin e tyre.

4. Detyrimi, sipas pikës 3, të këtij neni, ekzekutohet në përputhje me rregullat për ekzekutimin e detyrimeve financiare, nëse subjekti i ekzekutimit nuk e depoziton shumën e shpenzimeve të ekzekutimit.

Neni 177

Detyrimi për bashkëpunim

1. Nëse përmbushja e detyrimit jofinanciar nuk mund të arrihet, sipas parashikimeve të nenit 176, të këtij Kodi, dhe subjekti i ekzekutimit nuk e ka përmbushur plotësisht ose pjesërisht këtë detyrim, organi publik kompetent zbaton forcërisht detyrimin jofinanciar, në përputhje me dispozitat e këtij Kodi dhe legjislacionin në fuqi.

2. Policia e Shtetit mbështet organin publik për ekzekutimin e detyrimeve jofinanciare, sipas pikës 1 të këtij neni.

Neni 178

Ekzekutimi i vendimeve të ndërmjetme

1. Ekzekutimi i vendimeve të ndërmjetme, në zbatim të nenit 67, të këtij Kodi, që parashikon detyrime jofinanciare, kryhet në përputhje me dispozitat e neneve 176 dhe 177, të këtij Kodi, edhe përpara bërjes së aktit të ekzekutueshëm.

2. Njoftimi i ekzekutimit, në rastin e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, është pjesë e aktit që urdhëron marrjen e masës përkatëse.

3. Detyrimet, sipas vendimeve të ndërmjetme, ekzekutohen brenda 3 ditëve nga nxjerrja e aktit.

Neni 179

Ekzekutimi i menjëhershëm

1. Organi publik mund të ushtrojë në mënyrë përjashtimore një nga mënyrat e ekzekutimit të detyrueshëm, të parashikuara në nenet 176 dhe 177, të këtij Kodi, edhe pa nxjerrë paraprakisht një akt administrativ, nëse përmbushen të tre kushtet e mëposhtme:

a) është e nevojshme marrja e një mase urgjente për të siguruar rendin dhe sigurinë publike, apo shmangur kërcënime a rreziqe të menjëhershme për jetën, shëndetin, apo pronën e personave;

b) për shkak të urgjencës ekstreme për marrjen e masës, akti administrativ, që urdhëron plotësimin e një detyrimi jofinanciar, nuk mund të nxirret në kohë;

c) nuk mund të gjendet menjëherë pala, apo përfaqësuesi, të cilit do t'i drejtohet akti, për urdhërimin e plotësimin të një detyrimi jofinanciar.

2. Me kërkesë të palës së cenuar nga ekzekutimi i masës urgjente dhe brenda 8 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, organi publik duhet të nxjerrë një akt në formë të shkruar, që konfirmon veprimin e kryer. Në çdo rast, kërkesa e palës mund të bëhet jo më vonë se 60 ditë nga data e ekzekutimit.

KREU IV

PEZULLIMI, PUSHIMI DHE ANKIMIMI I EKZEKUTIMIT

Neni 180

Pezullimi i ekzekutimit

1. Ekzekutimi i detyrueshëm pezullohet kryesisht ose me kërkesë të subjektit të ekzekutimit në rastet kur:

- a) vërtetohet se ekziston rreziku i shkaktimit të një dëmi të rëndë dhe të pazëvendësueshëm për subjektin e ekzekutimit dhe pezullimi në këtë rast nuk e cenon interesin publik;
- b) gjykata kompetente për çështjet administrative ka vendosur pezullimin e zbatimit të aktit, sipas dispozitave të legjislacionit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative;
- c) ekzekutimi është kryer apo është duke u kryer ndaj një subjekti që nuk detyrohej;
- ç) sipas ligjit, ekzekutimi nuk lejohet;
- d) në rastet e tjera, të parashikuara nga ligji.

2. Në të gjitha rastet, organi publik arsyeton vendimin e tij për pezullimin e ekzekutimit të detyrueshëm.

Neni 181

Pushimi i ekzekutimit

Ekzekutimi i detyrueshëm pushon në rastet kur:

- a) subjekti i ekzekutimit e ka përmbushur detyrimin;
- b) akti administrativ, që përbënte bazën e ekzekutimit, është shfuqizuar apo anuluar;
- c) në rastet e tjera, të parashikuara nga ligji.

Neni 182

Shtyrja e ekzekutimit

Ekzekutimi i detyrueshëm shtyhet në rastet kur:

- a) organi publik ka vendosur shtyrjen e tij për një afat të caktuar;
- b) një akt tjetër zëvendëson aktin që ekzekutohet;

Neni 183

Pasojat e ekzekutimit të aktit të shfuqizuar ose të anuluar

1. Kur ekzekutimi vullnetar apo i detyrueshëm është kryer dhe akti është shfuqizuar ose anuluar më pas, subjekti i ekzekutimit ka të drejtë të kërkojë rikthimin në gjendjen e mëparshme apo gjendjen përkatëse, sipas aktit të ri.

2. Kërkesa shqyrtohet nga organi publik kompetent për ekzekutimin, me kërkesë të palës që ka qenë subjekt i ekzekutimit.

Neni 184

Ankimi ndaj veprimeve të ekzekutimit

1. Ndaj njoftimit për ekzekutim mund të bëhet ankim në përputhje me dispozitat e këtij Kodi. Ankimi shqyrtohet drejtpërdrejt nga organi epror i organit kompetent për ekzekutimin, brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes. Ankimi mund të bëhet vetëm për mënyrën e ekzekutimit të zgjedhur dhe nuk ka

efekt pezullues.

2. Pala mund të ankohet në organin e parë të organit kompetent për ekzekutimin, kur veprimet e kryera për ekzekutimin e detyrueshëm tejkalojnë pjesën urdhëruese të aktit që ekzekutohet ose kur këto veprime janë në kundërshtim me dispozitat urdhëruese të këtij Kodi. Paraqitja e ankimit nuk ka efekt pezullues dhe ai shqyrtohet brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së tij.

3. Përfundimisht, në rast se vazhdimi i ekzekutimit mund të përbejë një kërcënim për shëndetin, jetën apo për pronën, pala mund t'i drejtohet drejtpërdrejtë gjykatës kompetente për çështjet administrative.

PJESA E NËNTË DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 185

Dispozitë kalimtare

Për procedurat administrative, që kanë filluar para hyrjes në fuqi të këtij Kodi, zbatohen dispozitat e ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

Neni 186

Aktet nënligjore dhe rregullat e brendshme

Brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij Kodi:

a) Këshilli i Ministrave miraton aktet e përcaktuara në pikën 7, të nenit 59, dhe në pikën 3, të nenit 76, të këtij Kodi.

b) Organet publike miratojnë rregullat e brendshme të punës në zbatim të dispozitave të këtij Kodi.

Neni 187

Referencat në legjislacionin në fuqi

Me hyrjen në fuqi të këtij Kodi, çdo referim që dispozitat ligjore dhe nënligjore bëjnë në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, apo dispozita të veçanta të tij, vlerësohet si e bërë në këtë Kod, për aq sa është e mundur.

Neni 188

Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij Kodi:

a) ligji nr. 8485, datë 12.5.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, shfuqizohet.

b) Çdo dispozitë ligjore dhe nënligjore që vjen në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi shfuqizohet.

Neni 189

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 1 vit pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratur në datën 30.4.2015

Shpallur me dekretin nr. 9112, datë 22.5.2015, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani